

AKTET
Journal of Institute Alb-Shkenca
Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca
Vol. IV, 2011



AKTET
Journal of Institute Alb-Shkenca
Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca

Vol. IV, Nr 4
© 2011 Institute Alb-Shkenca

ISSN 2073-2244
www.alb-shkenca.org

Editor-in-chief

Robert Magari, Ph.D., Beckman Coulter Inc., Miami, Florida, USA

Editors

Anila Hoda, Dr, University of Agriculture, Tirana, Albania

Ardian Harri, Ph.D., Mississippi State University, Mississippi State, Mississippi, USA

Eshref Januzaj, Dipl.-Inform. Univ. (M.Sc.) Technische Universität Braunschweig, Germany

Evan Rroço, Prof., Dr., University of Agriculture, Tirana, Albania

Kristaq Jorgo, Dr., University of Tirana, Tirana, Albania

Lulzim Dragidella, Dr., University of Applied Sciences, Regensburg, Germany and University of Prishtina, Kosovë

Margarita Ifti, Ph.D., University of Tirana, Tirana, Albania

Musa Rizaj, Prof., Dr, University of Prishtina, Prishtina, Kosovë

Naim Shabani, Dr., Ludwig - Maximilians - University, Munich, Germany

Nebi Caka, Prof., Dr., University of Prishtina, Prishtina, Kosovë

Nikolla P. Qafoku, Ph.D., Pacific Northwest National Laboratory, Richland, Washington, USA

Pandi Zdruli, Ph.D., Mediterranean Agronomic Institute of Bari Valenzano, Bari, Italy

Roza Allabashi, Dipl. Ing. Dr., University of Natural Resources and Applied Life Sciences, Vienna, Austria

Zeqirja Neziri, Prof., University "St. Cyril and Metodij", Skopje, Macedonia

Technical editor

Roland Lelaj, Millennium Research Group, Toronto, Canada

CONTENT

DIFFICULTIES IN LEARNING ESMERALDA BIRCAJ , MILIKA DHAMO,VIRXHIL NANO	561
TEACHING OF ENGLISH AS A FOREIGN LANGUAGE IN TECHNICAL DISCIPLINES VJOLLCA BELEGU-CAKA, ALI CAKA	566
IDENTIFYING PROBLEMS DURING E-DISTANCE LEARNING AS A REFLECTION OF A EUROPEAN EXPERIENCE ILIR NIÇKO, DONIKA DARDHA, IRENA KALLÇO, PAVLLO CICKO	571
SOCIAL PROGRESS AND ECONOMIC PERFORMANCE (GDP) IRENA NIKAJ, JULIAN KAPO	577
SHËLLJA E DHUNSHME NË SHKOLLË DHE NIVELI I VETËPRANIMIT VALDETE ADILI	582
TRAKTATI I LISBONËS DHE NDRYSHIMET INSTITUCIONALE TË BASHKIMIT EVROPIAN ABDULLA AZIZI	587
TË JESH PRIND I NJË FËMIJE ME ÇRREGULLIME ZHVILLIMI: STRATEGJITË E PËRBALLJES SË STRESIT ERJONA DERVISHALIAJ	598
RËNDËSIA E APLIKIMIT TË STRATEGJISË SË “PROJEKTIT KËRKIMOR” NË LËNDËN E HISTORISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR ZHULJETA KADILLI, ROLAND GJINI	603
THE PERCEPTION OF THE CORRUPTION INTO PUBLIC ADMINISTRATION BY THE REPUBLIC OF ALBANIA CITIES’ ELECTORATE ALEKSANDËR KOCANI, DORINA BËRDUFI	610
PËRCAKTIMI I CAKUT TË GABIMIT QË FUT KUOTA NË HALLKËN E FUNDIT TË KAMPIONIMIT TË NJË ANKETIMI KUNDREJT KAMPIONIMIT SISTEMATIK ALEKSANDËR KOCANI, ELUIZA DASHO	615
ADMINISTRATA PUBLIKE DREJT HAPËSIRAVE EUROPIANE MARJANA LAKO	619
THE DECENTRALIZATION PROCESS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA IN FUNCTION OF SOLVING INTER-ETHNIC RELATIONS ADIL ZENDELI, DITURIJE ISMAILI	624
TECHNICAL TERMINOLOGY AS A PERMANENT SOURCE OF VOCABULARY ENRICHMENT NEBI CAKA, ALI CAKA	629

THE TWO-SIDED MEDAL OF BODY LANGUAGE: UNDERSTANDINGS AND MISUNDERSTANDINGS BETWEEN ALBANIANS AND FOREIGNERS AIDA GJINALI, ANASTASI PRODANI, I. LEAL VALLADARES, JEAN NICOLAS VIAL	633
STATE AND THE LITERARY SCIENCE IN CONTEXT OF GLOBALISATION ARBEN HOXHA	640
DIASPORA AND THE INITIATIONS OF ALBANIAN FOLKLORISTICS ARBEN DUSHI	645
ITALIANIZMAT E ARBËRESHËVE TË ITALISË SIPAS FJALORIT TË KAMSIT NË PËRQASJE ME ITALIANIZMAT NË GJUHËN SHQIPE ORJETA BAJA, MERITA HYSA	650
NDIKIMET E RUSISHTES MBI SHQIPEN PËRMES LITERATURËS TEKNIKO-SHKENCORE EDA SHEHU, VILMA PROKO	655
PRE-SERVICE EFL TEACHERS' BELIEFS ABOUT LANGUAGE LEARNING ELIDA TABAKU	660
A TRANSLATION ANALYSIS OF COMPLEX SENTENCES FROM ENGLISH INTO ALBANIAN IN THEODORE DREISER'S NOVEL "THE GENIUS" GENTJANA TARAJ	665
THE SPECIALTY OF PHONETIC-PHONOLOGY IN THE SPOKEN OF KARADAK – SHKUP ASLLAN HAMITI	672
TEXT STUDIES BEYOND THE SENTENCE IN ALBANIAN – CASE STUDY: PARAGRAPH LINDITË SEJDIU - RUGOVA	677
DENDËSIMI EMOCIONAL I SHENJËS, NËPËRMJET PËRFTESAVE POETIKE MODERNE E POSTMODERNE NË KOHËN E BRITMËS, V. ZHITI MARISA KËRBIZI	682
THE SYMBOLISM OF THE HELL AND ITS SEMANTICS IN THE ALBANIAN NOVEL MUHARREM JAKUPI	689
DIACHRONICS AND SYNCHRONICS OF ALBANIAN TOPONYM NOTES IN THE REGION OF PELAGONIJA MUSTAFA IBRAHIMI	694
CLOTHING OF KERCOVA - TRADITION OF DEDICATION TO CONTINUITY ADEM XHELADINI	703
THE FORMATION OF SOME VERBS IN FRENCH DERIVEN FROM GIVEN ANIMAL NAMES	708

IRENA FISTANI

DIFFICULTIES, INSTRUCTIONS AND INSTITUTIONAL OBJECTIVES DURING THE LEARNING PROCESS

LENDITA GJIKOLLI

717

VEÇORITË E TERMINOLOGJISË PYJORE SI FUSHË E NGUSHTË E DIJES

LULJETA MINE , SHPRESA DELIJA

722

MBI VEPRIMTARINË E DEGËS SË KLUBIT “BASHKIMI” NË ELBASAN DHE TREVAT E TIJ

MAJLINDA PEZA (PERRIU)

728

NDIKIMET KULTURORE E GJUHËSORE TË GJUHËS SHQIPE NË ORËT E MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE SI GJUHË E HUAJ

MARSELA HARIZAJ

736

SOME ENGLISH TRAVELLERS ABOUT THE ALBANIAN NATIONAL COSTUMES IN THE XIX CENTURY GREECE

SHPRESA HOXHA

741

ACRONYMS IN THE SPOKEN AND WRITTEN ALBANIAN DISCOURSE

SHYKRANE GËRMIZAJ

745

SI TË BËHET NJË VLERËSIM I PAVARUR E I VETËDIJSHËM I KURSEVE TË FORMIMIT PASUNIVERSITAR TË OFRUARA NË RRJET PËR MËSUES GJUHE

SONILA PIRI

751

ON SOME ISSUES OF THE EXPRESSION OF CONDITIONAL RELATIONS IN THE TODAY ALBANIAN LANGUAGE

MATILDA PERLLAKU

756

ECONOMICAL ASPECTS OF ELBASAN CITY AT THE END OF XIXth CENTURY AND THE BEGINNING OF XXth CENTURY

ZHULJETA KADILLI

766

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NGA KOSOVA E VISET E TJERA DHE TRAJTIMI I TYRE NGA QEVERITË E SHQIPËRISË NDËRMJET DY LUFTRAVE BOTËRORE (1918-1941)

JANI SOTA

773

GJENEZA, PËRPUNIMI DHE PËRKRYERJA E NJË VEPRE

VIOLA ISUFAJ

784

ON SOME FEATURES OF NARRATION ON KADARE’S WORK

LEDIA DEMA

794

WOULD SUMERIAN LANGUAGE BE A FURTHER POSSIBILITY TO ALBANIAN HISTORICAL LINGUISTICS AND ALBANOLOGY?

ANASTAS S. SHUKE

798

GUIDE FOR AUTHORS

AKTET publishes papers presented during the annual meeting of Institute Alb-Shkenca (IASH). The journal publishes only research papers containing original, novel, and relevant research that enhances the existing knowledge. The editorial board consists of an editor-in-chief, a technical editor, and several subject areas editors.

Manuscripts can be submitted in English or Albanian, English being the preferred language. Submission of the manuscript implies that essentially the same research is not published before (except in a form of a summary, lecture, or thesis), is not submitted elsewhere for publication, and that the manuscript is approved by all the authors and authorities where the work is carried out. Authors are requested to disclose any conflict of interest and provide information for any financial support used to conduct the research. An accepted manuscript cannot be published elsewhere without the written permission of IASH.

The journal publishes only original work that contributes to the advancement of science. Plagiarism is not acceptable and will be reported to the appropriate authorities. Conclusions should be justified by the experimental design and data. The information presented in the paper should have sufficient details to permit others replicate the work. Authors should retain the research data and should be able to provide these data to the editorial board if asked. Please use appropriate language, be concise and grammatically correct. Authors are responsible for the scientific accuracy and the format of the submitted manuscript as well as the content of the correspondence with the editors.

ORGANIZATION OF MANUSCRIPT

Manuscript should be limited to 2500 words including title, summary, text, bibliography, tables, graphs, etc. Manuscript should be saved in Microsoft® Office Word, A4 format, 2.5 cm (1 inch) margins, single column double spaced, and Times New Roman font of size 12. Do not use footnotes or endnotes or any other formatting. Pages should be numbered while the title, names and contact information of the authors should be provided on the first page. Manuscript should contain:

1. **Title:** Be concise and clear. Provide authors contact information. Superscripts a, b, c can be used to indicate authors affiliations. Corresponding author should be indicated with an asterisk. Provide title in both Albanian and English.
2. **Key words:** Provide 4-5 key words that represent the subject of the paper.
3. **Summary:** Should represent the essence of the work and should be limited to 150 words. Provide summary in both Albanian and English.
4. **Introduction:** Describe your work, related research, its importance, and clearly state the objective of the study.
5. **Material and methods:** Provide details on the materials being used and experimental procedures. Provide sufficient details to allow work to be reproducible.
6. **Result and discussions:** Results should be clear and illustrated in tables and graphs. Use statistical analysis and draw conclusions based on statistical significance. Discuss in details the implication of

the results. Conclusions should be directly related to the results obtained. Conclusions should not be speculative, spontaneous, or/and summarizing the already available information.

7. Bibliography: List literature sources alphabetically base on the last name of the first author. Every literature source must be cited in the text by the related number. A limit of 20 literature sources can be provided. A citation 'in press' implies that the reference is accepted for publication. Unaccepted manuscripts cannot be referenced. Do not use references from the internet except for the online publications.

Examples of references:

1. Libby WF, Anderson EC, Arnold JR (1949) Age determination by radiocarbon content. Science 109, 227-228.
 2. Strunk W, White EB (1979) The elements of style, third ed. Macmillan, New York
8. Tables: Present each table on a separate page. Tables should be numbered and titled. Limit the number of tables to five.
 9. Figures and graphs: Present figures and graphs on separate pages after the tables. Altogether provide no more than five figures and graphs.

Authors submitting social sciences contributions may disregard sections 5 and 6 when preparing their manuscripts. Manuscripts that do not conform to the above format will not be considered.

SUBMISSION

Manuscripts are electronically submitted through the ALPA system at, http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet_v4_nr1/. Instruction for use of the ALPA system is found at the address above as well as at, www.alb-shkenca.org

Submit the manuscript within the deadline announced by the editorial board. Along with the manuscript submit a message directed to the editorial board, stating the desire to publish the manuscript and indicating the participation in the annual meeting of IASH.

Submitted manuscripts will be double-blinded reviewed by at least two experts of the subject area. Editorial board will make the decision on the acceptance of the manuscript based on the recommendations from the reviewers and notify this decision to the authors. Authors should be notified on the status of the manuscript within a 3-4 months period. The entire process will be electronically documented.

DIFFICULTIES IN LEARNING

ESMERALDA BIRCAJ¹, MILIKA DHAMO², VIRXHIL NANO²

¹ "Kristal "University, Fier, Social Science and Education Faculty

² "Tirana "University, The Social Science Faculty

Email: aldabircaj@hotmail.com

AKTET IV, 4: 561 - 565, 2011

SUMMARY

The expression "Difficulties in learning" refers to some disorders and PENSJA that damage the preacademic and academic development of the child. In this study we have tried in different ways to strengthen the idea that the children have different learning abilities. The ways that they learn have raised some interesting questions like:

- If the IQ does not measure the learning abilities of the child, than what test can do that?
- What intelligent ways of learning should be better develop on a child?
- What is the role of the teaching style in classroom communication?
- What are the mental models linked with the teaching process?
- Have we been able to discover the strong points of our students, (pupils)?
- Have we really valued their potential?

The children with learning difficulties are not "study cases". Instead they are complicated organisms that function in very complex ways. Most of the learning disorders result from the teaching disability from the teachers. So the principal should be their respectful treatment and evaluation. We should have the ability to see them as people, to notice the way they work, move, talk, and process the information.

Key words: Difficulties in learning, child dignity, the learning esthetics, strong point, vision.

INTRODUCTION

The most important word that the education is confronted is 'INEQUALITY'.

The change of the natural inequality into an unrightfully one is very common in the process of education[2] . THE NATURAL INEQUALITY IS BIGGER THAN THE UNRIGHTFULLY ONE.

The children in general are not equal on these aspects:

1. The economic conditions of the family /place of birth
2. The cultural level of the family /place of birth
3. Psychological qualities

These natural inequalities become reasons for an unfair treatment of the children (discrimination). The source of this discrimination is the teacher. Our typical teacher judges like this:

THE HARDER IT IS FOR THE STUDENTS TO LEARN,
THE LESS ATTENTION THEY DESERVE.

THE PROBLEM DESCRIPTION

This study describes one of the most important reasons of the results produced by the education. The teaching is done through the unfair treatment of the children (discrimination) even though each child can learn to be successful. The study was done in the classes of "Lef Sallata" school (a 9 year primary education level). We were present in different subjects, on different periodic teaching hours. The study took part during the school year 2009-2010. Our tries have had under supervision the knowledge, without eliminating the teacher's ability to understand the student from the psychological point of view.

This study expresses the education reality, which puts the teacher in the center, and most of the investments should be done for the them, in order that they can have the ability to see their students as people, to notice the ways the students work, move, think, talk, and process the information because our student “.....knows what he can do by his actions and behaviors. Without creative activities we do not have insurance for growth” .[1]

THE AIM (GOAL)

1. To better understand the reasons of the existing disparities in the quality of the education and equal opportunities.
2. To evaluate the needs of the unsuccessful students in their studies and to increase the responsibility of the teachers, school directors, parents in the achievements of each child, to improve the quality and involvement in school life.

THE MATERIALS

They were designed in two forms:

1. Questionnaires
2. Supervision

The questionnaires were filled out from the pupils, teachers, the school directors, and the parents selected in connection with the evaluation of the unsuccessful student's needs in learning.

The teacher's supervision was done in 5 topics:

- a. The environment of the learning
- b. The teaching plans
- c. Evaluation usage
- d. Personal and professional qualities of the teachers
- e. Overall evaluation

THE RESULTS

The reasons of these happenings are very complex. We do not have in our classrooms an environment that supports the learning process. The support and motivation are not enough to really help in a concrete way and differentiated work. The teachers do not explain for the actual pupils present in their classes, but for the median

pupil. They direct the class disconnected from the specific needs of the different pupils in the class.

The needs of the unsuccessful students are grouped mainly in pedagogical, social, psychological, and emotional needs.

From the study we noticed that the lowest levels of the teaching process are:

- a. *The learning environment*
- b. *The usage of the evaluation during the teaching process.*

THE FACTS

There are a considerable percentage of the students that are unsuccessful in learning. During the school year 2009-2010 in “Lef Sallata” school 1159 students started their obligated studies, 613 in the lower level of the education and 546 in the higher level of the education. There are 34 classrooms in the school, 19 for the LE and 15 for the HE. The teaching staff has 39 teachers, among them 4 directors, and 35 teachers. 17 of them teach in the LE, 18 in the HE. The school's GPA is 7.5.

- The passing level of the school is 93%, the LE with 86% and the HE with 99%. From the term's analyzing we noticed a very important problem, the students with grades from 4-5.
- The failing students are 79, 21 only in one subject, 15 in two subjects, 43 in more than 3 subjects.

The students with a GPA of 5 know less that they can learn. Why a part of these pupils have such low grades? According to the Proff. Stavri Llambri in the “HIDDEN ABANDONMENT” these types of students compared with the ones with high GPA are:

- a. Encouraged 5.4 times less
- b. Get yelled 1.6 times more
- c. Are questioned 4.7 times less [2]

Dr. Liew Voon Kiong lists some factors that relate to the low results of these students:

- d. Social economic factors
- e. Human nature linked to the level of intelligence
- f. School's infrastructure[8]

He raises the question: “*Should the teacher be responsible for the low grades of the student?*”

THE REASONS ACCORDING TO THE TEACHERS

1. The bad learning conditions 23 %
2. The absence of the collaboration with the parent, connected relationship 36%
3. Students should study up to 6 hours a day 39 %
4. The problems in the organization of the teaching, education, communication and collaboration of the teachers 2 %

THE PROFESSIONAL REASONS

The reasons are included in one, a misunderstanding between the OBJECT and the GOAL (pupil's achievement). Our education system is ALL ORIENTED TOWARD THE OBJECT. Teaching has in its center the text, (book) which is an object. The school's directors supervise only the teacher's professionalism, which is an object. The yearly school plan has only one activities list, which is an object. As a result the only goal of the teacher and the directors- the RESPONSIBILITY for the student's achievement is bypassed. The main goal is to prepare the students with the democratic expressions, the values and the knowledge of the democratic citizenship.

RECOMMENDATIONS

1. The improvement of the rechecking of the yearly school programs, the improvement of the teaching standards, implementation of a better methodology and infrastructure.

2. The teaching methods should focus the attention on the learning environment and the process of the evaluation in order to get a feedback from the class.

To increase the responsibility of the teachers and the school's directors on the achievement of each pupil the key word is PLANNING FROM THE END TO THE BEGINNING INCLUDING EVERYTHING.

"To fail planning, means to plan the failing".

For better teaching plans which put the student in the center we should answer these questions:

1. What should be achieved?
2. What is the idea being transmitted?
3. What will the students be able to do at the end of the hour?

4. How are we going to reach our goal?
5. How are we going to know what we have achieved?

On the school level each change should be:

SHIFTING OF

THE ATTENTION FROM THE OBJECTS TO THE GOALS.

1. THE TEACHER

The teaching profession is one of the most natural ones to work by objectives and vision, [4]- writes M. Fullan.

Teaching should meet some standards as :

- To activate and support the student's attention during the learning process.
- To support the students in their learning projects.
- To adapt the learning activities with the style that the teacher thinks is right for the student. [7]

This is an environment created by the teacher, who uses vivid forms of interactive activities in the classroom, where the problematic students find themselves developing according to their abilities.

The teaching methods and interactive learning in collaboration with each other, the application of the multiple intelligence, are efficient means of creating such an environment. [10]

Referring the curricula we would say that " *the pupils with low improvement* "are those groups where the aim is to reach the minimal objectives needed for each subject. The teachers keep the responsibilities for their student's achievements, making their minimal objectives needed to learn a unit. (OMDN) [1]

THIS MEANS A SHIFT OF DIRECTION, FROM THE TEACHING" FOCUSED ON THE BOOK", TO THE TEACHING "FOCUSED ON THE LEARNING OBJECTIVES".

The teaching objectives should be understood as changes to improve the quality and not the formality. The objectives are not goals in themselves but means to reach a certain goal, to direct the teacher in the selection of the teaching methods in function of the goals realization and in the process of evaluation, to see how the goals are met. [5]

Each teacher should know very well the pupil's individuality, to know who is he talking to, communicates, explains, to get information about family, social and environment factors. During his work the teacher should notice the VECORITE of the student's development. [6]

The teacher and the parents should collaborate with the school psychologist or specialized centers to test the unsuccessful child psychologically, to determine if the child has learning disabilities, mental retardation, attention deficit disorders (ADD) or hyperactivity.

2. THE SCHOOL DIRECTORS

After the teacher's observation, at the end of the teaching hour are recommended to be done some mini quizzes to test the student's received knowledge from the OMDN list of the unit.

This means a change of direction, the observation "focused on the teacher" has changed into an observation focused on the "student's achievements".

3. THE SCHOOL

The yearly school plan changes the traditional format totally starting from the measured objectives of the yearly achievements of the students. This means another change of direction from the plan that "puts in the center the activities" in a plan that puts in the "center the achievements of the students".

These changes will bring other changes where:

• THE TEACHER is transformed:

From	To
Book centered	Creative
Very sure about the quality of the work	Doubtful about the results of his work
Does not self evaluate	Self evaluates with mini quizzes
Does not need the colleges	Needs the coworkers
Does not need special training	Needs special training
Feels obligated to have a relationship with	They turn to collaborators
The parents	

• THE SCHOOL DIRECTOR

1. Cannot make the school plan by him, but should ask for the collaboration of the teachers and the community helpers.
2. Cannot control in an autarkic way, he should ask for monitored checkups.
3. Cannot have meeting of the pedagogic staff with themes borrowed from the literature, he should exchange ideas on how to reach the objectives.

This way the students not only will profit from the teaching method, but will be partners in the teaching process. [12]

• THE ACTORS OF TEACHING

The meaning of the teaching actors gets wider.

From : Teachers +Parents

to :

Teachers+Parents+Students+Community

The directors+Teacher+Parents+students =The school ((Results+Achievement+Performance)

THE RESULTS OF THE STUDY

The children with learning disability are not "case studies" they are organisms that function in complex ways. [6] Most of the disabilities result from the incapacibilities of the teachers. So the teacher should:

1. Be persistent to involve all the students in the learning process
2. To motivate the students, to find teaching methods in order to induce the desire to participate actively in the learning process
3. To create and maintain the interest, to initiate and motivate the academic activities and the increase of the performance based in intellectual abilities, those that the students can be better at. The principal should be: to evaluate and treat the children with respect because their dignity is the highest quality that they should be proud of, it is what makes them happy, valuable and priceless. [11]

BIBLIOGRAPHY

1. Muka , Petrit: "Teaching by objectives" , Tirana 1995
2. "The hidden abandonment" Stavri Llambiri, Tirane : Pegi

3. Davis, B "Tools for teaching", Jossey –Bass, San Fransisco
4. Fullan,M"New Understanding of change in education" Tiranë:Pegi,2001
5. Musai,B: Methodology of teaching /Bardhyl Musai,Tiranë:Pegi,2002
6. Musai,B(2003) Educational Psychology, reprint,Tiranë:Pegi
7. Nevo,D.,School-Based Evaluation:A Dialogue for School Improvement,Oxford:Pergamon,1995
8. Dr.Liew Voon Kiong
9. Gardner,H.(2003): The mind of the uneducated, ISP, Tirana
10. Gardner,H.(2003): Dimensions of mind, ISP, Tirana
11. HCN(2003) Understanding Human Rights
12. Hyseni,H(2004): Rights of students eyes of students.

TEACHING OF ENGLISH AS A FOREIGN LANGUAGE IN TECHNICAL DISCIPLINES MËSIMI I ANGLISHTES SI GJUHË E HUAJ NË DISIPLINAT TEKNIKE

VJOLLCA BELEGU-CAKA¹, ALI CAKA²

¹ Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

² Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË

Email: vjollca.caka@gmail.com

AKTET IV, 4: 566 - 570, 2011

PERMBLEDHJE

Është konstatim i përgjithshëm, në radhë të parë i punëdhënësve, jo vetëm te ne, se shumica e të diplomuarve në disiplinat teknika janë jo aq të zhdërvjelltë në komunikim, si me shkrim, ashtu dhe me gojë. Kjo ka të bëjë me komunikimin në gjuhën amtare. E kur dikush nuk e ka lehtë të komunikojë në mënyrë të efektshme në gjuhën amtare, atëherë e ka edhe më vështirë në një gjuhë të huaj. Me këtë problematikë dhe me çështjen e mësimit të gjuhës angleze si gjuhë të huaj në fakultetet teknike do të merret ky punim. Në bazë të përvojave personale me studentë, duke e ilustruar këtë me shembuj konkretë, do të jepen edhe sugjerime për ndryshimet që do të duhej të bëheshin në mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj në fakultetet teknike e me qëllim të zotërimit sa më të mirë të saj.

Fjalët çelës: mësimi-i-anglishtes, gjuha-e-huaj, disiplinat-teknike, komunikimi-efektiv, anglishtja-teknike

SUMMARY

It is a general conclusion, of the employers at first, that the majority of graduates in technical disciplines are not very versatile (eloquent) in communication, neither in written form nor oral. This has to do with communication in mother tongue as well. And when someone does not easily communicate effectively in the native language, then he/she even more difficult can communicate in a foreign language. This issue and the issue of teaching English as a foreign language in technical faculties will be discussed in this paper. Concrete examples have been illustrated in this paper, based on personal experiences with students, as well as suggestions for changes in the methodology of teaching English as a foreign language in technical faculties in order to better master it.

Key-words: teaching-of-English, foreign-language, technical-disciplines, effective-communication, technical-English

HYRJE

Në shekullin 21, bota është shndërruar në një "glob të vogël" brenda të cilit miliona njerëz, përfaqësues të kulturave të ndryshme nga i tërë rruzulli tokësor, komunikojnë çdo ditë me njëri-tjetrin. Në këtë kontekst, gjuha angleze është duke dominuar çdo ditë e më shumë, si gjuhë gjithëpërfshirëse në shumë aspekte të jetës së njerëzve, prandaj edhe me të drejtë njihet si "lingua franca". Gjuha angleze është bërë mjet komunikimi ndërmjet folësve të gjuhëve të ndryshme, pjesërisht për shkak të globalizimit

ekonomik, e pjesërisht për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Kjo e bën gjuhën angleze gjuhën më të kërkuar ndër gjuhët e huaja. Ajo njohësit të saj i mundëson jo vetëm që të komunikojë lehtë me pjesëtarët e popujve të tjerë, por edhe ia rrit mundësitë për punësim më të mirë dhe zhvillimin e karrierës profesionale. Kjo do të thotë që aftësitë për komunikim efektiv në gjuhën angleze profesionale e bëjnë një inxhinier më të vlefshëm për kompaninë dhe njëherazi ia rrisin shanset për promovim, avancimin si dhe ngritje të pagës së

tij. Këtu me komunikim të efektshëm nënkuptohet jo vetë komunikimi me gojë, por dhe aftësia e të shkruarit të letrave zyrtare, raporteve, kontratave, specifikimeve teknike, si dhe të projekt-propozimeve të adresuara grupeve me interesa të ndryshme.

Si të mësohet gjuha angleze në disiplinat teknike

Duke mos e kontestuar asnjëherë rëndësinë e gjuhës angleze profesionale, fakultetet e shkencave teknike, që nga themelimi i tyre, kanë paraparë në plan-programet e tyre universitare mësimin e saj në faza të ndryshme të studimeve. Kështu, për shembull, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë, fillimisht gjuha angleze është mësuar në dy semestrat e fundit të studimeve 5-vjeçare, me një fond prej 3 orëve në javë. Sot gjuha angleze në këtë fakultet ka fond të njëjtë orësh, por mësimi i lëndës është reduktuar në vetëm një semestër, në semestrin e parë të studimeve 3-vjeçare (sipas sistemit të Bolonjës).

Në bazë të përvojave personale me studentët, por edhe në bazë të përvojave të tjerëve, është vërejtur që ky reduktim i orëve në vetëm

një semestër dhe zhvendosja e lëndës (gjuhës angleze teknike) në vitin e parë të studimeve ka bërë që studentët të kenë vështirësi në zotërimin efektiv të saj në nivelin e duhur a të kënaqshëm. Kjo shihet edhe nga rezultatet e tyre në provimin final dhe aktivitetet e tyre gjatë procesit të mësimin (ligjëratave/leksioneve dhe ushtrimeve). Në tabelën 1 janë paraqitur shembuj të gabimeve të shpeshta të studentëve që janë hasur gjatë testeve me shkrim dhe me gojë. Studentëve u është diktuar një tekst i shkurtër dhe në bazë të gabimeve të bëra gjatë shkrimit, leximit, përkthimit dhe diskutimit të tij, ata (studentët) janë klasifikuar (grupuar) në pesë nivele.

Teksti i diktuar:

“English is the second most spoken language in the world. In many professions it is considered as mother tongue of professional languages. Through the global influence of native English speakers in cinema, music, broadcasting, science, and the internet in a recent decades, English is now one of the most widely learned language in the world....”

Tabela 1. Nivelet e njohurive të gjuhës angleze profesionale të studentëve:

Shkathësitë e studentëve në këtë nivel

Niveli 1

Studenti nuk mund të shkruajë fare me kuptim; vërehen gabime të rënda në sintaksë dhe në morfologji, madje edhe në fjalët dhe fjalitë më të thjeshta. Nuk është në gjendje të riprodhojë asnjë fjali të diktuar apo të bëjë lidhjen konsistente në kohë apo trajtë gramatikore, sado ngadalë të jetë diktuar teksti. Nuk mund t'i shkruajë korrekt as fjalët themelore profesionale, si: *electrical engineer, faculty, machine, energy, wire, speed, sound, circuit, frequency* etj., por as fjalët e thjeshta të përgjithshme.

Leximi i tekstit, posaçërisht i termave profesionalë, por edhe i atyre themelorë është i dobët, me shumë gabime dhe pa intonacion.

Përkthimi i tekstit profesional nuk mund të realizohet me ndonjë logjikë apo korrektësi pothuajse fare.

Interpretimi dhe diskutimi me gojë po ashtu i dobët dhe pothuajse fare i pamundur shpjegimi i tekstit profesional.

Shembull konkret nga punimet e studenteve (niveli 1):

Diktimi:

“English is a secent mas.....in the world. In many pe....it is consider as mather tan...True a vable influens of neidi specers in cinema, musick, brout casten, and the internet in the risin diceit English is now the mant ...lern langrit in the world....”

Përkthimi:

“Anglishtja është gjuha e dytë e cila përdoret më së shumti në botë. Mësohet duke shikuar filma, dëgjuar muzik ndërsa thuhet se gjuha e pastër mësohet duke shikuar film”...

Niveli 2

Studenti mund të shkruajë në një nivel shumë themelor vetëm fjalët dhe fjalitë e thjeshta me mjaft gabime. Mundohet të mbajë një konsistencë në trajtat e ndryshme gramatikore, por vërehen gabime në mospërshtatjen e kohëve dhe mosnjohjen e formave të pësorës dhe të ligjërit të drejtë dhe të zhdrejtë etj.

Mund të lexojë, por jo mirë, posaçërisht termat profesionalë.

Kupton vetëm tekstin e thjeshtë dhe të qartë.

Mund të kryejë vetëm një detyrë shumë të thjeshtë dhe nuk është në gjendje të përkthejë dhe të interpretojë pa gabime tekstin profesional të nivelit mesatar.

Shembull konkret nga punimet e studentëve (niveli 2-3):

Diktimi:

“English is the second most spoke language in the world. In many professional it is consider is mothertank all professional languages. True global influence of native English speakers in cinema, music, broacase seams and in the internet in risent deacase, English is now most one of most while leared lanuage in the world”.

Përkthimi

“Anglishtja është gjuha e dytë në botë që flitet. Në shumë profesione konisderohet si e të gjitha profesioneve. E vërteta e influencës globale është se flitet në kinëma musik në shërbime, në vende autoktone me interne. Aglishtja tani është gjuha e dytë që mësohet në botë.”

Niveli 3

Studenti lexon mirë, varësisht nga përmbajtja e tekstit.

Shkruan mesatarisht mirë, por ka nevojë për përmirësime konstante.

Mund të lexojë dhe të shqyrtojë instruksione të ndonjë manuali teknik.

Gjuha e tij është në nivelin minimal për të komunikuar dhe për të funksionuar në shoqëri, por jo edhe në nivelin e duhur profesional. Vërehen mangësi në përshtatjen e kohëve dhe të trajtave gramatikore në sintaksë dhe në morfologji.

Shembull konkret nga punimet e studentëve (shih më lart!):

Niveli 4

Studenti shkruan në nivelin e duhur dhe mjaft të mirë, si fjalët e përgjithshme, ashtu edhe ato profesionale, varësisht nga kompleksiteti i fjalëve dhe ushtrimeve që bën.

Lexon mirë, rrjedhshëm dhe me intonacion.

Kupton tekste të ndërlikuara me terma profesionalë dhe trajtat e ndryshme gramatikore. Mund të shqyrtojë materiale komplekse që kërkojnë njohuri të specializuar të gjuhës.

Gjuha e tij është korrekte, e disave në nivel të lartë, e që janë në gjendje të diskutojnë dhe sqarojnë dukuri të ndryshme profesionale.

Shembull konkret nga punimet e studentëve (niveli 4):

Diktimi

“English is the second most spoken language in the world. In many proffecionesions it is

considered as mother tongue of professional languages. Through the global influence of native English speakers in cinema, music, broadcasting, science, and the internet in a recent decades, English is now one of the most widely learned language in the world"

Përkthimi

"Anglishtja është gjuha e dytë më e folur në botë. Është konsideruar gjuha amë e gjuhëve profesionale. Nën ndikimin global të anglishtes folësve vendas në kinema, muzikë, radio, shkencë dhe internet, në dekadat e fundit, anglishtja tani është njëra nga gjuhët që më së shumti mësohe në botë."

Niveli 5

Studenti shkruan shumë mirë, si fjalët dhe fjalitë e përgjithshme, ashtu edhe ato profesionale, varësisht nga kompleksiteti i fjalëve dhe ushtrimeve që bën.

Lexon dhe perkthen shumë mirë, rrjedhshëm dhe me intonacion .

Kupton tekstet e ndërlikuara me terma profesionale dhe trajtat e ndryshme gramatikore. Mund të shqyrtojë materiale komplekse që kërkojnë njohuri të specializuar të gjuhës.

Gjuha e tij është korrekte dhe në nivel të lartë dhe ai është në gjendje të diskutojë dhe të sqarojnë dukuri të ndryshme profesionale.

Shembull konkret nga punimet e studentëve (niveli 5):

"English is the second most spoken language in the world. In many professions it is considered as mother tongue of professional languages. Through the global influence of native English speakers in cinema, music, broadcasting, science, and the internet in a recent decades, English is now one of the most widely learned language in the world...."

Përkthimi:

"Anglishtja është gjuha e dytë më e folur në botë. Në shumë profesione ajo konsiderohet si gjuhë amë e gjuhëve profesionale. Nën ndikimin global të anglishtfolësve vendas në kinema, muzikë, radio, shkencë dhe internet, në dekadat e fundit, anglishtja tani është njëra nga gjuhët që më së shumti mësohet në botë."

Shumica e studentëve gjenden në nivelet 2 dhe 3, ndërsa një numër i vogël janë në nivelin 1, 4 dhe 5. Ky rezultat natyrisht se nuk është i kënaqshëm, sepse një nivel i tillë i njohurisë së gjuhës së huaj nuk mjafton që studentët t'i kuptojnë si duhet, e aq më pak t'i interpretojnë dukuritë komplekse dhe proceset e ndryshme shkencore dhe teknike të parapara me plan-programin e lëndës.

Është evident fakti që plan-programi aktual dhe koha e paraparë për mësimin e gjuhës profesionale angleze kërkon një njohje të mirë paraprake të gjuhës së përgjithshme angleze, ashtu që studenti të jetë në gjendje ta kuptojë, ta shqyrtojë dhe ta interpretojë lëndën e cila zhvillohet gjatë procesit të mësimin.

Përveç këtyre njohurive të përgjithshme të gjuhës, të cilat, në parim, pritet që studentet t'i kenë trashëguar nga shkollat e mesme, studentët e vitit të parë ballafaqohet me njësi mësimore të cilat kanë të bëjnë me koncepte dhe procese të ndryshme teknike të cilat ata ende nuk kanë arritur t'i mësojnë, sepse mësohen në lëndët e viteve të larta të studimeve. Për mësimdhënësin e lëndës kjo është një vështirësi shtesë, sepse ai duhet t'i shpjegojë ato së pari në gjuhën shqipe, e pastaj ta zhvillojë njësinë mësimore përkatëse në gjuhën angleze.

PËRFUNDIM

Është me rëndësi të posaçme të bëhet klasifikimi i studentëve në grupe, në bazë të niveleve të njohurisë paraprake të gjuhës angleze, me qëllim të përshtatjes së metodikës së mësimit sipas nivelit të njohurive dhe nevojave të studentëve. Klasifikimi i studenteve në grupe në bazë të rendit alfabetik nuk është treguar i përshtatshëm për orët e gjuhës angleze, sepse shpesh ndodh që në këto grupe të qëllojnë studentë që kanë njohuri më të mira të gjuhës së përgjithshme angleze dhe kështu krijohet “kompleksi i dijes më të ulët” në grup, gjë që ul aktivitetin e studentëve të tjerë gjatë orës së mësimt.

Duke marrë parasysh që studentet që regjistrohen në fakultetet e shkencave teknike vijjnë me njohuri të niveleve të ndryshme të gjuhës angleze (disa më të mira, e shumica më të dobëta), paraqitet nevoja për rritjen e fondit të orëve të gjuhës angleze dhe mësimin e saj në dy semestra (tashti ai është 3 orë në vetëm një semestër). Me këtë rast semestri i parë do t'i kushtohet mësimt (apo përsëritjes) së gjuhës angleze të përgjithshme, ndërsa semestri i dytë do të merrej me literaturën profesionale, shtjellimin dhe interpretimin e saj në të gjitha format (shkrim, lexim dhe diskutim).

Me qëllim të mësimt të gjuhës angleze në konsistencë me lëndët profesionale do ishte mirë që lënda të zhvendosej nga viti i parë në vitin e dytë, a të tretin (të fundit) të studimeve, kur studenti të jetë tashmë i familjarizuar me termat, dukuritë dhe proceset teknike së pari në gjuhën amtare, kur, bie fjala, studentët e inxhinierisë elektrike do të dinin së paku të bënin dallimin ndërmjet *modulimit* dhe *modelimit*.

Në fund, vlen të ceket se gjatë mësimt të gjuhës së huaj profesionale duhet pasur parasysh që

studentet e sotëm janë profesionistët e së nesërme, të cilët do të udhëheqin biznese apo detyra në nivele të ndryshme, e për të cilat zotërimi i gjuhës së huaj profesionale konsiderohet si një shkathtësi jetike apo vendimtare për avancimin e bizneseve të tyre si dhe për prosperitetin e tyre profesional. Prandaj, në këtë kontekst, strukturat universitare dhe mësimdhënësit e lëndës duhet t'i përkushtojnë vëmendje të posaçme dhe hapësirë të mjaftueshme në plan-programet universitare mësimt të gjuhëve të huaja profesionale.

BIBLIOGRAFIA

1. *Altbach P. G. and Teichler, U. (2001). Internationalization and Exchanges in a Globalized University, Journal of Studies in International Education, Vol. 5 No. 1, Spring 2001 5-25 Association for Studies in International Education.*
2. Gatehouse, K. (2001). Key Issues in English for Specific Purposes (ESP) Curriculum Development, *The Internet TESL Journal*, Vol. VII, No. 10, October.
3. Krhutová, M. (2004). Specific Stylistic Features of English for Electrical Engineering, *International Conference on Engineering Education and Research "Progress Through Partnership"*, Ostrava, VŠB-TUO.
4. Kwary, D. A. (2003). Creating a Technical Vocabulary Wordlist and Web-based Materials: The First Step for Teaching and Learning ESP.
5. Podpera, I. (2006). Innovative approach to teaching English at FEI STU - Textbook and e-learning material, Bratislava..

IDENTIFYING PROBLEMS DURING E-DISTANCE LEARNING AS A REFLECTION OF A EUROPEAN EXPERIENCE

EVIDENTIMI I PROBLEMEVE GJATË TË MËSUARIT NË DISTANCË SI REFLEKTIM I NJË PËRVOJE EVROPIANE

ILIR NIÇKO, DONIKA DARDHA, IRENA KALLÇO, PAVLLO CICKO
Universiteti “Fan S. Noli” , Bulevard “Rilindësit”, Korçë, SHQIPËRI
Email: nicko_ilir@yahoo.com

AKTET IV, 4: 571 - 576, 2011

PERMBLEDHJE

Mënyrës tradicionale të të mësuarit face to face, me zhvillimin e mëtejshëm të teknikave të teknologjisë së komunikacionit i është shtuar edhe mënyra e studimit elektronik në distancë. Po cilat janë përparësitë dhe problemet që shoqërojnë këtë mënyrë të re të të nxënit?! Për këtë qëllim u mor në studim një kurs pasuniversitar në IAM-Bari, dhe u pa sjellja e tij në aspektin mësimor, në menaxhimin e teknologjisë, në aspektin organizativ dhe padyshim në rezultatet e arritura nga studentët. Mënyra e vlerësimit ka qenë ajo e intervistave cilësore të vetë studenteve, testimëve të organizuar në platforme elektronike, me ese dhe së fundi paraqitja e një projekti. Disa probleme kanë qenë në cilësinë e bashkëveprimit midis grupeve, komunikimin me stafin mësimdhënës, efektivitetin e platformës, në përdorimin e mjeteve interaktive (si chat, forumi etj), ku në këtë studim janë shprehur në vlera numerike të nxjerra nga intervistat.

Fjale kyçe: studim në distancë, aspekt mësimor, bashkëpunim, menaxhim i teknologjisë, ese.

SUMMARY

By the development of communication techniques and technology, to the face to face traditional way of learning, the e-distance learning way was added. What are some of advantages and problems that associate this new technique of learning? For this purpose a post university course was studied in IAM-Bari, where its behavior was observed in terms of learning aspects, technology management, organization aspect and on the results achieved by students. The estimation process has been carried out by qualitative interviews of the students, tests organized in electronic platform, by essays and at the end a project. Some problems were identified in collaborative quality between groups, communication with teaching staff, platform effectiveness, the use of interactive tools, which in this study are expressed in numeric values, extracted from the interviews.

Key words: e – distance learning, learning aspect, interaction, technology management, essay.

Falenderime

Falenderime të përzemërta Qeverisë Italiane dhe CIHEAM-IAM Bari për bursën e studimit dhe Prof. Luigi Sisto dhe Laura Scivetti për mikpritjen miqësore dhe mbështetjen profesionale.

MATERIALI DHE METODA

Si rast studimi u mor kursi “Të mësuarit në distancë mbi Menaxhimin e cilësisë të produkteve tipike dhe organike në zonën mesdhetare të Ballkanit”, që u zhvillua në IAM të

Barit, Mars –Tetor 2008. Në kurs u pranuan 25 studente pasuniversitare nga vendet mesdhetare dhe më gjerë, me sistemin e aplikimit me dosje, ku gjuha e huaj dhe përdorimi i kompjuterit ishin kusht. Programi u zhvillua në tre faza: 1. Në fazën

e pare Mars -Maj (8 javë) u zhvillua face to face pjesa bazë, gjithashtu për 1 javë studentët u trajnuan për organizimin e platformës dhe shkathhtësimin me të. Gjatë fazës së dytë maj – shtator (17 javë) që u zhvillua në distancë, çdo student u testua në 10 module, ku provimi u organizua në modelin me variante dhe një ese për çdo modul. Pjesë e vlerësimit ishin edhe diskutimet në forum. Në fazën e tretë face to face që u zhvillua në IAMB për 2 javë, çdo student

paraqiti një projekt në një nga modulet e zgjedhur. Për problemet që kishin të bënin me aspektin e të nxënit, të bashkëveprimit aktiv, të menaxhimit të teknologjisë dhe organizimit të kursit u zhvillua një intervistë ku morën pjesë 20 studentë. Rezultatet e intervistës u shprehen statistikisht dhe u diskutuan bashkërisht.

Pyetjet	Përgjigjet në %				
	Shumë ulët	<i>E ulët</i>	Mjaftueshëm	E lartë	Shumë e lartë
1. Koha limit prej 8 orësh për kryerjen e detyrave kryesore është		25	50	20	5
2. Qartësia e gjuhës teknike dhe përmbajtjes është		5	30	55	10
3. Sasia e lëndës për njësi kohë e vlerësuar për studime është		15	40	35	10
4. Qartësia e grafikeve është			30	40	30
5. Efektiviteti i testeve të vetëvlerësimit në fund të moduleve është		5	35	40	20
6. Përmbajtja në lidhje me mjetet didaktike është			45	45	10
7. Efektiviteti i modeleve të të mësuarit (të mësuarit elektronik dhe bashkëpunues)			20	60	20
8. Efektiviteti i moduleve përsëritëse		10	35	45	10
9. Koha e lejuar për pjesëmarrje në aktivitet bashkëvepruese në forum		5	40	35	20
10. Funkcionaliteti dhe pajtueshmëria e grafikeve të prezantimeve			55	25	20
11. Qartësia e përbërjes dhe strukturës të përmbajtjes			25	50	25
12. Qartësia e detyrave për tu kryer			25	65	10
13. Liria për të menaxhuar studimet në mënyrë autonome siç ndodh në sistemet a-sinkrone			45	40	15
14. Vlefshmëria e mjeteve didaktike, bibliografi, fjalor, leximet në linkografi,		15	30	40	15

Tabela 1. Statistikat mbi probleme të aspektit mësimor.

REZULTATET DHE DISKUTIMI


Pyetësi kishte për qëllim monitorimin e përshtypjeve pas përvojës on-line dhe për të krahasuar pritshmërinë e secilit me rezultatet e arritura në fund të kursit. Qëllimi ishte të

evidentonte problemet në aspektin mësimor, në bashkëveprimin midis vetë studenteve dhe me tutorët, në aspektin teknologjik, dhe në aspektin e organizimit të vitit akademik.


1. Aspekti mësimor

Në aspektin mësimor, shumë të rëndësishme ishin disa probleme si koha për ushtrimin e detyrave kryesore, qartësia e gjuhës teknike dhe grafikeve, efektiviteti testeve të vetëvlerësimit në fund të modulit, koha e caktuar për marrjen pjesë në veprimtaritë bashkëpunuese në forum, qartësia e detyrave për tu zhvilluar, vlefshmëria e mjeteve didaktike si bibliografia, fjalorthi, linkografia etj. Për këto probleme rezultatet jepen në tabelën 1. Nga tabela 1 shohim që koha limit prej 8 orësh për kryerjen e detyrave kryesore është me se e mjaftueshme vetëm për 75% të studenteve, qartësia e gjuhës teknike dhe përmbajtjes sipas kësaj interviste është mjaftueshëm për 30% të studenteve dhe e lartë për 65 % të tyre, ndërsa sasia e informacionit për njësi kohë e vlerësuar për studime ishte më se e mjaftueshme për 85 % të studenteve. Sipas intervistës qartësia e grafikeve ishte i kuptuar nga të gjithë studentët dhe po ashtu edhe efektiviteti i testeve të vetëvlerësimit në fund të moduleve. Përmbajtja në lidhje me mjetet didaktike ishte kuptuar mjaftueshëm nga 45% të studenteve dhe 55% në nivel të lartë dhe shumë të lartë ndërsa, efektiviteti i modeleve të të mësuarit (të mësuarit elektronik dhe bashkëpunues) ka qenë 20 % mjaftueshëm dhe 80% në nivel të lartë dhe shumë të lartë që nga përvoja jonë ndodh zakonshëm edhe në një klase normale me sistemin e mësimdhënës face to face. Kjo mund të shpjegohet me aftësitë individuale të njohjes të gjuhës të huaj dhe të shkathtësisë në platformën elektronike, përveç aftësive profesionale dhe bashkëpunimit ose jo në kohë të eksperteve. Efektiviteti i moduleve përsëritëse për 10 % të studenteve ka qenë i ulët, 35% mjaftueshëm, dhe 55% i lartë dhe shumë i lartë. Koha e lejuar për pjesëmarrje në aktivitet bashkëvepruese në forum duket se ka qenë e mjaftueshme për masën dërmuese me 95% të studenteve. Qartësia e përbërjes dhe strukturës të përmbajtjes dhe liria për të menaxhuar studimet në mënyrë autonome siç ndodh në sistemet a-sinkrone(jo on-line) del më se mjaftueshëm për të gjithë studentët. Për sa i përket vlefshmërisë të mjeteve didaktike,

literaturë, fjalor, shohim që 15% e studenteve paraqesin probleme për shkak të gjuhës të huaj, termave teknike, keqkuptimeve dhe akronimeve të shumta në literaturë.




Grafiku 1. Një përmbledhje e numrit të postave për çdo modul dhe në total të dërguara në forum.



Grafiku 2. Numri i postave individuale për çdo modul.

Nga grafiku 1, shohim që postat për ngritjen e problemeve rritet nga moduli i parë tek dy të tjerët dhe po ashtu edhe përgjigjet (postat) për detyra të ndryshme. Me kënaqësi shohim që ulet numri i postave për ndihmë, që shpjegohet me aftësimin e studenteve me tekniken e të mësuarit dhe mjetet e platformës dhe rritet numri i postave për qëllime sociale që tregojnë rritjen nivelit të bashkëpunimit midis studenteve dhe përdorimin e platformës pse jo edhe për argëtim. Grafiku 1, jep në nivel total numrin e postave, kurse grafiku 2 paraqet të njëjtën fenomen në shpërndarjen individuale të numrit të postave për të 23 studentët (nga 25 gjithsej), gjatë të tre moduleve.

Një element fundamental në aspektin e të nxënit është edhe cilësia e vlerësimit të studenteve (grafiku 3). Në rastin tonë studimor cilësia e notave në kohën e rregullt ka një shpërndarje mjaft simetrike, ku 29% e studenteve kanë rezultate të mira(B) dhe shumë të mira(O), 33% mjaftueshëm(S), 8% ngelëse(I) dhe 30 % munguese(X) për shkak të pushimeve verore, që do të ishte perfekte për çdo sistem të mësuarit (grafiku 3).



Grafiku 3. Cilësia e notave në përqindje ndaj totalit të të gjitha notave të grupit (Shuma e notave 230).

2. Bashkëpunimi interaktiv

Një element shumë i rëndësishëm i të mësuarit në distancë është edhe bashkëpunimi interaktiv midis studenteve në sensin e pjesëmarrjes në kohë, të entuziazmit, të atmosferës dhe të qënurit social në tërësi. Po ti referohemi përgjigjes të të intervistuarve ajo del 20% mjaftueshëm, 25% e lartë dhe 55% shumë e lartë, por po ti referohemi grafikut, del se numri i postave të dërguara është më i ulët se ai kërkuar

për 14 nga 23 studente. Kjo ndoshta shpjegohet me faktin që pritshmëria dhe pretendimet nga ana e studenteve për këtë zë ishin modeste.

Përsa i përket cilësisë të komunikimit me tutorin dhe stafin e IAMB, në kontekstin e përgjigjes në kohë dhe dobisë të përgjigjeve të pritura nga studentët nga kjo intervistë vlerësohet e lartë dhe shumë e lartë respektivisht me 80% dhe 85%.

3. Aspekte teknologjike

Në të mësuarin në distancë, aspektet teknologjike luajnë një rol të dorës të parë. Probleme të tilla si efektiviteti i mjeteve të platformës, dobia e mjeteve interaktive (forum, chat, lajmet) në platformë, pajtueshmëria midis modelit të të nxënit dhe teknologjisë të propozuar në intervistën tonë kanë përgjigje si më poshtë(tabela 3):

Rezultatet e tabelës 3, janë të shpjgueshme me faktin që në grup kishte 2 studente nga Palestina dhe 1 nga Iraku, dhe ndonjë vend tjetër me probleme politike, të lëvizjes dhe të telekomunikimit, të kuptueshme kur grupi formohet nga një zonë gjeografike mjaft e gjerë. Për disa nga studentët teknologjia e propozuar nuk ishte shumë e përshtatshme për shkak të parametrave të ulët të lidhjes së internetit. Për pjesën tjetër, interesant është fakti që, për të tre zërat e intervistuar, cilësia e performancës teknologjike ka qenë e lartë dhe shumë e lartë në mënyrë domethënëse nga 75-85%.

Pyetjet	Përgjigjet në %				
	Shumë ulët	E ulët	Mjaftueshëm	E lartë	Shumë e lartë
1. Cilësia e bashkëveprimit midis grupeve (pjesëmarrja, niveli teknik, entuziazmi atmosfera etj)			20	25	55
2. Cilësia e komunikimit me tutorin (shpejtësia e komunikimit dhe predispozicioni)			20	30	50
3. Cilësia e komunikimit me stafin e IAMB (shpejtësia e përgjigjes, predispozicioni, dobia e përgjigjes)			15	25	60

Tabela 2. Bashkëpunimi interaktiv midis aktorëve gjatë të mësuarit në distancë.

Pyetjet	Përgjigjet në %				
	Shumë ulët	<i>E ulët</i>	Mjaftueshëm	E lartë	Shumë e lartë
1. Efektiviteti i mjeteve të platformës			15	60	25
2. Dobia e mjeteve (forum, chat, lajmet) interaktive në platforme			25	50	25
3. Pajtueshmëria midis modelit të të nxëniet dhe teknologjisë të propozuar (MAIB platformë)			20	50	30

Tabela 3. Aspekte të performancës teknologjike

Pyetjet	Përgjigjet në %				
	Shumë ulët	<i>E ulët</i>	Mjaftueshëm	E lartë	Shumë e lartë
1. Qartësia e kërkesave paraprake për regjistrimin në kurs, formimi kultural, teknologjik dhe gjuhësor			40	50	10
2. Cilësia e organizimit administrativ dhe logjistik			20	40	40
3. Vlefshmëria e materialeve ndihmese dhe didaktike			10	75	15
4. Cilësia e koordinimit, mbështetjes teknike dhe menaxhimit të kursit			10	65	25
5. Niveli i kënaqësisë në përgjithësi për organizimin e kursit			5	55	40

Tabela 4. Intervista mbi organizimin e punës.

4. Organizimi i punës

Për zhvillimin me sukses të një kursi on-line në distancë ka shumë rëndësi edhe organizimi i punës si një e tërë. Hartimi i kërkesave paraprake për regjistrimin e studenteve të përshtatshëm në kurs, formimi kultural, teknologjik dhe gjuhësor, cilësia e koordinimit, mbështetjes teknike dhe menaxhimit të kursit janë fundamentale.

Siç e shohim edhe nga tabela 4, qartësia e kërkesave paraprake për regjistrimin në kurs, mbi formimin kultural, teknologjik dhe gjuhësor ka qenë mjaftueshëm për 40% të studenteve fitues dhe 60% e qartë dhe shumë e qartë. Pavarësisht nga kjo, është e pashmangshme pranimi i ndonjë studenti me formim të dyshimtë nga pikëpamja gjuhësore, teknologjike dhe profesionale në tërësi. Cilësia e organizimit administrativ dhe logjistik nga intervista ka dalë e mjaftueshme për 20 % të intervistuarve dhe e lartë dhe shumë e

lartë për 80% të të intervistuarve. Përsa i përket vlefshmërisë të materialeve ndihmese dhe didaktike dhe cilësisë të koordinimit, mbështetjes teknike dhe menaxhimit të kursit të intervistuarit e vlerësuan të lartë dhe shumë të lartë me 90%. Nga studentët u sugjerua një përqindje më e lartë e punëve praktike dhe vizitave teknike në përmbajtjen e programit.

Në fund të kursit niveli i kënaqësisë në përgjithësi për organizimin e kursit ishte i lartë dhe shumë i lartë për 95% të intervistuesve, ku rezultatja e vlerësimeve të përgjithshme ishte e mesme e lartë.

KONKLUZIONE

Në aspektin mësimor:

koha e parashikuar për kryerjen e detyrave me sa duket ishte e pamjaftueshme, disa module ishin më të gjatë se sa pritej, u shfaqën disa

keqkuptime për shkak të mosnjohjes sa duhet të gjuhës së huaj, termave teknike dhe akronimeve të shumta që nuk u gjetën në fjalor, vlefshmëria e fjalorëve, linkeve, dhe bibliografisë la për të dëshiruar, dhe efektiviteti i testeve përsëritëse nuk ishte i lartë.

Në aspektin bashkëveprues:

gjate të nxënimit në distancë u shfaq nevoja e një bashkëveprimi më të madh midis studenteve dhe profesorëve, pjesëmarrja në forume për kryerjen e detyrave ishte e mjaftueshme por jo e lartë, bashkëpunimi me udhëheqësit e temave të projekteve ishte mesatar.

Në aspektin teknologjik:

disa studentë shfaqen probleme teknike me lidhjen në platforme për shkak të cilësisë dhe parametrave të ulët të lidhjes në internet, vlefshmëria e mjeteve të platformës ishte e kufizuar dhe ndonjëherë me probleme.

Në aspektin organizativ:

para-kërkesat për pranim nuk ishin të qarta për një numër studentësh ose u manipuluan me dashje nga ndonjë tjetër, mundësisht modulet të ishin të shkarkueshme, rregullimi i raportit face to face dhe të nxënimit në distancë në favor të të parit, parashikimi i më shumë vizitave praktike dhe fushore.

LITERATURA

1. Grup autorësh. 1999. Metodatat e mësimdhënies për mësuesit e rinj, AEDP.
2. Musai Bardhyl. 2003. Metodologji e mësimdhënies, Tiranë.
3. Musai Bardhyl. 1999. Psikologji edukimi, Tiranë.
4. Freeman Donald. 1993. New Ways in teacher Education, Innovative classroom Techniques.
5. Eric P. Jensen. 1988. Super teaching: Master strategy for building student success..

SOCIAL PROGRESS AND ECONOMIC PERFORMANCE (GDP) PËRPARIMI SHOQËROR DHE GDP

IRENA NIKAJ^a, JULIAN KAPO^b


^aAssociate Professor of Sociology, Department of Social Science, Faculty of Education, University Fan S. Noli, Boulevard Gjergj Kastrioti, Korçë, Albania

^bAgjencia Aluizni, Korçë, Albania

Email: inikaj@yahoo.com

AKTET IV, 4: 577 - 581, 2011

From the classic GDP's indicators there is no evidence of how the people do leave. GDP is simply the total aggregate of all domestic economic activity; if output is up, the country must be economically healthier? But what if that output is harmful to people and the environment? If we cut down a forest to make junk mail or remove a mountaintop to burn coal, GDP measures all that but ignores the economic, not to mention social and environmental effects of the resulting mudslides, soil erosion, water table poisoning, air pollution or global warming. A team initiated by French President, N.Sarkozi, has presented proposals for a new system for measuring the country's economic growth. So the French President joined the opinion of the well known economists Joseph Stiglitz and Amalya Sen, who already think that for determining a given economy it is not sufficient just only to be taken into account the GDP's indicators, seeing this as a traditional method that has not the proper accuracy to judge about improving the quality of life. There is needed that the economic growth of a country shall be measured in more fully methods, as far as GDP is not more an enough standard for the economic growth. So we have to find the difference between GDP in one side and the Gross National Happiness (GNH) and the Economic Happiness to the other side.



Source: Indicator table G of the Human Development Report 2009

Figure 1. HDI Trends (Albania)-Human Development Report 2009




Figure 2. The National net revenues as % of GDP: OECD Annual National Accounts.




Figure 3. GDP and available income for Norway (1985-2007) HDI 2009.

HDI value	Life expectancy at birth (years)	Adult literacy rate (% ages 15 and above)	Combined gross enrolment ratio (%)	GDP per capita (PPP US\$)
1. Norway (0.971)	1. Japan (82.7)	1. Georgia (100.0)	1. Australia (114.2)	1. Liechtenstein (85,382)
68. Belarus (0.826)	36. Brunei Darussalam (77.0)	17. Moldova (99.2)	116. Cape Verde (68.1)	91. Ecuador (7,449)
69. Saint Lucia (0.821)	37. Barbados (77.0)	18. Tonga (99.2)	117. Sao Tome and Principe (68.1)	92. Grenada (7,344)
70. Albania (0.818)	38. Albania (76.5)	19. Albania (99.0)	118. Albania (67.8)	93. Albania (7,041)
71. Russian Federation (0.817)	39. Czech Republic (76.4)	20. Antigua and Barbuda (99.0)	119. Namibia (67.2)	94. Ukraine (6,914)
72. The former Yugoslav Republic of Macedonia (0.817)	40. Uruguay (76.1)	21. Hungary (98.9)	120. Azerbaijan (66.2)	95. Cuba (6,876)
182. Niger (0.340)	176. Afghanistan (43.6)	151. Mali (26.2)	177. Djibouti (25.5)	181. Congo (Democratic Republic of the) (298)

Figure 4. Human Development Index for Albania, 2007

1. GDP and the social progress in Albania

Furthermore, in the Albanian case, this relation draws our attention, because the perception and the indicators do not match with the givens of the GDP growth. In Albania, according to BERZH, up to now the indicators haven't been bad; the Albanian economy has faced 2009, but the expert judge from the fall of remittances, increase unemployment, precisely for the issue that we are treating: the Albanians poverty will be more sensible during this year.

According to BERZH, Banks will continue to pursue prudential credit policies due to the risk that recession has brought. The increase in the bad credits will burden on the balance sheet of the banks, and will diminish their abilities for offering further financing that are necessary to come out from crisis. The increasing of outside demand will be refund by the appliace of the tightly fiscal policies that will be applied in a lot of regional countries.

Private demand will be less as a consequence of the unemployment growth and the few credits, thing that will impede the growth of production and savings that were expend during the crisis. The long- term consequences that are thought to crop up are related to that of what may happen on the future years. The Albanian economy has increased during the last decade based on the remittances and not on the foreign investments. The remittances are falling due to unemployment growth at the EU Countries and a lot of experts are questioning with what resources they could be substituted. The Albanian bank is of the opinion that our country shall tent to increase the foreign investments, while same experts have introduced the idea that it should be reviewed the public debt strategy, for supporting a countercyclical interventions strategy. It is thought that our country can tent to increase the public debt in a medium term for financing the economic growth, but such scenario, requires considerable managing skills, which today lacks in our country. This means that the government shall take loans for investing when the economy is weak and to repay the debt when the economy improves.

But in an open and small economy like Albanian, such investments financed by debts can have a low real impact. Last year, 2008, Albania increased its public debt with more than half billion Euro. The falling of remittances has brought in the spotlight the question of the financial resources of the economic development in Albania. Regarding a old economic theory, the remittances begin to decrease until they go to zero after the first emigration decades because the emigrants stabilize their lives in their new

homes and slowly lose their family and spiritual connections with the mother land. The fast economic growth in Albania, from the fallen of communism, is particularly encouraging from the billions of Euro brought from the emigrants, cash that it was deposited into banks and after they were credited to the government and to the private businesses.

This year, as rarely, the deposits into banks haven't grown and therefore, even the credit to economy stuck. Albanian Bank proposed that the government should seriously think for the attraction of direct foreign investments while even the public sector as well as the private sector, shall think to invest the money in more profitable businesses. The investments will higher rates demand further professional skills from the Albanians, which implies the need for more investments in education. On the contrary of what was expected, the private banks of the second level have transfer outside Albania a capital of 1 billion dollars, or 73.9% more than in 2009, one part in the parent banks and another part invested on securities in other countries.

The forecasting's of the Academy of Sciences in 2005, demonstrate that with an additional 8% of the annual production, the level of output per capita in the European countries can be reached by Albanian in 2039, while with an increase of 10 %, the Albanians can reach the economic level of Europe (which was supposed that would stay firm) only in 2032. So, according to that study, Albanian resulted 30 years behind Europe in the per capita output view.

A report of the European Statistics Institution, Eurostat, recently published, classifies Albania for 2009, the poorest country in Europe with the lowest purchasing power.

2. Why Albania results as the poorest country?


The low Albanian family incomes firstly came from the unemployment. In Albania the satisfactory growth of 5-6 % per year is not associated with the additional number of jobs, but with the increase of unemployment. The Albanian economic growth has been asymmetrical in relation with unemployment.

The gap between the economic growth and unemployment in Albania is higher in comparison with the regional countries, but even with the global levels indicators.

If in global levels world has economic growth of 5-6 % even the unemployment is 5-6%. While in Albania the unemployment level is minimum 2 times ore 3 times higher than the economic growth. Unemployment is higher in poorest areas. Figures show that Albania has an overage remittances near to 300 euro per habitants.

Reductions of shipments are bringing serious consequences in the quality of life, which concretes at the purchasing power. This situation puts Albania in the Eurostat report for 2009 as the poorest country even in the relation with the regional countries. Serbia and Montenegro, that have less or more a problematic history, have indicators that are higher than those of Albania. Even Bosnia is better, or Macedonia has higher purchasing power. With an overage European figure of 100, Albania rank in the last place of the list with 27 countries, with only just a purchasing power of 27 % in relation to the DGP, Bosnia rank with 30%, Macedonia with 35%, Serbia with 37 and Montenegro with 43 % of GDP per capita.

According to the figures of the World Bank the lever of poverty in Albania has decrease from 25 % that was in the year 2002 up to 12% in year 2008. But the report of EUROSTAT for year 2009 shows a growth in poverty mainly from the unemployment.



Source: Indicator table H of the Human Development Report 2009

Figure 5. HDI and GDP per capita for Albania, 2009.

Total remittance inflows(US\$ millions)	Remittances per capita(US\$)
1. India 35,262	1. Luxembourg 3,355
7. Poland 10,496	7. Bosnia and Herzegovina 640
58. Azerbaijan 1,287	14. Romania 398
61. Turkey 1,209	15. Moldova 395
64. Albania 1,071	22. Albania 336
70. Armenia 846	23. Estonia 319
76. Kyrgyzstan 715	25. Croatia 306
131. Malta 40	129. Kazakhstan 14
157. Burundi 0	157. Burundi 0
Global aggregates	
Central and Eastern Europe and the CIS 49,618	Central and Eastern Europe and the CIS 114
High human development 92,453	High human development 101
World 370,765	World 58

Figure 6. Total Remittance inflows and remittances per capita, 2009

Human Poverty Index (HPI-1)	Probability of not surviving to age 40 (%)	Adult illiteracy rate (%ages 15 and above)	People not using an improved water source (%)	Children underweight for age (% aged under 5)
1. Czech Republic (1.5)	1. Hong Kong, China (SAR) (1.4)	1. Georgia (0.0)	1. Barbados (0)	1. Croatia (1)
13. Argentina (3.7)	26. Costa Rica (3.3)	17. Moldova (0.8)	37. Dominica (3)	48. Belize (7)
14. Singapore (3.9)	27. The former Yugoslav Republic of Macedonia (3.4)	18. Tonga (0.8)	38. Bahamas (3)	49. Bolivia (8)
15. Albania (4.0)	28. Albania (3.6)	19. Albania (1.0)	39. Albania (3)	50. Albania (8)
16. Belarus (4.3)	29. Malaysia (3.7)	20. Antigua and Barbuda (1.1)	40. Ukraine (3)	51. Peru (8)
17. Cuba (4.6)	30. Uruguay (3.8)	21. Hungary (1.1)	41. Argentina (4)	52. Fiji (8)
135. Afghanistan (59.8)	153. Lesotho (47.4)	151. Mali (73.8)	150. Afghanistan (78)	138. Bangladesh (48)

Figure 7. Selected indicators of human poverty for Albania, 2009.



Figure 8. Diagram of unemployment of Germany, 1991-2010 (DW-28.10.2010)

3. Economic growth samples that generates employment

For changing the situation it is needed to think for changes in the up to now model of the economic growth which is accompanied by unemployment growth. The model and the strategies of the country have to change and Albania has to find the right way toward economic growth that produces employment. The employment policies should occupy a more central space in the country development policies. The German model of development lies in the increasing of exports. The shift in this direction would need the growth of the investments in the new production technologies, in textiles, in agro food, etc.

This will bring a decrease in the unemployment and will generate incomes for increasing the confidence of the investors for revitalizing new credit sources to the economy.

BIBLIOGRAPHY

- Alkire S (2008) The Capability Approach to the Quality of Life.
- Duchrow J, Xhani E. Sarkozy wants the Introduction of a New System for measuring Economic Development, DW, 23.09.2009.
- Human Development Report 2009. Country Fact Sheets
- Nikaj I, Shehu D. (2005) Economic and Social Diagnosis of Mountainous Areas. Bulletin no. 11

of University Fan S.Noli, Series of Applied Sciences, Korca.

Nikaj I (2005) Some Definitions about the Relationship between the Quality of Social life and Environment in the Local Community. Bulletin no. 9 of University Fan S.Noli, Series of Applied Sciences, Korca.

Stiglitz J, Sen A, Fitoussi.(2010) Report by the Commission on the Measurement of Economic performance and Social Progress, www.Stiglitz-sen-fitoussi.fr.

SHJELJA E DHUNSHME NË SHKOLLË DHE NIVELI I VETËPRANIMIT

VALDETE ADILI

AKTET IV, 4: 582 - 586, 2011

PERMBLEDHJE

Tashmë është e njohur që shkollat po përballen çdo ditë me sjelljen agresive të nxënësve, sidomos gjatë pushimeve midis orëve, dukuri kjo e përhapur si te djemtë ashtu edhe te vajzat e moshës të adoleshencës. Punimi është bërë në shkollën e mesme "Mirko Mileski" në Kërçovë me qëllim studimin e lidhshmërisë së sjelljes së dhunshme në shkollë me nivelin e vetëpranimit, te 100 nxënës të vitit III gjimnaz. Të gjitha subjektet, edhe pse të ndara në dy grupe, kanë plotësuar shkallën e Filipit për vetëpranim dhe iu janë përgjigjur 21 pohimeve, varësisht prej shkallës së pajtimit me to. Analiza e rezultateve flet për një dallim të qartë të nivelit të vetëpranimit midis këtyre dy grupeve, rrjedhimisht, nxënësit me sjellje agresive kanë nivel më të ulët të vetëpranimit se nxënësit që nuk kanë shfaqur dhunë në shkollë. Studimi në fjalë është një përpjekje për të kuptuar sado pak natyrën e vetëpranimit dhe pasojat nga mungesa e tij.

SUMMARY

Nowadays it is well known that every day schools are dealing with the violence of the students from both genders, boys and girls at the age of adolescence. This study took place in one secondary high school aiming to analyze the relationship between the level of self-acceptance and violence of 100 students of 3rd year, aged 16-17. All of them, although divided in two groups, answered the 21 questions of Philip's scale of self-acceptance according to the level of agreement with the items. The analysis of the results showed that students with violent behavior at school have lower level of self-acceptance than students without any history of violence.

Based on this small study it is certain that we cannot conclude that violent behavior depends only on the level of self-acceptance but it is surely one attempt to understand the nature of the self-acceptance and the difficulties of the absence of the same.

Key words: self, vetëpranim, vetëvlerësim, sjellje e dhunshme, besimet irracionale

HYRJE

Të gjithë ne kemi përjetim personal për veten tonë, për cilësitë tona, karakterin, temperamentin, sjelljen, aftësitë, pamjen e jashtme, vlerat, qëndrimet....Të gjitha këto integrohen në një entitet të veçantë, në një koncept relativisht të qëndrueshëm që quhet imazhi për veten ose "uni"- self-concept. (McCrae, R.R, Costa P.T 1982)

Uilliam Xhejmsi (William James) qysh në 1890 në "Principles of psychology" duke folur për strukturën e personalitetit jep konceptin e parë të pastër për self-in ose uni-n, (sipas Myers-it, 1986) duke e ndarë atë në dy aspekte që ekzistojnë brenda një entiteti, selfi, ose uni si

subjekt, njohësi "I" dhe selfi, uni si objekt, i njohuri "Me".

Psikologët, që nga Frojdi, e kanë pranuar se një nga arsytet madhore që shkakton probleme emocionale është shprehia e shtypjes, mohimit ose shmangies së atyre pjesëve të personalitetit tonë për të cilat ne ndihemi keq, me shpresën se nëse i shmangim, ato do të zhduken. Por siç thekson edhe Seltzer-i, "vetëm duke i eksploruar të gjithë pjesët tona dhe duke i pranuar ato të cilat nuk jemi në gjendje t'i pranojmë mund të rrisim vetëbesimin dhe të krijojmë imazh më të plotë për veten tonë" (Seltzer, F.L. 2008).

Rreth vitit 1955 Albert Ellis, kishte lënë psikanalizën dhe në vend të saj ishte përqendruar

te sjellja e njerëzve, kishte kuptuar se ballafaqimi i njerëzve me besimet e tyre irracionale mund të ndryshojë konceptin e tyre për veten dhe rrit nivelin e vetëpranimit të pakusht “unconditional self-acceptance” siç e quajti ai.

Ellis-i, themelues i REBT-së (rational-emotional behavior therapy), me konceptin vetëpranim kupton pranimin e vetes pavarësisht nëse jemi të mirë ose jo dhe jo sepse jemi të mirë (Ellis, A. 1957). Në punën e tij si terapist, ai e pa shumë të vështirë të mësonte njerëzit të pranojnë veten me të gjitha përparësitë dhe mangësitë e tyre sepse ata duan ta pranojnë veten vetëm për gjërat pozitive.

Ellis-i numëroi disa besime irracionale, një nga ata, që ul nivelin e vetëpranimit tonë dhe që bën më të vështirë komunikimin midis individëve, është besimi se: ne duhet të jemi tërësisht të aftë, inteligjentë dhe të fitojmë gjithë respektin e mundshëm-në vend idesë që ne thuajse gjithmonë kemi nevojë të pranojmë veten tonë si një krijesë krejtësisht e papërsosur e cila ka kufizimet e përgjithshme njerëzore dhe dështime vetjake (Boeree, G. 2004).

Erih Fromi në “Selfishness and self-love” theksoi se është e domosdoshme të duam veten që të mund ta pranojmë atë dhe të duam të tjerët, dështimi ynë të pranojmë veten shoqërohet me një armiçësi ndaj të tjerëve (tek Denmark. K. 1973), ndërsa Berger-i gjeti lidhshmëri midis vetëpranimit dhe pranimit të të tjerëve, studime të cilat ndihmuan për krijimin e një profili të individit me nivel të lartë të vetëpranimit. Ndër të tjerat ai e përshkruan atë si: person i cili ka besim në kapacitetet e veta, merr përgjegjësi dhe pranon pasojat e sjelljes së tij, pranon mirënjohjet dhe kritikën në mënyrë objektive, nuk mundohet të mohojë asnjë ndjenjë, motiv, aftësi ose cilësi dhe i pranon ata pa vetëdënim, konsideron veten si person i barabartë me çdo njeri tjetër të planetit, nuk pret që të tjerët ta refuzojnë pavarësisht nëse u ka dhënë arsye ta bëjnë të njëjtën ose jo, nuk e përjeton veten krejtësisht të ndryshëm nga të tjerët dhe nuk është i turpshëm (Berger, E. 1952).

Kur flasim për vetëpranimin është gati e pamundur të mos përmendim konceptin e

vetëvlerësimit dhe jo rrallë herë këto dy koncepte trajtohen si të njëjtë, pavarësisht se ka dallim midis tyre. Vetëvlerësimi konkretisht i referohet sa të vlefshëm ose të çmuar e perceptojmë ne veten, vetëpranimi aludon në një konfirmim shumë më të gjerë se kaq, nëse ne pranojmë veten ne jemi në gjendje të përqafojmë gjithë tiparet tona, jo vetëm ato pozitive ose ato më “të çmuarat” (Seltzer, 2008).

Kohët e fundit po shkruhet një literaturë e vëllimshme rreth vetëvlerësimit duke folur për të si një nga faktorët kryesorë për shëndetin mendor si dhe përshtatjes me të tjerët (Boden M Josef, Fergusson M. David, Horwood L. John, 2007).

Kjo ka bërë që studime të shumta të hulumtojnë lidhjen midis nivelit të vetëvlerësimit dhe sjelljes agresive, disa nga ato kanë dëshmuar për lidhje pozitive midis nivelit të ulët të vetëvlerësimit dhe sjelljes agresive, ndërsa disa lidhje më të zbehtë midis tyre.

Fakte për lidhjen midis nivelit të ulët të vetëvlerësimit dhe sjelljes agresive gjejmë te studimi i Corwyn-it dhe Benda-s që flasin për një lidhje të dukshme tek adoleshentët e moshës 13-15 vjeç, (Corwyn R.F, Benda B.B, 2002), Ellickson dhe McGuigan zbuluan se femrat që shfaqën nivel të ulët të vetëvlerësimit në adoleshencën e hershme ishin më të gatshme të godisnin të tjerët në adoleshencën e tyre më të vonshme (Ellickson P.L, McGuigan K.A. 2000); gjithashtu Lindstrom gjeti një lidhje të theksuar midis vetëpranimit të ulët dhe sjelljes agresive tek adoleshentët në një grup madhor studimi në Suedi (Lindstrom P. 2000).

MATERIALET DHE METODAT

Studimi është bërë në shkollën e mesme “Mirko Mileski” -Kërçovë dhe janë përfshirë 100 subjekte, 57 djem dhe 43 vajza, nxënës të vitit III, moshë 16-17 vjeç. Njëri grup, 50 nxënës, janë nxënës me histori dhune në shkollë, të raportuar në shërbimin pedagogjik-psikologjik të shkollës për rrahje dhe zënka me nxënësit tjerë, dhe grupi kontrollues, 50 nxënës pa asnjë histori dhune në shkollë.

Pjesëmarrësit kanë plotësuar shkallën e Philip-it për matjen e nivelit të vetëpranimit (Philip's

scale for self-acceptance , SAS , 1951 me test-ritest reliabilitet prej $r = 0,84$)e përbërë prej 21 gjykimeve,me nga 5 shkallë pajtueshmërie(nga nuk pajtohem aspak deri në pajtohem plotësisht), ku mund të fitohen minimumi 21 dhe maksimumi 105 pikë. Të dhënat grupohen në 4 kategori,nivel i ulët i vetëpranimit (21-63), nivel mesatar (64-85),nivel i lartë (86-95) dhe imazh joreal për veten (96-105).Nxënësit e kanë plotësuar testin në mënyrë individuale si dhe u është dhënë fdbek individual për rezultatet e arritura.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet janë analizuar përmes devijimit standard të diferencës midis mesit aritmetik tek grupet e mëdha dhe të pavarura,ku rezultojnë dallime të vlefshme statistikore midis dy grupeve pasi që vlera e fituar z , ($z = -11,22$) është shumë më e madhe se vlera e z e tabeluar ($z = 2,33$) që është vlera më e vogël që duhet të arrijë z për të qenë e vlefshme në nivelin 0,01. Prandaj,hipoteza zero $H_0 : M_1-M_2= 0$ bie dhe vërtetohet ajo alternative, se niveli i vetëpranimit te nxënësit ndikon në shfaqjen e sjelljes së tyre të dhunshme.

Numri	Mesi aritmetik	Devijimi standard	Vlera z	Siguria
N1=50	M1=61,66	$\sigma =5,51$	z= -11,32	p > 0,01
N2= 50	M2=72,19	$\sigma =6,50$		

Ajo që duket edhe nga krahasimi i thjeshtë i dy meseve aritmetike me kategoritë e testit,është se grupi i nxënësve me sjellje të dhunshme,pra grupi eksperimental ka nivel të ulët të vetëpranimit ($M=61,66$) ndërsa grupi grupin kontrollues ka nivel mesatar të vetëpranimit ($M = 72,19$).Vlen të theksohet se nga të gjithë subjektet vetëm 7 nxënës, (7 %) të gjitha vajza, kanë arritur nivel të lartë të vetëpranimit.

Duke pasur parasysh periodizimin e ciklit të jetës që jep Eriksoni për stadet e zhvillimit dhe krizat e

përballjes së çdo stadi, dimë që adoleshentët përballen me krizën e identitetit dhe se niveli mesatar i vetëpranimit është më se i zakonshëm në këtë moshë (Funk,R.2003).

Testi mat mospërputhjen midis fotografisë ideale që kemi për veten dhe asaj reale, rezultatet flasin që nxënësit e dhunshëm kanë një zbrazëti më të madhe midis këtyre dy imazheve dhe kjo i bën më të ndjeshëm gjatë komunikimit me të tjerët.

Më tej analiza flet për dallime të mëdha midis këtyre grupeve sidomos në pohimet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë; grupi i nxënësve me sjellje të dhunshme rezulton me një përgjegjësi më të ulët ndaj veprimeve,janë më pak tolerantë ndaj kritikave,nuk kanë besim te vlerat personale, ndruhen se mos të afërmit dëshpërohen nga ata nëse e marrin vesh se kush janë me të vërtetë dhe i mundon ndjenja se nuk vlejnjë sa duhet.

Sjelljen e dhunshme e hasim më shumë nëpër shkollat me numër më të madh të nxënësve ku për të njëjtën arsye shkolla nuk arrin të krijojë hapësirë për përmbajtje të ndryshme kreative që nxënësit të mund të kalonin kohë cilësore duke realizuar kapacitetet e tyre. Edhe pse me një studim të përmasave të vogla siç është ky nuk mund të vërtetojmë se sjellja agresive është gjithmonë dhe vetëm produkt i nivelit të ulët i vetëpranimit,në bazë të rezultateve të fituara mund të dëshmojmë se ekziston një lidhshmëri e dukshme midis këtyre dy variableve.

Meqenëse bëhet fjalë për nxënës që akoma janë pjesë e sistemit edukativ-arsimor, shkolla mund të japë kontributin e saj në përballjen e adoleshentëve me krizën e tyre të identitetit, sidomos te nxënësit me sjellje të dhunshme. Rritja e nivelit të vetëpranimit është mënyra më e drejtpërdrejtë. Me të rritet besimi e tyre në vete dhe kjo mund të bëhet vetëm nëse këta nxënës i kycim aktivisht në programin shkollor. Vetëm duke shfaqur besim në cilësitë e tyre ata mund të rrisim përgjegjësinë .

Lufta e shkollës me dhunën duhet të orientohet drejt kanalizimit të kësaj energjie shkatërruese në konstruktive e jo duke i stigmatizuar ata.

Shkalla e Filipit për matjen e vetëpranimit

	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem pjesërisht	Nuk mund të përcaktohem	Pajtohem pjesërisht	Pajtohem plotësisht
1. Do të doja të gjeja dikë të më zgjidhte problemet e mia personale					
2. Nuk dyshoj në vlerat e mia personale edhe kur të tjerët dyshojnë tek unë.					
3. Kur të tjerët flasin gjëra të mira për mua e kam vështirë ta pranoj se e thonë me gjithë mend. Mendoj se ndoshta bëjnë shaka me mua ose thjesht nuk janë të sinqertë.					
4. Unë thjesht nuk mund ta duroj kur dikush më kritikon.					
5. Nuk e kam zakon të diskutoj për gjëra që ndodhin në shoqëri se kam frikë mos më kritikojnë të tjerët nëse flas diçka gabim.					
6. Jam i vetëdijshëm se nuk bëj ndonjë jetë aktive e të vlefshme dhe thjesht nuk besoj se ka diçka tek unë që mund të më motivojë të shfrytëzoj kapacitetet e mia personale në mënyrë më të mirë.					
7. Shumica ndjenjave që kam për të tjerët janë krejt të natyrshme dhe të pranueshme.					
8. Diçka brenda meje nuk më lejon të jem e/i kënaqur me çfarëdo pune që bëj. Kur çdo gjë mbaron atëherë nis e mendoj se nuk ishte aq e vështirë dhe se nuk kam bërë asgjë të veçantë.					
9. E ndiej se jam ndryshe nga të tjerët por do doja më shumë siguri se nuk ndryshoj dhe aq shumë.					
10. Kam frikë se njerëzit që i dua do të zbulojnë se si jam unë me të vërtetë dhe do të dëshpërohen nga unë.					
11. Shpeshherë më mundon ndjenja se nuk vlej sa duhet.					
12. Për shkak të disa njerëzve nuk mund të arrij aq sa duhet.					
13. Në shoqëri jam i turpshëm.					
14. Për të arritur sukses dhe për t'u pëlqyer të tjerëve më shumë se çdo gjë tjetër synoj të jem ashtu siç të tjerët presin nga unë.					
15. Mendoj se posedoj kapacitet për të zgjidhur problemet. Ndiem stabil dhe kjo më bën goxha të sigurt.					
16. Jam plotësisht e/i vetëdijshëm për aftësitë e mia kur gjendem në shoqërinë e njerëzve më të aftë se unë.					
17. Mendoj se jam shumë nervoz.					
18. Shpeshherë nuk tentoj të shfaqem me të tjerët sepse mendoj se nuk do ju pëlqej.					
19. Ndiej se vlej po aq sa edhe të tjerët.					
20. Nuk e heq dot ndjenjën e fajit për mendimet që kam për disa njerëz në jetën time.					
21. Nuk kam frikë të takoj njerëz të rinj. E di se jam njeri me vlera dhe nuk ka arsye përse të largohen nga unë.					

BIBLIOGRAFIA

1. Benda, B.B., Corwyn R.F. (2002) The effect of abuse in childhood and in adolescence on violence among the adolescents. Youth.Soc.33: 339-365

2. Berger, E. (1952) The relationship between expressed acceptance of self and expressed acceptance of others. Journal of abnormal and social psychology XLVII 778-82

- 3.Boeree, G. 2004, Teoritë e personalitetit. "Plejad" Tiranë
- 4.Boden, M.J. Fergusson M.D. Horwood L.J,(2007) Self-esteem and violence : testing links between adolescent self-esteem and later hostility and violent behavior. Soc. Psychiatr. Epidemiol. 42 : 881-891
- 5.Denmark, L.K (1973) Self-acceptance and leader effectiveness. Journal of Extension,winter,Texas University
- 6.Ellickson, P.L. McGuigan, K.A. (2000) Early predictors of adolescent violence. Am.Journ.Public health 90 : 566-572
- 7.Ellis, A (1957) How to live with a neurotic . Oxford,England: Crown Publishers
- 8.Funk, R.(2003) Erich From : his life and ideas. Translators J.Portman, M.Kunkel New York, Continoum International publishing Group
- 9.Lindstrom, P.(2000) School violence : a multi-level perspective. Int. Rev. Victimol Special Victims and fear of crime in contemporary Sweden 8 : 141-158
- 10.McCrae , R, R.,Costa, P. T. (1982) Self concept and the stability of personality : Cross Sectional Comparisons of Self-Reports and Ratings. Journal of Personality and Social Psychology.Vol.40.No 60,1282-1292
- 11.Myers, G.E (1986). W. James- His life and Thought. Yale Univ. New haven and London,344-386
12. Phillips, E. L. (1951) " Attitudes toward self and others : a brief questionnaire report" Journal of consulting psychology, february 78-82
- 13.Seltzer,F.L 2008, " The path to unconditional self –acceptance ", Psychology Today,september 9 .

TRAKTATI I LISBONËS DHE NDRYSHIMET INSTITUCIONALE TË BASHKIMIT EVROPIAN

ABDULLA AZIZI

Universiteti i Evropës Juglindore, Rr. Ilindenska pn. Tetovë, 1200, R. E MAQEDONISË
Email: a.azizi@seeu.edu.mk

AKTET IV, 4: 587 - 597, 2011

Fjale kyce: Traktati i Lisbonës, institucionet e BE-së..

HYRJE

Ky punim gjen bazën në Traktatin e Lisbonës, i cili paraqet një përpjekje për të kapërcyer mangësitë në funksionimin e traktateve themeluese të mëparshme të Komuniteteve dhe Bashkimit Evropian. Njëherit, i njëjti llogaritet si vazhdimësi e punës kërkimore të mëparshme dhe si udhërefyese për punonjësit shkencor që kanë për objekt studimi proceset euro-integruese.

Edhe pse në aspektin formal-juridik nuk e ka fuqinë e Kushtetutës, me Traktatin e Lisbonës BE-ja stabilizohet në plan afatgjatë, si strukturë baraspeshe e sovranitetit të ndarë nacional dhe mbi-nacional.

Traktati i Lisbonës parasheh autorizime të reja për Bashkimin Evropian, në veçanti për vetë institucionet e saja. Ai synon që përmes dispozitave të tij të ofrojë mundësi më të mira për veprim të institucioneve të BE-së.

Traktati reformues i Lisbonës, vendosi themelet për një sistem institucional më të qëndrueshëm, i cili do të mundësojë vendimmarrje më të suksesshme, në mënyrë më transparente, me kontroll më të mirë demokratik. Ai parashikon disa ndryshime institucionale, veçanërisht ndryshime në: procesin e vendimmarrjes, Këshillin e BE-së, Këshillin Evropian, përbërjen e Parlamentit Evropian, Gjykatën e drejtësisë etj.

Ky punim përqendrohet në dispozitat për ndryshim dhe plotësim të Traktatit të BE-së

(Nicës) dhe Traktatin mbi funksionimin e BE-së (Lisbonës).

1. Risitë në Traktatin e Lisbonës dhe ndryshimet e përgjithësuara në traktatate e mëparshme mbi Bashkimin Evropian

Meqenëse Kushtetuta e BE-së nuk ishte ratifikuar, për shkak të refuzimit të saj në referendum nga qytetarët e Francës dhe të Holandës, krerët e shteteve dhe qeverive të shteteve anëtare të BE-së, tentuan që t'i japin fund krizës institucionale duke nënshkruar Traktatin e Lisbonës më 13 Dhjetor 2007. Në Traktatin e Lisbonës, ndryshimet më tepër përqendroheshin në thjeshtëzimin e procesit të menaxhimit dhe vendimmarrjes në BE.

Me nënshkrimin e "Traktatit të Lisbonës" shtetet anëtare të BE-së ranë dakord jo vetëm që të thjeshtëzonin procesin e menaxhimit dhe vendimmarrjes, por hapen dhe rrugët për pranimin e anëtarëve të rinj.

Me Traktatin e Lisbonës, i cili hyri në fuqi pas ratifikimit nga shtetet anëtare më 1 dhjetor 2009, BE-ja u bë me Kryetar me një mandat 2.5 vjeçarë, me të cilin zëvendësoi sistemin e kryesimit të rotacionit 6 mujorë.

Në të ardhmen vendimet do të merren me shumicë votash, e jo njëzëri (unanim) si deri më tani. Konsensus i të gjithë shteteve anëtare do të kërkohet vetëm në politikën e përbashkët të

jashtme, mbrojtjen, çështjet sociale, tatimet dhe kulturën.

Edhe pse në aspektin formalo-juridik nuk e ka fuqinë e Kushtetutës, me Traktatin e Lisbonës BE-ja stabilizohet në plan afatgjatë, si strukturë baraspeshe e sovranitetit të ndarë nacional dhe mbi-nacional.

Traktati lë të hapur mundësinë që në të ardhmen BE-ja të kalojë në federatë Evropiane me pushtet më të centralizuar politiko-ekonomike dhe ushtarake.

Ky dokument dallon nga ato të mëparshmit për shkak të risive që parashikon:

- më tepër transparencë dhe demokraci: Konkretisht parashikon që të paktën 1 milion qytetarë të BE-së pa marrë parasysh nëse janë të një apo më tepër shteteve anëtare t'i propozojnë Komisionit në bazë të iniciativës qytetare propozimin e tyre politik dhe në këtë mënyrë të marrin pjesë në krijimin e legjislacionit të BE-së;
- më tepër efikasitet: vendimet do të bazohen në sistemin e shumicës së dyfishtë prej vitit 2014. Kështu, që të merret një vendim, do të duhet të ketë përkrahjen e të paktën 55% të shteteve anëtare dhe të paktën 65% të popullatës evropiane;
- më tepër të drejta: Konventa për të drejtat themelore e vitit 2000 tani do të ketë fuqi obliguese dhe do të paraqesë mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut. Traktati parashikon që, të drejtat e përcaktuara në Konventën për të Drejtat Themelore duhet të respektohen nga institucionet dhe nga shtetet anëtare. Konventa mbulon të drejtat si vijon; të drejtat individuale lidhur me dinjitetin, lirinë, barazinë dhe solidaritetin, të drejtat lidhur me statusin e qytetarisë (shtetësisë) së BE-së dhe drejtësinë. Në këtë drejtim, Gjykata e Drejtësisë ngarkohet të zbatojë në mënyrë konkrete, dispozitat e Konventës të cilat janë pjesë përbërëse e Traktatit të Lisbonës;
- më tepër ndikim ndërkombëtar: BE do të përforcojë fuqinë e saj negociuese dhe do t'a bëjë atë më efikase në skenën botërore përmes posti të ri-Përfaqësues i Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë. Ai duhet të sigurojë konsistencën/përputhshmërinë e marrëdhënieve

të BE-së me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare. Ai do të ketë rol të dyfishtë: do të përfaqësojë Këshillin për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, dhe do të jetë nënkryetar i Komisionit Evropian (komisionar për marrëdhënie me jashtë), duke udhëhequr politikën e jashtme dhe të sigurisë si dhe, do të drejtojë mbledhjet periodike të ministrave të jashtëm të shteteve anëtare të BE-së.

Një risi, të përcaktuar në Traktatin e Lisbonës, paraqet edhe *përfshirja e Parlamenteve nacionale në procesin e vendimmarrjes*. Kjo nënkupton rritjen e demokracisë në BE. Ndryshimet kryesore rreth kësaj çështje sipas Traktatit të Lisbonës janë si vijon:

- dokumentet konsultative të Komisionit duhet t'iu dorëzohen parlamenteve nacionale;
 - propozim-aktet legjislative duhet t'iu dorëzohen parlamenteve nacionale në të njëjtin moment kur propozimet i dorëzohen Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
 - e drejta e parlamenteve nacionale mund të diktojë qëndrim kundër propozim/aktit legjislativ (pra, të bjerë ndesh me propozim/aktin evropian);
 - brenda 8 javësh, çdo Parlament Nacional mund të refuzojë propozim/legjislacionin në bazë të shkëljes së subsidiaritetit;
 - nëse kundërshtimi përkrahet nga të paktën 1/3 e Parlamenteve Nacionale, atëherë propozimi duhet rishikuar;
 - nëse Komisioni Evropian dëshiron të mbrojë propozimin, ai duhet të japë arsye për këtë;
 - nëse kundërshtimi është përkrahur nga shumica e Parlamenteve Nacionale, Komisioni Evropian duhet të vërtetojë së propozimi i tij tërhiqet për shkak të opinionit të arsyeshëm, i cili do t'i dorëzohet Këshillit dhe Parlamentit Evropian, që më pas do të vendos për çështjen.
- Fakti që Traktati ka shënuar risi të mëdha institucionale, të cilat e bëjnë Unionin më të fuqishëm dhe më efikas, nuk do të thotë se shkojnë në dëm të shteteve anëtare, pasi relacionet mes shteteve anëtare dhe Unionit mbeten të pandryshuara dhe çdo modifikim i rëndësishëm i traktateve do të duhet të vendoset dhe ratifikohet nga çdo shtet anëtarë, për të cilin

duhet arritur konsensus. Së dyti, ekziston një detyrim eksplisit i Unionit që në të gjitha veprimet e tij, të respektojë identitetin nacional të shteteve anëtare.

Për sa i përket zgjerimit, me Traktatin e Lisbonës kriteret për anëtarësim nuk janë përcaktuar në mënyrë strikte, por në nenin 49 theksohen "kriteret për përshtatshmëri për anëtarësim" të përcaktuara nga Këshilli Evropian. Aplikimi për anëtarësim do të dorëzohet në Këshill, i cili do të vendos më pas, me konsensus. Shteti aplikues duhet të informojë Parlamentin Evropian dhe parlamentet nacionale të shteteve anëtare edhe pse ato, nuk kanë rol vendimtar.

Për herë të parë që nga ekzistimi i BE-së parashikohet mundësia e lëshimit të anëtarësisë apo daljes nga BE-ja. Çështjet lidhur me këtë, diskutohen nga shteti që kërkon një gjë të tillë, ndërsa Këshilli vendos me shumicë të kualifikuar. Nëse shteti, pas një kohe të caktuar dëshiron përsëri të anëtarësohet në BE, do të duhet përsëri të rifillojë procedurën e zakonshme për anëtarësim, që nënkupton përveç kërkesës së re, edhe plotësimin e kushteve të reja që kërkohen për anëtarët e rinj (kushtet mund të ndryshojnë nga ato kur shteti, ka qenë anëtarësuar për herë të parë në BE).

Traktati reformues i Lisbonës, i jep Unionit fuqi më të madhe në marrëdhëniet me jashtë, ndërsa qytetarëve të BE-së që udhëtojnë në vendet e treta, iu mundëson ndihmë më të madhe praktike konsullore dhe diplomatike.

Traktati i Lisbonës për herë të parë parashikon dispozita mbi ndryshimet klimaterike (neni 174), dhe politikën energjetike (176 A). Në pjesën mbi energjinë, ai parashikon funksionimin e pandërprerë të tregut energjetik, veçanërisht në furnizim, promovimin e efikasitetit në shfrytëzimin dhe kursimin e energjisë, si dhe aktivitetet në zhvillimin e formave të reja dhe të ripërtërishme të energjisë. Theksohet se një nga objektivat e Unionit është që të punojë për një zhvillim të qëndrueshëm në nivel evropian, veçanërisht për mbrojtjen dhe përmirësimin në shkallë të lartë të cilësisë së mjedisit jetësorë. Mjedi i jetësorë është një nga sferat ku Komisioni, i ndan kompetencat me shtetet

anëtare. Kur Unioni ndërhyt në këtë fushë, duhet të kontribuojë në objektivat e caktuara: mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor, ruajtjen e shëndetit të njerëzve, promovimin e shfrytëzimit racional të resurseve natyrore, promovimin e masave në nivel ndërkombëtarë për ballafaqim me problemet botërore dhe rajonale në mjedisin jetësorë, përmirësimin e luftës kundër ndryshimeve klimaterike etj.

Në qendër të prioritetëve, Traktati i Lisbonës parashikon lirinë, drejtësinë dhe sigurinë. BE-ja do të ballafaqohet me grupet kriminele të cilat merren me trafikun e qenieve njerëzore, do të përkrahë aktivitetet lidhur me parandalimin e kriminalitetit, dhe do të ndihmojë luftën kundër terrorizmit.

Po ashtu, Traktati i Lisbonës përmban klauzulën e solidaritetit, sipas së cilës Unioni dhe shtetet anëtare do të veprojnë bashkërisht në frymën e solidaritetit nëse ndonjë shtet anëtarë bëhet 'viktimë' e ndonjë sulmi terrorist ose fatkeqësive natyrore (neni 188 R).

Këto risi do të mundësojnë që Unioni të zbatojë sa më shpejt politikatat e tij dhe të sigurojë parakushte për rritje ekonomike dhe konkurrencë të ndershme; të përmirësojë situatën me hapje vendesh të reja pune dhe kushte sociale, të rrisë sigurinë personale dhe kolektive; të promovojë një mjedi më të mirë jetësorë dhe kushte më të mira në shëndetësi; zhvillim të kohezionit dhe solidaritetit mes shteteve anëtare; zhvillim shkencor dhe teknologjik; dhe së fundi të përmirësojë aftësinë për të vepruar në arenën ndërkombëtare.

2. Ndryshimet institucionale me Traktatin e Lisbonës

Traktati reformues i Lisbonës, vendosi themelet për një sistem institucional më të qëndrueshëm, i cili do të mundësojë vendimmarrje më të suksesshme, në mënyrë më transparente, me kontroll më të mirë demokratik. Ai parashikon disa ndryshime institucionale.

2.1 Parlamenti Evropian

Sipas Traktatit të Lisbonës, përbërja e Parlamentit Evropian është përcaktuar e tillë (750 deputetë +1 kryetar) dhe është bërë shpërndarje e rishikuar e vendeve ulëse (proporcionaliteti degresiv, pragu minimal 6 dhe ai maksimal 96 i deputetëve për shtetet anëtare). Shpërndarja e saktë pritet të vendoset nga Këshilli Evropian [neni 14(2)].

Deri tani, Parlamenti ka miratuar legjislacionin bashkërisht (në bazë të procedurës së bashkë-vendosjes) me Këshillin në shumë sfera (p.sh: mbrojtjen e konsumatorëve, çështjet e ambientit), ndërsa në fusha të tjera, është konsultuar nga Këshilli. Deri përpara Traktatit të Lisbonës, Parlamenti dhe Këshilli kishin pasur fuqi të përbashkët vendimmarrëse mbi buxhetin e BE-së, mirëpo Këshilli ka pasur fjalën e fundit për disa shpenzime. Parlamenti po ashtu, ka pasur disa funksione mbikëqyrëse mbi Komisionin Evropian.

Kompetencat e PE-së ishin rritur në mënyrë permanente edhe në Traktatin për themelimin e kushtetutës së Evropës, gjë kjo që u pasqyrua edhe në Traktatin reformues të Lisbonës. Ky i fundit, me dispozitat e tij e afroi PE-në për nga fuqia ligjvënëse me Këshillin, pasi procedura e bashkë-vendosjes gjithnjë e më tepër transformohej në procedurë të rëndomtë të miratimit të akteve legjislative të BE-së.

Fuqia më e madhe ndërhyrëse i është njohur Parlamentit nga konsultimi, me miratimin e dispozitave të ndryshueshme, aprovimi i kornizës financiare shumëvjeçare, pezullimi i disa të drejtave të shteteve anëtare në rast të shkeljes së vlerave të Unionit, zgjerimi i kompetencave për veprim në marrëveshjet ndërkombëtare etj.

Në mënyrë të përgjithësuar, Traktati i Lisbonës zgjeron rolin e Parlamentit përmes përdorimit më të madh të procedurës së rregullt legjislative dhe në suaza të procedurës së veçantë legjislative, ku kërkohet pëlqim i Parlamentit dhe jo konsultim [nenet 19(1) dhe 351].

Përfundimisht, Parlamenti Evropian tani do të konsultohet në fushat si: mbrojtja diplomatike dhe konsullore e qytetarëve të Unionit, regjimi gjuhësor i titujve mbi pronësinë intelektuale,

pasaportat dhe dokumentet e tjera për identifikim etj.

Është evident zgjerimi i procedurës së bashkë-vendosjes midis Parlamentit dhe Këshillit pothuajse në të gjitha sferat e veprimit, për të cilat Këshilli vendos me shumicë të kualifikuar votash. Në Traktatin e Lisbonës numërohen mbi 40 sfera të reja nga të cilat pjesa më e madhe janë sfera ekzistuese të ndryshuara me procedurën e bashkë-vendosjes, ndërsa 13 janë sfera të reja që për herë të parë janë vënë në procedurë të bashkë-vendosjes (si p.sh: liria; siguria dhe drejtësia; procedura e azilit, migracionit, bashkëpunimi gjyqësor për çështjet penale; rregullat minimale për përcaktimit të dënimeve në sferën e krimit të organizuar; masat për parandalimin e krimit; EURO-JUST (drejtësia evropiane); bashkëpunimi policor; EUROPOL dhe mbrojtja e qytetarëve). Ndryshime të rëndësishme janë bërë edhe në sferën e politikës bujqësore dhe tregtinë e jashtme, mirëpo akoma mund të vërehen përjashtime të caktuara nga rregulli i bashkë-vendosjes.

Megjithatë, është fakt se Traktati i Lisbonës rriti kapacitetin legjislativ të PE-së, mirëpo se sa do të arrijë t'i përgjigjet sfidave të parashtruara në të, mbetet për t'u parë. Në këtë drejtim, do të ishte i nevojshëm një konsolidim i brendshëm dhe riorganizim i vetë Parlamentit, posaçërisht në funksionimin e komiteteve të përhershme dhe hapjen e nën-komiteteve të reja, racionalizimin e kohës së shfrytëzuar në seancat plenare etj. Në veçanti, Komiteti për të drejtat, liritë dhe punët e brendshme do të duhet të ndryshojë natyrën e punës për shkak të zgjerimit të procedurës së bashkë-vendosjes dhe shumicës së kualifikuar në sferën e drejtësisë dhe sigurisë.

Fatkeqësisht, Traktati i Lisbonës nuk parashikon të drejtën e iniciativës ligjvënëse Parlamentit Evropian (Komisioni mban akoma të drejtën ekskluzive të iniciativës ligjore si element i balancimit institucional). Roli i PE-së do të përmirësohet në drejtim të ngritjes së mbikëqyrjes institucionale ndaj Komisionit dhe trupave të tij punues, procedurë kjo e cila mund të zbatohet atëherë kur Komisioni do të vendosë që të ndryshojë, plotësojë apo anulojë elementet

jo qenësore të ndonjë instrumenti të miratuar në procedurën e bashkë-vendosjes. D.m.th, çdo herë ku Komisioni sipas procedurës së tij rregullatore do të lejojë masa të propozuara nga ndonjë organ kompetent i tij, do të duhet që ato t'i dorëzohen Këshillit dhe Parlamentit, të cilët në afat prej 3 muajsh, duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i kundërshtojnë propozim-masat nëse vërejnë se ato e tejkalojnë fuqinë e parashikuar në instrumentin kryesor, ose me to nuk respektohet parimi i subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Kësisoj, Këshilli mund të veprojë me 2/3 e shumicës, ndërsa Parlamenti me shumicë votash, dhe nëse paraqiten opinione të kundërta, propozim-masat duhet të miratohen nga Komisioni. E drejta e PE-së që me shumicë votash të kundërshtojë propozim-tekstin e caktuar ose masën e parashtruar nga Komisioni, i ngjan vetos ose frenimit në procesin e vendimmarrjes, mirëpo zbatimi i drejtë i procedurës së mbikëqyrjes mund të çojë në ngritjen dhe përmirësimin e aktiviteteve të Parlamentit.

Ndryshimet në rolin e Parlamentit Evropian, me Traktatin e Lisbonës, kanë të bëjnë me fuqinë e përforcuar të tij, përsa i përket legjislationit, buxhetit dhe kontrollit politik:

- *në fushën legjislative*, Traktati i Lisbonës shënon zgjerim të procedurës legjislative të bashkë-vendosjes (Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave) në mbi 40 fusha të reja. Kjo procedurë i jep Parlamentit, fuqi legjislative që krahasohet me atë të Këshillit të Ministrave. Kjo procedurë aplikohet kryesisht në fushën e kompetencave të deritanishme të BE-së (tregu i përbashkët dhe menaxhimi ekonomik) dhe disa kompetenca të reja që i janë dhënë. Në rast të fundit, duhet theksuar se fuqia ligjvënëse e Parlamentit Evropian fokusohet në kontrollin e personave në kufij, masat për menaxhimin e marrjes dhe procesimin e azil-kërkuesve, luftën kundër emigrimit të paligjshëm. Po ashtu, zgjerohet edhe fuqia legjislative, si rezultat i zgjerimit të procedurës për bashkë-vendosje dhe influencës së rritur në procedurën buxhetore (neni 314).

- *në fushën buxhetore*, Parlamentit Evropian i është dhënë e drejtë e barabartë vendimmarrjeje sikurse edhe Këshillit të Ministrave, sidomos

përsa i përket aprovimit të buxhetit vjetor në tërësi (ndërsa deri tani Këshilli ka pasur fjalën e fundit në të ashtuquajturat 'shpenzime të detyrueshme' që përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxhetit të BE-së, veçanërisht shpenzimet bujqësore). Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave, tani kanë fuqi të përbashkët vendimmarrëse mbi buxhetin e BE-së, në tërësi. Procedura e bashkë-vendosjes i ka dhënë rol ekuivalent Parlamentit dhe Këshillit. Po ashtu, roli është zgjeruar në pjesën më të madhe të fushave që votohen me shumicë të kualifikuar. Riemërtimi si "procedurë e rregullt legjislative" konfirmuan rolin e tij qendror në procesin e vendimmarrjes. Roli i Parlamentit po ashtu është përforcuar, dhe në këtë drejtim ka fuqi të barabartë vendimmarrëse me Këshillin, me të cilën e rrënon "fjalën e fundit" të Këshillit si e drejtë e posaçme mbi shpenzimet e detyrueshme (veçanërisht, për politikën e përbashkët bujqësore).

Përsa i përket fuqisë buxhetore të Parlamentit, sipas nenit 268 dhe 279 b të Traktatit të Lisbonës, kjo i besohet plotësisht Parlamentit sipas procedurës së bashkë-vendosjes. Kësisoj, Parlamenti do të ketë të drejtë të vendosë për të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore që paraqesin gjithashtu rritje të dukshme të fuqisë së tij. Nga ana tjetër, Parlamenti do të ketë obligim të prezantojë kornizën shumëvjeçare financiare në të cilën do të parashikohen shpenzimet vjetore, vlerësimi i shpenzimeve të ndryshme dhe kategoritë e pagesave në BE. Traktati i Lisbonës sheshon dallimet midis fondeve strukturore të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, dhe politikës së brendshme për shpenzimet. Edhe pse Parlamenti ka fjalën e fundit mbi buxhetin, ai mund të refuzojë buxhetin vetëm nëse për një gjë të tillë votojnë shumica e deputetëve. Në rast se buxheti refuzohet nga Këshilli, atëherë ai mund të miratohet vetëm sipas modelit me 3/5 e votave.

- *në fushën e kontrollit politik*. Parlamenti ka rol vendimtar në zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit Evropian dhe vendosjen e Komisionit në tërësi, përfshirë Përfaqësuesin e ri për Çështjet e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, nënkryetarit të

Komisionit [neni 17(7)]. D.m.th., në fushën e kontrollit politik, Parlamenti Evropian zgjedh Kryetarin e Komisionit me propozim të Këshillit Evropian. Parlamenti mban llogari për zgjedhjet evropiane përpara se të shprehet shumica. Kjo bën që vota e qytetarëve të ketë më shumë peshë dhe të influencojë në kursin e çështjeve politike evropiane. Votuesit mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në anësinë politike të kolegjiut. Me Traktatin e Lisbonës, Parlamenti është i vetmi institucion i Komunitetit që zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë të përgjithshëm dhe shënon rritje të madhe të fuqisë politike në “trekëndëshin institucional” (Komision, Këshill Ministrash dhe Parlament Evropian). Po ashtu, sipas nenit 9 të Traktatit të Lisbonës, Parlamenti do të zgjedhë kryetarin e Komisionit Evropian në propozim të Këshillit Evropian, duke marrë parasysh rezultatet nga zgjedhjet e fundit, dhe pas konsultimeve të mëparshme do të lejojë përbërjen e Komisionit të zgjedhur më parë nga Kryetari i emëruar. Përpara së Këshilli Evropian të sjell çfarëdo qoftë vendimi, përfaqësuesit e tyre do të mbajnë konsultime të përbashkëta ku do të fokusohen në biografinë e kandidatëve për kryetarë të Komisionit. Ekziston një ndarje e qartë e kompetencave ku Këshilli Evropian propozon kandidatin, ndërsa Parlamenti e zgjedh atë, gjë kjo që mund të interpretohet si ratifikim i përzgjedhjes së bërë nga Këshilli Evropian. Është evidente se edhe në të kaluarën, veçanërisht në vitin 2004 Parlamenti kishte parasysh nevojën e nominimit të kandidatit për kryetar të Komisionit, në pajtueshmëri me vullnetin e deputetëve.

Në pjesën e bashkëpunimit të përforcuar, në nenin 280 të Traktatit të Lisbonës parashikohet që cilado qoftë iniciativë duhet të marrë pëlqimin e Parlamentit (përveç çështjeve nga sfera e politikës së jashtme dhe sigurisë ku Parlamenti vetëm konsultohet).

Parlamenti sipas nenit 33 përfshihet edhe në procedurën për ndryshim të traktateve të Unionit, dhe paraqet aktor kryesor në iniciimin e ndryshimeve të tilla sipas procedurës së rëndomtë me organizim të konventës. Përkatesisht pëlqimi i tij është i nevojshëm edhe

atëherë kur Këshilli Evropian do të vendos të thirret konventë.

Si përfundim, Traktati i Lisbonës e rrit fuqinë e PE-së në disa fronte:

- *e para*, përmes procedurës së bashkëpunimit të përforcuar do të rriten aktivitetet e komiteteve në Parlament;
- *e dyta*, përmes kontrollit të rritur rregullues dhe mbikëqyrës mbi punën e institucioneve tjera, PE-ja do të stabilizojë fuqinë e tij kontrolluese;
- *e treta*, përmes fuqisë më të madhe buxhetore Parlamenti do të sigurojë ndikim më të madh institucional në krijimin e politikave të BE-së;
- *e katërta*, përmes dispozitave të reja të rolit të forcuar të PE-së në procedurën për ndryshimin e dispozitave të traktateve të BE-së, Parlamenti për herë të parë do të fitojë shansin për t'u bërë aktor kryesor në përcaktimin e fizionomisë së re të BE-së.

2.2 Komisioni Evropian

Traktati i Lisbonës parashikon një mekanizëm për reduktimin e mundshëm të numrit të komisionarëve, prej vitit 2014 (neni 17(5)). Ky mekanizëm do të rezultojë me 2/3 e shteteve anëtare, që nënkupton zvogëlimin e numrit të komisionerëve nga 27 në 18 për periudhën 2017-2019. Sipas këtij mekanizmi, e drejta e emërimit të Komisionerit nënkupton rrotacionin e shteteve anëtare në baza të barabarta. Pra, çdo shtet anëtar mund të emërojë anëtarin e vet në Komisionin Evropian për dy nga tre përbërjet e Komisionit, ose 10 vjet në çdo 15 vjet (neni 9d).

Ndryshim tjetër, përbën edhe lidhja direkte midis rezultatit të zgjedhjeve parlamentare evropiane, dhe zgjedhjes së kandidatit për Kryetar të Komisionit. Ai do të zgjidhet nga Parlamenti, në bazë të propozimit të Këshillit Evropian (sipas shumicës së kualifikuar) duke mbajtur llogari për rezultatet e zgjedhjeve parlamentare [neni 17(7)]. Parlamenti po ashtu, ka rol vendimtar në zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit dhe vendosjen e Komisionit në tërësi, përfshi Përfaqësuesin e Lartë për Çështjet e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, i cili njëkohësisht do të jetë nënkryetar i Komisionit (neni 9e). Kryetari do të ketë më tepër

fuqi, pasi gëzon të drejtën e shkarkimit të komisionarëve.

Komisioni Evropian do të ketë rolin kryesor për të promovuar interesat publikë të BE-së. Roli i Komisioni zgjerohet në fushën e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë.

Kjo njëkohësisht nënkupton ndryshime në favor të shteteve të vogla gjatë konstituimit të Komisionit. Ky traktat ndryshoi edhe mënyrën e zgjedhjes së kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve të këtij institucioni. Së pari, Këshilli Evropian me shumicë të kualifikuar emëron kryetarin e Komisionit, i cili aprovohet nga Parlamenti Evropian. Pastaj, Kryetari i emëruar, në pajtim me Këshillin Evropian propozon anëtarët e tjerë të Komisionit, ndërsa Komisioni si tërësi emërohet pasi të aprovohet nga Parlamenti Evropian.

Po ashtu, kryetari i Komisionit fiton autorizime të mëdha, p.sh ai ndan përgjegjësitë ndërmjet komisionerëve të cilët ushtrojnë detyra që u janë besuar nga kryetari i Komisionit; kryetari mund të pezullojë ndonjë anëtar nga funksionet pasi të ketë marrë autorizim nga kolegji me shumicë të zakonshme votash (neni 217).

Sipas Traktatit të Lisbonës, Komisioni ka rol thelbësor mbi implementimin e programit të Komunitetit të përcaktuar me këtë traktat. Veçanërisht, organizimi më i mirë dhe zhvillimi i politikave më efektive, do të mundësojnë implementimin e Strategjisë Evropiane për globalizim.

Traktati i Lisbonës nuk i ndryshon kompetencat e Komisionit, por roli dhe ndikimi politik i Kryetarit të Komisionit Evropian përcaktohen qartë dhe përforcohen. Monopoli i Komisionit lidhur me fuqinë e iniciativës po ashtu theksohet qartë, dhe është i njohur roli i tij vendimtar në vënien e bashkëpunimit të përforcuar.

Ndryshimet në kompetencat legjislative të Komisionit Evropian me Traktatin e Lisbonës lidhen me:

- monopolin për iniciimin e legjislacionit [neni 17(2)] të cilin ky institucion, e zgjeron në politikën e bashkëpunimit juridik, penal dhe çështjet civile përveç disa përjashtimeve (nenet 76, 289), por jo edhe në politikën e jashtme dhe të sigurisë;

- mbikëqyrjen në zbatimin e të drejtës së BE-së [neni 17(1)];

- sigurimin e përfaqësimit të jashtëm të Unionit, me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe rrafshet e tjera të caktuara në Traktat [neni 17(1)].

2.3 Këshilli i (ministrave) BE-së

Risi të rëndësishme institucionale ka parashikuar Traktatit i Lisbonës, dispozitat e të cilit kanë të bëjnë kryesisht me promovimin e metodave të reja në procesin e vendimmarrjes dhe zëvendësimin e unanimitetit, me shumicën e kualifikuar, për shumë çështje.

Roli i Këshillit të BE-së nuk ndryshon dhe ai do të vazhdojë të ndajë fuqinë e vendimmarrjes dhe buxhetit me Parlamentin dhe po ashtu, mban rolin e tij qendror në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe koordinimin e politikave ekonomike.

Ndryshimet që solli Traktati i Lisbonës për Këshillin kanë të bëjnë si vijon:

- *ndryshon procedura e vendimmarrjes*, përkatësisht forma e votimit. Votimi me shumicë të kualifikuar sipas shpërndarjes së votave nga Traktati i Nicës, ka kërkuar 255 vota apo 73.9% nga numri i përgjithshëm i votave (345). Ky sistem do të mbetet në funksion deri më 2014, ndërsa më pas, shumica e kualifikuar (e njohur si 'shumicë e dyfishtë') do të kërkojë që vendimet të merren, nëse plotësohen dy kushte nga Traktati i Lisbonës. Ndryshe nga Parlamenti Evropian, ku vendimet merren me shumicë të thjeshtë, rregullat e votimit në Këshill pasqyrojnë peshën e çdo shteti anëtarë dhe shumicën e qytetarëve të BE-së, (të ashtuquajturën 'shumicë e dyfishtë'). Ndryshe nga deri më tani, ku shtetet anëtare kanë pasur vota sipas peshës demografike, me Traktatin e Lisbonës krijohet një sistem më demokratik dhe më transparent i bazuar në shumicën e dyfishtë të shteteve dhe popullatës (që nënkupton se një akt mund të aprovohet në Këshill nëse atë e kanë përkrahur 55% e shteteve anëtare ose 15 nga 27 shtetet anëtare të BE-së, dhe ato të përfaqësojnë 65% të popullatës së Unionit). Kjo do të reflektojë legjitimitetin e BE-së si Union i kombeve dhe

shteteve, ku e drejta e BE-së do të jetë më transparente dhe më efikase. Sidoqoftë, ky sistem i votimit të shumicës së kualifikuar, nuk do t'i përfshijë të gjitha fushat edhe pse ato ndaj të cilave do të përdoret, janë të zgjeruara dukshëm. Sipas këtij sistemi, do të merren vendime për ndryshimet klimaterike, ndihmën humanitare dhe sigurinë energjetike; ndërsa për çështjet tatimore, politikën e jashtme, mbrojtjen dhe sigurinë sociale është ruajtur rregulla e vendosjes me konsensus.

Për të shmangur pengesën nga 'një numër i vogël shtetesh anëtare me numër të madh banorësh' të marrjes së vendimeve, parashikohet "pakica bllokuese" që përbëhet nga të paktën 4 shtete anëtare. Përndryshe, shumica e kualifikuar do të llogaritet si e arritur edhe nëse kriteri demografik nuk plotësohet. Për t'u ballafaquar me shqetësimin e Polonisë se sistemi i tillë e sanksionon atë krahas shteteve të tjera të mëdha, u arrit një kompromis, që vendosja për zbatim e sistemit të ri, të zgjatej deri në vitin 2014. Prej 1 nëntorit 2014 deri më 31 mars 2017, sistemi i shumicës së dyfishtë do të plotësohet me një rregull shtesë e cila lejon përlllogaritjen e votave sipas Traktatit të Nicës.

Nëse numri i shteteve që janë kundër tekstit të ndonjë akti, është i madh por akoma i pamjaftueshëm për të bllokuar vendimin (1/3 e shteteve anëtare ose 25% e popullatës), të gjitha shtetet anëtare angazhohen të gjejnë zgjidhje për të mbledhur kundërshtarët që të rezervohen nga mundësia e votimit.

- *zgjerohet përdorimi i shumicës së kualifikuar.* Deri tani, shumica e kualifikuar është përdorur për shumë çështje, përfshi bujqësinë, rregullat e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisin, ndërsa me Traktatin e Lisbonës ky rregull do të zgjerohet edhe në fusha të tjera si energjia, azili dhe migracioni nga vendet jo anëtare të BE-së (neni 53).

Përdorimi i shumicës së kualifikuar u zgjerua në fushat politike që më herët ishin subjekt i unanimitetit, veçanërisht çështjet lidhur me bashkëpunimin policor dhe juridik.

Fushat më të rëndësishme që do të menaxhohen sipas shumicës së kualifikuar janë:

- *në sferën sociale:* lëvizja e lirë e punëtorëve, përfitimet sociale, parimet e koordinimit të funksionimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik

- *në sferën ekonomike, financiare dhe buxhetore:* ndryshimi i disa dispozitave mbi statusin e Sistemit Evropian në Bankave Qendrore, emërimi i kryesuesit të BQE-së dhe anëtarët e Bordit, masat implementuese për sistemin e resurseve vetjake (megjithatë dispozitat mbi resurset vetjake mbeten subjekt i unanimitetit); qëndrimet e përbashkëta dhe përforcimi i unifikuar në arenën ndërkombëtare të eurozonës.

- *në fushën e bashkëpunimit policor dhe drejtësisë, migracionit dhe bashkëpunimit administrativ:* bashkëpunimi administrativ në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, kontrollet kufitare (përveç pasaportave, dokumenteve të identifikimit dhe lejeve të qëndrimit), azili dhe mbrojtja e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, imigrimi, bashkëpunimi policor në disa sektorë (përveç bashkëpunimit operativ që mbetet subjekt i unanimitetit), Europol, masat shtesë mbi parandalimin e krimit, mbrojtja civile, bashkëpunimi administrativ.

- *në sferën e politikës së jashtme:* vendimet që bazohen në vendimet e Këshillit Evropian ose me propozim të Përfaqësuesit të Lartë që shoqërohet me vendimin e Këshillit Evropian, emërimi i përfaqësuesit special, masat për lehtësimin e mbrojtjes diplomatike apo konsullore, emërimi i Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë, Statuti i zyrave qendrore të Agjencisë Evropiane për Armatim, vendosja e bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar në fushën e mbrojtjes, krijimi i fondeve fillestare për financimin e detyrave të politikës së mbrojtjes, ndihma humanitare dhe krijimi i trupave evropian vullnetar.

- *në kornizat e kompetencave të reja të përcaktuara për BE-së:* politikën mbi hapësirën, energjinë (funksionimi i tregut, furnizimet, energjia e ripërtërishme, bashkë-komunikimit), turizmi dhe sporti)

- *në sferën institucionale:* regjistrimi i konfiguracionit të Këshillit, rishikimi i rregullave

që kanë të bëjnë me përbërjen e Komitetit të Rajoneve dhe Komitetit Ekonomiko-Social, iniciativa e qytetarëve evropian drejtuar Komisionit për propozim/ndryshimet e të drejtës së BE-së, marrëveshjet për tërheqjen e shteteve anëtare, administrimi i BE-së

- *sferat e tjera*: standardet e larta të sigurisë për pajisjet mjekësore dhe kurim, masat në favor të mbrojtjes së shëndetit njerëzor, në veçanti luftës kundër kërcënimeve serioze tej-kufitare, duhanit dhe alkoolit, pronësisë intelektuale (themelimi i të drejtës dhe implementimi i regjimit të autorizimit, kontrolli i centralizuar në nivel evropian), në përjashtim të regjimit gjuhësor të së drejtës së pronësisë.

Në disa fusha (si p.sh: mbrojtja, tatimet, disa aspekte të politikës së jashtme, mbrojtja sociale, të drejtat e qytetarëve, gjuha etj) vendimet do të vazhdojnë të merren me unanimitet, që nënkupton të drejtën e çdo shteti të vendos 'veto' për ndonjë propozim apo ndryshim në këto sfera.

- *takimet legjislative mbahen publikisht* [neni 16(8)]. Sipas Traktatit të Lisbonës Këshilli i Ministrave mban mbledhje publike (gjë që deri tani, nuk ishte kështu) dhe sipas kësaj, gazetarët mund të informojnë qytetarët mbi debatet që zhvillohen brenda Këshillit;

Deri tani Këshilli i Ministrave kryesohej nga përfaqësuesit e shteteve sipas sistemit të rotacionit 6 mujorë. Sipas Traktatit të Lisbonës, kjo do të vazhdojë për të gjithë këshillat përveç atij për Punë të Jashtme, i cili do të kryesohet nga Përfaqësuesi i Lartë për Çështje të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë. Rotacioni midis shteteve anëtare do të vazhdojë në çdo 6 muaj për kryesimin e formacioneve sektoriale të Këshillit.

Duke shfuqizuar unanimitetin, integrimet evropiane mund të zhvillohen më shpejtë, duke përshpejtuar ritmin e implementimit të politikave të Unionit. Ashtu sikurse në çdo rishikim të traktateve të mëparshme, edhe me këtë Traktat fushat kyçe nuk janë më subjekt i unanimitetit, por kalojnë me votim të shumicës së kualifikuar. Fushat e ndjeshme siç janë taksat, mbrojtja sociale, politika e jashtme, politika e përbashkët e mbrojtjes, bashkëpunimi operativ policor, regjimi

i gjuhës dhe zyrave qendrore të institucioneve, bëhen fusha të cilat do të menaxhohen sipas shumicës së kualifikuar.

Në frymën e mënyrës së miratimit të akteve nga Këshilli, përcaktimi i ri i votimit të shumicës së kualifikuar do të mundësojë shmangien e rrethanave që për zgjerimet e ardhshme, e vështirësojnë çështjen e numrit të votave të përcaktuara për çdo shtet.

Së fundi, mund të vendoset për transferimin nga procedura e veçantë legjislative në procedurë të rregullt legjislative në disa sfera, veçanërisht e drejta e punëtorëve (neni 137), zhvillimi rajonal dhe mjedisi (175).

2.4 Këshilli Evropian

Traktati i Lisbonës krijoi poste të reja: Kryetarin e Këshillit Evropian dhe Përfaqësuesin e Lartë të BE-së për Çështje të Politikës së Jashtme dhe sigurisë.

- *Kryetari i Këshillit Evropian*, zgjidhet nga vetë Këshilli Evropian me shumicë të kualifikuar për 2.5 vjet me mundësi për një rizgjedhje tjetër [neni 27(3)]. Këshilli Evropian do të menaxhohet nga pozicioni i ri i Kryetarit [neni 15(6)], me qëllim që të përmirësojë efikasitetin e punës së Këshillit Evropian. Puna kryesore e tij do të jetë përgatitja e punës së Këshillit dhe sigurimi i vazhdueshmërisë së punës përmes konsensusit të vendeve anëtare. Ai do të ndihmojë vazhdimësinë politike, do të rrisë ndikimin e BE-së në arenën botërore, do të adresojë shqetësimet mbi temat financiare dhe personelin. Kryetari, për aq kohë sa ushtron postin, nuk mund të mbajë edhe ndonjë pozitë tjetër zgjedhore në vendin e tij. Kryetari i Këshillit Evropian nuk ka rolin e Kryetarit të SHBA-së, por ai vetëm kryeson Këshillin Evropian. Kryesuesi i ri nuk do të ketë më tepër fuqi, por më tepër koherencë dhe konsistencë në menaxhimin e prioritetëve të Këshillit Evropian, qasjet strategjike dhe drejtimit e tij. Kryetari po ashtu, do të sigurojë përfaqësim të jashtëm të Unionit mbi Çështjet e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, pa ndikuar në rolin e Përfaqësuesit të Lartë.

Kryetari i Këshillit Evropian do të jetë përveç Përfaqësuesit të Lartë dhe Kryetarit të Komisionit

Evropian “njeriu i tretë” në krye të BE-së. Kjo formë e drejtimit të “Presidencës treshe” të Unionit mund të çojë në dyshim të efikasitetit të Unionit në të ardhmen që të flet me një zë. Kryesimi i Këshillit me formacion të ndryshëm sipas “treshes” do të vazhdojë, ndërsa bashkëpunimi me një presidencë stabile të Këshillit do të rezultojë si komplekse.

Kryetari i Këshillit Evropian do të përfaqësojë BE-në në nivelin më të lartë, dhe për dallim nga kryesuesit e sotëm të cilët nuk mund të jenë njëkohësisht kryetar qeverie, apo funksionar tjetër i shtetit anëtar. Kështu, synohet të rritet pesha politike e BE-së si fuqi globale politike. Anëtarë të Këshillit Evropian, sipas funksionit do të ishin ministri i punëve të jashtme të BE-së dhe Kryetari i Komisionit Evropian, ndërkohë që ministrat e jashtëm të shteteve anëtare nuk do të ishin më në përbërjen e tij. Kështu, prezenca numerike thuhet do të përgjysohej në mbledhjet e Këshillit Evropian.

Kryetari i Këshillit Evropian do të kishte zyrën e vet dhe do të gëzonte mbështetjen organizative në Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit të BE-së. Kjo do të thoshte, se Këshilli Evropian do të kishte një aparat shumë të vogël administrativ dhe pozitë relativisht të vogël në buxhet. Këshilli Evropian do t’i merrte vendimet e tij, me pajtimin e të gjithë anëtarëve, ndërsa për emërimin e mandatarit për Kryetarin e Komisionit të BE-së dhe për përbërjen e plotë të Komisionit, vendimet do të merrreshin me shumicë të kualifikuar. Këshilli Evropian nuk do të kishte as në të ardhmen funksion ligjvënës.

• *Përfaqësuesi i diplomacisë së BE-së* (Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Çështjet e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë) do të rrisë shtrirjen ndërkombëtare të BE-së. Ai emërohet nga Këshilli Evropian në pajtim me Kryetarin e Komisionit (neni 9e), ndërsa Parlamenti konsultohet për emërimin e Përfaqësuesit të Lartë (përpara të cilit bën edhe betimin). Ai do të kombinojë në një pozicion, përgjegjësitë e Përfaqësuesit të Lartë të Këshillit të Ministrave për Politikë të Jashtme dhe Sigurisë, si dhe Komisionerit për Marrëdhëniet me Jashtë (mban pozicionin e nënkryetarit të Komisionit Evropian

të ngarkuar për çështje të jashtme), i cili koordinon aktivitetet diplomatike të Komisionit Evropian dhe menaxhon programet për zhvillim të BE-së. D.m.th., personi në këtë pozicion do të jetë agjent i Këshillit të Ministrave (që do të përfaqësojë shtetet anëtare), njëkohësisht edhe nënkryetar i Komisionit.

Përfaqësuesi i Lartë do të duhet të drejtojë politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Unionit, të kontribuojë në zhvillimin e kësaj politike dhe t’a zbatojë atë gjatë mandatit të këshillave. Kompetencat e tij po ashtu, janë zgjeruar në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, për të cilën do të ketë përkrahjen e “shërbimit për veprim të jashtëm”, i përgatitur nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe shtetet anëtare.

Ai mund të humb pozicionin e tij si komisioner në rast se ndaj tij ngrihet mocion mosbesimi. Në këtë rast, në emër të parimit të kolegialitetit të Komisionit Evropian, ai mund të fitojë mbështetje për punën e tij nëse shumica e kolegëve të tij e përkrahin për çfarëdo iniciative nga fusha e kompetencave të tij. Përfaqësuesi i Lartë për Çështjet e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë / zv. Kryetar i Komisionit është bartës i dy funksioneve:

- kombinon funksionin e Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Sigurisë, dhe Komisionerit për Çështje të Jashtme (neni 18), ndërsa portofoli i tij mbetet për t’u qartësuar nga Kryetari i Komisionit dhe ai i Këshillit Evropian;
- kryesues i ‘shërbimit të ri Evropian për veprim të jashtëm’, aktivitetet e të cilit mbeten të përcaktuhen me vendim special të Këshillit [neni 27(3)].

Traktati i Lisbonës ka parashikuar ngritjen e Këshillit Evropian në nivelin e institucionit më të lartë të integritetit, që do të kishte më së paku katër mbledhje të rregullta në vit. Ai parashikon heqjen e pozitës së shtetit kryesues në Këshillin e BE-së, që ndryshon çdo gjashtë muaj. Në vend të tij, nuk do të ishte më shteti, por personi i zgjedhur - Kryetari i Këshillit Evropian me mandat dy vjet e gjysmë. Ky mandat do të mund të zgjatej edhe për dy vjet e gjysmë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, mund të zbuten disa mangësi të deritashme në organizimin dhe funksionimin e Këshillit Evropian.

2.5 Gjykata e Drejtësisë

Sipas Traktatit të Lisbonës, juridiksioni i Gjykatës së Drejtësisë është zgjeruar në të gjitha aktivitetet e Unionit, me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe sigurisë (neni 9f). Sidoqoftë, Gjykata ka 'lajthitje' në rast të shkeljes së procedurës ose konfliktit për kompetenca (patrullimi i kufijve midis shtyllës së parë dhe të dytë). Ajo mund të japë masave (shtrënguese) restriktive dhe të ofrojë opinion mbi marrëveshjet ndërkombëtare (neni 240a). Nëse opinioni i Gjykatës është në kundërshtim, marrëveshja e shqyrtuar nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë sa nuk ndryshohet ose rishikohet (neni 188n).

Ndryshim është bërë edhe në numrin e avokatëve të përgjithshëm, i cili është rritur nga 8 në 11 (Deklarata Nr.38), ndërsa parashikohet edhe mundësia e themelimit të gjykatave të specializuara, nëse për një gjë të tillë bie dakord edhe Parlamenti (p.sh në fushën e të drejtës autoriale).

Ndryshimet në Gjykatën e Drejtësisë, sipas dispozitave të Traktatit të Lisbonës numërohen si vijon:

- zgjeron juridiksionin me përjashtim themelor të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (nenet 19, 24);
- panel konsultativ për emërimin e gjykatësve dhe avokatëve të përgjithshëm (nenet 253-255);
- Gjykata Evropiane e Drejtësisë mbetet akoma kompetente për të rishikuar aktin legjislativ lidhur me pajtueshmërinë e tij me parimin e subsidiaritetit, me iniciativë të shtetit anëtar (bazuar në nenin 230). Parlamentet nacionale mund të veprojnë vetëm përmes qeverive të tyre (neni 8 i Protokollit Nr. 2 për aplikimin e parimit të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit). Gjykata e Drejtësisë e BE-së ka pushtet të veprojë në bazë të shkeljes së parimit të subsidiaritetit përmes aktit legjislativ, të shpallur në pajtim me rregullat

e përcaktuara në nenin 230 nga shtetet anëtare ose të shpallura nga ato sipas rendit të tyre në emër të parlamenteve nacionale.

KONKLUZIONE

Sipas kësaj që cekëm më lartë, Bashkimi Evropian do të vazhdon të jetë pro-motor i risive në të gjitha segmentet e jetës shoqërore në shtetet anëtare por edhe në ballafaqimin me sfidat e kohës.

Një çështje tjetër e cila mund të shkakton brengosje paraqet vetë mënyra se si do të interpretohet dhe implementohet Traktati (që do të varet nga personat e thirrur për të bërë interpretimin).

Duhet pasur parasysh se Traktati i Lisbonës paraqet vetëm një dokument bazë, i cili tenton t'u jep kahe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohet BE-ja, mirëpo se si kjo do të realizohet në praktikë varet nga shume faktorë dhe nga sjellja e shteteve në drejtim të respektimit të dispozitave të Traktatit.

Megjithatë, edhe ky dokument nuk ka arritur të jetë i përsosur për t'u ballafaquar me të gjitha problemet reale, ndërsa për të gjitha problemet tjera që do të paraqiten gjate kohës do të duhet të ndërmerren edhe hapa të mëtejshme në revidimin dhe plotësimin e dispozitave të tij në të ardhmen.

BIBLIOGRAFIA

1. Azizi A., "Bashkimi Evropian: E Drejta, Institucionet dhe Politikat", Tetovë, 2010
2. Bonde J.P., "The Lisbon Treaty", Foundation for EU Democracy, Notat Grafisk, Denmark - 2009.
3. EuroWorld 2015: a European strategy for Globalisation.
4. Protokollit No1 mbi rolin e Parlamenteve Nacionale në BE OJ 2007 C306/148
5. Protokollit No2 mbi aplikimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit OJ 2007 C306/150.

TË JESH PRIND I NJË FËMIJE ME ÇRREGULLIME ZHVILLIMI: STRATEGJITË E PËRBALLJES SË STRESIT

ERJONA DERVISHALIAJ

Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

AKTET IV, 4: 598 - 602, 2011

PERMBLEDHJE

Qëllimi i këtij studimi ishte eksplorimi i përvojave të prindërve të fëmijëve me çrregullime zhvillimi, e konkretisht mënyrave të përballjes me stresin e përjetuar prej tyre. Studimi ka natyrë përshkruuese. Intervista të gjysmëstrukturuara u zhvilluan me me prindër të fëmijëve me çrregullime të zhvillimit. Fëmijët me çrregullime të zhvillimit i përkisnin moshës 6-10. Të dhënat u përftuara u analizuan dhe u përpunuan duke përdorur përjasjen e Teorisë së Bazuar tek të Dhënat (Grounded Theory). Përfundimet e studimit gjetën mbështetje në studime e kryera më parë në kontekste të tjera. Gjetje të tjera kërkojnë hulumtim të mëtejshëm .

Fjalë kyçe: çrregullime zhvillimi, strategji përballimi të stresit, teoria e bazuar mbi të dhënat.

SUMMARY

The purpose of this research was to explore the subjective experiences of families of children with developmental disabilities, specifically coping strategies for these families. Semi – structured interviews were conducted with families to shed light on their subjective experience. In an effort to increase understanding of the worldview of these families, issues in theory, and family research are briefly discussed. Findings of this study were supported by other research findings. Still, there is need for further research in this area.

Key words: developmental disabilities, coping, grounded theory

HYRJE

Prezenca e nje çrregullimi të zhvillimit nuk i shkakton vuajtje psikologjike vetëm individit që e ka atë, por edhe familjes që përballlet çdo ditë me të. Shumë evidenca tregojnë se prindërit e fëmijëve me çrregullime zhvillimi përjetojnë nivele më të larta stresi se prindërit e fëmijëve me zhvillim tipik (Hastings 2002, Jones & Passey 2004). Me gjithë këto sfida, me të cilat prindërit duhet të përballen çdo ditë, studimet tregojnë se ata arrijnë të zhvillojnë perceptime e qëndrime pozitive për situatën ku gjenden (Gupta & Sigal, 2004).

Për t'u ardhur në ndihmë familjeve, së pari, është e nevojshme të njihen e të hulumtohen më tepër cilat janë qëndrimet dhe perceptimet e prindërve. Studimi kërkon t'u japë një mundësi

prindërve për t'u dëgjuar, për të kuptuar mungesat dhe nevojat e tyre.

Sipas Lazarus (Hauser et al 2003), përballimi i stresit konsiston në një seri transaksionesh midis individit dhe mjedisit, të cilat synojnë të rregullojnë gjendjen e brendshme të personit, apo marrëdhënien e tij me mjedisin.

Propozohen dy dimensione të përballimit të stresit, strategjitë e përballimit të orientuara/përqendruara te problemi, dhe strategjitë e orientuara/përqendruara te emocionet..

Sarafino (Hauser et al 2003) i ka vlerësuar teknikat e përqendruara te problemi si më adaptive, se ato të fokusuara tek emocionet. Teknikat e fokusuara te problemi mund të përdoren kur individit mund të ndryshojë rrethana të caktuara të situatës, ndërkohë që teknikat e

fokusuara tek emocionet zakonisht përdoren kur individi është i pafuqishëm të ndryshojë apo rregullojë diçka nga problemi.

Vitet e fundit është theksuar roli i procesimit të kognicioneve në përballimin e stresit. (Manne 2003). Duke u dhënë një kuptim pozitiv eksperiencave negative, individi është më i aftë të pranojë humbjet që përjeton.

Një tjetër proces i përdorur është krahasimi social, ku njerëzit krahasohen me të tjerët në mënyrë që të marrin më shumë informacion për veten (Dragoti, 2004).

Jones & Passey (2004), raportojnë se t'u shpjegonin të tjerëve gjendjen apo çrregullimin e fëmijës, konsierohet një strategji e sukseshme përballimi nga prindërit. Shmangia dhe injorimi ishin dy strategji të tjera të përmendura, por jo shumë të përdorura. Si strategji aktive të përballimit të stresit, gjysma e prindërve raportuan kërkimin e suportit gjetiu, kërkimin e informacionit dhe ndihmës, ndërkohë që të tjerë raportonin teknika pasive si të "pranuarit e gjërave ashtu si janë." Pak prindër sugjeruan këmbënguljen për ndryshime në shërbimet e ofruara si psh suport në trainime e trajtime.

Qëllimi i studimit ishte: Të njihen dhe përshkruhen strategjitë e përballimit të stresit të cilat prindërit i përdorin më shpesh

Pyetja e studimit: Cilat janë mekanizmat e përballimit të stresit të përdorura nga këto familje dhe që duken se kanë ndikim zbutës mbi stresin që përjetojnë këto familje?

METODOLOGJIA

Studimi ka natyrë përshkruese dhe eksploruese mbi përjetimet e prindërve. Për t'u përshtatur kërkesave të studimit, u përdor kërkimi cilësor, duke aplikuar përfaqshën e Teorisë së Bazuar mbi të Dhënat. (Grounded Theory) për analizën e të dhënave (Eilling, 2001; Camic, Rhodes, Yardley, 2003).

Kampioni

Në studim u përfshinë 13 prindër të cilët kanë fëmijë të moshës shkollare (6-11 vjeç) të diagnostikuar me çrregullime të zhvillimit, banues në qytetin e Vlorës, dhe që kanë të paktën një fëmijë tjetër me zhvillim tipik. Për këto arsye,

kampioni i përzgjedhur ishte jorastësor, i qëllimshëm. Personat e intervistuar ishin nënat, duke qenë kujdestari kryesor i fëmijës, i njohin më mirë problemet që paraqet fëmija i tyre, nevojat e tij, dhe janë më të prekshme nga stresi.

Metoda dhe instrumenti

Metoda e përdorur për mbledhjen e të dhënave të studimit ishte intervistimi. U përdor intervista e gjysmëstruktuar. Pyetësi i intervistës së gjysmëstruktuar, përbëhet nga pyetje me fund të hapur dhe të mbyllur. Artikujt e përfshirë në pyetësor, u identifikuan nga kërkimet e mëparshme në këtë fushë, si dhe nga bisedat paraprake të zhvilluara me disa nga prindërit. Si metodë mbështetëse, gjatë intervistimit u përdor vëzhgimi i pastruktuar.

Procedura e ndjekur gjatë studimit

U realizuan takime paraprake individuale me nënat që pranuan të përfshiheshin në studim. Ato u informuan më gjerësisht mbi qëllimet e studimit si dhe u sigura leja e informuar prej tyre. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ishte 60-90 min. Intervistat u regjistruan në diktofon, me përjashtim të tre rasteve, ku prindërit nuk dhanë miratimin e tyre për përdorimin e diktofonit. Në këto raste, me aprovimin e tyre, gjatë intervistave asistoi një person i tretë (i trainuar për regjistrimin manual të të dhënave cilësore), i cili regjistroi bisedën. Intervistuesi mbajti gjithashtu shënime të zgjerura gjatë intervistës. Intervistat e regjistruara në diktofon u transkriptuan më pas dhe u kompiuterizuan.

Pas transkriptimit të intervistave, të dhënat u koduan në çdo paragraf. Etiketimet e përfutura, në sajë të krahasimeve të vazhdueshme, u bashkuan në kategori qëndrore dhe nënkategori. Gjatë kodimit, u shfaqën dy kategori kryesore të përballimit të stresit: fuqizimi i familjes në përballimin e stresit dhe shfuqizimi i saj, të cilat u studiuuan në tre dimensione: marrëdhëniet brenda familjes, marrëdhëniet e familjes me profesionistët, marrëdhëniet e familjes me shoqërinë.

REZULTATET

Marrëdhëniet me familjen dhe të afërmit-strategjitë fuqizuese

Kërkimi i informacionit dhe sigurimi i njohurive ishte një nga nëntemat e strategjive fuqizuese. Dy nga prindërit treguan se pas diagnostikimit të fëmijëve të tyre e në vazhdim, kishin kërkuar më tepër informacione e libra mbi çrregullimin e fëmijëve, për të kuptuar dhe për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të tyre. Kjo rriste sadopak ndjenjën e kontrollit të tyre mbi situatën. *Ndryshimi i perceptimeve dhe përqendrimi në aspektet pozitive* brenda familjes ishte një tjetër çështje e përfshirë në strategjitë fuqizuese të përbaljes me stresin. Disa nëna treguan kur donin t'i jepnin forca vetes, ato dhe bashkëshortët mendonin arritjet sado të vogla të fëmijës së tyre me çrregullime, për dashurinë e mbështetjen që merrnin nga anëtarët e familjes. *Zhvillimi i sensit të humorit* ishte, *ndryshimi i filozofisë së jetës dhe të pranuarit e asaj që s'mund të ndryshohet apo kontrollohet, të kërkuarit hapur të ndihmës* kur gjendeshin përbalë vështirësive, si edhe të këmbëngulnin më tepër për atë që e quanin të drejtë, ishin disa nga nëntemat e shfaqura.

Përfshirja në aktivitete që u sillnin kënaqësi ishte një tjetër nëntemë që u shfaq në kategorinë e strategjive fuqizuese. Nënat treguan se ato dhe familja e tyre përpiqeshin të gjenin mënyra të ndryshme sesi të shlodheshin e të rimerrnin fuqi, si kopshtaria, shëtitje buzë detit, organizimi i një darke familjare, dëgjimi i muzikës, apo një kafe me miqtë.

Një nga nënat, e cila ishte e punësuar, e konsideronte një strategji fuqizuese punësimin e saj, i cili e ndihmonte jo vetëm në të ardhura, por i siguronte distancimin fizik dhe psikologjik nga situata stresuese në familje duke i dhënë mundësi të rimerre forca për kthimin në shtëpi, dhe së fundi e kish ndihmuar të dilte nga izolimi i saj social.

Duke i përmbledhur sa më sipër do të thonim se strategjitë fuqizuese të raportuara nga prindërit ishin *zhvillimi i aftësive personale* (kërkimi i informacionit dhe fitimi i njohurive, kërkimi i ndihmës dhe këmbëngulja,), *zhvillimi i aftësive kognitive* (ndryshimi i perceptimeve dhe filozofisë së jetës, përqendrimi në aspektet pozitive, ngritja

e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit) dhe *perfshirja/angazhimi në aktivite përshtatëse*.

-Strategjitë shfuqizuese-

Viktimizimi i vetes dhe ndjenja e fajit, ishin dy ndër nëntemat e shfaqura. Nënat raportuan se shpesh se ato dhe bashkëshortët e tyre ndiheshin të goditur nga fati apo nga Zoti. *Mbyllja në vetvete dhe të qarët* ishte një tjetër mënyrë e komentuar nga pjesa më e madhe e nënave të përfshira në studim. *Shmangia* u raportua si një teknikë që përdorej më tepër nga bashkëshortët, duke u larguar nga shtëpia me orë orë të tëra, mospranimin për të diskutuar rreth problemeve, apo në abuzimin me alkoolin. *Shpërthimet e agresivitetit dhe zemërimit* ishte një tjetër temë e komentuar nga nënat.

Zhvillimi i kognicioneve negative (viktimizimi dhe fajësimi) dhe *sjelljet keqpërshtatëse* (mbyllja në vetvete, shmangia, shpërthimet e zemërimit) ishin dy nëntemat kryesore të shfaqura në kategorinë e strategjive shfuqizuese brenda familjes.

Dimensioni i dytë: familja dhe profesionistët-strategjitë fuqizuese

Këmbëngulja për të luftuar mbi të drejtat e fëmijëve ishte një tjetër çështje e trajtuar nga prindërit në marrëdhënie me profesionistët, po kështu edhe *kërkimi i ndihmës* nga profesionistët gjë që konsiderohej mjaft ndihmuese.

Në mënyrë të përmbledhur do të thonim se *angazhimi në komunikimin* me profesionistët dhe *kërkimi i ndihmës* janë nëntemat e strategjive fuqizuese të përdorura nga prindërit.

-Strategjitë shfuqizuese-

Pavarësisht nga eksperiencat pozitive me disa nga profesionistët, mjekë, mësues, drejtues shkollash, apo psikolog në një rast, nënat treguan se shpesh janë ndjerë të shpërfillura nga profesionistët. Reagimet e tyre në këto raste kanë qenë *shmangia, pranimi i situatës në mënyrë pasive dhe largimi, mungesa e besimit te profesionistët dhe riorientimi i pritshmërive* të tyre.

Dimensioni i tretë: familja-fqinjët dhe shoqëria-strategjitë fuqizuese

Disa nga nënat raportuan se falë problemeve që kishin kaluar, kishin *zhvilluar disa cilësi personale*

që i ndihmonin dhe u lehtësonin marrëdhëniet me të tjerët. *Ndjenja e dhembshurisë, përkujdesja për të tjerët, dhe ndjenja e përgjegjshmërisë, të dëgjuarit e duruar, të kuptuarit, dhe qëndrimet joparagjykses ndaj të tjerëve, ishin cilësitë që ato përmendën si ndihmuese gjatë ndërveprimeve sociale.*

Rivlerësimi i marrëdhënieve sociale dhe ndryshimi i prishmërive ndaj të tjerëve ishte një tjetër çështje e shfaqur. Nënata treguan se ato dhe bashkëshortët e tyre, veç vështirësive gjatë kontakteve sociale, kishin pasur mundësinë të rivlerësonin personat që u qëndronin pranë, dhe të kuptonin se cilët ishin ata që vertetë interesoheshin për familjet e tyre.

Në vazhdim të çështjes së mësipërme, 7 nga nënat komentuan se një tjetër strategji ndimuese për to ishte *kërkimi i hapur i ndihmës*, ndonëse në një rreth shumë të kufizuar njerëzish.

Konfrontimi me të tjerët dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës së tyre ishte një tjetër mënyrë që nënat e përdornin kur ndiheshin të diskriminuara apo të paragjykuara nga të tjerët, ndonëse nuk rezultoi në përdorur shumë shpesh nga nënat. Në raste të tjera, ishte *inorimi i situatës* ishte sjellja që adoptonin.

Zhvillimi i aftësive ndërpersonale (komunikimi, dhembshuria, përkujdesja etj) *ndryshimi i qëndrimeve dhe pritshmërive mbi shoqërinë* (rivlerësimi i marrëdhënieve dhe pritshmërive) dhe *sjelljet përshtatëse* (kërkimi i ndihmës, mbrojtja e të drejtave të tyre apo të fëmijëve, indiferenca) ishin tre nëntemat kryesore të kategorisë së strategjive që konsideroheshin fuqizuese nga nënat në lidhje me kontaktet sociale.

-Strategjitë shfuqizuese -

Tkurrja, largimi dhe shmangia, mungesa e besimit në kompetencat sociale, dhe zhvendosja e agresiviteti, ishin nëntemat e kategorisë së strategjive shfuqizuese të familjeve në raport me ambjentin social.

DISKUTIM

Gjetjet e këtij studimi mbështeten dhe nga studime të tjera të zhvilluara në kontekste të ndryshme. Zhvillimi i aftësive personale, zhvillimi

i aftësive kognitive e emocionale dhe kryerja e aktiviteteve përshtatëse e kreative të raportuara si strategji fuqizuese nga pjesëmarrësit në përballimin e stresit, gjejnë mbështetje në studime të tjera (Zannobini etj 2002).

Gupta & Sigal, (2004) thonë se prindërit përfshihen më tepër në strategjitë e përballimit të orientuara drejt emocioneve dhe kognicioneve, gjë që u mbështet edhe nga ky studim.

Po kështu, u vu re se zhvillimi i aftësive kognitive ishte disi më i varfër në subjekte të caktuar. Duhet pasur parasysh se faktorët personalë e kulturorë ndërthuren duke ndikuar në skemat dhe filtrat kognitive, me anë të të cilëve njerëzit procesojnë informacionin. Ky mendim mbështetet edhe nga studimet e Finn (1999) mbi familjet e fëmijëve me çrregullime të zhvillimit, të cilat u përkisnin kulturave të ndryshme.

Gjetjet e studimit hodhën dritë edhe mbi proceset e vetëartësimit-vetëvlerësim dhe vetëbesimit, të cilat u konsideruan ndihmuese nga prindërit në përballimin e ngjarjeve stresante. Studimet tregojnë se vetëartësimi dhe vetëritja i paraprijnë dhe ndërmjetësojnë gjithashtu përshtatjen pozitive me ngjarjen stresuese (Summers, Behr, & Turnbull, 1989).

Gorgoni (2002) thotë se zhvillimi i kognicioneve negative (viktimizimi dhe fajësimi) dhe sjelljet keqpërshtatëse janë disa nga çështjet që shfaqen në strategjive shfuqizuese brenda familjes, gjetje këto, që mbështeten edhe nga ky studim.

Nga studimi duket se nënat janë më të prirura të përqendrohen në aftësitë për të shprehur emocionet, ndërsa baballarët në zgjidhjen e problemeve në fushën okupacionale, ata duken më të shkëputur përsa u përket kërkesave që kanë bashkëshortet. Gottlieb & Wagner (1991) mbështesin pak a shumë këto gjetje.

Bibliografia

Camic, P.M., Rhodes, J.E. & Yardly, L. (2003). *Qualitative Research in Psychology: Expanding Perspectives in Methodology and Design*. Washington DC: American Psychological Association. disability (fq. 27–40). Baltimore: Paul H. Brooks.

- Dragoti, E. (2004). *Psikologjia sociale*. (fq 40-53) Tiranë.
- Gorgoni, L., Giannotti, G. & Cappello, R. (1992). Raporto su: Handicap, stigma e emarginazione. *Studi e Ricerche*, 13, 5-47.
- Gottlieb, W.D. Wagner, F. (1991). *Stress and support processes in close relationships*. New York, Plenum Press.
- Gupta, A. & Singhal, N. (2004). Positive perceptions in parents of children with disabilities. *Asia Pacific Disability Rehabilitation Journal*, 15:1, 22-32.
- Hastings, R.P. (2002). Parental stress and behavior problems of children with developmental disabilities. *Journal of Intellectual & Developmental Disability*, 27, 149-160.
- Hauser-Cram, P. & Howell, A. (2003). Disabilities and development. In R.Lerner, A. Easterbrooks. & J. Mistry (Eds), *Handbook of psychology: Development Psychology* (vol 6) (fq 513-535). New Jersey: John Wiley & Sons, INC.
- Jones, J. & Passey, J. (2004). Family adaptation, coping and resources: parents of children with developmental disabilities and behavior problems. *Journal on Developmental Disabilities*, 11:1, 32-44.
- Manne, Sh. (2003). Coping and Social Support. In Nezu, C. Nazu & P. Geller (Eds), *Handbook of Psychology: Health Psychology* (vol. 9) (fq. 51-75). New Jersey: John Wiley & Sons, Inc
- Summers, A., Behr, S. K., & Turnbull, A. P. (1989). Positive adaptation and coping strengths of families who have children with disabilities. In G. H. S Singer & L.K. Irvin (Eds.), *Support for caregiving families: Enabling positive adaptation to disability* (fq. 27–40). Baltimore: Paul H. Brooks.
- Willing, C. (2001). *Introducing Qualitative Research in Psychology: Adventures in theory and mind*. Buckingham: Open University Press.
- Zanobini, M., Manetti, M. & Usai, C. (2002). *La Famiglia di Fronte alla Disabilita: Stress, Risorse e Sostegni*. Trento: Erickson.

RËNDËSIA E APLIKIMIT TË STRATEGJISË SË “PROJEKTIT KËRKIMOR” NË LËNDËN E HISTORISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

ZHULJETA KADILLI, ROLAND GJINI

Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti “A.Xhuvani” ,
Elbasan

Email: zhkadilli@yahoo.com

AKTET IV, 4: 603 - 609, 2011

PERMBLEDHJE

“Shpërthimi i informacionit” është tipar i zhvillimit të sotëm shoqëror. Në këtë zhvillim të vrullshëm e të shpejtë askush nuk mund të mësojë gjithshka që i duhet të dijë, për më tepër që ato nuk mund të arrihen gjatë orëve të mësimt. Në vënd të përvetësimit të njohurive sot kërkohet nga nxënësit të ndërtojnë e krijojnë vetë njohuri. Ky artikull synon të analizojë vëndin dhe rolin që duhet të luajë projekti kërkimor në histori për për ndërtimin dhe përvetësimin e njohurive. Ai gjithashtu nxjerr në pah përparësitë që ka rritjen e cilësisë në përvetësimin e njohurive. Për shkrimin e artikullit kemi shfrytëzuar një literaturë gjërë bashkëkohore. Në vazhdimësi kemi ndjekur procesin e projektit kërkimor të aplikuar në disa shkolla të qytetit të Elbasanit për qëllime studimore. Nga analiza e procesit rezultoi se kjo strategji ndikoi pozitivisht në përvetësimin dhe zgjerimin e njohurive të reja. Zbatimi u bë mjaft interesant dhe gjithpërfshirës. Nxënësit punuan në mënyrë aktive dhe të pavarur. Si përfundim rekomandojmë përdorimin e kësaj strategjie sidomos në njohjen e historisë së vëndlindjes. Nxënësit jo vetëm do të rrisin cilësinë e nxënies por njëkohësisht do të mësojnë metodologjinë e punës kërkimore shkencore.

Fjalë kyçe: metodologji, projekt, projekt kërkimor, strategji, vëndlindje

1. HYRJE

Qëllimi kryesor i arsimimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsëritin ato që kanë bërë brezat e tjerë –njerëz që janë krijuar, shpikës dhe zbulues. Qëllimi i dytë i arsimimit është të formojë mendje që të mund të jenë kritike, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë do gjë që u jepet (Studio gjithshka, arsyes vëndin e parë.Tiranë,1998).Dikur ishte e mjaftueshme që të nxënët të konsiderohej si trashëgim nga e kaluara. Të nxënët riprodhues, përvetësimi i një mase të dhënë njohurish kulturore, aftësitë e pranuar, pikpamjet, metodat dhe rregullat e përcaktuara ishin të mjaftueshme për t’u orientuar në situatat e njohura dhe të përsëritura. Të mësuarit riprodhues ishte i drejtuar nga një model i përcaktuar i shoqërisë.

Ai ishte një tip i të nxënët që kishte për qëllim të ruante sistemin egzistues dhe të riprodhonte një mënyrë jetese jo të ndryshme. Zhvillonte aftësinë e zgjidhjes së problemeve për një gamë të përcaktuar dhe të njohur problemesh.Të mësuarit riprodhues u përgjigjej nevojave të mbijetesës së individëve dhe dhe shoqërive të të kaluarës. Edhe sot ai vazhdon të jetë i nevojshëm, por ama nuk është i mjaftueshëm.Ajo që nevojitet për mbijetesën në të ardhmen është të mësuarit novator.

Në qoftë se fëmijëve tanë do t’u duhet të përballojnë turbullirat e ndryshimeve si në planin vetjak, ashtu edhe në atë shoqëror, ata kanë nevojë të mësojnë jo vetëm se si të përshtaten në të ardhmen, por edhe si t’i japin formë asaj. Në qoftë se një nga sfidat e arsimimit është përgatitja e fëmijëve për një botë me ndryshim të

shpejtë, atëherë del e qartë nevoja që ata të mësohen të mendojnë në mënyrë krijuese (Studio 1998,f 51). Që nxënësit të mësojnë në mënyrë krijuese duhet që pa tjetër të përfshihen në punë të pavarur.Format e organizimit të punës së pavarur janë të shumta, që nga ato brënda klasës në orën e mësimit, jashtë saj e deri puna e bazuar me projekte (Kuri,Gjini 2008). Mësimdhënia e bazuar në projekte përfaqson një afrim të gjithanshëm drejt një të mësuarit aktiv e bashkëpunues, i cili karakterizohet nga përfshirja e vazhdueshme e nxënësve në kërkimin mësimor (Gjokutaj, Shahini, 2005). Punimet kërkimore janë ajo pjesë e formimit arsimor që zhvillon shprehi dhe aftësi të ndryshme, që nga mbledhja dhe përdorimi i informacionit, deri tek metoda të veanta që mund të përdoren në jetë.Punimet kërkimore janë ushtrime të cilat ndryshe nga ç'mendohet, nuk synojnë t'ua vështirësojnë punën nxënësve, përkundrazi kur ai bëhet me kujdes ka një vlerë shumëdimensionale (Boce,2004).

2. Kuptimi mbi mësimdhënien e bazuar në projekte

Puna me projekte ka si qëllim kompletimin e një detyre.Ajo përfshin në vetvete shumë burime: kohën, njerzit dhe materialet, në të njëjtën kohë praktikon një gamë aftësish e një system gjuhësh.Shëmbuj në këtë drejtim ka shumë: një grup adoleshentësh përfshihen në punën me projekte për prodhimin dhe shpërndarjen e posterave për mjedisin.2-Një grup nxënësish të shkollës Dh.Todri përfshihen në punën me projekte për pastrimin e zonës turistie të Byshekut me qëllim për ta bërë atë sa më tërheqëse për vizitorët.Ky park është mjaft tërheqës dhe ka vlera të pa kthyeshme për natyrën dhe qytetin tonë.

Përgatitja e qytetarëve të shoqërisë demokratike, të cilët mendojnë në mënyrë kritike, të aftë për të zgjidhur probleme, që nga ato në mjedisin më të ngushtë, në atë në nivel local, kombëtar e deri global, janë në vëmendje të procesit të sotëm të edukimit. Suksesi në edukim pa dyshim kërkon një proces mësimor aktiv, të rinovuar në formë dhe përmbajtje, gjë që gjen shprehjen konkrete

në përdorimin e metodave, strategjive e teknikave mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse (Gjokutaj, 2005). Ky process mësimor njëherazi është në koherencë me prirjen e sotme në vëndet e zhvilluara, thelbi i së cilës është: ta shndrojmë klasën auditorin në një mjedis të gjallë, ku, në vend të dhënies së informacionit, kultivohen shprehitë për gjetjen, kërkimin e pavarur të tij, diskutohen çështje në këndvështrime të ndryshme, analizohen ato, identifikohen problemet dhe punohet bashkërisht për zgjidhjen e tyre (Musaj, 2003). Një nga metodat në funksion të këtij qëllimi është pikërisht të mësuarit nëpërmjet projektit kërkimor. Mësimdhënia e bazuar në projektin kërkimor është një model i veprimitarisë mësimore, i cili zhvendoset nga praktikat e mësimdhënies së izoluar brënda klasës e të përqëndruara te mësuesi, në veprimtari të nxëni me në qendër nxënësin.

Këto veprimtari janë afatgjata, ndërdisiplinore dhe të integruara me problemet e rëndësishme të komunitetit dhe praktikat e botës reale. Mësimdhënia e bazuar në projekte kërkimore përfaqëson një afrim të gjithanshëm drejt një të mësuarit aktiv e bashkëpunues, i cili karakterizohet nga përfshirja e vazhdueshme e nxënësve në kërkimin mësimor (Gjokutaj, 2005). Në kontekstin e kësaj mësimdhënieje, nxënësit bashkëpunojnë për t'i dhënë kuptimin dhe përgjigjen e duhur asaj që po ndodh në kërkimin e tyre.

Puna me projekte nënkupton nga ana tjetër pikërisht faktin që temën dhe platformën e paraqet vetë nxënësi si dhe materialin përfundimtar.Në këtë rast padyshim që prania dhe asistenca e mësuesit është e pa diskutueshme, në ndryshim nga essetë apo punët e thjeshta kërkimore. Angazhimi i nxënësve në punët me projekte i lehtëson disi nga ngarkesa që disa mësues shpesh ua japin nxënësve, pa marrë parasysh ngarkesën, moshën, interesat e tyre etj.Në kohën e sotme mësuesit priren gjithnjë e më shumë që në histori në fund të çdo kapitulli të kërkojnë esse apo punë të tjera me shkrim.Natyrisht si pedagogë të metodikës mendojmë që janë ngarkesë dhe jo forma e

vetme për të realizuar programin cilësisht. Esheja apo punët me shkrim kanë dhe ato kufizimet e tyre. Për këtë arsye për të rritur cilësinë e të mësuarit dhe pjesmarrjes së nxënësve në punën kërkimore mendojmë që puna me projekte ka më avantazhe në disa drejtime.

3. Avantazhet e mësimdhënies të bazuar në projekte

Sot në shkollën tonë gjithnjë e më shumë mësuesit kanë tendencën për t'i ngarkuar nxënësit me detyra jashtë klase në lëndën e historinë, ju kërkojnë edhe, detyra kërkimore, mbledhje materiale të ndryshme nga interneti apo burime të tjera. Absolutisht nuk jemi kundër por kur rritet volumi i tyre natyrisht që krijon mbingarkesë për nxënësin duke pasur parasysh të gjitha lëndët. Në këtë kontekst do të mendojta që t'i jepej prioritet të mësuarit me projekte, sidomos në njohjen e historisë të vëndlindjes, trashëgimisë kulturore, resurseve turistike, apo temave të rëndësishme nga historia në të cilat orët e programuara nuk mjaftojnë. Kurrikula e re e përmban punën me projekte madje ze 30% të vlerësimit të përgjithshëm të nxënësit. Të mësuarit në këtë mënyrë ka disa avantazhe të cilat janë:

- 1- Ve në qendër nxënësin
- 2- Jep mundësinë për të nxënë ndërdisciplinor
- 3- Ndhmon një të nxënë të dobishëm nëpërmjet lidhjes së njohurive me jetën jashtë klase e jashtëshkollore, duke iu drejtuar problemeve reale dhe më të rëndësishme
- 4- Jep mundësi reale dhe të pazëvendësueshme në ndërtimin e mardhënieve të shëndosha e korrekte të mësuesve me nxënësit
- 5- Krijon lidhje bashkëpunimi midis mësuesve të profileve të ndryshme
- 6- Krijon lidhje të shëndosha midis shkollës dhe komunitetit
- 7- I angazhon nxënësit në punë të pavarur
- 8- I angazhon dhe i mëson nxënësit në punën kërkimore duke i përgatitur për në universitet dhe më tej
- 9- I përgatit për të shkruarin akademik
- 10- I aftëson për të kërkuar në literaturë dhe jo vetëm gjëra të gatëshme nga interneti

- 11- Aftësohen për të bëtë përzgjedhjen e materialit sipas tematikës
- 12- Ju zgjeron njohuritë e kulturën gjatë kërkimit
- 13- Përmirëson fjalorin e komunikimit të lëndës.
- 14- Puna me projekte siguron shumë mundësi për të krijuar një larmi dëshirash dhe etje për dije e punë
- 15- Nxënësit kanë pavarësi në planifikimin dhe realizimin e punës
- 16- Mësuesi sillet si shofer i cili drejton tek nxënësit etjen për dije e punë

Gjatë zbatimit të kësaj metode nxënësit kërkojnë zgjidhje të problemeve jo të nivelit të zakonshëm:

- 1- duke pyetur dhe riformuluar çështjet për hulumtim
- 2- duke debatuar rreth ideve të ndryshme
- 3- duke bërë parashikime
- 4- duke përvijuar plane
- 5- duke grumbulluar dhe analizuar të dhëna
- 6- duke skicuar përfundime
- 7- duke ua komunikuar idetë dhe gjetjet e tyre pjestarëve të tjerë
- 8- duke shtruar çështje të tjera për hulumtim
- 9- duke krijuar një prodhim të ri të vetin (Gjokutaj 2005)

Dy janë kriteret për fillimin e punës me projekte: **drejtimi dhe mbështetja.**

Të mësuarit me projekte, si rregull ka dy përbërës kryesorë

Një çështje një qëllim ose një problem për ndjekje dhe zgjidhje

Një prodhim të fundmë ose një shumicë paraqitjesh në formën e një serie zgjidhjesh e komunikimesh vetjake (Gjokutaj, 2005).

4. Ecuria metodike e mësimdhënies të bazuar në projekte

Gjatë studimit të kurrikulës dhe në mënyrë të veçantë kur mësuesi përgatit planin vjetor është mirë që të parashikojë dhe realizimin e një pune me project për tematikën që do t'i duket atij më me interes për lëndën dhe grupin. Gjatë vitit shkollor, semestrin e parë ose të dytin mësuesi paraqet idenë e tij në klasë, se ka ndërmend tu

japë nxënësve të zhvillojnë një punë të pavarur për një periudhë të gjatë kohe.

Plani i punës me projekte

a- Informimi mbi projektin

Qëllimi i projektit

Zona ku shtrihet projekti

Bashkëpunuesit (zgjidhen ata që aplikojnë, në rastin konkret nxënësit sipas dëshirës

Tipi kryesor i aktivitetit të projektit

b- Objektivat

Numri i objektiveve

Emërtimi i objektiveve

Përcaktimi i shkronjës për çdo objektiv

Përshkrimi i aktivitetit për çdo objektiv

Koha e përcaktuar

Stafi i aplikantëve

Masat për realizimin e objektiveve

Faza e parë: Parapërgatitja për projektin

Paraqitet projekti që do të ndërmerret

Caktohet koha gjatë të cilës do të realizohet

Hartohen objektivat në të gjitha nivelet

Ndahen grupet dhe detyrat për secilin grup

Përcaktohen mënyrat, mjetet që do të përdoren

Përcaktohen rezultatet e fazës së parë.

Faza e dytë: Puna rreth projektit

Grupet punojnë në mënyrë të pavarur

Grumbullohen materialet nga literatura

Organizohen intervistat me persona të moshave e profesioneve të ndryshme

Sistemohen materialet

Faza e tretë: Shkrimi i materialit

Paraqiten pjesë pjesë materialet

Përgatitet drafti

Diskutohet

Shkruhet materiali përfundimtar

Faza e katërt: Vlerësimi

Bëhet botimi

Vlerësohet puna e secilit grup në vazhdimësi e përfundim

c- Zbatime të mësimdhënies së bazuar në projekte (shëmbuj)

Në lëndën e historisë mendoj se me interes do të jenë tema që lidhen me historinë e vendlindjes, trashëgimisë kulturore të saj, guidat turistike për qytetin, potencialet turistike, etj.

Projekti: *Traditat historike të qytetit të Elbasanit si potencial i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit kulturor.*

Procesi i modelimit

1- Duke kërkuar

2- Duke zgjidhur

3- Duke krijuar

4- Duke shkëmbyer informacion

d- Interpretime rreth temës së projektit

Qyteti i Elbasanit ka një histori të gjatë të krijimit të tij, kalaja e ndërtuar në vitin 1466 është ngritur mbi themelet e një kështjelle më të hershme. Themelimi i qytetit daton në shek III-IV të erës sonë por zbulimet arkeologjike në rrethinat e tij tregojnë për një kulturë të hershme ilire. Që nga kjo periudhë e në vazhdim si një qendër e banuar ky qytet ka bërë histori e cila ka gjurmët e saj. Zhvillimi i tij ka pasur vazhdimësi, qendrueshmëri ndër shekuj dhe ka mbijetuar për shkak të pozicionit të favorshëm gjeografik. I ndodhur në kryqëzimin të rrugëve të rëndësishme në drejtimet Perëndim – Lindje dhe Jug- Veri, i shtrirë në arterien kryesore ballkanike të njohur me emrin “Via Egnatia” pa dyshim që do të bëhej një nga qendrat urbane më të rëndësishme ekonomike dhe sociale.

Elbasani e arriti kulmin e zhvillimit nga shek XVII e deri në gjysmën e dytë të shek. XIX. Në këtë kohë qyteti ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme zejtare. Shumëllojshmëria e prodhimeve është dëshmi e pranisë së një tregu të sigurtë. Brenda qytetit e më gjerë. Prodhime të veçanta të zejtarisë si ai i armëve të zbukuruara apo prodhimeve të argjendarisë kanë qenë të preferuara jo vetëm në Perëndim por deri në Indi e Lindje. Kjo histori dhe gjurmët që janë lënë duhet të evidentohen dhe të rijetëzohen me qëllim që të kthehen në mundësi për të tërhequr sa më shumë vizitorë në qytet. Pra është e nevojshme që ky zhvillim historic të njihet, të evidentohet dhe të kthehet në vlerë për qytetin, pasi kështu dhe e ardhmja është më e mirë.

e- Detyra dhe kërkesa për nxënësit

1- Përpikuni të gjeni materialet që tregojnë për historinë e qytetit tuaj. Këto materialet mund të

jenë nëpër botime të ndryshme, në muzeum, dokumente të vjetra të ruajtura nga paraardhësit tuaj, foto të periudhave të ndryshme.

2- Pyesni të moshuarit për gjëra që mund të mbajnë mend apo kanë lexuar për periudhat e hershme, në lidhje me zhvillimin ekonomik, me zhvillimin urban të qytetit, zakonet, traditat etj.

3-Bëni foto të qytetit tuaj me qëllim që t'i krahasoni me ato të kohëve të kaluara

4-Evidentoni qëndrat historike të qytetit

Motivimi

1-Të njohim vëndlindjen, historine e saj padyshim që është një detyrë e rëndësishme për të gjithë. Përveç fjalëve motivuese në funksion të temës së projektit, jepet një film me pamje nga qyteti në pjesët më të rëndësishme të tij. Këto filmime në pjesën më të madhe të tyre duhet të jenë me pamje nga e kaluara, sigurisht edhe me të sotmet me qëllim që të mund të bëhet krahasimi.

2-Është mirë që vëndin kryesor në këto diapozitivë ta zenë qëndrat historike.

3- Pas çdo pamje të bëhet nga një koment i shkurtër nga nxënësit apo mësuesi kur nuk kanë informacion nxënësit për to.

4-Çfarë vlere historike dhe kulturore kanë këto objekte

5-Rëndësia e rivitalizimit të objekteve historike

6-Historia dhe kultura si mundësi tërheqje për turistët vëndas e të huaj.

f-Ecuria e procesit

Kujdes, Projekti do të planifikohet dhe zhvillohet mbi bazën e njohurive që janë marrë gjatë semestrit. Në se duhet të riformulohet një problem, duhet të sigurohemi që ai i plotëson kriteret e pranuar për një nivel të lartë të mësimdhënies konjitive, që do të thotë, riformulimi duhet të jetë në mënyrë të mjaftueshme i përpiktë.

Nxënësit ndahen në grupe, jepen detyrat dhe problemet për çdo grup. Gjatë muajit të parë nxënësit hulumtojnë për gjetjen e materialeve dokumenteve të ndryshme, në përputhje me problematikën që trajtojnë. Në fund të muajit të parë mbledhen si grup dhe raportojnë për gjetjet, i studiojnë ato ngrenë pikpyetje për dukuri të

ndryshme, diskutojnë me njëri tjetrin. Gjatë këtij momenti këmbëjnë mendime dhe materialet me njëri tjetrin.

Drejtimi i projektit, mësuesit e lëndës, një përfaqësues i komunitetit, një përfaqësues nga nxënësit e klasës. (Trëndafil, karaguni, 2008, f210)

Momenti i dytë ka të bëjë me plotësimin e disa pyetësorëve për probleme të cilat nuk i gjejnë të shkruara. Këta pyetësorë zakonisht bëhen në mosha të mëdha që kanë jetuar herët dhe e njohin të kaluarën e qytetit të tyre në shumë aspekte. Brënda grupit përpunohen të dhënat, bëhet interpretimi i tyre e nxirren konkluzionet. Gjatë kësaj faze ndahen edhe materialet midis pjestarëve të grupit sipas çështjeve me qëllim që të fillojnë të shkruajnë .

Momenti i tretë. Nxënësit pasi kanë bërë përzgjedhjen e materialeve në grup dhe atë që kanë gjetur vetë nisur edhe nga sugjerimet e shokëve e mësueses, fillojnë të shkruajnë, secili për vete. Pasi kanë bërë draftin e parë bashkohen me grupet e tjera diskutojnë për probleme të pa qarta, i korigjojnë për ta paraqitur përfundimisht në grup.

Momenti i katërt

Organizohet një orë mësimi apo mbasdite pune në të cilën paraqitet puna e bërë me projektin për gjatë semestrit. Në këtë paraqitje ftohen nxënës e mësues të tjerë. Paraqitja bëhet e shoqëruar me fletpalosje, diapozitivë, referime të nxënësve.

Vlerësimi

Në fund të këtij seminari po qe se e quajmë të tillë do të bëjmë dhe vlerësimin . Para këtij procesi përcaktojmë treguesit që duhen arritur dhe mënyrat e vlerësimit të punës së nxënësve. Kriteri bazë është punimi më i mirë i cili dallon për vlerë dokumentare, bibliografi të pasur, të dhëna nga burime dytësore, filmime, interpretime dhe ajo që do ta rriste më shumë vlerën e punimit do të ishte aktualizimi dhe vlerësimi për kohën. Nxënësit duhej me argumente të justifikonin punën e breë për disa muaj. Këto ishin kriteri bazë, por padyshim një rëndësi të madhe do i kushtoja edhe aktivizimit

masiv të nxënësve, diskutimeve në grup të secilit prej tyre, paraqitjes së jashtme të punimit.

5. Rezultatet e aplikimit të një projekti në arsimin para universitar

Na ka ndodhur shpesh që kolege të më kërkojnë tu bëj esse apo ndinjë temë për femijët e tyre në histori. Shpesh ua kemi bërë por nuk kanë qenë të pakta rastet kur i kemi refuzuar, pasi kanë dashur angazhim jo vetëm fizik por edhe intelektual. Shoh që mësuesit e kanë bërë modë këtë punë, pra u kërkojnë shpesh punë me shkrim. Natyrisht që personalisht e vlerësojmë por kur kalon masën kthehet në mbingarkesë dhe nuk ka asnjë vlerë pasi nxënësit ose kopjojnë ose ua bëjnë të tjerët. Për të shmangur këto fenomene kemi mendimin që do të ishte e mirë që disa punë me shkrim të zëvendësoheshin me një project. Këtë gjë ua sugjeruam madje e aplikua me bashku me mësuesen, në shkollën Dh.Todri, klasa e 10 b. Temën e planifikuar të njohim vendlindjen, mësuesja propozoi që ta organizonim së bashku në formën e një projekti, brënda simestrit të dytë.

U ndoq procedura metodike si më lart, me të gjithë treguesit e saj. Në fund rezultoi se nxënësit aplikuan të gjithë për të marrë pjesë në grupet e punës. Puna e bërë qe mjaft cilësore. Nuk qe mbingarkesë për nxënësit, koha në dispozicion qe e bollshme për të realizuar punimin. Puna kishte një shtrirje më të gjërë në problematikë, ishte mjaft e larmishme. Gjatë kësaj veprimtarie konstatova se nxënësi punon në grup, zhvillon mjaft aftësi, aftësohet në kërkimin shkencor, debaton, këmben ide, interpreton, shkruan, etj. Për këtë arsye kam mendimin që edhe puna me projekte të fillojë të aplikohet, sidomos në shkollën e mesme.

Më poshtë po japim disa nga rezultatet e punëve të përfunduara në project. Pjesmarrja ishte 100% nga këta 70% u vlerësuan shumë mirë, 20% u vlerësuan mire dhe vetëm 10% u vlerësuan mjaftueshëm. Klasa kishte 35 nxënës. Punët më të mira ishin në grupet me lider, Sara Dervishi, Flavio Poroçani dhe Ardit Banja. Në punët e tyre kishin realizuar objektivat, kishin evidentuar të

gjitha vlerat historike të qytetit të Elbasanit. Dalloheshin jo vetëm për kërkimin por dhe interpretimin e fakteve. Paraqitja grafike ishte mjaft e suksesëshme. Komunikimi i vlerave për auditorin u bë në të gjithë dimensionin e mundshëm. Ata kishin arritur në përfundimin që ky potencial historik dhe kulturor në qytetin e tyre mund të shërbejë për zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Detyra kryesore e mësuesit është të ndërtojë veprimtari mësimore, të cilat të përmbushin arritjen e rezultateve të të nxënësit që parashikohet në objektiva. Një mësues i mirë bën planifikimin e të gjitha aktiviteteve dhe veprimtarive që do të zhvillojë gjatë gjithë vitit. Në këtë planifikim mendoj se duhet të zerë vënd edhe planifikimi i një projekti në histori sidomos tani që orët për vendlindjen janë të integruara në cilindo program studimi. Ky project mund të jetë dhe për një periudhë të gjatë 1- ose 2- vjeçare. Ai duhet të kontrollohet e ndiqet me hapa dhe në secilin të bëhet vlerësimi. Angazhimi i nxënësve në punët me projekte është një veprimtari mjaft e dobishme për disa arsye: a) rrit angazhimin e nxënësve në punën kërkimore; b) aftësohen për punë të pavarur; c) nxit bashkëpunimin në grup; d) veprimtaria shtrihet në një kohë të gjatë; e) nxënësit shkëmbejnë informacion; f) nxënësit aftësohen për të shkruar.

Shumë antropologë kanë nënvizuar rëndësinë e të shkruarit për zhvillimin e arsyes logjike. Shkrimi përveçse është imazh i të folurit, ka lejuar ndërtimin e inventarit grafik dhe leksikut që kanë formësuar saktësinë terminologjike dhe mendimin logjik (J.P.Meunier, D,Peraya, 2009, f. 208). Mësojini nxënësit të punojnë me projekte se kështu do të dinë të projektojnë të ardhmen e tyre dhe te vëndit të tyre.

BIBLIOGRAFI

- B.Musaj, Metodologji e Mësimdhënies, Tiranë 2003
 Q.T.K.A, Mësimdhënia me në qendër nxënësin, Tiranë, 2005

V.Kuri, R.Gjini, Bazat teorike dhe praktikat e të mësuarit të historisë, shblu, Tiranë, 2008

AEDP, Studio gjithshka arsyet vendin e parë, Tiranë, 1998

CDE, Si të shkruajmë një punim kërkimor, Tiranë, 2004

G.Trëndafili, M.Karaguni, Didaktika e gjeografisë, Ideart, 2008

J-P. Meunier, D.Peraya, Hyrje në teorinë e Komunikimit, Q.S.SH.E, Tiranë, 2009

Unicef, Objektivat minimale të domosdoshme për nxënësin, Pegj, Tiranë, 2007

J. Zwiers, Zhvillimii i shprehive të të menduarit në klasat 6-12, CDE, Tiranë, 2005

Temple, Crawford, Saul, Mathews and Makinster, Strategji te mesimdhënie dhe të nxëniet per klasat mendimtare, CDE, Tiranë, 2006

B. Musai, Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues, CDE, Tiranë, 2005.

THE PERCEPTION OF THE CORRUPTION INTO PUBLIC ADMINISTRATION BY THE REPUBLIC OF ALBANIA CITIES' ELECTORATE

PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NGA ELEKTORATI I QYTETEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

ALEKSANDËR KOCANI, DORINA BËRDUFI

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Rr. «Gjon Buzuku», Nr.115, Tiranë, Albania

Email: alkocani@gmail.com

AKTET IV, 4: 610 - 614, 2011

PERMBLEDHJE

Në kuadrin e një studimi panel të zhvilluar në qytetin e Tiranës dhe pothuaj në të gjithë qytetet e vendit, u fokusua vëmendja në perceptimin që ka elektorati i tyre lidhur me problemin e korrupsionit në administratën publike. Si hipotezë e studimit u zgjodh një pohim që lidhte profilin vleror të «mbijetesës» (apo, materialist) me sjelljen e mundshme korruptive të nëpunësve të administratës publike dhe të qytetarëve që u drejttoheshin atyre për të siguruar shërbimet përkatëse. Me që pyetësi, i cili do të siguronte informacionin që do të lejonte testimin empirik të implikimeve të dedukuara nga hipoteza, përmbante shumë pyetje të tipit delikat, u përzgjedh një kampionim me bistak, me strate të papeshuara (në Tiranë) ose të peshuara (në qytetet e tjera), që përmbylej me kuotë sipas grup moshave dhe gjinisë. Kjo përmbylej do të siguronte dhe shkallën e nevojshme të besueshmërisë të të dhënave të mbledhura me pyetësorët.

Fjalët kyçe: Kampionim me kuotë, kampionim me strate të peshuara, kampionim me strate të papeshuara, profil vleror i elektoratit, pyetje delikate.

SUMMARY

In the frame of a panel study carried out in Tirana and almost all the country cities, the survey it was focused on the public administration corruption's perception by the cities electorate. As hypothesis was chose a proposition which related the materialistic value's profile with the potential corruption behavior of the public administration officials and citizens looking for services. Because of the many delicate questions including in the questionnaire, it was decided to frame a sample composed by the clustered, stratified and quota components. In the end it was placed quota by group age and gender in the aim to provide the necessary level of data credibility gathered by questionnaire.

Key words: Quota sampling, pondered stratified sampling, ponderless stratified sampling, electorate value profile, delicate questions.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

A. Konceptimi

Studimi synonte që me një anketim të tipit masiv sasior jo shterues të maste marzhet e korrupsionit në administratën publike sipas perceptimit të elektoratit të një grupi qytetesh kryesore të Republikës së Shqipërisë. Idea

qëndrore e studimit bazohej në shoqërimin kushtëzues që ekziston midis një profili «materialist» («të mbijetesës») të aktorëve socialë dhe shfaqjes nga ata të një sjelljeje korruptive (4). Domethënë, të pritmënisë së shfaqjes së sjelljes korruptive (edhe në mundësi) nga individë që karakterizohen nga një profil

vlëror të tipit «të mbijetesës», apo «materialist» (3). Kjo, mbasi sjellja korruptive bën pjesë logjikisht në sistemin e vlerave që cilësohet si «materialist» apo i «mbijetesës» (7). Këtu kemi konsideruar si premisë të «fshehtë», apo, po të ndjekim terminologjinë e K.Popper (9), si «aksiomë» supozimin se aktorët socialë karakterizohen kryesisht nga një sistem vleror, qoftë ky i tipit «materialist» (i «mbijetesës») apo «post materialist» (i «vet afirmimit»). Pra, që tek çdo aktor social ne kemi detyrimisht një sistem vlerash të lidhura logjikisht që formojnë një profil të caktuar («materialist» ose «post materialist»), ndonëse nuk përjashtohet që ai të shfaqë edhe vlera të veçanta që i përkasin një profili tjetër, në se ndjekim konceptin e G.Bachelor për koplementaritetin e qenies (1). Por, ka edhe autorë, si C.Brooks dhe J.Manza, që pohojnë të kundërtën (8). Përcaktimi ynë mbështetet në rezultatet e një studimi eksperimental i tipit panel, me krahasim «vertikal», apo kohor (të kryer në Departamentin e Shkencave Politike të UT në vitet 2003 dhe 2008), i cili synonte që të hetonte në se aktori social karakterizohej nga një profil vleror apo ai nuk kishte një të tillë (nuk kishte fare profil vleror, ose kishte dy të tilla). Studimi tregoi se më shumë kishte të ngjarë që të vlente modeli i një profili vleror si karakteristikë e sistemit vleror të një aktori social.

Siç u përmend më sipër, si hipotezë e studimit u zgjodh një pohim që lidhte profilin vleror të «mbijetesës» (apo, materialist) me sjelljen e mundshme korruptive të nëpunësve të administratës publike dhe të qytetarëve që u drejtoheshin atyre për të siguruar shërbimet përkatëse (6). Më konkretisht, hipoteza e punës pohonte: «Duke krahasuar sjelljen korruptive të aktorëve socialë në qytete të Republikës së Shqipërisë në vitin 2010, shkalla e kësaj sjelljeje është në përpjestim të drejtë me përvijëzimin e një profili «materialist» (të «mbijetesës») tek ata». Nga kjo hipotezë u deduktuan dy implikime kryesore. Kështu, njëri prej tyre do pohonte se "sa më tepër t'i afrohet profili vleror i një aktori social në qytete të Republikës së Shqipërisë sistemit «materialist» (të «mbijetesës»), aq më shumë ka

të ngjarë që ky aktor të shfaqë sjellje të tipit korruptiv". Kurse i dyti do të pohonte se "sa më shumë t'i afrohet profili vleror i një aktori social në qytete të Republikës së Shqipërisë sistemit «post materialist» (të «vet afirmimit»), aq më pak ka të ngjarë që ky aktor të shfaqë sjellje të tipit korruptiv". Nga këto dy implikime mund të nxirren edhe implikime të tjera. Kështu, ka vend që të pritët të ketë një shoqërim statistikor ndërmjet variablave që i përkasin profilit «materialist» dhe atyre që lidhen me sjelljen korruptive të aktorëve socialë, si dhe të mos ketë shoqërim statistikor ndërmjet variablave (përgjigjeve të pyetjeve) që i përkasin profilit «post materialist» dhe atyre që shprehin sjelljen korruptive. Konstatimi i këtyre rasteve të shoqërimit ose mos shoqërimit statistikor, do të përbënte edhe fokusin e testimit empirik të hipotezës së punës. Kështu që edhe pyetësori do të strukturohej me pikësnyim të testonte këto dy relacione të supozuara nga implikimet e dedukuara logjikisht nga hipoteza e punës.

Pyetësori u ndërtua në mënyrë të tillë që jo vetëm në përgjithësi të testonte empirikisht implikimet e dedukuara nga hipoteza e studimit, por edhe, në veçanti, të maste si në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet e respondentëve lidhur me dukurinë e korrupsionit në administratën publike, ashtu edhe jo drejtpërdrejtë ato që qarkullojnë lidhur me këtë dukuri në mjedisin social të tyre. Në të u përfshinë edhe pyetje të pyetësorëve të ndërtuar për të hetuar posaçërisht korrupsionin në shoqërinë e sotme shqiptare.

Lista e qyteteve ku u shtri studimi nuk doli në bazë të ndonjë skeme statistikore (bistakë, strate etj.), por disi rastësisht. Studimi u nis fillimisht vetëm në qytetin e Tiranës, për arsye se nuk kishte fonde për të planifikuar shtrirjen e tij në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë. Më tej u ofruan, në kohë të ndryshme dhe njeri pas tjetrit, vullnetarisht disertantë të ndryshëm. Kjo shpuri që, de facto, studimi të shtrihej në 18 qytetet kryesore të vendit (përfshirë këtu të gjitha qytetet e mëdhaja dhe të madhësisë së mesme). Në këtë mënyrë, caktimi i listës së qyteteve ku u shtri studimi, ka formën e një

kampionimi komod. Por, me që në këtë listë u përfshinë gadi shumica dërmuese e qyteteve të vendit, mund të konsiderohet ky kampionim i qyteteve si komod i përmirsuar deri në atë shkallë, sa që të mund të quhet i pranueshëm me kriteret shkencore të kampionimeve. Brenda qyteteve u procedua si vijon. Në qytetin e Tiranës u përdor një kampionim i kombinuar i strateve sipas zonave elektorale, me bistakë brenda secilës zonë sipas rrugëve (zgjedhje e rastit e një rruge bazë dhe dy rrugëve si rezervë e parë dhe e dytë). Brenda secilës rrugë të zgjedhur, në bazë të tabelës së numrave të rastit, **nuk** u procedua me kampionim sistematik të tipit *'nga porta në portë'* në bazë të një hapi të përcaktuar në rrugë empirike. Kjo sepse u konsiderua se pyetëtori kishte një numur të konsiderueshëm të pyetjeve që klasifikohen në kategorinë e pyetjeve delikate. Në raste të tilla, siç sugjeron edhe teoria e metodave të kërkimit, lipset të bëhet çmos që të sigurohet anonimati i respondentëve. Në librat e metodave të kërkimit (2) rekomandohet që, në mos anonimati, të paktën të sigurohet konfidencialiteti, por kjo kërkesë për shkallën e lartë të mosbesimit (prill 2009 – 61%) që shfaq elektorati shqiptar, nuk lejon sigurimin e një niveli të pranueshëm të besueshmërisë dhe vefshmërisë së rezultateve të matjeve. Prandaj në terrenin shqiptar, mendojmë se lipset të kërkohet vetëm anonimati dhe jo të zëvendësohet ai me konfidencialitetin e intervistës. Dhe ky anonimat, në kushtet e vendit tonë, sigurohet në qoftë se në hallkën e fundit të kampionimit përmbyllja bëhet me kampionim që nuk e identifikon respondentin, domethënë, me kampionim me kuotë (sipas grup moshave dhe gjinisë). Kështu edhe u veprua.

Si madhësi e kampionimit për qytetin e Tiranës u caktua masa prej 330 njësive të analizës nga popullata e elektoratit të këtij qyteti. Një madhësi e tillë e kampionimit dilte e përshtatshme si për objektivat dhe kërkesat e studimit, ashtu edhe për përmasat e popullatës teorike në studim. Me që kërkohej të matej niveli i perceptimit të korrupsionit dhe jo vetë kjo dukuri, binte disi kërkesa për saktësi të madhe të matjeve, gjë që lejonte të operohej jo me vlera mbi mesataren e

madhësisë së kampionimit të duhur për një qytet si Tirana.

B.Procedimet praktike

Në bazë të pyetjes kërkimore u hartua hipoteza e punës si përgjigje e supozuar e saj. Nga hipoteza u deduktuan implikimet përkatëse dhe prej tyre u identifikuan indikatorët e informacionit që do të realizonte testin empirik. Në përputhje me këto indikatorë u skicua drafti i pyetësorit, ndonëse në të u përfshinë (ndonjëherë edhe jo me shumë kujdes!) edhe pyetje të huazuara nga pyetësorë të tjerë. Kështu u huazuan disa pyetje që, në vetvete hetonin mjaft mirë dukurinë e korrupsionit, por (siç doli nga përpunimi i të dhënave të furnizuara nga ato) që nuk mund të përdroreshin lehtësisht për të testuar empirikisht implikimet e hipotezës së punës.

U freskua informacioni i të dhënave lidhur me elektoratin e Tiranës dhe, në përputhje me të, u skicuan kampionimet për 11 zonat elektorale të qytetit të Tiranës.

Në bazë të një plani kalendarik u realizuan intervistimet në terren nga dy zona elektorale në ditë, duke monitoruar secilën zonë me një grup prej 5 mbikqyrësish. Intervistimet u realizuan në harkun kohor të 7 ditëve, një kohë relativisht tepër e shkurtër për to, që e bën atë jo faktor ndikues në studim. Domethënë, që minimizon relativisht tepër ndikimet të cilat lidhen me ndryshimet në kohë të opinionëve të respondentëve. Me që koha ishte e shkurtër dhe, me që gjatë këtyre 7 ditëve nuk pati ndonjë ngjarje, e cila do të kishte peshë ndikuese në opinionet e elektoratit të qytetit të Tiranës, është e logjikshme të supozohet që faktori kohë nuk ishte i pranishëm në kuadrin e studimit tonë. Më tej u realizua hedhja e të dhënave nga studentët intervistues nën mbikqyrjen e grupit monitorues.

Mbasi u përgatit baza e të dhënave në excel për përpunim të mëtejshëm (korrigjimi i gabimeve dhe krijimi i variablave të reduktuar), ajo u thirr nga një program SPSS.16 dhe u krijua baza përkatëse për përpunimin e specializuar statistikor.

Synimi kryesor i përpunimit ishte të vlej informacioni që do të testonte empirikisht dy implikimet bazë të deduktuar nga hipoteza e punës dhe që do të lejonin praktikisht të vlerësonim empirikisht pranueshmërinë ose jo të kësaj hipoteze. Implikimi **i parë** pohonte se sa më shumë i spikatur të ishte profili materialist i aktorëve socialë në qytetin "X", aq më e lartë do të ishte shkalla e shfaqjes së sjelljes korruptive që tregonin ata. Implikimi **i dytë** theksonte se sa më shumë i spikatur të ishte profili postmaterialist i aktorëve socialë në qytetin "X", aq më e ulët do të ishte shkalla e shfaqjes së sjelljes korruptive që tregonin ata.

Për të testuar empirikisht implikimin e parë, u zgjodhën për anketimin e zhvilluar në qytetin e Tiranës (që përbënte edhe anketimin bazë për studimin), **33** çifte të variablave që paraqesin njëri tiparet e profilit materialist dhe tjetri ose tipare të tjera të këtij profile ose tipare të sjelljes korruptive. Synimi ishte që të hetohej në se ndërmjet këtyre çifteve të variablave kishte apo jo shoqërim statistikor dhe, a ishte ky shoqërim statistikisht domethënës. Për këtë qëllim u përdorën si instrumenta matës kryesisht tabelat e kryqëzuara (ose edhe ato të krahasimit të mesatareve).

Për të testuar empirikisht implikimin e dytë, u zgjodhën **30** çifte të variablave sipas të njëjtit kriter me atë të testimit të implikimit të parë. Pritmënia në këtë rast ishte që të konstatohej mungesë e shoqërimit statistikor ose, të paktën, jo shoqërim statistikisht domethënës ndërmjet çifteve të variablave të përzgjedhur.

REZULTATET

Nga shqyrtimi i tabelave të kryqëzuara që testonin empirikisht implikimin e parë (për anketimin e zhvilluar në qytetin e Tiranës), del se **27** nga **33** kombinime (**81.82%**) prej tyre **dëshmojnë** për shoqërim statistikor domethënës. Kjo do të thotë se ***mund të konsiderohet*** se ato e vërtetojnë empirikisht implikimin e parë.

Nga shqyrtimi i tabelave të kryqëzuara që testonin empirikisht implikimin e dytë, del se **25** nga **30** kombinime (**83.33%**) prej tyre **dëshmojnë** për shoqërim statistikor domethënës.

Kjo do të thotë se ***mund të konsiderohet*** se ato e vërtetojnë empirikisht implikimin e dytë.

Si përfundim, mund të thuhet se ***testi empirik ka më shumë të ngjarë të ketë konfirmuar hipotezën bazë të punës***, duke i dhënë kështu një përgjigje pyetjes se përse kemi shkallën e vëzhguar të sjelljes korruptive të aktorëve socialë në qytetin e Tiranës.

Idea e përsëritjes së testit empirik të hipotezës së punës në 17 qytete të tjera më të rëndësishme të vendit lidhet me qasjen epistemologjike të kontrollit të pranueshmërisë së hipotezës së punës nëpërmjet konfirmimeve cilësore që sjellin implikimet e ndryshme të inferuara nga hipoteza, të cilat provohen nga testi empirik. Si faktor të ndryshimit u muarr ai hapësinor, domethënë, ndryshimi i vendit të testimit të hipotezës. Kjo, në rast të konfirmimit të implikimeve do të përbënte një përfundim mjaft cilësor të hipotezës nga poshtë, sipas konceptit të epistemologut Karl Hempel (5). Rezultatet e anketimeve në 17 qytetet e përmendura vërtetojnë empirikisht implikimet përkatëse dhe në këtë mënyrë konfirmojnë hipotezën e punës. Me që implikimet e testuara në rrethet e tjera janë disi të ndryshme nga ato të testuara në Tiranë dhe përsëritja e testit empirik nuk bëhet në të njëjtin vend, pranohet që konfirmimi i tyre ***e përforcon në mënyrë cilësore*** hipotezën e punës. Ky ishte qëllimi i përfshirjes së tyre si formë kontrolli për testimin empirik të hipotezës në qytetin e Tiranës.

LITERATURA

1. Bachelard, G. (1963) *Le Nouvel Esprit Scientifique*, P.U.F., Paris;
2. Bernstein, R.A., Dyer, J.A., *An introduction to Political Science Methods*, Prentice Hall Englewood Cliffs: New Jersey;
3. Dossier (juin 1997) *De la modernité à la postmodernité*, Sciences Humaines, n°73;
4. Fuga, A., Kocani, A., Sinani, Gj. (1999) *Shqipëria në tranzicion dhe vlerat*, SOROS, Tiranë;
5. Hempel, C. (1972) *Éléments d'Épistémologie*, A.Colin
6. Inglehart, R., Baker, Wayne E., (2000), *Modernization, Cultural Change, and the*

Persistence of Traditional Values American Sociological Review, Vol.65 (February);

7. Inglehart, R. (2000) Globalization and Postmodern Values, Washington Quarterly 23.1;

8. Lecomte, J. (1998) Raisons de vivre. Raisons d'agir, Sciences Humaines, N° 79.

9. Popper, K.R. (1982) La logique de la découverte scientifique, Payot..

PËRCAKTIMI I CAKUT TË GABIMIT QË FUT KUOTA NË HALLKËN E FUNDIT TË KAMPIONIMIT TË NJË ANKETIMI KUNDREJT KAMPIONIMIT SISTEMATIK

ALEKSANDËR KOCANI, ELUIZA DASHO

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Albania
alkocani@gmail.com

AKTET IV, 4: 615 - 618, 2011

PERMBLEDHJE

Në një eksperiment social të zhvilluar një vit më parë, u synua që të përcaktoheshin marzhet e gabimit që fut kampionimi sistematik në hallkën e fundit në një anketim për probleme delikate si rezultat i mos sigurimit të anonimatit të respondentëve. Krahasimi bëhej ndërmjet dy anketimeve me të njëjtin pyetësor (ku kishte pyetje delikate), në të njëjtën kohë dhe vend, me ndryshimin se, në hallkën e fundit njëri realizonte intervistat bazuar në kuotat (gjini, grupmosha), kurse tjetri përdorte përzgjedhjen sistematike me hap (nga porta në portë). Marzhi i përcaktuar në këtë rast përfshinte edhe atë që sillte përdorimi i kuotës. Për këtë arsye këtë vit u ndërtua një eksperiment, ku me pyetësor (me pyetje jo delikate) të njëjtë, në të njëjtin vend e kohë, do të intervistoheshin dy palë votues të qytetit të Tiranës. U synua që i vetmi dallim të qëndronte në hallkën e fundit të kampionimit, në njerin me kuotë, në tjetrin me skemë sistematike. Pritej që dallimet në përgjigjet të kushtëzoheshin kryesisht nga ky dallim. Diferencat e tyre do të përbënin marzhin e kërkuar.

SUMMARY

In a social experiment carried out the last year, it is aimed to design the error margins put by a systematic sample in its last step for a survey about subtle problems as an effect of non providing the being anonymous of all respondents. A comparison between two surveys is made providing the same questionnaire (with delicate questions) in the same place and time. The only difference was in the last step of the sample: one of the surveys has made the interviews based on the quota (gender, group age), whereas the other has used the systematic schema (with step – door by door). The margin decided by this way included also the one produced by the use of the quota. This was the reason for the implementation this year of an experiment seeking the interviews of two groups of respondents belonging to the Tirana electorate, by using the same questionnaire (without delicate questions), in the same place and time. The principal aim was to provide only one difference in the last steps of the sample: on one side, the sample closed up by quota, on the other side, utilisation of the systematic schema. The expectation was a determination of differences between answers by this distinction.

Në një eksperiment social të zhvilluar një vit më parë, u synua që të përcaktoheshin marzhet e gabimit që fut kampionimi sistematik në hallkën e fundit në një anketim për probleme delikate si rezultat i mos sigurimit të anonimatit të respondentëve (4). Krahasimi bëhej ndërmjet dy anketimeve me të njëjtin pyetësor, në të njëjtën kohë dhe vend, me ndryshimin se, në hallkën e fundit njëri realizonte intervistat bazuar në kuotat (gjini, grup mosha), kurse tjetri përdorte përzgjedhjen sistematike me hap (nga porta në

portë). Marzhi i përcaktuar në këtë rast përfshinte gabimin statistikor që fuste kampionimi sistematik dhe atë që sillte përdorimi i kuotës.

Për këtë arsye këtë vit u ndërtua një eksperiment, ku me pyetësorë (*me pyetje jo delikate*) të njëjtë, në të njëjtin vend e kohë, do të intervistoheshin dy palë votues të qytetit të Tiranës. U synua që i vetmi dallim të qëndronte në hallkën e fundit të kampionimit, në njerin me kuotë, në tjetrin me skemë sistematike. Pritej që dallimet në përgjigjet të kushtëzoheshin kryesisht nga ky dallim.

Diferencat e tyre do të përbënin marzhin e kërkuar plus gabimin statistikor që fut kampionimi sistematik i përfshirë në eksperiment.

Prandaj në matjet e marzhit të gabimit që fut injorimi i anonimatit të respondentëve në anketim, krahas gabimit që fut kampionimi sistematik (i cili jepet nga kurba përkatëse që lidh madhësinë e këtij gabimi me atë të kampionimit sistematik) (1), përfshihet edhe gabimi që fut kuota, i cili është i papërcaktuar sepse nuk është statistikor. Lipset që ky gabim të llogaritet apo matet me një procedurë të posaçme (ad hoc). Në këtë mënyrë vihet realisht tek marzhi i gabimit që fut mos konsiderimi i anonimatit të respondentëve gjatë anketimit.

Për të kontrolluar (Ky kontroll, sipas konceptit të K.Hempel (2)), do të synonte përforcimin cilësisht më të madh të hipotezës së punës në rast të vërtetimit të implikimeve të testuara empirikisht), rezultatet e eksperimentit të zhvilluar këtë vit me elektoratin e qytetit të Tiranës, u mendua që të zhvillohej paralelisht i njëjti eksperiment edhe në 11 qytete të tjera kryesore të vendit. Natyrisht që në këto qytete u përdor një kampionim më i vogël, 50 dhe 100 njësi, në varësi të madhësisë së qytetit dhe me logjikën e strateve të peshuara. Në Tiranë u përdor një kampionim prej 330 njësisish sipas strateve të pa peshuara.

Si instrument matës u përdor një pyetësor që maste profilin vleror të respondentëve. Kjo për arsye se një instrument i tillë ishte testuar në shumë anketime dhe ishte mjet matës i besueshëm dhe i vlefshëm. (Për më tepër shih artikullin për profilin vleror të elektoratit të qytetit të Tiranës (3)). Në kushtet kur eksperimenti do të zhvillohej me dy anketime, ku njëri do të mblidhte përgjigjet e respondentëve të përcaktuar me kuota (që ishin të pa identifikueshëm), kurse tjetri do të hetonte opinionet e respondentëve të përzgjedhur me një skemë rastësore sistematike të tipit «nga porta në portë» (i cila nuk e përjashtonte mundësinë e identifikueshmërisë për respondentët) (për më tepër shih artikullin për këtë problem (4)), ishte e nevojshme që të bëhej çmos të shmangeshin faktorë të tjerë të mundshëm ndikues. Kështu, për të mbajtur si

faktor të vetëm ndryshimin në hallkën e fundit të kampionimit, në pyetësorin e përdorur që maste profilin vleror të respondentëve, u shmangën pyetjet e konsideruara si delikate. Prandaj, një zgjedhje e tillë metodologjike shërbente për të shmangur ndikimin që mund të jepte bërja e pyetjeve të tilla në kushtet kur respondentët e perceptonin veten si të identifikueshëm, pra edhe si të kërcënuar potencialisht, gjë që rekomandohet edhe nga literatura për metodat e kërkimit (1).

Synimi metodologjik ishte që të konstatoheshin diferenca të mundshme në përgjigjet ndërmjet pyetjeve të njëjta të bëra sipas dy kampionimeve që dallonin vetëm në hallkën e fundit: njëri sipas përzgjedhjes sistematike (nga porta në portë), kurse tjetri sipas kuotës (me grup moshe dhe gjini). Për të bërë të mundur përdorimin e SPSS për matjen e diferencave të synuara, në bazën e të dhënave u vendosën përgjigjet ndaj anketimit të zhvilluar në rrugë në vijim horizontal (jo vertikal!) të përgjigjeve nga anketimi i zhvilluar me mënyrën sistematike në hallkën e fundit të kampionimit. Pra, si të thuash, u «ngjitën» bazat në drejtim horizontal dhe jo vertikal. Kështu që baza e krijuar kishte 330 rrjeshta (numri i regjistrimeve, apo i respondentëve në secilin anketim) dhe dyfishin e kollonave që duhej për njërin nga anketimet.

Një gjetje e tillë lejonte që, nëpërmjet krahasimit të mesatareve në tabelat e frekuencave, të krijoheshin tabela me diferencat sipas pyetjeve homologe (të zhfrytëzuara me kampionim kuota dhe sistematik). Zgjedhja e mesatareve si instrument për të matur diferencat në përgjigjet sipas dy tipeve të kampionimit përbënte një gjetje tjetër. U vendos kështu, sepse në statistikë mesataret konsiderohen si më përfaqësuese për shpërndarjet e vlerave që i afrohen shpërndarjes normale. Pra, çdo vlerë mesatare për çdo variabël përfaqësonte më mirë 330 vlerat e ndryshme të tij. Kështu që u bë praktikisht më e mundur të krahasoheshin diferencat ndërmjet vlerave të variablave analogë (domethënë, përgjigjeve ndaj pyetjeve të njëjta, por të bëra sipas dy kampionimeve të përmendura) nëpërmjet krahasimit (diferencës algjebrike) të vlerave

mesatare përkatëse. Diferencat e gjetura u renditën në linjën algjebrike nga vlerat më të vogla në ato më të mëdha. Në bazë të kësaj renditjeje u formua një interval me vlerën minimale dhe atë maksimale. Intervali i dalë nga anketimet në qytetin e Tiranës është nga minimumi prej **-0.34%** deri në maksimumin prej **+228%**. Ndërmjet tyre ndodhen **40** diferenca negative, **72** diferenca pozitive dhe **3** diferenca 0. Me që kemi relativisht shumë diferenca pozitive dhe negative dhe ato lidhen me pyetje të ndryshme, të cilat në intervistat mund të mos kenë patur të njëjtën shkallë kuptimi të drejtë, atëherë nga pikëpamja statistikore më e drejtë do të ishte që të gjenim mesataren e diferencave pozitive dhe atë të diferencave negative. Kjo sepse secili varg i diferencave përbën një farë shpërndarje vlerash dhe statistikisht një shpërndarje, në përgjithësi, e përfaqëson apo e shpreh më mirë, një mesatare e vlerave të vargut. Për më tepër në metodikat e matjeve të madhësive të ndryshme fizike, theksohet se vlera e madhësisë së kërkuar matet disa herë dhe më tej nxirret mesatarja e tyre, me që në çdo matje ndërhyt ai që quhet gabim i matjes (apo i aparaturës matëse). Vlera e kërkuar do të jetë në intervalin që krijohet nga zbritja e gabimit të matjes nga kjo vlerë mesatare (kufiri i poshtëm) dhe nga shtimi i këtij gabimi të matjes ndaj mesatares (kufiri i sipërm). Kjo është arsyeja që u zgjodh që në vend të dy vargjeve, ose të dy kufizave skajore të tyre, të merren për të shprehur intervalin e kërkuar mesataret e vlerave të këtyre dy vargjeve. Mesatarja e vlerave (diferencave) negative do të na japë kufirin e poshtëm të intervalit, kurse mesatarja e diferencave pozitive – atë të sipërm.

Me këto dy mesatare mund të formojmë një interval diferencash që statistikisht e përfaqësojnë më drejtë marzhin e diferencave që kërkojmë. Nga kryerja e veprimeve të mesatarizimit të përmendur del se ky marzh në fjalë është **(-10.1%, +23.6%)**. Ky interval ende nuk përbën marzhin e gabimit që fut kuota në hallkën e fundit të një kampionimi. Kjo sepse në të përfshihet edhe gabimi statistikor që sjell përzgjedhja sistematike në hallkën e fundit të kampionimit. Madhësia e

këtij të fundit varet nga madhësia e kampionimit dhe gjendet nga kurba e gabimit. Për madhësinë prej **330** njësisish që përbën kampionimin e Tiranës, gabimi statistikor përkatës është në kuotën e \pm **4.25% (-4.25%, +4.25%)** (). Vlerën negative të këtij gabimi statistikor ia heqim kufirit të poshtëm të diferencave të lartpërmendura (me që duam të «presim» pjesën e gabimit që fut kampionimi sistematik), që do të thotë, ia shtojmë në vlerë algjebrike ("-" heqim "-", kthehet në "+": **-10.1% - [-4.25%] = -5.85%**). Kemi pra, vlerën prej **-5.85%** si kufi të poshtëm të marzhit të kërkuar të gabimit që fut kuota në hallkën e fundit të kampionimit. Kurse kufirit të sipërm të mesatareve të diferencave i heqim gabimin statistikor që fut kampionimi sistematik dhe kemi për kufirin e sipërm të marzhit të gabimit të kërkuar, vlerën prej **+19.35% (+23.6% - 4.25% = +19.35%)**. Kështu që marzhi i kërkuar i gabimit jepet nga intervali **(-5.85%, +19.35%)**.

Intervali brenda së cilit ndodhet vlera e «saktë» ka madhësinë e afro **25%** (nga **-5.85%** deri në **+19.35%**). Në se i kthehemi matjeve të bëra vitin që shkoi, lidhur me gabimin që fut në matje moskonsiderimi i anonimatit të respondentëve (kur ka pyetje delikate), madhësia e tyre bruto u përcaktua në marzhet prej **15% - 26%**. Këtij marzhi ne lipset t'i heqim pjesën që ka lidhje me gabimin që sjell kampionimi me kuotë dhe do të kemi : 1) *rasti minimal* – $[-15% - (-5.85%), +15% - 19.35%] = (-9.15%, -4.35%)$. Ose ndryshe, **(-9.15%, -4.35%)**; 2) *rasti maksimal* – $[-26% - (-5.85%), +26% - 19.35%] = (-20.15%, +6.65%)$.

Natyrisht që këto marzhe nuk janë më të mirat e mundshme, sepse janë rezultat, si të thuash, i 'përpunimit në dorën e parë'. Dhe, për rrjedhojë, si të tilla, ato reflektojnë gabimet e bëra gjatë procesit të matjes. Lipset që të hetohet ku dhe sa është gabuar gjatë eksperimentit për të bërë të mundur që të saktësohet më tej marzhi i gabimit të kërkuar. Kjo do të përbënte edhe një sendërtim të filozofisë poperiane se «ne mësojmë më shumë nga gabimet» (5). Me që një reflektim i thellë do të kërkonte më shumë kohë, ai është menduar të bëhet gjatë vitit në vazhdim. Por, disa linja të përgjithshme ku mund të jetë gabuar dhe ku lipset të bëhen rregullime për të rritur shkallën e

saktësisë në eksperiment, mund të jepen që tani. Kështu, mbetet problematik angazhimi i një numri relativisht të madh intervistuesish (rreth 80), gjë që e ul cilësinë e matjeve të bëra me anketim. Po ashtu, mund të 'krihen' më mirë zonat e anketimit nëpërmjet përzgjedhjes së tyre në mënyrë që të rritet më tej besueshmëria e rezultateve të matjeve. Ka vend edhe për përmirësim të mëtejshëm të instrumentit matës (pyetësorit) me anë të pre-testimit të tij.

Një nga arsytet madhore, që kushtëzon një pjesë të konsiderueshme të gabimeve të bëra në procesin e eksperimentimit, është mungesa e financimit. Ai ka çuar në atë që procesi i anketimit të jetë i dyfishtë: t'i shërbejë edhe eksperimentit dhe testimit të një hipoteze tjetër studimore që të justifikohen edhe objektivat metodiko-mësimore. Kjo ka shtuar artificialisht sa numrin e intervistuesve, aq edhe të zonave, si dhe ka kërkuar një pyetësor jo shumë të specializuar, në mënyrë që të testojë edhe hipotezën studimore jashtë objektivave të eksperimentit. Në këtë mënyrë prishen parametrat optimale të një kërkimi të mirëfilltë eksperimental. Këtu vlen të theksohet se paradoksi është që mjete financiare në UT ka, por njëkohësisht ato janë të pa disponueshme !

Siç u përmend në fillim, testimi i hipotezës në 11 qytete të tjera veç Tiranës, më tepër synonte që të përforconte idenë e hipotezës se ka diferenca në përgjigjet ndaj të njëjtave pyetje kur ato realizohen me kampionim kuotë ndaj atyre që realizohen me kampionim sistematik («nga porta në portë»). Me që kampionimet e caktuara në

këto qytete ishin të paktën tre herë më të vogla nga ai i përdorur për qytetin e Tiranës, pritej që gabimi statistikor që fuste madhësia e kampionimit në anketim me metodë sistematike do të ishte ndjeshëm më i madh së ai i përfutur nga anketimi në qytetin e Tiranës. Prandaj, që në fillim nuk u shpresua një përforsim i mundshëm i vlerave të marzhit të gabimit të synuar nga eksperimenti, por një **përforcim cilësor** të idesë se ekziston një diferencë në përgjigje kur kalohet nga kampionimi sistematik në atë me kuota. Dhe këtë «mision» anketimet në rrethe e kryen më së miri. Ato konfirmuan në mënyrë mëse bindëse për ekzistencën e diferencës së supozuar në hipotezën e punës.

LITERATURA

1. Bernstein, R.A., Dyer, J.A., An introduction to Political Science Methods, Prentice Hall Englewood Cliffs: New Jersey;
2. Hempel, C. (1972) Eléments d'Epistémologie, A.Colin
3. Kocani, A.(2008) Cili është profili vleror i popullatës së Tiranës? Revista Pedagogjike, Nr.5;
4. Kocani, A., Derhemi (Bitri), B. (2010) Një qasje metodologjike: gabimi në matje në anketim kur nuk merret në konsideratë ndryshimi i mjedisit socio-politik (rasti i sondazheve Zogby në Shqipëri), AKTET Revistë shkencore e Institutit Alb-shkenca, Vol III, Nr.4.
5. Popper, K. (1982) La logique de la découverte scientifique, Payot.

ADMINISTRATA PUBLIKE DREJT HAPËSIRAVE EUROPIANE

MARJANA LAKO

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shqipëri

Email: marjana.lako@mash.gov.al

AKTET IV, 4: 619 - 623, 2011

PERMBLEDHJE

Në këtë punim bëhen përpjekje për të paraqitur dhe diskutuar disa probleme dhe shqetësime të elementëve të kulturës së organizatës duke e konsideruar këtë të fundit –administratë publike. Suksesi i një organizate është i ndërruar edhe nga kultura organizative. Kultura përfaqëson bashkësinë e vlerave të një organizate që i ndihmon anëtarët e saj të kuptojnë se çfarë përfaqëson organizata, si i bën punët dhe çfarë konsideron të rëndësishme ajo. Në pamje të parë kultura paraqitet si një nocion që ndofta mund të quhet edhe amorf, por që sfidon matjen ose vëzhgimin objektiv të veprimtarisë. Ajo mund të përcaktohet si filozofi, vlera, qëndrime dhe norma të organizatës. Nga vetë përmbajtja kuptohet që është pikërisht kultura e organizatës që e mban atë të bashkuar. Detyrimi për të respektuar normat e kulturës organizative në punën e gjithsecilit përfshin gjithë shumën e detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës.

Fjalë kyçe: kulturë organizative, ideologji organizative, mision, norma kulturore

SUMMARY

This paper presents and analyses several topics and issues regarding the elements of culture of organization in terms of current public-administration concepts. The success of an organization depends on the organizational culture. Culture represents the values of a community involved in the organization and helps its members to understand what does the organization represents, At first glance culture appears as a notion that perhaps could be called as amorphous one, but when it is viewed closer it challenges the ways one uses to measure or monitor the organization's objectives and activities. In brief, it can be defined as the philosophy, values, sentiments and norms on which organizations functions. From the course content it is exactly the culture of the organization that holds it together. The obligation of everyone to respect the norms of organizational culture within the work environments is considered as part of all obligations related to employment obligations.

Key words: organizational culture, organizational ideology, mission, cultural norms.

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i problemeve të ndeshura në zgjedhjen e personelit në Administratën Publike dhe përcaktimi i mundësive për mënjanimin e mangësive të evidentuara. Në funksion të këtij qëllimi synohet t'u jepet zgjidhje dhe problemeve që përbëjnë objektiva të tjerë:

- Të krijojë një pamje të plotë të zgjedhjes së personelit aktualisht
- Të evidentojë mangësitë e ndeshura në këtë mënyrë zgjedhje

- Të evidentojë disa disa mundësi dhe preferenca në lidhje me zgjedhjen e personelit nga këndvështrimi i punonjësve të Administratës Publike.

Ndryshimet e sistemit politik dhe atij ekonomik të fund shekullit të kaluar, u shoqëruan midis të tjerash dhe me ndryshime të pozicioneve dhe raporteve të vendeve të Evropës Lindore, në mes tyre dhe Shqipërisë, drejt integritetit europian, i cili është një proces i gjatë dhe i shoqëruar me një sërë sfidash, që kushtëzohen dhe nga e kaluara e secilit vend.

Integrimi europian, shfaq elementë të paparashikuar në mënyrën e funksionimit të institucioneve në të gjithë dimensionet e këtij funksionimi, të cilat në mënyrë të pashmangshme fokusojnë cilësinë e burimeve njerëzore dhe konkretisht, të administratës publike.

Impaktet integruese të Administratës Publike, janë të përmasave sasiore dhe cilësore, të cilat kërkojnë zgjidhje konceptuale dhe funksionale. Zgjidhjet konceptuale synojnë krijimin e tipareve të reja të Administratës Publike, ku të harmonizohen tiparet europiane të saj me specifikat kombëtare të vendit.

Disponimi i Burimeve njerëzore në Administratën Publike ka të bëjë me parametra sasiore dhe cilësore, të cilat bëjnë të domosdoshme sigurimin e Burimeve Njerëzore me karakteristika profesionale dhe etike të evidentueshme, gjë e cila duhet të fillojë që me zgjedhjen e personelit. Gjetja dhe përdorimi racional i Burimeve Njerëzore në Administratën Publike si dhe në çdo organizatë tjetër ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë dhe në të ardhmen një pikë kritike për suksesin e tyre.

Konceptet e reja mbi cilësinë dhe mënyrën e funksionimit të Administratës Publike, që synojnë formimin e një formati kreativ pune, janë një sfidë që ndërthur probleme të ndryshme në kulturën e vetë Administratës Publike dhe të mjedisit të saj. Proceset integruese sjellin transformime të detyrueshme në kulturë dhe psikologjinë e punës në Administratën Publike.

Administrata publike shqiptare, me ndryshimet e fund shekullit të kaluar hyri në një fazë të re, të ndryshme dhe të pakrahasueshme me mënyrën e mëparshme të funksionimit. Këto ndryshime fokusonin më tepër ndryshimet konceptuale të mënyrës së funksionimit dhe atë aplikative, se sa ndryshimet numerike.

Funksionimi sa më efikas i Administratës Publike, plotësimi i qëllimeve të saj, është i lidhur me dy probleme:

1. Disponimin e domosdoshëm të Burimeve Njerëzore

2. Përdorimin racional të tyre

Burimet njerëzore përfshijnë individë me njohuri, aftësi dhe zotësi të ndryshme, të cilët janë

formuar në mjedise materiale, njerëzore dhe kulturore të ndryshme. Janë pikërisht këta individë që do të bëjnë të mundur realizimin e objektivave të organizatës ku ata punojnë.

Niveli i realizimit të këtyre objektivave, pa folur këtu për burimet fizike dhe financiare të organizatës, duke u fokusuar tek Burimet Njerëzore do të kushtëzohet nga këta faktorë:

- Pajisja me personelin e nevojshëm, në sasi dhe aftësi profesionale
- Trajnimi i personelit
- Programet e shpërblyerimit dhe Performimi
- Aftësitë drejtuese për të krijuar një ambient performues për Burimet Njerëzore

Të gjitha këto, për shumë dekada janë trajtuar si funksione të menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto të fundit në institucione publike përfaqësohen nga Administrata Publike.

Realizimi i këtyre funksioneve merr rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për Administratën Publike, e cila projekton politika makroekonomike dhe përgatit kushtet për vënien në zbatim të këtyre politikave, me objektiv kryesor: **zhvillimin ekonomik dhe social të vendit**. Ky përbën një angazhim sa delikat aq dhe vizionar, çka e vendos Administratën Publike, funksionet dhe modernizimin e saj në qendër të studimeve që janë ndërmarrë dhe do të ndërmerren në të ardhmen.

Analiza e funksioneve të mësipërme për mirëfunksionimin e Administratës Publike përbën një angazhim të përmasave të mëdha që kalon limitet e një prezantimi. Prandaj në këtë punim do të trajtohen vetëm aspekte të këtyre funksioneve dhe konkretisht:

- Probleme të aftësive profesionale të Administratës Publike
- Aspekte të programeve që nxisin kreativitetin e Administratës Publike, si në këndvështrim individual ashtu dhe kur ato funksionojnë në ekip.

Aftësitë profesionale të Administratës Publike, startojnë që në zgjedhjen e personelit, i cili është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm si në rastin e krijimit të Administratës Publike, ashtu dhe të vazhdimësisë së saj, me synim funksionimin e

Institucioneve ku ata punojnë, sipas standarteve europiane.

Administrata Publike aktuale, pa mohuar ndryshimet dhe transformimet pozitive të saj, duhet pranuar se në një pjesë të konsiderueshme është pasuese e Administratës Publike që funksiononte në institucione që para viteve 90. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999, "Mbi Statusin e nëpunësit civil", për të siguruar mirëfunksionimin e saj u la një afat kohor përshtatjeje në një hark prej dy vitesh, ku Administrata ekzistuese kaloi në Administratë Publike me status të nëpunësit civil. Ky kalim u bë pa iu nënshtruar një testimi, i cili mendojmë se do të ishte i domosdoshëm. Kryerja e testimit kërkonte detyrimisht:

- a) Paraprakisht të përgatitej një program specifik sipas ministrive dhe specialiteteve me shtrirje nivelesh sipas hierarkisë.
- b) Hartimi i këtij programi, kërkonte nga drejtuesit e burimeve njerëzore njohuri vizionare që për kohën mendojmë se paraqisnin vështirësi të paarrtshme.

Për të plotësuar këtë mangësi, nga institucioni përkatës, Departamenti i Administratës Publike, është bërë kujdes që Administrata Publike t'i nënshtronte një sërë trajnimesh të karakterit të përgjithshëm dhe atij specifik që kanë të bëjnë me zhvillimin e programeve të formimit të tyre, forcimin e rolit të manaxhimit të nivelit të lartë, etj. Këto trajnime kanë ndikuar dhe do të ndikojnë edhe në të ardhmen në aftësimin, shtimin e kapaciteteve dhe cilësisë së Burimeve Njerëzore.

Pikërisht, në këto kushte të integritit në BE, një strategji e re dhe objektiva të reja, krijojnë dhe diktojnë cilësi të reja në Administratën Publike. Kjo kushtëzon nevojën e menjëhershme për formim dhe zhvillim të Burimeve Njerëzore, me qëllim që, Administrata Publike të përfshihet gjithnjë e më tepër në problemet e identifikimit të prirjeve të zhvillimit të sektorit ku ato punojnë dhe të ndërmarrjes së politikave efikase të pjesshme dhe të plota. Që ndërmarrja e politikave të jetë e sukseshme dhe të orientojë drejt veprimtarinë e sektorit që ato fokusojnë, duhet që Administrata Publike të rrisë

përgjegjësitë e veta dhe të adaptojë një kërkesë pune të ndryshme nga ajo aktuale. Në këtë mënyrë Administrata Publike e gjen veten gjithnjë e më shumë të përfshirë në problemet strategjike të institucionit.

Të gjitha këto fokusojnë domosdoshmërinë e cilësisë së Administratës Publike, e cila siç u theksua fillon me zgjedhjen e personelit.

Fakti se zgjedhja e personelit sipas statusit të nëpunësit civil i lë kompetencë të plotë sipas limiteve ligjore eprorit direkt për përcaktimin e aplikantit fitues, mendojmë nuk është në respekt të plotë me kërkesën që në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore njihet si "Vlefshmëria lidhur me kriterin", vënia në jetë e të cilit presupozon zgjedhjen e aplikantit që arrin vlerësimin maksimal.

Zgjedhja cilësore jo vetëm përmirëson punën në organizatë (institucion), por mënjanon edhe dukuri që çenojnë veprimtarinë e tij, siç janë largimet nga puna.

Administrata Publike në ndryshimin e sistemit përfaqësohej nga specialistë të fushave të ndryshme. Gjatë periudhës 10 vjeçare janë përfshirë në këtë sektor punonjës të rinj dhe janë larguar prej saj të tjerë punonjës punonjës për motive të ndryshme si:

- Për plotësim të moshës,
- Larguar si të papërshtatshëm,
- Larguar drejt bizneseve private

Kjo ndryshueshmëri është shkaktuar nga faktorë biologjikë të paevitueshëm, si dhe nga faktorë të tjerë të natyrës ekonomike, legjislativë, sociale, prioritetive arsimore dhe demografike.

MATERIALI DHE METODIKA

Për përgatitjen e këtij punimi si objekt studimi shërben një pjesë e AP në dy ministritë dhe konkretisht MASH dhe MB, kryesisht punonjës të nivelit specialist dhe kjo për faktin se ata përbëjnë pjesën më të madhe në numër të Administratës Publike.

U studiua literatura në gjuhë të huaj dhe shqip si dhe praktika e deritanishme e zgjedhjes së personelit në AP. Të dhënat e nevojshme për përgatitjen e këtij punimi u siguruan nga pyetëtori i përgatitur për këtë qëllim. Pyetëtori

krahas pyetjeve që synojnë të grumbullojnë të dhëna të karakterit të përgjithshëm, përbëhet nga pyetje që synojnë të grumbullojnë të dhëna vlerësuese të të anketuarëve mbi problemin objekt i këtij diskutimi, si të dhëna në lidhje me mënyrën aktuale të zgjedhjes, mangësitë që vërehen. Për sigurimin e të dhënave të besueshme u përfshinë në anketim punonjës të AP. Anketimi bazohej në zgjedhjen e rastit.

Ligji nr. 8549 dt. 11.1999, "Mbi Statusin e nëpunësit civil", ka zgjidhur drejt një sërë problemesh dhe ka funksionuar relativisht mirë. Megjithatë përsëri ka subjektivizma në zbatimin e tij, e cila duhet të mënjanohet, duke përmirësuar cilësinë e zgjedhjes së personelit.

Aktualisht zgjedhja përfundimtare bëhet duke i lënë në kompetencë eprorit direkt të drejtën e përzgjedhjes, e drejtë kjo juridikisht e pakundërshtueshme. Kjo kompetencë që ligji ia njej eprorit direkt mendojmë se ka këto mangësi:

- Procesi i zgjedhjes së personelit synon në sigurimin e aplikantëve, kualifikimi i të cilëve i përgjigjet kërkesave të punës. Kjo përbën problemin themelor të zgjedhjes së personelit në cdo organizatë, ndaj përzgjedhja nuk duhet të përqëndrohet vetëm tek eprori direkt.
- Përqëndrimi tek një person i të drejtës së zgjedhjes e vendos eprorin në pozita favorizuese dhe lë shkas për subjektivizëm të theksuar.

Testi i njohurive apo provimi me shkrim ka një peshë të madhe në vendimin e seleksionimit në praktikën e deritanishme. A e justifikon praktika e deritanishme e përzgjedhjes këtë peshë të vlerësimit?

U hartuan dy hipoteza në lidhje me besimin në vlerësimin vetëm sipas testit:

- Punonjësit nuk besojnë në transparencën e zgjedhjes vetëm nëpërmjet testit.
- Punonjësit besojnë në transparencën e zgjedhjes vetëm nëpërmjet testit.

Zgjedhja e hipotezës u bë me anë të kriterit të Maan Whitney për zgjedhjet e vogla që kalon në këto faza.

E para, renditen të dhënat e siguruara nga pyetësi të zgjedhjeve respektive sipas rendit. Përcaktojmë nivelin e rëndësisë $\alpha = 0.05$ (pra siguria 95%).

E dyta, Llogariten shumat e rangjeve të zgjedhjes së parë dhe mesatarja e tyre.

$$R1M = \sum R1$$

$$\text{Logaritet mesatarja} - MR = \frac{1}{2} (n1)(n1+n2+1)$$

Llogaritet shmangia nga mesatarja kuadratike e kriterit Maan Whitney:

$$\text{Devijimi standart } \sigma = \sqrt{1/12 n1n2(n1+n2+1)}$$

E treta, Llogaritet Zf për ta krahasuar me Zkr

$$Zf = (R1M - MR) / \sigma$$

Kur $Zf > Zkr$, Ho hidhet poshtë.

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE

Për këtë problem u anketuan punonjës të administratës publike të cilët mbështesin kërkesën "Vlefshmëria në lidhje me kriterin", por shprehen skeptik për veprime të parregullta në vlerësim.

Për këtë, për lehtësi në dy grupe punonjësish u konsideruan 4 zgjedhje, të cilët pyetjes: *A besoni se zgjedhja vetëm mbi bazë të testit do të jetë rezultative? Vlerësojeni atë me pikë nga 1 deri në 10.* Kjo pyetje iu drejtua specialistëve të dy ministrive. Vlerësimi i tyre ishte si më poshtë vijon:

	Vlerësimi me pikë			
Grupi I	6	8	9	10
Grupi II	4	3	5	7

Pikët	<u>3</u>	<u>4</u>	<u>5</u>	6	<u>7</u>	8	9	10
Rangjet	1	2	3	4	5	6	7	8

Pasi renditen të dhënat e pyetësorit sipas rendit bëhen llogaritjet përkatëse:

$$R1M = 4+6+7+8= 25$$

$$\text{Mesatarja MR} = \frac{1}{2} 4*(4+4+1) = 18$$

Shmangia nga mesatarja kuadratike:

$$\sigma = \sqrt{1/12 * 4*4*(4+4+1)} = 3.4$$

$$Z_f = (25 - 18)/3.4 = 2.05$$

$$Z_{kr} = 1.96 \text{ (Nga tabela e shpërndarjes normale)}$$

$$Z_f > Z_{kr} \rightarrow 2.05 > 1.96$$

Pra H_0 hidhet poshtë dhe pranohet ajo alternative H_1 që do të thotë se të intervistuarit besojnë në transparencën e zgjedhjes vetëm sipas testit.

KONKLUZIONE

- Duke patur parasysh përmbajtjen e kriterit të Maan Whitney për zgjedhjet e vogla mund të konkludohet se është një teknikë e thjeshtë për të kuptuar dhe e lehtë në përdorim për shkak të aparatit statistikor që përdoret.
- Vlefshmëria lidhur me kriterin krijon kushte për një zgjedhje personeli në respekt të të ashtuquajturës “Vlefshmëri Konkurruese”, pasi krijon kushte për një vendosje të aplikantëve në kushte krahasuese me objektivat e institucionit për pozicionin përkatës që gjen pasqyrim në përshkrimin e punës.
- Mënjanimi i dukurive të parregullta që mund të paraqiten në këtë mënyrë veprimi, arrihet me anë të përgatitjes së një numri të madh tezash

dhe zgjedhja e tezës vlerësuese nga vetë aplikantët në kohën e duhur.

- Kjo mënyrë siguron transparencë në përgatitjen e testit dhe për rrjedhojë çon në vlerësim korrekt.
- Vërtetimi i hipotezës obligon institucionet bashkëpunuese në zgjedhjen e personelit për zbatimin në praktikë të zgjedhjes së personelit vetëm mbi bazë të rezultateve të testimeve me shkrim. Në këtë mënyrë gjen zbatim edhe “Vlefshmërinë lidhur me kriterin”, çka përmirëson dukshëm cilësinë që në zgjedhje.

LITERATURA

1. Diamond, K: The Ethics of Public Service; 1988
2. Hobruk, T; Burecreacy and Political Corruption; 1993 ILO; Report; Human Resources Training and Development, May 2000
3. Kaufman, C. 1986. " Beyond the managerial model: The Case for Broadening Performance Assessment in Government and the Public Service"
4. Olson 1990. Public Administration. New York; Alfred A. Knopf,
5. Ostrom, R. 1992. Management of Organizational Behavior. Englewood cliffs.N.
6. Sumser, R; 1996. Guide for effective Strategic Management of Human Resources .

THE DECENTRALIZATION PROCESS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA IN FUNCTION OF SOLVING INTER-ETHNIC RELATION PROBLEMS PROCESI I DECENTRALIZIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË FUNKSION TË ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE NË MARRËDHËNIET NDËRETRNIKE

ADIL ZENDELI^a, DITURIJE ISMAILI^b

^aProdekan në Fakultetin e Administratës Publike dhe Shkencave Politike, UEJL

^bZyra për Hulumtime Shkencore, Universiteti i Evropës Jug Lindore Tetovë, REPUBLIKA E MAQEDONISË

Email: f.zendeli@seeu.edu.mk

AKTET IV, 4: 624 - 628, 2011

PERMBLEDHJE

Në vitin 2001 në RM kishim konflikt të armatosur që rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, kuptohet se ky dokument ishte në funksion të vendosjes së paqes së qëndrueshme ku sistemi juridik dhe politik do të pësonte ndryshime cilësore dhe marrëdhëniet ndëretnike si shtyllë e sigurisë së shtetit.

Njëri prej inovacioneve kryesore që promovohet me Marrëveshjen Kornizë është shumica e dyfishtë në procesin legjislativ, me të cilin është rritur rëndësia e përfaqësimit të bashkësive jo shumicë në Kuvendin Republikan. Shtylla e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit është kompromisi i arritur për Republikën e Maqedonisë si shtet unitar por me elemente të theksuara të decentralizimit. Fokusimi jonë në trajtimin e kësaj çështje ka të bëjë me procesin e decentralizimit si një proces mjaft i rëndësishëm në funksionimin e organeve lokale të pushtetit, duke mos haruar edhe dimensionin politik të decentralizimit në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etnike në RM.

Fjalet çelës: demokracia, marrëdhëniet ndëretnike, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, procesi i decentralizimit, shumica e dyfishtë.

SUMMARY

The armed conflict of 2001 in Republic of Macedonia resulted the signing of the Ohrid Framework Agreement and it is understood as document in the function of establishing lasting peace where the political system would suffer qualitative changes and interethnic relations as a security state pillar. One of the main innovations promoted by the Framework Agreement is the double majority in the legislative process, which has increased the importance of non-majority community representation in the Republican Assembly. The backbone of the Ohrid Framework Agreement is a compromise reached for the Republic of Macedonia as a unitary state but with significant elements of decentralization. Our focus in addressing this issue has to do with the decentralization process as a very important process in the functioning of local organs of the government, not forgotten the political dimension of decentralization in order to resolve ethnic disputes in Macedonia.

Key words: democracy, inter - ethnic relations, Ohrid Framework Agreement, the process of decentralization, double majority.

HYRJE

Pas shkatërrimit të ish Jugosllavisë, dhe ndryshimeve në shtetin shoqëroro-ekonomik dhe politik në Republikën e Maqedonisë, duhej të krijohet sistem i ri demokratik mbi baza të

barabarta etnike dhe kulturore, ku do të respektoheshin të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejta e grupeve etnike në vend

Mirëpo, pranimi i sistemit demokratik, pluralizmit politik, pronave, vetadministrimit lokal, në shumë

segmente ishte sipërfaqësor, veçanarisht në fushën e vetadministrimit lokal ato mbeten shprehje pa funksion si mungesë e kompetencave efektive në drejtim të shfrytëzimit të resurseve ekonomike dhe financiare, personelit profesional etj.

Largimi nga sistemi Jugosllav i komunave në RM-së nxiti më tepër procesin e centralizimit se sa atë të decentralizimit. Prandaj ishte i nevojshëm riorganizim rënjësor i sistemit të vetadministrimit lokal, për çka u krijuan kushte pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, ndryshimeve në Kushtetutën e RM-së, miratimit të Ligjit të ri për vetadministrim lokal si dhe një sërë ligjesh që rregullojnë sferën komunale.

Pas Marrëveshjes Kornizë së Ohrit, dhe ndryshimeve kushtetuese hapet mundësia për zhvillimin e proceseve të decentralizimit të pushtetit por edhe për fillimin e procesit të dekoncentrimit dhe decentralizimit të politikës, të administratës, aftësive financiare të koncentruara dhe të centralizuara në pushtetin qendror.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001 nuk paraqet zgjedhje ideale dhe nuk i përmbush kërkesat dhe aspiratat e shqiptarëve për barazi në të gjitha segmentet e jetës, mirëpo ajo paraqet një hap përpara në avancimin e të drejtave të shqiptarëve në përgjithësi.

Shtylla e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit është kompromisi i arritur për Republikën e Maqedonisë si shtet unitar por me elemente të theksuara të decentralizimit dhe hapje më të madhe të institucioneve qendrore për komunitetet joshumicë. MKO nuk ka mundur autonominë substanciale territoriale ose autonomi kulturore për komunitetet jo shumicë në RM-së, por në vend të kësaj, marrëveshja ka mundur decentralizimin e pushtetit, me të cilin veçanarisht komunitetit të dytë etnik në RM-së, shqiptarëve por edhe grupeve tjera etnike do tu jepet autonomi më e madhe në nivel nacional dhe lokal.

Procesi i decentralizimit dhe legjislacioni që u aprovua në përputhje me marrëveshjen, rrisin kapacitetin e komunave në fusha si arsimit, urbanizmi, decentralizimi fisal, vendimarrje për

çështje etnike (votimi i dyfishtë) si dhe fusha tjera të rëndësishme për komunitetet lokale.

Komponentë e pandashme e reformimit të vetadministrimit lokal është edhe nxjerrja e ligjit për ndarje territoriale, me qëllim të korigjimit të gabimeve të cilat janë bërë në të kaluarën, për arsye se në Republikës së Maqedonisë kemi numër të konsiderueshëm të komunave në të cilat jeton popullata etnike maqedonase, me numër shumë të vogël të banorëve dhe me shtrirje territoriale më të madhe në krahasim me disa komuna të tjera ku jetojnë shqiptarët etnikë të cilat kanë numër shumë të madh të banorëve dhe shtrirje territoriale më të ngushtë. Kjo është bërë me qëllime të caktuara politike dhe strategjike që në Republikës së Maqedonisë të ketë sa më pak komuna që do të qeverisen nga shqiptarët.

Revizioni i kufijve komunal do të bëhet nga ana e pushteteve lokale dhe nacionale me pjesëmarrje të faktorit ndërkombëtar.¹

Marrëveshja kornizë duhet të mundësojë decentralizimin e komunave, me të cilës komunitetve jo shumicë dhe veçanarisht komunitetit shqiptarë do ti mundësojë autonomi më e madhe në nivel lokal dhe do të sigurojë përfshirje më të madhe në institucionet lokale. Vetë marrëveshja përcakton se "nuk ka zgjidhje territoriale për çështjet etnike" që është në frymën e shtetit unitar dhe në funksion të reformimit të institucioneve të vetadministrimit lokal.

Marrëveshja Kornizë dhe ligjet për decentralizimin e pushtetit kanë krijuar kategorinë juridike 20%, që në essence është diskriminues edhe pse nga krijuesit është tentuar të paraqitet si diskriminim pozitiv apo instrument për të mbrojtur komunitetet jo shumicë. Nëse është kështu, parashtrohet pyetja, nga kush duhet të mbrohet komunitetet jo shumicë? Nëse ata duhet të mbrohen nga komuniteti shumicë, at'here zgjidhja sigurisht se do të duhej të ishte më substanciale dhe më tepër mekanizma mbrojtës për komunitetet jo shumicë dhe për një zgjidhje më cilësore sigurisht se do të duhej më

¹ Po aty, pika 3.2

tepër guxim nga krijuesit e marrëveshjes, në drejtim të automisë substanciale të komunave ku komunitetet jo shumicë janë dominante. Instalimi i kategorisë 20 % krijon bindjen se shqiptarët janë të favorizuar në raport me komunitetet tjera jomaqedonase dhe me këtë e defokuson problemin nga marrëdhëniet etnike shqiptaro-maqedonase në marrëdhëniet shqiptarë në raport me komunitetet tjera jomaqedonase. Kjo është tendencë e politikës maqedonase që shqiptarët sa më tepër të jenë në kategorinë e popullatës jo shumicë në Republikën e Maqedonise, respektivisht shqiptarët duhet të krahasohen me grupet tjera etnik që për nga përqindaj janë të pakët në nivel shtetëror.

Pala maqedonase edhe me MKO i ruajti pozicionet e veta dominuese brenda sistemit duke vazhduar që ti mbaj shqiptarët jashtë pushtetit real por duke e hapur pak sistemin edhe për shqiptarët në segmente që prekin interesa kulturore, arsimore, gjuhësore etj.

Ridefinimi territorial duhej të ndryshonte dominimin etnik dhe politik të komunitetit maqedonas, siq janë komuna e Strugës dhe Kërçovës. Komuna e Strugës e bashkuar me ish Komunën e Veleshtës ndryshoi strukturën etnike të komunës nga dominimi maqedonas në dominim shqiptarë, me një fjalë komunës së Strugës iu kthyen territore të cilat me motive të qarta politike dhe etnike i ishin marrë me ndarjen territoriale të vitit 1996. Mbeti i hapur problemi me Komunën e Kërçovës. Për arsye politike, kompromiseve të konjunkturave udhëheqëse shqiptare dhe maqedonase Kërçova mbetet në kufijt e ndarjes territoriale të vitit 1996 dhe me këtë nuk realizohet një nga detyrimet kryesore të MKO, që padrejtësisht u krijua me ndarjen territoriale të vitit 1996

Fokusimi jonë në trajtimin e kësaj çështje ka të bëjë me procesin e decentralizimit si një proces mjaft i rëndësishëm në funksionimin e organeve lokale të pushtetit, por duke mos haruar edhe dimenzionin politik të decentralizimit në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etnike në RM-së.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit ndali luftën e armatosur të vitit 2001, hapi shtigje të reja të

funksionimit të sistemit juridik dhe politik në RM-së, hapi sistemin pak më tepër për shqiptarët, riti përfaqësimin e e komuniteteve jo shumicë në administratën publike, aplikoi parimin e votimit të dyfishtë në marrjen e vendimeve në Kuvendin Republikan dhe lokal për komunitetet jo shumicë për çështjet që tangojnë të drejtat gjuhësore, arsimore, kulturore, etj.,

Procesi i decentralizimit luan rol jashtëzakonisht të madh në drejtim të demokratizimit të shoqërisë dhe çka është më e rëndësishme e forcon kohezionin e shtetit aty ku është më e brishtë marrëdhëniet shqiptaro-maqedonase.

Në përputhje me MKO u realizuan ndryshime kushtetuese, të cilat janë miratuar në fund të vitit 2001 dhe fillim të vitit 2002 nga kuvendi republikan.

Me këto ndryshime kushtetuese gjuhës që flitet më tepër se 20% në gjithë territorin e shtetit i jepet status i gjuhës zyrtare, këtë kusht e plotëson vetëm komuniteti shqiptarë, prezantohet sistemi i shumicës së dyfishtë ose ndryshe e quajtur sistemi i badinterit (shumica e votave në Kuvend të deputetëve që janë të komuniteteve joshumicë) për fushat që prekin, gjuhën, kulturën, përfaqësimi i barabartë për administratën publike në nivel nacional dhe lokal, decentralizimi dhe reforma e pushtetit lokal, hapet rruga për krijimin e policisë lokale etj..

Një nga çështjet kryesore të Marrëveshjen kornizë është përfaqësimi i ulët i shqiptarëve në administratën publike dhe kompanitë publike. Nga të dhënat statistikore qartë mund të shifet pjesëmarrja e ulët e shqiptarëve në administratën publike, veçanërisht në fushat e ndjeshme të administrates publike, si për shembull policia, ku numri i shqiptarëve çdoherë ka qenë i ulët që nga vitet e nëntëdhjeta.

Pas Marrëveshjes së Ohrit, është ritur pjesëmarrja e shqiptarëve dhe komuniteteve tjera në sektorin publik dhe kompanitë publike por ende është në përqindje jo e mjaftueshme e përfaqësimit të shqiptarëve dhe komuniteteve tjera në institucionet publike

Përfaqësimi adekuat i komuniteteve joshumicë në administratën publike është shoqëruar me mjaft dobësi në drejtim të politizimit të

administratës, garës ndërmjet palës maqedonase dhe shqiptare se kush më shume punësime ka bërë në administratën publike, cilësia joadekuatë e të punësuarëve etj.

Vendimmarrja në Këshillat e Komunës sipas votimit të dyfishtë

Njëri prej inovacioneve kryesore që promovohet me Marrëveshjen kornizë është shumica e dyfishtë në procesin legjislativ, me të cilin është rritur rëndësia e përfaqësimit të komuniteteve në Kuvend. Sistemi i shumicës së dyfishtë, që në Maqedoni njihet edhe si shumicë e Badenterit, e kërkon shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, si dhe shumicën e votave të deputetëve që deklarohen si pjesëtarë të komuniteteve joshumicë për çështje që tangojnë interesat nacionale të tyre:

- Kultura
- Përdorimi i gjuhëve
- Arsimi
- Dokumentet personale
- Përdorimi i simboleve
- Vetëqeverisja lokale

Sistemi I votimit të dyfishtë zbatohet edhe në vendimmarrjen e këshillave komunale për fushat që prekin interesat e komuniteteve joshumicë në komuna.

Edhe pse në shikim të pare duket se bëhet fjalë për një instrument demokratik të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve joshumicë në këshillat e komunave, në essence në nivel local ky parim mbron një trashigimi diskriminuese që është krijuar me dekada në Republikën e Maqedonisë. Pala maqedonase në komunat ku është pakicë nuk është e intresuar që të ndyshoj marrëdhëniet shoqërore ku ajo është e favorizuar ndërsa komunitetet tjera janë të diskriminuar dhe me këtë e shfrytëzon këtë për të ruajtur pozitën e veta.

Është e domosdoshme që votimi I dyfishtë të mos shfrytëzohet për konzervimin e pozitave të fituara nga më pare por të shërbej për ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore që do të jenë në frymën e MKO dhe një kohezini më të madh etnik brenda shoqërisë.

Synimi kryesor i MKO dhe decentralizimit të pushtetit është që komuniteteve joshumicë tu mundësohet pjesëmarrje më e gjërë politike, institucionale dhe ndërtimin e një shoqërie më të integruar (multietnike, multikonfesionale, multikulturore etj)

PËRFUNDIMET

Si konkludim nga gjitha ajo që u tha më sipër është se procesi i decentralizimit të pushtetit në RM-së është proces i pashmangshëm jo vetëm si obligim nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe nga Karta Evropiane për vetadministrim lokal, por edhe si nevojë e qytetarëve për plotësimin e nevojave të tyre, në mënyrë të drejtëpërdrejtë duke përijashtuar tutelën e pushtetit qendror dhe duke e ofruar pushtetin më afër qytetarëve.

Qëllimi kryesor i reformës në sferën e vetadministrimit lokal dhe decentralizimit të pushtetit do të ishte ndërtimi i komunave të bazuara në parimet e demokracionit dhe decentralizimit, si dhe ata të aftësohen për të udhëhequr me punët lokale me përgjegjësi dhe në interes të qytetarëve, duhet të krijohen kushte që komuna nëpërmjet organeve të veta të jetë më afër qytetarëve dhe më e përgatitur për zgjidhjen e problemeve të përditshme lokale.

Synimi kryesor I MKO dhe decentralizimit të pushtetit është që komuniteteve joshumicë tu mundësohet pjesëmarrje më e gjërë politike, institucionale dhe ndërtimin e një shoqërie më të integruar (multietnike, multikonfesionale, multikulturore etj)

Pengesë kryesore për mosfunksionalizimin më të plotë të procesit të decentralizimit mbetet friga e palës maqedonase nga pushtetit lokal në komunat ku shqiptarët janë shumicë. Kjo është pengesë serioze e procesit të decentralizimit në tërë territorin e shtetit.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe decentralizimi i pushtetit hapën shtigje të reja të funksionimit të sistemit juridik dhe politik në RM-së, hapi sistemin pak më tepër për shqiptarët, riti përfaqësimin e e komuniteteve jo shumicë në administratën publike, aplikoi parimin e votimit të dyfishtë në marrjen e vendimeve në Kuvendin Republikan dhe lokal për komunitetet jo shumicë

për çështjet që tangojnë të drejtat gjuhësore, arsimore, kulturore, etj.

Marrëveshja kornizë e Ohrit e vitit 2001 nuk paraqet zgjedhje ideale dhe nuk i përmbush kërkesat dhe aspiratat e shqiptarëve për barazi në të gjitha segmentet e jetës, mirëpo ajo paraqet një hap përpara në avancimin e të drejtave të shqiptarëve në përgjithësi.

BIBLIOGRAFIA

1. Alex Belamy, "The New Wolves at the Door: Conflict in Macedonia," *Civil Wars*, Vol. 5, No. 1 (Spring 2002), fq. 132-133.
2. Biljana Vankovska, "Multi-ethnicity or Bilingualism? The Framework Agreement and the Future of the Macedonian State "Current Perspectives on Macedonia," Heinrich-Böll-Stiftung.
3. Florian Bieber, "Power Sharing as Ethnic Representation in Post-Conflict Societies: The Cases of Bosnia, Macedonia and Kosovo," A. Mungiu-Pippidi and I. Krastev (eds), *Nationalism after Communism. Lessons Learned* (Budapest: CEU Press 2004), fq. 229-46.
4. Iso Rusi, "What Do the Casualties of War Amount to?" *AIM*, 25.12.2001.
5. John McGarry and Brendan O'Leary, "Consociational Theory, Northern Ireland's Conflict, and its Agreement 2. What Critics of Consociation Can Learn from Northern Ireland," *Government and Opposition*, Vol. 41, No. 2 (2006), fq. 268.

6. MILS News, "Problem with Macedonian-Muslims on Census is Technical Issue," 13.11.2002.

7. Engström, citat i hapur; Židas Daskalovski, "Language and Identity: The Ohrid Framework Agreement and Liberal Notions of Citizenship and Nationality in Macedonia," *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, No.1, 2002.

8. Natasha Gaber-Damjanovska, Aneta Jovevska, "Current Events and Political Parties, Development in the Republic of Macedonia," *Institute for Sociological, Political and Juridical Research*, Skopje, No. 16, Qershor

9. OSCE/ODIHR, "Former Yugoslav Republic of Macedonia, Parliamentary Elections September 2002," Final Report, 20.11.2002.

10. Stephan Hensell, "Typisch Balkan? Patronagenetzwerke, ethnische Zugehörigkeit und Gewaltdynamik in Mazedonien," *Internationale Politik und Gesellschaft*, No. 4, 2003, fq. 131-146.

11. Timothy D. Sisk, *Power Sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts* (Washington: USIP, 1996), fq. 34-45

12. Vlado Popovski, "Kutia e Pandorës mbetet e mbyllur", *Forum Analitika*, dhjetor-janar 1998, Nr. 1, fq. 90 zgjedhor, Shkup, Ministria e drejtësisë, Shkup, gusht 2007.

TECHNICAL TERMINOLOGY AS A PERMANENT SOURCE OF VOCABULARY ENRICHMENT TERMINOLOGJIA TEKNIKE BURIM I PËRHERSHËM I PASURIMIT TË FJALORËVE SHPJEGUES TË PËRGJITHSHËM

NEBI CAKA¹, ALI CAKA²

¹Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

²Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË

Email: nebi.caka@fiek.uni-pr.edu

AKTET IV, 4: 629 - 632, 2011

PERMBLEDHJE

Fjala *laser* nuk ka mundur të jetë në *Fjalorin e gjuhës shqipe* më 1954, se laseri do të shpikëj gjashtë vjet më vonë, por do të mund të ishte fjala *transistor*, se transistori ishte shpikur gjashtë vjet më parë. Këto fjalë në fillim kanë shërbyer vetëm si terma teknikë, por me kohë, me përhapjen e përdorimit të sendeve që ato emërtonin, kanë filluar të bëhen fjalë të përdorimit të zakonshëm, prandaj fjala *transistor* është përfshirë në *Fjalorin e shqipes së sotme* të vitit 1984, por jo dhe fjala *laser*. Sot *kompjuteri* dhe *interneti* janë bërë pjesë përbërëse e jetës së shumë njerëzve anembanë botës, ndaj dhe janë përfshirë në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 2006. Përfshirja e termave teknikë të përdorimit të gjerë në fjalorin shpjegues të çdo gjuhe, pra edhe të shqipes, është domosdoshmëri, ngase sot nuk mund të komunikojmë në mënyrë të efektshme pa to.

Fjalët çelës: terminologjia teknike, pasurimi i fjalorit, Fjalori i gjuhës shqipe (1954), Fjalori i shqipes së sotme (1984), Fjalori i gjuhës shqipe (2006).

SUMMARY

The word *laser* could not be inserted in the Dictionary of Albanian language in 1954, as the laser was to be invented six years later; but the word *transistor* could had been included since it had been invented six years before. These words serving only as technical terms at first, were later to become common words by the spread of the usage of objects they labeled. As a result, the word *transistor* got to be included in the Dictionary of Albanian language in 1984, but still not the word *laser*. Nowadays the *computer* and *internet* have become part of many people's daily life around the world, therefore they have been included in the Dictionary of Albanian language in 2006. The inclusion of wide-usage technical terms in general dictionaries of any language has become a necessity, because in nowadays, it is almost impossible to communicate effectively without them.

Key-words: Technical terminology, vocabulary enrichment, Fjalori i gjuhës shqipe (1954), Fjalori i shqipes së sotme (1984), Fjalori i gjuhës shqipe (2006).

HYRJE

Gjatë shfrytëzimit të Internetit shpesh hasim në fjalë të panjohura, në të shumtën e rasteve terma teknikë, për të cilët nuk mund të gjejmë shpjegimin a përshkrimin në fjalorët ekzistues. Nga ana tjetër, përfshirja e tyre në fjalorët shpjegues të përdorimit të përgjithshëm dhe

shpjegimi i tyre i atillë që të jetë i kuptueshëm për një rreth të gjerë lexuesish nuk është punë edhe aq e lehtë. Edhe shpikësit në vendet e ndryshme të botës gjatë patentimit të shpikjeve të tyre hasin në vështirësi, sepse shpikja duhet të shpjegohet me numër të kufizuar fjalësh dhe

është vështirë të gjenden fjalët e duhura, madje edhe në gjuhën amtare (Kovalick 2009).

Futja e termave të rinj teknikë në një gjuhë nuk është e vogël. Çdo ditë krijohet ndonjë term i ri ose kuptime të reja u shtohen fjalëve të vjetra. Një numër i madh termash të rinj shfaqen për çdo ditë për të shënuar sendet e reja, proceset e reja dhe shpikjet e reja, sidomos në teknologjinë e informacionit, e cila përfshin shumë lëmenj të jetës sonë, ndaj dhe koha në të cilën jetojmë quhet epoka e teknologjisë së informacionit. Por shtrohet pyetja a duhet të gjithë termat shkencorë dhe teknikë të përfshihen në një fjalor të përgjithshëm? Kuptohet se jo të gjithë termat duhen përfshirë në një fjalor shpjegues të përgjithshëm të tipit të mesëm. Termat shumë specifike duhet lënë jashtë fjalorëve të përgjithshëm se vetëm do t'ua zinin vendin termave që kanë përdorim të gjerë ose fjalëve të tjera për të cilat do të mund të pritej që në një të ardhme të afërme (bie fjala deri te ribotimi i radhës i fjalorit që i përmban) do të bëheshin fjalë të përdorimit të përgjithshëm. Megjithatë, terminologjia shkencore dhe teknike gjithnjë e më shumë po zë vend në fjalorët e përgjithshëm. Një pjesë shumë e madhe e pasurimit të fjalorit tonë të përditshëm ka të bëjë me nxënien e këtyre termave. Vlerësohet se rreth 40% e fjalësit të fjalorëve të përgjithshëm janë terma shkencorë dhe teknikë (Panagiotis 2001).

1. Termat teknikë dhe fjalorët e përdorimit të përgjithshëm

Fjalori i përgjithshëm më i ri i Oksfordit "*The New Oxford American Dictionary*", botimi i tretë (2010) me 350.000 fjalë, shprehje dhe kuptime, me qindra shënime shpjeguese dhe me mbi një mijë ilustrime paraqet fjalorin më gjithëpërfshirës dhe më të saktë të anglishtes amerikane dhe merret si standard i përsosmërisë leksikografike në këtë vend. Ai paraqet një tekst tërësisht të përditësuar dhe të rishikuar. Shumica e fjalëve të reja, të përfshira në të, janë nga fushat me zhvillim të hovshëm, si informatika, teknologjia, biznesi dhe ekologjia dhe futja e tyre, në këtë fjalor, është bërë në bazë të evidencës më të re të korpusit dymiliardë-fjalësh të anglishtes të

Oksfordit, i cili pasqyron ndryshimet më të reja në korpusin e gjuhës angleze. Ky fjalor nuk është zëvendësim për fjalorët teknikë, por ka një numër tepër të madh të përkufizimeve për terminologjinë teknike aktuale.

Në një fjalor të përgjithshëm shpesh futen edhe shkurtesa, të cilat me kohë marrin kuptimin e fjalëve të mirëfillta, siç ka ndodhur bie fjala, me shkurtesat e anglishtes RADAR (**R**adio **D**etection **A**nd **R**anging) dhe LASER (**L**ight **A**mplification by **S**timulated **E**mission of **R**adiation) që sot janë fjalë të përdorimit të përditshëm pothuajse në të gjitha gjuhët e botës: *radar* dhe *laser*.

2. Termat teknikë dhe fjalorët e përgjithshëm të gjuhës shqipe

Edhe përpiluesit e fjalorëve të përgjithshëm të gjuhës shqipe janë munduar të ndjekin zhvillimin e shkencës dhe të teknikës dhe këtë ta pasqyrojnë në fjalësin e fjalorit, herë me më pak sukses, e herë me më shumë sukses. Për të mirë vlen të veçohet *Fjalori i gjuhës shqipe*, i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006 (FGjSh 2006). Siç thojnë hartuesit e këtij fjalori "Në (këtë) fjalor janë përfshirë shumë fjalë, shprehje e kuptime që përdoren sot në shqip dhe që nuk gjenden në fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes. Kjo lëndë e re pasuruese, që është nxjerrë nga vjelja leksikore e veprave të letërsisë artistike a shkencore, nga shtypi i përditshëm e periodik, nga fjalorë dygjuhësh, sinonimikë, krahinorë etj., e ka përditësuar kënaqshëm fjalorin." Në të janë përfshirë edhe disa fjalë të huaja, kryesisht terminologjike, që kanë hyrë këta 10-15 vjetët e fundit, veçanërisht në fusha të tilla si informatika, biznesi, ekonomia e tregut etj.

Nga termat teknikë që janë përfshirë në këtë fjalor e që nuk janë në fjalorët e mëparshëm do të përmendnim vetëm disa prej atyre që janë të njohura nga shumica, si: *celular*; *digjital* (por jo dhe: *digjitalizoj* e *digjitalizim*), *disketë*, *formatoj* e *formatim*, *informatikë* e *informatizoj*, *internet*; *klikoj* e *klikim*, *kompaktdisk*, *kompjuter*, *kompjuterik*, *kompjuterizoj*, *kompjuterizim*; *mi* (miush, maus), *printer*, *printoj*; *printim*, *i printuar*;

rrjetëzim (kompjuterik), skaner, skanoj, skanim, i skanuar; virus (si term i informatikës) etj.

Në fjalorin e përgjithshëm të gjuhës së sotme shqipe do të mund të përfshiheshin edhe mjaft fjalë të tjera teknike që kanë një përdorim të shpeshtë e të gjërë, si këto të mëposhtmet, të marra nga *Fjalori i Informatikës* (Caka, Dika, Rodiqi, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005), të mbesim në të njëjtën fushë: *adapter, algoritëm, aplikacion* (sot e ka zgjeruar kuptimin dhe përdoret edhe për: konkurrim), *bajt, bit, brezgjërë* (angl. *broadband*), *çip* (qark i integruar), *dekoder, disk* (*disk magnetofoni, disk kompjuteri, disk optik*), *gigabajt e gigaherc* (*giga* = 1 mijë milion), *detektor e detektim, demodulim, domen, ekran* (*i kompjuterit*), *e-mail, ikonë* (simbol grafik në ekranin e kompjuterit) *kalkulator, konektor, komutator, laser e laserik, mbart* (për fjalën e anglishtes *upload*), *meny* (në kompjuterikë a informatikë), *modem, modulim, modulator, monitor, ndërfaqe, terabajt e teraherc* (*tera* = 1 milionë milionë), *rrugëzues* (për fjalën e anglishtes *router*), *zhbart* (për fjalën e anglishtes *download*) etj.

Siç u tha më herët, përveç futjes së fjalëve të reja në fjalor, disa prej tyre marrin edhe kuptime të reja. Kështu, krahas **virus** (term në mjekësi): “mikroorganizmi më i vogël, që njihet deri më sot, i cili rritet e zhvillohet vetëm në qeniet e gjalla dhe shkakton sëmundje ngjitëse. *Virus i gjallë (aktiv). Virusi i gripit (i lisë, i tërbimit)*”, kemi dhe **virus** (term në informatikë): “Program që hyn në një sistem kompjuterash (më drejt: në një sitem kompjuterik) dhe e ndryshon ose e zhdruk informacionin e ruajtur në të: *ka virus*”. (FGJSh 2006)

3. Problemet gjatë përfshirjes së termave teknikë në fjalorët shpjegues

Leksikografët anglezë të shekullit 17, disa fjalë, posaçërisht termat shkencorë, matematikorë ose gjeometrikë, i shpjegonin me anë të ilustrimeve se kështu kuptoheshin më mirë. Semjuel Xhonsoni në fjalorin e tij, të njohur si *Fjalori i Xhonsonit*, të botuar më 1755 në Londër e ndërpreu këtë praktikë (McDermott 2005).

Sot, në lëmin e teknikës fjalët a termat teknikë të caktuar zakonisht përkufizohen me anën e fjalëve a termave të tjerë teknikë. Një logjikë e tillë shpesh ndiqet edhe nga përpiluesit e fjalorëve shpjegues të përgjithshëm dhe për të kuptuar përkufizimet e tilla duhet të njihen në një masë të konsideruar fushat së cilës i përkasin këta terma. Edhe hartuesit e *Fjalorit të gjuhës shqipe* (FGJSh 2006) kanë ndjekur këtë logjikë. Kështu, p.sh., fjala **klikoj**, si term i kompjuterit a kompjuterikës, në këtë fjalor shpjegohet si:

klikoj – “ndaloj dhe shtyp kursorin e kompjuterit në një pikë të caktuar të ekranit për të përfutur një të dhënë: *klikoj dy herë*”.

Pra, për shpjegimin e foljes (termit) **klikoj** janë përdorur katër terma të tjerë po të kësaj fushe:

1. **kursor** – shenjë në trajtë shigjete e kompjuterit, që lëviz në ekran drejt vendit a pikës ku duhet të klikohet. - Siç mund të vërehet, **klikoj** shpjegohet me **kursor**, e **kursor** me **klikoj**;

2. **kompjuter** – aparat elektronik, i pajisur me program të posaçëm logjistik, që kryen në mënyrë automatike shumë veprime të ndërlikuara informatike: *ekran kompjuteri; radhit në kompjuter*. Por në fjalor nuk jepet fjala (mbiemri) *logjistik*, ndaj mbetet e paqartë çfarë nënkuptohet këtu me ‘program (të posaçëm) logjistik’, siç mbetet e paqartë, se çfarë mendohet këtu edhe me ‘veprime (të ndërlikuara) informatike’, meqë në fjalor nuk jepet po ashtu as fjala (mbiemri) informatik, ndonëse kjo mund të nxirret nga kuptimi i fjalës (emrit) *informatikë*, që jepet në fjalor.

3. **ekran** – pëlhurë e bardhë (në kinema) ose pllakë prej lënde të posaçme (në televizor, kompjuter etj.) ku riprodhohen me anë të dritës filma, sinjale etj. – Kjo nuk është aq e saktë për ekranin e kompjuterit, ku riprodhohen kryesisht tekste, figura, diagrame etj.

4. **e dhënë** – 1. *zakon. sh.* Njoftime për dikë a për diçka; fakte a dokumente për të vërtetuar diçka, për të nxjerrë përfundime etj. 2. *sh spec.* tërësi përmasash, faktesh etj. të gatshme që jepen e që janë të domosdoshme për të përcaktuar, për të gjetur a për të zgjidhur diçka; sistem shenjash a sinjalesh që jepen me radiodhënë. 3. veti a cilësi që karakterizojnë dikë a diçka; aftësi, dhurëti. Ai

që nuk është i fushës së kompjuterikës (informatikës) nuk e ka aq lehtë ta gjejë se me cilin kuptim të kësaj fjale kemi të bëjmë në përkufizimin e mësipërm të fjalës/termit *klikoj*.

Fjalori i vogël i Oksfordit (2008), ndërkaq kuptimin e fjalës/termit *klikoj* (angl. *click*) e jep vetëm me tri terma të tjerë “shtyp butonin në miun e ‘kompjuterit’”. Siç shihet, kemi të bëjmë me shtypjen e ‘butonit’ në ‘miun’ e ‘kompjuterit’, e jo me shtypjen e ‘kursorit’ në ‘ekranin’ e ‘kompjuterit’, gjë që mund të konstatohet edhe nga përkufizimi i fjalës *miush* (si term i kompjuterit) në vetë *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* 2006: pjesë e kompjuterit, që komandon lëvizjen e kursorit dhe bën klikimin.

Një çështje tjetër që duhet pasur parasysh gjatë përditësimit të fjalësit të fjalorit, është edhe përditësimi i shpjegimeve, sidomos kur kemi të bëjmë me terma teknikë. Kështu, p.sh., fjala *diodë* (si term në elektronikë) e shpjeguar në ‘FGJSh 2006’ si: “llambë elektronike me dy elektroda (me anodë e me katodë)” tashmë i takon historisë së elektronikës. Më i përditësuar do të ishte përkufizimi i dhënë në *Collins Gem English Dictionary* (1999), si: “pajisje gjysmëpërçuese, e cila shërben për shndërrimin e rrymës alternative në rrymë të vazhduar”, ose në *Oxford Mini Dictionary & Thesaurus* (2008), si: “gjysmëpërçues, i cili lejon rrjedhjen e rrymës elektrike vetëm në një kah dhe i cili i ka dy skaje”.

PËRFUNDIM

Një nga mënyrat e pasurimit të fjalësit të fjalorëve shpjegues të përgjithshëm është futja në ta e fjalëve të marra nga terminologjia shkencore e teknike. Gjatë futjes së termave të caktuar në një fjalor shpjegues duhet pasur parasysh, ndër të tjera, edhe shpeshtinë e përdorimit të tyre në tekste të ndryshme, e për këtë do të ndihmonte shumë hartimi i një korpusi të rendit qindramilion-fjalësh i gjuhës shqipe.

Vetëm atëherë do të mund të pritej të kemi një fjalor shpjegues të përditësuar. Deri atëherë duhen shfrytëzuar fjalorët terminologjikë jo të pakët dhe të vilen prej tyre fjalët që kanë përdorim të gjërë.

BIBLIOGRAFI

CAKA, Nebi, Agni DIKA, Seb RODIQLI (2005), Fjalori i informatikës anglisht – shqip, shqip – anglisht, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.

KOVALICK, Vincent P. (2009), *Markman Hearings and Their Critical Role In U.S. Patent Litigation*, China IP News, October.

MCDERMOTT, Anne (2005), Johnson's Definitions of Technical Terms and the Absence of Illustrations: *International Journal of Lexicography*, Volume 18, Number 2, 1 June 2005, pp. 173-187(15), Oxford University Press.

PANAGIOTIS E. Tsampoumaras (2001), Bilingual lexicography in Greece: *Translatum Journal*, Issue 1, June 2001.

X x x x (1954), Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë.

X x x x (1984), Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

X x x x (1999), *Collins Gem English Dictionary*, Collins Gem.

X x x x (2006), Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

X x x x (2008), *Oxford Mini Dictionary & Thesaurus*, Second Edition, Edited by Charlotte Livingstone, Oxford University Press.

X x x x (2010), *The New Oxford American Dictionary (NOAD)*, Third Edition, Angus Stevenson and Christine A. Lindberg (editors), Oxford University Press. August..

THE TWO-SIDED MEDAL OF BODY LANGUAGE: UNDERSTANDINGS AND MISUNDERSTANDINGS BETWEEN ALBANIANS AND FOREIGNERS MEDALJA DYFAQËSHE E GJUHËS SË GJESTEVE: KUPTIME DHE MOSKUPTIME NDËRMJET SHQIPTARËVE DHE TË HUAJVE

AIDA GJINALI, ANASTASI PRODANI, I. LEAL VALLADARES, JEAN NICOLAS VIAL
Departamenti i Gjuhës Italiane, Departamenti i Gjuhës Spanjolle, Departamenti i Gjuhës Frënge,
Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI
Email: aidagjinali@yahoo.it

AKTET IV, 4: 633 - 639, 2011

PERMBLEDHJE

Komunikimi verbal është dhe mbetet një nga format më të përhapura të komunikimit njerëzor. Por ajo ç'ka qeniet njerëzore dhe jo vetëm ato, janë të afta të bëjnë është dhe komunikimi jo verbal. Ky komunikim është i shumëllojshëm dhe përfshin tërë qenien tonë fizike. Ky aspekt ka rëndësinë e tij, sidomos në kuadrin e heqjes së barrierave të komunikimit ndërmjet popujve. Ne do të prezantojmë në këtë punim një shumësi gjestesh, që në vende të ndryshme të botës kanë kuptime të njëjta ose të ndryshme. Ky studim do të jetë me interes për të gjithë mësuesit shqiptarë të gjuhëve të huaja, të cilët, duke ua përcjellë këto njohuri nxënësve, në kuadrin e një informacioni dhe të një formimi kulturor, do të arrijnë të ulin sa më shumë barrierat e komunikimit global.

Fjalë çelës: gjuha e gjesteve, komunikim global, informacion, kulturë.

SUMMARY

Verbal communication is and there remains one of the most widely spread forms of human communication. Another form of communication is the non-verbal communication that can be done not only by human beings. This communication is diverse and includes all our physical being. This aspect carries its own importance especially in the context of removing the barriers of communication between peoples. In this work we will present a plurality of gestures bearing similar or different meanings in different countries. This study will be of interest to all Albanian teachers of foreign languages that by conveying these knowledge to the students, in the context of imparting information and cultural formation, will manage to reduce as much as possible the barriers of global communication.

Key words: gesture language, global communication, information, culture.

HYRJE

Ky punim është një kërkim i mëtejshëm për të kuptuar veten dhe botën përreth, për të njohur dhe mirëkuptuar pa paragjykuar kulturën dhe sjelljen e kombeve të tjera, me qëllim uljen e barrierave të komunikimit ndërkulturor. Dhe kjo mund të bëhet e mundur edhe me anë të njohjes dhe studimit të një gjuhe sa të lashtë, aq dhe, shpesh të panjohur, që është ajo e gjuhës së gjesteve. Ky është dhe qëllimi ynë kryesor:

njohja, interpretimi dhe mësimi i kësaj forme komunikimi.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin që sjell risi në njohjen e gjuhës së gjesteve të katër kombeve të ndryshme, interpretimin dhe përqasjen ndërmjet tyre. Gjithashtu ofron mundësi të përdorimit të këtij materiali për mësuesit e gjuhëve të huaja, me qëllim realizimin e një prej objektivave themelore në mësimin e një gjuhe të huaj që është: kulturizimi.

MATERIALET DHE METODAT

Materialet bazë janë fotografitë e gjeesteve të ndryshme sipas kategorive të përcaktuara më poshtë, realizimi i tyre.

Metoda konsiston në mbledhjen e materialit, klasifikimit të tij, kategorizimit dhe më pas ajo e përfaqëson, interpretimit, diferencimit të gjeesteve. Vijohet më tej me nxjerrjen e karakteristikave përkatëse dhe mesazhin që ato përcjellin duke vënë në pah përkimet apo jo ndërmjet gjeesteve për çdo komb.

1. Komunikimi gjestual

Të komunikosh do të thotë t'i bësh të tjerët pjesëmarrës të mendimeve personale nëpërmjet përcjelljes së një mesazhi, i cili një ide e përkthen në një shumësi shenjash. Një nga karakteristikat thelbësore që dallon njeriun si qenie njerëzore nga kafshët është padyshim aftësia e tij për të komunikuar oralisht. Sigurisht që ky punim nuk do të ketë si qëllim trajtimin e komunikimit oral jo se nuk ka vend për studime të mëtejshme por ne kemi parë më me interes një formë tjetër të komunikimit që është ai gjestual.

Komunikimi gjestual, në pamje të parë duket si diçka e vetvetishme të cilën njeriu e përdor në mënyrë të pakontrolluar dhe sikur ajo të ketë lindur me vetë qenien njerëzore. Është më se e ditur dhe e qartë që ky lloj komunikimi është shumë më i hershëm, madje ka teori që mbështesin hipotezën se komunikimi oral ka rrjedhur nga ai gjestual, ndaj dhe si i tillë ai është pjesë e strukturave konjitive të njeriut. Sipas një studimi të kryer në Yerkes National Primate Research Center të Atlanta-s tek primatët mbi përdorimin e gjeesteve, u vu re që "gjestet e përdorura në situata të ndryshme mbështeteshin kryesisht në përdorimin e dorës së djathtë për komunikim, pra dominonte hemisfera e majtë, ashtu siç ndodh edhe në komunikimin tek njerëzit" (2). Format e komunikimit kanë qenë fillimisht të tipit gjestual, të cilat gradualisht gjatë vijimit të zhvillimit filogjenetik janë gjeneruar në artikulacione të gjuhës së folur (3). Por, pavarësisht vjetërsisë apo domosdoshmërisë së njeriut për ta përdorur atë, ky lloj komunikimi ka nevojë të mësohet ashtu si

dhe komunikimi oral. Njeriu e mëson këtë lloj komunikimi në komunitetin ku ai bën pjesë dhe e përdor atë sipas normave që janë vendosur arbitrarisht nga vetë ky komunitet, i cili i bashkëndonë ato.

2. Kur përdoret komunikimi gjestual?

Komunikimi gjestual është i domosdoshëm dhe mjaft i nevojshëm sidomos në situata të veçanta:

- kur njeriu nuk ka mundësi të përdorë komunikimin oral;
- kur krahas komunikimit oral është i nevojshëm dhe shpjegimi gjestual;
- kur komunikimi oral ka nevojë të përforcohet nga komunikimi gjestual;
- kur komunikimi gjestual është shumë më shprehës se ai oral;
- kur ngjyrimi që i jep gjesti është shumë më domethënës se fjalët;
- kur nuk kemi nevojë për fjalë pasi gjesti e eliminon atë totalisht, apo kur fjala do të ishte shumë më e varfër se vetë gjesti.

Gjestet kanë paraqitur, paraqesin dhe do të paraqesin një mjet të jashtëzakonshëm për të shprehur mendimin, emocionet, dëshirat, pasionet etj. Sipas A. Mehrabian (4) përdorimi i gjeesteve zë pothuajse 55% të hapësirës së një mesazhi.

3. Cilat është semantika e gjestit të dorës OK?

Një shumësi gjestesh kanë përdorim të njëjtë pothuajse në të gjithë botën. Kështu buzëqeshja, lotët dhe përkëdheljet shprehin kudo gëzimin, hidhërimin dhe dashurinë e nuk mund të kenë një interpretim tjetër. Duket sikur ato kanë lindur me vetë njeriun. Por një shumësi tjetër gjestesh janë kontradiktore apo të panjohura, të cilat mund të çojnë në krijimin e situatave sa qesharake aq edhe të rrezikshme. Kështu, p.sh. gjesti i dorës, OK, është një gjest pozitiv në një pjesë të mirë të botës, ndërsa në vendet arabe ai është një gjest shumë ofendues dhe vulgar. Mosnjohja e tij mund të çojë në degjenerimin e një situatë komunikimi, kur të dyja palët nuk dinë se çfarë përfaqëson ai gjest për kombin tjetër.

Janë dy gjeeste në fakt në botën e politikës, që kanë shkaktuar dy gafat më të famshme: ajo e

Bush-it dhe e Klinton-it. Bushi me gishtin e madh të ngritur OK, po që në Manila, ai i korrespondon gishtit të mesit të ngritur lart, ndërsa Klinton, në Duma të Moskës bëri gjestin OK, por me gishtin e madh dhe tregues që formojnë një O, shenjë kjo që në vendet sllave domethënë “do t’ju.....” (5).

4. Tipologjia e gjesteve

Kështu gjuha e gjesteve varion nga kultura në kulturë dhe nga një vend në tjetrin, ashtu siç ndryshon dhe gjuha e folur. Gjestet mund të jenë të qëllimshme ose jo, kjo varet nga mënyra sesi i përdorim ne ato.

Ndarja, përcaktimi dhe tipologjia e gjesteve nuk është një detyrë e lehtë, pasi ashtu si dhe në gjuhën e folur, ku shumë fjalë vdesin dhe të tjera lindin përgjatë vijimit kohor, po ashtu edhe gjestet kanë një cikël jete, ku lindin dhe vdesin, por dhe lindin të tjera sërish, kjo pasi risitë që sjell koha kërkojnë lindjen e gjesteve të reja për të interpretuar fenomenet, konceptimet e reja. Për shembull në gjuhën politike (kështu shenja e dy gishtave lart V, që shpreh viktory apo fitore, ka hyrë në përdorim në vendin tonë pas viteve 90, apo zhdukja në pjesën më të madhe të përshëndetjes me grusht, rikthimi i përshëndetjes së mbretit Zog). Gjesti i nderimit të mbretit Zog nëse do bëhej me lëvizje do të tregonte ‘uri’ në Itali.

Ndërsa në gjuhën sportive (ekipi i Partizanit i mbiquajtur më vonë si Demat e kuq ka gjeneruar një simbol atë të brirëve të demave që përdoret nga tifozët). Por kjo e fundit në Itali (ku brirët janë simbol i djallit), nëse brirët mbahen lart do të thotë që të kanë tradhtuar, me brirë poshtë është një gjest supersticioz, që bëhet për të larguar të keqen, me brirë të drejtuar nga dikush apo nga diçka për t’i uruar një fatkeqësi. Pra, siç dhe mund të vëmë re vetëm një gjest mund të ketë interpretime të ndryshme në vende të ndryshme, por gjithashtu në kontekste të ndryshme dhe në pozicione të ndryshme ai mund të ketë një mori interpretimesh.

Në këtë punim do të përshkruhen gjestet e duarve të katër shteteve (Shqipëri, Itali, Spanjë dhe Francë) (6, 7, 8, 9). Kontakti i përditshëm që kemi duke qenë në një ambient ku fliten këto

katër gjuhë na bëri që të analizonim pikërisht gjestet tona pasi ndryshimet ndërmjet tyre, në disa, raste ishin të dukshme dhe në disa jo.

Gjestet e duarve që kemi marrë në shqyrtim janë ndarë sipas shpeshësisë së përdorimit që ato kanë në jetën e përditshme dhe sipas funksionit që ato kryejnë. Ato do të paraqiten me foto dhe të shoqëruara me shprehjet gjuhësore, nëse ka, dhe interpretimet përkatëse.







Klasifikimi është i tillë:


1. Raportet sociale
 - a) Takimet
 - b) Ndarjet
 - c) Dashuria
 - d) Qortimi
 - e) Aprovimi, përgëzimi / urimi, ngushëllimi
 - f) Kërcënimi
2. Ndjenjat dhe emocionet
 - a) Gëzimi / kënaqësia
 - b) Hidhërimi / dëshpërimi / shqetësimi
 - c) Aprovimi
 - d) Mërzia
 - e) Frika
 - f) Vlerësimi pozitiv / negativ / mesatar
 - g) Pakënaqësia
3. Kërkesa, pyetje dhe përgjigje
 - a) Kërkesa
 - b) Përgjigje pozitive / negative indiferente / dyshuese
4. Karakteristikat /cilësitë
 - a) Mençuria
 - b) Budallallëku
 - c) Kokëfortësia
 - d) Dinakëria
 - e) Fortësia
 - f) Brishtësia
5. Veprime të ndryshme që përfshijnë folësin dhe bashkëfolësin
 - a) Të afrosh
 - b) Të largosh
 - c) Të qetësosh
6. Supersticione
 - a) T’i urosh vetes fat
 - b) T’i largosh vetes fatkeqësinë
7. Materie

8. Nevoja fizike
9. Sharjet, talljet

Është e qartë që nuk mund të sjellim gjithë shumësinë e gjeve të klasifikuara si më sipër, por do sjellim disa prej tyre që i kemi konsideruar si më domethënës.

Gjesti	Si kryhet ai	Çfarë do të thotë
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Me fërkimin e gishtave me njëri-tjetrin (shq, fr, spa); 2. Me përplasjen e tyre (it.) 	<p>Shq: ata të dy janë bashkë, It: quei due sono d'accordo / quei due se la intendono ecc. Spa: los dos estan juntos. Fr: Ils s'entendent bien.</p>
 <p>Shq, it fr</p> <p>spa</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Heqja e një vije horizontale (shq, frengj, it) 2. Heqja e një vije vertikale (sp) 	<p>Shq: mrekulli, e përsosur Ital: perfetto, ottimo Spa: perfecto, que bien. Fr: parfait, excellent</p>

 <p>pelqimi dhe krenaqësia italiane</p> <p>guava/aguas de biber</p> <p>it</p>  <p>pelqimi/krenaqësia francoze-italiane</p> <p>al bacio/ottimo Delicieux, c'est une merveille, merveille</p> <p>fr</p>  <p>Pelqimi dhe krenaqësia spanjole</p> <p>¡GRACIAS! ¡DE RECHUPETE!</p>  <p>Spa</p> <p>shq</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Puthja e majave të gishtave të mbledhura (It, Fr,) 2. Lëpirja e majave të gishtërinjve (spa) 3. Rrotullimi i gishtit tregues mbi faqe (it) 4. Fërkimi barkut dhe lëpirja e buzëve (shq) 	<p>Shq: yll fare / mrekulli / e përsosur / shumë e mirë / sa e mirë!</p> <p>It: ottimo / perfetto / al baccio / da lecarsi i bafi!</p> <p>Spa: Que bien! Esta bien! Magnifico! Que maravilla!</p> <p>fr: délicieux, c'est une merveille!</p>
 <p>merca/darua franceze</p> <p>J'en peux plus/ j'en ai ras le bol!</p>  <p>Mercini! darua indiane</p> <p>(che toba/che toba), (he galle)</p> <p>Fr</p> <p>it</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e dorës mbi kokë. (fr) 2. Lëkundja e të dyja duarve përpara barkut me pëllëmbë nga lart. (it) 3. Heqja e një vije horizontale mbi ballë (spa, it,) 4. Vënia e gishtit tek maja e hundës (shq) 	<p>Shq: më ka ardhur në majë të hundës! / nuk duroj dot më!</p> <p>It: ne fin qui/ sono proprio stufo/ che barba/ che noia/ non ne posso più!</p> <p>Sp: Estoy hasta la coronilla. Estoy harta. No aguanto mas!</p> <p>Fr: Je n'en peux plus, j'en ai ras le bol!</p>

			
--	--	--	--

PËRFUNDIME

Bota që na rrethon i krijon kontaktet me ne nëpërmjet mjaft formave dhe mënyrave nga më të ndryshmet dhe të larmishmet. Një ndër to padyshim është edhe gjuha e gjesteve, ndaj për ta kuptuar sa më mirë dhe për të qenë të gatshëm dhe të hapur në mesazhet që kjo botë na përcjell dhe për të mos e ndjerë veten jashtë saj, por pjesë të pandarë, do të ishte më se e nevojshme njohja, interpretimi dhe përdorimi i një gjuhe siç është gjuha e gjesteve.

Përfundimet e nxjerra nga ky studim nxjerrin në pah:

- njohjen e pakët që kemi në këtë sektor;
- ndryshimet që qëndrojnë ndërmjet gjesteve të këtyre katër kombeve;
- ngjashmëritë;
- ndryshimet jo vetëm në gjeste, por edhe në shprehjet gjuhësore që ato i shoqërojnë;
- faktin që sa lehtë mund të biem pre e interpretimeve të gabuara, të cilat mund të sjellin situata keqkuptimi;
- që një gjest mund të paraqitet në të njëjtën formë dhe të ketë kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme;
- nevojën e hartimit të një fjalori gjestual, ku të përfshihen gjestet e një shumësie kombesh;
- nevojën për kërkime të mëtejshme, duke mos u ndalur vetëm në gjuhën e gjesteve të duarve;
- që duke qenë kjo një 'gjuhë' ka nevojë të mësohet, mund të hartohen module mësimi jo

vetëm për ata që merren me studimin e gjuhëve të huaja, por edhe për këdo që është i interesuar të njohë fqinjin e tij në fshatin global, ku ai jeton dhe komunikon.

BIBLIOGRAFIA

1. COELHO, P., (1996), *L'alchimista*, Edizioni Bompiani, Milano.
2. MEGUERDITCHIAN, A., VAUCLAI, J., HOPKINS, D. (January 2010), "Captive chimpanzees use their right hand to communicate with each other: Implications for the origin of the cerebral substrate for language", *Cortex*, Volumi 46, 1, B, Elsevier, Itali.
3. GENTILUCCI, M., CORBALLIS, M. C. (2006) From manual gesture to speech: A gradual transition, in «*Neuroscience and Biobehavioral Reviews*», 30, fq 949-960.
4. MEHRABIAN, A. (1972). Nonverbal communication. Cole J.K. (Ed.), *Nebraska symposium on motivation*, 1971: Vol. 19.). Lincoln, NE: University of Nebraska Press. fq. 107-161;
5. BALBONI, P., P. (1999) *Parole comuni*, Culture diverse. Guida alla comunicazione interculturale, Venezia, Marsilio Editore, fq.45;
6. POGGI, I., MAGNO CADOGNETTO, E. (1994), *Il gestionario: un dizionario dei gesti simbolici italiani*, "Quaderni del Centro di studio per le ricerche di fonetica", 13, fq. 375-404.

7. DIADORI, P., (1990) Senza parole. 100 gesti degli Italiani, Bonacci editore, Roma.
8. COLL, J., GELABERT, Ma J., MARTINELL, E., (1990), Diccionario de gestos con sus giros más usuales., Madrid: Edelsa.
9. CESTERO, Ana María (1999), Comunicación no verbal y enseñanza de lenguas extranjeras. Arco Libros. Madrid.

STATE AND THE LITERARY SCIENCE IN CONTEXT OF GLOBALISATION SHTETI DHE SHKENCA LETRARE NË KONTEKSTIN E GLOBALIZMIT

ARBEN HOXHA
Instituti Albanologjik, Prishtinë, Kosovë
E mail: arbenhoxha69@yahoo.com

AKTET IV, 4: 640 - 644, 2011

PERMBLEDHJE

Në epokën moderne shteti me komponentët e tij nuk përbën vetëm subjektin veprues në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe një forcë bazike organizimi dhe orientimi të energjive njohëse dhe të dijeve në shërbim të riciklimit dhe maksimalizimit të potencialeve të bazës së vet materiale. Në qoftë se komponenta e bazës materiale dhe e institucioneve të shtetit përcaktohet prej politikës, aspekti emocional i tij përcaktohet prej sociale, e cila mund t'i paraprijë komponentës së bazës materiale dhe institucionale të tij. Në kumtesën tonë do të përqendrohemi në analizimin e rolit të shteti në punë të integritit të produkteve që vijnë nga "popullsia" shqiptare, si element i komponentës së bazës materiale të shtetit; dhe në përcaktimin e rolit të tij për krijimin e fizionomisë epistemologjike në shkencën letrare shqiptare - si element i aspekti emocional të tij – me qëllim që letërsia shqipe të trajtohet si letërsi e njësishe.

Fjalët çelës: shteti, shkenca letrare, globalizmi, liberalizmi, metodologjia, teoritë.

SUMMARY

In modern time state with its components is not only operating entity in the system of international relations, but also a basic force of energy organization and cognitive orientation and knowledge in the service of recycling and maximization of its potentials of material base. If the components of the base material and of state institutions is determined by politics, its emotional aspect is determined by social aspect, which may precede the component of its material and institutional base. In our paper we will focus on analyzing the role of the state to work to integrate products that come from the Albanian "population", as an element of the material base component of the state, and in defining its role for creating the epistemological physiognomy of Albanian science literature - as an element of the emotional aspect of it - in order to be treated as unique Albanian literature.

Key Words: state, literary science, globalism, liberalism, methodology, theories.

HYRJE

Në qoftë se veprimi i organizuar është produkt i mendimit të organizuar, atëherë mund të themi se shkenca e organizuar është produkt i një forme cilësore organizimi të shoqërisë njerëzore. Që në antikitetin e lashtë grek, një nga format më domethënëse dhe më të larta të organizimit të shoqërisë njerëzore do të konsiderohet organizimi politik i tij në shtet. Krijimi i modeleve të shteteve në mendje fillon me kërkimin e arsyes së krijimit të shtetit. Përgjigja në pyetjen se "pse duhet shteti?", përbën përgjigjen paradigmatiche

për krijimin e modelit të shtetit. Në veprën e vet "Shteti", Platoni shprehet: "Kujtoj se shteti krijohet sepse secili prej nesh nuk i mjafton vetvetes por kërkon shumë gjëra" (Platoni, 1980:89).

Premisa për pamjaftueshmërinë e qenies njerëzore në vetvete Platonin e shpjen te konkluzioni se shteti është një e mirë e përgjithshme dhe kusht i domosdoshëm që njeriu (individi) ta kalojë kufizueshmërinë e vet partikulare.

Hajdegeri, ndërkaq, duke pasur parasysh modelin e polisit platonian, polisit e konsideron themel ontologjik të Dasein-it, apo “vendi i të ndodhurit historik” të Dasein-it. Sipas Hajdegerit, polisi, është vend politik ku gjithë anëtarët hyjnë në relacion me njëri tjetrin (Heidegger, 2000:162). Në polis Qeniesimi (Dasein-i) fillon të shfaqet si Qenie e hapur për qeniet e tjera dhe në relacion me qeniet tjera. Polisi është vendi ku Qeniesimi (Dasein-i) e realizon veten.

Shtetit: raporti i politikës me socialen

Për ndryshim nga përpjekjet metafizike të Hajdegerit që t’i përcaktojë kufijtë ontologjik të shtetit, filozofia politike moderne kufijtë e natyrës së shteti i vështron në një rrafsh konkret të organizimit të jetës shoqërore. Në epokën moderne, shteti me komponentët dhe elementët e tij: bazën materiale (territorin, pasuritë natyrore, popullsinë, etj.); institucionet apo instrumentet e tij (parlamentin, qeverinë, gjykatat, policinë, ushtrinë etj.); dhe aspektin emocional: artin, kulturën, historinë, shkencën, ideologjinë, etj. (Buzan, Barry, 1991:57-96); nuk përbën vetëm subjektin themelor në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe një forcë bazike organizimi dhe orientimi të energjiive njohëse dhe të dijeve në shërbim të riciklimit dhe maksimalizimit të potencialeve të bazës së vet materiale.

Në qoftë se elementët e bazës materiale dhe të institucioneve të shtetit përcaktohen prej komponentës së *politikës*, aspekti emocional i tij – i cili e bën atë të dalloj prej bashkësive të tjera politike – përcaktohet prej komponentës së *sociales*.

Varësisht prej përkufizimeve që do t’ua bëjnë doktrinat filozofiko-politike marrëdhënieve të këtyre komponentëve (politikës dhe socialës) për krijimin e shtetit, do të përcaktohet natyra e shtetit dhe fuqitë e shtrirjes të kompetencave dhe vlerave që ai ndanë me anëtarët e tij.

Thida Skocpol, në veprën e saj “Shtetet dhe revolucionet sociale”, e bën dallimin ndërmjet revolucioneve politike dhe atyre sociale. Sipas saj revolucionet politike (politikja) mund të ndikojë në ndryshimin e strukturës së shtetit, por jo edhe

në strukturën sociale të tij, ndërkaq revolucionet sociale medoemos do të sjellin ndryshime në strukturën politike dhe në vet strukturën e shtetit. Përfundimisht ajo është e mendimit se ndryshimet themelore në strukturën shoqërore dhe në strukturën politike ndodhin së bashku dhe në mënyrë reciprokisht përplotësuese, dhe këto ndryshime ndodhin përmes konflikteve intensive sociopolitike (Skocpol, Theda, 1979:4-5). Pra, ashtu sikur që shteti vepron në drejtim të komponentëve të tij, janë strukturat e komponentës sociale dhe ato të politikës që, të bashkërenditura dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën, veprojnë në strukturën e shtetit.

Niveli i organizimit dhe funksionimit të strukturës emocionale, si përbërës i strukturës së shtetit, është tregues i nivelit të organizimit dhe funksionimit të strukturës materiale të tij (territorit, popullsisë, institucioneve politike e qeverisëse etj.). I tillë çfarë është organizimi i një bashkësie njerëzore në shtet i tillë do të jetë edhe niveli i organizimit i institucioneve shkencore dhe të vet shkencës në atë shtet.

Në qoftë se themi se struktura shtetërore është e pandarë nga formati kulturor dhe shoqëror, mund të thuhet se ndërlidhja e komponentës së socialës me politikën dhe strukturën e shtetit, gjithashtu është e pandarë nga ndërgjegjja kolektive subjektive e një bashkësie njerëzore. Është struktura subjektive e ndërgjegjes kolektive e një bashkësie, e cila me ndërhyrjen e saj në strukturën sociale dhe në strukturën e politikës mund të krijojë konfigurime të reja në strukturën e shteti që shkojnë në dobi të domosdoshmërisë së përbushjes së nevojave imediate të bashkësisë, siç është nevoja e të qëniti i lirë, apo të formimit të shtetit sovran kombëtar.

Për ta kuptuar më drejtë rolin përcaktues të ndërgjegjes kolektive subjektive në krijimin e marrëdhënieve të reja ndërmjet komponentës së socialës dhe politikës në punë të krijimi të formatit dhe modelimit të strukturës së shtetit, mjafton të rikujtojmë angazhimin e kolonive shqiptare gjatë periudhës së Rilindjes së Kombëtare. Kolonitë shqiptare – si përmasë e socialës dhe si aspekt emocional i shtetit – gjatë kohës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare do të

jenë gjenerator të luftës për liri, të idealit të kombformimit dhe krijimit të shtetit kombëtar shqiptar. Ato do të krijojnë, kultivojnë dhe do të përpiqen të shpërndajnë idenë për kulturën e përbashkët dhe vlerat autentike të popullit shqiptar të të gjithë anëtarët që e përbëjnë atë.

Shteti, arti dhe epistemologjia letrare

Qëndrueshmëria e një forme organizimi politik, siç është shteti, sipas Platonit përcaktohet prej asaj se si përkufizohet *njohja* e të mirës dhe së keqes.

Sipas Aristotelit bashkësia, si prodhim spontan natyror, është e pa përkryer dhe jo e plotë. Është *arti* dhe *njohja* që asaj (bashkësisë politike) i japin domethënie simbolike dhe identitet. Përplotësimi i natyrës, sipas Aristotelit, realizohet nëpërmjet mimesisit, jo në kuptimin platonian të kopjimit (të botës së ideve), por si reproduktim kreativ i realitetit (Aristoteli, 1984:12). Bashkësia identifikohet me atë që për të është mimesis (reproduktim) dhe që arrin ta përplotësojë dhe ta përsosë natyrën e saj, dhe njëkohësisht e bën atë të dallojë prej bashkësive të tjera. Prandaj, nuk është e rastit që shteti me anë të metodave dhe institucioneve të standardizuara, lufton për “ngulitjen në popullatë të vlerave, diturisë dhe pozicionimeve “autentike”” (Smith D., Anthoni, 2008:102).

Nëpërmjet elementit emocional, shtetet – me qëllim që të krijojnë homogjenitetin, kohezionin e brendshëm dhe vazhdimësinë e vet në rrjedhën kohore – janë përpjekur dhe vazhdojnë në përpjekjet e tyre sot, që t’i formësojnë tiparet e identitetit kombëtar me të cilat identifikohet popullata që është e përfshirë në të dhe anëtarë e saj që janë jashtë tij, por që njësohen me ato tipare (shih. Smith D., Anthoni, 2008: 103-104).

Në historinë e zhvillimit të kombit shqiptar dhe në përpjekjet e tij për realizimin e shtetit kombëtar, letërsia do të jetë një nga mediumet më konsekuente të manifestimit të të tipareve të identitetit kombëtar dhe aspiratës së kombformimit dhe shtetformimit kombëtar.

Epistemologjia letrare, si refleksion për letërsinë dhe si një nga elemente e komponentës emocionale të shtetit (bashkë me artin letrar, me

arsimin dhe kulturën në përgjithësi), do të luaj një rol të rëndësishëm në drejtim të rritjes së mundësive për të depërtuar dhe zgjeruar përmbajtjen e vetëdijes sociale e politike të popullit shqiptar me idenë për përkatësinë e përbashkët kombëtare; të krijojë vetëdijen dhe bazën për kohezionin e një shoqërie moderne shqiptare.

Shtrohet pyetja si reflektohet sot struktura e shtetit në strukturën epistemologjike letrare shqipe, si element i komponentës sociale të tij?

Në kohën e globalizmit të sotëm, prirja për “decentralizimin” dhe “policentrizmin” i institucioneve shkencore shqiptare mund të themi se nuk është produkt i zhvillimeve cilësore sociale, as produkt i zgjerimit të strukturave politike, si përbërës të strukturës shtetërore kombëtare shqiptare, por produkt i anarkisë së elementeve të komponentës politike e sociale, që gjenerohet prej qëndrimit konfuz, të shumtën edhe mohues, ndaj idealit të shtetit kombëtar shqiptar. Kaosi institucional rreth idesë së shtetit kombëtar, do të prodhojë edhe kaosin institucional shkencor në Shqipëri dhe Kosovë; kaosi institucional shkencor është e natyrshme që të prodhojë edhe kaosin epistemologjik letrar, në rrafshin gnoseologjik, e sidomos në atë aksiologjik.

Në varësi të pozitës që refleksioni për letërsinë do të marrë midis konceptit të lirisë në njërin, dhe konceptit teoriko-letrar për të vërtetën dhe vërtetësinë e të qenit të letërsisë shqipe si letërsi e njësishe dhe pjesë unike-përbërëse e identitetit kulturor të kombit shqiptar, në anën tjetër, shkencën letrare shqiptare – që nga vitet ’80-të dhe, në mënyrë të veçantë, pas përfundimit të botës gjeopolitike bipolare – do ta shoqërojë ideali i trajtimit integralist të letërsisë dhe ideali i trajtimit partikularist. Në qoftë se prirja integraliste në shkencën letrare shqipe do të operojë me kategorinë kulturore të etnisë dhe kombit, si përmasë e realitetit të identitetit kombëtar, prirja e partikulariste do të operojë me kategorinë e territorialitetit, si përmasë e identitetit material të shtetit, në të cilat do të ndodhen pjesë të shkëputura të kombit.

Pra territori, si element i komponentës së bazës materiale të shtetit, si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë, do të bëhet kriteri përcaktues i trajtimit të produksionit letrar shqiptar.

Në qoftë se dje koncepti i autonomitetit të artit prej “partikularistëve imanentistë” do të afishohet në emër të deideologjizimit të tij (shih, *Vox clamantis in deserto*, 1971), sot, duke kontrabanduar konceptin teorik të “qarqeve kulturore” – që bazohen në tre faktorë të pozitivizmit natyralist-esencialist: faktorin e mjedisit, e racës dhe të frymës – të njëjtit synojnë të krijojnë një “identitet të veçantë letrar kosovar”, në funksion të konstituimit të të ashtuquajturit “identitetit të kombit kosovar”. Pra territori, si element i komponentës së bazës materiale të shtetit, si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë, do të bëhet kriteri përcaktues i trajtimit të produksionit letrar shqiptar.

Duke i dhënë përparësi territorialitet, si element përbërës të komponentës materiale të shtetit, sot studentët në departamentin e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, në Fakultetin Filologjik të UP të Prishtinës, mësojnë dy lloj romantizma shqiptar: romantizmin arbëresh dhe romantizmin shqiptar (!!!). Nesër mbase do të mësohet edhe “romantizmi kosovar”

Derisa në shkencën letrare evropiane e atë botërore sot flitet për periudhën postimanentiste të studimit të letërsisë, por edhe për mundësinë e unifikimit të dijeve dhe të disiplinave, herë duke u thirru në të arriturat më të rejtat të logjikës bashkëkohore, e herë duke i thirru në të arriturat e metodologjisë së hulumtimit shkencor, institucionet tona shkencore (si gjithnjë të vonuar në raport me botën) pretendojnë të hartojnë histori të letërsisë shqipe që bazohet në premisa të studimit imanent të letërsisë. (Shih. *Historia e letërsisë shqipe* 2010).

Në qoftë se dje totaliteti, si koncept dhe parim epistemologjik, do të përbëjë kriterin bazë të objektivitetit shkencor, sot si asnjëherë më parë atij i është shpallur luftë (!)(*Historia e letërsisë shqipe*, 2010:253). Pse tek ne “luftohet” totalitetit? Mos vallë për t’i shërbyer të vërtetës dhe objektivitetit shkencor, si parime epistemologjike?

Cilat janë qëllimet dhe efektet një strategji të tillë në praktikën e epistemologjisë letrare shqipe?

Tek ne luftohet totaliteti, si entitet epistemologjik, me qëllim që të rrënohen strukturat dhe funksionet e tij, të cilat i diktojnë konditat e marrëdhënieve të pjesëve të veçanta në raport me tërësinë. Me eliminimin e konditave që i përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëve në raport me tërësinë, ashtu krijohen kushtet “logjike” për nxjerrjen e një subjekti të caktuar veprues nga totaliteti i veprimeve të subjekteve të tjerë, që janë bashkëpjesëmarrës dhe bashkëveprues në të njëjtën materie, e cila formohet dhe shërben si ndërmjetësues ndërmjet tyre. Detotalizimi i tillë nuk ka për qëllim që të zotërohet procesi i totalizimit të njohjes në rrjedhën e vet. Me shkaputjen e subjektit prej materies në të cilën ai vepron në rrjedhën kohore dhe prej subjekteve të tjerë që e krijojnë totalitetin e materies në atë rrjedhë, synohet detotalizimi i vetë rrjedhës së totalizimit të njohjes. Në atë mënyrë pjesa merr statusin e tërësisë.

Duke manipuluar dhe duke e keqpërdorur – për nevoja politike dhe për nevoja klanore – idenë e modernizimit të shkencës letrare shqipe, dhe duke e vënë në qendër totalitetin, si pengesë të atij modernizimi, në praktikën e epistemologjisë letrare shqiptare, sot synohet të afirmohet dhe të përlligjet një ide politike: ideja e krijimit të kombit kosovar (*Historia e letërsisë shqipe*, 2010:151).

Struktura shtetërore, në këtë rast, bëhet përcaktuese e përmbajtjes së strukturës së ndërgjegjes subjektive epistemologjike, e cila vihen në funksion të mirëmbajtjes dhe forcimit të strukturës së saj (shtetit të Kosovës).

Mungesa e vullneteve subjekteve për ta tejkalluar situatën e mungesës së hierarkisë ndërmjet elementeve të komponentës së bazës material dhe asaj institucionale të shtetit kombëtar, në hapësirën e qenies shqiptare do të diktojë shkallën dhe mënyrat e dobësimit të aspektit emocional të tij, e kjo domethënë: dobësimit të fuqive për përthithjen dhe ndarjen e vlerave me të gjithë anëtarët e kombit shqiptar, pavarësisht kufijve se ku do të ndodhen ata.

PËRFUNDIM

E tillë çfarë është cilësia e organizimit të një bashkësie njerëzore në shtet, dhe cilësia e organizimit dhe funksionimit të elementeve dhe komponentëve të shtetit (bazës materiale dhe institucionale të tij) e tillë do të jetë cilësia e strukturës dhe funksionimit të elementëve të komponentës emocionale të tij, në këtë mes edhe të epistemologjisë letrare si element përbërës i saj, dhe anasjelltas. Format e organizimit të institucioneve shtetërore (qeveria, parlamenti, administrata shtetërore, gjykatat etj.) do ta përcaktojnë edhe formën e organizimit të institucioneve shkencore (instituteve shkencore, fakulteteve dhe departamenteve të tij etj.).

BIBLIOGRAFIA

ARENDR, Hanna (2002), *Origjina e totalitarizmit*, Dija, Prishtinë.
ARISTOTELI (1978), *Politika*, Rilindja, Prishtinë.
ARISTOTELI (1984), *Poetika*, Rilindja, Prishtinë.
BUZAN, Barry (1991), *People, States and Fear: An Agenda for international security studies in the Post-Cold War Era*, Londër, Harvester Weatshef.

FENOMENI i avangardës në letërsinë shqiptare, (aktet e seminarit shkencor, 2004), UT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë, Arbëria, Tiranë.

HAMITI, Sabri (2005), *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë.

HEIDEGGER, Martin (2000), *Intriduction to Mataphsics*, Yale University Press.

HISTORIA e letërsisë shqipe, (2010) – (Materialet e konferencës shkencore, 30-31 tetor 2009, Prishtinë) - ASHAK dhe ASHSH, Prishtinë.

PLATONI (1980), *Shteti*, Rilindja, Prishtinë.

SAID, Edward, (2009), *Orientalizmi*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë.

SKOCPOL, Theda (1979), *States and social revolutions*, Cambridge, Cambridge University Press.

SMITH D., Anthoni (2008), *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale*, Botimet Dudaj, Tiranë.

VOX clamantis in deserto, Rilindja (gazetë ditore), Prishtinë, datë 2.10.1971..

DIASPORA AND THE INITIATIONS OF ALBANIAN FOLKLORISTICS DIASPORA DHE FILLET E FOLKLORISTIKËS SHQIPTARE

ARBNORA DUSHI
Instituti Albanologjik, Prishtinë, KOSOVË
Email: arbnoradushi@hotmail.com

AKTET IV, 4: 645 - 649, 2011

PERMBLEDHJE

Fillet e folkloristikës shqiptare i hasim që në shek. XVII, me botimin e *Fjalorit latinisht-shqip* të Frang Bardhit në Romë, për të vazhduar më pas në shekullin XIX me veprat e Jeronim De Radës, Thimi Mitkos në Aleksandri, Zef Jubanit në Trieshtë, Spiro R. Dines në Sofje, Vinçenc Prenushi në Sarajevë etj. Botimet e folklorit në diasporën shqiptare vazhduan derisa dolën vëllimet e “Visareve të Kombit”, më 1937 me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, me ç’rast barrën e botimit të folklorit e morën mbledhësit dhe botuesit shqiptarë brenda në Shqipëri, e më pastaj edhe në Kosovë. Diaspora shqiptare pati një rol shumë të rëndësishëm në fillet e botimit të përmbledhjeve të para të folklorit, pasi që në një kohë kur në viset shqiptare ishte e pamundur të realizohej botimi i folklorit shqiptar, intelektualët shqiptarë që jetonin në diasporë e mundësuan të parët dokumentimin e vlerave të çmuara të tij.

Fjalët çelës: folkloristika, diaspora, mbledhësit e folklorit, botimet

SUMMARY

The initiations of Albanian Folkloristics we encounter in XVII century, with the publication of Latin-Albanian Dictionary of Frang Bardhi in Rome, than the works of Jeronim De Rada in Italy, of Thimi Mitko in Alexandria, of Zef Jubani in Trieste, Spiro Dine in Sofia, Vinçenc Prenushi in Sarajevo etc. Publications in the Albanian Diaspora folklore continued until began the volumes of “Visaret e Kombit” in 1937 on the occasion of 25th anniversary of Independence of Albania, where the burden of the publication of folklore collectors and publishers took the Albanians in Albania, as well as in Kosovë. Albanian diaspora had a very important role in the initiations of the first publication of collections of folklore, as in a time when the Albanian areas was impossible to realize the publication of Albanian folklore, Albanian intellectuals living in the Diaspora enabled the first documentation of values of its products.

Key Words: Folkloristics, Diaspora, Folk-collectors, publications, Albanian culture

1. HYRJE

Termi diasporë bart në vete kuptimin e zhvendosjes, pra të zhvendosjes së popullsisë që e gjen veten për çfarëdo arsye të ndarë nga territori i vet kombëtar dhe që zakonisht njerëzit e saj kanë shpresë, ose të paktën një dëshirë, për t’u kthyer në atdheun e tyre një ditë, pra veçoria e njerëzve të diasporës, të cilët jetojnë të shkëputur nga atdheu është se ata vazhdojnë të mbajnë një marrëdhënie të ngushtë me vendin e origjinës (Waldman, 2010). Po e theksojmë këtë,

pasi që jo çdo lëvizje migruese apo koloni e emigrantëve mund të quhet diasporë. Termi nënkupton qartë lidhjet kulturore dhe kthimin në vendin e origjinës në një të ardhme.

2. Diaspora e hershme shqiptare dhe fillet e vetëdijes për vlerat e kulturës kombëtare

Lëvizjet e popullsisë shqiptare historia i njeh që në origjinën e saj dhe të tillat i kanë përcjellë së pari ilirët dhe pastaj shqiptarët gjithmonë. Motivet e këtyre migrimeve ishin nga më të

ndryshmet, duke filluar nga luftërat e pushtuesve, të cilat qenë mjaft të shpeshta në këto vise, motivet ekonomike, sociale e motive të tjera, të cilat i kanë shtyrë shqiptarët të kërkojnë kushte më të mira jetese. Mirëpo, siç thamë më lartë, gjithmonë popullata që ka emigruar, nuk ka pushuar "t'i mbajë sytë të kthyer pas, kah atdheu".

Ngaqë tema jonë lidhet me periudhën e zgjimit kombëtar të shqiptarëve, pra periudhën e Rilindjen Kombëtare, kur shqiptarët filluan të japin shenjat e para për një vlerësim të cilësive të veta kombëtare, vetëdije kjo që lidhet edhe me njohjen e vlerave të paçmuara deri atëherë të folklorit shqiptar, do të orientohemi në diasporën shqiptare që u formua nga emigrimi i popullsisë në periudhën e pushtimit osman, kohën pas vdekjes së Skënderbeut deri në kohën e Pavarësisë së Shqipërisë.

Me pushtimin osman dhe sidomos pas vdekjes së Skënderbeut, atdheu i shqiptarëve u trazua shumë dhe siguria e banorëve vendas u ndie shumë e rrezikuar. Kjo bëri që popullata vendase, sidomos ajo e krishterë, e cila e kishte problem pranimin e fesë së pushtuesit osman, u detyrua të emigrojë në vendet fqinje. Për t'i shpëtuar përdhunimeve dhe zhdukjes fizike një pjesë e popullsisë u detyrua të ngjitet në male, si mjedise më të mbrojtura, e të tjerë ikën në Greqi e në Jug të Italisë. Këto migrime i përkasin shek. XV, e përgjithësisht shek. XVI-XVII (Tirta, 1999). Nga kjo kohë sot vazhdojnë të jetojnë në ato troje, arbërorët në Greqi dhe arbëreshët në Itali e Kroaci.

Në anën tjetër, shqiptarët myslimanë, emigruan nga zonat ku shtrihej dominimi i pushtuesit grek, të cilët ushtruan represion ndaj popullatës myslimane, duke e detyruar të shpërngulen në Turqi. Në Turqi shqiptarët emigruan edhe për të zënë punë, si dhe ngaqë shumë shqiptarë shërbenin në ushtrinë dhe administratën osmane, siç e vë re edhe Sami Frashëri në veprën e tij (Frashëri, 1978). Por edhe më pas, gjatë kohës së Rilindjes, migrimi i shqiptarëve për nevoja ekonomike u dendësua si asnjëherë më parë. Shqiptarët vazhduan të emigrojnë në Turqi, Greqi e Itali, që ishin vendet fqinje dhe që i

lidhnin edhe përvojat e emigrantëve më të hershëm të periudhave të mëhershme, por ata emigruan edhe në Rumani, Bullgari, Egjipt, Rusi dhe më pas edhe në Amerikë e Australi.

Duke qenë se numri i shqiptarëve në mërgim po rritej, por edhe duke qenë se shumë prej tyre kishin ikur për shkaqe politike, për t'i shpëtuar represionit osman, largimi nga atdheu ishte bërë nën rrethana dhune e detyrimi. Ata, të pashkëputur me mendje e zemër nga familjet e veta dhe nga atdheu, filluan të organizoheshin nëpër grupe e shoqëri dhe të zhvillonin veprimtari nëpërmjet të cilave mendonin të rregullonin sistemin dhe shoqërinë në vendin e tyre. Sidomos që nga Lidhja e Prizrenit (1878) e këtej, u formuan shoqëri atdhetare kudo ku kishte grupime shqiptarësh në diasporë. Kështu, shqiptarët, sipas organizimeve që bënë, u grupuan nëpër koloni dhe historia sot i njeh veprimtaritë atdhetare të kolonisë së Stambollit, e cila edhe ishte më e madhja, të kolonisë së Bukureshtit, të Sofjes, të Egjiptit (Tirta, 1999).

Pothuajse që të gjithë mërgimtarët, merreshin me punë fizike në vendet ku kishin mërguar, por disa prej tyre arritën të bëjnë edhe shkolla, siç është rasti me vëllezërit Frashëri, Jeronim De Radën, Jani Vreton, Zef Jubanin, Koto Hoxhin; dhe kështu në kontakt me kulturat dhe edukimet e huaja, natyrisht edhe ngaqë ishin larg vendit të tyre për të cilin iu dhembte zemra se e kishin lënë të pushtuar, filluan të mendojnë për ngritjen arsimore e për zhvillimin e vetëdijes intelektuale të tyre dhe të bashkatdhetarëve në atdhe.

Synim i tyre i rëndësishëm mbetej hapja e shkollave, shkrimi dhe botimi i librave, gjë për të cilën e rëndësishë së parë ishte themelimi i Alfabetit shqip, përpjekje për të cilat u angazhuan Shoqëria e Stambollit, Drita e më vonë Dituria e Bukureshtit, derisa nuk u koordinuan në Kongresin e Manastirit më 1908 me miratimin e Alfabetit që e kemi edhe sot. Këto shoqëri, nëpër të cilat u organizuan shqiptarët gjatë periudhës së Rilindjes, nxorën edhe gazetatat e tyre, kulturore e politike, në të cilat shkruanin në shqip, por edhe në gjuhët e vendeve ku jetonin dhe vepronin.

Mërgimtarët shqiptarë, preokupim kryesor kishin rimëkëmbjen e Shqipërisë në të gjitha fushat, por, sigurisht që, parësore e kishin arsimin dhe edukimin. Veçanërisht për këtë u dallua Shoqëria Italo-Shqiptare në Itali (Skendi, pa vit botimi), pra e arbëreshëve të Italisë e cila përbënte diasporën më të hershme shqiptare, por dhe e cila gëzonte njëfarë lirie të veprimtarisë në Itali, më tepër se që i lejohej diasporës shqiptare në Greqi, arbërorëve, të cilët po ashtu moti ishin larguar nga atdheu.

Arbëreshët e Italisë, kishin arritur të bënin shkolla në Itali dhe në kohën e Rilindjes Kombëtare përfaqësonin breza të tërë shqiptarësh, të cilët ishin edukuar nga brezat e mëparshëm me mallin për atdheun që e kishin braktisur. Madje, ata kishin themeluar edhe dy institucione arsimore shqiptare: (a) *Kolegjin italo-shqiptar* të shën Mitrit në Shën Mitër Koronë të Kalabrisë; dhe (b) *kolegjin e Palermos*, ku mësohej gjuha shqipe” (Skendi, pa vit botimi). Tek Arbëreshët e Italisë u shfaq një literaturë me prirje kombëtare, rreth mesit të shekullit XIX. Këta njerëz gëzonin në Itali liri kulturore dhe ishin më të ekspozuar ndaj ideve perëndimore të iluminizmit dhe të atyre kombëtare sesa shqiptarët në mëmëdhenë e tyre” (Skendi, 2000).

3. Fillet e folkloristikës shqiptare

Me folkloristikë nënkuptohet puna për mbledhjen, botimin dhe studimin e folklorit. Sigurisht se faza e saj e parë është mbledhja e krijimeve folklorike në terren dhe kjo fazë e shënon vetëdijen e ngritur të pjesëtarëve të popullit, për vlerat e folklorit kombëtar.² Kjo fazë në Evropë u paraqit tek shumë popuj në fund të shekulli XVII dhe fillim të shekullit XIX, kur edhe

te shqiptarët e vërejmë si një vetëdije që po zhvillohej. Mirëpo, shumë para kësaj kohe, shenja të qarta të interesimit për krijimtarinë popullore gjejmë që në shekullin XVII, kur kleriku Frang Bardhi, nga Zadrima, i shkolluar në Itali, boton në Romë, *Fjalorin latinisht – shqip* (1635) dhe aty i përfshin edhe 113 proverba shqiptare (Zheji, 1998).

Më pas prifti arbëresh nga Kieuti, Nikollë Filja, në një dorëshkrim të zbuluar më vonë shënon 18 këngë popullore, disa prej të cilave janë këngë legjendare dhe dorëshkrimi e mban datën 19 nëntor 1737 (Zheji, 1998). Giuseppe Crispi, një shqiptar tjetër nga Sicilia botoi një libër me kujtime në Palermo më 1853 dhe aty përfshiu disa përkthime të këngëve popullore shqiptare (Skendi, pa vit botimi). Më 1866 gjuhëtari arbëresh Dhimitër Kamarda botoi në Prato (Itali) një libër gramatike dhe në shtojcë të tij përfshiu edhe një numër të konsiderueshëm këngësh popullore nga Kalabria e Sicilia si dhe nga ngulimet e arbërorëve në Greqi. Në të njëjtin vit profesori nga Kolegji arbëresh në Kalabri, Jeronim De Rada, në Firencë, botoi librin *Rapsodi të një poeme arbëreshe (Rapsodie di un poema albanese)*, ku i publikoi 72 këngë popullore nga ngulimet arbëreshe në Napoli, të shoqëruara me përkthimin italisht (Skendi, pa vit botimi). Kjo konsiderohet vepra e parë e madhe me të cilën fillon mbledhja e mirëfilltë e folklorit shqiptar (Zheji, 1998).

Më 1871, Zef Jubani, shkodran, sekretar i konsullit francez në Shkodër, Hekardit, nëpërmjet veprës së këtij të fundit për Shqipërinë e Epërme, që u botua në Paris më 1858, botoi 12 këngë shqiptare të përkthyer në frëngjisht. Mirëpo, Zef Jubani, më 1871 në Triestë botoi në origjinal këngët shqipe me përkthimin e tyre italisht në veprën *Raccolta di canti popolari e rapsodie albanesi*, në të cilën përfshiu këngë që këndoheshin në qytetin e Shkodrës (Hecquard, 2008).

Përderisa veprat e mësipërme, që shënojnë filltet e folkloristikës, botoheshin në Itali me alfabetin latin e me përkthime italisht dhe paraqisnin folklorin arbëresh apo atë të zonave veriore të Shqipërisë (Zef Jubani), vepra që pason shënon

² Duke filluar nga viti 1961, Instituti i Folklorit në Tiranë, botoi në tetë vëllime tërë materialin e hershëm të folklorit shqiptar të botuar nga mbledhës shqiptar në diasporë, por edhe nga mbledhës jo shqiptarë, të cilët shërbyen si misionarë në periudha të caktuara në Shqipëri dhe me atë rast publikuan lëndë nga folklori i pasur shqiptar. Tri vëllimet e para përfshijnë lëndën e publikuar që nga proverbat e Frang Bardhit e deri te Pavarësia e Shqipërisë. Kjo kollanë titullohet *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635 – 1912)*, I-VIII.

ndikimet nga një kulturë tjetër. Emigranti Thimi Mitko nga Korça, i cili jetonte në Egjipt dhe ishte pjesëtar i Kolonisë shqiptare të Egjiptit, më 1878, e botoi në Aleksandri përmbledhjen e këngëve popullore me shkronja greke, nën titullin *Alvanike melissa – Bleta shqiptare*, në të cilën përfshiu shumë këngë lirike dhe legjendare, nga të cilat 97 janë në dialektin e toskërishtes dhe 26 në atë të gegërishtes (Hecquard, 2008). Sipas kollanës *Mbledhës të hershëm të Folklorit shqiptar*, ku botohen të transkriptuara dhe të transliteruara dorëshkrimet dhe botimet e mbledhësve të parë të folklorist shqiptar, nën numrin II të kësaj kollane, e cila përfshin veprën *Bëletën shqiptare* të Mitkos, përmbledheshin fjalë të moçme, fjalë t'errëta (gjëegjëza), të përshëndoshura, emra vetjakë, këngë të vjetra (alegorike dhe për të qeshur), këngë që këndohen në disa ditë të caktuara, këngë shqype dasëmored, këngë shqype jaranishte, gegërishte, këngë shqype trimërishte, këngë trimërie gegërishte dhe 12 përralla shqype. Me këtë vepër Thimi Mitkoja konsiderohet mbledhësi i parë i mirëfilltë i folklorit shqiptar (*Mbledhës të hershëm*, 1961).

Një vepër tjetër që vazhdon të shënojë vazhden e fillimeve të botimeve folklorike e që botohet gjithashtu nga një pjesëtar i kolonisë së shqiptarëve në Egjipt është ajo e atdhetarit Spiro Dine, *Valët e detit*, e botuar më 1908 në Sofje. Dineja ishte nga Vithkuqi i Korçës. Ai herët kishte emigruar në Egjipt. Njihej me Thimi Mitkon dhe i kishte ndihmuar atij në mbledhjen e këngëve të *Bletës shqiptare*. Edhe për botimin e veprës së tij, siç shprehet në parathënie, Dinos i kishin ndihmuar të tjerë shqiptarë që ia dinin vlerën dokumentimit të folklorit (*Mbledhës të hershëm*, 1962). Ai ishte inspiruar nga puna e Mitkos dhe më pas kishte vazhduar ta bënte këtë punë edhe vetë, pasi që ndër mërgimtarët, të merreshe me mbledhjen e folklorit, konsiderohej një vepër shumë atdhetare, se nëpërmes dokumentimit të vlerave të folklorit shqiptar ata konsideronin se po i sillnin një nder të madh atdheut dhe me këtë e plotësonin edhe mungesën e tij që e ndienin në mërgim. Folklorin e mbledhnin nga shqiptarët e mërguar, të cilët ishin të shumtë në viset ku ata jetuan. Vepra e Spiro Dines përmban këngë

trimërishte, vajtime, këngë dashurie, zakone, këngë dasme, fjalë të urta e përralla nga të dy dialektet.

Një vepër tjetër e vazhdës së botimeve të hershme folklorike në diasporë është vepra e françeskanit Vinçenc Prenushit, *Kangë popullore gegnishte*, e botuar në Sarajevë më 1911. Ky botim përfshin 276 këngë popullore (132 këngë trimërie, 109 valle, këngë dasme, dashurie dhe 35 këngë fëmijësh). Materialet e mbledhura prej tij ishin nga zonat e Veriut, qyteti i Shkodrës me krahinat përreth dhe një pjesë nga Gjakova e Peja në Kosovë, për të cilat thuhet se i janë dërguar nga Shtjefën Gjeçovi dhe nga miq të tjerë (*Mbledhës të hershëm*, 1962). "Prenushi nuk mblodhi këngë kreshnikësh, meqë i quante të rrjedhura nga folklori serb dhe kjo pa të drejtë" (Zheji, 1998). Prenushi u burgos nga diktatura dhe vdiq nën torturë në moshën 63 vjeçare më 1949 në burgun e Durrësit.

PËRFUNDIM

Diaspora shqiptare, e lidhur shumë me gjendjen politike, sociale e ekonomike në Shqipëri, vazhdoi të ndjejë çdo lëvizje që bëhej dhe që e bënin në drejtim të përmirësimit apo edhe të përkeqësimit të situatës. Aktivitetet e saj politike e kulturore nuk shteruan. Ata në forma dhe mënyra të ndryshme organizimi vazhdimisht e shprehën lidhjen e tyre të pashkëputur me vendin amë. Aktivitetet e tyre janë të njohura në histori si edhe përpjekjet e mëdha për alfabetin e për hapjen e shkollave shqipe. Folkloristika shqiptare ndonëse me ndonjë botim të rrallë, ndoshta më tepër nga të huajt se nga shqiptarët jashtë, në vitet e mëvonshme filloi të nxjerrë publikime edhe në vend.

Me përcaktimin e Alfabetit pas Kongresit të Manastirit më 1908, filluan të dalin në sipërfaqe edhe data shpresëdhënëse për shqiptarët, përfshirë këtu lejimin e mësimi shqip në shkollat filllore dhe të mesme fetare. Kjo ishte një e arritur e madhe kur dihej se mësimi në shkolla deri atëherë bëhej me alfabetin arab. Pas shumë kryengritjesh në terren, por edhe kuvendesh e përpjekjesh të mëdha të kolonive shqiptare, politika e turqve të rinj, xhonturqve, qëllloi më

tolerante për shqiptarët dhe ata arritën të përfitojnë duke e shpallur Shqipërinë të pavarur nga Turqia.

Në vitet e mëpastajme edhe gjendja e botimeve të folklorit zë e forcohet. Botimet që pasojnë botohen në Shqipëri, kështu, më 1926 Marin Sirdani boton në Shkodër *Skanderbegu mbas gojdhana*, ku përmbledh këngë tradicionale të arbëreshëve të Italisë, në të cilat lartësohet Skënderbeu dhe heroizmat e tij. Më 1933 Kasem Taipi, po ashtu në Shkodër, boton *Zana Popullore – Këngë Popullore I*, Stavro Frashëri, më 1936 në Durrës botoi *Folklori shqiptar I*, një përmbledhje prej 33 këngësh legjendare, të cilat shoqërohen edhe me pjesën studimore. Mbledhësi është kujdesur që në veprën e tij të mos përfshinte këngë të botuara të Mitkos e Dines, çka tregon se botimet e diasporës njiheshin në Shqipëri (Skendi, pa vit botimi).

Pa dyshim se me botimet që pasojnë, *Visaret e Kombit*, folkloristika shqiptare e kalon fazën fillestare të punës me folklorin, pasi që këto vëllime tregojnë për një qasje serioze dhe të vëllimshme ndaj lëndës gojore. Françeskanët shkodranë, në Shkodër, me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë, më 1937-1939, botojnë materialet në katër vëllime këngët epike – këngë trimnive dhe kënge kreshnikësh – këngë nga cikli i Mujit dhe i Halilit, këngë lirike, këngë vajtimi, këngë djepi, balada dhe përralla (Zheji, 1998). Nën përkujdesjen e mbledhësve dhe studiuesve Karl Gurakuqi, Filip Fishta, Bernardin Palaj e Donat Kurti, folkloristika shqiptare merr udhë dhe

kështu ajo shqiptare hyn në përkujdesjen e institucioneve shtetërore dhe nuk vazhdon të botohet në diasporë. Pas më shumë se një dekade më vonë, edhe në Kosovë dalin botimet e para të folklorit shqiptar.

BIBLIOGRAFIA

- FRASHËRI, Sami (1978), *Vepra 2: Shqipëria ç'ka qenë' ç'është e ç'do të bëhet*, Rilindja, Prishtinë.
- HECQUARD, Hyacinthe (2008), *Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*, përkth. Oriana Tamburi, Plejad.
- MBLEDHËS të hershëm të folklorit shqiptar II (1635 -1912) (1961), Instituti i Folklorit, Tiranë.
- MBLEDHËS të hershëm të folklorit shqiptar III (1635 – 1912) (1962), Instituti i Folklorit, Tiranë.
- SKENDI, Stavro (pa vit botimi), *Poezia epike gojore e shqiptarëve dhe e sllavëve të jugut*, përkth. Xhavit Lloshi, Bota shqiptare, IDK, Tiranë.
- SKENDI, Stavro (2000), *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878 – 1912*, përkthyer nga Skënder Luarasi dhe Nestor Nepravishta, Phoenix @ Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Tiranë.
- TIRTA, Mark (1999), *Migrime të shqiptarëve: Etnografia shqiptare 18*, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë.
- WALDMAN, K. Peter (2010), *Radicalisation in the Diaspora: Why Muslim in the West Attack Their Host Countries (WP) 9/2010 – 15/3/2010*.
- ZHEJI, Gjergj (1998), *Folklori shqiptar*, Argeta – LGM, Tiranë..

ITALIANIZMAT E ARBËRESHËVE TË ITALISË SIPAS FJALORIT TË KAMSIT NË PËRQASJE ME ITALIANIZMAT NË GJUHËN SHQIPE

ORJETA BAJA, MERITA HYSA
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, SHQIPËRI
E mail: bajaorjeta@yahoo.com

AKTET IV, 4: 650 - 654, 2011

PERMBLEDHJE

Në këtë artikull vjen si objekt studimi shtresa e fjalëve të huazuara, nëpërmjet *Fjalorit arbërisht-shqip* të Kolë Kamsit, duke u ndalur posaçërisht tek fjalët italiane në leksikon e arbërishtes dhe duke i parë këto në rrafsh krahasimtar me italianizmat në gjuhën shqipe në përgjithësi. Takimi i të folmeve arbëreshe me italishten pas shpërnguljes nga Shqipëria, u bë në rrethana krejt të tjera, të cilat me kohë sollën edhe dygjuhësinë arbëresho-italiane, pastaj shumëkund edhe bjerrjen e plotë të gjuhës amtare, duke çuar kështu në përfitim të një varieteti gjuhësor më vete. Vepra *Fjalor arbërisht-shqip* pasqyron gjerë këtë proces gërryerjeje gjuhësore që kishte marrë udhë në të folmet arbëreshe. Artikulli ndihmon për çuarjen përpara dhe thellimin e studimeve në fushën e gjuhëve në kontakt dhe me njohjen e rrethanave gjuhësore arbëreshe ndihmon historinë e gjuhës shqipe për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth fazave të depërtimit të italianizmave në të folmet arbëreshe.

Fjalët çelës: arbërisht, dygjuhësi, italianizma, ndikim, variant (gjuhësor)

1. HYRJE

Brenda kufijve të një bashkësie shoqërore, vërehen grupe të ndryshme, qoftë nga përbërja gjuhësore, qoftë nga përkatësia etnike. I tillë është rasti i Italisë, që ka një trashëgimi të pasur gjuhësore e kulturore në këtë drejtim. Në fakt, në Itali gjenden dialekte e gjuhë minoritare të transplantuara prej kohësh në tërësinë e territorit. Disa janë prej shekujsh, si, p.sh.: helenofonët, gjermanofonët, sllavofonët, albanofonët a *arbëreshët*.

Kolë Kamsi, një nga ata dijetarë shqiptarë që u njoh qysh herët me botën arbëreshe të Italisë, i prekur nga ajo "mrekulli" e ruajtjes së gjuhës e traditave të moçme shqiptare në mjediset arbëreshe në Itali, vuri në fokus të veprimtarisë së vet shkencore mbledhjen e fjalëve, të frazeologjizmave e të folklorit arbëresh, duke dhënë kështu ndihmesën e tij në evidentimin sa më mirë të ruajtjes së shqipes në dhe të huaj. Duke hulumtuar dorëshkrimet dhe letërsinë arbëreshe të botuar e duke qëmtuar të folmet e

gjalla, Kamsi fiksoi forma fjalësh që atij i dukeshin të vlershme për t'ua vënë në dorë historianëve të gjuhës shqipe, si lëndë krahasuese për të hetuar etimologjinë apo fazat e hershme të strukturës fonetike e morfologjike të shqipes.

Qëkur ishte nxënës në Kolegjin Arbëresh të Shën-Mitër Koronës, ku pati për mësues edhe prof. dr. Aleksandër Xhuvani, djaloshi i ri nga Shkodra, pati rastin të dëgjonte nga goja e arbëreshëve të Shën-Mitrit, Maqit të folurën e tyre të ëmbël. Kjo ishte një gjë shumë tërheqëse për cilindo shqiptar që ndeshej me arbëreshët më shumë se pesë shekuj pas shpërnguljes së tyre në Itali.

Ky njohës i mirë i kulturës shqiptare në përgjithësi, por edhe i asaj arbëreshe në veçanti, shkroi shumë vepra të një rëndësie të veçantë për kombin shqiptar. Por, vepra e tij kryesore, së cilës iu kushtua për një kohë të gjatë dhe, që mund të konsiderohet si një dëshmi e gjallë dhe e pakundërshtueshme e vlerës së arbërishtes, që ***Fjalori arbërisht-shqip***, të cilin, prof. Eqrem Çabej do ta cilësonte si *më të mirin në këtë lëmë*.

2. Fondi i fjalëve të *Fjalorit të Kamsit*

Në këtë *Fjalor* prej rreth 8600 fjalësh, autori u ka dhënë përparësi fjalëve dhe formave që i ka ndeshur në veprat e botuara të autorëve arbëreshë, si dhe të lëndës folklorike që kishte në dorë deri atëherë. Natyrisht, ka përfshirë aty edhe fjalë që i ka dëgjuar vetë në mjediset arbëreshe, duke pasqyruar një leksik të dokumentuar me saktësi:



Grafik 1

Kamsi ilustron fjalët me citate origjinale e të zgjedhura, pa shtuar asgjë nga vetja, duke e bërë, kështu, *Fjalorin*, një mjet pune të sigurt për të gjithë shqiptarët, në mënyrë të veçantë për nxënësit, që të lexojnë dhe kuptojnë më me lehtësi letërsinë e pasur arbëreshe, folklorin e shkrimet e shumta të autorëve arbëreshë, por edhe për studiuesit e komentuesit e letërsisë arbëreshe në shpjegimin e fjalëve që janë bërë thujtë të pakuptueshme për lexuesin bashkëkohor.

Themi 'fjalë të pakuptueshme', sepse, në këtë vepër, kemi të ruajtur jo vetëm thesarin e trashëguar me fjalë shqipe, por edhe shumë fjalë të huazuara e fjalë të reja të krijuara sidomos me rrugën e kalkimit (për ta shpëtuar arbërishten sa ishte e mundur nga huazimet e panevojshme e për t'i ruajtur origjinalitetin), interferimi dendurisht i të cilave ka çuar në përfitim të një varieteti gjuhësor më vete.

3. Huazimet arkaike në të folmet e arbëreshëve

Objekt studimi kemi marrë pikërisht shtresën e fjalëve të huazuara, nëpërmjet *Fjalorit arbërisht-shqip* të Kolë Kamsit, duke u ndalur posaçërisht

tek ndikimi i atyre italiane (meqë kanë numrin më të madh) në leksikon e arbërishtes.

Të gjitha gjuhët kanë fjalë të huaja në leksikon e tyre, por në shqip (arbërisht) ato janë të shumta, si rezultat kryesisht i pushtimeve të ndryshme për një periudhë të gjatë. Kujtojmë këtu që gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e atyre (gjuhës dhe kulturës) latine, greko-bizantine, sllave e turke, duke lënë kështu në shqip fjalë me origjinë nga këto gjuhë. Takimi i shqipes me latinishten dhe me gjuhët romane (neolatine) kishte nisur që shumë shekuj para se të ndodhte shpërngulja e arbëreshëve nga Shqipëria. Gjurmët e takimeve të shqipes, qoftë me latinishten ballkanike, qoftë me latinishten letrare e me gjuhët e tjera romane i shohim në një numër të mirë latinizmash e italianizmash në këtë fjalor, si p.sh.: *turp/tyrp* (lat. turpis), *urdhër* (lat. ordo-ordine). Kjo shtresë fjalësh duhet dalluar nga huazimet dhe ndikimet e mëvonshme.

4. Huazimet e reja në të folmet e arbëreshëve

Përveç ndikimeve gjuhësore të vendeve pushtuese, të cilat i mbartën me vete, arbëreshët, të ndodhur në mjedisin e huaj italian, për të përballuar jetesën në dhe të huaj, krahas përfshirjes në popullsinë e një vendi që kishte tjetër gjuhë, nuk mund të mos pësonin edhe ndikimin nga italishtja dhe dialektet e saj. Takimi i të folmeve arbëreshe me italishten pas shpërnguljes nga Shqipëria, u bë në rrethana krejt të tjera, të cilat me kohë sollën edhe dygjuhësinë arbëresho-italiane, pastaj shumëkund edhe bjerrjen e plotë të gjuhës amtare. Është me rëndësi të theksojmë se *rrallë gjen ndër arbëreshët e Italisë dygjuhësi të përsosur*. Deri relativisht vonë *arbërishtja ka mbajtur kurdoherë vendin e gjuhës së parë, ndërsa italishtja ka mbetur gjuhë e dytë*.


Vepra *Fjalor arbërisht-shqip* pasqyron gjerë këtë proces gërryerjeje gjuhësore që kishte marrë udhë në të folmet arbëreshe dhe që pasqyrohet edhe në leksikon e shkrimtarëve arbëreshë. Në *Fjalor* ka shumë pak ose aspak fjalë turke (meqë si rezultat i pushtimit osman, arbëreshët u larguan nga vendi i tyre), të cilat, ndërkaq janë të

dendura në shqip, porse ka aq shumë italianizma që janë bërë pjesë e fondit leksikor të arbërishtes së Italisë.

Prof. Kolë Kamsi, jo vetëm e konstatoi këtë dukuri, por edhe e hetoi mjaft gjerë atë, duke u bërë vend në fjalor, krahas fjalëve shqipe, edhe aq shumë fjalëve (emra, folje, mbiemra) të huazuara nga dialektet italiane në ligjërimet e folura arbëreshe, apo nga italishtja letrare në gjuhën e shkrimtarëve arbëreshë: Në të vërtetë, kur ndodh të takohen një shqiptar dhe një arbëresh, pjesa e pakuptueshme *për arbëreshët* janë pikërisht fjalët turke dhe sllave që kanë depërtuar në shqip pas mërgimit arbëresh. Nga ana tjetër, *për shqiptarin* është e pakuptueshme ajo pjesë e fjalëve arbëreshe që kanë hyrë me kohë nga kalabrishtja e siçilishtja dhe që, duke u shtuar gjithnjë, e bëjnë përherë e më të vështirë të kuptuarit e ndërsjellë shqiptaro-arbëresh.

5. Vëllimi i huazimeve italiane në të folmet e arbëreshëve

Nga rreth 8600 lema që përmban leksiku i këtij fjalori, rezulton se 1568 prej tyre janë huazime italiane, pra afro 20 % e leksikut të arbërishtes:



Grafik 2

Huazimet italiane që gjenden në këtë *Fjalor*, studiuesi Kamsi i ka ndarë në dialektet përkatëse: friulan, napolitan, siçilian, venet, kalabrez; të gjithë këto dialekte të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, por jo plotësisht të kuptueshëm reciprokisht.

Ndër to (1568 it.), 960 i përkasin gjuhës standard. E bëjmë këtë pohim duke iu referuar faktit se në *Fjalor* nuk i është shënuar krahas dialekti, siç ndodh me fjalët e tjera, por vetëm përcaktimi si italiane (*it.*); 591 i përkasin dialektit *kalabrez*; 31 i përkasin dialekteve: *friulan* (1), *napolitan* (11) (2 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera): *sicilian* (17) (12 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera), *venet* (2):



Grafik 3

Këtë fond huazimesh (italiane) mund ta grupojmë si më poshtë:

- (1) Italianizma të përbashkëta për shqipen dhe të folmet arbëreshe të Italisë
- (2) Italianizma që ndeshen vetëm në të folmet arbëreshe dhe që mungojnë në gjuhën e sotme shqipe

5.1. Italianizma të përbashkëta për shqipen dhe të folmet arbëreshe të Italisë


Të parat kishin hyrë në shqip **para se të niste shpërngulja e arbëreshëve** për në Itali e gjetkë. Këto huazime, zakonisht dallohen nga prania e të njëjtës trajtë fonetike, si në shqipen ashtu edhe në të folmet arbëreshe të Italisë. Të tilla janë, p.sh.: *forca*, *fund*, *grup*, *birrë*, *kundër*, *mars*, *pashkt* "pashkët", *qind* "njëqind", *sapun*, *sipar*, *spijun*, *qiparis*, *shall*, *shelq* "shelq", *engjëll*, *mik*, *parmendë*, *rërë* (geg. *ranë*), *bukë*, *qiell*, *këmbë* (geg. *kamb*), *qen*, *faqe*, *femër*, *festa*, *fik*, *vishkull* etj. Por, ka edhe shumë raste që italianizmat e të folmeve arbëreshe dallohen fonetikisht nga ato të shqipes së sotme. Për këtë arsye, siç vihet re në analizën e *Fjalorit*, një numër i madh i huazimeve, edhe pse rrjedhin nga e njëjta gjuhë

dhe si të tilla kanë të njëjtën rrënjë, dallohen në realizimin fonik të tyre, duke pasur në të folmet arbëreshe gjurmë më të dukshme të shqiptimit në dialektin italian prej nga janë marrë.

5.2. Italianizma që ndeshen vetëm në të folmet arbëreshe dhe që mungojnë në gjuhën e sotme shqipe

Të dytat kanë hyrë në të folmet e arbëreshëve të Italisë **pas shpërnguljes** së tyre, si p.sh.: *destinguir, difendir, dominar, fermar, furnonj e fërnonj, fraxhelar, kapir, arbur, arvur, cikonjë, cukar, animalj, alminu* etj.

Në periudhën menjëherë pas shpërnguljes, përmendim si më të fuqishëm ndikimin e leksikut të italishtes dialektore mbi të folmet arbëreshe të krahinave përkatëse, për arsyen e ditur se edhe situata gjuhësore italiane e kohës (që përkon me vendosjen e arbëreshëve në Itali të Jugut) karakterizohej nga përdorimi i gjerë i dialekteve, ndërsa gjuha e përbashkët italiane kishte vend më të kufizuar. Hyrja e tyre është bërë në masë e shkallë të ndryshme në të folme të ndryshme arbëreshe. Duke ndjekur këtë kategori huazimesh leksikore, mund të njohim njëkohësisht edhe bjerret e fjalëve shqipe që ekzistonin më përpara.



Grafik 4

6. Shtresa vetjake e arbërishtes

Duke iu referuar gjithmonë përcaktimit që i bën vetë autori fjalëve në *Fjalor*, pasi mënjanojmë 1568 italianizmat, nga 8600 fjalët e përfshira në fjalor, pjesa tjetër prej 7032 fjalësh i përket shtresës vetjake të arbërishtes dhe shtresës së huazuar me prejardhje të ndryshme, si: latine,

bullgare, frënge, greke, gjermane, perse, rumune, sllave e turke, ku numri i këtyre të fundit (i huazimeve joitaliane) nuk është i konsiderueshëm:

Është e vërtetë që shqipja, apo në rastin konkret arbërishtja, ka pësuar ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet ato, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Këto huazime rrallë i ndeshim në formën e tyre të pastër; ato, zakonisht, janë përfshirë në sistemin fonetik e morfologjik të arbërishtes, duke iu shtruar një procesi të njohur "shqiptarizmi". Kështu, gjatë periudhës që vendi ynë, kultura jonë, gjuha jonë ishin nën influencën e kulturës e të gjuhës latine, greko-bizantine, sllave e turke, gjuha shqipe ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë indoevropiane me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë, duke vazhduar si e tillë edhe pas shpërnguljes së shqiptarëve në Itali, me ndikimin italian. Natyrisht, një proces i tillë, në të folme të ngulimeve të ndryshme, nuk ka qenë kudo i njëjtë: diku ai ka qenë më i thellë dhe më i shtrirë, diku më i lehtë, gjë që ka arsyet e veta gjuhësore e jashtëgjuhësore.

Mund të themi se leksiku i arbërishtes, parë nëpërmjet këtij fjalori, sado që i ndikuar nga italianizmat, prapëseprapë ka ruajtur një pasuri të vyer fjalësh të njëjta me ato të mbarë shqipes ose së paku me ato të ndonjë të folmeje, kryesisht jugore, të saj. Megjithatë, gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqitet si një varietet më vete, që nuk është plotësisht i njëjtë me asnjërin dialekt të shqipes në trojet kompakte ballkanike, prandaj edhe ndonjë studiues ka dashur ta quajë atë si dialekt të tretë të shqipes. Sipas studiuesit Gjovalin Shkurtaç, *po të vështrojmë elementet strukturore dhe fonetike themelore të ligjërimeve arbëreshe, rezulton se ato i përkasin toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamërishtes e të labërishtes, po edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë; nga ana tjetër, - pohon Shkurtaç -, ato ligjërime paraqesin edhe dukuri e tipare të reja (inovative) (sidomos në fushën e leksikut), që përcaktohen e kushtëzohen nga*

takimi i ngushtë gjuhësor që kanë pasur për caq shekuj me italishten, qysh prej shek. XV – XVI e këtej (Shkurta, 2006: 17).

7. PËRFUNDIM

Ngulimet arbëreshe paraqesin sot një diasporë historike të moçme e disashekullore, të përhapur nëpër gjithë Italinë Jugore e në Siçili, që natyrisht, është e përfshirë, tashmë, ligjërisht e "in tutto e per tutto" në jetën e në konfiguracionin e Italisë, si shtetas italianë, por që, megjithëkëtë, arbëreshët nuk jepen kurrë: ata duan të flasin e të këndojnë shqip, të dallohen në mjedisin italian se janë pikërisht të tillë. Ata janë, pra, qytetarë italianë, me origjinë dhe gjuhë të ndryshme prej shtetasve të tjerë të vendeve ku ndodhen, ndonëse edhe italishten e kanë mësuar dhe e kanë pothuajse kudo në përdorim, kurse shqipen, në variantin e tyre dialektor tradicional e me shumë dukuri ruajtëse (konservative) e kanë pasur dhe vijojnë ta kenë kurdoherë si gjuhë të "zembrës".

Diaspora arbëreshe në Itali, edhe pas caq shekujsh qëkur është ndarë nga mëmëdheu, duke jetuar në kushtet e një pakice në të gjithë Jugun e Italisë, që nga Abruci e Pulia deri në Sicili, diti të gjente një pikë të fortë uniteti dhe përbashkimi pikërisht nëpërmjet punës dhe përpjekjeve të grupeve intelektuale të atjeshme, që vepronin e veprojnë në emër të amësisë së përbashkët etnike, kulturore dhe gjuhësore të kësaj diaspore.

Identiteti i Arbëreshëve u trashëguar për shekuj me radhë në mënyrë të mahnitshme, në kushte shumë të vështira, kur mungonin edhe mjetet mbështetëse të çdo lloji. Ndjenja që u diktonte përkatësinë në një kulturë të veçantë ka qenë e përgjithshme dhe e trashëguar me zili. Identiteti i Arbëreshëve në nivelin popullor u shfaq nëpër shekuj me një larmi dukurish, ndër të cilat shkëputëm *gjuhën*: gjuha, edhe sot e folur në shumicën e komuniteteve me origjinë arbëreshe,

të formuara në Italinë jugore pas vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, përfaqëson një dukuri shumë të fortë që prek si ata që e flasin ashtu edhe dëgjuesit, italianët, që i kanë pritur arbëreshët si mysafirë. Procesi i asimilimit ka ndjekur ligjet e veta, por Arbëreshët i bënë ballë me një qëndrim dinjitoz dhe të fortë duke u prirë gjithmonë nga fuqia e identitetit të tyre.

Megjithatë, realiteti arbëresh sot, po tregon se situata gjuhësore atje po ndryshon: Shqipja e arbëreshëve të Italisë po merr karakteristikat e gjuhës vartëse në një situatë diglosie. Kështu, elementi gjuhësor arbëresh po dobësohet duke i lënë vend më tepër elementit italian, si rezultat i kalimit më lehtë tashmë për ta në gjuhën italiane, sidomos nga të rinjtë, duke çuar në përfundimin e një varieteti gjuhësor ndryshe prej atij të viteve 1960, kohë në të cilën përfundoi së realizuari *Fjalori arbërisht - shqip* i autorit Kolë Kamsi, leksikut të të cilit iu referuam në këtë artikull.

Në këtë vështrim, arbërishtja e shqiptarëve të Italisë përbën një varietet gjuhësor më vete, gjeografik e historik njëherësh, me tipare dalluese e në ndryshim të vazhdueshëm si rezultat i faktorit *kohë*.

BIBLIOGRAFI

- ASCOLI, I. G. (1961), *Colonie straniere in Italia. Frammenti albanesi: Studi critici*, I, Milano.
- ÇABEJ, Eqrem (1960), *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- KAMSI, Kolë (2000), *Fjalor arbërisht - shqip*, Shkodër.
- SHKURTAJ, Gjovalin (1984), *Shpirti i arbit rron*, Tiranë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2006), *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë.
- TITONE, R. (1972), *Bilinguismo precoce e educazione bilingue*, Armando Editore, Roma.

NDIKIMET E RUSISHTES MBI SHQIPEN PËRMES LITERATURËS TEKNIKO-SHKENCORE

EDA SHEHU, VILMA PROKO

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Albania

Email: edashehu_2006yahoo.com

AKTET IV, 4: 655 - 659, 2011

PERMBLEDHJE

Lidhjet e vendit tonë me ish-Bashkimin Sovjetik patën një jetë të shkurtër, nga viti 1945-1960, por zhvillimet intensive në të gjitha fushat e jetës, në ndikimet e këtyre lidhjeve gjetën pasqyrim në leksikon e gjuhës shqipe. Përmes njohjes së gjuhës ruse prej kuadrove specialistë që përgatiteshin në BS, por, edhe prej literaturës shkencore-teknike u futën në gjuhën shqipe, në sferat profesionale, fjalë dhe terma që shënonin objekte të reja teknike si *stanok* (usht.), *bequnok* (mek.). Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me BS, vijon hyrja në bibliotekat tona të literaturës shkencore-teknike, e cila shërbeu për hartimin e teksteve mësimore për shkollën e lartë. Ndikimet e rusishtes mbi shqipen vijuan në fazën e dytë (1960-1980) përmes literaturës shkencore-teknike në fushën e fjalëformimit. Këto formime nuk mund të cilësohen si huazime të drejtpërdrejta nga rusishtja, por si përshtatje modelesh, mbi bazën e të cilave u plotësuan dhe u pasuruan terminologjitë përmes brumit të shqipes dhe mjeteve të saj fjalëformuese. Mbi bazën e modeleve ruse u aktivizuan mjetet fjalëformuese shqipe për emërtimin e dukurive abstrakte, por edhe objekteve të reja, si prapashtesa *-im*, *-ri*, *-si* (rus. *-enije*, *-ost*: *liqishmëri-zakonnost* (drejt), *pamjaftueshmëri-njedostatocnost* (mjek)), e deri në krijimin e togfjalëshave, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të terminologjive. Kjo çoi në krijimin e simetrive në strukturën e formave të brendshme në të dyja gjuhët si rus.: *çjernaia metalurgjia*, *cvetnaja metalurgjia* dhe në shq.: *metalurgji e zezë*, *metalurgji me ngjyra*.

Fjalë kyçe: kontakt, term, model, mjet fjalëformues, formë e brendshme.

HYRJE

1. Format e ndikimit të gjuhëve të huaja mbi shqipen qysh nga lashtësia e deri më sot në të gjitha nivelet e saj, sidomos në leksik, i gjejmë të pasqyruara në shtresimet e krijuara në të, si ato më të vjetrat, të krijuara si rrjedhojë e kontakteve të drejtpërdrejta (pushtimet qindraveçare, fqinjësia), siç janë *latinizmat*, *greqizmat*, *turqizmat*, në ato më të reja (kontaktet e tërthorta), *italianizmat*, *francesizmat* dhe më të fundit *anglicizmat* (*anglezizmat*). Të gjitha këto shtresime, sidomos ato më të vjetrat janë bërë objekt studimesh të shumanshme, të gjera dhe të thella, duke përfshirë këtu gjuhëtarët më të shquar vendës e të huaj, ndërmjet të cilëve mund të përmendim E.Çabej, E. Majer, etj.

Vëmendja e studiuesve ndaj ndikimit të gjuhëve të huaja mbi shqiptarët ka vijuar, ndonëse me përkushtim më të kufizuar, me huazimet më të reja, me italianizmat e më rrallë me francizmat, kurse kohët e fundit është përqëndruar mbi anglicizmat.

Mund të vërehet se përqëndrimi i vëmendjes së studiuesve mbi shtresat e mësipërme leksikore, sidomos mbi ato më të vjetra, kushtëzohet në mënyrë të veçantë me refleksat që kanë lënë ndikimet e gjuhëve të mësipërme mbi shqipen në formën e njësive të drejtpërdrejta të huaja, si fjalë, si elemente fjalësh deri në formante të identifikueshme e të veçueshme në leksikon e shqipes si të huaja, të cilat zbulojnë gjuhën nga kanë ardhur *xhezve* (turq.), *byro* (fr.), *parking* (angl.), *klikoj* (angl.). Kjo vërehet deri në

formantet *-xhi* (si), *ist*, *izm* etj. Nga ana tjetër, duhet nënvizuar se këto shtresime të huaja janë krijuar në kushtet e kontaktetve të drejtpërdrejta ose edhe të tërthorta, si ato më të rejtat, por që kanë vijuar për një kohë relativisht shumë të gjatë (qindrvjeçare), herë të ndërprera e herë që ndihen aktive dhe intensive sot siç janë anglicizmat. Këto fakte kanë rëndësi të theksohen sepse prania e kufizuar e njësive nga gjuhë të tjera ose ndikimi i tyre kohëshkurtër i kanë lënë ato mënjanë vëmendjes së studiuesve, si të thuash, duke i cilësuar ndikimet e tyre si "të pameritueshme" ose "të pavlershme" për t'u bërë objekt i veçantë studimi. Një nga këto gjuhë, e cila ka vepruar me ndikimin e vet për një kohë relativisht shumë të shkurtër (ndikim rreth njëzetvjeçar), kurse si ndikim global (rreth mbi dyzetvjeçar) në kushtet e kontakteve shumë të tërthorta e të dobëta ndërghjuhësore, por shumë të fuqishme e intensive jashtëgjuhësore është gjuha ruse, e cila bëhet si objekt vështrimi në këtë trajtesë nga ana e disa veçorive të ndikimit të saj mbi shqipen.

2. Deri më sot vështrimi i ndikimit të rusishtes mbi shqipen ka mbetur jashtë vëmendjes së studimit të gjuhëtarëve, ndonëse ndikimet e saj mbi shqipen sidomos veprimi i saj mbi ndërtimin e strukturave gjuhësore mbi bazën e modeleve leksiko-fjalëformuese ruse, por me brumin e shqipes janë venë re në mënyrë të veçantë prej mësimdhënësve; këto modele janë shfrytëzuar në masë të konsiderueshme prej hartuesve të teksteve mësimore shqipe sidomos për shkollën e lartë dhe ka patur edhe ndonjë studim rreth tyre në krahasim me shqipen.

I pari që ka vështruar ndikimin e gjuhës ruse mbi shqipen, sidomos në fushën e terminologjisë për nevojat e pasurimit dhe plotësimit të terminologjive të shqipes dhe ngritjes së tyre në sistem të qëndrueshëm është prof. Emil Lafe në artikullin "Razvitije knjzihnoj leksiki albanskogo jazika vo vtoroj pollovinje XX veka" në përmbledhjen kushtuar 100-vjetorit të A. Desničakajës. Ai i ka vlerësuar ndikimin e gjuhës ruse mbi zhvillimin e leksikut politik-shoqëror të shqipes mbi bazën e modeleve fjalëformuese ruse, të cilat çuan në ndërtimin e termave me

brumin e vet shqipes, çka ka ndihmuar për ndërtimin e termave të rinj me bazë amtare, por edhe për zëvendësimin e termave të huaj. Për këtë si bazë kanë shërbyer modelet e ndërtimit të termave në gjuhën ruse, çka del nga përqasja me termat e huaj në shqipe të huazuar nga gjuhët neolatine si *bërthamor-jadernij -nuklear*, *tretës-rasvoritel-solvent*. Në punimin e vet prof. Emil Lafe paraqet në mënyrë sintetike tipat bazë të fjalëformimit të shqipes, mbi të cilët ka ushtruar ndikim gjuha ruse.

Mbështetur në idetë e prof. E. Lafe ne do ta përqëndrojmë vështrimin tonë mbi kushtet e ndikimit të gjuhës ruse jo vetëm mbi gjuhën shqipe, por edhe mbi gjuhët e tjera të përfshira në një bashkësi me baza ideologjiko-politike. Ne do të vështrojmë edhe tërësinë e rrethanave që çuan për një kohë kaq të shkurtër në përthithjen prej shqipes sidomos në sferën e leksikut shkencor-technik të të gjithë atij potenciali fjalëformues modelor, që u vu në bazë të ndërtimit të plotë të një sistemi, siç janë terminologjitë e shqipes.

3. Pas shekullit XIV gjuha ruse u shkëput nga trungu gjuhësor lashtorus duke u ndarë në degë më vete dhe duke u mëvetësuar si gjuhë plotësisht e pavarur. Megjithatë nga pikëpamja tipologjiko-strukturore dhe semantike ajo vijoi të karakterizohej në shekuj nga dy veçori qënësore: a) përbënte bërthamën e gjuhës së përbashkët lashtoruse, gjurmët e të cilës mbetën në dy gjuhët e tjera të reja, në gjuhën ukrainase dhe bjelloruse; b) mbeti gjuha e një kombi të madh, e cila s'mund të mos ndikonte jo vetëm në gjuhët e trungut të vet, por edhe në ato fqinje.

Faza më e rëndësishme e rolit të gjuhës ruse si gjuhë e një kombi të madh lidhet me krijimin e Bashkimit Sovjetik, i cili pas Luftës së dytë Botërore bashkonte rreth vetes 16 shtete republika dhe një varg njësisish autonome. Njësia ideologjike e politike, ideologjia sunduese marksiste-leniniste, lidhjet e afërta në të gjitha fushat e jetës me të gjitha vendet që kombi rus solli që të bëhej i domosdoshëm shndërrimi i gjuhës së tij, si gjuhë e parë e komunikimit ndërshtetëror në të gjithë Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS). Qysh pas

Revolucionit të Tetorit dhe sidomos pas Luftës së dytë Botërore, rusishtja pranohet si gjuhë zyrtare në të gjitha republikat e Bashkimit Sovjetik, duke përfshirë këtu edhe republikat me gjuhë të ndryshme prej rusishtes nga ana tipologjiko-strukturore, sidomos republikat balltike, kaukaziane etj. Me krijimin e Kampit Socialist pas Luftës së dytë Botërore, gjuha ruse bëhet mbizotëruese para të gjitha gjuhëve e vendeve të tjera të kampit socialist jashtë Bashkimit Sovjetik, duke përfshirë këtu edhe shqipërinë.

Qysh pas vitit 1945, e në mënyrë të veçantë pas vitit 1948, pas kohës së prerjes së lidhjeve me Jugosllavinë, përfshirja e plotë e vendit tonë në Kampin Socialist bëri që gjuha ruse të zinte pozitat e një gjuhe të fortë ndikuuese edhe në gjuhën shqipe. Nën trysinë e lidhjeve të gjithanshme të ngushta ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake, etj., si faktorë të fuqishëm jashtëgjuhësorë, gjuha shqipe u vu në kushtet e një dygjuhësie të tërthortë të pasqyruar në nivelin leksikor në futjen e ndonjë fjale të rallë drejtpërdrejt prej saj dhe më dendur në përfshirjen e strukturës leksikore strukturorosemantike të ndërtimeve të huazuara nga gjuha ruse jo vetëm në formën e kalkeve strukturorosemantike, por edhe të fjalëve të rikuptimësuar sipas modeleve ruse.

Mund të thuhet se brenda një periudhe 18-vjeçare (1945-1962) gjuha ruse mbi shqipen pati një ndikim të veçantë, që lidhet drejtpërdrejt me faktorët jashtëgjuhësorë. Mund të veçohen 3 faza themelore:

I. *Faza 1945-1960 (1962,1963)*, pra, faza pas Luftës së dytë Botërore.

Këtë mund ta quajmë fazën e kontakteve intensive, që u ndikua nga marrëdhëniet e drejtpërdrejta në fushat ideologjike, politike, ekonomike e ushtarake.

Jashtë u përgatitën kuadrot e mesëm dhe të lartë. Me kalimin e kohës u intensifikuan (zgjeruan) lidhjet në fushën e industrisë dhe këto u forcuan me përgatitjen e kuadrove të lartë, që sillnin përvojën e huaj në Shqipëri. Pra, kështu u krijua baza për fazën e dytë, meqë kuadrot e lartë tashmë shërbenin kryesisht në shkollën e lartë.

Veçoritë gjuhësore që u shfaqën gjatë kësaj periudhe ishin këto;

- U morën nga rusishtja fjalë, që kishin barazvlerëset në shqipe, të cilat filluan të hynin në një varg industrish, në atë të mekanike, tekstile, të naftës. Këto fjalë në përgjithësi nuk zunë vend, meqë kishin barazvlerëset në shqipe, si fjalë amtare ose të huazuara nga gjuhë të tjera si: *vishka* (kullë), *shatun* (bjellë), *valik* (bosht), *struzhkë* (ashkël), *baraban* (tambur), *vagränkë* (kubilot). Një pjesë prej tyre pati jetë të shkurtër, meqë kishin barazvlerëset shqipe, kurse një pjesë tjetër u zëvendësuan nga fjalë shqipe si *struzhka* (ashkël), *stanok* (mbështetës), *baraban* (tambur).

- U futën në leksik fjalë ruse që shënonin objekte, koncepte që lidheshin në mënyrën e organizimit të jetës shoqërore, ekonomike, politike, arsimin ushtarakë ose me mënyrën e jetës së përditshme që kaluan nga mjedisi rus në atë shqiptar: *kulak*, *kulakëri*, *hozrashot*, *inteligjencie*, *stakanovist*, *bolshevik*, *çapajev*, *çekanka*, *podezhka*, *plitka*, *katanka*.

- U futën fjalë joruse, por të prejardhura përmes rusishtes me kuptime të modifikuara në rusishte, të cilat kaluan edhe në shqipe si: *detal* (makine), *dezhurn*, *kombinat*, *kompleks*, *agregat*, *docent*, *plenum*, *presidium*, *byro*, *aspirant*, *rektor*, *dekan*, *kandidat* (i shkencave) (*кандидат наук*)

- U përshtatën fjalë, si kalke të drejtpërdrejta që shënonin dukuri, objekte e koncepte të sistemeve organizuese ideologjike, politike të botës e jetës socialiste, të huazuara nga mjedisi rus e të pasqyruara në strukturat shqipe me brumin e saj leksikor e mjetet fjalëformuese, por me modelet e ndërtimit rus. Këto modele në shqip u përfshinë si njësi togfjalëshe, të njëjta nga përbërja semantike (forma e brendshme kuptimore) me togfjalëshat rusë si: *Komitet i Partisë*, *Komitet Ekzekutiv*, *Komitet Qendror*, po kështu *Kuvend Popullor* etj..

II. *Faza e dytë 1960 (1962,1963)-1980*

Si veçori e kësaj faze përbën ndërprerja e lidhjeve të gjera me Bashkimin Sovjetik dhe përqëndrimin e tyre në përvetësimin e të rejave tekniko-shkencore nëpërmjet literaturës ruse. Kjo u motivua me përgatitjen e një baze specialistësh, sidomos mësimdhënësish në shkollën e lartë qysh

në fazën e parë (1945-1962). Për këtë kishte dy themele mbështetëse: e para ishte baza njerëzore që përbëhej nga mësime të mësimdhënësive të përgatitura në fazën e parë, të cilët iu futën punës për hartimin e teksteve mësimore sidomos për nevojat të shkollës së lartë, kurse e dyta ishte literatura shkencorë-tekniqe, e cila u sigurua në gjuhën ruse nëpërmjet rrugëve të tërthorta nga vendet e tjera të bashkësive socialiste që vepronte nën ombrellën e Bashkimit Sovjetik.

Si veçori të këtij ndikimi mund të përmendim një varg dukurish jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore: ngritja e fushave të dijes në sisteme dhe kristalizimi i tyre në kuadrin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, bazat e së cilës u hodhën në Kongresin e Drejtshkrimit. Një anë tjetër gjuhësore është futja e një numri shumë të vogël termash të drejtpërdrejta në leksikonin e fushave të ndryshme të dijes. Mund të nënvizohet se terminologjia në bazën e vet tashmë ishte e konsoliduar dhe siç dihet plotësimi i leksikut të fushave të dijes kishte filluar qysh nga Rilindja. Disa fjalë të rralla në fusha të ndryshme kanë mbetur deri më sot: *tjagaç, plitka, stanok, katanka, podjezhka, ballast,*

baraban, kulak, sputnik etj.,. U krijua edhe ndonjë formim brenda shqipes si *zbor_z* *zborist*, të cilat në kushtet e përdorimit të tyre kishin një shpeshësi të lartë.

-Mbeten fjalë ruse të veçanta, me origjinë të huaj për të, të futura si terma prej rusishtes në sistemet e ndryshme të fushave të dijes: *shllam, feldshpat, buksa, panel, plasmasë, presformë, takt, gabarit, agregat, faska, shasi, magistral, starter, zhikler, kontur, rele, shunt, stacionar, ekonomajzer.*

Mund të nënvizohet gjithashtu se gjuha ruse, sidomos në fushat e specializuara, ndihmoi në thellimin dhe zgjerimin e sistemeve terminologjike nëpërmjet modeleve fjalëformuese ose të niveleve të ndryshme, të cilat kanë vlerë të veçantë për tu studiuar. Këtu mund të përmendim:

1. U intensifikua përdorimi i shprehjeve, togfjalëshave sipas modeli emër+emër,

Kontradikta klasash (противоречия классов), kamp pionierësh, shtëpi oficerësh, klub gjuetie.

2. Nën ndikimin e rusishtes më shumë u pasurua tipi fjalëformues i mbiemrave me *-or* për shembull, *klasor (классовый), botëkuptimor (мировоззренческий)*

3. Një tjetër tip produktiv fjalëformues kanë qënë mbiemrat me kuptim mohues *-jo* për shembull *jodemokratik, (недемократический) johistorik (неисторический)*. Ky tip mbiemrash u pasurua nëpërmjet kalkimeve të mbiemrave mohues rus.

4. U futën si modele fjalëformuese me prodhimtari të lartë ndërtimi me prapashtesën-*shmëri* që në rusisht u korrespondon prapashtesa *-ость* si: *partishmëri (партийность), rrezikshmëri (опасность), parajtushmëri (неприимчивость),*

ndershmëri (честность), ideshmëri (идейность)

5. U aktivizuan emrat me prapashtesën *-ës (-тель) деятель* si dhe ekuivalente togfjalësh.

6. U krijuan njësi me bazë kompozitash dhe togfjalëshash:

a.kompozita

-mësime dhënëse (преподаватель)

-mësime dhënie (преподавание)

-vendbanim (местожительство)

-vendndodhje (местонарождение)

b.togfjalësh:

-kandidat i shkencave (кандидат наук)

-Këshill shkencor

-Kabinet pedagogjik

-artist i popullit

-mësues i popullit

-Kuvend Popullor (Народное Собрание)

-Komitet Ekzekutiv (Исполнительный Комитет)

-Fushatë Zgjedhore (Выборная компания)

-Organizata Bazë (Первичная организация)

-bashkëpuntor i vjetër shkencor (старший научный сотрудник)

III. *Faza e tretë (1980-1990)*. Këtë do ta quajmë si fazë të rënies graduale deri në zhdukjen e ndikimit të rusishtes. Duhet nënvizuar që gjithçka që u krijua më parë pati reflekset e mëtejshme pozitive, pasi modelet ruse u bënë pjesë

përbërëse e sistemit të terminologjive të fushave të ndryshme, që kanë ardhur deri më sot.

Pas vitit 1990 e deri më sot nuk kemi ndikime të rusishtes mbi shqipen, por kjo fazë ka interes të studiohet, nëse shqipja vështrohet në rrafshin përqasës me anglishten dhe me gjuhë të tjera, si edhe më vete rusishten, ku, kjo e fundit, e ka humbur tashmë statusin e dikurshëm si gjuhë me shtrirje të kufizuar ndërkombëtare. Gjithë ky proces ka interes të vështrohet nga pikëpamja e mësimdhënies, i cili do të bëhet prej nesh objekt studimi në të ardhmen.

BIBLIOGRAFIA

DURO, Agron (1986), Veçoritë e dukurive gramatikore të stilit tekniko-shkencor të rusishtes

dhe mënyrat e të ushtruarit praktik të tyre: Studime dhe artikuj rreth teorisë dhe praktikës së mësimdhënies së gjuhëve të huaja, Tiranë.

ÇABEJ, Eqrem (1976), Marrëdhëniet e shqipes në periudhën e saj historike: Studime gjuhësore, vëll. III, Rilindja, Prishtinë.

LAFE, Emil (2001), Razvitije knizhnoj leksiki albanskogo jazika vo vtoroj pollovinje XX veka (vlijanije ruskogo jazika) XX veka: Studia linguistica, Sankt-Peterburg.

BASHA, Y. (1982), Interferencat në të mësuarit e gjuhës së huaj, Tiranë..

PRE-SERVICE EFL TEACHERS' BELIEFS ABOUT LANGUAGE LEARNING QËNDRIMET I STUDENTËVE TË MASTERIT “ MËSUES TË GJUHËS ANGLEZE” NDAJ TË NXËNIT TË GJUHËS

ELIDA TABAKU

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Angleze, Universiteti i Tiranës

Email: lidatabaku@yahoo.com

AKTET IV, 4: 660 - 664, 2011

PERMBLEDHJE

Studentët e programit Master “Mësues i Gjuhës Angleze “ fillojnë studimet me bindje dhe qëndrime për mësimin e gjuhës që ndikojnë në mësimdhënie dhe në stilet e të nxënësve të tyre. Studimi në programin Master i bën studentët më të vetëdijshëm për strategjitë që përdorin gjë që i ndihmon në ndryshimin e bindjeve. Ky punim jep një tablo të bindjeve të 100 studentëve për gjuhën e huaj në fillim të programit dhe zhvillimin e tyre gjatë vitit akademik. Të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve, intervistave dhe vëzhgimeve. U hartua një udhëzues për trajtimin e bindjeve, u zhvilluan diskutime dhe punë në grupe për zbatimin e strategjive të ndryshme të të nxënësve . Rezultatet e studimit tregojnë ndikimin e përvojës në klasë dhe të punës në grup për ndryshimin e bindjeve. Ai përfundon me nevojën e një pune të konsiderueshme për shmangjen e bindjeve të gabuara përpara se studentët të fillojnë mësimdhënien.

Fjalët çelës: Bindje, gjuhë e huaj, përgatitja e mësuesve.

SUMMARY

The students of Master of EFL Teacher Education start this program holding a number of certain beliefs and attitudes about foreign language learning which influence their teaching and their students' language learning styles . The study this Program make students aware of strategies used helping them to change their beliefs.This paper aims to give an overview of 100 students' beliefs on language learning and teaching at the beginning of the program, their development during the academic year. The data was collected through questionnaires, interviews, class observations and teaching practice. A packet of instructions about dealing with these beliefs was prepared, as well as discussions and group work for applying various learning strategies. The results of this study show the influence of class experience and group work on changing beliefs. It concludes that considerable work must be done to eliminate any mistaken beliefs before teacher students start teaching

Key words: Beliefs about language learning, EFL learning, training

Mësimdhënia është një nga profesionet më me ndikim në shoqërinë e sotme. Me punën e tyre të përditshme mësuesit sjellin një ndryshim të rëndësishëm në jetën e fëmijve në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet lëndës që japin, edhe në mënyrë të tërthortë nëpërmjet sjelljeve, qëndrimeve, vlerave dhe marrëdhënjeve që krijojnë. Përgatitja e mësuesit të aftë fillon në shkollat e larta.

Misioni kryesor i arsimit në shekullin e XXI është përgatitja e brezit të ri për një botë në ndryshim si në fushën e punës ashtu edhe në përfshirjen e tyre shoqërore dhe kulturore. Arsimi nuk kërkon thjesht të japë njohuri dhe aftësi, por ka dhe një qëllim moral dhe shoqëror. Ky mision e bën të domosdoshme rritjen e cilësisë në përgatitjen e mësuesve në mënyrë të vazhdueshme. Niveli dhe cilësia e njohurive të mësuesit për lëndën,

aftësitë e tij pedagogjike , ndjeshmëria e tij ndaj problemeve dhe çështjeve të kohës, motivimi i tij për mësimdhënje ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e përvetsimit të njohurive dhe aftësive nga nxënësit si dhe në përvojat e tyre të të nxënës. Në këtë kuadër për mësuesit e gjuhëve të huaja kërkohet *kompetenca gjuhësore* e cila përfshin aftësinë për komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhë të ndryshme; talentin e mësuesit për të informuar nxënësit e tij në mënyrë të qartë për lëndën duke përdorur mënyra të mësimdhënies efektive. (Hutmacher, 1996). Programet Master në Mësuesi synojnë përgatitjen e mësuesve nga ana pedagogjike dhe metodike, por edhe gjuhësore për të thelluar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Bindjet dhe qëndrimet e studentëve për gjuhën dhe nxënjen e saj kanë ndikim të rëndësishëm në punën e tyre të mëtejshme si mësues.(5)

Studimi ynë

Ky studim synon të japë një tablo të bindjeve dhe nevojave të studentëve të Masterit Mësuesi për mësimin e gjuhës së huaj si dhe pritjet e tyre nga ky program. Analiza e pyetsorëve na ndihmoi për të përcaktuar më mirë qëllimet dhe objektivat e programit, përmbajtjen e kursit, zgjedhjen e materialit mësimor dhe format e vlerësimit.

Në këtë studim u përfshinë 100 studentë të programit Master “Mësues i gjuhës angleze”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, UT, të cilat kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në UT, UV dhe UE . Ata sjellin përvojën si nxënës të gjuhës angleze, si dhe bindje të caktuara për mësimin e gjuhës, të cilat janë formëzuar gjatë viteve të shkollimit. Për vjeljen e të dhënave u përdorën pyetsorë, intervista , vëzhgime në klasë dhe u modeluan strategji të ndryshme të të nxënës.

Pyetsori përbëhej prej dy pjesësh. Pyetjet e pjesës së parë lidhen me përvojën e studentëve për përvetsimin e aftësive gjuhësore, materialet dhe metodat e punës së përdorur . Pjesa e dytë jep pritjet e studentëve nga programi duke ju përgjigjur pyetjes “ Si do veproje për mësimin e aftësive gjuhësore dhe për mësuar komunikativ të gjuhës së huaj”. Gjithashtu ata duhet të

raportonin për bindje të ndryshme që kane për mësimin e gjuhës angleze. Në pyetsor jepej lista e veprimtarive të ndryshme mësimore që mundësojnë një përvetsim të gjuhës për qëllime komunikative (4). Kjo u bë me dy qëllime për të ndihmuar studentët në plotësimin e pyetsorit dhe për t'i njohur ata me një shumëllojshmëri veprimtarish mësimore efektive.

Analiza e nevojave

Nga analiza e pjesës së parë të pyetsorëve rezultoi se leximi është aftësia gjuhësore e praktikuar më shumë. Kjo për dy arsye, së pari, sepse leximi është mjet për mësimin e gjuhës dhe së dyti, sepse provimet kryesisht bazohen në leximin e teksteve.

Leximi me zë të lartë raportohet nga 100 % e studentëve . 90 % shënojnë se përdoret përkthim për të kontrolluar kuptimin. Kjo ndodh në shkollën 9-vjeçare edhe në shkollën e mesme. Detyra më e shpeshtë në lidhje me leximin është përgjigja e pyetjeve rreth tekstit , ku mësuesi luan rolin kryesor. Kjo teknikë raportohet nga 90% e të pyeturve. Detyrat e tjera më komunikative zënë një vend të vogël.

Tekset e përdorura janë kryesisht ato që përfshihen në librat shkollorë si historitë e shkurta, fabulat, përshkrimet, artikuj gazetash, intervistat, letra zyrtare dhe familiare. Më rrallë përdoren materiale autentike si lajmërimet, programe TV dhe radio, grafikët, tabelat, udhëzimet, reklammat, orare , formularët .

Aftësia gjuhësore e *shkrimit* praktikohet më pak . Detyrat me shkrim në klasë dhe jashtë saj renditen nga përgjigjet e pyetjeve në shtëpi,(100%), formim fjalish më fjalët e reja (80%), përkthim teksti (75 %) , diktim (70 %) , plotësim vendesh bosh (55 %), ushtrime tipike testimi (50 %). Detyrat me karakter krijues përdoren më rrallë dhe kufizohen në shkrim letrash bazuar në një model të dhënë.(40 %). Mjaft studentë (78%) shenojnë se detyrat me shkrim në klasë përdoren si mjete për plotësimin e orës së mësimin, ose për mbajtjen e disiplinës.

Dëgjimi është aftësia gjuhësore së cilës i kushtohet më pak kohë dhe rëndësi në mësimin e gjuhës së huaj .Ajo trajtohet si pjesë plotësuese e mësimin të aftësive të tjera gjuhësore. Në rastet

kur në shkolla ka manjetofon reduktohet në dëgjimin të thjeshtë pa u shoqëruar me detyra. Vetëm 56 % e të pyeturve shënojnë se kanë ndjekur seanca dëgjimore, por pa detyra të përcaktuara qartë për zhvillimin e aftësive të dëgjimit.

Të folurit bazohet kryesisht me diskutimin rreth tekstit ku vendin kryesorë e zënë pyetje përgjigje për mësimin e kaluar dhe të ditës (100%). Ritregimet, ushtrimeve gojore dhe recitimi i dialogjeve shënohen nga 90 % e studentëve. Diskutimi rreth pamjeve të ndryshme, përvojave personale, loja me role, nxjerrja e informacionit nga harta, tabela, grafiqe dhe diskutimi i tyre, diskutimi për libra ose filma zënë pak vend në orën e mësimin. 57 % e studentëve nuk patur mundësi komunikimi me folës vendas. Ata ndjehen më të sigurë me lexim shkrimin, por kanë vështirësi në dëgjim dhe komunikim.

Përgjigjet e pjesës së dytë të pyetsorit tregojnë së studentët e programit Master janë të vetëdijshëm se nevojiten ndryshime në disa nga bindjet dhe strategjitë e tyre të të nxënësve. Lista e veprimtarive mësimore për një përvetsim të gjuhës për qëllime komunikative ju dha mundësi për të reflektuar për përvojën e tyre personale.

Leximi shikohet si një aftësi e rëndësishme që duhet praktikuar vazhdimisht duke përdorur tekste të shumëllojshme që ndeshen në jetën e përditshme dhe që mundësojnë të lexuarit kritik. Studentët kanë nevojë t'ju modelohen teknika të shumëllojshme të punës me tekstin, si dhe të jepen detyra që aktivizojnë njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të lexuesit(1). Kontrolli i kuptimit të realizohet me detyra që kërkojnë zbatimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve. Detyra të tilla si kombinimi i figurave me kuptimet, rishkrimi i pjesës në një vetë tjetër, ndërtim pyetjesh nga nxënësit, përmbledhja dhe perifraximi i tekstit, analiza e pjesës së lexuar etj. e bëjnë leximin në gjuhën e huaj më kuptimplotë (4). Më shumë nevojitet të punohet me leximet jashtë klase me materialeve të përshtatura për nivelin gjuhësor dhe interesat e nxënësve të sotshëm. Aftësitë e nxënësve në lexim rriten ndjeshëm nëse leximi trajtohet si proces ku nxënësi ndërvepron me tekstin, duke u vënë në qendër të mësimin (8).

Vlerësohen si të rëndësishme detyrat me shkrim që aktualisht përdoren nga mësuesit dhe shërbejnë për përforsimin e njohurive gjuhësore. Por krahas tyre shihet si e domosdoshme dhenja e detyrave gjysëm të kontrolluara ose krijuara që lidhen me nevojat komunikative të një nxënësi të gjuhës së huaj si shkrimi i shënimeve të shkurta, memo, udhëzime, lajmërime, pjesë ditari, ftesa për festat të ndryshme, plotësim formularësh dhe pyetsorësh, përmbledhje tekstesh, shkrimi i pjesëve me ndihmën e pikturave, vazhdimi i një fillimi, ose plotësimi i një fundi të një historie të shkurtër (6). 50 % e studentëve shënojnë se mbajtja e ditareve nga nxënësit në gjuhën angleze ka motivon nxënësit.(7)

Aftësia e dëgjimit konsiderohet e vështirë. Zhvillimi i saj kërkon përdorimin e detyrave komunikative si ndjekja e udhëzimeve të dhëna, vizatimi i një përshkrimi të dëgjuar, ndjekja e itinerarit në një hartë, lidhja e pamjeve me tekste të dëgjura, përgjigja thirrjeve telefonike (3). Këto forma e bëjnë dëgjimin kuptimplotë dhe tërheqës për nxënësin.

Veprimtaritë mësimore për zhvillimin e aftësisë gjuhësore të të folurit të lidhen më një detyrë dhe nevojë për të komunikuar në gjuhën e huaj. Puna në çifte dhe në grupe e mundëson këtë. Diskutimi rreth një pikturë, diskutim për të plotësuar informacion bosh në një tekst të shkruar ose në pamje të paplotë, lojat me role, simulimet, rrefimet për përvojat ose përshtypjet personale janë disa prej veprimtarive (2).

Disa nga bindjet e studentëve për mësimin e gjuhës janë të sukseshme dhe janë transferuar nga brezi në brez si: Mësimi i gramatikës është shumë i rëndësishëm për përvetsimin e gjuhës; Gjuha është e përbërë nga shprehje, mësohen më të zakonshmet; Fjalori studjohet në kontekst; Stilet e të nxënësve janë të rëndësishme, duhet gjetur mjeti mësimor për t'u përshatur me to; Loja me role është e rëndësishme etj.

Por ka edhe bindje të gabuara që vështirësojnë përvetsimin e gjuhës së huaj si: Duhet të mësohet gjithshka saktë që në fillim, se nuk korrigjohet dot; E vetmja mënyrë për të lexuar në anglisht është të kuptosh secilën fjalë që lexon; Fjalët e reja mësohen më mirë kur i mëson

përmendësh ; Dëgjimi është shumë i vështirë; Nuk mund të komunikosh me folës vendas nëse nuk ke qënë në vendin e gjuhës etj.

Diskutim dhe përgjithësim

Analiza e të dhënave tregoi se shumica e studentëve (67 %0 ndjehen më mirë në një të mësuar me qender mësuesin , i cili është përgjegjës për transferimin e njohurive dhe për vlerësimin. Kjo nxjerr në pah nevojën e studentëve për t'u mësuar me mësim ku studentit është në qendër , duke u bërë pjesmarrës aktiv në orën e mësimit , duke reflektuar për përparësitë dhe disavantazhet e kësaj mënyrë mësimdhënje për studentët si dhe rëndësinë e saj për mësimin e gjuhës së huaj.Ky kalim bëhet gradualisht me qëllim që studentët të mësohen me të (2) .Kjo mund të arrihet kur studentët përfshihen aktivisht në procesin e të nxënës nëpërmjet leximit, shkrimit, diskutimit dhe reflektimit mbi idetë dhe konceptet e dhëna në lëndë të ndryshme. Ky është një trajtim i ri i mësimit ku studentët zbatojnë në seminare atë teori që mësojnë për një të mësuar komunikativ të gjuhës së huaj.Është pedagogu ai që planifikon dhe zbaton veprimtari aktive të të nxënës dhe ndihmon nxënjen kur këto përdoren në klasë. Përdoren tre tipe si veprimtari të kontrolluara plotësisht nga mësuesi, të drejtuara nga mësuesi dhe veprimtari të lira në mënyrë progresive dhe në raste të kombinuara (6). Përfshirja e studentëve në mënyrë graduale bëhet sepse ata përballen me sfida për të përshtatur më stilet të reja të të nxënës , të ndryshojë mënyrën tradicionale të mësimit të gjuhës së huaj e bazuar në lexim-përkthim , të përvetsojë aftësi praktike dhe kompetenca për mësimdhënje të gjuhës së huaj për qëllime komunikimi . Në dokumentin Tuning (2004) propozohen forma të organizimit të mësimit dhe veprimtari të ndryshme të studimit. Në zhvillimin e seminareve planifikohet dhe punohet që studentët të (a) njihen me strategji efektive mësimore; (b) zbatojnë strategjive efektive mësimore; dhe (c) krijojnë bindje rreth rolit të nxënësit në këtë proces.

Një formë efektive e përdorur për aftësimin metodik të studentëve është përfshirja e tyre në punë në grup për bërjen e një projekti.Në kuadrin

e studimit grupe studentësh do hartonin një doracak për përdorimin e strategjive konjitive dhe metakonjitive në lexim ,bazuar në përvetësimin e tyre. Puna në grup u plotësua me veprimtari mësimore individuale. Synimi i kësaj veprimtarie ishte që pedagogët dhe studentët të kuptonin si dhe sa duhen ndihmuar studentët në punën me grupe me qëllim që të përfitojnë sa më shumë nga kjo veprimtari, duke krijuar një raport të drejt midis kontrollit të mësuesit dhe punës autonome të studentit. Studentët mbajtën shënime dhe reflektuan mbi përvojat e tyre dhe strategjitë që përdornin për leximin, si përmbledhjen dhe perifraximin , ose aftësitë e tyre të komunikimit gjatë punës në grup. Përvoja konkrete ndihmoi që ata të modifikonin strategjitë e tyre të lexuarit sipas detyrave të caktuara , të bashkëpunonin me shokët dhe të përfitonin nga ata. Në vlerësimet e bëra për projektin ata theksuan se në puna në grup i ndihmon për të përfituar nga shokët , për të planifikuar dhe zbatuar punën me grupe në mësimin e gjuhës së huaj në klasat e tyre. Është e domosdoshme për programet e mësuesisë të ndihmojnë studentët të behen më të vetëdijshëm për të nxënës e tyre duke përdorur strategjitë më të mira njohëse dhe metakonjitive, sepse ata do jenë modeli dhe mbështetja për nxënësit e tyre. Përgatitja e mësuesve të rinj të gjuhës së huaj kërkon të zbatohet një kurrikul që do të mundësojë të përgatisim mësuesit e ardhshëm për veprimtari mësimore cilësore dhe veprimtari efikase profesionale në një shoqëri të bazuar mbi dijen. Njohja e qëndrimeve dhe bindjeve të studentëve për gjuhën e huaj, për mësimdhënjen e saj, nevojat e tyre dhe kërkesat e kohës për një përvetësim komunikativ të gjuhës së huaj janë bazë e punës në auditor. Planifikimi i veprimtarive mësimore me në qendër studentin i ndihmon ata për të përkthyer njohuritë teorike në aftësi praktike. Kjo kërkon një kombinim të përvojës së shkollës sonë me atë evropiane.

Bibliografia

1. Arnold, J. (1999) *Affect in Language Learning*, Cambridge: Cambridge University Press.

2. Benson, P. (1996) 'Concepts of autonomy in language learning' *Applied Linguistics*, 2: 15-46.
3. Canale, M. and Swain, M. (1980) 'Theoretical bases of communicative approaches to second language teaching and testing', *Applied Linguistics*, 1: 1-47.
4. Candlin, C. and Murphy, D. (1987) *Language Learning Tasks*, Englewood Cliffs, NJ
5. Council of Europe (2001) *A Common European Framework of Reference for Languages: learning, teaching, assessment*, Cambridge University Press.
6. Larsen-Freeman, D. (2000) *Techniques and Principles in Language Teaching*, 2nd ed, Oxford:Oxford University Press.
7. Lyne, C. (1995) 'Incorporating peer-teaching observation into a staff development programme' in *Proceedings of the 5th National Institution-wide Languages Programmes Conference*, Nottingham: Nottingham Trent University.
8. Nation, I. S. P. *Teaching ESL/EFL Reading and Writing*. Routledge, 2009..

A TRANSLATION ANALYSIS OF COMPLEX SENTENCES FROM ENGLISH INTO ALBANIAN IN THEODORE DREISER'S NOVEL "THE GENIUS"

GENTJANA TARAJ

Department of Foreign Languages, University of Vlora-Albania

Email: gtare@univlora.edu.al

AKTET IV, 4: 665 - 671, 2011

SUMMARY

Literary translation is probably the most well-known and widely debated form of translation, which constitutes almost 60% of the literary publication in Albania. In comparison to other kinds of translators, literary translators tend to uncover what lies under the surface which often requires going beyond the boundaries of the language in order to produce an equivalent text in the target culture. This requires expert and competent translators. This paper looks at the translation techniques used in the translation of complex sentences in the novel *The Genius* written by the American writer Theodore Dreiser. Furthermore, an attempt has been made to introduce some suggestions for a better translation. The paper will be concluded with the idea that literary translators have to adopt sentences and their clauses from the source language to make reference to the original context and colour of the text, thus leading to more accurate and communicative translations.

Key words: literary translation, methods of translation, literary translator, complex sentences, language and culture

INTRODUCTION

Human beings are social creatures by nature which makes it indispensable for them to live in a community and actively interact with the other members of it. As a means of communication, language plays an essential role in this process, making it possible and easier for people to communicate. People use language not only to convey their experience and ideas in various fields such as basic sciences, human sciences, religion and technology, but also in art which helps them reveal their feelings about life and the world they are actually living in or wish to live, either in spoken or in written forms such as literature. In all the times there has been a pressing need in using language as a means of communicating experiences, feelings and making them known for the rest of the world. This holds true not only for the members of the same community, but also for the members of

different communities who wish their social-cultural knowledge be known by others.

The age of information explosion brought about the expansion of human communication throughout the world, increasing the role of translation and translators as mediators in the process. A large amount of information in the form of books and scientific articles has been first published in the well developed and industrialized countries and then translated into the less developed countries giving a great contribution to their progress. In particular translated literature has played an important role in the intercultural exchange, feeding the secondary literatures with new forms of writings and styles (Ivan Etmar Zohar, 2008:136) as the result of which the national culture and identity has further developed. A well-known example of this concern with foreign literature impact on the native culture is the nineteenth century classics

translated into the albanian language during the communist's era.

Although English has become an international language not everything can be read in English. Sometimes people find themselves facing a communication gap which has fortunately been resolved through translation. Translation makes possible the transmetion of the messages and ideas from the source text into the target text, thus facilitating target readers' understanding of original texts. In fact, not all texts require only some knowledge on the source language in order to translate them. As far as literature is concerned familiarity with the source and target languages is not enough for a good translation. A good translator must be able to transfer the message from the source text into the target text without the readers realizing it as a translation. This is a very difficult process since translators face difficulties because of the differences in cultures and languages. Sentences, their length and types represent a serious challenge in translation. Translator's concerne with sentences and their characteristics will be the focus of our attention in this study.

Literary translation

Literary translation represents a distinct type of translation not only because of its unique challenges, but also because it represents an opportunity to discover the imaginary world of the original writer and make it available for the readers of another culture. In practice, literary translation problems depend on translation's purpose and the source text embedment in the source culture. The more source-text-oriented a translation is, the more difficult it is to achieve it. The deeper a text is embedded in the source culture, the more difficult it is to work on it. In this respect the task of the literary translator is more or less the same as that of the original writer. Somehow translators use the target language features to create a credible and engaging literary reality which belongs to characters unknown to the target reader but who are eager to discover it in their own language.

Conventionally, it is believed in Albania that knowledge on the source and target language is enough to translate literature. This goes against what translation theory suggests. In order to perform their job successfully translators should meet three requirements, namely: familiarity with the source language, familiarity with the target language, and familiarity with the subject matter. These three requirements help translators uncover the meaning of the text in the source language behind its forms and then produce that meaning in the target language by using the TL forms and structures. What the translator attempts to do is the reproduction of the same meaning and message even though the form and code are changed. In other words, the translators' final goal is to reproduce the same ideas, thoughts, and messages in the target language.

A very important discussion in literary translation is focused lately on identifying the linguistic unit for which the equivalent must be sought for. Based on the linguistic form, the discussion is focused on whether equivalence is to be pursued at the level of words, clauses, phrases, sentences, paragraphs, or the entire text. Such an attempt has led to the concept of Translation Unit which is one of the key concept in translation theory. In the field of translation theory, trasnlation unit may be a single word, a phrase, a clause, a sentence, or even a larger unit like a paragraph. Since sentence is regarded as a meaningful unit that conveys the message completely, for the purpose of this study it will be the unit of translation.

Syntax which regulates the order of words in the sentence is perhaps the least flexible of all the constrains under which translators must work. This is because the syntax regulates the sequence in which the information is given and the rhythm under which that information is exposed. If the translation occur between languages that do not differ much from each other the translator can easily reproduce the same effect, but if the languages are different then translators resort to different devices to achieve the same analogous effect. (Lefevere:1992:79).

Realism and attention to details are the main characteristic of Dreiser's style, which pose certain problems to translator. The Genius, for example, stylistically is marked by the use of free indirect discourse and complex sentences as a narrative technique. With this narrative style, Dreiser focus his attempts at revealing the character's thoughts and feelings through the use of complex sentences that go hand in hand with the psychological processes the main characters go through since the emphasis is on the internal events and the character's inner thought at a particular moment. Therefore, challenging from the translation point of view is handling the extensive use of free indirect discourse and the large amount of details. The following quote illustrates this point:

"She could not have understood if she could have seen into Eugene's mind at this time how her home town, her father's single farm, the blue waters of the little lake near her door, the shadows of the tall trees on her lawn were somehow compounded for him not only with classic beauty itself, but with her own charm."

"Ajo nuk do ta kish kuptuar në atë kohë, po të kish pasur mundësi të shihte brenda mendjes së Juxhinit, i cili mendonte se qyteti i saj i vogël i lindjes, ferma e veçuar e të jatit, ujët e kaltër të liqenit të vogël pranë shtëpisë, hijet e pemëve te lëndina, përmblihdnin në sytë e tij jo vetëm bukurinë e tyre dhe, në këtë mënyrë, bëhej dhe më tërheqëse."

Here we have a descriptive sentence by the narrator who expresses the character's consciousness through a conditional clause and an adverbial clause of manner. The adverbial clause of manner starts with a very long subject, which represents the most important concept in Eugene's subjectivity toward life, "woman's charm." In other words, there are two main ideas included in this complex sentence: Angela's incapacity to understand Eugene and Eugene attitude toward life. The questions rise: How has the translator cope with the information? How is the information represented in translation?

These are two questions that we asked throughout the study.

As can be easily seen from translation the information in albanian is not as clear as it is in the original text. In an attempt to clear the situation by including the relative pronoun "i cili," and the unnecessary adverbial phrases of time "në këtë mënyrë," the translator has achieved the opposite effect. Other features like the verb "conmpounded" which is used metaphorically in the original text and seems to be equivalent in meaning with the verb "connected, or related," are not understood by the translator who has provided us with a translation that does not conform to albanian language grammar and semantics " përmblihdnin në sytë e tij jo vetëm bukurinë e tyre dhe, në këtë mënyrë, bëhej dhe më tërheqëse."-it is not obvious to what refers the last part of the sentence, as it is not clear the function of the conjunction "and," or the expression "përmblihdnin në sytë e tij" which makes no sense in the albanian language.

In addition, the translation of the adverbial clause of manner as a relative clause in albanian has brought about a change in narrator's perspective. According to the original the initial beauty of "her home town, her father's single farm, the blue waters of the little lake near her door, the shadows of the tall trees on her lawn" reminds Eugene the classical beauty and the charm of his girlfriend while in translation that meaning is lost since it is the beauty of "her home town, her father's single farm, the blue waters of the little lake near her door, the shadows of the tall trees on her lawn" the only thing that matters.

In conclusion, this example serves as a warning to translators against the greatest challenges of syntax in literary texts. Understanding the construction of the period in the source language helps translators decide on the right strategy that makes sentence reproduction possible in the target language. However, translators must know that any change in sentence type or length affects its illocutionary effect. For this reason the translator of "The Genius" should have paid a particular attention to the following linguistic issues: for example it would be wrong to

translate the idiomatic expression "could have seen into Eugene's mind," word for word since "shihthe brenda mendjes" makes no sense in albanian, there is a deletion and addition of information which has altered the meaning of the original and the sentence's length making the translation suffer from the incoherence and unintelligibility.

Research questions

This study aims at finding an answer to the following questions:

1. What kinds of translation procedures are used to translate complex sentences in the novel "The Genius" by Theodore Dreiser?
2. Does the translator show consistency in the translation method throughout the book?

Methodology

Theodore Dreiser, one of the main representatives of American Naturalism of the XIX century, is known as a writer that stands ahead of his own time. *The Genius*, Dreiser's autobiographical novel, was first published in 1915. It explores the conflicts between traditional and modern views of sexual morality and it is the second successful novel of Dreiser translated into the Albanian language. Although the translation was published 41 years ago the novel is still wanted by the young generation, which makes its translation a success. In the novel "The Genius" written by Theodore Dreiser and translated by Mahmud Bobradi we find many complex sentences, which constitute the main concern of this study.

Conducting this research, an attempt has been made to investigate the methods and the problematic nature of translating complex sentences from English into the Albanian language in literature. This paper is a contrastive study of the pairs of sentences in source and target language with the only purpose of highlighting the different techniques the translator has adopted in translation.

Firstly, based on a comparative-contrasting approach several sentences from the source text and their corresponding translation in Albanian

are traced with the only purpose of discovering the translation procedures and method applied for each of them and the sentence effect. Secondly, we recognize the fact that this research has its own limits since it is based only on the data extracted just from one novel. Lastly, we have placed this research within the framework of translation methods introduced by Newmark (1988: 45-47) and consider translation as product-oriented:

- *Word-for-word translation*. SL word order is preserved and the words are translated by their most common meanings, out of context.
- *Literal translation*. SL grammatical constructions are converted to their nearest TL equivalents, but the lexical words are translated out of context.
- *Faithful translation* attempts to produce the precise contextual meaning of the original within the constraints of the TL grammatical structures.
- *Semantic translation* differs from 'faithful translation' only in as far as it takes more account of the aesthetic value of the SL text.
- *Adaptation* is the freest form of translation. It is used mainly for plays and poetry; the themes, characters, plots are preserved the SL culture is converted to the TL culture. The text is rewritten.
- *Free translation* produces the TL text without the style, form, or content of the original.
- *Idiomatic translation*. Although it reproduces the 'message' of the original the nuances of meaning are distorted by preferring colloquialisms and idioms where these do not exist in the original.
- *Communicative translation* attempts to render the exact contextual meaning of the original so that both content and language are readily acceptable to the readership.

Data analysis

Complex sentences are more difficult to translate than simple or compound sentences. This is because the periods may consist of one or more independent and dependent clauses which need to be considered as a whole in order to reveal its meaning. Generally, syntactical similarities between Indo-European languages allow

translators to reproduce the same illocutionary effect by using the same devices as the original (Levefere, 1992:78). This decision making process which increases translators' responsibility to confront the challenges of syntax without altering the aesthetic values of the original, at times forces them to alter the syntax of the original for the sake of original text's ideas, thoughts, and messages preservation in the target language.

As stated before, this study intends to describe the translation methods applied in transferring the English complex structural sentences in the novel of Theodore Dreiser's "*The Genius*" into Albanian complex structural sentences in its translation "*Gjeniu*." At the end of the research

we found out that there is some variation in English complex sentence translated into Albanian complex sentences. The results show that English complex sentences are generally translated by the same sentence type in Albanian. In addition, we found that there are three types of translation methods applied in translating English complex sentences: word-for-word translation, literal translation and semantic translation.

The data of this research are complex sentences with a total of 30 data collected in random. The result of the research shows that complex sentences extracted from the novel *The Genius* are translated as follows:

Nr.Sentenc	W.for.W	Literal	Semantic	Change. Sent.Type	Mistrans
30	30%	55%	15%	20%	40%

From the data displayed above we conclude that the method used by the translator in most of the sentence belongs to literal translation since the transference of the meaning and the linguistic units which form the sentence are firstly done by finding out the equivalence for each word and then adopting their position within the sentence according to the target language grammar. We concluded that it is part of translator style that everything written in the source text is directly translated into the target text without any changes not only in its form and structure but also in the order arrangement of sentence elements. 30% of the translations above belongs to word-for-word translation type since the transference of the meaning and the position of the sentence constituents are the same as those in the source text. Only 15% of the complex sentences are translated by using the semantic method of translation where the aesthetic values are considered of primary importance.

Furthermore, in his attempt to produce in translation the same effects on his readers as the original work on its readers, the translator has minimized and sacrificed the form of the original

literary text. It is very important to state that apart from the methods mentioned above the translator has applied other translation strategies such as the addition of information, deletion of information and structural adjustment. The former is the dominant strategy used in dependent clauses in the novel. The last result of this research shows that from 30 data analyzed, only 60% of it belongs to accurate translation and 40% belongs to inaccurate translation.

CONCLUSION

It goes without saying that translation plays a crucial role in human communication. Translators who are considered as bridges that connect different cultures has enabled and facilitated human communication by transferring the ideas and messages from the source language (SL) into the target language (TL). Due to translation everything written and created in different epochs has become part of people's culture inheritance. The necessity in many countries like Albania for more translation of scientific, social-cultural texts and imaginative writings requires nowadays expert and competent translators who

must be familiar with the native language and culture as well as with the language and culture they translate from.

Translators have at their disposal various strategies for rendering the meaning and the form of the original texts intact in target language. According to the sentence type and sentence length as well as the nature of target language translators try to render the literary text without altering its meaning and form. The more the translator knows about the subject matter and the language involved in translation the better the message is preserved avoiding thus mistranslation as a result of the translator's failure to acknowledge them. A loss in meaning accompanied by a confusion and lack of readability causes TL readers' decrease of interest and consequently, makes the translation ineffective.

Dresier's use of details throughout the novel is a feature of his writing that has put the translator into difficulties. In many of the sentences used in this analysis, the translator has longed and simplified the original for the sake of clarity. However, such an attempt has at times affected and sacrificed the quality of style. Most of the time dependent clauses are preserved as they are in original, but here and there we noticed a change in their type and length as the result of which some stylistic peculiarities that were hard to preserve are lost. However, following the distinctive syntax of the original too closely would at times compromise the comprehensibility of translation and yield undesirable results. For example: in translation, these two sentences are compressed into one to produce an acceptable albanian text with flow. The uses of commas, dashes, colon in Albanian do not have a one-to-one relationship with English but they were normalized in the Albanian translation so as not to violate the norms of the target language:

"it was bad business-running with other women-no doubt of it. It always ended in something like this-a terrible storm in which he has to sit by and hear himself called brutal names to which there was no legitimate answer."

"Po, pa dyshim, të shkoje me gra të tjera ishte një punë që të fuste në njëmijë ngatërresa: përfundimi ishte gjithmonë një skenë e ngjashme me këtë-një shamatë e tmerrshme, gjatë së cilës ishte i detyruar të rrije dhe të dëgjoje sharjet më të rënda, pa pasur as të drejtën të kundërshtojë."

Finally, although theoretically a text which is embedded in its culture may be both possible and impossible to translate in other languages practically every translation is possible. It is true that dealing with translations that have a feel and nuance embedded more in literary meaning than in language differences is a great challenge, but using the right techniques and translation methods every problem is easily overcome. The degree of closeness to source text at sentence level and the extent to which their structure might be changed depend on the purpose of translation, text type and target language norm. In conclusion, it is up to translator to decide which translation method to use as far as the translation purpose and message of the original text are preserved. If the choices of translator are governed by his purpose to present the beauty of style without sacrificing the meaning then translation is possible and a good one.

REFERENCES

- Bassnett-McGuire. 1980. Translation Studies. New York: Methuen & Co. Ltd.
- Bell, Roger T. 1991. Translation and Translating: Theory and Practice. London: Longman Group Ltd.
- Brislin, Ricard. W. 1976. Translation: Application and Research. New York: Gardner Press Inc.
- Catford, J.C. 1965. A Linguistic Theory of Translation. London: Oxford University Press.
- Hatim, Basil and Mason, Ian. 1990. Discourse and the Translator. Longman: Longman Group Limited.
- Mc Guire, S.B. 1980. Translation Studies. Methuen London and New York.
- Newmark, Peter. 1981. Approaches to Translation. Oxford: Pergamon Press.
- Newmark, Peter. 1988. Textbook of Translation. Oxford: Pergamon Press.

Even-Zohar, Itamar 2008. The Position of Translated Literature within the Literary Polysystem.

Andre Lefevere, 1992. Translating Literature: Practice and Theory in a comparative literature

context. New York: The Modern Language Association of America Press..

THE SPECIALTY OF PHONETIC-PHONOLOGY IN THE SPOKEN OF KARADAK, SHKUP VEÇORITË FONETIKE-FONOLOGJIKE TË TË FOLMES SË KARADAKUT TË SHKUPIT

ASLLAN HAMITI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare, Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski", Universiteti
"Shën Qirili e Metodi", Shkup, MAQEDONI

Email: asllan_hamiti@yahoo.com

AKTET IV, 4: 672 - 676, 2011

PERMBLEDHJE

Karadaku i Shkupit shtrihet në zonën veriore të Maqedonisë. Pjesa skajore e këtij regjioni shtrihet përgjatë kufirit të Maqedonisë me Kosovën. Ai përfaqëson një tërësi gjeografike, etnografike dhe gjuhësore. Në këtë kumtesë do të trajtojmë përmbledhtas veçoritë fonetike e fonologjike të të folmes në fjalë. Do të shqyrtojmë inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore, vlerën fonologjike të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve, mungesën e fonemës /ë/, dukuritë fonetike, siç janë diftongimi i zanoreve, qiellzorizimi i ëgç-së në ëgç, shqiptimi më i përparmë i mesgjuhoreve ëq, gjç; shndërrime zanoresh e bashkëtingëlloresh, buzorëzimin e zanores ëaç në ëoç, përngjashmimin e grupeve të zanoreve e të bashkëtingëlloresh, rënien dhe shtimin e tingujve etj. dhe në fund kemi përcaktuar vendin e kësaj të folmeje në strukturën dialektore të shqipes.

Fjalët çelës: e folme, inventar, diftongim, qiellzorizim, afrikatizim, buzorëzim

SUMMARY

The spoken of Karadaku-Shkup is on field in the north of Macedonia. The divvy of this field is in the boundary of Macedonia with Kosova. It's representative of the geographic, ethnographic and linguistic in the general altogether. In this studies we'll attend the specialty of phonetic and phonology at the spoken of Karadak – Shkup. In the following we will study for vowel and consonant in the concept of phonology and their length of nasalize. The wantage of the vowel /ë/ and the phonetic occurrence are the diphthong of vowels, the palatal ëgç into the ëgç, the before pronunciation of ëq, gjç; the conversion of vowel and consonant; the labial of the vowels ëaç into ëoç; the simulation groups of vowel and consonant and the falling or raise etc. The end of this study we have decided for the place of that spoken and the structure of the Albanian dialects.

Key words: Spoken, inventory, diphthong, palatal, affricate, labial.

HYRJE

Ndërmjet Shkupit, Kumanovës, Gjilanit, Preshevës dhe Kaçanikut shtrihet një krahinë malore që quhet Karadak. Këto vargmale ngjiten përpjetë nga lugina e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës (në lindje), Lugina e Gjilanit (në veri) dhe rrjedha e lumit Lepenec (në perëndim). Ky masiv malor shtrihet në drejtimin jugperëndim – verilindje, me majën më të lartë Ramno që ka 1.651 metra lartësi mbidetare ("http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopaska_Crna_Gora").

Në Karadaku e Shkupit jetojnë popullsi me përkatësi të ndryshme kombëtare: shqiptarë, maqedonas, serbë, myslimanë, turq, romë dhe të tjerë.


Karadaku i Shkupit (që e quajmë edhe Mali i Zi i Shkupit, *maq.* Скопска Црна Гора (Skopska Crna Gora) shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë. Ai përfaqëson një tërësi gjeografike, etnografike dhe gjuhësore. Kufiri verior i Karadakut të Shkupit përkon me kufirin e Maqedonisë me Kosovën. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës dhe të

Likovës, ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec si edhe rruga magjistrale Shkup – Prishtinë.

Në këtë kumtesë do të trajtojmë përmbledhtas veçoritë kryesore fonetike e fonologjike të këtij areali gjuhësor, përkatësisht të 11 fshatrave me mbi 15 mijë banorë, pra të katundeve Tanushë, Brezë, Malinë, Bllacë, Luboten, Straçincë, Orllancë, Mojançë, Grushinë. Për shkak se pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave Haraçinë dhe Hasanbeg, që gjenden në jug të zonës, janë

të ardhur nga katundet përreth, në aspektin dialektor edhe këto dy fshatra i takojnë këtij areali.

Materialin dialektor e mblodhëm nëpër të gjitha fshatrat e kësaj krahine të banuara me shqiptarë, me pyetje të tërthorta në bazë të një pyetësi dhe me biseda të lira e tematike me informues tipikë të moshuar e të paarsimuar, të cilët nuk kanë munguar për një kohë të gjatë nga vendi i lindjes.



Inventari i fonemave zanore

Në mënyrë të përgjithësuar, vështruar nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike, kjo e folme ka një sistem zanoresh me kundërvënie fonologjike të gjatësisë (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) dhe të hundorësisë (zanore gojore ~ zanore hundore). Rrjedhimisht, kjo e folme ka një inventar me 14 fonema zanore të theksuara (10 gojore dhe 4 hundore), nga të cilat:

5 të shkurtra: /a/ /e/ /o/ /i/ /u/

5 të gjata: /a:/ /e:/ /o:/ /i:/ /u:/

4 hundore: /ã/ /ê/ /ê/ /û/

Në rrokje të patheksuar përdoret edhe zanorja e shkurtër /ë/ që ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës.

Këto 14 fonema zanore kanë fushë të gjerë përhapjeje, përkatësisht realizohen nëpërmjet modifikimeve të ndryshme si alofone, deri sa edhe si diftongje gjatë shpërbërjes së /i/-së dhe

të /u/-së në dyzanorësh: /i/ në ëaiç, ëëiç, ëëiç: *shpai, shpëi* (< shpi, shtëpi), dhe të /u/ në ëauç: *nause* si dhe në formë të monoftonguar *na:se* (< nuse); diftongoide ëäç: *caëng* (< cung), *rraësh* (< rrush); ëuçoç: *kuodër* (< kodër), *muotër* (< motër), *i vuogël* (< i vogël); sekuenca diftongore ëieç: *gjieth, liepër, lietër, viega* (< gjeth, lepur, letër, vegë) etj.

Këto fonema në rrokje të theksuar në trekëndëshin akustik mund të paraqiten kështu:

a) të shkurtra b) të gjata c) hundore
 /i/ /u/ /i:/ /u:/ /î/ /û/
 /e/ /o/ /e:/ /o:/ /ê/ /ã/
 /a/ /a:/

Zanoret e theksuara janë afërsisht dy herë më të gjata sesa të patheksuarat. Këtu na dalin 6 zanore në rrokje të patheksuar:

ëaç, ëeç, ëëç, ëoç, ëiç dhe ëuç.

Përgjithësisht, si në të gjitha të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallojmë tri gjatësi zanorësh: të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Por, vetëm të shkurtrat krijojnë kundërvënie fonologjike me zanoret e gjata, ndërsa zanoret e gjatësisë së mesme nuk krijojnë kundërvënie, ato nga pikëpamja e gjatësisë janë asnjansë. Gjatësia e zanoreve në këtë të folme, si edhe në të gjitha të folmet e tjera gege ka vlerë kuptimdalluese (semantike), si në çiftet minimale të fjalëve: *kos* ~ *ko:s* 'kos-i – kos-a', *çaj* ~ *ça:j* 'çaj-i për pije - shqyej', *boll* ~ *bo:ll* 'mjaft – bollë, lloj gjarpri' ose funksion gramatikor: që të bëjë dallimin e gjinisë së emrit (mashkullor – femëror): *plak* ~ *pla:k* 'plak - plakë', *kunat* ~ *kuna:t* 'kunat - kunatë'; dallimin e numrit (njëjës – shumë): *dishek* ~ *dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *dham* ~ *dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *dollap* ~ *dolla:p* 'një dritare – shumë dritare' etj.

Edhe pse zanoret hundore janë pjesë e shprehisë nyjetimore të Shqiptarëve të Karadakut të Shkupit, ekzistenca e një numri të vogël të çifteve minimale fjalësh që dallohen nëpërmjet opozicionit fonologjik zanore gojore ~ zanore hundore dëshmon për prirjen e kësaj të folmeje, si edhe të folmeve të tjera gege (në jug më shumë e në veri më pak) për humbjen e vlerës

fonologjike të hundorësisë, përkatësisht prirjes për defonologjizimin e hundorësisë dhe të gjatësisë së zanoreve. Nga materiali i vjelë dialektor e kemi pasur vështirë që të veçojmë çifte të tilla fjalësh të cilat hundorja i kundërvihet zanores përkatëse gojore për të krijuar fjalë me kuptim të ndryshëm. Të tillë kemi shembuj të paktë:

kundërvënie fonologjike zanore gojore ~ zanore hundore				
zanore gojore	kuptimi	~	zanore hundore	kuptimi
rraj	rri	~	rrã:j	rrënjë
lam (na)	(ne) lamë	~	lã:m	lëmë
jan	jan-i	~	jã:n	(ata) janë
(gjemt) tan	djemt tanë	~	e tã:n	e tundë
(ata) kan	(ata) kan	~	kã:n	kën/ë,-a

Theksi

Lidhur me theksin, e folmja shqipe e Malit të Zi të Shkupit, si edhe përgjithësisht të folmet e tjera, nuk përfaqëson izoglosë më vete, por përfshihet në makrosistemin dialektor.

Edhe në këtë të folme, theksi është dinamik, i palëvizshëm në paradigmat e eptimit dhe i ngulitur në një rën nga dy rrokjet e fundit të fjalës, rëndom në rrokjen parafundore ose në rrokjen fundore.

Në këtë të folme, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, kur diftongohen zanoret e mbyllura të theksuara /i/ ose /u/, atëherë theksi rregullisht qëndron mbi të njëjtën rrokje, përkatësisht në zanoren e mirëfilltë të diftongut. Krahaso shembujt: *kusi* > *kusai*, *burrnim* > *burrnëim*, *stërnip* > *stërnaip*, *koleshnik* > *koleshnëik*, *nuse* > *nause*, *arushë* > *araush*, *katun* > *kataun*, *kërcunj* > *kërcaung* etj. Theksi bie mbi rrokjen e njëjtë edhe kur diftongu dytësor monoftongohet, sipas tipit: *arushë* > *arash* > *ara:sh*, *nuse* > *nause* > *na:se*, *katund* > *kataun* > *kata:n....*

Në këtë të folme (si në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes) disa emra që në toskërishte shqiptohen me theks në rrokjen fundore *verí, qirí, njerí* etj., në të folmen tonë të njëjtat shqiptohen me theks parafundor, si *véri, qirí, njé:r*.

Prirja e përgjithshme për të theksuar emrat në rrokjen e dytë në këtë të folme del në shesh edhe te disa huazime orientale, të cilat edhe këtu shqiptohen me theks në rrokjen parafundore, si: *káfe, páre, xhézve, tenxhére, tenéqe, téqe, mináre, matáre, çáre, kadífe, déve, feréxhe, xháde, zérde, zahíre* etj, sikurse dhe disa emra vetjakë me burim oriental: *Fatíme, Makfíre, Zahíde, Naíle, Hatíxhe, Halíme, Ájshë* etj. Kjo zhvendosje e theksit nga rrokja fundore në atë parafundore bëhet për shkak të përshtatjes së fjalëve të huazuara me tipin më të përhapur të theksimit të fjalëve në shqipen.

Edhe te sllavizmat (para së gjithash maqedonizmat dhe serbizmat) si dhe tek huazimet e tjera josllave, të huazuara kryesisht me ndërmjetësimin e gjuhës maqedonase, bëhet rregullimi mekanik i theksit, gjegjësisht përshtatja me natyrën e theksit të shqipes. Këto fjalë në trajtën e pashquar më së shumti përdoren si oksitonë. Krahaso shembujt: *koçnicë > koçní:c, kolicë > kolí:c, bollnicë > bollní:c, bullicë > bullí:c > bullaíc, kovác, varanicë > varanaíc, slluzhbeník, opshtinë > opshtí:n, fllaník, popllavë > popllá:v, direktór, sekretá:r, çuvá:r, shumá:r, (mesna) zaední:c* etj.

Inventari i fonemave bashkëtingëllore

E folmja e fshatrave Luboten, Straçincë, Bllacë, Mojancë dhe Orllancë ka një inventar me 29 fonema bashkëtingëllore, ndërsa e folmja e fshatrave Tanushë, Brest, Malinë dhe Grushinë kanë 30 fonema bashkëtingëllore, sepse kanë më tepër bashkëtingëlloren prapagjuhore /ŋ/, që është përftuar nga përngjashmimi i grupit /ng/:

/p/, /b/, /m/, /f/, /v/, /t/, /d/, /l/, /ll/, /c/, /x/, /s/, /z/, /n/, /r/, /rr/, /ç/, /xh/, /sh/, /zh/, /th/, /dh/, /q/, /gj/, /j/, /nj/, /k/, /g/, (/ŋ/), /h/.

Ndër tipare fonetike-fonologjike më të rëndësishme të kësaj të folmeje janë edhe:

1. Diftongimi i zanoreve të mbyllura të theksuara /i/ dhe /u/ në diftongje dytësore, përkatësisht i /i/-së në *ëai, ëiç* dhe i /ú/-së në *ëau, ouç*, si shpër: *> shpai, shpëi*; *núse > nause, nouse*;
2. monoftongimi i diftongjeve në zanore të mirëfillta (arú:sh > araush > araësh, *ara:sh*; rrú:sh > rraush > rraësh > *rra:sh* etj);
3. Përdorimi i shpeshtë i të njëjtave fjalë në dy forma fonetike: të diftonguar dhe të padiftonguar, si *mullëi* dhe *mulli:*, *kusai - kusí:*, *sëi - si*, *temcëi - tepsí:*; *kataun - katu:n*, *fortaun - fortu:n*, *ftaurk - ftu:rk* etj.
4. Zhbuzorëzimi i *ëýç > ëiç* dhe zbërthimi i mëtutjeshëm në diftong dytësor (*sý:* > *sí:* > *sai. sëi*), si dhe shndërrimi i /y/ -së në *ëuç*: *shyt > shut*, *dynja: > dunja:*, *ymyt > umut*;
5. Mospërdorimi i zanores *ëëç* në pozitë të theksuar;
6. Labializimi i hundores së përgjithshme gege *ëãç* në *ëoç* (*hã:n > ho:n*, *nã:n > no:n*, *kãma > koma*, *bãna > bona*);
7. Rënia e *ëëç*-së në fundin absolut të fjalës, si *a:r* < arë, *do:r* < dorë, *bu:rr* < burrë, *pla:k* < plakë, *dishë:k* < dyshekë;
8. Mossqiptimi i shpeshtë i /ë/-së në pozitë të patheksuar edhe në mes të fjalës: *tlin* < tëlyen, *malsai* < malësi, *udhta:r* < udhëtar, *lku:r* < lëkurë, *knu:s* < këndues etj.
9. Shndërrimi i zanores /u/ të patheksuar në *ëëç*: *flutër* < flutur, *kumëll* < kumbull, *hekër* < hekur etj.
10. Konsonantizimi i *ëiç*-së dhe i *ëuç*-së së patheksuar në *ëjç*, respektivisht në *ëvç* në fund të fjalës, si: *aj shkoj* (< ai shkoi), *ja* (< ia), *vllaj ma j madh* (< vllai ma i madh); *e piv*, *e dav*, *e prev*, *e thav* (< e piu, e ndau, e preu, e thau) etj;
11. Ruajtja e grupeve e zanoreve *ëaeç* dhe *ëoeç*: *pae*, *lae*, *voe*;
12. Monoftongimi i togjeve të zanore *ëieç* dhe *ëueç* në zanore të gjata *ëi:ç* dhe *ëu:c*: *diell* > *di:ll*, kam punue > *kam punu:*, por edhe diftongimi i *ëauç* (*punau*) si dhe monoftongimi i të njëjtës, në fshatin Brezë në zanore të gjatë *ëa:c*: *puna:* etj.;
13. Qiellzorëzimi i *ëgç*-së dhe i grupit të vjetër konsonantik *ëglç* në *ëgjç*: *gisht > gjisht*, *gur > gjur*, *gojë > gjo:j*, *prag > pragj*, *larg > largj*; nga forma e

vjetër gluha > *gjuha*, gluni > *gjuni*; i, e glatë > *i*, e *gja:t* etj.

14. Palatalizimi i grupit të bashkëtingëlloreve ëd**ç** > ë**g**ç: *dja:l* > *gja:l*, *dje* < *gje* dhe i ë**pl**ç > ë**q**ç, si *plak* > *qak*, *plesht* < *qesht*, *pleh* < *qeh*, *plep* < *qep*;

15. Afrikatizimi i bashkëtingëllores qiellzore ë**ç**ç > ë**ç**ç: *qen* > *çen*, *qafë* > *ça:f*, *faqe* > *façe*, *qiell* > *çi:l*! si dhe i ë**g**ç > ë**xh**ç, si në fjalët *gjak* > *xhak*, *gjumë* > *xhu:m*, *gjarpën* > *xharpën*, *gjysmë* > *xhimc*.

16. Shndërrimi i ë**n**ç > ë**j**ç: *zo:j* < *zonjë*, *pej* < *penj*, *rra:j* < *rrënjë*, *e ejte* < *e enjte*, *i shtre:jt* < *i shtrenjtë* etj. e më rrallë në ënç, si *ni* < *një*, *nizet* < *njëzet*.

17. Përngjashmimi (në Tanushë, Bllacë, Mojançë, Orllancë, Brezë dhe Grushinë) dhe ruajtja (në fshatrat Luboten dhe Straçincë) e grupeve të bashkëtingëlloreve ë**m**bç, ë**nd**ç dhe ë**ng**ç: *dham* - *dham*, *vend* - *ven*, *ngat* - *ngat*, *gat*;

18. Rënia e ë**j**ç-së në grupet e bashkëtingëlloreve ë**p**jç, ë**m**jç, ë**v**jç: *pje:shk* > *peshk*, *kam mje:l* > *kam mel*, *vjehërr* > *vehërr*);

19. Ruajtja e grupit ë**fl**ç në fshatrat Tanushë, Bllacë, Mojançë, Orllancë dhe Grushinë: *fla:k*, *flo:k*, *flutër* etj. dhe jonizimi i tij në fshatrat Brezë, Malinë, Straçincë dhe Luboten: *fja:k*, *fjo:k*, *ffutër*.

Vendi i të folmes së Karadakut të Shkupit në strukturën dialektore të shqipes

Sipas veçorive gjuhësore që përkojnë me shtrirjen gjeografike, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit mund të cilësohet si **e folme më skajore verilindore e gegërishtes qendrore**. Me fjalë të tjera, të folmet e fshatrave të Malit të Zi të Shkupit, si për nga shtrirja hapësinore, ashtu edhe për nga tiparet gjuhësore, përfaqësojnë kufirin më verior të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore. Pjesa veriore e kësaj krahine në një farë mënyre është përvijuar me kufirin shtetëror të Maqedonisë me Kosovën: fshatrat Tanushë, Bllacë dhe Brezë kufizohen me të folmet e gegërishtes verilindore (afër kufirit të Maqedonisë me Kosovën), ndërsa vendbanimet e

tjera shtrihen diçka më në jug të kësaj zone kufitare. Prandaj, kjo e folme përfaqëson një izoglosë “*ndërkaluese nga gegërishtja qendrore në gegërishten verilindore*”.

Si përfundim, në strukturën dialektore të shqipes, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit i përket *gegërishtes qendrore*, por në të gjejmë të gërshetuara mjaft tipare gjuhësore të gegërishtes verilindore.

LITERATURA

BAHRI Beci (1985), Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike: Studime Filologjike 1: 93-109.

BECI, Bahri (1962/2, 1963/3), Hulumtime gjuhësore në Mat, BUSH, SShSh, Tiranë.

BECI, Bahri (1965), Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme: Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë.

BECI, Bahri (1987), Të folmet qendrore të gegërishtes: Dialektologjia shqiptare V, Tiranë.

BECI, Bahri (1994), Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes: Jehona 1-2, Shkup.

DODI, Anastas (2004), Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë.

GJINARI, Jorgji (1989), Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë.

gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë.

HAMITI, Asllan (1999), E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup.

HAMITI, Asllan (2005), Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Shkup.

TAGLIAVINI, Carlo (1978), Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore: Studime

TOPALLI, Kolec (1995), Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë.

TEXT STUDIES BEYOND THE SENTENCE IN ALBANIAN. CASE STUDY: THE PARAGRAPH STUDIMET TEKSTORE TË SHQIPES PËRTEJ FJALISË DHE PERIUdhËS. SHEMBULL I STUDIMIT: PARAGRAFI

LINDITË SEJDIU - RUGOVA

Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË

Email: linditarugova@gmail.com

AKTET IV, 4: 677 - 681, 2011

PERMBLEDHJE

Shpjegimi i elementeve përbërëse të një paragrafi është shumë me rëndësi për studimet e tekstit meqë paraqet një nga problemet kryesore të analizave të diskursit dhe atyre pragmatike të kohëve të fundit. Gjatë analizës sonë do t'i shqyrtojmë vetëm ato elemente që janë me rëndësi për punimin në fjalë: forma e tekstit, tipat e tekstit (strukturimi i tekstit) dhe mënyra e shprehjes së koherencës tekstore tematike. Në kuadër të kohezionit gramatikor do të ndalemi te referenca gjuhësore brenda tekstit dhe te elementet e tjera kohezive, ndërkaq nga aspekti i këndvështrimit do t'i vështrojmë kohët e foljeve në tekst. Paragrafi është nxjerrë qëllimisht nga një vepër letrare në prozë e përkthyer nga anglishtja në shqip, me qëllim të identifikimit të problemeve që dalin gjatë përkthimit nga gjuhët e tjera në shqip, veçanërisht në rrafsh të një njësie hierarkike më të lartë se fjalia dhe periudha.

Fjalët çelës: tekst, diskurs, paragraf, kompozicion, këndvështrim

SUMMARY

The explanation of constituent elements of the paragraph is of great importance for the text studies since it belongs to one of the most problematic cases of recent discourse and pragmatic analyses. The paper will concentrate on explaining the most relevant elements of that category: text form, text type, text structure, and expression of text thematic coherence. Within the grammatical cohesion, the paper will focus on language text reference and other cohesive elements, whereas verb tenses will be analysed from the perspective of point of view category of text analysis. The paragraph has been taken in purpose from a literary work translated from English into Albanian in order to identify translation problems that come out on the level of higher syntactic units other than a sentence.

Key words: text, discourse, paragraph, composition, point of view

HYRJE

Ka kaluar tashmë më se një gjysmë shekulli që kur Zellig Harris-i, në punimin e tij shkencor "Discourse Analysis", të botuar në revistën shkencore "Language", nr. 28, të vitit 1952, për herë të parë e ka përmendur termin "discourse" (diskurs) që për Harris-in paraqiste një njësi gjuhësore të rangut më të lartë, e cila përcaktohet nga lloje të ndryshme të varshmërive brenda saj dhe që lidhen me njëra-tjetrën. Ishte kjo një ngjarje e madhe në qarqet gjuhësore meqë nga aspekti metodologjik dhe teorik po

flitej shkencërisht për një koncept që tejkalonte konceptin e fjalisë dhe të periudhës.

Koncepti i atëhershëm i Harris-it nuk kishte të bënte drejtpërsëdrejti me analizën e sotme të diskursit, por ishte më tepër koncept pragmatik. Analiza e diskursit sot paraqet një sërë aktivitete, duke filluar nga një hulumtim i thjeshtë i përdorimit të pasthirmës 'oh' që përdoret në bisedat e zakonshme e deri te hulumtimi dhe studimi i të shprehurit të ndonjë ideologjie kulturore në, për shembull, praktikat arsimore apo politike (Brown & Yule, 1983: 83).

Në qoftë se e përkufizojmë analizën e diskursit në kornizat gjuhësore, atëherë kemi të bëjmë me të dhënat (të folura ose të shkruara) e procesit, nëpërmjet të cilit gjuha përdoret në një kontekst të caktuar për të shprehur një qëllim të caktuar.

1. Studuesit shqiptarë të tekstit

Në fillim të viteve '70, në gjuhësinë shqiptare nisnin studimet e para në këtë fushë të shkencës së gjuhësisë, pikërisht me përmbledhjet *Shenjë dhe ide* (1974) dhe *Shumësia e tekstit* (1980) të Rexhep Ismajlit. Ismajli thekson nevojën e studimeve në nivelin e përtejfrazës, të tekstit dhe sugjeron që kjo gjuhësi të vendosë njëfarë raporti barazie midis dy niveleve: atij sintagmatik dhe paradigmatic, meqë gjuhësia e frazës i thekson vetëm raportet paradigmatiche.

Përpos Ismajlit, mund të theksojmë edhe disa botime të viteve të fundit që do të mund të radhiteshin në vazhden e studimeve gjuhësore të tekstit në gjuhën shqipe. Mund të përmendet vepra *Monologu i brendshëm* i Lindita Tahirit, në të cilin studiuesja merret me interpretimin e një teknike letrare dhe që synon përshkrimin formal gjuhësor të kësaj teknike. Studimi i takon stilistikës letrare dhe nxjerr në pah domethënien funksionale të tekstit letrar në sfondin e studimeve stilistike. Studim tipik dhe modern gjuhësor të një teksti, përkatësisht të gjuhës së gazetave në Kosovë paraqet libri i studiuesit Bardh Rugova, i cili e trajton problemin nga dy këndvështrime kryesore: nga rrafshi sociolinguistik dhe nga rrafshi i analizës së diskursit.

Marrë në tërësi, interesimi për studime të gjuhësisë së tekstit dhe të gramatikës së tekstit në veçanti, ndonëse pak i vonuar, është gjithnjë e më i pranishëm në qarqet gjuhësore shqiptare. Edhe në Shqipëri në fund të viteve '90 dhe në fillim të mileniumit të ri u botuan disa tekste universitare dhe punime të tjera shkencore nga kjo fushë e studimit të gjuhës (Klodeta Dibra, Nonda Varfit, Linda Meniku), kryesisht duke i bartur përvojat e studimeve të gjuhëve evropiane në studimin e tekstit në shqip, por shumica sosh mbetën nën hijen e përshkrimeve teorike.

2. Studimi i paragrafit – studim primar i tekstit përtej fjalisë

Objektivi ynë i studimit ka të bëjë me studimin e paragrafit (në rastin tonë të një paragrafi rrëfimor apo narrativ), i cili bën pjesë në hierarkinë e njësive tekstore brenda kategorisë tekstore të kompozicionit. Paragrafi narrativ (rrëfimor) është nxjerrë nga romani i George Orwell-it, *Animal Farm*, i përkthyer në shqip nga A. Kallamata si *Republika e kafshëve*.

Megjithatë, këtu do të ndalemi vetëm te rasti i shqipes. Analiza tekstore e bërë në këtë kapitull është mbështetur kryesisht në studimet tekstore që janë bërë për anglishten (Werlich E., 1982), gjithnjë duke e përshtatur teorinë e përgjithshme edhe për shqipen.

Paragrafi i zgjedhur për analizë:

Në prill, Ferma e Kafshëve u shpall Republikë, ndaj doli e nevojshme që të zgjidhej edhe një President. Pati vetëm një kandidat, Napoleoni, që u zgjodh me qind për qind të votave. Po atë ditë, u njoftua se qenë gjetur dokumente të reja, që nxirrnin më mirë në pah lidhjet e Snoubollit me Xhonsin. Tani dilte se Snoubolli jo vetëm kishte tentuar të humbiste Betejën e Stallave me anë të një strategjie të gabuar, siç e dinin deri atëherë kafshët, por edhe kishte marrë pjesë hapur në luftim përkrah Xhonsit. Në fakt, vetë ai kishte qenë në krye të forcave njerëzore dhe qe sulur në ballë me parullën "Rroftë njerëzimi!". Plagët që kish marrë në kurriz e që kafshët i mbanin ende mend, s'ishin tjetër veçse plagë të shkaktuara nga dhëmbët e Napoleonit.

Ky paragraf në gjuhën shqipe bën pjesë në format tekstore narrative a rrëfimore. Në format e tilla tekstore dërguesi (folësi) i paraqet veprimet nga këndvështrimi subjektiv dhe i regjistron këto veprime dhe ngjarje nga këndvështrimi i përshtypjeve të tij subjektive në kohë. Pra, faktori kohë në këtë paragraf (*Po atë ditë, deri atëherë*) luan rol qenësor në përcaktimin e formës së tij tekstore. Por, jo domosdoshmërisht një paragraf është vetëm narrativ, ai jo rrallë kombinohet me formën deskriptive (përshkruese) të tekstit.

Fjalja e dytë e paragrafit është tipike për format tekstore përshkruese (trajtat gramatikore me

është / janë, gjendet/gjenden, i karakterizojnë tekstet e tilla): *Patj* (= qe, gjendej) vetëm një kandidat, Napoleoni, që u zgjodh me qind për qind të votave.

Stili neutral i një paragrafi narrativ gradualisht modifikohet nga stili krahasues apo metaforik i dërguesit (folësit), nëpërmjet trajtave gramatikore krahasuese (*Anija vezullonte si xham*), apo të metaforave të ndryshme (*Bardhësia ishte ashpërsia e valëve të detit*) (Werlich, 1982). Por, meqë paragrafi ynë e arrin koherencën tematike duke e paraqitur një ngjarje në mënyrë kronologjike e të kombinuar me sekuenca të një rrëfimi (*plot*) të përmbyllur brenda vetë paragrafit dhe, meqë më tepër i ngjason një raporti kronologjik të një ngjarjeje që kishte ndodhur para çastit të ligjërimit, nuk përmban shumë krahasime dhe elemente metaforike. Koha e përfundimit të veprimit, në këtë paragraf, nuk ka ndonjë lidhmëri gramatikore a funksionale me çastin e ligjërimit.

Dërguesi koherencën funksionale specifike për këtë tekst e arrin nëpërmjet zgjedhjes së këndvështrimit personal dhe zakonisht flet nga veta e parë njëjës apo nga veta e tretë njëjës (*doli e nevojshe, u njoftua, dilte, kishte tentuar të humbiste, ai kishte qenë*). Dërguesi tenton që të kombinojë këndvështrimin e orientuar drejt një vete të caktuar (në rastin konkret drejt personazhit të Snoubollit) me këndvështrimin e grupit të foljeve të përdorura në të shkuarën, si p.sh.: *u shpall, doli, u njoftua, dilte*.

Sa i përket fokusit, si element shumë i rëndësishëm i këndvështrimit të dërguesit, bashkë me vetën dhe kohën e që ka të bëjë me këndin e ndryshueshëm të të parit të fenomeneve nga ana e dërguesit në një kontekst hapësinor-kohor, në paragrafin tonë narrativ të zgjedhur për analizë, fokusi është i ngushtuar, meqë e tërë ngjarja përshkruhet brenda një dite të caktuar të muajit prill, ditës kur edhe u përhap lajmi për tradhtinë e Snoubollit.

Në rrafsh të formës është paragraf kryesor, meqë paraqitet si paragraf i paraqitjes së një informacioni shumë të rëndësishëm brenda kapitullit të nëntë të romanit *Animal Farm /Republika e kafshëve*, atë të zgjedhjes së

Napoleonit kryetar dhe të nxjerrjes në pah të fakteve të reja rreth tradhtisë së Snoubollit. Për nga strukturimi tekstual paragrafi i tij del të jetë paragraf i lidhur për kotekstin (*cotext-bound text structuring*), meqë organizimi i fjalive në të bëhet sipas një modeli koherencial të sekuencës kohore:

Në prill, Ferma e Kafshëve u shpall Republikë,... Po atë ditë, u njoftua se qenë gjetur dokumente të reja,... bashkë me trajtat kohore të së shkuarës janë segmente gjuhësore që lidhen me perceptimin kohor të dërguesit.

Është paragraf me progresion në të djathtë, pra fjalia mbështetëse (*Po atë ditë, u njoftua se qenë gjetur dokumente të reja, që nxirrnin më mirë në pah lidhjet e Snoubollit me Xhonsin.*) pasohet nga fjalitë e pjesërishme, nga zgjerimet e saj tematike. Fjalitë tipike për këtë lloj të paragrafit janë fjali të regjistrimit të veprimit, fjali që përmbajnë folje kalimtare dhe kundrinat e tyre, ndërkaq përdorimi i shpeshtë i plotësive ndajfoljorë i karakterizon këto fjali.

Sa i përket realizimit të kohezionit gramatikor, do të ndalemi te *realizimi i referencës* brenda këtij paragrafi. Referenca është kryesisht: anaforike, e shprehur me përemrin dëftor *atë* (*Në prill.... atë ditë*), me përemrin vetor *ai* (*Snoubolli....ai*), me trajtën e shkurtër të përemrit vetor *i* (*plagët... i*); ekzoforike me shquarsinë e emrit kafshët (*-ët*), por del edhe në formën e saj kataforike, me përemrin vetvetor *vetë* (*Snouboll...., vetë ai*) dhe me përemrin e pacaktuar *tjetër* (*...s'ishin tjetër veçse plagë të shkaktuara nga dhëmbët e Napoleonit.*)

Mjetet kohezive të lidhshmërisë në paragrafin narrativ janë: *në prill* – mjet kohor i lidhshmërisë me kuptim të specifikimit të kohës në paragraf, *ndaj* – mjet i thjeshtë i lidhshmërisë që shpreh marrëdhënie shkak-pasojë (radha e parë e paragrafit), *po atë ditë* - mjet i thjeshtë kohor i lidhshmërisë me kuptim të simultanitetit (radha e tretë e paragrafit), *tani* – mjet i tërthortë i lidhshmërisë që ka forcë kohezive dhe që bën pjesë në të ashtuquajturit “continuatives” (radha e katërt e paragrafit) dhe *në fakt* – është mjet përqasës kontrastiv i lidhshmërisë me kuptim të

pohimit a të deklarimit (radha e shtatë e paragrafit).

Po qe se i analizojmë kohët e foljeve në këtë paragraf rrëfimor vërejmë se kohët e shkuara dominojnë dukshëm. Nga 18 trajta foljore të përdorura shtatë të tilla janë në të kryerën e thjeshtë, tre në të pakryerën, katër në më se të kryerën, dy në të kryerën e tejshtuar dhe tre të tjera në të pakryerën e lidhore. Rrjedhimisht, vështruar nga aspekti i qëndrimit folës, kemi të bëjmë me paragraf rrëfimor, meqë asnjë kohë e së tashmes a e së ardhmes nuk është përdorur. E kryera e thjeshtë dhe më se e kryera janë tipike rrëfimore, ndërkaq e kryera e thjeshtë dhe e pakryera dalin si kohë karakteristike për planin e parë, derisa e tejshtuara si kohë e prapavijës. Më se e kryera, që është përdorur 4 herë në paragraf, shpreh një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Te kjo kohë, koha e veprimit, zhvillohet para kohës së vështrimit, koha e vështrimit para çastit të ligjërit. E kryera e tejshtuar në të gjitha rastet e përdorimit të saj në paragrafin e përkthyer në shqip tregon parakohësi dhe është kohë e rrëfimit. Kuptimi i saj themelor, sikurse te më se e kryera, është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

3. Në vend të përfundimit

Vërehet një tendencë e përkthyesit që barasvlerat e fjalive në shqip t'ia përshtatë origjinalit në anglisht jo vetëm me kuptim, por edhe me struktura gjuhësore, ndonjëherë, atipike për shqipen. Një dukuri e tillë shkakton shpeshherë probleme gjatë përcaktimit dhe analizës së materialit gjuhësor në shqip. Prapëseprapë, këto keqpërkthime nuk kanë ndikuar në llojin e formës së tekstit a të tipit të saj. Në të dy gjuhët, teksti rrëfimor mbetet rrëfimor dhe pikërisht kohët e foljeve në tekst e përcaktojnë një gjë të tillë. Qëllimi i analizës tekstore është që para së gjithash t'i tejkalojë barrierat përkthimore nga njëra gjuhë në tjetrën për nevojat praktike të specialistëve të gjuhës dhe të përdoruesve të rëndomtë. Dallimet strukturore ndërmjet shqipes dhe anglishtes janë më të mëdha se ato funksionale, për shkak të

fleksionit të zhvilluar të shqipes. Rrjedhimisht, përkthimi i strukturave del shpeshherë më i vështirë.

Teoria e analizës së tekstit i nxjerr në pah shumë nga gabimet gramatikore dhe kuptimore të përkthimit të një teksti nga njëra gjuhë në tjetrën, por është qenësore në përcaktimin e grupit, të formës dhe të tipit të tekstit. Ristrukturimi i fjalive duke i marrë parasysh elementet kompozicionale të tekstit (kohët e foljeve, veta, mënyra, aspekti) si dhe ato të shprehjes së koherencës tekstore dhe të kohezionit në përgjithësi (koherenca tematike e funksionale, referencialiteti, zëvendësimi, lidhshmëria) janë zbërthyesit kryesorë pragmatikë të një teksti, në rastin konkret të një paragrafi rrëfimor.

BIBLIOGRAFIA

- BROWN G, Yule G. (1983), *Discourse Analysis*, Cambridge University Press, Cambridge;
- DE BEAUGRANDE R., DRESSLER, W. (1981), *Introduction to text linguistics*, Longman, London & New York.
- DIBRA, K., VARFI, N. (2000), *Deiksis dhe shprehjet deiktike në gjuhën shqipe: "Studime albanologjike"*, 5/6, Tiranë.
- HALLIDAY, M. A. K., HASAN, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman, London.
- HALLIDAY, M. A. K., (2002), *Text and Discourse*, Continuum, London.
- HARRIS, Z. (1952), *Discourse Analysis: A sample test: "Language"*, 28:4, 474-494.
- HARRIS, Z. (1966), *Structural Linguistics*, The University of Chicago Press, Chicago.
- ISMAJLI, R. (1974), *Shenjë e ide*, Rilindja, Prishtinë.
- ISMAJLI, R. (1974), *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë.
- RUGOVA, B. (2009), *Gjuha e gazetave*, KOHA, Prishtinë.
- TAHIRI, L. (2006), *Monologu – personazhi dhe autori*, Kosova Pen Center, Prishtinë.
- VAN DIJK, T. (1989), *Text and Context*, Longman, London.

WERLICH, E. (1983), A Text Grammar of English,
Quelle & Meyer, Stuttgart..

DENDËSIMI EMOCIONAL I SHENJËS, NËPËRMJET PËRFTESAVE POETIKE MODERNE E POSTMODERNE NË KOHËN E BRITMËS, V. ZHITI

MARISA KËRBIZI

Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
Email: mkerbizi@yahoo.com

AKTET IV, 4: 682 - 688, 2011

PERMBLEDHJE

Qëllimi i këtij punimi, është analiza dhe interpretimi i përftesave poetike, tek romani *Në kohën e britmës*, të shkrimtarit brilant Visar Zhiti. Thyerja e variantit tradicional të ndërtimit të fjalisë, mungesa e shenjave të pikësimit, përdorimi i pazakontë i shkronjës së madhe, dendësimi i kuptimit të fjalës në rrafshin sintagmatik, përdorimi i rimës, aliteracionit, reticënsës etj., e afrojnë gjuhën e prozës me poezinë. Kësaj, zbehet funksioni komunikues i gjuhës dhe forcohet funksioni estetik i saj, i cili e bën mesazhin referues.

Fjalët kyçe: Përftesa poetike, dendësimi i kuptimit, rimë, aliteracion, reticënsë, funksion estetik i gjuhës.

HYRJE

Në kohën e britmës, është roman i sendërtuar nga sublimimi i përvojës jetësore të shkruarit të saj. Që në paratekst (titull), shpaloset një univers ndjenjësor i ngarkuar negativisht. Koha e rrëfyer është relativisht e gjatë; ajo nis *in medias res*, në vitet e para pas rënies së diktaturës komuniste dhe mozaiku plotësohet me ngjarje, përpara dhe pas kësaj kohe. Fokalizimi i këtyre ngjarjeve bëhet nga perspektiva e rrëfimitarëve të ndryshëm. Tërësia e përjetimeve të ngjashme të secilit prej tregimtarëve, i krijojnë të tregimtuarit idenë e objektivitetit. "Loja" narrative mund të paraqitet sipas skemës: ngjashmëria mes perceptimit të ngjarjeve nga rrëfimtari i parë, dytë, i tretë subjektiv, bën që i tregimtuari jashtëdiegjetik ta konsiderojë atë që i rrëfëhet si një të vërtetë që nuk varet nga Uni që flet.

Rrëfëhet për bashkëkohësinë, por nëpërmjet diskursit narrativ shpesh vatërzohen ngjarje akronike. Kthimi pas në kohë, me qëllim ripërjetimin e ngjarjeve traumatike (të dhimbshme) është një proces i natyrshëm,

nëpërmjet të cilit qenia njerëzore priret të shkojë *ab origine*, për të kuptuar dukuritë, faktet që e shqetësojnë. Rugëtimi i Zhitit drejt Golgotës së tij, e vë atë përballë rrezikut të reduktimit të veprës letrare, në një autobiografi të vuajtjeve vetjake të përjetuara. Por ai është SHKRIMTAR, nga ata që ka fare pak, nga ata që **fjalën** e kanë krah; me tw pwrshkron ferrin pa u prekur nga flakët.

Përftesat unike gjuhësore, nëpërmjet të cilave përcillet **emocionalisht** njësia e kohës (e shkuara dhe e tashmja), janë objekt i këtij studimi, sepse sipas strukturalistëve, **struktura verbale** është e vetmja gjë me rëndësi në një tekst letrar. *Mënyra se si zgjidhen fjalët, sistemohen fjalitë dhe njësitë më të gjata gjuhësore, përbëjnë stilin e një shkrimtari, identitetin i tij, "fytyrën" dhe "zërin" që nuk mund të ngatërrohen* (DiYanni, 2000: 400).

1. Reduktimi i shenjave zhanrore që ndajnë prozën nga poezia, nëpërmjet potencializimit të

fjalës , përdorimit të rimës së brendshme, reticënsës, etj .

Në romanin *Në kohën e britmës*, vihet re një prirje eksperimentale për të reduktuar dominantet që ndajnë poezinë nga proza, për t'i afruar ato me njëra-tjetrën. Shestimi i ngjarjeve tragjike njerëzore, të ndodhura në vendin e shqipeve, kryhet nëpërmjet **gjuhës poetike**, e cila konsiderohet si tipar i rëndësishëm i letërsisë moderne e postmoderne.

Gjuha poetike ndryshon nga *gjuha tradicionale e prozës në afrinë ndaj përftesave poetike si rima, ritmi, përsëritja* (Jeferson, Roby, 2006: 47). Ajo dallohet nga prirja e theksuar për të përdorur figuracionin, i cili e bën *gjuhën* “të tërthortë”, “të vështirë”, “dredharake (Jeferson, Roby, 2006: 116). Një tjetër tipar i saj është dykuptimësia që sipas Empson-it, përcaktohet si *çdo nuancë verbale, sado e lehtë, e cila lë vend për interpretime alternative ndaj së njëjtës copëz gjuhe* (Harmon, Holman, 1996: 109).

Në romanin e Zhitit, nëpërmjet gjuhës poetike (karakteristikë e së cilës është *të shprehurit lirik e afektiv të realitetit*), fiksionalizohen ngjarje reale që lidhen me diktaturën e post-diktaturën komuniste në Shqipëri. Eksodi i madh, piramidat, Gërdeci janë aty, njësoj si Gorbaçovi, Ibrahim Kodra, At Zef Pllumi etj. Por qëllimi nuk është sistemimi kronologjik i ngjarjeve (siç ndodh rëndom në veprat që karakterizohen si metafiksione historiografike). Synimi është shpalosja e një të vërtete tragjike: diktatura dhe postdiktatura nuk ndryshojnë aspak. Karakterizimi i dy sistemeve politikisht të kundërta (diktaturë e demokraci), nëpërmjet të njëjtës sintagme *kohë e britmës*, shenjon barazimin e tyre në tipare. Stadi i ri që po jeton vendi i shqipeve, në mënyrë groteske konsiderohet:

Rrjepublikë Pluhuralizëm Demonkreaturë Monoharki SoCIALizëm Shkretëtirë dhe deve. (Zhiti, 2009: 309)

Ndërfutja e rrokjeve, semave, në trupin e fjalëve që shenjojnë koncepte të rëndësishme politike, sjell çmitizimin e tyre. Siç pohon edhe vetë shkrimtari: *Fjalët (...) ringjallen me kuptim tjetër* (Zhiti, 2009: 136). Nëpërmjet këtij operacioni

gjuhësor, thyhet tabuja e mitit të demokracisë. Ndryshimi mes të shkuarës dhe të tashmës është veç çështje terminologjie. Pushteti i popullit (dêmos kratos), kthehet në një krijesë diabolike (**Demonkreaturë**) shumë e ngjashme me simotrën e saj të fabrikuar në laboratorët e ideologëve komunistë (SoCIALizëm). Në fund të fundit, të përbashkëtat mes tyre shpjegohen me prejardhjen e njëjtë gjenetike. A s'është ajo bijë e denjë e etërve të saj? Apo ishin vetë etërit ata që e ristrukturuan sërish formatin e vjetër, duke i dhënë një emër të ri? Si ndodhi kjo metamorfozë?

Abstragimi i rrëfimitarit për ardhjen e shumëpritur të demokracisë merr tone tragjike.

1)...vegim në një mesjetë të mbetur, mbuluar me dhunë... si mjegull... çarçaf i bardhë dorëzimi... e u dorëzua në demokraci një ditë të bukur. Por dhe ai bunkeri brinjëmënjane buzë detit u shndërrua në lokal, restorant... 2) “Ju sollëm demokracinë!-bërtasin drejtues partish sikur demokracia janë ndihmat, ushqimet, lodrat, që shkarkojnë nga kamionët: - Sa veta jeni ju në shtëpi? Kaq? Urdhëroni aq demokraci, na dhe ti tjetri...” – “Më pesho dhe mua ca...”. “Çfarë?” – “Demokraci, pra...” –S’ka këpucë demokratike, kulturë po. (Zhiti, 2009: 256)

Teksti i mësipërm mund të analizohet duke u ndarë në të paktën **dy** njësi të dallueshme kuptimore. **Në njësinë e parë** (nga *vegim në një mesjetë* deri tek *u shndërrua në lokal restorant*), rrëfëhet për ngjarjen. **Në njësinë e dytë** (*ju sollëm demokracinë* deri tek *s’ka këpucë demokratike, kulturë po*), rrëfëhet për fjalët. Sema **mjegulla** që del në njësinë e parë, shërben si shenjues për dy të shenjuar.

a) ajo shërben si mjet stilistikor (krahasim) për të karakterizuar periudhën kohore përpara rënies së diktaturës.

b) ajo shenjon tymnajën semantike, që krijohet nga mungesa e koherencës, dhe e lidhjeve logjike mes gjymtyrëve të fjalisë. Më tepër se një fjali standarte, ajo duket si i bashkim i disa vargjeve në një njësi ligjërimore. Prania e rimës femërore e thekson këtë hipotezë.

... vegim në një mesjetë të **mbetur**...
mbuluar me dhunë... si **mjegull**...

Organizmi i brendshëm i fjalisë, bëhet nëpërmjet përdorimit të shpeshtë të reticënsës. Nëpërmjet saj, njësia ligjërimore kumton mesazhe që lidhen me tre kohë të ndryshme: diktatura, viti '90 dhe postdiktatura. Reticënsa mbush hapësirën e munguar, nga njëri stad kohor në tjetrin. Ngjarjet zhvishen nga detajet, sepse vëmendja kalon nga ngjarja tek përjetimi i protagonistit.

Me anë të përdorimit të mbiemrave (ose emrave a togfjalëshave që shprehin tipare), rrëfëhet për ndryshime të mëdha, duke i cilësuar ato. Nëpërmjet emërimit dukuria, fenomeni prangoset brenda "*shtëpisë-burg*" të gjuhës (Jeferson, Roby, 2006: 94).

Rrëfimtari i urren kufizimet (kujtojmë se ai është ish-i burgosur politik), ndaj në mënyrë të vetëdijshme a pavetëdijshme shmang kllapën që emrat vendosin mbi frymorët, sendet a nocionet. Dëshira e patjetërsueshme e rrëfimitarit për liri, shpaloset me zëvendësimin e **emërimit** të dukurive me **cilësimin** e tyre. Ai shmang sistemet shenjore konvenciale dhe e përqendron vëmendjen te karakteristikat subjektive të të shenjuarve. Nëpërmjet këtij procedimi, mesazhi *transmetohet emocionalisht*.

Në njësinë e dytë kuptimore, rrëfëhet për fjalët. Zërat që flasin karakterizohen nga anonimati, sepse nuk është i rëndësishëm ai që kumton por ajo që kumtohet. Përdoret humori i zi, i cili sipas Breton konsiderohet si *revolta më e lartë shpirtërore kundër vlerave të pranuar nga të gjithë* (Breton, 1939: 68), ndërsa për Scholes-in, si reagim intelektual i artistit ndaj kufizimeve.

2. Rritja e ngarkesës emocionale të tekstit, nëpërmjet "prishjes" së variantit tradicional të ndërtimit të fjalisë (Mungesa e shenjave të pikësimit brenda dhe në fund të njësisë ligjërimore, përdorimi i shkronjës së madhe, elipsa etj.)

Gjuha **poetike**, mund të shprehet nëpërmjet rimodelimit të strukturës gramatikore të fjalisë. Nga ana formale (d.m.th nga ana leksikore-gramatikore dhe fonetiko-gramatikore) fjalët lidhen sipas ligjeve të gjuhës, por njësisë

kumtuese i mungon intonacioni i mbarimit. Pa këtë intonacion nuk tregohet dot nëse *ndërtimi është i mbyllur apo kuptimi është i plotë* (Akademia e Shkencave, 2002: 423). Megjithatë, mungesa e shenjave të pikësimit (brenda fjalisë a në fund të saj), nuk e kthejnë tekstin në një njësi të vetme kuptimore e strukturore. Përdorimi i shkronjës së madhe, vendos kufijtë mes fragmenteve të ndryshme ligjërimore. Organizimi në fjali, ndodh kryesisht sipas ligjeve kuptimore. Fjalja mbaron, atëherë kur ndihet se arrihet *plotnia tërësore a relative* (Akademia e Shkencave, 2002: 60) e kumtimit.

Ta tallim vdekjen Duhet ç'mitizuar Zhvdekjesuar po çirreshin Të tjerët po luajnë me vdekjet e të tjerëve ne do të argëtohem me vdekjen tonë Dhe pinim me kafka Të jenë të vërteta Ç'bëhet kështu i ofruan dhe atij një kafkë të mbushur përgjysmë me verë a gjak e ktheu shpejt e shpejt Kafka nuk rridhte s'kishte vrimë pra sipas ekspertizës del që nuk është e ndonjë të pushkatuari goditur me plumb pas kokës Surbi prapë me kafkë Për fat nuk është imja tha me zë dhe ende nuk i vinte për të fjetur... (Zhiti, 2009: 309)

Organizim i veçantë i tekstit mund të ketë interpretime të ndryshme.

Së pari, gjuha e rrëfimit është gjuha e makthit. Sipas S. Hamiti, *krijimi i mbështetur në kohën e ëndërrimit (edhe makthi ëndërr është)*, *kërkon liri, liri të pakufizuar, nuk i njuh kufijtë e hapësirës, është krijim që mbështetet në liri të plotë ose të paktën e gjakon një liri të tillë*. (Hamiti, 1974: 59)

Rrëfëhet për ngjarje makabre, për krime të tmerrshme ndaj mendja e trazuar e rrëfimitarit dëshon që të verë rregull. Sipas Jacques Lacan-it, *ka "një rrafsh të pafundëm mendimesh kaotike" që përpunohen nga gjuha* (Lacan, 1977: 67). Por rrëfimtari i braktis me vetëdije ligjësitë gramatikore të modelimit të fjalive. Për të, përjetimi është aq tronditës sa ai nuk mund të materializohet gjuhësisht nëpërmjet rregullave gramatikore. Çmenduria e asaj që ka ndodhur, bashkëshoqërohet me çrregullimin e strukturës së njësisë ligjërimore.

Së dyti, rrëfimtari nuk është i vdekshëm por i vdekur, ai është zë, hije, shpirt. Ndaj gjuha që ai

përdor është fluide si ajri; e rrjedhshme si uji; ajo nuk njeh pengesa (presja) a ndalesa (pika).

Së treti, rrëfimtari refuzon *Rregullin Simbolik* (*Symbolic Order*), nëpërmjet së cilit, rregullat dhe diktati i shoqërisë, i imponohen qënies njerëzore në momentin që ai pranon konvencionet e komunikimit gjuhësor. Sipas Lacan-it, *respektimi i rregullave dhe i kufizimeve, pranimi i ligjit që njihet me termin “big Other”, lidhet me njohjen e “Emrit të babait” (Name-of-the-Father), i cili buron nga kompleksi i Edipit.* (Lacan, 1977: 67)

Qënia njerëzore, rritet me vetëdijen se materializimi gjuhësor bashkëshoqërohet me një inflacion të dendësisë së përjetimeve, ndjenjave, ideve etj. E megjithatë kjo qenie i nënshtrohet autoritetit unifikues gjuhësor, që e detyron t'i përshtatet rregullave, parimeve, ligjeve, kompromis ky që bëhet për hir të të qenit pjesë e të njëjtës bashkësie a komuniteti.

Rrëfimtari në romanin e analizuar, nuk pranon të bëjë një kompromis të tillë. Ai adhuron lirinë, për të cilën ka sakrifikuar shumë, ndaj me vetëdije shmang diktatin që rregullat imponojnë. Sipas Bakhtin-it, *çdo akt ligjërues pasqyron ndikimin nga konteksti historik dhe social në të cilat zhvillohet* (Bakhtin, 1968: 95), ndaj gjuha groteske e rrëfimtari, shpreh dëshirën për të zhdukur çdo gjurmë tiranie, shtypjeje e despotizmi.

Përdorimi i **fjalive eliptike** është një tipar **poetik** gjithashtu. *Fjalitë eliptike kumtojnë të njëjtin kuptim, por ndryshimi emocional është prezent. Me elipsën bëhet e begatë gjuha poetike, sepse fiton intonacion, intensitet, ritëm e pauzë që e bën të dendur shprehjen poetike* (Berisha, 2002: 94).

Kaq shumë të copëtuara e të ndarë... të përngjitur keq e keq, me diktatura përsipër... Kosovë... Vorio Epir...Çamëri, Vojvodinë, Timoshoarë, aty nisi dhe e vranë diktatorin... Shkodra... Ulqini... kjo legjendë është imja, edhe ky hero, jo janë të mitë... E dua unë Skënderbeun, edhe Nënë Terezën... Po njeriu? Uomo Balcnicus... këtë betejë e fitova vetëm, ti nuk ishe më 1389... As ti... i dhashë Shën Naumin, se mora rrugët, thotë mbreti i vdekur... Takimi në Trieste, s'vij me ty. (Zhiti, 2009: 93)

Thyerja e fjalisë, nëpërmjet përdorimit të shpeshhtë të reticencës shënon thyerjen shpirtërore të rrëfimtari, sepse siç pohon dhe Roland Barthes, *personazhi është ligjërata që ai prodhon* (Barthes, 1970: 179). Kjo thyerje vjen nga kujtime të dhimbshme, pjesë e kujtesës kolektive të asaj që ka ndodhur në të shkuarën e largët dhe të afërt. Historia e etnisë së tij, që ndër shekuj ka vuajtur dramën e ndarjes/copëtimit, i vjen vazhdimisht në mendje rrëfimtari dhe e bën atë të flasë me gjuhën e dhimbjes. *Fjalët (...)* *shkëputen nga kuptimi i zakonshëm, nga lidhjet e rregullat të logjikës së dhe të gjuhës. Ato (...)* *hyjnë në një marrëdhënie krejt të pazakonta, të papritura, (...)* *absurde e alogjike* (Uçi, 2001: 37).

Gjuha i largohet ligjërit të përditshëm, i cili është karakteristik për prozën. Gjithashtu, **zbehet funksioni komunikues i gjuhës dhe forcohet funksioni estetik i saj, nëpërmjet të cilit, mesazhi bëhet referues.**

Tiparet e mësipërme janë pastërtisht poetike, sepse poezia e ndryn universin brenda njësisë minimale kuptimore. Kjo gjini letrare, nuk i nënshtrohet rregullave kuptimore e gramatikore (të prozës) duke i bërë të rrëfimtari t'i duket bota që ne njohim, tërësisht e re.

3. Dendësimi i kuptimit të njësisë gjuhësore në rrafshin sintagmatik.

Sipas Riffaterre-s, dallimi mes poezisë dhe prozës, vjen nga burimi i kuptimit në dy rrafshet të ndryshme. *Proza zakonisht e realizon tërësinë e kuptimit në aksin vertikal, të njohur gjithashtu si aksi paradigmatic ose boshti i përzgjedhjes. Në këtë bosht, ne kërkojmë kuptimin e tekstit duke u bazuar në referentët e zgjedhur. Ndërsa (...)* *boshti i kuptimeve në poezi është horizontal.* (Riffaterre, 1983: 35). Poezia nuk e referon realitetin, por krijon një sistem koherent kuptimi. Një tekst poetik, duhet të analizohet sipas marrëdhënieve që zhvillohen mes fjalëve në rrafshin horizontal, i njohur gjithashtu si rrafshi sintagmatik ose aksi i kombinimeve.

Në romanin e Zhitit, njësitë leksiko-gramatikore, kthehen në fjalë-bëthamë (nucleus word),

funksioni i të cilave është organizimi i fjalëve satelitare (Riffaterre, 1983: 39).

Ploja e porsakrijuar duke sikur doli nga zonat neutrale të trurit, duhej medoemos, thanë.

Pluhuri përsipër nuk lëvrinte. "Gërdeci" prapë, u dëgjuan zëra të copërluar. Pu-pu, ç'municion paskësh grumbulluar diktatura për të na vrarë ne ... ja e plasi... Gër-rr-r, deee-eh – ciii...ih (...)

Brenda një ankthi mund të ndodhë gjithçka. Por ti duhet të zgjohesh. (Zhiti, 2009: 184)

Gërdeci dhe *Gër-rr-r, deee-eh – ciii...ih (...)*, nuk janë e njëjta gjë. Emërtimi i parë, shënon vetëm një nocion gjeografik. I dyti është një bërthamë semantike, rreth të cilës vërtiten fjalët satelitore, të ndara përkatësisht në emra *diktatura*, *municion*, dhe foljet *plas dhe vras*, e para në diatezën veprorë dhe e dyta në joveprorë pësore. Këto fjalë funksionojnë si një *metonimi për bërthamën* (Riffaterre, 1978: 39); pra kuptimi i gjithë sistemit deskriptiv barazohet me shumën e fjalëve përbërëse të kostelacionit. Emërtimi gjeografik Gërdeci (fshat në veri-perëndim të Tiranës, 11 km larg saj), pasurohet me sema të reja, të cilat lidhen me ngjarjen tragjike që ka ndodhur aty.

Ngjarja nuk rrëfëhet, por nëpërmjet përzgjedhjes së fjalëve (*municion, plas dhe vras*) përgjatë aksit sintagmatik, rikrijohet atmosfera e dhimshme e asaj që ka ndodhur pak kohë më parë. Qëllimi nuk është përcjellja e informacionit, të dhënave, listave me të vdekur e të lënduar, por trasmetimi i dhimbjes së përjetuar. Kjo është arsyeja pse e gjithë përvoja traumatike rrudhet brenda katër fjalëve të sipërmendura.

Potencializimi i fjalës, analizimi i kuptimit në njësitë minimale kuptimore, është tipar karakteristik për gjuhën poetike.

Shpeshherë, teksti reduktohet në një statistikë britmash, sepse siç pohon dhe rrëfimtari, *njeriu është thirrja e tij* (Zhiti, 2009: 116).


E para ishte **fjala**, thonë tekstet e shenjta. E fundit është **britma**, thotë Zhiti. Në një sistem diktatorial, fjala, dhurata më e madhe e vdekatarëve kthehet në thirrje/ulërimë. Kjo metamorfozë dëshmon për bjerrjen e tipareve humane nën ndikimin e dhunës, terrorit e ideologjisë. Megjithatë, për rrëfimtarin britma

është shenjë vitaliteti e qëndrese. Njeriu që thërret, barazohet me *homme révolté*; ai nuk bën kompromis, nuk hesht. Nëpërmjet shumësisë së formave që merr britma, shenjohejt një luftë simbolike, mes dy palësh ndërluftuese, individ-shtet totalitar.

Dua më shumë ulërimat se njeriun që i nxjerra ato- më kanë thënë se kam thënë(...) Është e vërtetë që **unë me thirrje e ulërima matja kohën**. Dhe jo vetëm atë (...)

Kur ora ishte 5 e 30, zgjohesha, më i lodhur nga ç'kisha fjetur. Duhej të bëhesha gati për punë, që e linim vonë mbasdite në orën 6 a 7. Dhe më vonë, gjatë verës edhe më 9. Dhe nuk i quaja më orë, por ulërima. Duhet të laheshim keq e keq me ujën e kanalit, për 3-4 minuta ose gulshe. Po të gjenim ndonjë qerre, i hipnim. Një gjysmë bulërimë a treçerek kërkëllimë të alivanosur rrotash në baltë... Ndohte të hipnim edhe pas ndonjë "zetori" deri te lëmi...çerek tërsëllimë. Dita – një dënim i vërtetë. Dhe më duhej të shihja patjetër Rezanën, ajo ishte amnistia ime, gëzimi im. (Zhiti, 2009: 115)

Nëpërmjet zgjedhjes së semës së përbashkët (*shared seme*) kohë, (emërtim ky tepër përgjithësues) abstragohet mbi kohëzgjatjen e ngjarjes së rrëfyer. Ajo mund të jetë një **ditë** (që zvarritet sa një jetë), ose një **jetë** (që përsëritet në mënyrë identike çdo ditë). **Ditë/jeta** e ferrtë e Zhitis sendërtohet nëpërmjet krijimit të njëjstive të reja leksikore, ose neologjizmave letrare. Funkcioni i tyre, sipas Michael Riffaterre-s është "*të përmbledhin/kondensojnë tiparet kryesore të tekstit*" (1983: 74).



Sema e përbashkët *kohë*, bashkon në aksin sintagmatik semat *ulërima, gulshe, bulërimë, kërkëllimë, tërsëllimë*, të cilat kthehen në

sinonime (të pjeshme) të njëra-tjetrës. Neologjizmat *bulërimë dhe kërkëllimë* kanë origjinë të qartë onomatopeike. Ato janë njësi ligjërimore leksiko-gramatikore, në të cilat lidhja e shenjës me të shenjuarin nuk është arbitrare.

Dy neologjizmat, lidhen me semat e tjera të analizuar, jo vetëm nëpërmjet kuptimit sinonimik, por edhe nëpërmjet efekteve tingullore që ato krijojnë.

Tek fjalët *ulërima, gulshe, bulërimë, kërkëllime, tërsëllimi* vihet re përsëritja e bashkëtingëlloreve apikale l, -ll, post alveolare -r dhe dybuzore -m, përsëritja e të cilave krijon kakofoni.

Nga ana tjetër spikat aliteracioni i krijuar nga përsëritja e zanoreve -u, -i, -ë.

Sipas eksperimenteve akustike vihet re egzistenca e asosacioneve të qëndrueshme midis zanoreve të pasme dhe mendimeve të rënda, të zymta e të errëta. (Lloshi, 1999: 59)

Zanorja **-u**, mbizotëron në pasazhet kur rrëfëhet për "heroin" dhe nëpërmjet saj, zbulohet bota e vuajtjeve të njeriut nën diktaturë.

Nga ana tjetër, *zanoret e përparme (i,e) sugjerojnë ndjenja e gjendje si hareja, lehtësia, qartësia, e lirizmi* (Lloshi, 1999: 59). Gëzimi i rrëfimitarit lidhet me objektin e tij dashuror, **Rezanën**, gëzim ky, që njësoj si rrezet e hënës (Rez-ana), zbrret nga qielli (aludim për praninë e Zotit dhe origjinën hyjnore të dashurisë).

Tragjizmi i jetës nën sistemin totalitar, theksohet nga pranëvënia mes ndjenjave sublime, me fjalë triviale si zetori e traktori. Shenjat krijojnë binome kuptimore të panatyrshme si psh harezetor, ndjenjë-traktor etj. Nëpërmjet këtyre kombinimeve shpalosen kufizimet e skajshme nën diktaturë, ku ndjenjat fluide materializohen në formë groteske, si pasojë e trysnisë së madhe të realitetit.

Shpeshherë ngjarja në romanin *Në kohën e britmës, rrudhet në numra*. Gjuha e numrave është më e lashta (madje sipas hamendësimeve mendohet se shkrimet e para të shenjta flisnin me këtë gjuhë). Dekodifikimi i kuptimit të kolonave numerike në tabelën e të dhënave, përcjell kumte tragjike. Të mbledhura së bashku,

shenjat shprehin një dhimbje që nuk mund të materializohet dot me fjalë. Njësitë leksiko-gramatikore e mpakin ndjenjën, e kufizojnë atë. Nëpërmjet emërtimit gjithë universi ndjenjësor burgoset brenda një fjale të vetme, duke u zhvlerësuar, tkurrur, vdekur.

Dhimbja për të cilën rrëfëhet nuk mund të mpaket dot. Për këtë arsye **Data** kthehet në **datë**. Emri potencializohet, duke mbajtur peshën kuptimore të njësisë frazeologjike, *më kall datën*. Vendi ku ka ndodhur tragjedia, zëvendësohet me përemrin pyetës **ku**, nga përsëritja e të cilit **ku-ku** evokohet kënga e qyqes, parandjellëse e së keqes, por edhe piskama e këngëve të vajtitimit.

Datë, tmerr!	Ku-ku?	Të mbytur	Të shpëtuar
31 dhjetor	Otranto...	10	1
1992	Oh-oh-oh!	12	13
12 tetor	Oh-	2	
1994	Ç'trandje!	15	12
18 tetor	Kanali i ...	19	?
1994	Kanali i Oh...	17	5
11 shtator	Kan(ib)ali i ...	6	14
1995	Adriat-iku...	14	5
30 nëntor	Lampeduza	289	29
1995	Në jug të Kepit	5	
1 dhjetor	Kanali i Oh...		
1995			
25 prill			
1996			
26 prill			
1996			
24 dhjetor			
1996			
23 mars			
1997			

(Zhiti, 2009: 284)

Nëpërmjet përdorimit të teknikës së prerjes ("cut-up" technique), ndërthuren elemente të tekstit letrar, me komnikimin zyrtar formal

(statistika). Jeta dhe vdekja barazohen gjuhësisht, nëpërmjet përdorimit të gjuhës së shifrave. Të shpëtuar e të mbytur janë kthyer në numra.

Nëpërmjet këtij procedimi shenjohet zhvlerësimi i jetës njerëzore. Demonkreatura ushqehet me gjak, njësoj si nëna e saj komuniste. Tragjikisht historia shqiptare përsërit vetveten në mënyrë identike.

Së fundmi duhet thënë se, *Në kohën e britmës* është një formë e mrekullueshme *poïoumenon-i*, (ngjarja thuret mbi letrat-ditar te Gjergjit). Përpjekja për të dekodifikuar "*shkrimet*" e tij, shpalos përpara të rrëfimtuarit brendadiegtetik dhe jashtadiegtetik, fatin tragjik të njeriut nën diktaturë. Ndryshimi i pikëvështrimit të ngjarjeve nga prespektiva e rrëfimtaraëve të ndryshëm, formësimi i veçlantë i personazheve, shumësia e përdorimit të përftesave poetike, përballja simbolike individ-shtet e bëjnë veprën e Zhitit të jetë "një oaz" i procedimeve moderne e postmoderne. Arti tronditës i Zhitit është në harmoni të plotë me personalitetin e tij jetësor. Ai shmang çdo prangë e kufizim që lidhet me konvencionet letrare (e joletrare), duke dëshmuar se horizonti i tij i pritjes (si njeri e si shkrimtar) është pas të sotmes .

BIBLIOGRAFIA

- AKADEMIA E SHKENCAVE. (2002), Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë.
- BAKHTIN, M. (1968), *Rabelais and His World*, Cambridge: MIT Press.
- BARTHES, R. (1974), *S/Z*, New York: Hill and Wang.
- BERISHA, A. N. (2002), *Në mbretërinë poetike të Anton Pashkut*, Prishtinë: Kuvendi Salezian.
- BRETTON, A. (1939), *Anthologie de l'humour noir*, Tolkinud.
- DIYANNI, R. (2000), *Literature, USA*: McGraw-Hill.
- JEFERSON, A. ROBY, D. (2006), *Teoria moderne letrare*, Tiranë: Albas.
- LACAN, J. (1977), *Ecrits, A selection*, New York: Norton.
- LLOSHI, XH. (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë: LAERT.
- HAMITI, S. (1974), *Variante*, Prishtinë: Rilindja.
- HARMON, Ë. HOLMAN, H. (1996), *.A Handbook to Literature*, NJ: Prentice Hall.
- RIFFATERRE, M. (1983), *Text Production*, New York: Columbia University Press.
- UÇI, A. (2001), *Grotesku në letërsinë shqipe*, Tiranë: Mësonjtorja e parë.
- ZHITI, V. (2009), *Në kohën e britmës*, Tiranë: OMSCA..

THE SYMBOLISM OF THE HELL AND ITS SEMANTICS IN THE ALBANIAN NOVEL SIMBOLIKA E FERRIT DHE SEMANTIKA E TIJ NË ROMANIN SHQIPTAR

MUHARREM JAKUPI
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, SHQIPËRI

AKTET IV, 4: 689 - 693, 2011

PERMBLEDHJE

Ismail Kadareja tek romani Hija tek episodi i parkimit nëntokësor paraqet një metaforë të Ferrit; tek romani Lulet e ftohta të marsit kjo metaforë është arkivi i nëndheshëm ku gjendet Libri i Gjakut, por edhe tuneli i fshehtë që lidhte shtëpinë e "shefit të madh" me shtëpinë e ish-kryeministrit të vvarë; tek Pasardhësi kemi projeksionin e Ferrit si endje shpirttrash të vdekurish mëkatarë nëpër hapësirat e botës së përtejme. Interpretimi i Pallatit të Ëndrrave si Ferr nuk mbështetet nga teksti i këtij romani. Rexhep Qosja në romanin Nata është dita jonë i është përmbajtur analogjisë me Ferrin e Dantes përmes paraqitjes të një institucioni të tillë simbol si "Shtëpia e të Çmendurve", ku gjenden të sistemuara kategoritë e "të dënuarve". Romani përbën një satirë të fortë ndaj shumë problemesh aktuale. Tek Lëkura e qenit i Fatos Kongolli Hadi është simboli i diktatorit komunist, por edhe vetë Shqipëria e përfaqësuar përmes jetës në një krahinë të prapambetur.

Fjale kyce: krim shtetëror, përgjim, korrupsion, gjakmarrje, incest

SUMMARY

Ismail Kadare, in his novel *The Shadow*, in the episode of the underground parking, presents a metaphor of the Hell; in the novel *The Cold Flowers of March*, this metaphor is the underground archive where is to be found the Book of Blood, as well as the hidden tunnel binding the house of the "big boss" with that of the murdered prime minister; in *The Successor*, we've got the Hell's projection as a weaving of spirits of dead sinners throughout the spaces of the Hereafter. The interpretation of *The Palace of Dreams* as Hell is not based by the text of the novel. Rexhep Qosja, in the novel *The Night is our Day*, has followed the analogy of Dante's Hell through the presentation of such a symbol institution like "the House of Fools", with the categories of "prisoners" systematized in it. The novel is a strong satire against many actual problems. In Fatos Kongolli's *The Dog's Skin*, Hadi is not only the symbol of the communist dictator, but also Albania itself represented by the life in a backward province.

Key words: state crime, surveillance, corruption, revenge, incest

HYRJE

Intertekstualiteti është një teknikë ligjërimore të cilin veçanërisht arti postmodern e bëri të njohur, duke e shndërruar atë në emblemën e vet stilistike. Por kryeveprat e letërsisë botërore vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen e autorëve të talentuar të kohëve moderne të cilët, përmes rimarrjeve të elementeve të ndryshme kanë arritur të krijojnë domethënie të thella të veprave të veta. Është interesante kur një shkrimtar gjen përkime midis ngjarjeve të sotme

reale dhe subjekteve, skenave, episodeve a figurave të veçanta të veprave të fondit të artë të letërsisë botërore.

Me gjetjen e vet ekspresive *Komedia Hyjnore* e Dantes dhe veçanërisht pjesa e parë e kësaj vepre, *Ferri*, kanë gjetur gjithmonë jo vetëm interpretime të pafundme kritike, por edhe interpretime artistike, pasi çdo referim i mëvonshëm intertekstual është njëkohësisht edhe interpretim nga pikëvështrimi i një artisti të madh. Nga ana tjetër, këto referime nuk mund të

mos ndikojnë në zgjerimin, ngushtimin, modifikimin, rikuptimësimin e vetë poemave të Dantes. Pra ndikojnë në thellimin e kuptimit tonë mbi to. Në këtë pikëpamje, ato mund të vazhdojnë të bëhen prodhimtare edhe më tej, duke “ndihmuar” vepra të tjera me ekspresivitetin e tyre “të tepërt” për t’iu përgjigjur më mirë aktualitetit me mantelin e famshëm të qëmotshëm. **Ferri** është një nga veprat më të referuara të letërsisë botërore pasi bota jonë është mjaft e mbushur me mëkate e mëkatarë dhe këta mëkatarë, në gjallje apo pas vdekjes, janë gjithsesi kontingjente të mundshme të ferrit.

Në mënyrë të posaçme intertekstualiteti me **Ferrin** e Dantes e ka treguar aftësinë frytdhënëse në veprën e Kadaresë, Qosjes dhe Kongolit, të cilat mund të bëhen gjithmonë objekt interesant shqyrtimi.

Simboli i ferrit në romanet e Kadaresë

Edhe në kuadrin e shqyrtimeve studimore mbi letërsinë shqipe ekzistojnë punime të cilat janë orvatur të bëjnë objekt vepra artistike për të cilat studiues të caktuar mëtojnë të vërtetojnë analogji mes tyre dhe **Ferrit**. Në ndonjë rast konkret krejt ngrehina studimore mund të jetë ngritur në ajër pasi midis veprës së bërë objekt studimi dhe **Ferrit** të Dantes mund të mos ketë asnjë grimë analogjie, kështu që paralelizmi apo studimi krahasues ka dalë i dështuar. Kështu do të ndodhte nëse analogjia me **Ferrin** kërkohet tek struktura narrative e romanit **Pallati i ëndrrave** të I. Kadaresë.

Së pari, duhet thënë se “pallati i ëndrrave” nuk është i populluar nga shpirtra apo njerëz të vdekur, por që, të personifikuar, vazhdojnë të kenë ontologji prej të gjalli. Pallati i ëndrrave është një lloj arkivi dhe instituti studimesh, njëherësh. Është arkiv sepse ai është i mbushur vetëm me dosje ëndrrash të para nga “shtetas” të ndryshëm në mbarë Perandorinë Osmane dhe është institut studimesh pasi këto ëndrra vijnë dhe shqyrtohen nga “interpretuesit” specialistë. Ai është “një nga bazat e shtetit” përmes të cilit “kuptohet gjendja e vërtetë e perandorisë”. [3. Fq. 18]

Nga këto parashtrime të eprorit të Mark-Alemit që në fillim të romanit na zbulohet pa asnjë dykuptimësi edhe funksioni i këtij pallati: depërtimi i kontrollit dhe përgjimit shtetëror gjer në porët e trurit të çdo shtetasi dhe mbyllja a izolimi ideologjik e politik i këtij pallati, si metonimi e vetë shtetit të të gjallëve. Sikurse një sërë romanesh të tjera të Kadaresë, edhe kjo vepër tematizon përgjimin e rreptë nga frika se mos depërton ndonjë ide e huaj në mendjet e shtetaseve, prej nga mund të vijë shthurja dhe shkatërrimi i krejt perandorisë, sado e madhe dhe e fortë ushtarakisht qoftë ajo. **Pallati i ëndrrave** mund të shkonte më mirë si një metaforë e Sigurimit të Shtetit a e institucioneve të tjera të këtij tipi, të gatshme të merren me mjete a metoda të sofistikuara për të mbajtur njerëzit nën kontroll duke i përgjuar ata gjer në skutat më të errëta të ndërgjegjes, siç janë gjumi dhe ëndrrat.

Por Kadareja ka pika të jashtëzakonshme referimi në vepra të letërsisë, në mitologji dhe në folklorin shqiptar. Por veprat e tij që mund të kenë referenca pikërisht tek **Ferri** i Dantes janë romane, si: **Hija, Lulet e ftohta të marsit, Pasardhësi** etj.

Romani **Hija** e paraqet Shqipërinë jo vetëm si një botë të vdekurish për shkak të izolimit, por edhe si një ferr sepse populli është i detyruar të bëjë jetë ferri, d.m.th. të heqë mundime të ngjashme me personazhet e Dantes. Intertekstualiteti sa me **Ferrin**, aq edhe me baladën e ringjalljes, duke i lidhur logjikisht së brendshmi këto dy arkitekste për t’i shfrytëzuar pastaj me forcë të jashtëzakonshme artistike, është i fortë dhe shfaqet që në çelje të romanit: “*Matanë dritares së avionit janë dritat e Orlyës. Edhe disa çaste dhe unë do të jem përsëri matanë qelqit ndarës. Përtej pasqyrës. Të pamundurës.*

Veshët më shungullojnë nga një ulërimë ngadhënjimi të brendshëm. E ndiej si hapet dera e avionit ashtu si mbulesa e arkëmortit dhe nën gjëmën e kaltëreme të kambanave, nën çarjenkrismë bubulluese antike, unë dal përsëri nga mesjeta.

Ting... ting... ting... Zonja e zotërinj... Orfeu po ngjitet nga ferri... Temepratura jashtë është trembëdhjetë gradë... Aleluja..." [1. Fq. 13-14]

Por metafora e ferrit përdoret me analogji të plotë dhe me shumë fantazi në një moment më të vonë në zhvillimin e ngjarjeve. Protagonisti i romanit, një kineast i dështuar njoftohet nga ambasada shqiptare në Paris se së bashku me atashahun kulturor do të marrin pjesë në festivalin e Kanës, në Francë. Kur mbërrin, në hotel dikush i porositi ta çonin makinën në parkingun e nëndheshëm të pallatit të festivalit. Ndërsa futeshin nën tokë kineasti përsiaste me vete rreth yjeve të kinemasë kur zbrisnin për të kërkuar makinat këtu në guvën nëntokësore të ndriçuar zbehtë, me zërat që u ngjanin jonjerëzorë pas përplasjes në beton. "Ajo shtjellje e tyre si midis zisë vetëm pak minuta pas shkëlqimit kishte diçka nga rënia në botën e poshtme." [1. Fq. 142] Ata vazhdojnë të zbresin poshtë nëpër parking. "Nuk ka vende në katin e dytë... Kati i tretë është plot me mëkatarë... Po ne? Në ç'rreth e kishim vendin ne?" [1. Fq. 142] Me përemrin "ne" në këtë kontekst shënjohej një vend mëkatar sikurse ishte Shqipëria diktatoriale. "Kati i katërt... Ku është rrethi i kineastëve të dështuar?... Më poshtë, me siguri, mendova. Një burrë, që m'u duk si im atë, vuri dorën te sytë për t'u mbrojtur nga dritat e makinës." [1. Fq. 143] Dhe kështu duke zbritur nëpër rrathët e tjerë danteskë të këtij ferri metaforik, protagonistin e shoqërojnë mendime të turbullta dhe e shqetësojnë halucinacione që i japin mundësi autorit të krijojë faqe tepër të bukura të prozës shqipe, me shumë aluzione, alegori, ironi e sarkazëm adresuar tek sistemi politik diktatorial që sundonte atëherë në Shqipëri.

Në funksion të ironizimit të propagandës zyrtare autori ndjen nevojë ta thërrasë edhe një herë tjetër metaforën e ferrit, por këtë herë më fluturimthi. Pas një darke në restorant, Richardi, një maoist, e fton dhe ata frekuentojnë një bar nate. Pasi dalin, pyetjes së Richardit se ku ke dëshirë të shkojmë, kineasti i përgjigjet: "Meqë e filluam si me gjysmë prostituta, le të shkojmë te kurvat e vërteta." [1. Fq. 150] Nisen për në Aveny Wagram ku në trotuare kishte si asnjëherë nga

vajzat që ata kërkonin. Në hyrje të lokaleve të natës ndjellësi i ftonin të futeshin brenda. "Ia nisëm që ia nisëm kësaj, le të shkojmë gjer në fund të ferrit", [1. Fq. 151] i thotë ai Richardit. "...Gjer në fund të ferrit, mirë e the", [1. Fq. 151] i përgjigjet ky i fundit. "Gjer në fund të ferrit kapitalist, përsërita me vete... për të njohur zvetënimin e kësaj bote. Madje, përmenda disa herë fjalën "ferr", domethënë "ferr kapitalist". [1. Fq. 152] Koncepti i ferrit në kontekstin e dhënë ironizon si frikën nga përgjimi e spiunimi, ashtu edhe propagandën zyrtare dogmatike, por nuk lë pa konotacion ironizues edhe këtë lloj pjese gjysmë të errët të jetës mbitokësore.

Shtëpia e të çmendurve

Romani *Shtëpia e të Çmendurve* i R. Qosjes është shtëpia e frekuentuar prej mëkatarëve në fushën e moralit të sotëm shoqëror e politik. Shumica e tyre janë njerëz që zotërojnë, drejtojnë apo frekuentojnë dundur banka, hotele dhe kazino, sepse "sa më shumë banka, hotele dhe kazino më shumë pasuri, më shumë zyrtarë, më shumë vjedhje, më shumë kumar dhe më shumë kurvëri. Mungojnë vetëm shtëpitë e të çmendurve. Deri kur?" [6. Fq. 18] Dhe paralelisht me ngjarjet e tjera, gjer nga fundi i romanit edhe kjo shtëpi ndërtohet e përurohet. Ajo, edhe për nga arkitektura, me qëllim që të fitojë konotacionet e ferrit, edhe nga pikëpamja arkitekturore është konceptuar me kate e ndarje të tjera brenda kateve që të kujtojnë rrathët e *Ferrit* të Dantes. Edhe kjo shtëpi është strukturuar sipas shkallëve të mëkatit të atyre që e popullojnë atë.

Në shëtitjen e tij nëpër labirintet e asaj shtëpie, sikurse Danten që në vizitën e tij nëpër Ferr e shoqëron Virgjili, rrëfimtari e shoqëron gjithmonë një zë që ai nuk e kupton se nga i vjen: prej ndërtesës, prej nëntokës apo prej qiellit. Kjo shtëpi u afronte shërbimet e veta 55 personave çdo ditë, kurse të dielave numri arrinte 99 – në parodi me numrin e 99 këngëve që përbëjnë krejt *Komedinë Hyjnore*. Të gjithë ata që e vizitojnë këtë shtëpi janë ndër figurat më të shquara të qytetit, ku kryetari i bashkisë së qytetit të Vajazanit "do të bëhet anëtar nderi, i përhershëm, në të vërtetë drejtor nderi i përhershëm". [6. Fq.

421] Dhe të gjithë ata që vijnë në këtë shtëpi quhen me termin mjekësor “sadamazohistë”.

Krejt katin përdhes të Shtëpisë së të Çmenduarve e përbënte një paradhomë dyshemeja dhe muret e së cilës ishin të mbushura me piktura që paraqisnin skena epshi të egër. P.sh. në murin ballor ishte pikturuar një oktapod i madh, këmbët e mëdha të të cilit plekseshin midis këmbëve të shumë vajzave bukuroshe të veshura tepër hollë. Sytë e zmadhuar të oktapodit shndrisnin si fosfor dhe shikuesin e bënin të mendoje se “*ai po bënte ç’ka do të duhej të bënin aq djem sa kishte vajza rreth tij; ngërçet në të cilat ishin shtangur fytyrat e vajzave tregonin se sa e madhe ishte kënaqësia tmerruese që ndienin ato*”. [6. Fq. 423] Edhe pikturat e tjera që paraqisnin skena epshi gjakësor, për shkak se kryheshin me kafshë e shtriganë kafshues, përcillen nga autori me një sarkazëm të thellë.

Në katin e parë të kësaj shtëpie janë tri salla të ndryshme, të mbushura me makina kazinoje para të cilave qëndrojnë në këmbë apo ulur burra e gra, të vjetër e të rinj duke futur në to lloje të ndryshme lekësh të vendeve më të njohura të botës, por më shumtit e luanin lojën me *lekë shqiptare*. Edhe rrëfimtari dëshiron të ulet për të luajtur, por nuk kishte në xhep asnjë cent. Në katin e dytë pranë tryezave janë ulur burra e gra, të vjetër e të rinj, me letra në duar duke luajtur lojëra të ndryshme kumari të vjetër e kumari të ri. Zëri që e shoqëronte, sikurse zëri i Virgjilit tek *Ferri* i Dantes, e sqaron në mënyrë ironike se për këtë arsye kjo shtëpi mund të quhej Shtëpia e Fatit.

Në katin e fundit, pra në të tretin, rrëfimtarin e presin të papriturat më të mëdha. Këtë kat, përzier me tingujt e muzikës popullore, të muzikës klasike apo të muzikës rok, e përshkrijnë klithma të të dy gjinive, domethënë klithma të njerëzve që përjetojnë ekstazën e ngritjes në qiell apo të rrëshqitjes në skëterrë. Aty janë përfaqësuesit “*e tri shtresave kryesore të Vajazanit dhe të Vendit, të shtresës së pushtetarëve, të shtresës së të pasurve dhe të shtresës së intelektualëve. Të gjithë ata vijnë ose për të përjetuar dhembje vetë, ose për t’u shkaktuar dhembje të tjerëve. Të dyja këto lloje*

dhembjesh janë kushti që mund t’i çojë deri në fund, domethënë deri në orgazëm, marrëdhëniet seksuale, në qoftë se seksuale, vërtet, mund të quhen të gjitha marrëdhëniet në të cilat lëshohen ata meshkuj dhe ato gra. Nga vetë gojët e tyre mund të dëgjosh se liri e vërtetë është ajo para së cilës nuk vihen, nuk durohen, nuk qëndrojnë kurrfarë pengesash: as ligjore, as morale, as shpirtërore.” [6. Fq. 427]

Vetë rrëfimtari arrin në konkluzionin, që merr edhe vlerën e konkluzionit të krejt romanit se paraja sundon mendjen, dhuntinë, fuqinë dhe politikën. Kurse zëri i “Virgjilit të tij” i artikulon: “*siç ke mundur të bindesh, të gjithë ata besojnë se vetëm robëria e pakufizuar dhe liria e pakufizuar bëjnë të mundshme orgazmën e pakufizuar, domethënë kënaqësinë e pakufizuar; robëria e pakufizuar dhe liria e pakufizuar i asgjësojnë kufizimet: robëria të lirisë dhe liria të robërisë; domethënë duhet të jemi të robëruar për të qenë të lirë dhe duhet të jemi të lirë për të qenë të robëruar dhe robërues; robërit e shijojnë lirinë e vërtetë vetëm kur i robërojnë të tjerët*”. [6. Fq. 434]

Është interesante të analizohet se si puqen e barazohen në të njëjtën kategori “robëria e pakufizuar” dhe “liria e pakufizuar”. Motivimi që bën autori se “robëria e pakufizuar dhe liria e pakufizuar i asgjësojnë kufizimet” është tautologjik dhe i bërë me qëllim për të theksuar ironinë dhe për ta shndërruar atë në sarkazëm. Në fakt ironia e sarkazma, si në çdo paradoks të analizuar, e bëjnë mjaft koherente shprehjen e mësipërme. Sepse romani lirinë e pakufizuar e përkufizon si robëri morale; sepse robëria e pakufizuar është nënshtrimi, servilizmi e çdo lloj konformizmi shoqëror vetëm për përfitime materiale, edhe duke flakur e shkëlmuar vetë çdo vlerë të karakterit e personalitetit. Gjithashtu sepse romani i fshikullon njëlloj të dyja këto kategori, pavarësisht diferencave të dukjes apo të thelbit që ato kanë midis tyre. Barazimi i këtyre dy termave bëhet në rrafshin moral dhe jo plotësisht edhe në atë kategorial.

Që në fillim mëkatarët e kanë projektuar vetë Shtëpinë e të Çmendurve për të përfunduar në mbarim të romanit të satirizuar fort në të, si në

një pikëmbërritjeje logjike e domethënëse për karakterin e tyre. Dhe pas analizës e zbulimit të plotë e të gjithanshëm të karaktereve përmes mjeteve artistike kryesore: ironisë dhe autoironisë, rrëfimtari në një pikë të caktuar të vizitës së tij ndjen se “*nuk ka më nevojë të shikojë edhe sallat e tjera*” të këtij projekcioni metaforik e alegorik të **Ferit**. Gjithë lënda e parashtruar dhe mënyra artistike e parashtrimit në tërësi lejon të arrihet në përfundimin se romani përbën një satirë shoqërisht të shëndoshë, pavarësisht pranisë intensive të shtresës banale të fjalorit të shqipës si dhe të mjaft skenave të turpshme, pavarësisht mjeteve artistike të përdorura e qëllimit.

LITERATURA

- KADARE, Ismail. Hija. Onufri, Tiranë, 2003.
KADARE, Ismail. Lulet e ftohta të marsit. Onufri, Tiranë, 2000.
KADARE, Ismail. Pallati i ëndrrave. Onufri, Tiranë, 1999
KADARE, Ismail. Pasardhësi. ShB 55, Tiranë, 2003.
KONGOLI, Fatos. Lëkura e qenit. Toena, Tiranë, 2006.
QOSJA, Rexhep. Nata është dita jonë. Toena, Tiranë, 2007..

DIACHRONICS AND SYNCHRONICS OF ALBANIAN TOPONYM NOTES IN THE REGION OF PELAGONIJA SHËNIME DIAKRONIKE DHE SINKRONIKE TË TOPONIMEVE SHQIPTARE NË RAJONIN E PELAGONISË

MUSTAFA IBRAHIMI
Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
Email: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

AKTET IV, 4: 694 - 702, 2011

PERMBLEDHJE

Në pjesën e parë të punimit shqyrtohen toponimet dhe antroponimet e rajonit të Pelagonisë, duke vështruar toponimet historike me burime turke, bullgare, serbe dhe shqiptare. Trajtohen toponime që lidhen me termin "arbanas", antroponime dhe ojkonime të këtij rajoni, kryesisht nga autorë të huaj. Në pjesën e dytë, kryehen analiza të thella të toponomisë së mbledhur në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit, kryesisht në fshatrat: Zhitoshë, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan dhe Debreshtë, Borinë, Nerovë, Alldançe, Jakrenovë, Sazhdevë, Presill Bellushinë, Jabollçishtë dhe Sogle. Numri më i madh i njësive topnomastike është nga gjuha shqipe me 1308 shembuj ose me 63,6 %, shtresa sllave përfaqësohet me 382 shembuj ose 18,5 %, me prejardhje turke kemi 297 shembuj ose 14,4 %, ajo greke paraqitet me 25 shembuj ose 1,2 %, arumune me 8 shembuj ose 0,4 %, latine 12 shembuj ose 0,6% dhe 23 shembuj kemi nga gjuhët ndërkombëtare ose 1.1 % .

Fjalët çelës: mikrotoponime, diakroni, sinkroni, Pelagoni

SUMMARY

In the first part of the paper reviewed and toponyms Pelagonisë antroponimet the region, looking at historical toponyms Turkish sources, Bulgarian, Serbian and Albanian. Treated toponyms associated with the term "arbanas" antroponime and ojkonime of this region, mainly by foreign authors. In the second, deeper analysis kryehen toponomisë collected in the Albanian settlements in the district of Prilep, and Veles Krusevo, mainly in villages Zitose, Cërnilishtë, Desovë, Gostirazhni, Peshtalevë, Llazhan and Debreshtë, trumpet, Nerovë, belahan, Jakrenovë , Sazhdevë, Presill Bellushinë, Jabollçishtë and Sogle. The largest number of units is from Albanian topnomastike with 1308 samples or 63.6%, Slavic layer is represented by 382 samples or 18.5%, with examples from Turkey have 297 or 14.4%, it appears the 25 Greek examples or 1.2%, with 8 examples Aromanian or 0.4%, Latin 12 samples or 0.6%, and 23 examples have international languages or 1.1%.

Keywords: mikrotoponimes, diachrony, synchrony, Pelagonia

HYRJE

Dokumentet e hershme qofshin ato sllave apo turke kanë nxjerr në dritë njohuri dhe dëshmi të një rëndësie të veçantë për prezencën e shqiptarëve autokton në trevën e Maqedonisë. Për ta përcaktuar etnosin shqiptar në mesjetë, sidomos shtrirjen e saj territoriale, në mungesë dokumentesh ka qenë e vështirë. Megjithatë disa

trajta që paraqiten në funksion toponimi, antroponimi dhe patronimi edhe në mungesë të dokumenteve të shkruara më të hershme, e bëjnë më të bindur prezencën e shqiptarëve në këto treva ku kanë jetuar apo ende jetojnë këtu në Maqedoni. Këto trajta para së gjithash shërbejnë për t'i bindur në mënyrë shkencore disa studiues sllav nga pohimet e tyre se gjoja

shqiptarët në këto treva paskan ardhur mbas shek.XVIII. Pra këto trajta dëshmojnë për shumë emërtime nga zanafilla antiko-ilire shqiptare edhe në Maqedoninë e sotme.

Si më karakteristike nga këto trajta që përcaktojnë etnosin shqiptarë janë trajtat: Arbanas. Arbanash dhe Arnaut, të cilët gjatë mesjetës shfaqen në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët, dhe siç do të shohim më poshtë, përveç tyre në rajonin e Pelagonisë të pranishme janë edhe trajta tjera me burim nga gjuha shqipe.

1. Toponomastika diakronike (historike) në rrafshin e Pelagonisë

Vështruar historikisht, pra në rrafshin e toponomastikës historike të këtij vendi, elementi shqiptar shtrihej edhe në vetë emërtimin e rajonit "Pelagoni" si dhe në shumë fshatra tjera të këtij rajoni, sot të banuara me popullsi maqedonase. Megjithatë, sot në këto emra kanë mbetur vetëm gjurmë historike toponomastike dhe patronimike si fosile të procesit të asimilimit të këtij etnikumi në elementin sllavomaqedonas.

Fjalën "Pelagon" për herë të parë e krijuan pellazgët, që sipas tyre **Pelagon** donte të thoshte: **i lindur jam prej dheut**. Pellazgët ishin plotësisht të vetëdijshëm për kuptimin e secilës fjalë me vete, nga të cilat përbëhej fjala **Pelagon**. D.m.th ata e dinin se "**pel**" do të thoshte "i lindur" se tingulli **a** do të thoshte **jam**, dhe se tingulli **g** (i cili tregon plotësinë e vepronjësit) do të thotë: **prej dheut**, por njeri **ditëgjatë** d.m.th i **vjetër**. Por, meqenëse njeri ditëgjatë dhe i vjetër (si në kohët e lashta edhe tani) konsiderohet **plaku**, fjala **pelagon** mori kuptimin e fjalës **plak**. Dhe puna që plaku quhej nga pellazgët "**pelagon**", ka rëndësi shumë të madhe, sepse në këtë mënyrë vërtetohet drejtpërdrejt se **pellazgët**, duke e quajtur plakun **Pelagon**, janë stërgjyshërit e shqiptarëve, të cilët e quajnë **plak** (Konda 1964:346).

Prania e termit **Arbanas** në rrethin e Prilepit dëshkohet që nga viti **1336** kur mbas fitores së serbëve ndaj grekëve, Stefan Dushani e pushton Prilepin dhe pasi si qendër të zhupanisë së tij e zgjedh manastirin Treskavec, lëshon tri dekrete nga të cilët është ruajtur ai i vitit 1336 (Vasilević

1902:97). Këtë vepër me 1865 e zbuloi edhe nga sllavishtja e vjetër e përktheu St.Novaković (Novaković 258-361). Këtë dekret në mënyrë origjinale në veprën e tij e boton edhe në Eniqeveri (Eniqerev 1906:333). Në këtë dekret thuhet: "**Sheshi i shkretë i Drenovcit, nga ai gjysma dhe gjysma nga fushat dhe malet edhe nga Arbanasi**", d.m.th. manastirit të Treskavecit i dhurohet pasuri të patundshme edhe nga fushat dhe malet e fshatit **Arbanas**", fshat që sot nuk ekziston në topografinë e shtetit.

Edhe në shumë dokumente tjera turke dhe sllave dëshmohen për prezencën e elementit shqiptar, i cili në vazhdimësi jeton që nga mesjeta e deri sot në trevat e tyre autoktone. Kjo mund të dëshkohet edhe me termat tjera onomastike, që do t'i përmendim me anë të topikëve: **Arbanas**, **Arbanash** dhe **Arnaut** të cilët i ndeshim në disa lokalitete dhe vendbanime të trevës së Prilepit, si: **Arbanasi** - kullosë kodrinore në Prilep (TD 1971): **Arbanasi** - kullosë në vend kodrinor në fshatin Dupjaçan (Ivanova 1982:125); **Arbanasi** - lokalitet afër fshatit Nebregovë të Prilepit, këtu gjendet "Latinska Crkva" të cilën Blazhe Koneski e lidh me elementin etnik shqiptar, ndërsa "latin" i quan shqiptarët katolik (Koneski 1991:30); **Arnaut Xhamia** - xhami në Prilep dhe **Arnaut Mahalla** - mëhallë në Prilep (Traiqev 1925: 8-11), sot nuk ekziston, **Arnautska Maalla** - f. Golemi Konjari, **Arnautska Zemja** në anë të Prilepit (Milladinovci 1962: 242).

1.1. Gjurmë shqiptare në mikrotoponimet të mbledhur nga autorë joshqiptarë

GURGUROT – vend në Prilep (PP-1978:444) ; **GURGUSICA, GURGUSOVAC** - kroj në rrethin e Prilepit (Pavloviç 1965: 73); **KISHOICA** – arrë dhe livadh në vend të lagur në Prilep (Ivanova 1982: 78); Lagjet **Buliman** (burrë i madh) dhe **Muzak** në Prilep (TD VI: 42); Lagjet **Katunar, Trullishte e Barbaros** në fshatin Debresht; Lagja **Gjon** në fshatin Dupjaçan të Poshtëm (TD VI: 136) formuar nga i pari i kësaj bashkësie familjare dhe nga emri personal shqiptar **Gjon**; **SHTENAR** – lagje në Prilep, ku del të përdoret edhe **Mile Shtenar**, po në këtë lagje (TD 99), rrjedh nga emër personal shqiptar **Shtenar**, ky një shkurtime i brendshëm nga **Kërshten**. (Koneski 1991: 86); **Buzaana** –

emër vendi (Kepeski 1993: 27); **BOZOPAN** – fshat në Prilep. Me këtë afrohen Bozovce. Rjedh nga emri vetjak shqiptar **Bozo** e **BEZO**. Një varisacion i tij dhe **Bozdogan** e **Bozge** (Murati 1993) ; **ORUSHICA** – Në vendin prapa Varoshit dhe Gradsko Poles, që shtrihet në drejtim të Manastirit, P. Skoku ka shënuar lokalitetin **Orushica** (Skok 1933: 196). P. Skok nuk jep shpjegim etimologjik, mirëpo M. Pavloviq e nxjerr nga shqipja “**arushë**”, në kuptimin semantik “**vend ku ka arusha**” (Pavloviq 1966: 77) (krh. me hidronimin **Mexhexha, Medvexha**). Këtu kemi kalimin **a>o**, (krh. me **Olbanesh** nga **Albanesh** (Koneski 1991: 18); Karposh nga Karpa(sh) (Çabej : 268-269) ; **PELITAKOIQ** – Toponimin Pelitakoïq, Skoku e nxjerr si të paqartë (Skok 1933: 197), megjithatë Pelitakoïq është një formë e përgjithshme që i përgjigjet shqipes **plit + i kuq**; **RUKLEC** – Emërtimin e njëres nga çezmat e qytetit të Markut, pra Prilepit, me emrin **Ruklec**, (Skoku 1933: 198), e lidh nga ndonjë llagap. Ndërsa M.Pavloviq e nxjerr nga shqipja “**rrugë**” me kuptimin semantik (**çezme në rrugë**) (Pavloviq 1966: 78), krah. këtu **Rugova, Rugovska Klisura**, që si bazë e kanë fjalën shqipe “**rrugë**”; **ZHURKA** – Edhe kjo çezme në qytetin e Prilepit **Zhurka**, (Skok 1933: 198), ka temë semantike si shqipja **zhur = rërë**, me kuptimin krua nga rëra, çezme në rërë (M. Pavloviq 1966: 75), krah. këtu edhe oiknonimin **Zhur** në Kosovë; **GURGUZICA** – Edhe kjo çezme në qytetin e Prilepit (Skok 1933:198) ka për bazë fjalën shqipe. Etimologjia e kësaj fjale lidhet me shqipen “**gur** dhe **gus** nga arumanishtja **ghios**. Krah. **Gurgurot** – vend në Prilep (PP I: 1978: 444), **Gurishta** - arë në fshatin Cërnilishtë të Prilepit; **SHUTI VRF** – Është term orografik që gjendet në Prilepec (Skok 1933: 201), ku mbiemri **shut**, ka kuptimin “*pa dru, majë e pastër*”. Në të folmen e fshatit Cërnilishtë, kemi “**krÿe shut**”, “*shut kurumut*”, për njerëz që s’kanë flokë. Nga kjo jemi të mendimit se **Shuti vrf** nuk ka kuptimin “*kusast vrf*” (majë e shkurtër), siç e shpjegon Skoku (Skok 1933: 201), por “*majë pa dru*” ; **BOJÇECA** – Këtë emër Skok e konsideron si të paqartë (Skok 1933:201). Ky toponim rrjedh nga një emër personal shqiptar **Boja**, mjaft i shpeshtë në mesjetë, dhe sufiksi sllav **-ca**,

karakteristikë për emërtimin e gruas së Bojës, krah. Mitrejca, Muslica; **PISOKALL** – Këtë vend që gjendet në fshatin Krushevica (P.Skok 1933: 202) e konsideron si emër vendbanimi. Meqë në afërsi gjenden Malet e turqve (Turska Planina) e kupton si shenjë se këtu ka pasur turq. Emrin **Pisokall**, P.Skok e konsideron si kompozitë nga mbiemri “**Pisov**” që s’ja di kuptimin dhe fjalës **kall = “baltë**”. S’ka dyshim se mbiemri “**pisov**” lidhet me mbiemrin shqip **pis, i pistë** (jo i pastër) në kuptimin i përlÿer me baltë, ose vend i pistë me baltë. Po në këtë fshat gjenden edhe vendet **Pisokallska Reka** si dhe **Kaza pisokallski**.

XHAVETO – Në sinorin Boneçka të fshatit **Krushevica**, Skoku ka shënuar edhe kodrën Xhaveto (Skok 1933: 203), që me të drejtë e konsideron si identike me fjalën shqipe **qafë**; **RAPESH** – Ky emër në fillim përmendet si fshat cincar **Gopesh** ((Skok 1933:203). Sipas Skokut ky emër është i paqartë. M. Pavloviqi, për nga struktura pranon se ky toponim nuk i takon tipit sllav. Sipas tij në fillim të fjalës sheh metatezën (**or-ro**) dhe prapashtesën **-es**, ku si bazë merr formën **arp**, që e nxjerr nga fjala arumune **arpa- aripa** (Mihaileanu, Dictionar Macedoroman) që tregon pozitën sipas truallit, që mund të përkthehet si vend i rrëpirtë (Pavloviq 1966:77). Por, ky toponim ka të ngjarë të lidhet edhe me fjalën shqipe **rap, rrap = “dru i fortë dhe shekullor”** (Doçi 1983: 66) dhe prapashtesa **-esh**. Krah. edhe **Rapsha** (katund i Mbishkodrës), **Repishta** (mal në Dolc të Llapushës). Vlen të përmendet se sipas H. Krahes dhe A. Mayerit **Raparie e Rapista** janë fjale shumë të moçme ilire (Krahe 1925: 124); **DUSHKOEK** – Këtë toponim, P. Skoku (op. cit. 204) e gjen në fshatin Makovë, duke e nxjerrë nga emri personal Dushko, emër që nuk ekziston në gjuhën maqedonase. Këtë toponim , me të drejtë e shqyrton M. Pavloviq (op. cit. 74), ku thotë: “ Dushkoec (Dushkovac f. 207) është emërtim paralel e nxjerrur nga baza iliro-shqiptare **dushkë**, që Eqrem Çabej, e nxjerr nga fjala **dru** (Çabej 148-149). Khs. **Dushnik** (afër Nishit), po ashtu **Dushnik** (katund në Berat) ; **QKORIE** – Për toponimin Qkorie, P. Skoku thotë: kështu thirret për shkak se në terren ka dru të njomtë, të cilët quhen **qkor** (Skok 1933: 204), me

këtë lidhet edhe Jokli duke e lidhur me fjalën shqipe **shkurë** = “pyll i vogël, kaçubë”(Jokli 230). **MARTINEC** - Livadh në fshatin Makovë (Skok 1933: 204), i dalë nga emri personal Martin, mjaft i shpeshtë te shqiptarët; **DRAGOR, DRAGILICA** – P.Skoku për lumin që kalon nëpër Manastir (Skok 1933: 14-215) thotë se mban emër sllav **Dragor**, kurse toponimin Dragilica e ka të paqartë (Skok 1933: 204). M. Pavloviq, nuk pajtohet me mendimin e P. Skokut dhe me të drejtë, emrin e lumit Dragor e nxjerr nga shqipja “**dragua**” figurë nga mitologjia shqiptare, duke bërë krahasim nga koha primitive, si në mitologjinë greke, kur populli, burimet dhe ujërat rrejdhëse i ka personifikuar. Krh. Mbrojtësi i burimit të Arijevit afër tebës ka qenë biri i Arijevit, **dragoi** (Glasnik III: 629), kurse Bor. Drobnjakoviç përmend burimin **Zmajevac** “dragua” në Shumadi; **PUPULEGI** – Ky emër nga ana e P. Skokut (Skok 1933: 205) konsiderohet si i çuditshëm, dhe mendon se ndoshta është në lidhje me shqipen **populë**, që do të thotë “kodër, shpinë”, krh. G.Majeri, Alb. etym. W. 358; **GJUROV GLAS** – Shumë karakteristik është toponimi Gjurov Glas-kodër në Rapes, për të cilën P. Skoku emrin glas (për shkak se ky emër vjen nga fjala themelore toponomastike), e nxjerr si eufemizëm nga fjala sllave **gaz** për “prapanicë, bythë”. Por ai pranon, se as informatori nuk di ta shpjegojë fjalën “**glas**”, duke shpjeguar se ashtu kanë folur francezët dhe tash edhe populli ashtu flet (Skok 1933: 206). Nga këto të dhëna M. Pavloviq na thotë se “ky emërtim ka lindur gjatë Luftës së Parë Botërore, pikërisht në vijën frontale të Selanikut, ku ishin të vendosura mburojat e aleatëve, pra në vendin ku qëndronin trupat franceze. Sipas kësaj M. Pavloviq mendon se “**Gjurov Glas**” do të thotë “Gjurin Shanac”= llogoret e Gjurit. Kështu e kanë quajtur luftëtarët francez frontin e afërt, prej nga ka ngelur edhe te populli (Pavloviq 1966: 74-75); **GOR** – Në sinorin **Brnika**, P. Skoku (Skok 1933: 207) përmend edhe kodrën **Gor**, që sipas tij flitet dhe shkruhet si është në hartë. Por këtë mendim e kundërshton M.Pavloviqi duke e konsideruar si jo të saktë (Pavloviq 1966: 73). Po ashtu P. Skoku thekson se francezët gjatë Luftës së Parë Botërore, këtë kodër e kanë quajtur “**Col de gor**”.

Kjo formë në mënyrë fonetike i përgjigjen shqipes **gurë** (G. Majer, EW, 135.)

1.2. Gjurmë shqiptare në emërtimet e fshatrave (ojkonimeve)

BORINË (B-r-i-n-a TD 66) – fshat në perëndim të Prilepit. Në Defterin turk të regjistrimit e ndeshim me formën Brina, krh. këtu dhe Brinanc në Petriç. Kjo fjalë rrjedh nga emri vetjak shqiptar **Biran**, ky nga apelativi **bir**, **~i**, i terminologjisë familjare, që si i këtitllë ka kaluar të përdoret edhe te maqedonasit (Murati 1990: 117) ; **BOZOPAN** – fshat në Prilep. Me këtë afrohen Bozovcë (Bozovca TD 106) – fshat i rrethit të Tetovës, Bozovci (Gorë, S. Gashi SHSHTG 131), nga emri vetjak shqiptar Bozo, Bezo. Një variacion i tij dhe Bozdogan e Bozge, sh. Martini, b.Bozdoganit (Veles), Bozge b. Vlasit (Gostivar, S. Gashi SHSHETG 131); **BRILLOVË**- edhe në këtë fshat, që gjendet poashtu afër fshatit të zhdukur Arbanas gjejmë të regjistruar trajta me emra shqiptare, siç janë: **Mino, i biri i Boldosit** (TD 71) nga shqipja **Bale-bale**, pullë e bardhë që ka qenë disa kafshë ose njerëz në kokë ose në trup (Murati 1990: 97). **Biran**, i biri i Radosllavit (TD 71). Etimologjinë e këtij emri mund ta nxjerrim nga mbiemri **i bardhë + prapa. –ovë (Bardhovo > Barllovo)** dhe metateza **ar>ra** : **Barllovo>Braillovo**. Krh. fshatin **Barlovo** në Toplicë, komuna e Kurshumlisë; **DESOVË**- në pikëpamje strukturale ojkonimi **Desovë** paraqet një sintagmë atribute të krijuar nga rrënja e emrit të fisit ilir të **Desareteve** (Ibrahimi 2003:). Në bazën e këtij emri qëndron antroponimi iliro-shqiptar **Das** (dash) – **Des** (desh) (Doçi 1994: 52), i cili dikur ishte në përdorim të shpeshtë ndër ilirët dardane dhe ilirët e tjera. Në funksion patronimi gjejmë disa trajta shqipe siç janë: **Prodan, b.Mozakut; Dobre Mozak** (TD 109)- Trajte e emrit prsonal **Muzak-u**. (Murati 1990: 106). Këta fakte i vëretin edhe e dhëna se në këtë fshat edhe sot jetojnë shqiptarë; **DEBRESHTË** (TD 544) fshat në veriperëndim të Prilepit. Rrjedh nga një emër personal Debres, të cilin në mesjetë e mbanin edhe shqiptarët, shih Prodani, b.Debreskos (Krushnicë – Poreçe TD 255) ; **DRENOVCE** - Mendojmë se edhe ky ojkonim të ketë dalë nga shqipja, gjegjësisht nga një fjalë

trako-shqipe **dre-dreri** (dreni) + shkronja epentetike **-n-** + sufiksi **-ovo-** dhe prapashtesa për zvoglim **-ce**. Këtë fjalë e gjejmë edhe te një emër lagjeje në Terstenik të Ferizajit si Drejkovci. Antroponimi Dreni mund të kërkohet edhe me emrin e krahinës së Drenicës. Poashtu me fjalën dre mund të afrohen edhe mikrotoponimet: Mali Dren në mes të fshatrave Llapceve e Koznik (Llapushe), Drethi (Istog); Ara Drethit (Runik-Drenicë); Guri i Drenit (Devetak-Ferizaj); Kodra Drenit (Reçak - Ferizaj) (Doçi 1990: 65). Megjithatë kjo çështje ngel e hapur nga fakti se disa trajta me të drejtë shpjegohen nëpërmjet një fjale sllave **dren thane - dru mali** (V. Pjanka 1970: 52-53); **DUBJAÇAN-** në këtë fshat që nga mesjeta janë dëshmuar një varg emrash: vendesh, personash dhe familjesh që përmbajnë elemente nga areali shqiptare. Në këtë fshat është regjistruar një kullosë kodrinore me emrin **Arbanas** (Ivanova 1982: 25). Gjithashtu në defterët turke (TD IV), gjejmë të shënuar lagjen **Gjon** (TD VI 136), formuar nga i pari i kësaj bashkësie familjare e nga emri personal shqiptar **Gjon-i** (Murati 1993: 14). Në këtë fshat kemi të regjistruar edhe disa trajta në funksion patronimi: **Martin, i biri i Stales** (TD 90), nga emri personal shqiptar **Martin; Cerp, i biri i Janes** (TD 90), nga apelativi i shqipes **Cerpe** (kungullishte) (Murati 1993: 99); **Mato, i biri i Prodanit** (TD 90), nga emri **Mato, Mate, Matreng-** emër i shpeshtë në truallin gjuhësor shqiptar (Murati 1993: 105); **GRUNISHTA** – Fshat në rrethin e Manastirit. Petar Skoku e nxjerr nga fjala shqipe **grun** + suf. **-ishte** (Skok 1933: 145). V. Mihajloviq e nxjerr nga **“grunec”** – lloj peshku në liqenin e Ohrid. Krh. këtu edhe emrin Grunevski (Shkup TI 91), nga baza antroponimike e shqipes ***grun (grurë)**, krh. këtu edhe Grunjë-a, Grunja b.Kodinit (Shuteriqi LSHPB 318); **NEROVË** – Fshat në rrethin e Krushevës. Ka prejardhje nga emri personal **NERO**, i dëshmuar edhe në rrethinën e Strugës nga vëllezërit Milladinovci, rrethinën e Shkupit (**Nerez**), në atë të Tetovës (**Nerashti**). Të gjitha këta emërtime shpjegohen nga një bazë të shqipes **“njeri”** (Ilievski 1988: 540); **NOSH PAL** (TD 546) – fshat në vilajetin e Prilepit, sot të Manastirit. Emri është me strukturë kompozitore

nga hipokoristikat e emrave vetjak popullor **Nosh** (nga Andon) dhe **Pal** (Paul); **OBËRSHAN** (TD 73) – fshat në jugperëndim të Prilepit, afër Bella Cërkvës. Në këtë toponim përmbahet fitoleksema e shqipes **“bërshen”** lloj druri halor i ngjashëm me dëllinjën”, në thelb një vend i pasur me këtë lloj druri të bërshenit; **ROPOTOVË** (TD VI 100) – fshat në veriperëndim të Prilepit. Rrjedh nga emri personal mesjetar shqiptar **Ropo** +suf.-**ovë**. Emri **Ropo** është i ngjashëm me ato **Rapo, Rrap, Rrapaj** që i ndeshim brenda antroponomastikës shqiptare; **STROVIJA** – Fshat në veri të Prilepit, emrin e ka marrë nga fjala sllave **streльсь (strellëcë)** nga strela (shigjeta) (Urošević 1975: 136).. Fjala e sotshme Strovija është formuar nga ndikimi i drejtpërdrejt i gjuhës shqipe, ku **e-ja** e patheksuar ka kaluar në **o**, duke i shtuar tingulli **v**, si **Drenovci** (Drenovac), shih edhe **Strovci** (Vuçitërn) (Mulaku 1989: 128); **GRUNISHTA** (TD I 129) – fshat në vilajetin e Prilepit, sot të Manastirit. Rjedh nga fitoleksema shqipe **“grun”** – lloj drithi + suf. **-isht**. Krahaso këtu edhe emrin **Gruneski** (Shkup TI 91) nga baza antroponomike e shqipes dhe **Grunjë-a** bija e Kodinit (Shuteriqi LSHPB 318) ; **PRISAD-** edhe në këtë fshat gjejmë disa trajta në funksion patronimi dhe antroponimi: **Gon, i biri i Gergit** (TD 105); **Gin** (TD 105); **Gin, i biri i Cengarit, Gin, i biri i Kovacit, Gin, biri i Proskos** (TD 105); **Leko, i biri i Marices, Bogoj, i biri i Lekos; Liko, i biri i Dorinit; Liko, i biri i Dimos** (TD 105). Siç mund të shihet në këtë fshat të gjithë personat e regjistruar nga ky defter, ose numri më i madh i kryefamiljeve mbajnë emra shqiptarë; **KUTLESHEVË** (TD 100) – fshat në veriperëndim të Prilepit në mes të Senokosit dhe Vrançes. Nga mbiemri familjar shqiptar **Kutleshi** dhe sufiksi sllav **-evë**. rahëso këtu edhe mbiemrin familjar **Kutleshi** në anë të Kosovës, një kompozitë nga **Kut + Lesh; DEDEBALCI** (Dede Bali TD 116). Fshat në verilindje të Manastirit në kufi me Prilepin afër Radobarit, formuar prej antroponimit mesjetar shqiptar **Dedebali** (nga **Dedë** dhe **Balë** në formë të përngjitur). Një numër i këtyre të mbante edhe një person i këtij lokaliteti, **Sh. Dedebali** i biri i **Mehmetit** (TD 116); **JAKRENOVË** – Fshat në jugperëndim të Prilepit, i banuar edhe sot me

shqiptarë. Tek emri i këtij topiku gjejmë të përbashkët një emër vetjak i krishterë **Jak** a **Jakrenovë**, i përhapur edhe sot te shqiptarët, krh. **Jak** e **Jaku** si emër dhe mbiemër familjar te shqiptarët e Kosovës etj (Murati 1993: 15) ; **KALEN** (TD 127) fshat në juglindje të Prilepit, formuar mbi bazë të antroponimit shqiptar **Kalen**, prej të cilit dalin edhe patronimet e këtilla si **Kaleshat** emra familjesh në Tuhin dhe në Prapadisht të Kërçovës, **Kalenxhejt** (Goranë) e **Kalajxhiajt** (Zajas) (Murati 1993: 15) ; **KOKRE** (TD 127) – fshat në juglindje të Prilepit afër Reshtanit. Me këtë afrohet edhe emri i lagjes **Kokora** të Velesit, prej nga ka dalë edhe topiku **kokre**, në thelb nga **kokë** të shqipes.

2. Toponomastika sinkronike (përshkruese) në rrafshin e Pelagonisë

Gjendja e sotme e toponimisë në vendbanimet shqiptare në pjesën veriperëndimore të rrafshit të Pelagonisë është mjaft e pasur. Në studimin tonë kemi përfshirë tri rrethina kryesore me 16 fshatra: 1. Rrethinën e Dollnenit (Prilepit), që rrok fshatrat **Zhitoshë**, **Cërnilishtë**, **Desovë**, **Gostirazhni**, **Peshtalevë**, **Llazhan dhe Debresh**: 2. Rrethinën e Krushevës, me lokalitetet: **Borinë**, **Norovë**, **Alldançe**, **Jakrenovë**, **Sazhdevë**, **Presill dhe Bellushinë** dhe 3. Rrethina e Çashkës (Velesit) duke përfshi vetëm dy fshatra **Jabollçishtë dhe Sogle**, të banuara kryesisht me popullsi shqiptare, disa të përzier edhe me popullatë turke, maqedonase dhe boshnjake, por në të cilat mbisundon elementi shqiptarë.

Në këto vendbanime shënuam gjithsej 1868 njësi toponimike (oronime, hidronime, si dhe emra të objekteve më të vogla gjeografike). Numri i mikrotoponimeve sipas komunave është si vijon, në rrethin e Prilepit u shënuan 884 toponime, prej të cilëve 297 toponime në f. Cërnilishtë, 69 në Desovë, 128 në Gostirazh, 46 në Peshtalevë, 138 në Debresh, 49 në Llazhan dhe 157 toponime në Zhitoshë. Në rrethin e Krushevës u shënuan gjithsej 787 toponime, prej tyre 53 toponime u shënuan në fshatin Jakrenovë, 122 në Sazhdevë, 121 në Bellushinë, 62 në Borinë, 105 në Alldançe, 145 në Nerovë dhe 179 toponime në Presill. Kurse në rrethin e Velesit u shënuan gjithsej 197

toponime nga dy fshatra, në Jabollçishtë u shënuan 137 toponime dhe në Sogle 60 toponime.

Numri më i madh i njësive toponomastike është nga gjuha shqipe me 1308 shembuj ose me 63,6 %, shtresa sllave përfaqësohet me 382 shembuj ose 18,5 %, me prejardhje turke kemi 297 shembuj ose 14,4 %, ajo greke paraqitet me 25 shembuj ose 1,2 %, arumune me 8 shembuj ose 0,4 %, latine 12 shembuj ose 0,6% dhe 23 shembuj kemi nga gjuhët ndërkombëtare ose 1.1 % (shih tabelën nr. 2).

Edhe në planin leksikor toponomia e këtij rajoni është shumë e pasur. Ne shënuam 393 njësi leksikore, ose 19 % nga toponomia e përgjithshme. Edhe këtu shtresa shqipe është dominuese dhe përfaqësohet me 185 fjalë (gjegjësisht me 47 %), nga gjuhët sllave janë 125 fjalë (ose 31.8 %), me prejardhje turke janë 56 fjalë (ose 14,7 %), fjalë greke janë 9 Mikrotoponime (ose 2,3 %), arumune janë 3 fjalë (0,8 %) dhe 11 fjalë janë nga gjuhë të ndryshme ndërkombëtare (ose 2,8 %).

Numrin më të madh nga pikëpamja leksikore e përbëjnë fitonimet me 63 leksema, pastaj vijon oronimet me 61 leksema, raportet sociale me 54 leksema, objektet kulturore me 51 leksema e kështu me rradhë.

Nga njësitë toponomastike më tepër janë të përfaqësuara, gjithashtu oronimet me 405 apelative, hidronimet me 327, raportet sociale me 254, komunikacioni me 225, Blegtoria me 213 etj. Apelative më frekuentuese sipas bazave semantike janë ato që emërtojnë objektet karakteristike në teren, si: Udha (me 177 shembuj), Livadhi (105), Guri (89 shembuj), Korija (69), Çeshmja (66), Varret (55), kodra (46), Prroji (42), mal (14), Kalaja (12), etj.

Nga mbiemrat përdorim më të gjerë kanë antonime: Posht (36), I madh (25), I vogël (15), Epër (13 shembuj) etj.

Nëse krahasojmë koeficientin e përfaqësimit midis bazave dhe numrin e Mikrotoponimeve më i madh është tek oronimet (61 baza – 405 njësi toponomike), hidronimet (41 – 327), raporte sociale (54 – 254), Komunikacioni (11 baza dhe 225 njësi toponomike) etj.

Nga numri i përgjithshëm prej 2057 njësi toponomike sa kemi regjistruar në këto fshatra, 644 (ose 31,30 %) janë mikrotoponime njëgjymtyrëshe. Numri i kompozitave dhe i mikrotoponimeve të përbëra që e gjejmë në këtë rajon është më i madh dhe sillet prej 1413 (ose 68,70 %) nga numri i përgjithshëm i njësive toponomike.

2.1. Gjurmë të vjetra pagane në topleksemat e kësaj zone

Përveç emërtimeve gjeografike, hasim dhe një numër topleksemash që shënojnë gjurmë të vjetra pagane të karakterit etnologjik, të mendësisë primitive shpirtërore, që lidhen me gurin, drurin dhe ujin, ku kanë shkuar njerëzit për tu shëruar ose për të lindur fëmijë e ngjashëm.

Besëtytnitë e këtilla që lidhen me gurin, ujin dhe drurin paraqesin një element të trashëguar nga lashtësia dhe të ngritur në kult te popullsia shqiptare vendëse, e ruajtur edhe sot e kësaj dite.

1. Besëtytnitë që lidhen me gurin kryesisht janë vende ose gurë në të cilat shkojnë gratë për të lindur fëmijë, pra kemi të bëjmë me besimin në gurë. Më karakt eristik na del Guri i Shpuar që del në disa variante, si: **Guri i Shpum** (Cër), **Guri Shpou** (Deb, Llazh, Zhit), **Guri Shpaut** (Sazh), **Guri Shpunun** (Pre) dhe **Guri i Shput** (Jak); **Gur i Xhamis** (Alld).

2. Një besëtytni tjetër që është trashëguar nga lashtësia është edhe besimi në ujë. Në këto burime uji njerëzit kanë shkuar për t'u shëruar ditët e caktuara. Në toponomastikën e kësaj ane takojmë: **Ujti i Mkaurës** në Alldançe dhe Sogle, **Ujti i Xhumas** në Alldançe, Sogle, Cërnilishtë dhe Desovë; **Ujti i Shtaunës** në Sogle, **Ujti i Dillës** në Cërnilishtë, Sogle dhe Zhitoshë.

3. Rreth drunjve të shenjtë, bëheshin kuvende e ndenja, nëse gjendeshin në vende të përshtatshme e publike në mes fshati, apo në rrugëkryqe. Ata të cilit rriteshin në vende "vakëfi", siç ishin vendet e trojeve të lashta e të zhdukura, ose brendi të truallit të varrezave, trajtoheshin si drunj kult, të shenjtë dhe në asnjë mënyrë nuk dëmtoheshin, qoftë edhe me thyerjen e ndonjë degë nga ta. Besohej se personi i cili pret drurin e tillë do të pësojë tragjedi në

familje ose personale. Drunj të tillë ishin vend me shenjë dhe kishin emërtime të caktuara. Në fshatin Peshtalovë, 25 km larg Prilepit, gjendej lis i moçëm dhe i shenjtë. Pranë tij gjendej ujë i shenjtë ku njerëzit shëroheshin nga sëmundjet e ndryshme. Sot ky vend quhet **Ke Saltashi** vend ku lahej xhenazja, sepse druri dhe burimi nuk ekzistojnë më.

2.2. Struktura fjalëformuese e toponimisë së Pelagonisë

Toponimet, si përmendore e kujtesës njerëzore që janë, ruajnë, përveç tjerash, edhe mënyrat e fjalëformimit dhe strukturën gjuhësore-fjalëformuese të tyre. Këtë mund ta dëshmojë edhe lënda onomastike e trevës sonë, e formuar sipas **tautologjisë, sinonimisë** dhe **fjalëformimit**.

Emërtime tautologjike – në këtë trevë janë shumë të pakta, kryesisht dalin si formime nga dy fjalë të një gjuhe ose të dy gjuhëve të ndryshme, por që kanë kuptime të njëjta, të tilla janë: **Kodra e Malaritit** (Alld), formuar nga fjala shqipe **kodër** dhe fjala sllave **rid**, Prroj i Utofdollit (Cër), formuar nga fjala shqipe **përrua** dhe fjala sllave **doll**.

Emërtime sinonimike – kemi ndeshur mjaft shembuj të tillë sinonimik, si rezultat i gërshetimeve dhe të ndikimeve gjuhësore të ndërsjella, ku rëndom njëra është fjalë vendëse, tjetra e huaj, ose ato u takojnë dy varianteve (alonimeve) të së njëjtës gjuhë. Kështu bie fjala, krahas fjalës **udhë** me variantet **audh, oudh** (me 182 toponime), ndeshim edhe fjalën greke **drum** (me 1 toponim), **pat** i sllavishtes (2 toponime) dhe fjalës turke **sokak** (me 2 toponime). Krahas fjalës **kroi** me 14 toponime, përdoren edhe fjalët turke **çeshme** (me 66 toponime) dhe **bunar** (17 toponime), fjalët sllave **klajneci** (20 toponime) dhe **izvori** (6 toponime). Paralelisht me fjalën **përroi** (42 toponime), përdoret edhe **doll** i sllavishtes (12 toponime). Toponime sinonimike paraqesin edhe fjalët **liqe** (1 toponim) – **ezero** (2 toponime); **zall** (30) – **reka** (2), **ujë** (17) – **voda** (13) etj. Një numër të madh të fjalëve sinonimike i hasim edhe tek toponimet

fitonimike, si p.sh. **pishë-bor, ah – buka, lis –dab, lajthi – leska , bli – lipa** etj. Fjalë sinonimike hasim edhe tek toponimet që lidhen me kafshët, si: **kal – konj, dhelbër – lisica, shqiponjë – orell, gjarpër – zmija, lakuriq nate – lilak** etj. Edhe në fushën e blegtorisë hasim disa toponime sinonimike, si te: **livadh – livada, kolibe** (5 toponime) – **stan** (2 toponime), ashtu siç kemi edhe në fushën e bujqësisë, si: **arë** (50 toponime) – **niva** (8), **fushë** (8) – **pole** (3),

Shikuar nga aspekti i strukturës gjuhësore-fjalëformuese, numri më i madh i emrave të kësaj zone dalin sipas tipave të fjalëformimit: **fjalë të parme, të prejardhura dhe kompozita.**

Mikrotoponime fjalë të parme – që janë fjalë me kuptim të përgjithshëm (apelativa), pa ndonjë mjet fjalëformues, me sa duket, janë të pakta në numër. Ato rëndom përdoren në emëroren e trajtës së shquar, në numër njëjës dhe shumës dhe zakonisht shënojnë konfiguracionin e terrenit, si p.sh.: **Bara** (Deb), **Batak** (Gos), **Bisa** (Gos), **Blina** (Alld), **Biloku** (Zhit), **Bokat** (Bell), **Boklat** (Pre), **Briegu** (Cër), **Brraka** (Cër,Bor), **Bunari** (Cër), **Çairi** (Llzh), **Çuka** (Pesh, Gos), **Dërma** (Cër), **Kalaja** (P,K), **Kulla** (Gos), **Llagu** (Cër, Alld), **Lugu** (Jak),etj.

Emërtime fjalë të prejardhura – në këtë anë janë formuar me morfema rrënjore dhe ndajshesore: parashtesa dhe prapashtesa. Në krahasim me fjalët që janë formuar me parashtesa, ky lloj i fjalëformimit në të folmen tonë është më i pranishëm dhe më produktiv. Formimi me prapashtesa vërehet gati te të gjitha llojet e fjalëve të sistemit gjuhësor.

Në pikëpamje strukturore – gramatikore, mikrotoponomia e këtij rajoni na ofron karakteristika shumë të rëndësishme për oronimet, hidronimet dhe kategorite tjera toponomike. Fjalëformimi me prapashtesa është më i pranishëm dhe më produktiv , si më karakteristike i kemi shqyrtuar prapashtesat: - **avec, -ak, -are, -ik, -inë > -ain,-ajn, -itë (>-ait,-ajt) , -ica (>-aic,-ajc), -urë (> -aur), -in, -ka, -nik (> -naik, najk), -xhi, -çe, -ush, -ec, -ishte, -ko, -çka, -**

le dhe –eza. Në fjalëformimin e mikrotoponomisë së kësaj ane më produktive është prapashtesa – **icë** me të cilën kemi regjistruar 80 topikë (**Belulica** (Deb), **Bezhaica** (Jab), **Bojxhica** (Des), **Boroçica** (Gos), **Branaica** (Bor, Cër, Zhit), **Branajca e Bellushajnës** (Bor), **Branenaica** (Gos), **Branica** (Zhit), **Çaushaica** (Bor); me **-ishtë** janë formuar 46 topikë (**Baçilishta** (Cër, Deb, Gos, Ner), **Barishta**, (Llzh), **Bostanishte** (Ner), **Bubishta** (Pre), **Bunishte** (Gos), **Dupçishtë** (Ner), **Firishta** (Ner), **Gradisht** (Ner), **Gradishta** (Ner), **Grashishte** (Deb), **Grebishta** (Cër),, aktive janë edhe prapashtesat **-ec** me 27 topikë (**Audha e Bashinecit** (Cër), **Audha e Dollgovecit** (Cër), **Audha Konjojec** (Llzh), **Bashineci** (Cër), **Bozec** (Ner), **Çeshmja e Bashinecit** (Cër), **Gjorgoec** (Gos), **Gojdareci** (Cër), **Gravanec** (Alld), **Ilineci** (Bell, Bor, Zhit); **-nik** me 20 topikë (**Gernik** (Deb), **Gorniku** (Pre), **Opalenik** (Alld), **Pularnik** (Pre), **Trestenik** (Alld), **Udha e Opalenik** (Alld), **Ulnarik** (Pre), **Audha e Gabrovnaikut** (Gos), **Bojanaiku** (Cër), **Gojdarnaik** (Des), **Grabavnaiku** (Cër), **Medenaiku** (Deb), **Tërstenaiku** (Deb),etj.

PËRFUNDIM

Toponomastika shqiptare e rrafshit të Pelagonisë, sikundër edhe ajo e viseve tjera të Maqedonisë përgjithësisht ka një rëndësi të madhe për autoktoninë e shqiptarëve në viset ku kanë jetuar me shekuj, por ku edhe sot vazhdojnë t'i përdorin po ata mikrotoponime që i kanë përdorur stërgjyshërit. Për këtë arsye materiali onomastik i vjelur në këto vendbanime shqiptare është dëshmi e gjallë jo vetëm për prezencën shqiptare shumëshekullore këtu, por edhe për mënyrën e jetesës, ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteve të ndryshme kulturore. Ky material ofron edhe të dhëna për ndikimet gjuhësore midis popujve të ndryshëm të cilët me shekuj kanë jetuar pranë njëri-tjetrit, andaj edhe huazimet janë të mëdha. Pa dyshim duhet të gjurmohet edhe më tutje me saktësi dhe të studiohet me gjerësinë dhe thellësinë e tij me objektivitet dhe fakte të duhura

shkencore, jo vetëm në këtë rajon por edhe në vendbanimet tjera shqiptare.

Shkurtesat

Alld - Alldançe
 Bell - Bellushinë
 Bor - Borinë
 Cër - Cërnilishtë
 Deb - Debresht
 Des - Desovë
 Gos- Gostirazh
 Jak – Jakrenovë
 Jab - Jabollçishtë
 Llazh - Llazhan
 Ner - Nerovë
 Pesh - Peshtalevë
 Pre - Presill
 Sazh – Sazhdevë
 Sog - Sogle
 Zhit - Zhitos

BIBLIOGRAFIA

ÇABEJ, Eqrem, Studime gjuhësore I. Tiranë.
 DOÇI, Rexhep (1983), Antroponimia e Llapushës (Prekorupës). Prishtinë.
 DOÇI, Rexhep (1994), Dëshmime onomastike ilire-shqiptare në Maqedoninë e sotme: Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup.
 ENIÇEREV, Nikola Gançev (1906), Vt̄zpominani i bele`ki. SofiÔ.
 GLASNIK Etn.Instituta SAN, III, 629.
 HAXHI-VASILJEVIÇ, Jovan (1902), Prilep i njegova okolina. Beograd.
 ILIEVSKI, Hr. Petar (1988), Balkanski Lingvisti~ki Studii, Skopje.
 IBRAHIMI, Mustafa (2003), Interpretime dhe studime gjuhësore, Shkup.
 IVANOVA, Olga (1982), Mesnite iminja na oblata po slivot na Bregalnica. Skopje.
 KEPESKI, Krume (1993), Pilepskiot govor 1941, Skopje.

KONESKI, Blaze (1991), Makedonski mesta i imiwa, Skopje.

KRAHE, Hans (1925), Die alten balkanillyrischen geographiechen namen, Heidelberg,
 KRYEZIU, Bahtiar (2000), Onomastika e Hashanisë. Prishtinë.

MILLADINOVC I B. (1962). Zbornik 242,373,445, (1881-1961), Skopje.

MULAKU, Latif (1989). Ndryshimet gjuhësore të disa toponimeve. në GJA – SSHF, 19-1989, Prishtinë.

MURATI, Qemal (1993). Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni. Tiranë .

MURATI, Qemal. (1993) Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni. Tiranë.

NOVAKOVIÇ, St. Srpske starine u Makedoniji-Bele`ke s putovawa Arhimandrita Antonina iz 1865 ne spomenik Srpske Kraqevine Akademije. IX; si dhe në GSND XLI .

PAVLOVIÇ, M. (1966). "Miscellanea toponymica macedonica - II" në Makedonski jazik, XVII, Shkup.
 PJANKA, V. (1970). Toponomastikata na ohridsko-prespanskiot bazen. Skopje.

PP I (1978). Prilep i Prilepsko niz istorijata I. Prilep.

SKOK, P. (1933). Iz Toponomastike Juzne Srbije. I Predeo izme|u Prilepa i kajmak~alana. Glasnik Skopskog Naucog Drusva, XII, 1933 dhe XV-XVI. Skoplje.

KONDA, Spiro, N. (1964). Shqiptarët dhe problemi pellazgjik. Tiranë.

TD - Turski Dokumenti VI.

TD IV (1971)- Turski dokumenti za istorijata na makedonskiot narod, Tapu tahrir defter, Nr.4, 1467-1468, Skopje.

TRAIÇev, Georgi Grad† Prilep. SofiÔ.

UROSEVIC, A. (1975). Toponimi Kosova. Beograd.

COSTUMES OF KËRÇOVA - TRADITION OF DEDICATION TO CONTINUITY VESHJA KËRÇOVARE - TRADITE E PËRKUSHTIMIT NDAJ VAZHDIMËSISË

ADEM XHELADINI
Kërçovë, Maqedoni
Email: adem.xh@hotmail.com

AKTET IV, 4: 703 - 707, 2011

PERMBLEDHJE

Veshja tradicionale shqiptare në rrethinën e Kërçovës paraqet një hallkë thelbësore në kalvarin e kultivimit të vlerave të vazhdueshme shpirtërore në mbarë hapësirën ku marrin frymë shqiptarët. Gjatë hulumtimit në terren është vërejtur se një sërë veshjesh, si të burrave ashtu edhe të gratë, po ruhen të paprekura dhe të pandikuara. Ornamentet dhe shenjzimet në sipërfaqen e tyre janë dëshmi të dobishme lidhur me të kaluarën e këtyre hapësirave. Nëpër arkat e nuseve janë gjetur mjaft materiale që dëshmojnë autoktoninë dhe origjinalitetin. Ky thesar, i cili ka ngelur akoma i pa prezantuar sa duhet mund të japë një kontribut modest në kalvarin e begatë të veshjeve shqiptare në përgjithësi

Fjalët çelës: Autoktonia, hallkë thesari etnologjik, kronologji, origjinaliteti, ornamented

SUMMARY

The traditional costume in the area of Kërçova represents an essential link in the calvary of continuous cultivation of spiritual values all over the expansion where Albanians breathe. During the field research it is noted that a range of clothing, both of men and women, are kept intact and uninfluenced. Ornaments and signs on their surface are useful evidence about the past of these regions. In the chests of the brides have been found sufficient materials that prove the autochthony and authenticity. This treasure, which has still remained without sufficient presentation can give a modest contribution in the prosperous Calvary of the Albanian clothing in general.

Key words: Indigenous, ethnological treasure link, chronology, authenticity, ornaments

Kërçova me rrethinën e saj është njohur për ruajtjen e veçantive të veshjes popullore, të cilat me xhelozë janë pasuar prej gjenerate në gjeneratë. Këto vlera deri më tani janë trajtuar në nivel të përgjithësuar bashkë me probleme të tjera të etnologjisë ndaj thellimi në të paraqet një kopsht akoma të paherrur. Në këtë punim do të përipiqemi të trajtojmë disa elemente si: llojin, formën, vëllimin, ornamentet dhe mjeshtrinë e realizimit të saj.

Për të realizuar punimin janë shfrytëzuar fondet e arkave të nuseve të vjelura në terren në fshatin Zajaz, si dhe punime të studjuesve që janë marrë me çështjen e kësaj veshjeje në Kërçovë.

Historia e kulturës sonë është shumë e lashtë aq sa vetë populli. Gjatë shekujve, populli asaj i ka dhënë një fizionomi të veten, me veçori, që e dallojnë nga popujt tjerë. Kjo veçori përbën tabanin kombëtar dhe veshja në kalimin nga periudha parakombëtare në atë kombëtare, paraqet hallkë në zinxhirin e pashkëputur dhe vlerë me peshë. Ruajtja e kësaj tradite, luajti një rol të rëndësishëm në rritjen dhe formimin tonë kombëtar. (Z. Sako, Studime për folklorin, Tiranë, 1984, f.141). Kundruar nga ky cep, veshjet popullore janë pasqyrim i ndërgjegjes estetike të një populli a të një rrethine të caktuar etnografike. (A. Bido, Kultura popullore, 2, 1985, Tiranë, f. 105).

Rrethi i Kërçovës ruan një fond tejet të pasur veshjesh, që ngërthejnë vlera të shquara kostumografike dhe artistike. Krahas funksionit praktik, në veshjet e Kërçovës shprehet edhe shija e hollë e krijuesit, dmth., spikat talenti artistik. Kërçovarët kanë ditur të shpalosin gjithë talentin e tyre krijues kur flitet për dëshminë e lashtësisë dhe aspektit artistik. Kërçova ngërthen në vete një gjeografi të madhe shqiptare, dhe paraqet interes të madh në fushën e studimeve të folklorit. (Dr. F. Mehdiu, Nga Kërçova për Kërçovën, Kërçovë, 1995). Aty hasim veçori të shumta si nga aspekti i krijimit poashtu edhe nga pikëpamja e kultivimit të tyre.

Për dallim nga rrafshi dialektologjik, në rrafshin kostumografik Kërçova është unitare (Dr. Q. Murati, Kërçova, Shkup, 2008, f. 217), pra pos që nuk ka dallime brendaregjonale, nuk ka as shkëputje me viset tjera shqiptare nga ku vërehet qartë vazhdimësia, kronologjia, trangu i përbashkët i lashtësisë, meqë elemente të përbashkëta të këtij zinxhiri, hasim gjithandej trangu tonë etnik. Në aspektin e llojshmërisë veshja e Kërçovës paraqitet në kontekstin e gjinisë, moshës, dhe situatës. Nga aspekti gjinor dallojmë veshjen e burrave dhe veshjen e grave, e cila ndahet poashtu në veshje për të ri dhe pleq, veshje për darsëm, veshje për në shtëpi dhe veshje për ditë morti.

Veshja e burrave dallohet me laryshinë e saj, koloritin dhe ornamentet e veçanta ku bëjnë pjesë: tirqët, çarapët, opengat, shullat, gjylmysët, brekët (të lintat e të leshtat), brezi, këmisha, strukja, mintani, xhylyni, xhamadani, kësula (çeçja), shamia etj. Pjesa e poshtme e veshjes së burrave karakterizohet me tirqit. Varësisht nga mosha e atyre që i vishnin dhe mbartnin këto veshje varej edhe ngjyra e tirqive të cilat për moshën e re kishin ngjyrën e bardhë ndërsa për më të moshuarit edhe ngjyra kafe e errët, të cilat ngjyeshin nga lëkura e drurit të verit por edhe ngjyra natyrore e leshit të deles e cila endej enkas për këtë qëllim, ndërsa tirqi të zeza zakonisht haseshin te pleqtë. Shumica e të rinjve vishnin tirqi të bardha me gajtana dhe atë të qepura në mënyra të ndryshme, me një gajtan, me dy, me shtatë etj. Kishte pastaj edhe tirqi që i quanin

edhe si në Gjakovë, si në Dibër, por më karakteristike ishin tirqit që priteshin si në Zajaz. Edhe gajtanat e tirqive ndaheshin në bazë të origjinës se nga vinte materiali kështu që gajtanat më të njohura ishin ato të Prizrenit, Gjakovës, Tetovës, Dibrës etj.

Materiali me të cilin kryesisht bëheshin tirqit dhe pjesët tjera të veshjes si xhamadani, mintani, strukja, xhylyni, brezi, “çarapët” dhe “kësula” ishte i leshtë, ndërkohë që këmisha ishte nga pëlhura. Varësisht nga kapaciteti ekonomik këmishat kategorizoheshin edhe ato në pëlhurë “me të da”, këmishë me tel, dy liqesh, shtatë liqesh, dymbëdhjetë liqesh etj. Kishte dhe pëlhurë (munashi) mëndafshi për të cilën gjë banorët e kësaj rrethine kultivonin edhe (buba) flutura mëndafshi, të cilat i ushqenin me gjethe të manit. Më të njohurat ishin këmishat “katër liqesh” të cilat më parë endeshin në “shul dhe shpatë” dhe më pas “vejeshin” në “tullar”. Këmisha zakonisht mbante jakë të qëndisur dhe karakterizoheshin sipas asaj se për çfarë rasti shërbenin si jakë me gjilërë, “jakë më dërrasë” etj. Gravurat e qëndisura te këto jaka kryesisht përbëjnë ornamente nga tradita ilire, për të cilat mund të thuhet me saktësi kur të bëhet krahasim në mes të mbetjeve arkeologjike të monumenteve ilire kanë ngjajshmëri të madhe dhe kishte ornamente të cilat quheshin “këmbë arushë” pastaj “këmbë zogu”, kry gjarpni” etj. Këto ornamente i hasim edhe te çorapet, si te meshkujt ashtu edhe te femrat. Përveç jakës këmisha përmbante edhe dorëzat të cilat varësisht prej rastit për çka visheshin kishin edhe ornamente të veçanta si te jakat dhe çorapet.

Xhamadanin zakonisht e vishnin të rinjtë dhe ai kryesisht vishej për raste solemne si nëpër dasma, nëpër ditë motmoti etj. Xhamadani përmban edhe sèpaku një xhep ku mbahej “çakia” ndërkaq në pjesën e epërme të xhamadanit vëndohej edhe një xhep i vogël ku mbahej ora “sahati”. Përveçse si dekor brezi simbolizon nivelin e burrërisë dhe gjatësia e tij matej me pëllëmbë por, mbahej edhe për shërbime tjera ku futej “patllaku” dhe takëmi i duhanit: kutia e duhanit, eshka dhe unuri, që shërbente për të ndezur duhanin. Struken e

mbanin njëkohësisht si të rinjtë edhe pleqtë, e cila vishej kur bënte kohë më e ftohtë dhe ka një



Figura 1. Veshje burrash

Xhylyni kryesisht vishej gjatë kohës kur bënte acar i madh dhe kryesisht e vishnin barinjtë me dhentë në stan. Xhylynin poashtu e kanë veshur edhe shumë luftëtarë, “kaçakët” në veçanti, pasi është tepër i trashë dhe mbron nga i ftohti. Edhe kësula që mbajnë banorët e Kërçovës ka trajtë të veçantë. Shumica e banorëve në kokë mbanin “kësulën” e rrafshët, të cilën e mbajnë edhe banorët e rrethit të Gostivarit, Dibrës dhe Strugës, mirëpo nuk mungonin raste kur dikush mbante edhe plis kosovar që e quanin “kësulë si strofkë zogu”. Gjatë të ftohtit rreth kësulës mbështillej edhe shamia që kishte kryesisht ngjyrë të kuqe apo të kuqërreme. Ngjyra e kuqe preferohej më së tepërmi, e cila edhe simbolizonte edhe ngjyrën e gjakut, si dëshmi se banorët e kësaj rrethine në të kaluarën kanë derdhur mjaft gjak. Shamia poashtu mbështillej për brezi dhe kështu krijonte një kolorit të papërshkrueshëm.

Zakonisht çorapet thureshin me tre shtiza dhe thureshin të bardha ato që do të “baheshin” dhe

pjesë të varur nga prapashpina në krahë dhe kur mblidhet mbi kokë merr formën e kësulës.



Figura 2. Shfaqja “Amaneti” Kërçovë

çorapet me një shtizë, të cilat poashtu visheshin për raste solemne. Gjylmysët ishin kordha të cilat tjerreshin për të mbajtur “shullat” të cilat ishin lecka të leshta, me të cilat mbështillej pjesa e këmbës nën gju, dhe lidheshin me “gjylmysë me kiska” dhe “gjylmysë pa kiska”, të cilat përbënin pjesën shoqëruese të opingave. Te veshja e grave dallojmë stil ndryshe nga burrat, kështuqë gratë shqiptare të rrethit të Kërçovës gjatë të kaluarës kurrë nuk kanë veshur tirqi, siç ka ndodhur me disa gra shqiptare nga trevat e Kosovës dhe të Shqipërisë. Për dallim nga tirqit që ishte veshje e burrave gratë mbajnë të ngjeshura “nogajca” “kameza” që janë ornamente të veçanta të endura në vek. Poashtu varësisht nga përdorimi, ornamentet të “kamezat” dallojnë për nga bukuria dhe dekorimi. Te gratë kemi një qasje tjetër të veshjes dhe kemi “nagajca të ditës së enjte, ditës së xhuma, ditës së shtunë, për në gosti, nagajca cucash, grashë, plakash. Ky lloj i veshjes ka qenë dominant deri aty kah vitet e tetëdhjeta si veshje e zakonshme

ndërsa tani kjo praktikohet në ndonjë dasmë fshati ku kryesisht me këso veshjesh vishen vajzat e reja. Çarapët e grave, si te burrat, përmbajnë ornamente tejet të bukura dhe kemi poashtu “çarapë me një shtizë”, “çarapë të qenis” etj.

Për dallim nga veshja e burrave, te veshja e grave në pjesën e poshtme kemi edhe peshterkën, e cila varësisht nga mosha dallon edhe në ngjyrë. Kështu plakat dhe gratë më të moshuara mbanin peshterka të bardha me pala, ndërsa vajzat e reja dhe nuset mbanin peshterka të kuqe. Gratë mbanin nga dy peshterka, një në pjesën e përparme e cila zgjatet deri në dy pëllëmbë nën gju ndërsa në pjesën e prapme një peshterkë e thyer në mes që zgjatet deri në një pëllëmbë mbi lakth. Për nga forma, brezi i grave dallon nga brezi i burrave dhe është më i ngushtë dhe ka kryesisht ngjyrë të bardhë. Është i dekoruar me llojlloj ornamentesh dhe është i endur në tullar me pasion të veçantë. Për dallim nga brezi i burrave, i cili ishte i njëjtë për të gjithë te brezi i grave dallojmë edhe breza sipas moshash. Kështu vajzat mbanin brez të zi, nuset të bardhë të dekoruar me ornamente, ndërkaq plakat brez të kuqërremtë. Këmisha e grave dallon nga ajo e burrave dhe ka dy lloje këmishash: këmisha e gjatë dhe këmisha e shkurtër “kousa”. Për nga materiali me të cilin përgatiten këto këmisha janë disa llojesh, “dy liqesh, katër liqesh, tetë liqesh, dymbëdhjetë liqesh”, varësisht nga ornamentet. Dallojmë këmishë “me të da” dhe “këmishë darsme”, e cila është përplot ornamente.

Sa u përket ornamenteve te veshja e sipërme e grave hasim në stoli të ndryshme varësisht nga shija artistike e tyre. Mëngët e këmishës te gratë janë më të gjëra dhe deri në bërryla vëheshin dorëza të cilat ishin të dekoruara me jaka me ornamente të ndryshme, një pjesë të të cilave i hasim edhe te jakat e këmishave të burrave. Fundi i këmishës zakonisht dekorohet me shirit rruazash, që quhej “spëik ndërsa në të gjitha cepat e këmishave të grave do të hasim “badrrat”, të cilat shërbejnë si stoli shtojcë, kjo ndodh sidomos te këmishat për cuca dhe nuse, ndërsa te këmishat e plakave ky lloj dekori ishte më i paktë.

Veçanti tjetër te veshja e grave është se në vend të xhamadanit hasim jelekun, i cili poashtu sipas shijes dhe mundësisë qepej disa llojesh. Kështu kemi jelekun “me kaftan”, jelekun “allaxhe”, jelekun me “pare, urupë”. Jeleku vlerësohej edhe në bazë të sumbullave, të cilat ishin vendosur në të, në bazë të numrit të gajtaneve. Poashtu te gratë hasim edhe “hyrkën”, e cila ka ngjyrë të kuqërremtë të ërrët për nuset dhe ngjyrë të kuqërremtë për gratë më të moshuara. Për rastet solemne sidomos kur merret nuse, asaj ia veshin “dollamën”, rizja dhe “paftja” dhe jeleku me pare, që përgatiten enkas si pajë e nusërisë dhe përdoren në çastet e dasmës kur merret nusja.

Do theksuar se jeleku me pare vlerësohej në bazë të numrit të urupëve që do t’i vareshin. Në bazë të traditës kërcovare nusja ka flokë të gjatë dhe ato i ka të thurura në “bishta” deri nën shpatulla dhe më poshtë shpërndahen në disa “bishta “ të vogla, që shpërndahen nëpër shpinë dhe mëpas mblidhen në bel ku lidhen në një të vetme me “mexhdi sërme” (monedhë argjendi me gurë të çmuar) dhe nën të rradhiten gurë të çmuar dhe mëposhtë flokët lëshohen “tufkë”.

Varësisht nga gjatësia e flokëve të vajzave “kupekat” (plakat që shëtisin nëpër dasma) vlerësojnë mençurinë dhe bukurinë e vajzës.

Për dallim nga kësula, te gratë hasim shaminë, e cila sipas mënyrës se si vëhet është disa formash. Kështu kemi shaminë vënë “hije” e cila mbulon pjesën e kokës ku janë flokët mbi ballë dhe e cila lidhet në pjesën ku flokët fillojnë të ndahen në gërsheta dhe e cila zakonisht kalon mbi veshë.

Forma tjetër e lidhjes së shamisë është shamia e lidhur “grykë” e cila palohet në formë trekëndëshi dhe kap pjesën e kokës veshëve dhe lidhet ose nën mjekërr ose me të mbulohen edhe buzët. Shamia e hollë, lidhet nën shami dhe stoliset me “hoja” që mbajnë nuset e reja në ditët e darsmës të cilat lidhen për flokësh me “kërfica”. Në rast dasme nën shaminë e hollë nuset i lëshojnë edhe “xëllufet” e flokëve që të duket e bukur.

Varësisht nga rasti apo solemniteti shamia mund të ketë ngjyrë të bardhë, dhe e kuqe e hapur, por parapëlqehet shamia e bardhë.

Mjerisht veshja tradicionale sot ka ngelur si relikт sidomos veshja e burrave ndërsa te gratë, veshje të këтillë hasim akoma në ndonjë dasmë fshati, ku vajzat e reja vishen për kureshtje. Sot, kjo veshje përdoret shumë pak. Vetëm dasmat janë vendi i duhur ku ato ekspozohen, por tendencat që kjo veshje të lihet në harresë janë të mëdha dhe ndikimet nga jashtë rrezikojnë këtë thesar.



Figura 3. Bofçe për gra në Zajaz

Është koha të ndërmerret diç në ruajtjen e këtyre vlerave të paçmueshme aq më tepër shtrohet nevoja e themelimit të ndonjë muzeu etnografik, sidomos në Kërçovë, ku këto vlera do të konservoheshin dhe brezave të ardhshëm do t'u shërbenin si dëshmi e autoktonisë dhe vazhdimësisë.



Figura 4. Vajza me veshje kërçovare në Festivalin Folklorik Kombëtar, Berat, 1995

BIBLIOGRAFI

ÇËSHТJE të folklorit shqiptar, 4, ASHRPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, (1989), Tiranë.
KULTURA popullore, 2, ASHRPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, (1985), Tiranë.
MEHDIU, F., Nga Kërçova për Kërçovën, (1995), Kërçovë.

MURATI, Q., Kërçova, (2008), Shkup.
SAKO, Z., Studime për folklorin, ASHRPSSH, Instituti i Kulturës popullore, (1984), Tiranë.
STUDIMI etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Instituti Albanologjik i Prishtinës, (1990), Prishtinë..

THE FORMATION OF SOME VERBS IN FRENCH DERIVED FROM GIVEN ANIMAL NAMES FORMIMI NË FRËNGJISHT I DISA SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE ME FOLJE TË PREJARDHURA NGA EMRA KAFSHËSH

IRENA FISTANI

Universiteti "Luigj GURAKUQI", Departamenti i Romanistikës, Shkodër, SHQIPËRI

Email: ifistani@hotmail.com

AKTET IV, 4: 708 - 716, 2011

PERMBLEDHJE

Gjatë punës sime shumëvjeçare, me fjalorë të gjuhës frënge dhe vitet e fundit në studimet e mia në fushën e frazeologjisë, më ka tërhequr vëmendjen pasuria e kësaj gjuhe me shprehje frazeologjike. Me këtë referim dua të jap një ndihmesë modeste për të nxjerrë në pah edhe një herë zhdërvjelltësinë e gjuhës frënge, larminë dhe përpjekjen për pasurimin e saj të vazhdueshëm frazeologjik me folje, që nëpërmjet fjalëformimit me prapashtesa, e kanë prejardhjen e tyre duke u nisur nga disa emra kafshësh. Populli e pasuron gjuhën e vet me fjalë e shprehje nga realiteti i përditshëm, që e rrethon dhe, pa e kuptuar se për çdo fjalë apo shprehje frazeologjike, ai operon me një dukuri leksikore. Francezët dhe gjuha e pasur e këtij kombi, na japin shembullin madhor për të kuptuar se si e përjetojnë dhe e përftojnë në gjuhën e tyre të pasur zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës, duke e pasur atë kurdoherë si pjesë të ecjes përpara e të zhvillimit. Në këto kushte, ne mënyrë të veçantë shquan në gjuhën frënge, krijimi i disa shprehjeve frazeologjike me folje, që krijohen mbi bazën e metaforave dhe njëherazi me anë të prapashtesave. Po t'i shtojmë, prapashtesën "er" emrave të kafshëve si: **singe, grenouille, serpent, renard, papillon**, përftohen foljet **singer, grenouiller, serpenter, renarder, papillonner**. Në gjuhën shqipe nuk ka folje të veçantë, për të dhënë barazvlerësin (ekuivalentin) e **singer**, por përkthehet me perifrazim: *përqesh si majmun*, ndërsa për *singer*, përdoret kuptimi figurativ *puçros me miell*, që i përket vetëm gjuhës frënge.

Fjalë çelës: fjalëformim, prapashtesë, perifrazim, metaforik, emërtim, barazvlerësim.

SUMMARY

The language evolution goes hand in hand with the performance and progress of the people who are its creators and owners. People enrich their own language with words from the daily life and often times, without realizing that for every word formation, has operated with a phenomenon grammar, lexical etc.. During my many years of work with French language dictionaries, the lexical richness drew my attention. With this referral I would like to give my modest contribution in order to highlight once again the evolution of the French language, its diversity and richness continuing through word formation with suffixes, starting from animal names.

Key-words: word formation, extension, circumlocution, metaphorical, label, equivalent

HYRJE

Studimi merr shkas nga vlerësimi i gjuhëtarit të shquar frëng, Pierre Guiraud, i cili, në veprën e tij *Locutions Françaises*, thotë: "Një gjuhë është pa dyshim pasqyra e një populli. Ajo është mënyrë e shprehjes së realitetit. Ajo pasqyron sendet që emërton: natyrën, njeriun, jetën e zakonet e tij, institucionet teknikën dhe mënyrën se si ai i ndjen

dhe si i koncepton gjërat" (Guiraud, 1980: 11). E vjetra dhe e reja në gjuhë shkojnë sipas ecurisë dhe përparimit të vet popullit që është krijuesi dhe bartësi i saj. Edhe gjuhëtari e studjuesi i njohur Atë Justin Rrota, qysh në vitet '30 të shekullit të kaluar, ndonëse duke mos pasur asnjë lidhje a ndikim të drejtpërdrejtë me gjuhëtarin frëng, por duke pasur pikërisht atë formim të

shëndoshë e dukshëm të lidhur me shpirtin e gjuhës e të zhvillimit ligjërimor të çdo kombi, thoshte: “*gjuha shkon tue marrë ato zhvillimet e veta’ dhe, sipas rastit, njeriu duhet dhe mundet me e dredhë g-juhën*”.

Gjatë punës sime shumëvjeçare, me fjalorë të gjuhës frënge dhe vitet e fundit në studimet e mia në fushën e frazeologjisë, më ka tërhequr vëmendjen, pasuria leksikore e kësaj gjuhe, zhërvjelltësia dhe larmia e saj. Francezët dhe gjuha e pasur e këtij kombi, na japin shembullin madhor për të kuptuar se si e përjetojnë dhe e përftojnë në gjuhën e tyre, zhvillimin dhe pasurimin e saj, duke e pasur atë kurdoherë si pjesë të ecjes përpara. Në mënyrë të veçantë në gjuhën frënge shquan krijimi i foljeve mbi bazën e metaforave dhe njëherazi me anë të prapashtesave, madje edhe abstrakte, si p.sh. duke u shtuar prapashtesën -er emrave të kafshëve si: **singe, grenouille, serpent, renard, papillon** përftohen foljet: **singer, grenouiller, serpenter, renarder, papillonner**.

Në gjuhën shqipe nuk ka folje të veçantë, për të dhënë barazvlerësin (ekuivalentin) e **singer** (Kokona, 2001: 980), por përkthehet me perifrëzim: **perqesh si majmun**, ndërsa **singer**, kuptimi figurativ **pudros me miell**, i përket vetëm gjuhës frënge. Pra dallojme shprehje frazeologjike që kanë në trupin e tyre folje që vijnë nga emra kafshësh si: “*Fouiner dans la vie privée de qqn*” ose “*Faire la coquette*”

Le të futemi më në thellësi të objektit që kemi marrë në shqyrtim. Modelin prapashtesor të formimit të fjalëve gjuha frënge e ka shumë të zhvilluar. Shpesh herë ky formim, shumë pjellor përfton kategori të reja gramatikore, p.sh. duke u nisur nga emrat **chant, cri, marche** dhe duke shtuar prapashtesën -er kemi një kalim të fjalëve nga kategoria emër në kategorinë folje: **chanter, crier, marcher**.

Objekti i studimit tonë, nuk është i përgjithshëm, por ka të veçantën e vet. Duke u nisur nga disa emra kafshësh cilat janë dukuritë gramatikore që shoqërojnë procesin e formimit të disa foljeve? Në gjuhën shqipe nuk është shumë i përhapur si model, por kemi dhe raste të tilla si nga emri **flutur, gjarpër**, të cilëve duke u shtuar

prapashtesën -oj kemi ndryshim nga kategoria emër në kategorinë folje: **fluturoj, gjarpëroj**. Siç thamë dhe më lart, duke shqyrtuar këtë dukuri veçojmë:

Në gjuhën frënge mund të formohen fjalë të tipit prapashtesor, duke u nisur nga emra kafshësh. Kështu barazvlerësat në frëngjisht janë **papillonner** (Rey, 1998: 934) dhe **serpenter**. Kuptimi i parë nuk është **fluturoj**, si në gjuhën shqipe, por **endem** (Kokona, 2001: 725), **breddh si flutura** dhe kuptimi i dytë: **kaloj nga një temë te tjetra**.

Në frëngjisht kuptimi i parë është **faire le papillon**, por mund të merret si folje kalimtare: **dindonner quelqu’un** (Larousse, 1, 1994: 343); **tromper quelqu’un** (Kokona, 2001: 299); **le berner** (kalimi nga folja jokalimtare **papillonner** në foljen kalimtare **berner quelqu’un**) **faire de quelqu’un un dindon**: gënjej dikë, ia hedh dikujt (Kokona, 2001: 299).

Siç do të mundohemi të sqarojmë në vazhdim e përbashkëta e këtyre foljeve të marra në kuptimin e parë, ose në atë figurativ, qëndron në faktin se janë përfutur duke u nisur nga tema, që është një emër kafshe dhe duke i shtuar në shumicën e rasteve, prapashtesën onner, otter, er, ter, der.

Profesori i madh i leksikologjisë, Jani Thomai, në *Leksikologjia e gjuhës shqipe* na mëson: “*Zakonisht me prapashtesim ndërrohet dhe kategoria leksiko - gramatikore, nga një pjesë ligjëratarë kalohet në një pjesë tjetër ligjëratarë*” (Thomai, 1984: 113).

Le të shohim ndryshimet semantike e gramatikore, që shoqërojnë kalimin e disa emrave të kafshëve në folje.

âne, ânonner
biche, bichonner
bracon, braconner
canard, canarder
cafard, cafarder
caracole, caracoler
chapon, chaponner
chèvre, cabrer
chèvre, cabrioler
chèvre, chevrotter
caille, cailleter.

chamois, chamoiser
 chien, chienner
 cochon, cochonner
 coq, coqueter
 dinde, dindon, dindonner
 faisan, faisander
 fouine, fouiner
 fourmie, fourmiller
 furet, fureter
 grenouille, grenouiller
 lézard, lézarder
 loup, louper
 marmotte, marmotter
 mouton, moutonner
 papillon, papillonner
 paon, pavane, se pavaner
 pie, pier
 pigeon, pigeonner
 serin, seriner
 serpent, serpenter
 singe, singer

Po të vështrojmë me hollësi, dallojmë se prapashtesa - **onner**, është më prodhimitare. Në mes të këtyre fjalëve, ka folje që mund të konsiderohen se kanë një prejardhje të drejtpërdrejtë si: **âne, ânonner; biche, bichonner; lézard, lézarder; loup, louper; canard, canarder; furet, fureter; grenouille, grenouiller; serin, seriner; serpent, serpenter; singe, singer; pie, pier.**

Po të marrim në shqyrtim foljet që kanë prejardhur nga emri i kafshës **dhi: chèvre - cabrioler; chèvre - chevrotter; chèvre (capra) - cabrer**, menjëherë kuptojmë kalimin nga kategoria *emër* në kategorinë *folje*, duke shtuar prapashtesat: - **otter** në rastin e formimit të fjalës **chevrotter** nga **chèvre**; - **er** në rastin e **cabrioler**

dhe **cabrer**. Por, njëkohësisht, do të kërkojmë ndihmën e etimologjisë së fjalës dhe prejardhjen e saj nga latinishtja, për të kuptuar lidhjen që kanë këto dy folje me emrin e kafshës **dhi - chèvre** në latinisht **capra**.

Nga emri **biche** (drenushë, sorkalle) kalojmë tek folja **bichonner**. Edhe në gjuhën shqipe, kur përmendim fjalën **sorkadhe** shpesh bëhet krahasimi me një vajzë të re, me trup të bukur (është si sorkadhe). Të njëjtën hijeshi na përcjell folja **bichonner**: bëj tualet me kujdes, me naze, zbukuroj dikë.

Folja **chienner**, që rrjedh nga emërtimi i kafshës **qen** nuk ka asgjë të përbashkët me foljen **leh**, në frëngjisht **aboyer**. Përkthimi i saktë në gjuhën frënge do të ishte: **me qenë (i, e) kursyer, koprrac**. Kështu **gjahu** bashkon emrin **bracon** (chien de chasse): **qen stani, gjoje, fam. zagar** me veprimin e foljes **gjuaj** ose **peshkoj** pa leje.

Me vështirësi bëhet lidhja e kuptimit të foljes: **louper: ne pas reussir: rater** me emrin **loup** (ujk). Folja **cailleter**, është e lidhur dhe me emrin onomatopeik të shpendit **la caille**, për tingullin që nxjerr **la caille (turtullesha)**. Në gjuhën shqipe, nuk kemi folje që emërton këtë veprim, por themi **bën si turtull**, është shumë llafazane **flet si turtull** tërë ditën.

Fjala **pie, laraskë** i jep jetë foljes **pier : rrëkëllej, pi heq, tërheq (gota, pije)**.

Foljet: **fouiner, fureter** janë sinonime dhe komunikojnë tek në kuptimin e foljes **fouiller: fut hundët në punët e të tjerëve, rrëmoj, gërmoj**.

Profesor Nonda Varfi në veprën e tij *Introduction à la lexicologie du français* jep përkufizimet shkencore për problemet e prejardhjes leksikore, semantike dhe prapashtesore (Varfi, N., 2005: 92-93)

Tabela 1

Emri fr.	Folja fr.	Emri shq.	Folja shq.
Âne .n.m. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 72)	Ânonner : lire, parler, reciter avec peine (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 72)	Gomar (Kokona, 2001: 63)	Lexoj, flas, recitoj me mundim; Lexoj me të ngecur v. Intr.etctr (Kokona, 2001: 63)
Biche .n.m.	Bichonner : arranger, parer avec soin et recherche(qqn, qch)	Sutë, drenushë (Kokona, 2001: 117)	Zbukuroj me kujdes , famë Fig: kujdesem shumë

	Fam. Faire sa toilette se preparer avec recherche et coquetterie 139) (<i>Larousse</i> , 1994: 139)		për dikë (Kokona, 2001: 117)
Bracon. (chien de chasse). N. M. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 159)	Braconner. v. i. chasser ou pêcher sans respecter la loi; les interdits ; se rendre coupable de; braconnage (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 159)	Qen stani, gjoje; fam, zagar (Kokona, 2001, 137)	Gjuaj ose peshkoj pa leje (Kokona, 2001, 137)
Chèvre. N.m. (capra du latin) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 170)	Cabrer: faire dresser (un animal, en partic. Un cheval sur les membres postérieurs -cabrer un avion : relever sa partie anterieure pour qu'il prenne de l'altitude ; se cabrer v.pr. : se dresser sur ses membres postérieurs Fig. :s'opposer avec viguer ou violence, se révolter (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 170)	Dhi	v.tr ngre arithi , v pr, ngrihet arithi fig : ngrihet kundër dikujt, kundër diçkaje (Kokona, 2001: 149); dialektore: u ngrit në bishti (Kokona, 2001: 149)
Chèvre. n.f. (capra du latin) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 170)	Cabrioler : faire des cabrioles (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 170) (Cabriole : n.f. demi tour exécuté en sautant légèrement)	Dhi.	Bej kollotumba Fig.:bëj marifete (Kokona, 2001: 149); ngrihet kali në dy këmbët e prapme (Kokona, 2001: 149);
Cafard, cablatte (insecte) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 172)	Cafarder, v.i.dénoncer moucharder	Bumallë (Kokona, 2001: 149);	v.tr. Kallezot raporto v.i.mërzitem (Kokona, 2001: 149);
Lézard (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 598)	Lézarder, produire des lézards Se lézarder : se fondre en parlant d'un mur (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 598),	Hardhuce (Kokona, 2001: 597)	v.tr.Shkaktoj të çara në mur, v.i. Shullëhem (Kokona, 2001: 597)
Loup. n.m.	Louper (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 610): ne pas reussir; rater	Ujk.	v. tr. Fam. : nuk arrij të bëj dicka. Tu vas louper ton train (Kokona, 2001: 291)
Caille. n.f.	Cailleter, pousser des cris. La caille carcaille, pousse un cri onomat (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 173).	Shkurtë, turtulleshë, turtull	Dërdëllit (Kokona, 2001: 150)
Canard. n.m	Canarder v.t Tirer sur qqn, en étant Soi-même à l'abri (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 178)	Rosak.	Qëlloj, shtie (Kokona, 2001: 153).

Caracole .n.m. (limaçon) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 184)	Caracoler ,v.i. se mouvoir, évoluer librement avec vivacité et légèreté (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 184)	Kërmill.	Lodroj, kërcej, hidhem. v. i. (Kokona, 2001: 156)
Chamois n.m. (Chamois des Pyrénées) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 205)	Chamoiser : préparer par chamoisage (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 205)	Kamosh (lloj dhije e egër) (Kokona, 2001: 169)	Regj lekurë me vaj peshku (Kokona, 2001: 169).
Marmotte, n. f. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 635)	Marmotter :v.t et i. (onomat) murmurer confusément et entre les dents (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 169)	Brejtës, vjedull	v.tr murmurit, llomotit, nënërit (Kokona, 2001: 614).
Mouton, n.m.	Moutonner, v. i. 1.-Se briser en produisant une écume blanche, en parlant de la mer. Les vagues moutonnent 2.-Se couvrir de petit nuages blancs et pommelés .Ciel qui moutonne (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 680).	Dash, (Tête moutonnée : kokë flokëdredhur (Kokona, 2001: 660)	Valëzon, shkumbëzon mer, lac, rivièrë qui moutonne. moutonné, e adj. 1.flokëdredhur: <i>tête moutonnée, kokë</i> me flokë të dredhur 2. me re të bardha ; ciel moutonné : qiell i mbuluar me re të vogla,të bardha (Kokona, 2001: 660)
Chapon n, m . (lat.capo, caponis) 1.-coq castré engraisé pour la table (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 208)	Chaponner, v.t. Castrer un jeune coq (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 208).	Gjel, kaposh, kendes i tredhur (Kokona, 2001: 171)	Tredh këndesin (Kokona, 2001: 171)
Chèvre .n. f. La chèvre béguète, bête, chevrote, pousse un cris (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 219).	Chevrotter v.i. .(en parlant des chèvre) 1.- bêler, 2.- chevrotter. II.chanter, parler avec des chevrottements dans la voix (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 219).	Dhi.	Flas, këndoj me zë të dredhur (Kokona, 2001: 179)
Chien,chienn e (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 219).	Chienn , etre avare (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 219)	Kursimtar. Chienné, chiennée adj. i, e kursyer (Kokona, 2001: 180)	Me qenë i, e, kursyer, koprac (Kokona, 2001: 180)
Cochon. n. m. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 238)	Cochonner .v.t. executer salement ; souiller, salir (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 238)	Derr.	v.t.(cochonner un travail) :katranos një punë; ia nxjerr sytë

Coq .n.m	Coqueter v. i. Faire la coquette.(le coquet) (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 273)	Gjel.	v. i. Bej naze ,sillem si koketë; kaperdisem (Kokona, 2001: 224)
Dinde , n.f. dindon . n m.(<i>Larousse</i> , 1, 1994: 343)	Dindonner v. t.: tromper qqn. Le berner (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 343)	Gjel deti; bibë (budallaçkë) (Kokona, 2001: 299)	v.t.Gënjej dikë ia hedh (Kokona, 2001: 299).
Papillon . n.m.(<i>Larousse</i> , 1, 1994: 742)	Papillonner v. i. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 934)	Flutur.	Endem , v. i. Fam. 1. bredh si flutura 2. kaloj nga një temë te tjetra (Kokona, 2001: 725).
Paon . n. m. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 933)	Se pavaner v.pr. Paon . (de pavane,avec l'influence da paon). Marcher ou se tenir en prenant des poses avantageuses ; parader. faire l'important (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 755). Être vaniteux, fier comme un paon (Rey, 1998: 933).	Pallua.	v.pr. Kapardisem , krekosem. Tundem e shkundem duke ecur (Kokona, 2001: 745).
Pie . n. f. 1. Passereau aux plumage noire et blanc. La pie jacasse, jasse 2.bavarde. Ta voisine quelle pie ! (Rey, 1998: 985).	Pier .v.r.(argotisme: boire)(Varfi, Bakillari, 2005: 89)	Laraskë (Kokona, 2001: 772).	Heq, tërheq, kthej rrëkëllej, pi. (Varfi, Bakillari, 2005: 89)
Pigeon .n.m. pigeonne, n. f. (Rey, 1998: 988)	Pigeonner v.t. : tromper, duper (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 782).	Pëllumb (Kokona, 2001: 776).	Mashtroj , ia hedh (dikujt) v. t, e gaboj (Kokona, 2001: 767)
Faisan .n.m. Faisanne. n, f. (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 427).	Faisander .v.t.:1. donner à un gibier un fumet acentué en lui faisant subir un commencement de décomposition. 2. être proche de la décomposition (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 427).	1.Fasan. 2.Batakçi (Kokona, 2001: 411)	1. Korruptoj. 2. E lë mishin e gjahut të prishet pak. (për t'i dhënë një farë shije. fasandée : i,e korruptuar (Kokona, 2001: 411)
Fouine .n.f.lat:fuscina. 1. vit dans les bois et commet des ravages La nuit des ravages	Fouiner . v i. 1.se livrer a des recherches indiscrete. <i>Fouiner dans la vie privée de qqn</i> (<i>Larousse</i> , 1, 1994: 542).	Shqarh (Kokona, 2001: 443).	Gërvëlis, rrëmoj Fam zhbiroj, fut hundët në punët e të tjerëve. v i. (Kokona, 2001: 443)

dans les poulaillers. 2. fig personne rusée, indiscrete (Larousse, 1, 1994: 542).			
Fourmie. n. f. lat. Formica (Rey, 1998: 578).	Fourmiller v. i.: La rue fourmille de passants (Larousse, 1, 1994: 454)	Thnegël, milingonë(Kokona, 2001: 445)	Fourmiller de qqch : ka plot me shumicë (Lilo, Varfi, 2006: 72); Gëlon (Kokona, 2001: 445)
Furet. n.m 1.Petit mammifère carnivore, au pelage blanc et aux yeux rouges, qui sert à chasser le lapin (Rey, 1998: 592) 2. personne curieuse, fouineuse (Larousse, 1, 1994: 463)	Fureter.v.i. 1. chasser au furet . 2.fouiller, chercher pour découvrir des choses cachées ou des secrets (Larousse, 1, : 463).	Qelbës, zool. (Kokona, 2001: 456)	Gërmoj (fig), rrëmoj, (fig), (Kokona, 2001: 456)
Grenouille. n. f (lat. ranucula) (Larousse, 1, 1994: 494) -Loc. Fam : manger la grenouille : vjell të hollat e arkës (një arkëtar) (Kokona, 2001: 484)	Grenouiller.v i. Fam et péj. Se livrer au grenouillage. (ensemble d'intrigues, de manoeuvres peu honnêtes, notamm. dans le domaine politique (Larousse, 1, 1994: 494)	Bretkosë (Kokona, 2001: 484)	Intrigoj, mashtroj
Serin, e (Larousse, 1, 1994: 932)	Seriner.v. t. 1. instruire un oiseau, un serin (Larousse, 1, 1994: 932) à chanter. 2. répéter sans cesse qqch. A qqn pour le lui apprendre.	Kanarinë Fam. leshko, rrotë (Kokona, 2001: 972)	Mesoj të këndoj : (kanarinën, zogun). I a përsërit shumë herë një mësim, një këngë, dikujt që t'ja fut në kokë. (Kokona, 2001: 972)
Serpent. n. m. (Larousse, 1, 1994: 932)	Serpenter.v. i. Decrire des sinuosités (Larousse, 1, 1994: 932)	Gjarpër. (Kokona, 2001: 973)	Gjarpëron (Kokona, 2001: 973).
Singe. n.m. (Larousse, 1, 1994: 940)	Singer.v. t. Imiter qqn. : singer un camarade (Larousse, 1, 1994: 940)	Majmun. (Kokona, 2001: 980)	1.Përqesh si majmuni (Kokona, 2001: 980). 2. fig. puetros me miell.

Siç pamë edhe në tabelën e mësipërme, kur kemi ndryshim kategorial të fjalës, kalim nga njëra

njësi, në një njësinë tjetër garamatikore dhe në rastin tonë konkret, kur fjala kalon nga një pjesë

e ligjeratës (emër), në një pjesë tjetër të ligjeratës (folje), shoqërohet edhe me ndryshime semantike të veçanta. Rrethi i ndryshimeve mund të bëhet edhe më i gjerë, por ne jemi fokusuar vetëm në kalimin nga emër, në folje.

Kalimet mund të zgjerohen: nga emri **mouton** (dash), në foljen **moutonner** (valëzon, shkumbëzon, dallgëzon), në mbiemrin **moutonné, e** (flokëdhredhur, i mbuluar me re të bardha), me mbiemrat e tjerë **moutonnant, e** (valëzues) dhe **moutonneux, euse** (i dallgëzuar, valë-valë) (Kokona, 2001: 660) për të vazhduar tek emri tjetër le **moutonnement** (valëzim). Ndryshimet më të shumta në këtë drejtim, ndjehen në rrafshin leksikor, por edhe në atë gramatikor. Një dukuri tjetër, që vërehet nga kalimi i emrave të kafshëve në folje, është edhe abstragimi kuptimor. Kuptimi ndjek një vijë logjike kur bëhet kalimi nga emri **paon** (pallua) në foljen **se pavaner** (kapardisem), ose kalimi nga emri **fourmie** (milingonë) në foljen **fourmiller** (gëlon), por merr karakter abstrakt kalimi nga emri **grenouille** (bretkosë) në foljen **grenouiller** (mashtroj, intrigoj). Pavarësisht se kur përdoret si folje, ai ka fituar tashmë ngjyrim të figurshëm, por gjithmonë duke sqaruar etimologjinë e prejardhjes së shprehjes frazeologjike të përdorur në rregjistrin familjar **manger la grenouille**, që do të thotë *ha të ardhurat e arkës, arkëtari*. Burim për shprehje frazeologjike të motivuara bëhen dhe përdorimet e këtyre foljeve të përdorura si metafora. Fare mirë flasin gjithashtu dhe shprehjet frazeologjike të sipërpërmendura si: *Fouiner dans la vie privée de qqn* (Larousse, 1, 1994: 542). *(fus hundët në jetën private të dikujt: Fam. zhbiroj, fut hundët në punët e të tjerëve. v i.* Kokona, 2001: 443), *Faire la coquette, le coquet* (Larousse, 1, 1994: 273): (Bëj naze, sillem si koketë; kapërdisem (Kokona, 2001: 224) *Se cabrer furieusement* (Fig. :s'opposer avec viguer ou violence, se révolter, Larousse, 1, 1994: 170): dialektore: **u ngrit në bisht** (Kokona 2001: 149) , *singer un camarade, imiter qqn.* : singer un camarade (Larousse, 1, 1994: 940), *Përqesh si majmuni, imitoj një shok* (Kokona, 2001: 980).etj,etj,

Gjuhëtari i njohur francez, Louis Guilbert, në veprën e tij *La créativité lexicale* na mëson: “Çdo gjuhë evoluon, sidomos në epokën tonë, me një shpejtësi të madhe. Mjafton të shohësh listën e fjalëve të reja, që u shtohen çdo edicioni të një ‘Petit Larousse’: Fjalë të reja, fjalë të kohës e gjithashtu neologjizma /.../. Ekzistojnë dy forma të krijimit leksikor, që nuk duhet të kundërshtojnë njëra – tjetrën: krijimi duke u nisur nga struktura e fjalisë dhe krijimi leksikor, duke u nisur nga ligjërata e një individi ose grupi të caktuar njerëzish, që i korrespondon një etape të caktuar historike. Këto dy të dhëna shpjegojnë evolucionin leksikor të një gjuhe” (Guilbert, 1975: 49).

Përfundim. Në punimin e cituar më sipër, që është frut i një pune të bërë me durim, duke kërkuar e rikëruar, krahasuar e hulumtuar në shumë fjalorë, u mundova të jap ndihmesën time modeste, në këtë fushë kaq të bukur, por dhe shumë të vështirë. Dhe populli e pasuron gjuhën e vet me fjalë nga realiteti i përditshëm, që e rrethon dhe pa e kuptuar se për çdo fjalëformim ka operuar me një dukuri gramatikore, leksikore.

BIBLIOGRAFI

- GUILBERT, L. (1975), *La créativité lexicale*, Larousse, Paris.
- GUIRAUD, P. (1980), *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3^e édition, Paris.
- GUIRAUD, P. (1966), P.Guiraud, *La sémantique*, Larousse, Paris,
- LAROUSSE (1994), *Dictionnaire Encyclopedique* volume 1. Paris.
- CHOLLET, I. ROBERT J-M, “Les expressions idiomatiques” CLE International, 2008, Paris
- LILO, R., VARFI, N. (2006), *Fjalor frëngjisht-shqip*, Albatros, Tiranë.
- REY, A. (1998), *Le Robert Micro dictionnaire de la langue française*, Paris.
- REY, A. (2007), : “A mots découverts, chroniques au fil de l’actualité” Robert, Laffort, Paris.
- REY, A. (1988), “Dictionnaire historique de la langue française”, Le Robert, Paris.
- KOKONA, V. (2001), *Fjalor frëngjisht-shqip*, Botimet Kokona, Tiranë.

KOKONA, V. (2003), V.Kokona, Mbi përkthimin dhe përkthyesin, Botimet Kokona, Tiranë
LILO, R., VARFI, N. (2006), Fjalor frëngjisht-shqip, Albatros, Tiranë.
THOMAI, Jani (1984), Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë.
SHKURTAJ, Gj. 2003. Sociolinguistika, SHBLU, Tirane.

SHKURTAJ, Gj. 2004 Etnografi e të Folurit të Shqipes, SHBLU, Tiranë
VARFI, N. (2005), 'Introduction à la lexicologie du français ', Shblu, Tiranë.
VARFI, N. BAKILLARI, V. Z. (2005), Fjalor Argotik frëngjisht-shqip, Albatros, Tiranë.

DIFFICULTIES, INSTRUCTIONS AND INSTITUTIONAL OBJECTIVES DURING THE LEARNING PROCESS VËSHIRËSITË, INSTRUKSIONET DHE OBJEKTIVAT INTITUCIONALE GJATË PROCESIT TË TË MËSUARIT

LENDITA GJIKOLLI

F.M.N. SH Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore, Prishtinë, KOSOVË

Email: lenagjikolli@gmail.com

AKTET IV, 4: 717 - 721, 2011

PERMBLEDHJE

Qëllimi i këtij punimi është t'i shtjelloj disa ide teorike të cilat në mënyrë eksplicite aplikohen gjatë punës tonë praktike, probleme që i hasim vazhdimisht dhe që krijojnë mospajtime dhe vështirësi. Do t'i vëmë në pah disa nga metodat më të reja, që janë mjaft të diskutueshme, pastaj vështirësitë që i hasim gjatë leximit, studimit, të një gjuhe në distancë dhe të mësuarit në mënyrë institucionale. Duke i identifikuar problemet e koshiençës së fonemave, të orthografisë, vokabularit, shkrimit si dhe të shprehurit të rrjedhëshëm në një gjuhë të huaj, gjithnjë duke u nisur nga konteksti kulturor, social, psikologjikë, arsimor, si edhe i moshës që e kanë të interesuarit për të mësuar. Do t'i shpalojmë problemet dhe supremacinë që ka gjuha amtare si gjuhë bazë, në rastin tonë gjuha shqipe për të mësuar një gjuhë të huaj.

Fjalët çelës: disleksia, dekodimi-silabikë, metoda-sintetike, analitike, metoda e rimediatimit

SUMMARY

The aim of this proceedings is to illuminate some theoretical ideas which an explicit way have been applied during our practical work, problems that we encounter repeatedly that creates disagreement and difficulties. We will put in highlights some new methods that are considerably disputable, then difficulties that we encounter during the reading, study of a language in distance and in the institutional learning way. Having identified the conscience problem of phoneme, orthography, vocabulary, writing and fluent expression of foreign language, always proceeding from the cultural context, social, psychological, educational, and the age that candidates have to learn. We will unfold the problems and supremacy that has native language as the basic language, in our case the Albanian language to learn a foreign language.

Key words: dyslexia, syllable decoding, synthetic-methods, analytic, remediation-method

HYRJE

Kërkimet e bazuara në studimet e shkencëtarëve të shquar për vështirësitë dhe qasjen metodologjike që duhet të kemi gjatë mësimin të gjuhëve të huaja, japin rezultate të dryshme, në vende të ndryshme. Natyrisht, gjithnjë duke u nisur nga konteksti kulturor, social, psikologjikë, arsimor si edhe i moshës që kanë të interesuarit, për të mësuar një gjuhë të huaj.

Debate të shumta të organizuara nga

shkencëtarë eminent Evropian (anglezë, francezë) pastaj amerikanë e kanadezë japin një pasqyrë të larmishme teorishë mjaft kontraverze, të cilat shërbejnë për t'a konsultuar dhe verifikuar metodën me të cilën shërbehemi.

Metoda tejet të debatueshme të shekullit XX të fëmijëve me vështirësi ose të meta datojnë që nga viti 1995 në SHBA që i hasim në publikimet e Rudolf Flench në veprën "Why Johnny can't read". Në vitet 1960-1970 vjen në shprehje

metoda globale, "méthode global" ose "éhole word methode" ose më mire të themi metoda ideo vizuale padekompozicion ndërsa, në Francë "Méthode syllabique" ku Chartier dhe Hébard në punimin: "*Discours sur la lecture*" vënë në pah mosmarrveshjet në diciplinat dhe ligjeratat pedagogjike.ë1]

Gjatë këtyre viteve i kushtohet rëndësi sa kuptimit të fjalëve aq edhe dekodimit teknikë. Në librin e Flench-it, "*Why Johnny still can't read?*" rilansohet sërish metoda e dekodimit ose "phonic methode" në SHBA. Në vitin 2007 Chartier nënvizon se: "këto debate të metodave janë efekte të revolucionit metodikë që datojnë në vitet 1950/60. "Në fakt, të shkruarit është një procedurë sintetike (i shkruajmë fjalët shkronjë pas shkronje) ndërsa, ushtrime-shkrimi janë kopjimi i shkronjave, sillabave dhe fjalëve"[2].

Duke u nisur nga vitet e 80-ta leksionet e lektyrës përqendrohen në dimensionin analitikë me theks të vaçant në fjali, fjalë ndërkaq, shkrimi në vete ngëthen një tjetër dimension.

Sipas E. Charmeux. (2007) [3] "*Të mësosh të lexosh d.m.th të njohësh fjalët*", ai, shpjegon egzistencën e metodave të ndryshme të të mësuarit e të lexuarit si:

Metoda sintetike- pra, duke u nisur nga grafemat, fonemat, e duke kaluar në fjalë

Metoda globale ose e memorizimit global- duke u nisur nga teksti dhe duke i bashkuar fjalët, si dhe metoda mikse që bashkon që të dyja.

Metoda sintetike – B.Germain e definojnë si: "Përparim i uniteteve (shkronjë-tingull) si dhe kombinimin (sillabë e shkruar /e folur) pa përjashtuar kombinimin (sillabë në fjalë). Sipas kësaj metode fëmijët duhet ti segmentojnë madje edhe unitetet më minimale të gjuhës së folur që të korespondojnë me gjuhën e shkruar, gjë që nuk është fare e natyrshme por, gjithësesi e domosdoshme. [4]

Ndërkaq, B. Germain paraqet tri formulime për këtë metodë si: "metode indirekte e të kuptuarit", "metoda indirekte e leximit"-dekodimi dhe "méthode gestuelle" me anë të së cilës fëmijët mësojnë të memorizojnë përmes gjestikulacionit, duke i asociuar shkronjat,

tingujtë për të formuar sillabat, duke i kombinuar ato dhe formuar fjalë.

Në Belgjikë, Brainbant dhe Gérard më 1990, këtë metodë e quajnë funksionale, globale ose analitike. Vepron duke i memorizuar fjalët të cilat kanë kuptim pastaj, duke i analizuar këto tekste dhe në fund duke i analizuar në mënyrë progresive elementet më të vogla. Kjo metodë është shumë e përafërt me metodën amerikane "Whole word methode".

Pra, të lexuarit definohet si një konstukcion i kuptimit dhe jo si, rezultat i procesit të dekodimit. Metoda mikse ka lindur si rrjedhojë e praktikës dhe çasjeve sintetike dhe funksionale gjatë procesit mësimor. Në Australi metoda "Whole language" [5] nuk paraqet çasjen më të mirë të mësuarit dhe bazohet në: relacionin në mes të shkronjave dhe tingujve, të kuptuarit e fjalëve të reja dhe nga ajo që është lexuar.

Debatet vazhdojnë edhe më tej për efektshmërinë e këtyre metodave duke mos menjanuar edhe rolin që ka gjuha amtare e më pas, sipas Michelle Pendax 1998 në librin e saj ; "*Veprimtaritë e të mësuarit në orën e gjuhës së huaj*" [6] ajo shpjegon se "mëvarsiht nga njohuria dhe aftësia që ka një nxënës ai, krijon një gjuhë të ndëmjeme.

Sipas Jorge Giacobbo "Përdorimi i gjuhës së parë nga nxënësi është proces themelor gjatë të mësuarit dhe është element përbërës i sistemit të hipotezave operuse të gjuhës së ndëmjeme dhe përcakton nivele të ndryshme, sipas nxënësve dhe sipas gjuhëve në fjalë. [7]

Trubeckoj shpjegon, citojmë ;" Vlerësimin e gabuar të tingujve të një gjuhe të huaj, atë që ai e quan "theks të huaj" d.m.th nxënësi nuk është se ai nuk mund ta shqipëtojë atë por, nga fakti se ai nuk e vlerëson mire atë tingull".[8]

Shembullin që jep (1995) Rajmond Renard "voiture" një anglez tingullin/ y /e përcepton si /ju /prandaj do ta lexonte si "vuajtur" [9] gjë që nuk do të ndodhte me një shqip –folës përshkak të alfabetit të pasur d.m.th / ka shkronjat si c, dh, ë, h, nj, th y/. që mundësojnë me lehtësi, me pak përpjekje të shqipëtojë një numër të konsiderushëm të gjuhëve. Duke i memorizuar

dhe krahasuar fjalët me preardhje latine, greke, turke, germanike dhe internacionale.

Problemet tjera që medoemos duhet cekur gjatë të mësuarit e fëmijëve me vështirësi ose” në rrezik”; sipas neurologëve me disfazi që nënkupton: vështirësi specifike të mësuarit e gjuhës së shkruar dhe folur, janë; disleksia, disothografia, diskalkulia dhe disgrafia shif, methods de lecture et difficile d'apprentissage .

Rezultatet e studimeve në Francë (të një grupi të fëmijëve disleksikë) tregojnë që; intelegjenca e këtyre fëmijëve është normale por, efikasiteti i tyre nuk mund t'i atribuohet metodës së të mësuarit. a/ fëmijët nuk mund të mbështeten në njohjen e tyre gjuhësore/leksikore/ ; b / kanë deficit leksikor/ në analizë të fonemave, në memorizimin e termeve të shkurta etj./

Kërkimet tregojnë se e tërë kjo mosaftësi është e ndërlidhur me problemet emocionale, që ka fëmiju në një klasë mësimi, në familje dhe rreth social. Si përfundim në këto vende është vendosur të implementohen vetëm metodat e aprovuara zyrtarisht në SHBA si p.sh. “Reading first” pastaj “Success for all” (SFA). Që është destinuar për fëmijë që gjuhë amtare kanë gjuhën angleze dhe spanjolle. Ky program punon me një metodë mikse/fonetike dhe e tërë gjuha “ëhole language” është e mbushur me tregime nga gjuha amtare.

CIRC (Cooperative Integrated and Composition) ose Reading Wings, që insiston në strategjinë e të kuptuarit, fitimin e vokabularit dhe të të shkruarit. Në Evropë mësimdhënësit janë të lirë të zgjedhin metodat, përveç në Greqi dhe në Luxemburg ku qeveria siguron manualin dhe udhëzuesin për mësimdhënie. Në Kosovë, sa i përket fëmijëve me vështirësi në të mësuar është hartuar plan – programi dhe funksion projekti me anë të cilit parashihet që deri në vitin 2017 të përfshihen në procesin mësimor, të gëzojnë të drejta dhe përkrahje institucionale e të gjithë fëmijëve me vështirësi në të mësuar. Përkundër kësaj, në Kosovë veprojnë 7 shkolla të specializuara për fëmijë me probleme të ndryshme psiko-fizike. Numri i fëmijëve të identifikuar me nevoja të veçanta është 1081,

prej tyre 511 në shkolla speciale dhe 570 në klasë të ndara.

Për të pasqyruar sado pak gjendjen dhe përpjekjen për zbutjen e këtij problemi aq të ndishëm dhe kompleks për shoqërinë, familjen dhe vetë fëmijët që të përshtaten dhe të aftësohen në mënyrë që të veprojnë të pa mvarur në komunitetin e tyre, do të mundohemi përmes disa të dhënave në dy shkolla të Kosovës, që me vite mirren me fëmijët me vështirësi në të mësuar. Duke pasur parasysh, periudhën në okupimin serb, luftën dhe periudhën e pas luftës kuptohet se ka pasur ndërprerje, ngecje, vështirësi në realizimin e objektivave të synuara duke mos pasur mjete. Por, gradualisht me përkrahjen e institucionale dhe organizatave të huaja të specializuara për këtë çështje ato po rimëkëmben dhe veprojnë në mënyrë shumë të organizua me staf shumë profesional njëra shkollë madje është e tipit të konvktit.

Në Prishtinë në shkollën fillore “Përparimi” punohet në dy cikle: në atë të ulët dhe të lartë, mësohen të gjitha landët por me program të reduktuar dhe të përshtatur aftësi individuale të fëmijëve. Në çdo paralele ka prej 6, 7 deri në 10 nxënës, fëmijët janë me probleme të ndryshme. Fëmijët paraprakisht testohen nga psikologu i shkollës, dhe në bazë të testeve jipen rekomandimet për punën e mëtutjeshme dhe çasjen që duhet pasur me atë fëmijë. Përveç, edukatores janë edhe mësueset udhëtuse të cilat punojnë me fëmijët që mësojnë në paralele me fëmijët e tjerë që nuk i kanë këto probleme d.m.th secili fëmijë ka një asistent. Tërë personeli është i kualifikuar dhe bashkëpunon në vazhdimësi me FSDEK- un (Finish support education in Kosovo), që ka bërë shumë trajnime me qëllim të aftësimin të mësimdhënësve në mënyrë që procesi mësimor të jetë i suksesshëm. Gjithashtu organizohen edhe trajnime të brendshme. Puna është ekipore në mes mësimdhënësve – prindërit – edukatores dhe natyrisht fëmijut. [10]

Punohet me metodën BENDER, gestat II, visual-motor Gestalt Test që përmban partage 9-18 muaj; guide 18- 36 muaj (from birth) 3-4 vjet; 4-5vjet; 5-6 vjet nga lindja deri 6 vjet. Fëmijëve u

është siguruar transporti. Dy fëmijë kanë arritur që të regjistrojnë fakultetin dhe ta përfundojnë-pedagogji. Kanë arritur ti marrin tri medalje të arta në lojrat euro-aziatike SOK të organizuara në vitin 2010.

Në Kosovë sakësisht në Prizren në shkollën fillore dhe të mesme“ Lef Nosi “është shkollë e tipit të konviktit ku punohet me fëmijë me vështirësi në të mësuar. [11]

Mësimi zhvillohet në gjuhë shqipe, qe dy vite ka filluar të mësohet edhe gjuha angleze, për të cilën fëmijët tregojnë interesim të vaçantë. Tërë stafi është i kualifikuar dhe përbëhet nga 27 persona, ku përfshihet edhe drejtori, pedagogu, 2 edukatore, 2 infermiere, mësimdhënësit e tjerë, kuzhinieri, shoferi i fëmijëve, pastruesit etj

Në vitin 2009/2010 janë regjistruar 79 nxënës, prej tyre 22 vajza-57 djem; ndërkaq të srehuar në konvikt gjithsejt janë 32 nxënës, 20 djem dhe 11 vajza.

Në vitin 2010/2011 janë regjistruar 82 nxënës, prej tyre 19 vajza,63 djem prej tyre të strehuar janë 29 nxënës, 8 vajza dhe 21 djem. Punohet në dy ndrrime 8-13 dhe 13-17 15. Përkujdesja për fëmijët është 24 orë. Secili fëmijë ka dosjen e tij personale në bazë së cilës jipen rekomandimet.

Format e punës janë:individuale në dyshe-Metoda Di (dua të di) mësova; pastaj përdorimi i Kllastrit (pemës së mendimeve), metoda e vizualizmit abstrakt dhe ditrekt, metoda agumentative. Kombinimi i këtyre metodave, formave dhe programit kurrikular sipas nevojave të nxënësëve, fjalori i qartë dhe i kuptueshëm i mësimdhënësve, përdorimi mjeteve të punës, demonstrimi i punimeve para prindërve, para publikut ngjallë vetbesim tek fëmiju. Shpesh organizohen tryeza të rrumbullakta për të shqyrtuar dukuritë dhe trajtuar problemin në bisedë me fëmijë.

REKOMANDIME DHE KONKUZIONI

Në periudhën e pas luftës dhe tranzicionit vështirë se mund të bëhet fjalë për përsosje ose përparim të dukëshëm të aplikimit të metodave direkte në mësimin e gjuhës së huaj,në kuptimin e realizimit edukativ, arsimor të detyrave dhe qëllimeve të tyre. Përkundër punës së

palodhëshme dhe përpjekjeve këmbëngulse të mësimdhënësve. Por, megjithate problemi është identifikuar dhe gjithnjë e më tepër prindërit bashkëpunojnë dhe mundohen që fëmijët të arrijnë rezultate sa më të mira me ndihmën e mësimdhënësve dhe institucioneve gjegjëse, gjë që nuk ndodhte më parë duke i konsideruar këta fëmijë plotësisht të pa aftë duke i lënë nën mëshirën e fatit.

Kjo do të mundësohet me trajtimin e barabartë, pa diskriminime, pa barriera dhe pa paragjykime nga të gjithë duke filluar nga prindrit, mësimdhënësit, komuniteti etj. Në mënyrë që fëmiju ti gëzojë me ligj të drejtat e veta si parakusht për pjesmarrje aktive në shoqëri.

Pengesat ekonomike janë shkaktarët kryesor, për lëvizjen përpara të sistemit arsimor e sidomos të fëmijëve me vështirësi në të mësuar. [12] Megjithate me një kuadër të kualifikuar dhe të tajnuar duke përdorur një metodologji më të përparuar dhe me përkrahje institucionale ky synim mund të arrihet, duke u mbështetur në teoritë dhe përvojat që kaë vendet e zhvilluara perëndimore për aftësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

BIBLIOGRAFIA

Chartier et Hébard: *Discours sur la lecture*; 1880-2000, BPI-Centre Pompidou, Fayard, 2000, Paris
E Charmeux, Dossier d’actualité, n° 31 – novembre, fq., 15

Bentolila Alain et Germain Bruno (2005). *Apprendre à lire: Choix des langues et choix des méthodes*. Paris: UNESCO.

Shif shkrimet e Annie Feyfant et Marie Gausse, *Méthodes de la lecture et difficultés d’apprentissage dossier d’actualité*, n31 novembre 2007, fq 8-10.

Michèle Pendanx, *Les activités d’apprentissage en classe de langue (Veprimtaritë e të mësuarit në orën e gjuhës së huaj)*, Hachette, 1998, Paris, fq 17-20

Giacobbe.J.(1990)“ *L’approche cognitive*”. Le français dans le monde, Hachette, Paris, 1990, fq.122

Troubetzkoy, N.(1994);"Principes de phonologie. Paris, Klincksieck (përkthim nga R.Renard (1965): L'Enseignement des langues vivantes par méthode structuro- globale audio-visuelle, Paris, Didier. Fq.51
Shkolla "Përparimi " Të dhëna nga drejtorja e kësaj shkolle në Prishtinë 2010

Shkolla "Lef Nosi" Të dhënat nga drejtorja e shkollës Prizren 2010.

M.A.SH.T (Ministria e Arsimit dhe e Teknologjisë) Prishtinë "Gjendja e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta" fq, 31-32 dhe 58..

VEÇORITË E TERMINOLOGJISË PYJORE SI FUSHË E NGUSHTË E DIJES

^a LULJETA MINE , ^b SHPRESA DELIJA

^a Universiteti Bujqësor i Tiranës

^b Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Email: luljetamine@yahoo.com

AKTET IV, 4: 722 - 727, 2011

PERMBLEDHJE

Terminologjia si leksik përbën bazën e gjuhës së specializuar e cila funksionon si një nënsistem i veçantë i gjuhës standarde shqipe. Terminologjia pyjore si fushë e veçantë e dijes identifikohet dhe mëvetësohet me sistemin e saj të dallueshëm, konceptor, të formuar në rrugë semantike, morfologjike, sintaksore si edhe huazimit dhe shqipërimit. Përdorimi togfjalëshave i jep terminologjisë së pylltarisë një karakter sistemor të lidhur dhe hierarkik. Dukuritë semantike që shfaqen në këtë terminologji kushtëzohen nga vetitë që kanë termat të tilla si sistemësia, përpikëria, njëkuptimësia, etj. Ndaj, mund të themi se edhe në terminologjinë pyjore shfaqen dukuri semantike si polisemia, homonimia sinonimia. Së fundi, leksiku i terminologjisë pyjore është tërësisht leksik autokton shqip, sepse baza e tij është brumi i vjetër i shqipes, fjalët e të cilës më vonë u ngritën në terma.

Fjalët kyçe: term, koncept, sistemor, hierarkik, autokton

SUMMARY

Terminology as a lexicon composes the base of the specialized language and it functions as a special subsystem of the Albanian standard language. The forestry terminology as a specific field of knowledge is identified with its distinguishable conceptual system formed in the same ways like in other fields of knowledge, such as semantic, morphological, syntactic ways as well translations in Albanian and borrowings. The use of collocations gives a systematic and hierarchical character to the forestry terminology. The semantic phenomena that appear in this terminology are conditioned by the features that terms have, such as systematicity, preciseness, the existence of one concept, etc. Therefore, we can say that the semantic phenomena like polysemy, homonymy, synonymy emerge even in forestry terminology. Finally, the forestry terminology is completely an Albanian autochthonous lexicon, because its base is the old Albanian language whose words were, later on, raised on terms.

Key words: term, concept, systematic, hierarchical, authentic

HYRJE

Terminologjia si sistem leksikor tërësor i gjuhës bën pjesë në gjuhën e shkencës dhe teknikës, që do të thotë gjuhë e specializuar, gjuhë për qëllime speciale. Terminologjia e pylltarisë përbëhet nga një sistem termash që përfaqësojnë një sistem konceptesh të kësaj fushe të dijes.

Lidhjet e leksikut të pylltarisë me leksikun e përgjithshëm

Terminologjia e pylltarisë ka identitetin e vet dhe veçohet si fushë dije me sistemin e koncepteve të

veta shkencore. Por ajo dallohet për lidhjet që ka me leksikun e përgjithshëm të gjuhës, ndonëse termi në dallim nga fjala e zakonshme është i lidhur ngushtë me konceptin, kurse fjala është e lidhur me kuptimin. "Njësitë emërtuese zakonisht i ndajmë në fjalë të përgjithshme ose joterma dhe fjalë terma."²

Kështu, p.sh., njësitë *pyll, dru, sharrë, rrenjë*, nëse shënojnë koncepte të zakonshme janë fjalë të leksikut të përgjithshëm, pra janë fjalë, nëse shënojnë koncepte shkencore bëjnë pjesë në leksikun e një fushe të caktuar të dijes, në rastin

tonë, të fushës së pylltarisë. Kjo kategori termash përbën një veçori karakteristike të kësaj fushe dhe lidhet kryesisht me kalimin e tyre nga fjalë në terma, të cilat kanë çuar në ngritjen e tyre në një funksion tjetër në gjuhë, në përdorimin si terma. Ato funksionojnë në mënyrë të dyfishtë si terma (brenda fushës) dhe si fjalë joterma (jashtë fushës përkatëse të dijes). Ato dalin me përmbajtje konceptore (kuptimore) të dyzuar, ku nga nga ana e formës shohim përdorimin e një fjale si term, kurse nga ana e përmbajtjes kemi ngritjen e një kuptimi të zakonshëm, si tek *rrënjë,pyll, sharre*, në një kuptim (koncept) shkencor, po te *rrënjë, pyll, sharre*, etj.

Në fushën e pylltarisë, çdo term në sistemin e termave ku bën pjesë, me formën e tij të jashtme, lidhet në mënyrë më të tejdukshme me konceptin që shënon. Nga kjo anë, termat dalin në përgjithësi shumë më të motivueshëm se fjalët e zakonshme, sigurisht kur vështrohen brenda fushës së dijes ku bëjnë pjesë.³

Terminologjia pyjore e ka bazën e saj në gjuhën shqipe

Terminologjia e pylltarisë dallohet, ndër të tjera, për përbërjen e saj **me bazë shqipe**. Leksiku i terminologjisë pyjore është tërësisht leksik **autokton shqip**, sepse baza e tij është brumi i vjetër i shqipes, fjalët e të cilës më vonë u ngritën në terma.

Si bazë kryesore referimi kemi Fjalorin e Frang Bardhit (i përket periudhës joterminologjike), dhe atë të Kristoforidhit (i përket periudhës paraterminologjike) krahas atyre që i përkasin periudhave të mëvonshme.

Në bazë të një vëzhgimi të bërë mund të themi se Fjalori i Frang Bardhit përbën bazën e të gjithave terminologjive dhe fjalorëve të ndryshëm të gjuhës shqipe. Ky fjalor përmban 206 fjalë që kanë lidhje me pylltarinë, të cilat më vonë shërbyen si bazë për ngritjen e tyre në terma, ndër të cilat 20 janë togfjalësha.

Ky përbën një fond autokton të shqipes si edhe bazën për shumë vargje fjalëformuese (siç ato i quan Prof. Androkli Kostallari). Aty gjejmë shumë fjalë me cilesinë e temave prodhuese si *dru –ha-brej* (sot *drusor – drunor; drungrënës-i;*

drubrejtës-i; drungrenës-e; drubrejtës-e;) ose *rrënje* (sot *rrënjëzot-rrënjëzim*) etj.

Nga studimi i Fjalorit të Frang Bardhit, shohim se fjalët e përfshira në të shërbejnë si bazë për sistemin e koncepteve terminologjike të pylltarisë. Ato i përkasin grupeve të ndryshme tematike të fushës së dijes në fjalë, si:

emërtime drurësh: *lis* (ose *dave*); *man*; *rrënjë* (*Iloj lisi*); *plep*.

emërtime shkurresh: *ferrë; shegë; thanë*.

emërtime që kanë lidhje me pjesët e drurit: *bisht* (*i gjethes*); *degëz*; *dell* (*i gjethes*); *gjethkë*; *kupë* (*e lules*); *kurorë*; *majë e drurit*; *nyje*; *rrënjë*; *trung*..

emërtime bimësh: *bimë*; *bar*; *drandofill*; *kërpudhë*; *mullagë*; *rosmarinë*.

emërtime shpendësh, kafshësh, insektesh (elementë të eko-sistemit pyjor): *fellanzë*; *fikës* (*Iloj zogut*); *gjarpër*; *gjel i egër*; *gjinkallë*; *mizë*; *kapruelli*; *korb-i*; *lepur*; *marimanga*; *mëllënjë*; *majmun*; *pëllumb*; *shqipe*; *ujk*; *rosë e egër*.

emërtime të gjëndjeve e pjesëve të tokës: *arë*; *baltë*; *fushë*; *kopsht*; *livadh*; *pyll*; *ullishte*; *gurë*; *shkëmb*; *rërë*; *zall*..

veprime që lidhen me pyllin: *bëj dru*; *coptoj*; *çaj dru*; *çel*; *çkul*; *del bari*; *gërryey*; *kullot*; *lulëzot*; *mbjell*; *rrëzot* (*rrëzot*).

Studimi i këtyre shtresave leksikore të pasqyruara në këtë fjalor, tregon se leksiku i sotëm i shqipes edhe në nivelet më të larta të tij, siç është ai terminologjik, ka ardhur duke u zhvilluar ndër shekuj, nga format më të thjeshta e deri më të ndërlikuarat duke u ngritur në fazën e sotme në sisteme të qëndrueshme homogjene.

Në parathënien e Fjalorit të Kristoforidhit gjuhëtari A. Xhuvani shprehet: “ prej gjithë punës së fjalorit, si edhe prej gjithë veprave të Kristoforidhit kuptohet se ai ka qënë një vëzhgues e një dijetar i fellë i shqipes, saqë dhe sot asht i pakëpërcyeshëm.”⁵ Ndaj themi se fjalët e këtij fjalori kanë shërbyer si bazë për fjalorët e mëvonshëm terminologjik.

Në këtë fjalor mund të veçonim disa shtresime leksikore që i përkasin grupeve të ndryshme tematike të pylltarisë.

emërtime drurësh: *ah-u; bli-ri; bredh-thi; dëllënjë; dushk; fice-ja; frashër; gjerdhishte; ilqe; borigë(pishë e zezë); etj.*

emërtime shkurresh dhe bimësh të egra: *kulumbri; gjineshtër; drizë; ferrë; fshikë-kartë; hisëll; kërp; kërpudhë; kočimare; etj.*

emërtime kafshësh, shpendësh, insektesh (popullata e pyjeve): *akrep; arushë; breshkë; buburrec; cërile (lloj zogu); cinxami; çafkë; fajkua; etj.*

emërtime që lidhen me gjëndjen e tokës/pyllit: *ahishte; baltë; djerrë; fierishte; çetinë; kullotë; kopsht; kumi etj.*

emërtime që lidhen me pjesë të drurit/bimës: *ashkëlë; bubuqeja; bisht, dell, buzë (e gjethes); degë; fletë; gëlvoxhë (lëvozhgë); gjethe; kurorë; kupë (e lules); cunq; eshkë; gdhëri; etj.*

folje që kanë lidhje me operacionet në pyll: *copëtoj; çkul; çkurroj (shkurroj); gjethësoj; kalbet; krasit, etj.*

Në këtë fjalor vihet re fakti se kemi të bëjmë me koncepte më të diferencuara si p.sh. fushat tematike që lidhen me kategoritë “shkurre” dhe “gjysmëshkurre”, etj. Pra brenda këtyre fushave mund të krijohen mikrosisteme konceptore; në këtë rast mund të sillnim disa lidhje konceptore mbi bazën e marrëdhënieve si “e tëra me pjesën”, “gjini me lloj”, etj. p.sh.

dru: *dru-ri, dru-ja; trung--lëvore-blanë;*

pjesë të drurit: *rrënjë-trung-degë-degëz-gjethe-lëvore;*

barëra: *gram-dredhëz-gjemb-hisëll etj.*

Hierarkia e sistemit të terminologjisë pyjore

Ashtu si në fushat e tjera, edhe termat e pylltarisë kanë si veçori hierarkinë e tyre.

“Tërësia e termave të një nënfushe të dijes, që shënojnë konceptet gjegjëse, të lidhur në bazë të marrëdhënieve të caktuara, përbën një sistem terminologjik. Të gjithë elementët e sistemit formojnë kështu një strukturë me nivele hierarkike.”¹

Termtat, në terminologjinë pyjore vendosen në mënyrë hierarkike, pra një term është i mbirenditur, kurse tjetri i nënrenditur, në

marrëdhënie me një tjetër mund të jetë i mbirenditur, (vihet re në Fjalorin e Termave Themelorë të Bujqësisë 2006, ose tekste të ndryshme, etj) p.sh **shfrytëzim** > *vjelje e materialit drusor* > *prerje* > *rrëzim* > *heqje degësh* > *çlëvorim* > *sharrim* > *trupa sharre* > *tallash*; ose **dru** > *dru halor* > *pishë* > *pishë e zezë*, etj.

Marrëdhëniet dhe varësitë ndërmjet këtyre termave përbëjnë bazën për grupimin e tyre sipas një nënfushe të strukturuar, si **shfrytëzim, dendrologji**, etj.

Sistemësia

Sistemësia paraqitet si në rrafshin e përmbajtjes ashtu edhe të formës.

a - rrafshi i përmbajtjes

Në përputhje me konceptet që pasqyrojnë, termtat lidhen me njëri tjetrin në baze të marrëdhënieve që vendosen midis tyre. Këto marrëdhënie **zbulojnë karakterin sistemor të pylltarisë**. Ato janë tri llojesh:

1- marrëdhënie “gjini - lloj” p.sh *dru halor - pishë e butë; dru fletor - ahu; shkurre - mersinë; gjysmëshkurre-shkozë;* “ Të gjithë elementët e sistemit formojnë kështu një strukturë me nivele hierarkike.”¹

2- marrëdhënie “e tëra – pjesa” p.sh. *druri – trungu* (më tej *myja-blanë-lëvorja*)

pishë e zezë – boçe; (më tej *mëllugë-farat/stikat*)

3- marrëdhënie funksionale të cilat janë më të ndërlikuara


Si p.sh “shkak – pasojë/efekt” *prerje – rrëzim; copëtim – trupim;*

“proces – vegël” *sharrim – sharrë;* ose “vegël – proces” *pykë – rrëzim/çarje; sharrë – sharrim; sëpatë – heqje degësh;*

“proces – produkt” *sharrim – dërrasë, tallash; grirje – ashkla;*


b - rrafshi i formës

Si shprehje më e theksuar e lidhjeve sistimore në rrafshin e formës janë termtat togfjalësh, tek të cilët rreth një njësie që shënon konceptin kryesor, bashkohen një varg termash dy a më shumë fjalësh. Termi kryesor trajtohet si term kyç i cili krijon lidhje me njësitë e tjera si p.sh:



Paraqitja e këtyre termave në lidhjet togfjalësore dëshmojnë për karakterin **sistemor, hierarkik** të kësaj terminologjie.

Një anë tjetër shumë e rëndësishme e karakterit sistemor të terminologjisë së pylltarisë është dhe lidhja midis termave, në bazë të një elementi të përbashkët të formës. Në këtë rast mund të vihet re se elementët rrënjore mund të shërbejnë si bazë për ndërtime mikrosistemesh në rrafsh fjalëformimi (duke përdorur parashtesa ose prapashtesa)



Veçori të tjera të terminologjisë


- 1- shumëkuptimësia
- 2- shumëvariantësia

Polisemia

Në terminologjinë pyjore vihet re shënimi i dy koncepteve me të njëjtën shenjë, kur e njëjta shenjë funksionon në dy rrafsh të ndryshme, në rrafshin e gjuhës së përgjithshme dhe në atë të terminologjisë. P.sh: **Shfrytezim** 1. proces që lidhet me përdorimin e një mjeti për një qëllim të caktuar.

Kuptimi i pare është i lidhur me fjalën e zakonshme, ndërsa i dyti me atë terminologjik. Konteksti i bën të dallueshëm këto kuptime (koncepte).

Prirja e termit për të qënë i njëkuptimshëm në kufijtë e fushës ku përdoret, bën që dukuri si polisemia e homonimia të shfaqen më rrallë. Normalisht duhet të ketë shenja për çdo koncept të shprehur, por nuk ndodh gjithmonë kështu.



Në shembujt e mësipërm, vihet re se kufiri ndërmjet kuptimeve (koncepteve) të shënuara nga i njëjti term është i prerë. Kjo ka të bëjë me **përpikërinë konceptore** që përmbahen brenda një shenje. Duhet theksuar se është “konteksti” ai që sjell identifikimin e kuptimit (konceptit).

Shumëkuptimësia është një dukuri e dëmshme, por mund të thuhet atje ku është e mundur. Në rastin e termit *dru* kemi të bëjmë me dy koncepte dhe diferencimi i tyre bëhet me dy shenja, pra *dru-ri* dhe *dru-ja (lënda e drurit)*.

Homonimia

Ajo shfaqet si lidhje kuptimesh(konceptesh) brenda një shenje(termini) dhe e vështruar si e tillë ajo del si nje rast i polisemisë. Kufiri i polisemisë dhe homonimisë është aq i papërcaktuar në fushën e terminologjisë, saqë polisemia mund të vështrohet si e rrëgjuar në homonimi. Por ka raste që homonimia është e dallueshme nga

polisemia. Në keto raste largësitë kuptimore brenda shenjës(termit) janë të atilla saqë e njëjta

shenjë mund të interpretohet si e ndashme në dy shenja të ndryshme.

Le të sjellim dy shembuj.

rrënjë { - lloj dushku (tipike për pyjet e bregdetit)
- organ që shërben për të mbajtur drurin në këmbë dhe për të thithur lëndë ushqyese
- pjesë e drurit

- tharje e drurit (pemës) kur është në këmbë

tharje e dru

- tharje termike e drurit, staxhionim para se të përpunohet

Në këtë rast kemi të bëjmë me një largësi kuptimore (konceptore), pra me **homonimi** (konceptet, objektet nuk lidhen brendësisht me njëri tjetrin).

Një aspekt tjetër që duhet trajtuar është edhe **sinonimia**. Në gjuhën e përgjithshme, sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë a të afërt, të cilat përputhen nga ana kuptimore, por ndryshojnë nga ana tingullore. Ato janë të larmishme dhe e pasurojnë leksikun e përgjithshëm. Sipas J. Thomait, “sinonimia është shprehje e thellimit të njohjes njerëzore që synon të zbulojë gjithnjë anë të reja të sendeve, dukurive etj.”⁴

Sinonimia jep mundësi që i njëjti objekt apo dukuri të emërtohet me fjalë të ndryshme. Sinonimia, në terminologji është e dëmshme, por e pranueshme. Në terminologjinë pyjore, ana e lidhjeve kuptimore brenda strukturës semantike është e mbyllur, pra lidhjet kuptimore shfaqen në kufijtë e sinonimeve absolutë. Kështu, sinonimet në pylltari do t'i trajtojmë sipas 4 rasteve:

A -Terma që s'kanë lidhje sinonimike

Në këtë grup përfshihen termat e huaj, të cilët dallohen nga **njëkuptimësia**.dhe kanë fituar statusin *terma standardë*. P.sh. *fitopalogjia pyjore, ekologjia pyjore, fotosinteza,*

B - Terma që kanë lidhje sinonimike me termat e tjerë që shprehin të njëjtin koncept, por që janë të njëkuptimshëm. p.sh *kaçubë-shkurre-gëmushë; kaçubor-shkurre; shfrytëzim-vjelje e materialit drusor*

C - Terma të cilët hyjnë në marrëdhënie sinonimie me një nga elementët e strukturës semantike të tyre.

p.sh *arrë* del në dy kuptime: *a- dru pyjor* dhe *b- fryti*. Në kuptimin e dytë termi *arrë* del sinonim me *kaçkë; goricë* del në dy kuptime *a- dru pyjor* dhe *b- fryti*. Në kuptimin e dytë termi *goricë* del sinonim me *dardhë e egër*.

D - Terma që kanë dy ose më shumë kuptime, por që nuk dalin sinonime me ndonjë fjalë tjetër.

Raste të tilla janë përmendur më lart si termi *rrënjë, etj.*

Prurjet e ndërtimit të terminologjisë së pylltarisë janë të njëjta si ato që takohen në fushat e tjera të dijes. Ato janë:

Rruga semantike

Kjo mënyrë ndryshe njihet si shfaqje e rikuptimësimit të fjalës së zakonshme ose edhe një termi të fushës kur i jepet një kuptim tjetër; P. sh. *nervaturë e gjethes; majë e gjethes; kupë e lules; bisht i gjethes etj.*

Mikrofusha në të cilën përdoren këto fjalë bën të mundur që të zbulohet përmbajtja konceptore e tyre.


Rruga morfologjike

Kjo mënyrë ka të bëjë me formimin e termave sipas rregullave të gjuhës shqipe. Si veçori të kësaj rruge mund të përmendim aktivizimin e një sasive të kufizuar të parashtesave dhe prapashtesave. Duhet përmendur fakti që në këtë rrugë marrin pjesë ndajshitesa të gjuhës shqipe,

por edhe të gjuhëve të tjera të huaja si *makro*, *mikro*, *poli*, *mono*, *agro*, *a*, *de* etj.

.Sipas mënyrës së formimit, termat mund t'i ndajmë në: terma të formuara me parashtesim, prapashtesim, me parashtesim dhe prapashtesim njëherazi.

Rruga sintaksore



Puna për shqipërimin e terminologjisë së pylltarisë është vështruar prej kohësh e deri në

Kjo gjë pasqyrohet qartë në tekstet mësimore apo në manuale të ndryshme që përdoren nga specialistët e pyjeve, ose në punime të ndryshme. Në to janë shqipëruar një sërë termash.

Shqipërimi i terminologjisë pyjore lidhet ngushtë me gjëndjen e leksikut të përgjithshëm, atij shkencor të pylltarisë dhe të fushave të tjera të dijes që kanë lidhje me pylltarinë.

Mënyra sintaksore e formimit të termave ndryshe njihet edhe si togfjalëzim.

Përdorimi i **togfjalëshave** i jep terminologjisë së pylltarisë një karakter **sistemor** të lidhur dhe **hierarkik**.

Huazimi dhe shqipërimi

BIBLIOGRAFI

X x x x, *Fjalor i termave themelore të bujqësisë*, Tiranë 2006, Parathënie.

KOSTALLARI A. - SF 1972/4

PASHO. H - *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX*, Tiranë, 2005.

THOMAI. J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë 2005.

MBI VEPRIMTARINË E DEGËS SË KLUBIT “BASHKIMI” NË ELBASAN DHE TREVAT E TIJ

MAJLINDA PEZA (PERRIU)

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Departamenti: Histori-Gjeografi, Elbasan, SHQIPËRI

Email: majapeza@yahoo.com

AKTET IV, 4: 728 - 735, 2011

PERMBLEDHJE

Ky artikull synon të evidentojë dhe të aktualizojë drejtimit kryesore të veprimtarisë politike, arsimore e kulturore të klubit patriotik “Bashkimi” që u krijua në Elbasan, veprimtaria dhe aktiviteti i të cilit, në kuadrin e institucionalizimit të jetës intelektuale pas shpalljes së Hyrjetit, ishte prezent jo vetëm në qytetin e Elbasanit por dhe në trevat e tij.

Fjalë çelës: Hyrjeti, klube patriotike, Kongresi i Elbasanit, Klubi shqiptar i Selanikut.

1. HYRJE

Pas shpalljes së Hyrjetit (Kushtetutës turke të korrikut 1908), për të organizuar sa më mirë lëvizjen arsimore kombëtare, patriotët shqiptarë u kujdesen për të krijuar klube e shoqëri kombëtare në të gjithë trevat shqiptare. Gjer në fund të vitit 1908, u formuan afërsisht rreth tridhjetë klube e shoqëri patriotike kombëtare, ndërkohë që numri i tyre gjatë harkut kohor 1908-1912 arriti në 80, pa përfshirë këtu shoqëritë patriotike që ekzistonin në diasporë (Myzyri, 2004: 66). Klubet dhe shoqëritë kombëtare gjatë kësaj periudhe shfaqën disa tipare të përbashkëta që konsistojnë në këto drejtime.

Së pari klubet ishin organizata të gjera demokratike, të cilat përfshinin në gjirin e tyre përfaqësues të shtresave të ndryshme të popullsisë. Në këto klube merrnin pjesë intelektualë, nëpunës të aparatit shtetëror e mësues shkollash, përfaqësues të borgjezisë qytetare, të prodhuesve e të tregtarëve të vegjël të qytetit e të fshatit, të bejlerëve-çifligarë, të oficerëve, si dhe përfaqësues të parisë të lidhur me sunduesit osmanë. Ato bashkonin në gjirin e tyre të gjitha rrymat politike të lëvizjes

kombëtare, si atdhetarët me pikëpamje radikale, ashtu edhe të moderuarit, ndërsa në udhëheqjen e tyre qëndronin intelektualët e dalluar edhe më parë për veprimtari atdhetare.

Së dyti, ata u bënë iniciatorët kryesorë për çeljen e kurseve të para e shkollave në gjuhën shqipe në të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë, ata u kujdesën për sigurimin e fondeve e të lokaleve të nevojshme e të domosdoshme, ku do të zhvillohej mësimi në gjuhën amtare, u morën me përgatitjen e personelit pedagogjik, për sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore shkollore. Në vitet 1908-1909 edhe në trevën e Elbasanit u formuan disa klube dhe shoqëri të rëndësishme patriotike dhe kulturore. Është për tu përmendur fakti se kryesitë e klubeve dhe shoqërive patriotike që u formuan në qytetin e Elbasanit përcaktoheshin duke aplikuar sistemin e zgjedhjes dhe njëkohësisht të rotacionit në postet drejtuese. Këto klube e shoqëri patriotike, kishin një këshill mbikëqyrës dhe kontrollues që i drejtonte patrioti i shquar Aqif pashë Elbasani.

2. HISTORIKU I KLUBIT “BASHKIMI” NË ELBASAN

Në 31 korrik të vitit 1908 u themelua klubi “Bashkimi” i Manastirit, me kryetar Fehim

Zavalanin, nënkryetar Gjergj Qiriazin dhe sekretar Naum Naçin. Ky klub u shndërrua në një ndër klubet më të mëdha dhe më të rëndësishme, që luajti një rol të veçantë në formimin e klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e regjimit xhonturk. Menjëherë pas themelimit të tij, klubi i Manastirit dërgoi në qytetet e tjera të vendit emisarët e vet për të propaganduar idetë kombëtare të shqiptarëve. Ndër qëllimet kryesore të këtij klubi, ishte të krijonte degë të tjera në qytetet më kryesore të Shqipërisë dhe të mbante lidhje të ngushta bashkëpunimi me to. Në funksion të kësaj ideje dhe në bazë të orientimit të klubit qendror *“Bashkimi”* të Manastirit, u formua në Elbasan e para degë e këtij klubi me të njëjtin emër, pra klubi *“Bashkimi”* i Elbasanit (AMHE, F. 2, D. 6: 5).

Ky klub u shndërrua në një ndër klubet më të rëndësishëm të kohës jo vetëm në trevën e Elbasanit, por dhe në të gjithë Shqipërinë. Pikërisht një status të tillë e konfirmon dhe fakti që, patriotët shqiptarë nuk nguruan ta cilësojnë, klubin në fjalë, për një periudhë të shkurtër kohore si klubin qendror në Shqipëri (Demiri, 2006: Egnatia, 94).

Për sa i përket kohës së krijimit të klubit *“Bashkimi”* në Elbasan, sipas studiuesit te njohur elbasanas Hysni Myzyri, mendohet që ky klub patriotik të jetë krijuar në të njëjtën kohë me çeljen e shkollës së parë fillore shqipe (më 2 gusht të vitit 1908), ndërsa zyrtarizimi i tij u bë disa ditë më vonë në 13 shtator të vitit 1908. Gjithashtu, studiuesi tjetër elbasanas Tomorr Plangarica, në një artikull të botuar në librin *Normalja në traditë*, na paraqet kohën e krijimit e këtij klubi patriotik në fund të muajit korrik të vitit 1908 (Plangarica, 1995: 30). Parë në këtë kontekst, ajo që pranohet nga këta studiues dhe nga dokumentet historike që gjenden në Arkivin e Muzeut Historik të qytetit të Elbasanit, është fakti se në 2 gusht të vitit 1908, me ndihmën e këtij klubi është hapur e para shkollë shqipe publike legale në Elbasan çka do të thotë që në këtë datë, ky klub rezultonte të ishte krijuar. Pra, si përfundim, duke ju referuar të dhënave dhe dokumentacionit të kohës, por dhe faktit se klubi

“Bashkimi” i Manastirit u formua në 31 korrik të vitit 1908, në gjykimin tonë mendojmë se klubi *“Bashkimi”* i Elbasanit është krijuar pas shpalljes së *Hyrjetit*, e pas krijimit të klubit të Manastirit. Nuk përjashtohet fakti që si datë e krijimit të tij jetë data 2 gusht e vitit 1908.

3. PROGRAMI DHE FUNKSIONIMI I KLUBIT

Programi i klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit ishte në përputhje me programet e klubeve të tjera të krijuara në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe, si i tillë, ky klub nuk paraqitej si një klub me karakter thjesht kulturor. Ai e shtriu veprimtarinë e tij edhe në fushën politike në favor të interesave kombëtare të popullit shqiptar. Ndërkohë, një vend të rëndësishëm në programin e këtij klubi, zinte pa dyshim zhvillimi i arsimit, kulturës përhapja e gjuhës shqipe dhe rritja e ndërgjegjes kombëtare në trevën e Elbasanit.

Në kryesinë e klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit merrnin pjesë:

Kryetar Refik efendi Myftiu;

Nënkryetar: Dhimitër Buda, i cili pasi dha dorëheqjen u zëvendësua nga Hysen Hostopalli;

sekretar: Simon Shuteriqi;

nësekretar: Ahmet Dakli;

arkëtar: Nexhip Haxhiademi;

anëtarë: Qamil beu, Muç Shqiptari, Beqir Plangarica, Pavli Papadhopuli dhe Kamber efendiu.

Klubi i *“Bashkimi”* i Elbasanit kishte një përbërje heterogjene në aspektin fetar e social. Në të përfaqësoheshin myslimanë e të krishterë, që vinin nga shtresa të ndryshme sociale, si nga zanatçinjtë, tregtarët, intelektualët, nëpunësit e tjerë.

Ky klub, gjatë gjithë veprimtarisë së tij jo vetëm që pati si model klubin qendror të Manastirit, por në çdo moment mbajti lidhje e marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me të. Në këtë drejtim një rol të pazëvendësueshëm ka luajtur në këtë klub dhe Halit Bërzështa, një nga anëtarët më me autoritet të këtij klubi dhe njëherësh përfaqësues i trevës së Elbasanit.

4. ZGJERIMI I VEPRIMTARISË: FORMIMI I DEGËS SË KLUBIT “BASHKIMI” NË GRAMSH

Ndërkaq, pas shpalljes së *Hyrjetit*, sikurse në Elbasan edhe në Gramsh, u krijua në korrik të vitit 1909 një degë e klubit “*Bashkimi*” me të njëjtin emër (AMHE, Musaj, K., D. 14: 2). Patrioti gramshiot Asllan Shahini lidhur me ngritjen e këtij klubi, në maj të vitit 1909, në një letër të botuar në një nga gazetatat e kohës, ndër të tjera shkruan: “Pra dhe ne me ndihmat e popullit po përpiqemi të ngremë një klub, për pak ditë çështjen do t’jua rrëfejme me gëzim të madh” (“*Lirija*”, 6 qershor 1909: 2). Në këtë klub, bënë pjesë anëtarë nga zona e Vërçës e nga fshati Lënije (Shënapremte), Kishtë, Bersik, Ostentë e deri në Mollas të Sulovës.

Klubi “*Bashkimi*” në Gramsh, mbante lidhje të ngushta me klubin patriotik të Elbasanit në zhvillimin e veprimtarisë politike arsimore e patriotike. Rëndësi të madhe ky klub i kushtoi përhapjes së shkrimit të shqipes në Gramsh, duke kërkuar me këmbëngulje hapjen e shkollave shqipe në këtë zonë. Një ish nxënës në një shkollë fillore turke në një fshat të Gramshit, në kujtimet e tij shprehej se: “Lëvizja Kombëtare ka filluar në Gramsh me mësimin e gjuhës shqipe” (Musaj, 1962: 306). Më tej edhe nga korrespondenca ndërmjet klubeve të Manastirit dhe atij të Elbasanit, evidentohen lidhjet që ekzistonin midis patriotëve gramshiotë e atyre elbasanas.

Kuadrin e këtij bashkëpunimi e plotëson edhe një letër e dërguar nga Elbasani në adresë të klubit “*Bashkimi*” në Manastir, në shtatorin e vitit 1908, ku ndër të tjera shkruhej: “Si u kemi shkruar dy muaj më parë kemi nevojë shumë të madhe për libra si brenda e jashtë. Nga Peqini, Gramshi e nga katundet vijnë njerëzit e kërkojnë libra e abetare” (AQSH, D. 5: 137 - 138).

Ndërsa në telegramin e dërguar në shtator të vitit 1908, nga klubi “*Bashkimi*” i Elbasanit, drejtuar klubit “*Bashkimi*” në Manastir shtoheshin disa kërkesa:

1. Mbajtja e një Kongresi të gjuhës shqipe (jepën mendime që ky kongres të mbahet në një qytet në qendër të Shqipërisë)
2. Caktimin e dërgimit të delegatëve

3. Nevojën e unifikimit të dialekteve në gjuhën e shkruar

4. Nevojën për t’i bërë një kërkesë qeverisë turke në emër të të gjithë shoqërive për njohjen e kombit shqiptar (AQSH, F. 102, D. 102: 1 - 6).

Por, sikurse e kemi përmendur, deri në gusht të vitit 1908 të mësuarit e gjuhës shqipe në trevën e Elbasanit, si dhe në trevat e tjera shqiptare bëhej në mënyrë ilegale.

Është më se i njohur në trevën e Elbasanit fenomeni i mësuesve shëtitës, përmes të cilit mundësohej mësimi i gjuhës shqipe në fshatra më të largët të krahinave të Shpatit, Çermenikës, Gramshit. Si të tillë mund të përmendim: Hysen Cekën, Hasan Gjevorin, Simon Shuteriqin, Hysen Haxhiun. Midis tyre vlen të përmendim dhe gratë arsimdashëse elbasanase, si: Tushi Xhoni dhe Shahu Dylgjerin. Duke ju referuar dokumentacionit të kohës, konstatojmë faktin se, Hysen Ceka sapo mori vesh shpalljen e *Hyrjetit* nxitoi të hapë i pari një kurs publik për të mësuar gjuhën shqipe (Demiri, 2006: 94).

5. HAPJA E SHKOLLËS FILLORE PUBLIKE NË ELBASAN DHE SHPAT

Ndërkohë, më 2 gusht të vitit 1908, patriotët elbasanas anëtarë të klubit “*Bashkimi*” hapin të parën shkollë fillore publike në qytetin e Elbasanit. Për finalizimin e aktit në fjalë, klubi “*Bashkimi*” zhvilloi një veprimtari të mirorganizuar (AMHE, D. 63: 26). Përmes dokumentacionit të kohës konstatojmë se në Elbasan, nën kryesinë e Aqif Pashë Biçakçiu, u zhvillua një mbledhje e cila, sikurse mësohet, kishte si synim “*vetëm të mësojë djemtë e vajzat në gjuhën e vet*”. Brenda dy ditësh u bë e mundur që të mblidheshin më tepër se 200 lira turke, me anën e të cilave do të shpërbleheshin financiarisht mësuesit, pa prituri që ata të shpërbleheshin nga organet shtetërore osmane. Gjithashtu ishte vendosur të caktohej nga një mësues për gjuhën shqipe në shkollat fillore turke dhe greke të qytetit (“*Lirija*”, vjeshtë e parë 1908, 8).

Ndërkaq, në fund të tetorit të vitit 1908, u hap edhe në Shpat një shkollë e tillë (AMHE, D. 63: 26). Një shkollë shqipe ku mësimi i gjuhës shqipe

bëhej nga patriotë vendas u hap në fund të vitit 1908 në Bërzeshtë të Librazhdit, ku mësues i saj ishte patrioti Rifat Leka (Kujtime, 1962: Libri shkollor, 39). Edhe në krahinën e Peqinit, patriotët Adem Gjinishi, Demir Godelli, Rexhep Peza, Hekuran Bedalli e Ramazan Teqja, pa marrë parasysh rreziqet që u kanoseshin përmes një përkushtimi të madh, kontribuan për përhapjen e mësimi dhe gjuhës shqipe.

Hapjes të së parës shkollë fillore publike në Elbasan, i bëhet jehonë edhe nga gazetatat me të rëndësishme të kohës. Kështu, gazeta *“Lirija”* e Selanikut shkruante: *“Sot u çel në Elbasan shkolla e parë shqipe. Ishin mbledhur me mijëra shqiptarë me gaz në buzë e shpresë në zemër. Erdhi Mytesarifi dhe disa nënpunës. Hafëz Sulejman efendiu këndoj një lutje, pastaj për të bekuar këtë ditë u hodhën 21 topa”* (*“Lirija”*, 4 gusht 1908, 4: 3).

Në të njëjtën kohë nga dokumentacioni i kohës evidentohet bashkëpunimi dhe ndihma e klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit kundrejt mësuesve dhe nxënësve të zonës së Shpatit. Në këtë kuadër në qershor të vitit 1909, shkollat e krahinës së Shpatit dërguan mësuesit dhe gjithë nxënësit e tyre për të bërë provimet vjetore në klubin *“Bashkimi”* në Elbasan. Përfundimi i provimeve u shoqërua me organizimin e një ceremonie festive dhe tepër miqësore (Kujtime, 1962, Libri shkollor : 29).

6. SHKOLLA E NATËS

Krahas shkollës shqipe të ditës në Elbasan, u hapën edhe shkolla të natës, për tu mësuar shkrim e këndim të rriturve, zanatçinje, nëpunësve. Lajmi për çeljen e shkollës së natës pasqyrohet në një artikull të shkruar në gazetën *“Lirija”* të Selanikut nga Rras e Bardhë (pseudonimi i Josif Haxhimimës), ku ndër të tjera ai shprehej:

“Me gëzim ju lajmërojmë se të krishterët e këtushëm hapën një mësonjëtorë nate dhe mësimet po jepen rregullisht” (*“Lirija”*, 3 janar 1909, 23: 2). nga Elbasani -10 janar 1909-Rras e Bardhë (Josif Haxhimina)

Mësimet e natës janë këta: *Mësim gjuhe, Istori, Dëshkronej (Gjeografi) e cila mësohet nga ana e*

z.Lef Nosi e z.Fot Papajani në lagjen Kala. Mësonjëtorja ka 40 nxënës. Shumë mirë do të jetë që edhe muhamedanët e këtushëm të hapin një mësonjëtorë nate” (*“Lirija”*, 3 janar 1909, 23: 2). Gjithashtu i njëjti burim konfirmon faktin se, në Elbasan u hapën dy shkolla nate. Përveç shkollës së natës të përmendur më sipër, shkolla tjetër e natës u çel në vetë godinën e klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit .

7. BASHKËPUNIMI ME KLUBIN “BASHKIMI” TË MANASTIRIT PËR KONGRESIN E ALFABETIT

Rritja e shpejtë e lëvizjes për arsim kombëtar pas shpalljes së Kushtetutës turke, çelja e shkollave të reja shqipe të ditës e të natës, përhapja e gjerë e shkrimit dhe leximit shqip, shtruan si detyrë emergjente caktimin e një alfabeti të unifikuar e të detyrueshëm për të gjithë shqiptarët

Pikërisht ky do të ishte një nga objektivat kryesore të kongresit që u mbledh në Manastir në 14 -22 Nëntor të vitit 1908 (nuk është objekt i këtij punimi të trajtojë vendimet e këtij Kongresi, por të evidentojë bashkëpunimin e klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit përmes shkëmbimit të ideve me klubin qendror *“Bashkimi”* të Manastirit).

Në një kontekst të tillë historik do të shfaqen lidhjet e ngushta midis klubit *“Bashkimi”* të Elbasanit e atij të Manastirit, që konsistojnë shkëmbimin e mendimeve e të ideve për sa i përket: *vendit të mbajtjes së kongresit*

Rendit të ditës

Çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe

Kjo bashkëmarrëdhënie ndërmjet këtyre dy klubeve pasqyrohet gjithashtu edhe në shtypin e kohës. Kryesia e klubit *“Bashkimi”*, shfaq interesimin për lidhjen e ngushtë dhe rëndësinë që kishte njësimi i alfabetit, për përparimin dhe arsimimin e kombit tonë dhe pasi u shoshën e u përshoshën ato që u kishte shkruar klubi i Manastirit, shprehet: *“Ne anëtarët e klubit “Bashkimi” të Elbasanit ju përgëzojmë e falënderojmë për ftesën që na bani”* (AQSH, F. 102, D. 102: 2). Më tej, klubi *“Bashkimi”*, i Elbasanit i parashtronte klubit të Manastirit dy sugjerime :

Së pari, për vendin e mbajtjes së Kongresit duke u shprehur: “Na duket ma e drejtë që një mbledhje e tillë e përgjithshme të bahet në kërthizët të Shqipërisë” (Pra në Elbasan).

Së dyti, që Kongresi të sugjeronte si gjuhë të përbashkët të folurën e Elbasanit, duke u shprehur se: “Mbas mendimit tonë lypset që mbledhja të marri masa që si gjuhë e përgjithshme në gjithë Shqipërinë, ligjëroja ma e bukur me të cilën asht bashkumun si me thanë toskënishtja me gegënishten asht ajo e Elbasanit, që mund të merret vesh e të flitet prej të gjithë shqiptarëve” (AQSH, F. 102, D. 102: 2).

Delegatë të Elbasanit që morën pjesë në Kongresin e Manastirit kanë qenë, mësuesi Simon Shuteriqi dhe farmacisti Dhimitraq Buda (Demiri, 2006: 95). Një pjesëmarrje e tillë pasqyrohet edhe në shtypin e kohës. Kështu gazeta “Lirija” e dt. 8 e vjeshtës së tretë të vitit 1908, shkruante se, delegatë të Elbasanit në Kongresin e Manastirit, ishin Simon Shuteriqi e Dhimitraq Buda, i cili në këtë kongres u shpreh se: “Qëllimi i Kongresit nuk është të merret me filozofi, se këtë fuqi se kanë delegatët, por është më mirë të merremi vetëm me **a b c-në**” (“Lirija”, vjeshtë e tretë 1908: 2). Njëkohësisht mësojmë se Dhimitraq Buda u zgjodh anëtar i komisionit kryesor të Kongresit, i cili përbëhej nga 11 anëtarë, të cilët u zgjodhën me votim të fshehtë. Ky komision u formua për trajtimin e çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht, për të frenuar ndikimet e grupeve të ndryshme turkomane brenda dhe jashtë vendit rreth çështjes së alfabetit. Ndër të ftuarit në këtë kongres, përmendet dhe Bexhet Beu nga Elbasani (Hoxha, 1986: 201).

Në këtë kuadër, të dhënat e mësipërme dëshmojnë fare qartë se çfarë roli të rëndësishëm luante klubi “Bashkimi” i Elbasanit, në funksion të përmbushjes së objektivave kryesore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

8. HAPJA E SHKOLLËS AMERIKANE

Nuk është rastësi që misionarët amerikane F. Kenedi dhe T. Erikson pas vëzhgimeve në disa qytete të Shqipërisë së mesme si në Elbasan, Durrës, Tiranë, e zgjodhën Elbasanin si qendër

më të përshtatshme, për çeljen e një shkolle fillore dhe një të mesme me konvikt, me shpjegimin se ai “Elbasani konsiderohet si terreni kulturor me pjellor” (Myzyri, 2004: 196). Më 28 maj 1909 Fines Kenedi (Phineas B. Kennedy) i dërgoi një letër nga Korça klubit “Vllaznia” të Elbasanit, me anë të së cilës e njoftonte se: “Shoqata jonë amerikane kërkon të hapë një shkollë të mesme për djemtë shqiptarë me pagesë të ulët”, gjithashtu ai kërkonte “një ndërtesë të bukur, ku do të kishte dhe një degë industriale”. Klubet “Bashkimi” dhe “Vllaznia” reagues pozitivisht ndaj kësaj kërkesë. Në fillim të Qershorit të vitit 1909, në klubin “Vllaznia” u organizua një mbledhje e përbashkët e dy kryesive të klubeve, ku u vendos që të ndihmonin me një shumë prej 100 lira turke, me kusht që të futej edhe të mësuarit e gjuhës shqipe në këtë shkollë amerikane (Myzyri, 2004: 196). Por për arsye të pengesave që nxorën autoritetet xhonturke (zvarritja e miratimit të lejes nga autoritetet xhonturke dhe arrestimi i Kristo Dakos që ishte emëruar drejtor i kësaj shkolle, bënë që kolegji amerikan të mos çelej.

9. KOORDINIMI ME KLUBIN E SELANIKUT

Aktiviteti i klubit patriotik të Elbasanit, nuk përfshinte vetëm sferën e veprimtarisë brenda kësaj treve, por njëkohësisht ky aktivitet me tendenca gjithëpërfshirëse, reflektohet edhe më gjerë. Në këtë kontekst, është më se evident koordinimi i veprimtarisë së tij me një ndër klubet më të rëndësishëm të kësaj kohe, siç ishte klubi shqiptar i Selanikut.

Në shtypin e kohës pasqyrohet qartë ky bashkëpunim dhe në mënyrë më konkrete, një vizitë që përfaqësues të klubit shqiptar të Selanikut, fill pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit, rezultojnë të kenë bërë në Shqipëri. Synimi kryesor, siç deklaruan delegatët e klubit të Selanikut, ishte që të kultivojnë tek shqiptarët “Vllazërim e Bashkim”. Delegacioni i klubit të Selanikut qëndroi në Elbasan tri ditë. Në këtë delegacion bënë pjesë: Riza bej Dibra, Abdyl bej Kolonja, Haxhi Vildon efendi Dibra.

“E 25-ta ditë e Vjeshtës së tretë”(8 dhjetor 1908), shkruante Lef Nosi nën pseudonimin Mal i

Vashes, qe një ditë historike, ditë e ndritshme". Më tej informacioni i Lef Nosit, vijon me evidentimin e faktit se qytetarët e Elbasanit ishin përgatitur për pritjen, që do të organizonin enkas për delegatët e klubit të Selanikut. Si për të përligjur organizimin shembullor të kësaj pritjeje, përmes informacionit që na vjen, mësojmë se "Çunakë " të rinj me kësula të bardha, në të cilat shkruhej "Rroftë Lirija" i gjeje kudo nëpër qytet. Është i pakundërshtueshëm fakti, se organizatori kryesor dhe qendra e kësaj lëvizjeje rezultonte të ishte klubi "*Bashkimi*" i qytetit të Elbasanit.

Gjithnjë, përmes këtij informacionit mësojmë se, rendi i aktiviteteve në kuadrin e kësaj pritjeje me të vërtetë festive, fillon me pritjen e parë të delegacionit jashtë qytetit tek "Rrapat e Vojvodës", për të vijuar më tej me momentin kur kryetari i Beledijes, Emin Haxhiademi, dha urdhër të radhiteshin çunat e shkollave veç e veç e anëtarët e klubit pranë flamureve. ("*Lirija*", 25 prill 1909, 41: 4). "Herën e parë i priti shkolla Idadie" më pas i priti shkolla "Hamidie" e më pas shkolla e veçantë e atdhetarit z. Fezi Guranjaku, pas kësaj shkolla e "Xhamisë së Mbretit".

Fjalën e hapjes e mbajti Abdyl Ypi (Kolonja), i cili i drejtohet të pranishëmve me fjalët: "Mirëse ju gjejmë o djemtë e Shkumbinit plak". Delegacioni vizitoi klubin "*Bashkimi*", shkollën "*Kristiane*" të Kalasë, ku i priti mësuesi Dhimitër Paparistoja, e më pas u drejtuan për në Peqin .

Ndërkaq nënvizojmë se në këtë periudhë, përveç klubit patriotik "*Bashkimi*" në Elbasan ekzistonte një klub turk i njohur si klubi i "Osmanllinjëve" (Ittihad) dhe një tjetër me emërtimin klub i "Fukarave" (Fuharreve), ku sipas të dhënave që kemi, roli i tij nuk ka qenë shumë i qartë .

Sukseset e arritura në fushën e arsimit në kushtet legale pas shpalljes së *Hyrjetit* filluan të vënë në lëvizje turqit e rinj, për të cilët shqetësimi parësor ishte përhapja e gjërë që kishte marre gjuha dhe shkolla shqipe në Shqipëri.

10. HAPJA E NORMALES SË ELBASANIT

Duke hulumtuar në dokumentacionin e kohës, konstatojmë rolin dhe kontributin aktiv që dhanë klubet patriotike "*Bashkimi*" e "*Vllaznia*" të Elbasanit në organizimin dhe mbajtjen e

Kongresit të shkollave shqipe, pra Kongresit të Elbasanit. Në këtë kongres Elbasani u përfaqësua nga gjashtë delegatë që përfaqësonin klubet "*Bashkimi*", "*Vllaznia*" dhe shoqërinë "*Afërdita*". Emin Haxhiademi dhe Dhimitër Buda përfaqësonin klubin "*Bashkimi*", Dervish Biçaku e Qamil Feza klubin "*Vllaznia*" dhe Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhimina përfaqësonin në Kongres shoqërinë "*Afërdita*", delegatë të cilët konsideroheshin me të drejtë vote. Lef Nosi, Dhimitër Paparistoja dhe Hysen Ceka morën pjesë pa të drejtë vote.

Gjithashtu vlen të përmendet fakti se nga katër anëtarë të kryesisë së Kongresit tre ishin nga Elbasani, ndër të cilët Dervish Biçaku (kryetar), Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhimina sekretarë. Në tri komisionet që u krijuan për shqyrtimin e problemeve kryesore të këtij kongresi delegatët e Elbasanit ishin gjithashtu të përfaqësuar.

Hapja e punimeve të Kongresit të Elbasanit u bë në selinë e klubit "*Bashkimi*" e në 3 shtator ai i vazhdoi punimet në klubin "*Vllaznia*" (Myzyri, 2004: 193). Sikurse është e ditur vendimi më i rëndësishëm i këtij Kongresi ishte ai për hapjen e një shkolle normale në qytetin e Elbasanit dhe, në mbështetje të saj, themelimin në Korçë të një shoqërie qendrore shkollore me emrin "*Përparimi*", e cila do të ndihmonte në mbarëvajtjen e shkollës Normale.

Është domethënë fakti që, shoqëria "*Përparimi*" që u formua në Korçë, për të mbështetur hapjen e shkollës Normale, ia besoi këtyre dy klubeve, klubin "*Bashkimi*" dhe "*Vllaznia*" zgjedhjen e *Pleqësisë kujdestare për shkollën e mësojvet*, ku dy ndër detyrat me emergjente të saj ishin, sigurimi i ndihmave financiare për hapjen e shkollës Normale dhe emërimi i mësuesve që do të jepnin mësim në këtë shkollë. Anëtarët e kësaj pleqësie ishin të gjithë nga Elbasani, disa prej të cilëve ishin përfaqësues të klubit "*Bashkimi*". Në të bën pjesë: Dervish Biçaku (kryetar), Hysen Ceka, Lef Nosi, Emin Haxhiademi, Dhimitër Buda, Petër Dodbiba, Dhimitër Paparisto dhe Ahmet Dakli (AQSH, F. 102, D. 63: 1).

11. KONKLUZIONE

Duke ju referuar materialeve të parashtruara më lart arrijmë në disa konkluzione sa të rëndësishme aq dhe të domosdoshme për rolin dhe aktivitetin e klubit patriotik *"Bashkimi"* dhe klubeve dhe shoqërive të tjera patriotike që ushtronin veprimtarinë e tyre në qytetin dhe trevën e Elbasanit në harkun kohor 1908-1910.

1. Fakti që ky klub patriotik u krijua menjëherë pas krijimit të klubit patriotik të Manastirit, madje mund të themi dy ditë pas krijimit të tij, është dëshmi e një mjedisi intelektual të begatë dhe multifunksional, rrjedhojë e një akumulimi dhe kultivimi paraardhës shumëvjeçar dhe me traditë.

2. Megjithëse u krijua si degë e klubit të Manastirit, marrëdhëniet midis tyre do të udhëhiqen nga parimi i respektit reciprok dhe i pavarësisë në aktivitetin dhe veprimtarinë patriotike, gjithmonë në funksion të çështjes kombëtare. Në momente të caktuara për çështje të rëndësishme të arsimit kombëtar anëtarët e klubit *"Bashkimi"* të Elbasanit i kanë shprehur mendimet dhe i kanë dhënë sugjerimet e tyre klubit të Manastirit (që gëzonte statusin e klubit qendror). Një fakt i tillë konstatohet në kërkesën që klubi i Elbasanit i bën atij të Manastirit për vendin dhe problemet që do të trajtonte kongresi i shkronjave shqipe (sikurse e kemi pasqyruar edhe më lart), pra ai kongres që u mbajt në Manastir.

Pikërisht ky qëndrim i klubit të Elbasanit duhet parë si një shprehje apo parim me karakter demokratik që konsiston në diversitetin e mendimeve.

3. Është i një rëndësie të veçantë aktiviteti i klubit patriotik *"Bashkimi"*, por dhe i klubeve dhe shoqërive të tjera patriotike në Elbasan, që shfaqet gjatë organizimit dhe zhvillimit të punimeve të Kongresit të Elbasanit. Megjithëse iniciatorë për thirrjen e këtij kongresi nuk ishte klubi i Manastirit, por klubi i Selanikut me drejtues Mithat Frashërin, patriotët elbasanas anëtarë të klubeve dhe shoqërive patriotike ju përgjigjën menjëherë kësaj thirrjeje për mbajtjen e një kongresi arsimor.

Ishin këto klube patriotike të këtij qyteti, që arritën të krijojnë një atmosferë të ngrohtë e miqësore në pritjen e delegatëve e pjesëmarrësve të Kongresit, që luajtën një rol të veçantë e të rëndësishëm në përgatitjen e kushteve konkrete e të përshtatshme dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit të Elbasanit. Patriotët elbasanas, anëtarë të këtyre klubeve, mbajtën peshën kryesore jo vetëm në organizimin e Kongresit të Elbasanit, por ata patën një përfaqësim të kënaqshëm dhe në organet përkatëse që drejtuan punimet e këtij kongresi, sikurse ishte kryesia e kongresit, e zgjedhur për drejtimin e punimeve të tij dhe tri komisionet kryesore të krijuar për të trajtuar problemet më të rëndësishme që shtronte për zgjidhje ky Kongres Arsimor Kombëtar Shqiptar. Në të njëjtën kohë këto klube patriotike dhanë kontributin e tyre modest në krijimin e kushteve të përshtatshme për çeljen e shkollës Normale, produkt i drejtpërdrejtë i vendimeve historike të këtij kongresi.

Duke shprehur ndjenjat dhe emocionet për pritjen e ngrohtë që ju bë delegatëve të Kongresit në Elbasan, Sevasti Qiriazi në një letër të datës 7 tetor të vitit 1909, shkruante: *"Brohoritje dhe përshëndetje shpërthyen nga turma që na priste në hyrje të qytetit. Edhe Qezari nuk do të kishte ndjerë aq shumë emocion në hyrjen e tij triumfale në Romë se sa ne në atë çast"* (AQSH. F. 52, D. 9).

BIBLIOGRAFIA

ARKIVI Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), Tiranë.

ARKIVI i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë (AIHGJ), Tiranë.

ARKIVI i Muzeut Historik të Elbasanit (AMHE), .

ARKIVI i Bibliotekës së Elbasanit (ABE).

DEMIRI, SH. Elbasani, qendër e Lëvizjes Kombëtare. Sesione, depozituar në Muzeun Historik, Elbasan.

DEMIRI, Sh. Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit. Materiale depozituar në Muzeun Historik, Elbasan.

DEMIRI, Shyqyri (2006), Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Egnatia, Tiranë.

PLANGARICA, Tomorr (1995), Mjedisi intelektual në qytetin e Elbasanit në prag të shpalljes së Pavarësisë: Normalja në Traditë, Botuar nën kujdesin e gazetës “Reklama”, Elbasan.

Gazeta “Lirija” (1908 – 1910), Selanik.

Gazeta “Tomorri” (1910), Elbasan.

HOXHA, D. I. (1986), Njëpër udhën e penës shqiptare. Botim i ISP, LIBRI SHKOLLOR, Tiranë.

KUJTIME VETERANËSH (1962), Elbasani në luftë për çlirim. Libri shkollor, Tiranë.

MUSAJ, Tafil (1962), Lufta për çlirim kombëtar, kujtime të Tafil Musajt, I.S.H.GJ, Tiranë.

MYZYRI, Hysni (2004), Shkolla Normale e *Elbasanit*, albPAPER, Tiranë. .

NDIKIMET KULTURORE E GJUHËSORE TË GJUHËS SHQIPE NË ORËT E MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE SI GJUHË E HUAJ

MARSELA HARIZAJ
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
Email: mharizaj@univlora.edu.al

AKTET IV, 4: 736 - 740, 2011

PERMBLEDHJE

Në këtë studim trajtohet rëndësia që ka të mësuarit e kulturës si pjesë e të mësuarit të gjuhës angleze në orët e gjuhës angleze në Shqipëri. Ky studim trajton ndryshimet dhe ndikimet kulturore mes gjuhës angleze dhe asaj shqipe. Kultura shihet me kuriozitet nga studentët. Nga vëzhgimet në orët e Kulturës Britanike, kam vënë re tendencën nga ana e studentëve për të identifikuar disa çështje që trajtohen në kulturën britanike në të njëjtën mënyrë si në kulturën shqiptare. Nxënësit duke studiuar një gjuhë të huaj, konkretisht gjuhën angleze, zgjerojnë burimet e tyre gjuhësore, por gjithmonë duke ruajtur aftësitë gjuhësore të gjuhës së tyre dhe duke zhvilluar aftësitë gjuhësore në gjuhën angleze, e cila u shërben atyre për arsye të ndryshme: (a) u jep mundësinë të bëjnë një vlerësim real; dhe (b) një shkëmbim kulturor me moshatarët e tyre. Përveç kompetencave komunikuese, zhvillohet edhe aftësimi kulturor. Në këtë mënyrë krijohet respekti ndaj kulturave të tjera, kjo falë ndihmës së mësuesit, që siguron aktivitete të cilat ndihmojnë në zhvillimin e kompetencës komunikuese dhe rritjen e njohurive kulturore.

HYRJE

Kultura është pjesë e jetës së përditshme të njerëzve që përdorin gjuhën. Ka disa aspekte të saj që janë veçanërisht të rëndësishme për të komunikuar – për shembull përdorimi i shprehjes joverbale, së cilës mund t'i kushtohet vëmendje e madhe në të mësuarit e gjuhës në mënyrë komunikative. Në këtë studim do të shohim sesi dy kultura mund të trajtohen së bashku. Përdorimi i eseve është mjeti më i mirë krahasues, duke gjetur aspektet e kulturës shqiptare edhe të gjuhës angleze në një të përbashkët. Studentët njihen me elementet e përbashkëta të të dy kulturave. Tema të ndryshme ofrojnë mundësi për të folur e komunikuar dhe gjithashtu për të folur qartë dhe rrjedhshëm në gjuhën angleze. Ka disa përbërës të përfshira në thelb të mësimit të gjuhës së huaj, si ajo që quajmë kompetencë gramatikore, kompetencë komunikuese, aftësimi gjuhësor, si

dhe të mësuarit e mënyrave dhe zakoneve të një kulture tjetër.

Në shkollat tona sa vjen dhe rritet dëshira për të mësuar një apo dy gjuhë të huaja. Në shkollat e mesme përveç gjuhës dhe letërsisë shqipe nxënësit studiojnë gjuhën angleze, franceze, italiane e atë gjermane. Nevoja për dije e për kulturë është rritur së tepërmi. Programet bilinguale sigurojnë studimin dhe zhvillimin e gjuhës në të dyja gjuhët. A është gjuha kulturë? Përgjigja është po. Sa më shumë të studiojmë aq më shumë edukohemi dhe kulturohemi. Por si merret kjo kulturë nëpërmjet gjuhës? Para së gjithash ne duhet të bëjmë të qartë për nxënësit tanë, çfarë fjala "Kulturë" përfshin në vetvete. Një paraqitje në qark e ideve është mënyra e duhur për të shpjeguar zakonet, besimet, traditat e një vendi tjetër, e cila është padyshim një pjesë integrale e të mësuarit të gjuhëve të huaja.

Komunikimi në gjuhë të huaj përfshin në vetvete kompetencën kulturore për shkak të përdorimit të shprehjeve komunikuese, ashtu si thotë Straub se "Theksi vendoset tek roli i kontekstit dhe rrethanat, në të cilat gjuha mund të përdoret me saktësi dhe në kohën e duhur e fjalët e përshtatshme, kur bëhet fjalë për pajisjen e nxënësve me të vërtetë aftësitë njohëse që ju nevojiten në një mjedis të dytë kulturor" (Straub, 1999: 2).

I. Standardet Kulturore dhe ndikimi i të dy gjuhëve tek njëra –tjetra

Shkëmbimet kulturore janë tepër të rëndësishme për çdokënd, veçanërisht në klasa kur mësuesi vjen nga një shkollë tjetër (një amerikan që jep mësim në ndonjë shkollë shqiptare). Atëherë lind diskutimi se çfarë nxënësit kuptojnë me këta apo ata terma, se ç' kuptojnë me stile të ndryshme, përmbajtjen e shakave për shembull apo edhe formatin e një bisede të zakonshme (Cook, G. 1996:).

Shumë studentëve u pëlqejnë bisedat dhe diskutimet sepse ato i ndihmojnë ata për të komunikuar. Këto diskutime janë kulturore dhe edukative. Për klasat monokulturore, ku nxënësit dhe mësuesit vijnë nga e njëjta kulturë, situata është më e vështirë dhe ata duhet të mbështeten tek mësuesi dhe njohuritë e tij, për të kuptuar gjuhën dhe kulturën që ky apo ai mësues po u mëson (Larsen, D. 1986:). Pra, me fjalë të tjera, do të thotë që kur mësuesi i gjuhës angleze u mëson gjuhë të huaj nxënësve të vet, ai, u mëson atyre jo vetëm dije, por edhe kulturë. Pra, një mësues i mirë duhet të jetë jo vetëm i aftë, por ai gjithashtu duhet të jetë inteligjent dhe komunikues mbi të gjitha. Arsyja pse nxënësit studiojnë një gjuhë të huaj është e qartë.

Së pari nxënësit duhet të zhvillojnë nivele të larta përparësie në gjuhën angleze.

Së dyti ata duhet të demonstrojnë sjellje pozitive kulturore dhe nivele të larta të vetëvlerësimit.

Marrëdhënia midis gjuhës dhe kulturës është e pandashme, ja pse kultura duhet të jetë një pjesë integrale e programit të gjuhës angleze. Për marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës Samovar, Porter & Jain citojnë: "Kultura e komunikimi janë

të pandashme për shkak se kultura jo vetëm dikton bisedën, kush flet, kujt i flet, për çfarë i flet dhe kujdeset për vazhdimësinë e komunikimit, por gjithashtu ndihmon të përcaktojë sesi njerëzit kodojnë mesazhet, kuptimet e mesazheve dhe kushtet e rrethanat nën të cilat mesazhe të ndryshme mund të dërgohen ose jo, mund të vihen re dhe të interpretohen. Kultura është themeli i komunikimit" (Samovar, Porter & Jain, 1981: 24).

Nivele të larta të strukturave gjuhësore të shqipes i ndihmojnë ata të kuptojnë edhe strukturat e gjuhës së huaj. Mënyra sesi mësohen varet nga mësuesit dhe metodat që përdoren. Mësimi i gjuhës përmes komunikimit ofron mundësinë për të folur. Duke trajtuar çështje të ndryshme që nga ajo më e thjeshta e deri tek ajo më e ndërlikuara atyre u jepet mundësia e madhe për të folur, për të ndërvepruar, për të shkëmbyer përvojë dhe eksperiencë. Një ndërveprim midis nxënësve duhet të lehtësohet me anë të përdorimit të strategjive të tilla si të mësuarit me bashkëpunim. (Lindholm, K. J. 1990:). Duke qenë se jap Studime të Kulturës Britanike me studentët e vitit të dytë të Gjuhës Angleze trajtoj në orët e mija jo vetëm kulturën britanike, por edhe atë shqiptare, duke u mundësuar nxënësve ushtrime të ndryshme dhe ese që janë tepër thelbësore për një nivel të avancuar, sepse ata zhvillojnë mendimin kritik, rrisin njohuritë dhe u zhvillojnë aftësitë e të folurit dhe të shkruarit në gjuhën angleze. Në shumicën e rasteve, kur diskutohet një temë, ajo trajtohet në të njëjtën mënyrë për shkak të mungesës së njohurive mbi kulturën tonë.

Përdorimi i idiomave ose shprehjeve frazeologjike midis anglishtes dhe shqipes ndonjëherë kanë të njëjtin kuptim, por ndonjëherë e njëjta shprehje mund të ketë një kuptim të ndryshëm. Edhe në këtë rast ata janë konfuz. Përveç tekstit herë pas here unë u sjell studentëve revista në gjuhën angleze që përmbajnë çështje që lidhen me temat që zhvillohen, ose u sjell libra me piktura apo fotografi, të cilat janë origjinale, ose kaseta që kanë gjuhë autentike, të cilat flasin për çështje të ndryshme si historia, letërsia dhe arkitektura.

Studentët janë gjithashtu të lirë për të sjellë materiale shitesë lidhur me temën nga të dy burimet anglisht edhe shqip. Studentët janë gjithmonë të ndikuar nga gjuha shqipe kur ata flasin. Ata përdorin fjalë anglisht, por struktura e gjuhës shqipe duke përdorur fjalë për fjalë për t'u shprehur. Ndikimi është parë në kohët e foljeve si ajo e pakryera apo e kryera e thjeshtë me kohën e shkuar. Ata ngatërrohen në përdorimin e parafjalëve, ndajfoljeve dhe vendndodhjen e tyre në fjali. Ndikimet e gjuhës shqipe vihen re edhe në krijimet e një eseje apo hartimi dhe kjo nga mënyra sesi bëjnë artikulin, ndërtimin e fjalive, mendojnë shqip dhe shkruajnë anglisht.

Shembuj: kur ata kanë për të thënë:

- "I have had the most beautiful holidays in my life" që në gjuhën shqipe është "Këtë vit kalova pushimet më të mira të jetës sime" ata thonë "I had the most beautiful holidays in my life"; ose kur duan të thonë "It's raining cats and dogs" në shqip "Po bie shi me gjyma" ata thonë "It's pouring heavy rain", sepse ndikohen nga gjuha shqipe, kështu që bëjnë përkthim fjalë për fjalë.

- Kur flasim për himnin kombëtar përsëri vërehet ndikimi i kulturës shqiptare duke e identifikuar në të njëjtën mënyrë.

Të përmbledhura ndikimet gjuhësore dhe kulturore janë si më poshtë:

Studentët e gjuhës angleze niveli B2 (40):

Studentët (degë të ndryshme niveli A1 (50))

- 26% konfuz. për termat gramatikore
- konfuz. për termat gramatikore 36%
- 35% konfuz. për termat kulturore
- konfuz për termat kulturore 25%
- 24% konfuz. për identitetin kulturor
- konfuz. për identitetin kulturor 15%
- 15% konfuz.
- Konfuz. 24%

2nd year students level A2 (60)

- 38% konfuz. për termat gramatikore
- 37% konfuz. për termat kulturore
- 14% konfuz. për identitetin kulturor
- 11% konfuz. nuk përgjigjen fare

II. Përfshirja e edukimit ndërkulturor në klasat e gjuhës së huaj

Si mund të përfshijë kulturën në programin e gjuhëve të huaja?

Ka disa komponentë mund të na ndihmojnë të ndërthurim kulturën me gjuhën në klasat tona. Përveç strategjive, materialet kanë rëndësinë e vet. Zgjedhja e materialeve në bazë të nivelit gjuhësor të nxënësve ndihmon shumë që grupmosha të ndryshme të trajtojnë çështje të ndryshme për shembull vajtja në një muze apo në qendër të Londrës janë diçka tepër interesante, emocionale që japin kënaqësi dhe zhvillim kulturor. Një mësues i mirë duhet t'i ketë të gjitha aftësitë dhe njohuritë e duhura që të trajtojë gjuhën dhe kulturën e nxënësve.

Ashtu si thotë edhe Rivers "Në raste të tjera, njohuritë për komunitetin përfitues kanë marrë formën e 'predikimeve' ose një 'predikim' për çështje të tilla si doganat dhe ceremonitë martesore, festivale, ekskursionet e diel, e kështu me radhë, duke e bërë studimin e një kulture të huaj një detyrë të lodhshme" (Rivers, 1968: 272). Duke trajtuar tema të ndryshme u jepet një mundësi shumë e mirë të gjithëve për të folur. Sjellja herë pas here e informacioneve të reja jep kënaqësi dhe motivim. Duke sjellë në pah elemente të kulturës së gjuhës që nxënësit studiojnë është e rëndësishme t'u bëjmë të qartë se zakone të ndryshme dhe kultura të ndryshme nuk do të thotë se kemi kultura "superiore" apo "inferiore", por thjesht kemi këndvështrime të njëjta apo të ndryshme për të njëjtat gjëra, ashtu si ka edhe njerëz të ndryshëm me mendime të ndryshme brenda së njëjtës kulturë.

Detyra e mësuesit është të stimulojë interesin e studentëve në kulturën e gjuhës që ata studiojnë dhe për ta kthyer orën e mësimit jo thjesht si një vend ku mësohet gjuha, por si një vend ku mundësitë për të mësuar gjëra të ndryshme sigurohen nëpërmjet ndërveprimit që ndodh midis pjesëmarrësve (Ellis, 1992: 171, cituar në Kramsch, 1993: 245). Për më tepër, mësuesit mund të ftojnë folës të ndryshëm, të cilët do të flasin për përvojat e tyre duke i bërë ata të vlerësojnë kulturën e vendit të huaj.

Duke pasur larmishmëri temash mësuesit mund të përdorin strategji të ndryshme për të bërë studentët apo nxënësit të vlerësojnë kulturën e

vendit të huaj. Në këtë mënyrë, ajo bëhet më e lehtë për mësuesit dhe nxënësit për të identifikuar "stereotipeve" dhe para se të bëjnë këtë duhet të kenë të qartë kuptimin e kësaj fjale: underlying significance of a particular term or word in the target language and culture. Duke e vënë theksin tek rëndësia themelore e një termi të caktuar apo fjale në gjuhën që ne studiojmë dhe në kulturën e saj. Duke folur për tema të ndryshme dhe duke u përpjekur për të gjetur ngjashmëritë dhe dallimet është zbatimëse për ta. Le ti hedhim një vështrim sesi janë trajtuar të dyja kulturat së bashku. Teksti i përdorur për kulturën britanike dhe temat:

A Miscenally of Britain, People, Places, History, Culture, Customs, Sport.

Tom O'Meara. The Publishing House, Bennetts Close, Cippenham, Slough, Berkshire, SL1, SAP, England, 2007, ISBN 978-0-572-0338 3 –5

Temat e trajtuara janë : Introduction, This is Britain, Great Brits. Celebrity, Great British Women. The great British Poll. Monarchs of England, The Virgin Queen. Henry VIII, Elizabeth II. Prime Ministers, Winston Churchill. Britain at Ęar. The Union Jack, National Rivers and the British Empire. Explorers and Adventurers, British inventions. Traditional British Food. The British Seaside. The English Language, British Slang. Books and ěriters, William Shakespeare. The BBC, Classic British TV. Selected British Riots. Fact Files, London, Cardiff, and Edinburgh fact file. Toěer of London. British Buildings. Westminster Abbey, Patron Saints. National Songs, Music, The Beatles. Sport, Bizarre Bets. Customs. British Naturism. British Art. The Routemaster Bus. Weird Britain. Auld Lang Syne, Famous Last Words.

Ushtrimet e dhěně studentěve ně provimin pěrfundimtar tě lěnděs Studime tě Kulturěs Britanike

Ese

Cultural diversity of Britain and Albania. The importance and development through the centuries, portratization and preservation of "Culture", (300 ěords)

Diversiteti kulturor i Britanisě dhe Shqipěrisě. Rěnděsia dhe zhvillimi gjatě shekujve, portratizimi dhe ruajtja e "Kulturěs", (300 fjalě)

(3 paragrafe)

- Mention the most important features of British culture From the beginning up to noě. – Pěrmend tiparet mě tě rěnděsishme tě kulturěs britanike nga fillimi deri tani.

- Highlight the differences of British architecture to Albanian ones. – Jep dallimet e arkitekturěs britanike me ato shqiptare.

- Highlight the differences and the importance of Tea to British classes. – Jep dallimet dhe rěnděsině e ćajit pěr klasat britanike.

(3 paragrafe)

- Mention the most important features of British culture From the beginning up to now. – Pěrmend tiparet mě tě rěnděsishme tě kulturěs britanike nga fillimi deri tani.

- Highlight the differences of British Patron Saints to Albanian ones. – Jep dallimet e shenjtorěve britanikě me ata shqiptarě.

- Highlight the differences and the importance of music to British classes. – Jep dallimet dhe rěnděsině e muzikěs pěr klasat britanike.

(3 paragrafe)

- Mention the most important features of British culture From the beginning up to now. – Pěrmend tiparet mě tě rěnděsishme tě kulturěs britanike nga fillimi deri tani.

- Highlight the differences of British symbols to Albanian ones. – Jep dallimet e simboleve britanike me ato shqiptare.

- Highlight the differences and the importance of sport to British classes. – Jep dallimet dhe rěnděsině e sportit pěr klasat britanike.

(3 paragrafe)

- Mention the most important features of British culture From the beginning up to now. – Pěrmend tiparet mě tě rěnděsishme tě kulturěs britanike nga fillimi deri tani.

- Highlight the differences of British anthems to Albanian ones. – Jep dallimet e himneve britanike me atě shqiptare.

- Highlight the differences and the importance of food to British classes. – Jep dallimet dhe rěnděsině e ushqimit pěr klasat britanike

Si janë kryer këto ushtrime nga ana e studentëve:

Nr. I studentëve (40)

- Ese 25%
- Pika e 1 10% (*the most important features of British Culture*)
- Pika e 2 10% (*janë në gjendje të shkruajnë, 18% nuk e dinë, 15 % janë konfuz dhe pjesa tjetër shkruajnë thjesht një fjali*)
- Pika e 3^d 5% arrijnë të japin dallimet 45% shkruajnë thjesht një fjali, 50% nuk e dinë përgjigjen.

PËRFUNDIME

Mësimi i kulturës duhet të bëhet një pjesë integrale dhe e pandarë e mësimi të gjuhëve të huaja. Mësimi i kulturës duhet t'u shërbejë nxënësve të rrisin njohuritë e tyre kulturore duke marrë parasysh mënyrën sesi njerëzit e jetojnë, vlerat, qëndrimet dhe besimet. Më konkretisht, në mësimdhënia e kulturës duhet t'i bëjë nxënësit të vetëdijshëm për aktet e të folurit, ngjyresat e kuptimeve të fjalëve, etikën e të folurit, kush është sjellje e përshtatshme ose e papërshtatshme,

Nuk kemi të bëjmë me kultura 'superiore' ose "inferiore" këto nuk janë gjë tjetër, por vetëm përgjithësime për shkak të mungesës së njohurive dhe mungesës së respektit ndaj qenieve të tjera njerëzore. Ata që studiojnë një gjuhë të huaj duhet ta përdorin atë jo thjesht si mjet komunikimi, por si një mjet për t'i dhënë zë mendimeve të tyre, duke dalë mbi ato që quhen konventa apo stereotipe kulturore (Byram, Morgan et al. , 1994:73)

Gjuha dhe kultura janë pjesë të pandara të procesit studimor. Lind nevoja dhe detyra që të

kemi një ndërgjegjësim si nga ana e mësuesve, ashtu edhe nga ana e nxënësve apo studentëve se nuk mund ta studiojmë një gjuhë pa marrë parasysh të gjithë komponentët themelorë që përfshinë studimi i një gjuhe, se kompetencat gjuhësore zhvillohen në mënyrë të pandarë me ato gramatikore, komunikuese dhe kulturore.

BIBLIGORAFI

BYRAM, M., MORGAN, C. and Colleagues (1994), *Teaching and Learning Language and Culture*, Great Britain: WBC.

GUY, Cook (1996), *Discorse*, Oxford university Press,. fq98)

LARSEN, Freeman Diane (1986), *Techniques and Principles in Language Teaching*, Oxford. Oxford University press. fq.131)

SAMOVAR, L., PORTER, R. & JAIN, N. (1981), *Understanding intercultural communication*. Belmont, CA: Wadsworth.

LINDHOLM, K. J. (1990), *Bilingual immersion education: Criteria for program development*. In A. Padilla, H. Fairchild & C Valadez Bilingual education: Issues and strategies. Newbury Park CA: Sage. Fq 91-105)

KRAMSCH, C. (1993), *Context and Culture in Language Teaching*. Oxford University Press, Oxford.

RIVERS, W. (1981), *Teaching foreign language skills* (2nd ed.), University of Chicago Press, Chicago.

STRAUB, H (1999), *Designing a Cross-Cultural Course*. English Forum, vol. 37: 3, July-September.

SOME ENGLISH TRAVELLERS ABOUT THE ALBANIAN NATIONAL COSTUMES IN THE XIXTH CENTURY GREECE

DISA UDHËPËRSHKRUES ANGLEZË MBI VESHJEN POPULLORE SHQIPTARE NË GREQINË E SHEKULLIT XIX

SHPRESA HOXHA

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

Email: shppreessaa@hotmail.com

AKTET IV, 4: 741 - 744, 2011

PERMBLEDHJE

Sikurse shumë studiues evropianë, edhe ata britanikë treguan një interesim të veçantë për kulturën shqiptare në përgjithësi. Shqiptarët në anën tjetër, me historinë e tyre të bujshme që nga ilirët e arbrit si dhe me një trashëgimi të pasur të kulturës materiale tërhoqën vëmendjen e udhëpërshkruesve, poetëve, topografëve dhe shkencëtarëve britanikë që në shekullin XVI. Me shkrimet e tyre portretizuan kulturën materiale dhe etnografinë e pasur të shqiptarëve nga veriu i Shqipërisë e deri në periferinë e Athinës sot. Bajroni, më pak, Holland, Lik, Hobhauz dhe të tjerë u morën në detaje me estetikën shqiptare dhe me veshjet e veçanta të shqiptarëve. Originalitetin e veshjeve e pohuan pa hezitim me asgjë të huazuar nga grekët apo fqinjët e tyre ballkanikë. U konfirmua se fustanella ishte veshje kombëtare zyrtare e shqiptarëve, pikërisht ashtu siç e pranuan edhe disa autorë grekë. Ky edhe është objekti i prezantimit të kësaj kumtese.

Fjalët çelës: udhëpërshkruesit anglezë, etnografia, trashëgimia, veshje kombëtare, fustanella.

SUMMARY

As a lot of European scientists as well as British showed a special interest in the Albanian culture. On the other side the Albanians with their sensational history from Illyrians and Arbrisi (Albanians of Greece) and with a rich material culture heritage attracted the attention of foreign travelers, poets, topographers and British scientists since the XVIth century. By their writings they presented the Albanian rich material culture and ethnography from the north of Albania up to the outskirts of noëadays Athens. Byron less, Holland, Leake, Hobhouse and others were occupied particularly with the Albanian' esthetics and with their special clothing. They affirmed without hesitation the originality and nothing borrowed from Greek or their Balkan neighbors. It was confirmed that the Albanian kilt was a national and an officially clothing exactly as some of the Greek authors accepted it. So, this is the presentation object of this paper.

Key words: English travelers, ethnography, heritage, national costumes, kilt.

1. HYRJE

Fundi i shek. XVIII është kohë e interesimit të politikës së jashtme angleze, e cila në brigjet e Detit Jon, në hapësirën e gjerë të Pashallëkut shqiptar të Janinës sheh interesin gjeo-strategjik, që është konkurrenca me interesat gjeopolitike ruse dhe franceze. Në këtë drejtim, diplomacia politiko-ushtarake britanike përgatit disa persona

ushtarakë e civilë që do duhej ti vrojtonin mirë e mirë lëvizjet e kolegëve të tyre rivalë, jo vetëm në Pashallëkun e Janinës, por edhe më gjerë, duke i bërë kështu lëvizjet e tyre në Shqipërinë e Jugut dhe në Greqinë e sotme një objekt të veçantë studimi politik dhe strategjik.

Mirëpo, nuk ishte kjo e tëra. Ata në vrojtimet e tyre shohin edhe interesin vetjak afirmativ në

fushën e shkencës dhe të kulturës në përgjithësi. Shqiptarët dhe grekët, në përgjithësi, por edhe etnitë e tjera bëhen subjekt interesimi për disa udhëpërshkrues anglezë, të cilët nëpërmes përshkrimit të viseve të banuara me ta ofrojnë të dhëna të rëndësishme, përveç tjerash edhe për kulturën popullore dhe materiale të shqiptarëve, në veçanti.

2. Fustanella – petku më i bukur në botë (Bajron)

Bajroni, kështu, ishte i pari që u dha pasardhësve të tij informacionet e para për shqiptarët, duke shkruar me entuziazëm, se: “Shqiptarët me veshjen e tyre kombëtare, me fustanellën e tyre të bardhë, me fije të arit dhe me stoli prej një jeleku të qëndisur mirë e konsideron si veshje më madhështore në botë” (Treimer, 1926: 202). Me fjalë të tjera, në një letër dërguar nënës së tij, në marsin e vitit 1810, miku i madh i shqiptarëve, shkruante: “Shqiptarët me petkun e tyre, më të bukurin në botë, me fustanellë të gjatë e të bardhë, tallaganë të qëndisur gjithë ar, me anteri e jelek kadifeje të kuqe qëndisur me ojna të arta, me jataganë e pishqolla të sermta/.../ të gjitha këto me pamjen e jashtëzakonshme të ndërtesës vetë, sajnin një skenë të re gëzimi për sytë e një të huaji. Më përcollën në një konak shumë të këndshëm dhe sekretari i vezirit erdhi të më përshëndesë, në mënyrën allaturka” (Spender, 1920: 26).

3. Shqiptarët, sipas stinëve, veshin tri lloje petkash (Doduell)

Nuk ishte vetëm Bajroni, ai, i cili me ato pak fjalë komplimenti kishte folur për veshjen kombëtare të shqiptarëve. Një udhëpërshkrues tjetër, megjithatë, kishte tërhequr vëmendjen me shkrimet e tij për veçantitë e veshjes së pasardhësve të iliro-arbrit. Kishte qenë ky Eduard Doduell, i cili, i entuziazmuar nga veçantitë e kulturës popullore shqiptare, veprës së tij i jep këtë titull: *A classical topographical tour through Greece, during the years: 1801, 1805 and 1806 (Një turne klasike topografike nëpër Greqi, në vitet 1801, 1805 dhe 1806)*. Edhe ky përshkruan veshjen e shqiptarëve të Greqisë, që ishte

krejtësisht identike me viset e tjera kontinentale të këtij vendi, që ende nuk ishte pavarësuar nga Perandoria Osmane.

Shqiptarët sipas tij kanë një pasion të veçantë për arin, stolitë nga argjendi dhe për pjesë të ndryshme veshjeje të trupit nga lëkura. Udhëtarët shqiptarë zakonisht përdornin tri lloj veshjeje, varësisht nga stina e vitit (Dodëell, 1819: 135, 136.). Kështu, sipas Doduellit, në dimër veshnin gunën nga lëkura e bagëtive pa mëngë, me vrima nga ana e jashtme, kryesisht ngjyrë të zezë. Rrobat e jashtme të arvanitasve të pasur ishin me penj ari, ndërsa në gjoksin e tyre ishin të radhitura katër rende pullash argjendi ose ari, pulla këto të mëdha sa një vezë e pulës, të punuara me mjaft kërsëri. Ndërsa çorapet e punuara nga leshi. Më të shtrenjta ishin çorapet e punuara dhe të stolisura nga fije ari. Këpucët e tyre, sipas Doduellit, ishin të lëkurës ngjyrë kuqe ose te verdhë. Sipas tij, grekët nuk mund të vishnin mbathje ngjyrë të verdhë pa i dhënë leje administrata osmane.

Sa i përket veshjes së grave, Doduell thotë se ajo përbëhej prej këmishës së gjatë ose fustanit mbi të cilin vishej xhoka, që ishte e përhapur sidomos në tërë Shqipërinë. Veshja e brendshme e femrave shqiptare, qoftë në Shqipërinë e jugut, qoftë thellë në viset e sotme të Greqisë është prej mëndafshi ose mëndafsh i përzier me pambuk, ndërsa veshja e jashtme, që i jep kostumit të femrave bukurinë e saj karakteristike është një cohë me ngjyrë të çelur, si ajo me ngjyrë të verdhë në ngjyrë kafeje, e cila është e qëndisur me kujdes dhe me gajtanë të vegjël (Dodëell, 1819: 135, 136). Në shpinë dhe në bel nga të dyja anët qëndisja është e hollë dhe e përsosur.

Doduellit, përshtypje të madhe i kishin lënë çorapet e gjata të burrave, të cilat i vishnin në luftë dhe në udhëtim e sipër. Ato - thotë Simopulos: “Ishin ngjyrë argjendi dhe disa herë të lara në ar dhe të përpunuara me kujdes të veçantë /.../. Mbulonin pjesën e pasme dhe të brendshme të këmbës. Dy pjesë të rrumbullakëta dhe të lakuara prej argjendi viheshin në kyçe për t’i mbrojtur nga gurët e çdo lloj tjetër pengese gjatë rrugës. Mjaft herë këto i vishnin dhe pa

këpucë dhe i lidhnin me rripa. Të tilla mbulesa kishin zakon t'i vinin dhe tek gjunjët. Çorapet e gjata metalike që vishnin shqiptarët quheshin thjesht çorape /.../. Armët e shqiptarëve ishin dyfeku dhe një çift pistoletash të lara në argjend /.../, jatagani, hanxhari dhe shpata” (Holland, 1815: 68).

4. Fustanella atraksion për udhëpërshkruesit anglezë

Sidoqoftë, për disa udhëpërshkrues britanikë, një atraksion i veçantë ishte përshkrimi i fustanellës, si pjesë e veshjes shqiptare të asaj epoke, e përhapur gati në të gjitha viset e banuara me shqiptarë. Kështu, E. Spenser, bartjen e fustanellës e përmend në Plavë e Guci, në rajonet e Jeni Pazarit, në Pejë, në Prizren, në Sanxhakun e Nishit, në Shkodër, në Mirditë, në Prespë e në Ohër (Spencer, 1835: 170, 290), kurse Lejardi admiron fustanellën e banorëve kryengritës të krahinave të Dibrës (Matkovski, 1974: 246). Henri Holland, i cili kishte ardhur menjëherë pas Bajronit në Shqipëri, kishte bërë përshkrimin edhe të pjesëve të ndryshme të kostumit me fustanellë, duke përmendur këmishën dhe të mbathurat prej pëlhure pambuku, xhamadanë dhe jelekë të ndryshëm, opingat prej lëkure, kësula, fesë formash të ndryshe sipas krahinave dhe bartja e armëve. Të gjitha këto, pjesë kryesore të kostumit Henri Holland i pa të bartura nga fshatarët dhe ushtarët shqiptarë të Prevezës dhe nga rojet e sarajeve të Ali Pashë Tepelenës (Holland, 1815: 68).

Përgjithësisht, në veshjen popullore shqiptare, qoftë te fustanella, te guna, te xhamadani, udhëpërshkruesit anglezë gjenin elemente të veshjes antike greko-romake, ani pse ata nuk përmendin se edhe vetë fustanella depërtoi në kulturën e Perandorisë Romake vetëm përmes ilirëve. Veçojmë po ashtu dallimet që udhëpërshkruesit anglezë i bëjnë veshjes së grave në disa vise të banuara me shqiptarë. Në këtë kontekst, piktori dhe udhëpërshkruesi Eduard Lir, me syrin e mprehtë të tij, duke bërë fjalë për një kostum grash shkodrane shkruan se: “kostum më të shkëlqyer nuk mund të gjesh: mëndafshi i purpurt dhe kadifeja e qëndisur me kujdes dhe

imët në ar dhe argjend formojnë veshjen e jashtme, model i punuar me dorë me shije të pakrahasueshme, dy ose tre veshjet e brendshme mbuluar me qëndisma, dimitë e plota të purpurta, zinxhirë të panumërt monedhash ari dhe argjendi dhe medaljet, së bashku me një vello të gjatë të bardhë, plotësojnë kostumin, pa folur për një mori shamish mëndafshi të ngjyrosura, të cilat janë qepur brenda jelekut të jashtëm, që kanë një pamje të çrregullt dhe pa shije po të krahasohen me kostumin. Kjo veshje e hareshme mbahet vetëm në ditë festash të mëdha, ose në raste të shënuara si martesë, pagëzimet (Lear, 1851: 153; Mema, 1988: 99-100).

5. Kostumet më të bukura të Evropës (Lik)

Të tilla përshkrime të veshjes popullore shqiptare, si për burra, ashtu dhe për gra jepen, ku më pak e ku më shumë, në disa vepra topografike të udhëpërshkruesve anglezë. Përshkrimet çfarë japin ata janë mendime të nivelit të lartë ku karakterizohen referenca të veçanta për to, si: eleganca, funksionaliteti i tyre, ana atraktive krahasuar me veshjet e fqinjëve të shqiptarëve, si edhe identiteti i atyre veshjeve me veshjet e epokave të lashta. Në këtë kontekst, Lik kostumet e shqiptarëve i konsideron si: “kostumet më të bukura të Evropës, veshje me figura të mrekullueshme të shqiptarëve ose kostume që qëndisen vetëm nga shqiptarët” (Leake, 1835: 45).

Por, udhëpërshkruesit anglezë donin të besonin dhe konfirmuan se veshja madhështore ishte cilësi dhe pronë përdorimi e shtresës së lartë sunduese shqiptare. Lidhur me këtë, udhëtari Ëilliams bën të ditur se: “kostumet e bukura shqiptare përdoren varësisht nga pozita materiale”. Për më tepër, kolegu i tij Boëen informon se shqiptarët me fuqi të vogël ekonomike veshin një këmishë të ashpër prej leshi, ndërsa kostumi i një shqiptari të kamur është mjaft elegant dhe i stolitur (Boëen, 1852: 196).

Sido që të jetë, në fillim të shekullit XIX disa pjesë të veshjes popullore shqiptare kanë shtrirje të gjerë edhe në rajonet fqinjësore të tyre. Kështu,

që në fillim të shek. XIX Uilljëm Martin Lik konfirmon se “veshja popullore shqiptare bëhej një dukuri e përditshmërisë jo vetëm në Moré por edhe në disa vise të tjera të Greqisë, ndërsa arsyet e këtij ndikimi të madh ai i gjente në faktin se “veshja shqiptare është më e lehtë dhe më praktike, se sa ajo osmane ose turke”. Po ashtu e vlen të përmendet edhe fakti se udhëtarët anglezë kishin konfirmuar të dhënën që veshjet popullore shqiptare prodhoheshin në vetë hapësirën e tyre etnike. Xh. Hobhauz për këtë kishte vënuar se në fillim të shek. XIX gati çdo shqiptar e bënte veshjen e vetë. Kjo para së gjithash ishte vënë re në Shkodër (Hobhouse, 1813: 134).

6. PËRFUNDIME

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër është një tipar i veçantë që udhëpërshkruesit anglezë, në endjet dhe përshtypjet e tyre, e përmendin duke theksuar se veshja popullore shqiptare ishte një veshje kombëtare, që në thelb ishte një veshje e veçantë popullore, me specifikat e veta, e cila në një anë kishte një fizionomi origjinale të veten dhe që cilësonte e qartësonte tipare të unifikuara për shumë rajone e vise në nivel kombëtar. Dhe, rrjedhimisht, këto veçanti të veshjes, padyshim, i dallonin shqiptarët nga shumë etni të tjera jo vetëm në rajon, por, mbase, edhe më gjerë. Këto tipare siç u panë më lartë dalloheshin nga të tjerët tek veshja kombëtare shqiptare për nivelin e lartë artistik të përpunimit të tyre, për materialin e përdorur në ato veshje, për ngjyrat dhe larushinë e tyre si dhe për shkallën e lartë estetike të përpunimit të atyre veshjeve, që popujt e tjerë të Ballkanit, atëherë, nuk e kishin.

BIBLIOGRAFI

- TREIMER, Karl (1926) *Byron und Albanologie: "Arhiv za arbanasku starinu jezik i etnologiju"*, Knjiga III, sveska. 1- 2, Beograd.
- SPENDER, H., (1920) *Byron in Greece*, London.
- DODWELL, Edward (1819) *A classical topographical tour through Greece, during years: 1801, 1805 and 1806*, vol. 1, London.
- HOLLAND, Henry (1815) *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, etc. During the years 1812 – 1813*, London.
- SPENCER, Edëard (1835) *Travels in European Turkey through Bosnia, Servia, Bulgaria, Macedonia, Thrace, Albania and Epirus, ëith a visit to Greece and the Ionian Isles*, vol.1, London.
- MATKOVSKI, A. dhe Angelakova, P. (1974) *Patuvanjetto na dvajca anglikani nis Makedonia vo 1839, 1842, i 1844 godina: "Glasnik" Skopje*.
- LEAR, Edward (1851), *Journals of a landscape painter in Albania*, London.
- MEMA, Shpëtim (1988), *Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve anglezë të gjysmës së parë të shekullit XIX, Tiranë*.
- LEAKE, William Martin (1835), *Travels the Northern Greece*, vol. 1, London.
- BOËËN, G.F. (1852), *Mount Athos, Thessaly and Epirus: Diary of a Journey from Constantinople to Corfu*, London.
- HOBHOUSE, John Cam (1813), *A journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople, during the years 1809 and 1810*, London. .

ACRONYMS IN THE SPOKEN AND WRITTEN ALBANIAN DISCOURSE AKRONIMET NE DISKURSIN E SHQIPES SË FOLUR DHE TË SHKRUAR

SHYKRANE GËRMIZAJ

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË

Email: shgermizaj@yahoo.com

AKTET IV, 4: 745 - 750, 2011

PERMBLEDHJE

Përdorimi i akronimeve në gjuhën shqipe është në rritje të vazhdueshme, mes tjerash edhe si rrjedhojë e globalizimit. Në këtë kumtesë shqyrtohet gjendja e tanishme e dendurisë së përdorimit të akronimeve në diskursin e folur dhe të shkruar në përdorimet publike të gjuhës shqipe. Në të prezantohen rezultatet e hulumtimit, qëllimi kryesor i të cilit ishte vlerësimi i ndikimit të përdorimit të tepruar të akronimeve në qartësinë e teksteve të folura dhe të shkruara, kuptueshmërinë e përmbajtjes së mesazhit, si dhe në transmetimin e tij. Rezultatet e hulumtimit tregojnë rritje të vazhdueshme të dendurisë së përdorimit të akronimeve në shqipe krahasuar me periudhat e referencës. Është vërejtur se akronime të formuara kohëve të fundit, ekzistenca e sinonimisë dhe homonimisë, krahas homofonisë dhe homografisë, rezulton me mesazhe hutuese, që për pasojë sjellin përgjigje të paqarta. Rrjedhimisht, kjo e vështirëson transmetimin e mesazhit, pra edhe komunikimin në përgjithësi.

Fjalët çelës: akronim, diskurs, globalizim, komunikim, medie, mesazh.

SUMMARY

The use of acronyms in Albanian is in constant increase, among other reasons, as a result of globalization. The paper discusses the present state of the frequency of occurrence of acronyms in spoken and written discourse focusing on public uses of Albanian. It presents the findings of the research, the main aim of which was evaluation of the impact of excessive use of acronyms on clarity of spoken and written texts, intelligibility of the content of the message, as well as its transmission. Research findings have shown increase in the frequency of occurrence of acronyms in Albanian compared to reference periods. It has been observed that newly coined acronyms, the existence of synonymy and homonymy, along with homophony frequently result in obscure messages. In consequence, the failure in recognition of acronyms produces obscure response. Hence, message transmission, and, consequently, communication in general is impeded.

Key words: acronym, communication, discourse, globalization, media, message.

Dy fjalë në vend të hyrjes

Akronimia, megjithëse dukuri shumë e shpeshtë në gjuhën shqipe, si në diskursin e folur ashtu edhe në atë të shkruar, nuk është proces fjalëformues rishtar, pasi që dihet se paraqitja dhe veprimi i saj kushtëzohen nga rrethanat shoqërore e politike dhe kulturore të periudhës së caktuar historike. Prodhimtaria e tejmasshme e saj daton nga vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar dhe është pasojë e hapjes së Shqipërisë

ndaj botës, vendosjes së protektoratit ndërkombëtar dhe krijimit të realitetit të ri shoqëror e politik në Kosovën e pasluftës. Ajo është edhe rrjedhojë e proceseve shtetndërtuese dhe integrimi globalizuese.

Trajtimi që u bëhet këtyre formimeve është në shpërputhje me vulltin, përhapjen dhe shtrirjen e dukurisë në diskursin e folur dhe të shkruar, si në përdorimet publike, ashtu edhe ato private të gjuhës shqipe.¹ Arsye shtesë për hulumtimin e

akronimeve në vazhdimësi janë edhe mospajtimet e autorëve rreth përkufizimit të tyre, burime të pakta për referencë, e mbi të gjitha, prodhimtaria e këtij procesi fjalëformues në shqipen e sotme. Këto arsye dhe paqëndrueshmëria e terminologjisë, ngatërresa e shkurtimeve me shkurtesat dhe përdorimi i tyre si terma sinonime, më kanë shtyrë ta hetojë këtë çështje në vazhdimësi dhe të përcaktohem për termin akronim, përkundër faktit që gjithnjë i parapëlqej termat e gurrës shqipe.

Korpusi dhe metodologjia

Për qëllimet e këtij artikulli, korpusi është vjelë nga mediat e shtypura dhe elektronike, përfshirë këtu programet e folura dhe shiritat lëvizëse gjatë periudhës 2009/2010. Përveç këtyre, një hulumtim është ndërmarrë nën udhëheqjen time me qëllim të vlerësimit të shkallës së njohjes së akronimeve nga publiku i gjerë, si dhe nga një grup i caktuar i popullatës. Hipoteza e hulumtimit se shtresëzimi i akronimeve në leksikon e shqipes merr kohë dhe indikacionet e para të vërtetësisë që në fazën e përzgjedhjes së mostrës. Hezitimi i respondentëve për pjesëmarrje, edhe pse në kushte anonimiteti të plotë, linte hapësirë për përfundime paraprake.

Në një studim të mëhershëm, duke i trajtuar çështjet e përdorimit të akronimeve në gjuhën tonë, pata vënë në dukje disa rregullsi, por edhe shmangie, që hetoheshin në këtë fushë.² Ndërkaq, në një studim të mëvonshëm,³ qenë rishqyrtuar prejardhja e akronimeve, tipat, klasifikimi në lakime, çështjet e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit, si dhe efektet e gjithmbarshme të përdorimit të tyre për lexueshmërinë, qartësinë dhe lehtësinë e transmetimit, përkatësisht të absorbimit të informacionit. Për këto arsye, çështjet teorike si dhe implikimet e tyre në praktikë që burojnë nga paqartësitë teorike nuk do të shqyrtohen në hollësi në këtë punim, mirëpo do të tërhiqen paralele dhe do të kundërvihen përfundimet sa herë që do të ketë përkime dhe dallime.

Rezultatet e hulumtimit - Denduria e përdorimit të akronimeve

Gjykuar nga të dhënat tona, ashtu siç patëm parashikuar, përdorimi i akronimeve po bëhet gjithnjë e më i dendur. Akronimet janë të pranishme në të gjitha gazetatat e përditshme që botohen në Kosovë e në Shqipëri. Numër i madh syresh hasen edhe në ueb faqet e institucioneve shtetërore. Ato, po ashtu, janë të pranishme në mediat elektronike, si në diskursin e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Në përdorim janë akronime të gurrës së huaj krahas atyre të gurrës vendore. Madje, disa syresh, edhe pse janë shqipëruar dhe kanë qenë në përdorim, tani janë shndërruar në **anakronime** duke u zëvendësuar plotësisht me barasvlerëset me burim të huaj (khs. MUP-i i Serbisë /MPB, ICO/ ZCN/ZNC). Mirëpo, duhet nënvizuar faktin se edhe akronime të tjera janë shndërruar në anakronime për shkaqe të arsyeshme (khs. **PSSP/ SRSG** > (shef i) ICO-së; **SHPK** > PK; **TMK** > FSK; etj.)

Në mediat e shtypura, akronimet paraqiten kudo: në kryetituj, tituj e mestituj, por edhe brenda artikujve. Dendurinë e përdorimit të akronimeve e dëshmojnë titujt në vijim:

Sejdiu kërkon ndihmën e NATO-s për FSK-në (Zëri, i 18. 3. 2010)

Beqiri, kryetar i GP të LDK-së (Inforpress, 25. 4.)

Suhareka injoron udhëzimet e MASHT-it, vepron sipas MAPL-it (Koha Ditore, 5. 6.)

NATO-ja e shqetësuar me praninë e MUP-it në veri (K.D. 25. 6.)

OEAK-u dhe USAID-i arbitrazh për investimet e huaja (Kosova Sot, 15. 7.)

PD sfidë PS, kërkon SHISH dhe buxhetin (Shekulli, 27. 7.)

Ligji i SHISH-it mbetet për shtator (Telegraf, 26. 7.)

Dekretet PS e PD e refuzuan Topin (Gazeta Shqip, 27. 7.)

Serbia nuk pranon marrëveshje me BE-në dhe SHBA-në (K. S., 13. 8.)

Përveç në titujt, për motive të tërheqjes së vëmendjes së lexuesit dhe të ekonomizimit me hapësirë, akronimet përdoren dendur edhe brenda teksteve të artikujve të shtypit ditor. Për ilustrim po sjellim një shëmbetje nga shtypi ditor

ku vetëm brenda dy paragrafëve (me përsëritje) numërohen gjithsej dhjetë akronime:

Përgjegjësi i ZIP-it i KK-së...hapësirat janë dhënë në shfrytëzim përkohësisht me vendim të KK-së, pjesë e të cilit ka qenë edhe Mehmeti i LDK-së...

Shefi i ZIP-it i Komunës ka thënë se... me një vendim të KK-së, pjesë e të cilit ishte edhe A. Mehmeti i grupit opozitar të LDK-së, njëherësh shefi i GK të LDK-së në KK të Gjilanit. (K. D., 5. 6.).

Për hir të së vërtetës duhet thënë se, pos rasteve të izoluara, akronimet rregullisht përdoren të shoqëruara nga emërtimet e plota, gjë që është për t'u shënuar.

Drejtskrimi dhe shmangiet

Sa i përket drejtskrimit, derisa në vitin 2007 ishte e qartë se tipar dallues i akronimeve në gjuhën shqipe ishte shkrimi i tyre me shkronja të mëdha, si fazë e (para)fundit e procesit fjalëformues,⁴ dy akronime që i kemi regjistruar në shtypin ditor bien ndesh me këtë rregullsi. Bëhet fjalë për përdorimin e të dy radhëve të shkronjave për shkrimin e dyshkronjëshave: MSH dhe RrGGK.⁵ Po të përligjej kjo metodë e shkrimit të akronimeve, rrjedhojë do të ishte domosdoshmëria e rishqyrtimit të drejtskrimit të të gjithë akronimeve që përmbajnë dyshkronjësha (khs. ASHAK, ASHSH, BERZH, GJND, GJKK, KGJK, MSHP, SHBA, SHISH, SHIK, etj.).

Analiza e hollësishme e akronimeve në përdorim tregon se sot, krahasuar me periudhat referente 2003 dhe 2007, gjendja është më stabile në shumë aspekte. Kjo hetohet në drejtskrimin si dhe në përdorimin e trajtave rasore. Tani më shkrimi i akronimeve me vizë lidhëse që i ndan nga mbaresa rasore është shtresëzuar, me ndonjë shmangie, pothuaj në gjithë shtypin ditor me përjashtim të *Gazetës Express*, në të cilën për qëllim të njëjtë përdoret apostrofi, i cili herë-herë alternon me vizën lidhëse. Alternimi i apostrofit me vizën lidhëse, si dhe përdorimi ekskluziv i vizës lidhëse është shumë më i shpeshtë brenda teksteve të botuara në këtë gazetë, që dëshmon përcaktimin e paqartë të redaksisë, zbatimin jokonsekuent, por edhe lënien në dorë të

vendimmarrjes në duar të artikullshkruesve. Ja si duket kjo në gazetën e përmendur:

Kryesia e LDK'së dhe ajo e AAK'së kanë zbarkuar në Istog; Studimi i OSBE-së zbulon paragjykime në Maqedoni; BE-ja në rrezik (4.4.); Të pabindurit e MPJ'së; Istogu pret KQZ'në; Akuza për Drejtorin e QKUK'së (14.4.)

(Mestitull): Reagim i AKR'së; (brenda tekstit): ... se AKR'ja është një subjekt politik... për të cilat Prezidenti i AKR-së shpëmzon kohën... (5.3.); Udhëtimi i baronshës Ashton...një përpjekje të re të BE'së dhe SHBA'së... Sekretari i përgjithshëm i OKB-së... ka njoftuar OKB-ja... (28.3);..mbështetjen e plotë nga SHBA'së (sic!)...nga përfaqësuesi i OKB'së (15.4.) ... Kandidati i LDK'së është i hapur...nga AKR-ja tha se... jo për udhëheqësin e TPK-së...duke folur në emër të LDD-së...PDK-ja e ka shqyrtuar këtë raport... (5.5.).

Ndonëse shkrimi me vizë lidhëse i mbaresave rasore të emrave (kurse akronimet janë emra dhe kryejnë gjithë funksionet sintaksore që kryhen nga emrat dhe grupet emërore) bie ndesh me rregullat e drejtskrimit të gjuhës shqipe, kujtojmë se ajo në këtë fazë është e arsyeshme pasi që i shenjon formimet akronimike dhe sinjalizon tiparet specifike të këtij lloji të veçantë kompozitash,⁶ pra të kompozitave të të shkurtuara.⁷ Kjo metodë megjithatë, për gjykimin tim, është zgjidhje më e drejtë se përdorimi i trajtës së pashquar.⁸ Nga ana tjetër, kujtoj se nuk duhet të përjashtohet mundësia që përngjitja të ndodhë në një fazë në të ardhmen. Kjo ka ndodhur në gjuhën angleze, pasi që mbaresa e shumësit është përngjitur pas rënien së apostrofit dhe të vizës lidhëse për shenjim të trajtës së shumësit (khs. 1980's: 1980s dhe CD-s: CDs), kurse apostrofi ka mbetur në përdorim vetëm për shenjim të rasës gjinore.

Meqë u përmend shumësi, vlen të theksohet se trajta e shumësit si temë motivuese e akronimeve as sot nuk duket prodhimtare. Megjithëse ka luhatur në përdorimin e formimeve të tilla herë në trajtën e njëjësit, e më rrallë në atë të shumësit, numri i tyre është fare i paktë. Përveç akronimeve që i patëm regjistruar më herët tani kanë dalë në shesh vetëm edhe dy

akronime të tjera në trajtë të shumësit: **NSH-të** dhe **OVL-të**.

Një çështje tjetër që buron nga analiza e akronimeve në diskursin e folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe e që duhet të vihet në pah është shquarsia. Mbështetur në të dhënat që burojnë nga hulumtimi ynë, trajta e shquar e rasës emërore ende nuk është shtresëzuar. Marrë në përgjithësi, ajo diktohet nga politika e redaksive përkatëse, mirëpo shmangiet tregojnë se përgjegjësia bie edhe mbi artikullshkruerit. Po të analizohen titujt e gazetave të të njëjtës datë (26 korrik 2010), lehtë bien në sy luhatjet mes të shquarës dhe të pashquarës së emërores: **PS** vendos mbi **SHISH** (Metropol); **PD** sfidë **PS**, kërkon **SHISH** dhe buxhetin (Shekulli); **LSI-ja** qëndrim parimor (Integrimi); ... **PS** urdhër deputetëve të mos mungojnë (Standard); **MPJ** pa strategji por optimiste (Lajm); **BQK** flet (Infopress).

Në parim, gazetatat “Koha Ditore” dhe “Kosova Sot”, pos disa shmangieve, akronimet në rasën emërore i përdorin në trajtë të shquar (khs. **UÇK-ja**, **BQE-ja**, **PE-ja**, **FFK-ja**, por **KE** - K.D. 3.5.); **PTK-ja** dhe **ART-ja**, **MSH-ja**, **AKP-ja** - K. S. 9.7.). Nga ana tjetër “Zëri” dhe “Gazeta Express”, pos disa përjashtimeve, emëroren e paraqesin në trajtë të pashquar (khs. **BE**, **PD** – Zëri; **KMSHK**, **SHBA**, **BP**, por **KEK’u** – Express).

Akronimet në diskursin e folur – përditshmëri

Përkundër rekomandimeve të gjuhëtarëve për përdorim ekskluziv të akronimeve në diskursin e

shkruar, duke përjashtuar nga kjo frymorët, hulumtimi ynë tregon se diskursi i folur, po ashtu shfaq shtimin e dendurisë së akronimeve dhe implikimet e ndikimeve të huaja. Ato po bëhen përditshmëri në stacionet tona televizive.

KTV: ...gjë-në-dë-ja rast për të dëshmuar ndasitë e bë-e-s; Ekuidistanca e ai-si-o-s...; Mbyllet në u-pë hapet në a-a-bë (19.7) Pse përfaqësuesi special i o-kë-bë-ve nuk e anuloi (22.7) ... kishte sulmuar një ti-vi stacion... (23.7)...në reagimin e o-vë-lë-së së u-çë-kë-s... (28.7) bë-e-ja...? (16.8.) xhi-pi-es-i (21.8)

RTK: kryesisë së lë-dë-dë-s; .. vendimi i gjë-në-dë-s; ...shefi i ai-si-o-s... (19.7.)

TV21: ...mendimi i më-pë-jë-s pas vendimit të gjë-në-dë-s (13.7.);...u kthye nga shë-bë-a-t; a-a-kë kritikon qeverinë... (26.7); a-e-zhe-ja; berzh-i; fë-së-bë-kë fajëson...;...irritojnë shë-bë-a-në (21.8)

ALSAT: Yjet e en-bi-ei spektakël...

Klan Kosova : ...zyrtar i map (29.8.)

Sa njihen akronimet nga publiku?

Anketimi ynë dëshmoi se akronimet që përdoren për një kohë relativisht të gjatë identifikohen në përqindje më të lartë nga publiku, ndërkaq të tjerat që janë formuar rishtas dhe nuk kanë arritur të shtresëzohen, nuk identifikohen me saktësi as nga punonjësit e institucioneve përkatëse shtetërore. Kjo ilustron me tabelën në vijim:

Gjithsej akronime në pyetësor 150	Numri i akronimeve të identifikuar	Përqindja e akronimeve të identifikuar	Shkalla e njohjes së akronimeve
	7	4.6%	50% - 92%
	12	8%	28% - 46%
	14	9.3%	10% - 24%
	40	26.6%	2% - 8%
Të paignifikuar	79	52.6%	0%

Tabela 1. Shkalla e njohjes së akronimeve

Sikundër shihet nga tabela 1, nga 150 akronime të radhitur në pyetësor, mbi 50% nuk njihen fare nga respondentët, kurse gjysma tjetër identifikohen saktë prej 2%-92% të respondentëve. Kjo nuk ka si të mos na kujtojë video incizimin e intervistës me qytetarë dhe përgjigjet e tyre në pyetjen: 'A është më mirë të jesh HIV pozitiv ose negativ?' ku qytetarët gjejnë arsye të llojndryshme të argumentojnë pse është më mirë të jesh 'pozitiv'.⁹

Në vend të përfundimit

Duke i përmbledhur dhe duke i sintetizuar të dhënat e hulumtimit dhe duke i krahasuar me ato të studimeve të mëhershme, del se hipotezat tona po dëshmohen të sakta.

- Prirja e gjuhës shqipe për formimin e akronimeve dhe inicializmave e alfabetizmave të reja dhe denduria e përdorimit të tyre është në rritje të vazhdueshme si në diskursin e folur ashtu edhe në atë të shkruar;
- Dukuria e përdorimit të akronimeve pa u shoqëruar nga emërtimet e plota është në rënie në diskursin e shkruar, por në rritje në atë të folur;
- Prirja për formimin e akronimeve sinonime po ashtu po vazhdon (BE/ BQE; KB/ OKB/ UN; TND/ TPI; OJQ / NGO; FYROM / IRM / IRJM), e së bashku me të po paraqiten edhe homografet dhe homofonet akronimike.
- Dukuria e akronimeve homonime po ashtu po shënon rritje (AAK, AK, BE, IAP, KB, KK, KPJ, PD, PK,...).
- Mungesa e burimeve për referencë, krahas mungesës së politikave të qarta redaktoriale dhe moskonsekuençës së artikullshkruesve, rezultojnë me shmangie dhe luhatje në drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e akronimeve.
- Një numër i madh akronimesh nuk njihen nga publiku i gjerë, madje as nga grupe të caktuara të publikut.

Së këndejmi, shtrohet kërkesa e ngutshme për qëmtim dhe regjistrim sistematik të gjithë akronimeve që përdoren në të gjitha sferat e shoqërisë në mbarë arealin gjuhësor të shqipes. Kjo do të shpinte në hartimin dhe botimin e burimeve për referencë, si në formë elektronike ashtu edhe në formë të shtypur. Burime të tilla do ta mundësonin mbajtjen e hapit me vullin e zhvillimeve në këtë fushë si dhe do t'u jepnin dorë gjithë atyre që mëtojnë ti krijojnë, atyre që i përdorin ditë për ditë, qoftë duke i shkruar, qoftë duke i shqiptuar, qoftë duke përkthyer në shqipe dhe nga shqipja, qoftë duke i ndeshur ato në tekste llojesh të ndryshme, shumë shpesh të shtrënguar t'i zbërthejnë ashtu si dinë e munden, mbase jo kurdoherë ashtu si do të duhej.

Poshtëshënimet

¹ Trajtim i sipërfaqshëm dhe aspak e fare pak hapësirë u kushtohet këtyre formimeve në tekste të leksikologjisë, gramatika, dhe fjalorë të gjuhës shqipe krahasuar me prodhimtarinë e procesit fjalëformues.

² Shykrane Gërmizaj, *Përdorimi i akronimeve në gjuhën shqipe*, në Kulturë e gjuhës 1, Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës, Prishtinë, 2003, f. 79-87 dhe në Anglishtja dhe shqipja – Përfaqje e kundërvënies, Prishtinë 2009, f. 153-166.

³ Shykrane Gërmizaj, *Formimet akronimike në gjuhën shqipe*, Seminari XXVII Ndërkombëtar i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, Prishtinë, 2007, f. 241-258.

⁴ Në përgjithësi konsiderohet se akronimet së pari formohen si shkurtime me shkronjat nistore që ndahen me pikë (p.sh. K.E.K.). Duke u shtrirë dhe duke u shtuar denduria e përdorimit të akronimit të caktuar, pikat bien (KEK), kurse shkronjat e mëdha mund të zëvendësohen me të vogla pas depërtimit të akronimit në shtresën e përgjithshme të leksikut (khs. Radio Detecting And Ranging : R.A.D.A.R. : RADAR: radar)

⁵ Në vitin 2007 po ashtu patëm hetuar prirje të përdorimit të dy radhëve shkronjash si p.sh. BprAL por ky tani më është shndërruar në anakronim.

⁶ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHRSH, Tiranë, 1995, f. 74-75

⁷ Mehmet Çeliku e të tjerët, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 360-361

⁸ Ta kujtojmë faktin se emrat personalë të burimit të huaj në shtypin ditor shpesh përdoren pa mbaresa rasore.

⁹ www.youtube.com/watch?v=pHHJWM32iUY

¹ Elsie Robert, *Histori e letërsisë shqipe*, Tiranë 1997, f. XII.

¹ Gazeta, "*Bashkimi*", nr. 241/11740, e premte 7 tetor 1983. f. 1 – 2.

¹ Kacoruh, Naxhi, *Gjorokastra e festivaleve*. Albin, 2000, f. 7.

¹ Gazeta "*Shekulli*," 14 shtator 2009, f. 11.

¹ Gazeta "*Panorama*", 12 tetor 2001, f. 14.

¹ Gazeta "*Festivali*", e enje 6 tetor 1983, f. 2.

¹ Gazeta "*Bashkimi*" nr. 240(8956e diel 7 tetor), f. 1.

¹ Gazeta "*Drita*", nr. 47,(670) 14 tetor 1973, f. 1.

¹ Gazeta "*Zëri i Popullit*", nr. 250(12561), e hënë 17 tetor 1988. f. 4

¹ Gazeta "*Festivali*", e hënë 8 tetor 1973, 1.

¹ Gazeta "*Bashkimi*", e shtunë, 7 tetor 1978, f. 1.

¹ Gazeta "*Festivali*", 12 tetor f. 2.

* Festivali Folkorik i vitit 1983 filloi më 6 tetor , në atë festival morën pjesë 1 700 festivalist.

¹ Gazeta "*Zëri i Popullit*", nr. 244/9417, e martë 10 tetor 1978. "*Det me këngë e mal me valle*".

¹ Gazeta "*Festivali*", nr. 7, 12 tetor 1978, f. 2.

¹ Gazeta "*Bashkimi*", nr. 246(10 527) e mërrkurë 11 tetor 1978, f. 1, 2.

¹ Gazeta "*Festivali*", nr. 8, e premte 13 tetor 1978, f. 4.

¹ Gazeta "*Zëri i Popullit*", 12 tetor 1983, Xhevair Spahiu, "*Art i jetës art i njerëzimit*" f. 1 – 3.

¹ Gazeta "*Festivali*", nr. 3, e shtunë 8 tetor 1983.

¹ Gazeta "*Bashkimi*", 8 tetor 1983, f. 4.

¹ Gazeta "*Zëri i Popullit*", nr. 246(12 557), e enjte 14 tetor, f., 3.

¹ Gazeta "*Festivali*" nr. 6 11 tetor 1988, f. 4.

¹ Gazeta "*Festivali*", nr. 4, e diel 8 tetor 1988, f. 4.

¹ Gazeta, "*Festavili*", nr. 5, e hënë, 10 tetor, 1988, f. 4.

¹ Po aty.

¹ Gazeta "*Fest – Folk 2009*", nr. 6, 29 shtator 2009, f. 1.

¹ Gazeta "*Koha Jonë*", 20shtator 2000, f. 26.

¹ Gazeta "*Fest – Folk 2009*", nr. 4, 27 shtator 2009, f. 1.

¹ Gazeta "*Fest – Folk 2009*", e hënë 20 shtator 2009, f. 2.

¹ Gazeta "*Fest – Folk 2009*", nr. 5, 28 shtator 2009, f.1.

SI TË BËHET NJË VLERËSIM I PAVARUR E I VETËDIJSHËM I KURSEVE TË FORMIMIT PASUNIVERSITAR TË OFRUARA NË RRJET PËR MËSUES GJUHE

SONILA PIRI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

Email: sonilap@yahoo.com

AKTET IV, 4: 751 - 755, 2011

PERMBLEDHJE

Nevoja që ka lindur vitet e fundit për të kërkuar mundësi formimi alternative në gjendje t'i ofrojë individit mbështetje për një përditim të vazdueshëm gjatë gjithë jetës, duke i garantuar pavarësi në menaxhimin e kohës e të hapësirës, është duke i dhënë hov një sistemi të ri formimi në distancë. Por përdorimi i rrjetit si mjet formimi nuk do të thotë të transferohen baza metodologjike e didaktike të efektshme të mësimdhënies tradicionale në një dimension të ri, por të rikrijohen rolet dhe funksionet e aktorëve të përfshirë, të materialeve të përdorura, të hapësirës e të kohës në dispozicion. Nëpërmjet disa skedash janë analizuar kriteret bazë të nevojshme për të përcaktuar si paraqiten faqet e internetit të këtyre kurseve si edhe vështirësitë që mund të hasen gjatë përdorimit si rrjedhojë e një infrastrukture teknologjike të ndërlikuar.

Fjalët çelës: vlerësim – kurs pasuniversitar - rrjet – formim – gjuhë të huaja

SUMMARY

There has been a certain need recently to look for an alternative education opportunity which can offer people support for lifelong updating of their knowledge, thus contributing in individuals' independence of time and space management. As a result, distance education has come up and is spreading heavily. Using the eeb as an information tool does not necessarily mean transferring all effective methodology and didactic means of traditional teaching into a new dimension; instead, it means recreating the roles and functions of the parties involved, of the materials used, of the time and space at the individuals' disposal. This study analyzes the basic criteria necessary for determining how eebPages for these courses can be presented; it also discusses the potential difficulties that can be encountered as a result of complications of the technology involved.

Key words: assessment - course – eeb - training - foreign languages

HYRJE

Nevoja që ka lindur vitet e fundit për të kërkuar mundësi formimi alternative në gjendje t'i ofrojnë individit mbështetje për një përditim të vazdueshëm gjatë gjithë jetës, duke i garantuar pavarësi në menaxhimin e kohës e të hapësirës, është duke i dhënë hov një sistemi të ri formimi në distancë (FnD), i njohur si "formimi në distancë i gjeneratës së tretë". FnD-ja përfaqëson alternativën e formimit tradicional që prej një shekulli, por vetëm me ardhjen e gjeneratës së tretë, e të ashtuquajturës epokë të telematikës,

ajo mund të konsiderohet si një alternativë e të njëjtit nivel dhe vlerë me sistemet e formimit në prani.

Nga pikëpamja e njohurive rrjeti mund të interpretohet në dy mënyra: si burim materjalesh e si ambient nxënies. Si burim materjalesh didaktikë rrjeti mund të përdoret për nxënien individuale ose të asistuar: Nxënia individuale karakterizohet nga të paktën dy forma vetënxënies: e para me materiale të strukturuar, pra rrjeti shndërrohet në një mjet shpërndarës (duke zëvendësuar praktikisht

postën tradicionale), e dyta si një nxënie e rastësishme me mbledhjen informacionesh e njohurish të reja falë lundrimit të rastesishëm. Në nxënien e asistuar mund të përdoren materiale didaktike të strukturuar ose të pranishme në rrjet, e cila parashikon një lloj asistence pak a shume të individualizuar, që nga testet e vetëvlerësimit deri tek tutorimi. Në të dyja këto qasje, rrjeti nënkupton një mjet të ri komunikimi, të cilit i vlerësohet shpejtësia, multimedialiteti e përdorimi i mundshëm. Ndërsa nga pikëpamja sociale, rrjeti bën të mundur nxënien e tipit bashkëpunues, duke ndërthurur teoritë e reja të nxënies me nevojat për fleksibilitet e menaxhim të kohës individuale.

Nëpërmjet disa skedash janë analizuar kriteret bazë, të nevojshme për të përcaktuar si paraqiten faqet e internetit të kurseve të formimit në rrjet, si edhe vështirësitë që mund të hasen gjatë përdorimit si rrjedhojë e një infrastrukture teknologjike të ndërlikuar. Strukturimi i skedave vëzhguese është menduar të jetë sa më efikas në lidhje me vëzhgimin e çfarëdo lloji kursi formimi në rrjet për mësues. Pikënisja e formulimit të skedave bazohet në idenë se ndërveprimi në rrjet bëhet mbi të paktën katër nivele që janë: ndërveprimi me mjetin, i cili varet jo vetëm nga mundësitë e infrastrukturave, por edhe nga kompetencat e përdoruesit; Ndërveprimi me përmbajtjen, d.m.th. me materialet e vëna në dispozicion, cilësia e tyre dhe niveli i përshtatjes së tyre; Ndërveprimi vertikal: nga përdoruesi drejt subjekteve organizuese dhe stafit mbështetës, si teknik ashtu edhe atij edukativ e anasjelltas; Ndërveprimi horizontal, ose shpërndarja midis të barabartëve.

Skeda e parë sygjeron të vëzhgohen e të pikasen të dhëna në lidhje me infrastrukturën, ose faqen e internetit, përdorimin e saj si edhe rrugëtimin e brendshëm, karakteristikat e mjeteve ndërvepruese që paraqiten.

SKEDA 1	Ambienti i nxënies
---------	---------------------------

1) Të dhëna të përgjithshme:

Aspekti i parë i marrë në konsideratë në analizën e karakteristikave është paraqitja me të cilën

“prezantohet” faqja e internetit, ose ndërfaqja si edhe përdorimi i saj, pra lehtësia e lundrimit për një përdorues mesatarisht ekspert ose joekspert. Meqenëse kjo analizë nuk mund të jetë përmbyllëse ose të japë të dhëna teknike, janë marrë në konsideratë disa kriteret bazë, të nevojshme për të përcaktuar se si faqja e internetit i shfaqet mësuesit/studentit e nëse ky i fundit mund të hasë pengesa për shkak të vështirësive në përdorim ose nga nevoja e një infrastrukture teknologjike të ndërlikuar.

- Faqet e internetit paraqiten saktësisht nga motorrë kërkimi rrjeti të ndryshëm

- Paraqiten elementë ndihmës për një shfaqje sa më të saktë të faqeve

(Fakti që disa faqe kërkojnë shkarkim programesh, përgjithësisht falas, bëhet pengesë për përdoruesin joekspert.)

- Karikimi i faqeve bëhet në më pak se 10 sekonda me një lidhje standarte prej 56.000 Kb (Hapja e shpejtë e faqeve të internetit duke shmangur pritje të mërzitshme është një nga kriteret minimalë për të përcaktuar lehtësinë gjatë përdorimit të faqes së internetit)

- Vendosja e ikonave të lundrimit është tradicionale: në të majtë të faqes

(Edhe pse rrjeti është një fenomen akoma i ri për të krijuar një traditë të mirëfilltë, ekziston një kod përdorimi i pashkruar i cili parashikon përdorimin e disa hapësirave në funksion të lundrimit të brendshëm e të jashtëm. Vendosja e ikonës së lundrimit të brendshëm i shfaqet përdoruesit pothuajse gjithmonë në të majtë të faqes. Humbja e disa sekondave për të gjetur atë krijon zhgënjim tek përdoruesi.)

- Paraqiten korniza të sipërme, anësore e të poshtme, prania e zakonshme e të cilave qetëson përdoruesin e një ambienti të caktuar

- Simbolet grafike duhet të jenë gjithnjë të pranishme pasi bëjnë të mundur pikasjen e lidhjeve (Një simboli të caktuar i përket një faqe e caktuar)

- Është i mundur kalimi nga faqja kryesore në të gjitha zonat e faqes së internetit

- Është i mundur kthimi në faqen kryesore nga të gjitha faqet e tjera

(Kjo mënyrë dikton një rrugëtim të shpejtë pa qenë e nevojshme të bëhet një kthim mbrapa duke kaluar faqe më faqe.)

- Është i mundur kërkimi i brendshëm në faqen e internetit ose kërkimi i disa zonave të përcaktuara, si p.sh. në hapësirën “shkarkimi”

(Kjo bën të mundur të mos “humben” faqet ose materialet sepse nuk mbahen mend ku gjendeshin ato. Nuk është automatike që procesi logjik i projektuesit të faqes së internetit ndaj sistemit të hapësirave e të materialeve, të jetë i njëjtë me atë që përdor përdoruesi gjatë kërkimit.)

2) Faqja kryesore:

Informacionet dhe burokracitë ndaj kursantëve:

- Prezantimi

(Ai është thelbësor jo vetëm për arsye reklame, por sepse në të bëhet përshkrimi i detajuar i ofertës së formimit e në bazë të informatave të para i interesuari vendos nëse kursi është i përshtatshëm për nevojat e tij e anasjelltas. Qartësia e vërtetësia e përmbajtjes së prezantimit të kursit është një nga aspektet e rëndësishme ndaj të interesuarit për të ndjekur atë kurs formimi.)

- Mundësia e rregjistrimit në internet

(Rregjistrimi direkt në internet është ekonomik për sa i përket kohës. Nëse rregjistrimi do të kërkonte procedura të ndërlikuara ose zgjatje burokratike, kjo do ta mërziste të interesuarin që në fillim.)

a) Hapësirat e informacioneve dhe burokracive ndaj kursantëve

- Fjalëkyçet për hapësirat e aktiviteteve

(Dihet që për hyrjen në kurset me pagesë duhet patjetër një fjalëkyç. E rëndësishme është që fjalëkyçi të jetë i personalizueshëm e jo i dhënë nga sistemi, pasi është më e thjeshtë të ngulitet në kujtesë një fjalëkyç i vetëzgjedhur.)

- Kalendar i aktiviteteve

(Në përgjithësi këto kurse ndiqen nga të rritur që kanë angazhime personale e profesionale, prandaj paraqitja që në fillim e aktiviteteve i ndihmon ata të organizohen në lidhje me angazhimet e tyre.)

- Kalendar i dorëzimeve

(Po kështu edhe datat e dorëzimeve duhet të jenë të qarta që në fillim.)

- Tabela e informacioneve

(Është burimi kryesor i informacioneve midis organizatorit/administratorit të kursit dhe kursantëve.)

b) Hapësirat e mbështetjeve dhe materialeve

- Zëri që përmban përgjigjet për problematika të lindura në kurset e mëparshme

(Në këtë mënyrë shmanget që organizatori i kursit të japë shumë herë përgjigje për të njëjtën pyetje. Funkcioni i këtij zëri nuk është për t'u nënvleftësuar pasi përdoruesi joekspert ndjehet zakonisht i lehtësuar nga prania e këtij zëri, sepse në të sqarohen menjëherë pyetje ose dyshime që mund t'i lindin.)

- Biblioteka dhe materialet

(Është hapësira ku ruhen materialet e studimit ose materialet që mund t'u interesojnë kursantëve. Karakteristikat e saj thelbësore duhet të jenë thjeshtësia në përdorim dhe lehtësia në gjetjen e materialeve.)

- Përgjegjësi teknik

(Është shumë e rëndësishme për qetësinë e përdoruesit të ketë një përgjegjës ekspert në gjendje ta mbështesë nga ana teknike, pasi edhe përdoruesi më ekspert mund të hasë vështirësi në përdorim e një platforme të panjohur.)

- Përgjegjësi administrativ (sekretaria)

(Kursi në rrjet duhet të japë mundësinë të kontaktohen po në rrjet përgjegjës administrativ për të zgjidhur probleme të mundshme burokratike.)

c) Hapësirat e aktiviteteve:

- Forumi në rrjet

(Zakonisht është hapësira e aktiviteteve më e përdorur e llojit josinkronik e përbërë nga një faqe bazë, një “rrjetë”, në të cilën gjenden mesazhet e përdoruesve të faqes, të vendosur në mënyrën klasike hierarkike, në formë peme. Strukturimi grafik i faqes bën të mundur të seleksionohet një nga diskutimet e hapura.)

- Lista e adresave postare elektronike

(Është një mjet komunikimi josinkronik tipike e komunikimit shumë me shumë, pasi një mesazh i dërguar listës, automatikisht i dërgohet edhe të gjithë të rregjistruarve.)

- Biseda në internet

(Biseda ose komunikimi direkt në internet është në çdo platformë kursi në rrjet dhe është relativisht i thjeshtë për t'u përdorur. Ka një limit përdorimi deri në grupe me 3-4 persona, mundësisht me kompetencë të barabartë në përdorimin e tij, pasi kush shkruan më ngadalë ose shikon tastierën ndërsa shkruan mund të hasë vështirësi të ndjekë bashkëbisedimin.)

- Videokonferenca.

(Është një mjet që bën të mundur lidhjen zanore e pamore midis pjesëmarrësve në veprimtari, leksion etj. Për të përdorur videokonferencën nevojitet një aparat më i ndërlikuar prandaj përdoret rrallë.)

d) Hapësirat e komunitetit:

- Bari/pub kafe

(Është zona e komunikimit të lirë, ku mund të flitet për gjithçka. Preferohet të mos flitet për materialet e për veprimtaritë që zhvillohen në module ose në kurs. Është një hapësirë që literatura e fushës e këshillon, por megjithatë nuk është gjithnjë e pranishme.

- Prezantimi i kursantëve.

(Është hapësira në të cilën aktorët prezantohen në formë tabelash, skedash apo faqesh personale. Këshillohet edhe nga literatura e fushës, pasi në një ambient virtual, në të cilin mungojnë të gjithë faktorët fizikë, është e rëndësishme që përdoruesit të dinë me kë kanë të bëjnë edhe nëpërmjet të dhënash thelbësore të kufizuara si psh. roli që ka në brendësi të kursit, profesioni, etj.)

parashikohen periudha të sakta për aktivitetet dhe dorëzimet e detyrave)

Modulet mund të parashikojnë edhe ndërhyrje të lirë në punët dhe aktivitetet që nuk kryhen në periudha të përcaktuara.

(Në disa kurse është e mundur që modulet të përsëriten gjatë vitit, kështu kursanti të ketë mundësinë të zgjedhë periudhën që dëshiron për të ndjekur një modul.)

Aktivitetet: vëzhgime të përgjithshme

Ky zë ka për objektiv të fokusojë llojet kryesore të aktiviteteve të dhëna brenda një moduli, për të pikasur në vija të përgjithshme modelin e kursit dhe modelin e mësimdhënies të lidhur me të.

(Dihet që asnjë model nuk mund të përshtatet në formë të pastër, prandaj analiza e tyre kufizohet në predominimin e njërit mbi tjetrin.)

- Jepen detyra të përcaktuara që duhet të zhvillohen individualisht

(Përparësia e aktiviteteve të këtij lloji shpreh se moduli është më shumë i orientuar ndaj modelit të dhënies së informacioneve të mësimdhënies, sesa ndaj ndërveprimit të klasës.)

- Preferohet diskutimi i lirë ose i varur nga të dhënat e tutorëve

(Vëmendja fokusohet tek komuniteti, pra tek shkëmbimi i njohurive midis pjesëtarëve të klasës, sipas modelit të tipi konstruktivist.)

- Preferohen aktivitete bashkëpunuese të llojit me projekte

(Vëmendja fokusohet vetëm tek komuniteti dhe tek aftësitë rreth implementimit të projekteve bashkëpunuese. Ky model mësimdhënieje është i llojit konstruktivisto-social.)

SKEDA 2	Metodologjitë e përdorura
---------	----------------------------------

- Kohëzgjatja

(Orientimet në lidhje me kohëzgjatjen dhe aktivitetet janë të lidhura me modelin e kursit të zgjedhur. Nëse modulet parashikojnë një ndarje kohore të mirëpërcaktuar, kursi është projektuar sipas një strukture ndarëse me sekuenca, ku

SKEDA 3	Materialet
---------	-------------------

Analiza e materialeve është e rëndësishme për të verifikuar cilësinë e tyre nga pikëpamja e shpërndarjes e nga përmbajtja.

Paraqitja e materialeve:

- Janë të strukturuar si faqe interneti

- Janë përgjithësisht tekstore dhe të shkarkueshme nga faqja e internetit.

- Janë përgjithësisht si orientim bibliografik ose orientim rreth faqesh interneti
- Janë përgjithësisht materiale të jostrukturuara (hipoteza pune, projekte, ide)
- Materialet janë konceptuar vetëm për atë kurs
- Materialet janë ripropozim i librave të tekstit
- Materialet janë të pranishme në rrjet
- Materialet janë në formë modulesh

- Vetëm vlerësimi i pjesëmarrjes në rrjet nga pikëpamja sasi/cilësi.
- Vlerësimi i një detyre/pyetësor përfundimtar dhe pjesëmarrja në rrjet.
- Vlerësimi në prani + vlerësimi i aktiviteteve në rrjet.

PËRFUNDIME

Të regjistrohesh në një kurs formimi që zhvillohet i tëri në rrjet kërkon një vetëdije të madhe pasi duhet të përballemi me kohë, mjete e mënyra komunikimi të ndryshme nga ato që përkohjnë me skemën tonë mendore të “shkollës”, duke filluar që nga mjete, kompjuteri të cilin shpesh nuk e zotërojmë tërësisht, deri tek gjuha e rrjetit të cilën shpesh e njohim vetëm për arsye personale. Edhe procesi i nxënies është i llojit virtual, prandaj mund të krijojë pengesa në zgjedhjen e kurseve. Për një vlerësim sa më të pavarur e të vetëdijshëm të një kursi pasuniversitar të ofruar në rrjet, është e nevojshme që mësuesi apo studenti i gjuhës së huaj të ketë njohuri rreth disa parametrash bazë që paraqiten në këto lloj kursesh formimi.

BIBLIOGRAFIA

- BANZATO M, (2002) Apprendere in rete, UTET, Torino
- CALVANI A, ROTTA M, (2003) Fare formazione in internet: manuale di didattica online, Erikson, Trento.
- MARAGLIANO R, (2004) Pedagogie dell’e-learning, Laterza, Roma.
- TRENTIN G., (2001) Dalla formazione a distanza all’apprendimento in rete, Franco Angeli, Milano..

SKEDA 4

Pjesëmarrësit

Cilët janë aktorët e klasës virtuale:

- Kursantët e numri i tyre

(Klasa ka më shumë se 10 studentë; ka 10- 20 studentë. Është e përbërë nga më shumë se 20 studentë.)

- Të dhëna cilësore

(Përqindja e të rregjistruarve që kanë eksperiencë në mësimdhënie, është më e madhe ose më e vogël se 70%.)

- Tutorët

Tutori është ekspert i fushës; është përgjithësisht “instruktor”, i qartë në përcaktimin e detyrave e të dorëzimeve. Ai shmang pikëpamje personale dhe emocionale, është i shpejtë në dhënien e përgjigjeve. Vë në dispozicion materialin e duhur pa ngarkesa në informacione. Njeh e komunikon duke iu përmbajtur rregullave të etikës. Lehtëson bashkëbisedimin midis kursantëve. Jep përgjigje në kohë e nxit reagimin tek kursantët.

SKEDA 5

Vlerësimi

Ka për qëllim të përcaktojë cilat janë kriteret vlerësuese të përshtatura gjatë zhvillimit të kursit formues.

ON SOME ISSUES OF THE EXPRESSION OF CONDITIONAL RELATIONS IN THE TODAY ALBANIAN LANGUAGE MBI DISA ÇËSHTJE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE KUSHTORE NË SHQIPEN E SOTME

MATILDA PERLLAKU
Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Email: mperllaku@mash.gov.al

AKTET IV, 4: 756 - 765, 2011

PERMBLEDHJE

Në këtë artikull përqipemi të trajtojmë vetëm disa nga çështjet që shtrihen për diskutim në lidhje me mjetet dhe format shprehjes së raporteve kushtore në gjuhën e sotme shqipe. Këto çështje janë trajtuar sipas problematikës si më poshtë, por në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën duke krijuar përshtypjen e një tërësie, sepse të gjitha mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore në fjali apo periudhë.

1. Mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore;

1. 1 Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore kushtore,

Trajtat mënyrore e kohore të fjalisë drejtuese dhe asaj të nënrenditur kushtore dhe bashkëlidhja e këtyre trajtave;

Kushti real apo joreal, i mundshëm apo i pamundshëm.

2. Dy nga format jo të zakonshme të shprehjes së raporteve kushtore:

2. 2. a Periudhat me fjali të nënrenditura kushtore jolidhëzore që fillojnë me folje në mënyrën lidhore;

2. 2. b Rrethanori i kushtit.

Artikulli synon t'i ndriçojë këto aspekte sintaksore për dy arsye:

së pari- problematika që përfshijnë ato është mjaft e gjerë ndaj gjithmonë ka hapësirë për diskutime dhe

së dyti- studimet e mirëfillta, që e trajtojnë këtë çështje datojnë larg në kohë dhe nëpërmjet trajtimit të tyre synohet të jepet një ndihmesë modeste në çuarjen përpara të studimeve shqiptare në fushën e sintaksës.

Fjalët çelës: Fjalja, klasifikimi, kusht, njësia sintaksore, periudha, raport.

HYRJE

Trajtimi i mjeteve dhe formave të shprehjes së raporteve kushtore ka përbërë objektin e disa studimeve të gjuhëtarëve të ndryshëm, shqiptarë apo të huaj, si pjesë të teksteve shkollore për shkolla të nivelit të mesëm apo të lartë ku përmendim, S. J. Xanoni (Xanoni, 1909: 160), G. Mikeli (Mikeli, 1916, 131), A. Xhuvani (Xhuvani, 1922, 1938, 1942), I. D. Sheperi (Sheperi, 1927), A. J. Rrota (Rrota, 1942, 1943, 2006: 614), K. Cipo (Cipo, 1949, 1951, 1952: 125), M. Domi (Domi, 1955, 1969, 1971), E. Guinard (Guinard, 1967: 57-68), S. Prifti (Prifti, 1959 I: 190; 1962 II 1: 181; 2: 182-322; 1971), *Fonetika dhe gramatika*

(*Fonetika*, 1976), *Gramatika e gjuhës shqipe* (Gramatika, 1997: 581-593), M. Totoni (Totoni, 2000: 98-107), apo si punime të veçanta siç është ai i albanologut austriak M. Lambertz (Lambertz, 1914-15: 163) dhe një studim gjuhësor i botuar në revistën Studime Filologjike 1969/3 e gjuhëtarit të mirënjohur shqiptar S. Mansaku (Mansaku, 1969: 153-167).

Të gjithë këta autorë, në punimet e tyre, kanë trajtuar diku më shkurt a diku më gjerësisht, çështje që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të shprehjes së raporteve kushtore.

Meqenëse gjuha është në zhvillim e në lëvizje dhe, si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve, ajo

pasurohet vazhdimisht me mjete të reja shprehëse dhe me ndërtime të reja, na duket me vend që këto të fundit t'i studiojmë nga ana gjuhësore në aspektin për të cilin interesohemi.

Në punim, për efekt të nëtyrës së aktivitetit në të cilin kumtohet dhe për arsye botimi, nuk do të trajtohen të gjitha mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore. Ne jemi përpjekur të përmbledhim më kryesoret dhe më të rëndësishmet prej tyre.

1. Mjetet dhe format e shprehjes së raporteve kushtore

1. 1. Mjetet kryesore të shprehjes së raporteve kushtore:

1. 1 Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore kushtore,

Trajtat mënyrore e kohore të fjalisë drejtuese dhe asaj të nënrenditur kushtore dhe bashkëlidhja e këtyre trajtave;

Kushti real apo joreal, i mundshëm apo i pamundshëm.

Këto mjete, në punim trajtohen lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, sepse përdorimi i njëres apo tjetres lidhëz kushtëzon edhe bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve në fjalitë brenda në periudhë, duke marrë gjithashtu në konsideratë hapësirën e kufizuar që duhet të ketë punimi. Shpjegimet për llojin e lidhëzave dhe të shprehjeve lidhëzore, duke i krahasuar si për nga terminologjia e përdorur nga autorë të ndryshëm, në periudha të ndryshme kohore, ashtu edhe nga evolucionin e tyre nga një gramatikë në tjetrën apo nga një autor në tjetrin janë shoqëruar, në shumicën e rasteve nga shpjegimet e shembujve të dhënë, në lidhje me kontekstin apo në raportin që mjetet lidhëse vendosin me trajtat mënyrore dhe kohore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë.

1.1.1 Periudhat me fjali të nënrenditur me lidhëzën *në* dhe variantet e saj *n`*, *për në*, *ndë*

Me prejardhjen e lidhëzës *në* është marrë M. Lambertz (Lambertz, *përkth. nga V. Dashi*, IGJL A-8 Sintaksa: 1), i cili, pasi e cilëson si "lidhësi hipotetik që përdoret më shumë se të gjithë në

gjuhën shqipe", sjell edhe përpjekjet e G. Meyer-it që e identifikon këtë lidhëz me parafjalën "*ndë (në)*" dhe ato të H. Pedersen-it që e mendon *në* të formuar nga *të* pa lidhje me parafjalën. Me sa duket, vetë Lambertz-i, përkrah mendimin që *në* ka origjinë parafjalore gjë që duket kur ai vë në dukje ndryshimet ndërmjet parafjalës *në* dhe pjesëzës *të*, si në pozicionet në të cilat ato gjenden, ashtu edhe në përdorimin e tyre. Duke bërë paralelizmin me disa lidhëza të tjera, për të cilat shpjegon prejardhjen nga greqishtja, ai e përforcon mendimin për lidhëzën *ndë*: "...prandaj konjucionet e greqishtes *este* dhe *ente* që përdoren me kuptimin temporal pa relativin... të cilat bazën e kanë ke prepozicionet dhe janë zhvillue ma gjatë prej tyre...janë paralele krejt identike për *ndë* tonë dhe kanë ardhë nga një epokë më e re e gjuhës, sikundër duhet që ta pranojmë edhe për *ndë*." (Lambertz, përkth. nga V. Dashi, IGJL A-8 Sintaksa: 4).

Ne kemi konstatuar nëpërmjet shembujve të vjelë se fjalitë kushtore me lidhëzën *në* shprehin një kusht të mundshëm, të dëshirueshëm ose thjesht një supozim. Ato janë të mbarë gjuhës, të të gjitha stileve, por mbizotërojnë në stilin e letërsisë artistike. Janë të rralla në stilin publicistiko-shkencor. Në poezi ndeshen shpesh, sepse vetë folja në mënyrën dëshirore me të cilën e gjejmë më shpesh të shoqëruar në fjali, është më e përshtatshme për të shprehur ngjyrimet emocionale, por këtë përdorim e lehtëson edhe struktura njërrokëshe e lidhëzës.

Lidhëza *në* dhe varianti i saj dialektor *ndë* ose në formën e apostrofuar *n`* (*per n`*) në materialin praktik të vjelë, na del me një bashkëlidhje të larmishme formash kohore dhe mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në përbërje të frazës kushtore: *Ndë tunden këmbët, tunden dhëmbët*. (Kalabri, Itali, *Fjalë të urta*: 135); *Gjarprit ke t`i biesh ndë kryet, ndë do t` e vrash*. (Kalabri, Itali, *Fjalë të urta*: 80);

Por n`je i armve e n`je shqyptar, / E per n`je ndopak bujar,

Xir tagân e n`kjoftë givkue, / N`bejleg kryet shkurtoma mue. (Fishta, *Lahuta, Preja*: 29).

Në fjalinë e nënrenditur mund të kemi kohën e *tashme të mënyrës dëftore*, kurse në fjalinë

kryesore folja mund të jetë në mënyrën urdhërore: **Në do ujë, prit radhën aty ku je.** (Kuteli “Qetësi përpara fërtyme”: 287).

Në fjalinë e nënrenditur folja mund të jetë në të kryerën e dëshirores, kurse në fjalinë kryesore është në të ardhmen e dëftores: **Në e pastë nisur prapsht, qe, prapsht do ta mbarojë.** (R. Qosja, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*: 199).

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, në fjalinë kryesore folja është në kohën e tashme të mënyrës lidhore që ka kuptimin e dëshirores: **Në daltë djalë, të na rrojë/ në daltë çupë, të të rronjë.** (Fjalë të urta: 273).

Kur në fjalinë e nënrenditur folja është në të tashmen e dëshirores, në fjalinë kryesore kemi një kallëzues të përbërë që shpreh domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi:

Gruaja e nerashme, **në dash** me të metë, ma së pari i nerashëm, **duhet me kanë** vetë. (Kosovë, *Fjalë të urta*: 333).

Ka ndonjë periudhë në të cilën marrëdhëniet kushtore ndërmjet fjalive fitojnë një nuancë lejore gjë që favorizohet edhe nga mungesa e bashkëlidhjes së qartë të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë: **Në** s’të jep një zamzan, pa një shishe nuk të lë. (Kuteli, *Fshati im Vëll. II*: 270).

1.1.2 Periudha me fjali të nënrenditru kushtore me lokucionin lidhëzor në qoftë se/në qe(kje) se

Lokucioni lidhëzor **në qoftë se** është i ndërtuar nga forma foljore e kohës së tashme të mënyrës dëshirore të foljes jam e pozicionuar mes dy lidhëzave nënrenditëse njëra kushtore – **në** dhe tjetra fthilluese – **se**.

Me lidhëzën **në qoftë se** përdoret mënyra dëftore dhe ajo kushtore, por, siç do ta shohim nëpërmjet shembujve, gjejmë të përdorur edhe mënyrën habitore, lidhore dhe urdhërore. Periudhat me fjali të nënrenditur me lokucionin kushtor **në qoftë se** përdoren në të gjitha stilet letrar-artistik, administrativo-juridik (nëpër formulime ligjesh apo nenesh), publicistikoshkencor (siç janë fjalitë kushtore të mirëfillta)

Në të dyja fjalitë kemi kohën e tashme të mënyrës dëftore: Atëherë pse më sjell rrotull, në qoftë se e di? (I. Kadare, *SPIRITUS*: 219).

Në fjalinë e nënrenditur folja është në mënyrën kushtore, kurse në fjalinë kryesore në të ardhmen e dëftores: Atë ditë më tha se, **në qoftë se do ta tradhetoja, do të më vriste me njëren nga ato armët e vjetra të tmerrshme që shikoja atje.** (I. Kadare, *Përbindëshi*: 13).

Në fjalinë e nënrenditur kemi një kallëzues të përbërë që shpreh mundësinë e kryerjes së veprimit, kurse në fjalinë kryesore kemi foljen në kohën e tashme të kushtores në formën joveprorë: **Kështu mund të dukej, madje kjo ëndërr mund të mos lindte kurrë, në qoftë se nuk do të nxirrej nga një shembull.** (I. Kadare, *Lamtumira e së keqes tek “Ëndërr mashtruese”*: 110).

Në ndonjë shembull kemi hasur fjalinë drejtuese jo në formën mohuese, por në formën e një pyetjeje retorike, e cila e shpreh dyshimin e autorit në formë qortimi a këshille, që përfundon në fjalinë e nënrenditur kushtore:

Si mund të lulëzojë sheshi i atdheut të përbashkët që është bota, **në qoftë se** njerëzit nuk grupohen në një mënyrë a në një tjetër për të lëruar çdo grup një copë të dheut? (F. Konica, *Vepra*: 281).

Pamundësia e realizimit të veprimit mund të shprehet edhe me kohën e tashme të kushtores, e cila përsëri është pjesë e fjalisë së nënrenditur dhe ka përgjegjëse të saj në fjalinë kryesore një folje në kohën e kryer të kushtores. Edhe në këtë shembull supozimi mbetet i pavërtetuar, sepse autori jep zgjidhjen e çështjes menjëherë pas përfundimit të periudhës me fjali të nënrenditur kushtore: **Në qoftë se Besniku nuk do të nisej nesër jashtë shtetit, ai do të kishte shkuar tani në kafe për t’u treguar shokëve me hollësi procedurën e rrezatimit. Por Besniku do të nisej nesër.** (I. Kadare, *Dimri i vetmisë së madhe*: 82).

Lokucionin **në qoftë se** e kemi gjetur edhe në variantin dialektor **n`kjoftë se**:

Zoti mirë ka m`e punue,

N`kjoftë se besen s`kemi Ishue. (Fishta, *Lahuta e Malcis*, Marash Uci: 137).

Një tjetër lokucion lidhëzor kushtor i ndërtuar me të njëjtat lidhëza fthilluese, por me kohën e kryer të thjeshtë të foljes jam është edhe **në qe(kje) se Per n`kje imend se i ká rá n`krye**

Kufijt t`onë me i shkapercyë

N`Traboinë Gjetja le t`dalë

Ded Gjo Lulit me i çue fjalë. (Fishta, *Lahuta e Malcis*: 146).

1.1.3 Periuha me fjali të nënrenditur me lidhëzën kushtore nëse

Lidhëza **nëse** është një bashkim i dy lidhëzave **në** dhe **se** që në origjinë janë ffilluese dhe që përdoren edhe si të tilla, edhe të bashkuara, si kushtore dhe ffilluese. Kjo formë e përmbledhur e lokucionit **në qoftë se** ose **në është se** përdoret me të gjitha kohët e mënyrës dëftore dhe me mënyrën kushtore.

Ndërtimet me lidhëzën kushtore **nëse** janë më pak të përhapura. Struktura dhe kuptimi thuajse i njëjtë me fjalitë e nënrenditura me lidhëzën **në qoftë se**, bëjnë që edhe shtrirja stilistike e tyre të jetë e njëjtë me tipat e fjalive të nënrenditura me lidhëzën kushtore **në qoftë se**. Në pjesën më të madhe të rasteve fjalitë me lidhëzën **nëse** i gjejmë me përdorimin e kësaj të fundit si lidhëz ffilluese në bashkimin e fjalive drejtuese me fjali të nënrenditura kundrinore ose kryefjalore.

Bashkëlidhja e foljeve të fjalive në periudhë është e rrafshit të së tashmes si në shembullin më poshtë: **Nëse** më premtton se nuk hyn kurrë mbrendë, po të lëshohem njetash ndër duer. (Camaj, *Vepra 5*: 136);

Kemi gjetur gjithashtu një bashkëlidhje; e kryer e dëftores në të nënrenditurën dhe e tashme e dëftores në formën joveprorë në fjalinë drejtuese. Në këtë shembull kushti i vendosur në fjalinë e nënrenditur është i shoqëruar edhe me pjesëzën vetëm që e bën kushtin më të kufizuar dhe për rrjedhim edhe pasojën më të varur prej realizimit të tij: Prapë ndigjova mbramë prej tim et se bleta, qoftë ajo e egër apo e butë, përkitet, vetëm **nëse** ka ngulë në zgurë lisi. (Camaj, *Vepra IV*: 187).

1.1.4 Periuhat me fjali të nënrenditur, fjalitë përbërëse të të cilave bashkohen me lokucionin lidhëzor **në është se**, i cili është ndërtuar nga forma foljore e kohës së tashme të foljes *jam* e vendosur mes dy lidhëzave nënrenditëse përkatësisht e para kushtore dhe e dyta ffilluese, kanë të njëtin kuptim dhe strukturë si ndërtimet me lokucionin lidhëzor **në qoftë se**. Dallimi ndërmjet tyre qëndron në ndërtimin e mjetit

lidhës dhe në bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë.

Ato kanë një shtrirje më të kufizuar në përdorim dhe janë karakteristikë më tepër e gjuhës së folur. Që nga ndërtimi i lokucionit që ka në përbërje kohën e tashme, në ndryshim nga lokucioni **në qoftë se** me të cilin bëmë paralelizmin, mund të konstatojmë se ndërtimet me të nënkuptojnë vënien në dyshim të veprimit që mund të realizohet ose jo në çastin që flet folësi: **Në është se** na jep argumente bindëse në lidhje me këtë çështje, po e dëgjojmë me kënaqësi edhe vazhdimin e arsytimit të çështjeve të tjera. (Bisedore).

1.1.5 Periuha me fjali të nënrenditur me lokucionin lidhëzor në rast se

Ky lokucion lidhëzor është i ndërtuar nga emri **rast** në trajtën e pashquar në rasën kallëzore, i prirë nga parafjala e rasës kallëzore **në** dhe i ndjekur nga lidhëza ffilluese **se**. Edhe fjalitë me **në rast se** përdoren me mënyrën dëftore dhe me atë kushtore. Shtrirja stilistike e periudhave fjalitë e të cilave bashkohen me këtë lokucion, përfshin stilin publicistiko-shkencor, atë letrar-artistik në gjuhën e shkruar, por ato kanë filluar të përdoren edhe në gjuhën e folur si rezultat i ndikimit të gjuhës letrare. Në pjesën më të madhe të rasteve fjalitë me **në rast se** përdoren në vend të fjalive me **në qoftë se**, me të cilat afrohen edhe nga struktura dhe bashkëlidhja. Por fjalitë e nënrenditura kushtore të ndërtuara me lokucionin **në rast se**, nga vetë ndërtimi i lidhëzës, e kanë të shprehur më qartë supozimin, dyshimin për realizimin e kushtit, rastësinë e vërtetimit të tyre. Ne kemi përzgjedhur disa raste bashkëlidhjeje të cilat do t'i sjellim nëpërmjet shembujve të vjelë nga materiali praktik, sidomos në vepra letrare të stilit artistik: **Në rast se** bie shi, asnjeri s' ka për të parë gjë dhe ushtarët duhet të kthehen në palestër. (Buxheli, *Karrjera e zotit Maksut*: 59).

1.1.6 Periuha me fjali të nënrenditur me lidhëzën kushtore po

Fjalitë me lidhëzën **po** ndërtohen me mënyrën dëftore dhe me lidhoren, rrallëherë, për qëllime afektive, edhe me lidhore-habitorën.

E pakryera e mënyrës lidhore në fjalinë e nënrenditur mund të ketë përgjegjësi në fjalinë kryesore një kallëzues të përbërë që shpreh mundësinë e kryerjes së veprimit, të ndërtuar me foljen gjysmëndihmëse *mund* dhe formën dialektore të mënyrës lidhore:

Por tash shtati i përqetëj, kur mendonte se shokët, *po ta dinin sekretin e tij, mund e merrnin nëpër gojë emrin e krijesës së adhureshme*. (E. Koliqi, *Hija e maleve*).

Gjithë ndërtimi, që përfaqëson kallëzuesin e përbërë, në trup të të cilit dallojmë gjithashtu edhe trajtën e shkurtër që, për shkak të mungesës së pjesëzës të të lidhore, nuk ka formuar, siç do të kishte ndodhur në rast të pranisë së saj, trajtën e bashkuar në paralelizëm me atë të fjalisë së nënrenditur; ka synimin t'i afrohet paksa "së mundshmes", sepse kushti, nga bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore, është i pamundshëm. (Fatmirësisht ata nuk e dinin sekretin e tij!) Kjo psherëtimë do ta kishte lehtësuar këdo, në një rast të tillë.

1.1.7 Periudhat me fjali të nënrenditur me lidhëzën *po që*

Te Naim Frashëri kemi gjetur edhe një periudhë kushtore të mundësisë ku fjalia drejtuese dhe e nënrenditura bashkohen ndërmjet tyre me lidhëzën *po që* një lidhëz e përmendur edhe nga M. Domi (Domi, 1971: 112), i cili, në nëndarjen për lidhëzat, pas lidhëzave, *në, (për në në veri), nëse, po*, sjell edhe lidhëzën *po që*.

Në shembullin e mëposhtëm, autori, nëpërmjet kushtit të vendosur në fjalinë e nënrenditur, premtion ndihmën e tij ndaj kujt do që e dëshiron atë: *Po që u bëre i urtë, mua më ke afër teje*. (N. Frashëri, *Vepra I*: 34).

Bashkëlidhja e rrafshit të së ardhmes që ndërtohet nga bashkëveprimi i foljes së fjalisë së nënrenditur që këtu është në kohën e kryer të thjeshtë të përdorur me kuptimin e së ardhmes (po të bëhesh i urtë në të ardhmen) dhe folja e fjalisë kryesore që paraqitet në kohën e tashme me kuptimin e së ardhmes (do të më kesh afër teje), e jep kushtin si të mundshëm me veprime që pasojnë njëri-tjetrin në kohë pasoja vjen pas realizimit të kushtit.

1.1.8 Periudha me fjali të nënrenditur me lokucionin lidhëzor *po që se*

Ky lokucion lidhëzor është ndërtuar nga folja jam në vetën e tretë në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, e vendosur mes dy lidhëzave: ajo që i paraprin kushtore dhe ajo që e pason ftilluese. Koha e foljes në përbërje të lokucionit, meqenëse i referohet një çasti të përcaktuar mirë të së shkuarës, mbart me vete dyshimin për një ngjarje që duhet të ketë ndodhur para se ndërtimit *po që* t'i ngjitet lidhëza ftilluese *se*. Pra pasi të jetë vërtetuar se "puna që kështu si paraqitet në realitet", dyshimi në fjalinë drejtuese "venitet" duke i hapur rrugë realizimit të veprimit të shpresuar për t'u realizuar.

Fjalitë me *po që se* ndërtohen me mënyrën dëftore dhe më rrallë me kushtoren: *Po që se nuk do njerinë, s'je njeri*. (N. Frashëri, *Vepra III*: 54); *Po që se vjen, edhe hisen time ia dhashë*. (M. Camaj, *Vepra V*: 32).

Në veprat e autorëve gegë kjo lidhëz gjendet me variantin *po kje se*:

Flamri kombtar nuk ka shka bân nder në

Po kje se dashtuni nuk kem` p`r Atdhé! (Fishta, *Mri i zanavet*: 108); *Po që se e zeza e flokëve nuk do të kishte genë e fortë njëlloj me atë të syve dhe të vetullave, ai mund edhe të pranonte se ishin të lyer*. (F. Kongoli, *Karuseli*: 15).

Periudha me bashkëlidhje të tillë: e kryer e kushtores në fjalinë e nënrenditur dhe e pakryer e lidhore me foljen gjysmëndihmëse *mund*, ndeshen më rrallë dhe kushti që paraqitet i pamundshëm si pasojë e kësaj bashkëlidhjeje, sikur "zbutet" paksa nga folja *mund* që shtie në fjali modalitetin e mundësisë, por njëjtësia e ngjyrës së flokëve me atë të syve dhe të vetullave, nuk lë asnjë mundësi për realizimin e veprimit të fjalisë kryesore të pranimit të faktit joreal të lyerjes së flokëve.

1.1.9 Po të jetë se, po të jetë që janë dy lokucione lidhëzore me përdorim të kufizuar në periudha me fjali të nënrenditura kushtore. Që në pamje të parë vëmë re që dallimi qëndron në ndërtimin e tyre: lidhëza *po* në dy lokucionet e fundit vendos lidhje me foljen *në kohën e tashme të mënyrës lidhore* dhe me lidhëzat ftilluese *se* ose *që*. Kuptimi i kohës së tashme të mënyrës

lidhore është të tregojë një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqit si të mundshme ose të dëshirueshme. Vetë lokucioni përmban në vetvete, përveç supozimit, edhe shpresën *për të mundshmen* që përfshin periudhën kohore që nga çasti që flasim e më tej.

Prej këndeje rrjedh se foljet me të cilat vendosin lidhje këto lokucione janë më të kufizuara. Ato i përkasin vetëm mënyrës dëftore.

Periudhat me fjali kushtore me **po të jetë se** e kanë foljen kallëzues zakonisht në kohën e *tashme të dëftores*, si edhe në këtë shembull, kurse në fjalinë kryesore folja është në kohën e ardhme në mënyrës dëftore e shprehur me një ndërtim dialektor ku *trajta e shkurtër e kundrinorit të zhdrejtë* e vetës së dytë i është paravendosur *paskajores së foljes* them (ka për të të thënë = do të të thotë). Kushti i mundshëm bëhet i qartë nëpërmjet kësaj bashkëlidhjeje që shpjeguam.

1.1.10 Periudha me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën kohore *si*

Gjatë vjeljes së materialit praktik vumë re se kishte disa ndërtime periudhash me fjali të nënrenditura kushtore, të cilat si mjet lidhës kishin lidhëzën **si** sinonimike me lidhëzën **po** dhe të njëjtën bashkëlidhje kohore e mënyrore me atë të fjalive që bashkohen me këtë lidhëz. Kështu bashkëlidhja mund të jetë:

-e rrafshit të së tashmes: Në të dyja fjalitë foljet janë në kohën e tashme, në të nënrenditurën në të tashmen e lidhore, kurse në kryesoren në atë të dëftores: **Si të ia hjeksh** strajcën kalit, **t'i kthen** shkemat. (Drenicë-Kosovë, *Fjalë të urta*: 313);

-e rrafshit të së shkuarës: *e pakryer e mënyrës lidhore në të nënrenditurën, e kryer e mënyrës kushtore në formën dialektore në fjalinë kryesore: Si të isha* në vend të të panjoftunit, tue e pa aq të idhët, as unë nuk *kisha me ia sjellë fjalën*. (Camaj, V: 117).

Kjo lidhëz në fjali të tilla nënrenditëse kushtore shoqërohet edhe nga forma e pashtjelluar paskajore geqe që përdoret në vend të mënyrës lidhore këtu konkretisht në vend të së pakryerës së lidhore: **Si mos me pasë** frigë se e lëndoj, *kisha me e hapë* derën e *kisha me e shty* me gjithë karrocë mbrendë. (Camaj, *Vepra V*: 149).

1.1.11 Periudha me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën *sikur*

Lidhëza **sikur** e ndërtuar nga përngjitja e dy lidhëzave të thjeshta njëra mënyrore **si** dhe tjetra kohore **kur** e cila përdoret për të bashkuar fjali të një periudhe me nënrenditje mënyrore, përdoret edhe për të bashkuar fjali të nënrenditura kushtore me fjali drejtuese në një periudhë me fjali të nënrenditur kushtore. Fjalitë e nënrenditura që bashkohen me drejtuesen me lidhëzën **sikur**, të cilat e tregojnë mënyrën e shtjellimit të veprimit të fjalisë drejtuese me anë të një krahasimi me një veprim të supozuar, në dallim nga fjalitë kushtore që bashkohen me drejtuesen me këtë lidhëz dhe ndërtohen me lidhoren ose me lidhore-habitorën, ndërtohen me mënyrën dëftore dhe lidhore.

Bashkëlidhja mund të jetë e rrafshit të së tashmes; Folje në të tashmen e mënyrës lidhore në fjalinë e nënrenditur dhe folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore në fjalinë kryesore: **Sikur të mos e ndalë turpi, mendonte ai, Jera tash më del përpara dhe më tregon**. (Camaj, *Vepra IV*: 190).

Bashkëlidhja mund të jetë e rrafshit të së shkuarës, duke filluar që nga *e pakryera e mënyrës lidhore*. Në fjalinë e nënrenditur të shembullit që do të shohim më poshtë, folja është në të pakryerën e mënyrës lidhore dhe, në të bashkërenditurën me të, që vjen menjëherë pas saj dhe të dyja janë të paravendosura ndaj kryesores, folja është në të ashtuquajturën "*formë joletrare*" të së pakryerës së mënyrës lidhore (shënimi 2 te Morfologjia, 1995: 325). Të dyja këto forma foljore kanë përbri në fjalinë kryesore një folje në kohën e tashme të mënyrës kushtore: **Sikur të mos ishin hidhërimet e djemve ushtarë, pra sikur të mos qe ai dëshpërim, Hankonatët do të kishin ca vite të qeta**. (I. Kadare, *Breznitë e Hankonatëve*: 101); **Ai do të kishte kthye në vend andej kah kishte ardhë, sikur të mos ish dukë në një ballkon guri grueja e veshun në zi...** (Camaj, *Vepra IV*: 237).

Veprimi i pamundshëm shprehet në periudhën e mëposhtme me bashkëlidhjen; *e kryer e mënyrës kushtore* në fjalinë kryesore, *më se e kryer e mënyrës lidhore* në të nënrenditurën. Veprimin e

mundshëm -mendojmë ne- që do të kryhej menjëherë, të shprehur me anë të rrethanorit të kohës të shprehur me emrin me parafjalë -në vend-, që, në fakt, ka kuptimin menjëherë, në çast, e pengoi dalja në ballkon e një gruaje me të zeza.

1.1.12 Periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me lokucionin lidhëzor *me kusht që*

Edhe ky lokucion si edhe *në rast se*, ndërtohet nga emri *kusht* në trajtën e pashquar në rasën kallëzore, por ai prihet nga parafjala e rasës kallëzore *me* dhe ndiqet nga lidhëza ffilluese *që*. Një e veçantë tjetër përveç asaj që do ta shohim edhe më poshtë në lidhje me kuptimin më të theksuar kushtor për shkak të emrit në përbërje të lokucionit që ka një përmbajtje leksikore tërësisht të përcaktuar qartë, që shprehin fjalitë e nënrenditura të prira nga ky lokucion e për rrjedhim edhe periudhat e ndërtuara me to, është edhe fakti që trajta e pashquar e këtij emri mund të shndërrohet lehtësisht në trajtë të shquar, duke e bërë më të qartë që kushti është një dhe i vetëm: përmbajtja e fjalisë drejtuese që i paraprin së nënrenditurës.

Fjalitë *me kusht që* ndërtohen me mënyrën lidhore: *Shkaba të çon fluturim atje ku do, me kusht që gjatë gjithë rrugëtimit t'i japësh copa nga trupi yt...* (I. Kadare, *Shkaba*: 62).

Me të njëjtin funksion, por me një shtrirje më të kufizuar, përdoret edhe lokucionin lidhëzor *me konditë që*. I ndërtuar njësoj si i mësipërmi me emrin në trajtën e pashquar në rasën kallëzore të prirë nga e njëjta parafjalë e rasës kallëzore dhe të pasuar nga e njëjta lidhëz nënrenditëse ffilluese me kuptim të përgjithshëm, ai bashkon në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore fjalinë e nënrenditur me drejtuesen duke shprehur kushtin nëpërmjet sinonimit të tij në të shprehur e rrallë në të shkruar. Edhe në rastin e këtij lokucionit, vënia e emrit në trajtë të shquar pa prekur rasën, nuk shkakton ndryshime në strukturën e fjalisë, por e bën më të përcaktuar kushtin që duhet të plotësohet në fjalinë e nënrenditur për t'u arritur realizimi i pasojës në fjalinë drejtuese: *Atëherë do t'i japim një apartament dy dhoma e një kuzhinë, me konditë*

që të shkojë ku të dojë vjehrra. (Nga filmi "Zonja nga qyteti").

1.1.13 Periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me lokucionin lidhëzor *mjaft që*

Ky lokucion lidhëzor është ndërtuar me një ndajfolje sasive *mjaft* dhe lidhëza ffilluese *që*. Në pamje të parë, por edhe duke u përpjekur ta zëvendësojmë këtë ndajfolje me foljen *mjafton* që formohet duke e përdorur si rrënjë atë:, duket sikur lokucionin është i ndërtuar nga forma e shkurtuar e foljes në fjalë. Në shumicën e ndërtimeve me shprehjen *mjafton që*, e cila mund të shërbejë edhe si lokucion lidhëzor kushtor duke e shqiptuar me intonacionin e duhur dhe duke e parë përmbajtjen e periudhës në tërësi, kjo shprehje ngjason më tepër me një vazhdim periudhe ku folja *mjafton* në kohën e tashme të mënyrës dëftore shërben si fjali drejtuese për fjalinë e nënrenditur ffilluese që fillon me lidhëzën ffilluese *që*, e cila në këtë rast nuk mund të konsiderohet pjesë e lokucionit. Duhet bërë këtu dallimi ndërmjet ndërtimeve me lokucionin lidhëzor *mjaft që* dhe *mjafton (te) që*. Të parat shfaqin raporte kushtore, kurse të dytat jo gjithmonë. Folja që i prin lidhëzës që në fjali të tilla, përfaqëson një fjali drejtuese për fjalinë e nënrenditur kryefjalore që bashkohet me të me lidhëzën ffilluese *që*, në shumicën e shembujve ku raportet kushtore nuk dalin qartë me anë të kësaj lidhëze shprehen më shumë raporte ffilluese. Në gjuhën e folur nuk janë të rralla rastet kur me lokucionin *mjafton që* (ku ndajfolja e sasisë *mjaft* është zëvendësuar nga një folje në kohën e tashme me përdorim të kufizuar në vetë) *mjafton*, raportet kushtore të dalin mbi ato ffilluese: *Do të vij patjetër në dasmën tënde, mjafton që të më lajmërosh disa ditë para që të marr leje nga puna dhe të bëj përgatitjet e duhura.* (Bised).

1.1.14 Periudha me fjali të nënrenditur kushtore me lidhëzën kohore *kur*

Fjalitë kushtore me lidhëzën kur e kanë foljen-kallëzues në të tashmen e mënyrës dëftore dhe lidhore ose në të ardhmen e mënyrës dëftore:

Perse nipave t'Kastrjotit,

kur t'jen lidhë me besë të Zotit,

s`ka shka u bân flaka e barotit. (Fishta, *Lahuta e Malcis, Te ura e Rrzhanicës*: 154).

Bashkëveprimi i foljes në kohën e kryer të mënyrës dëftore të fjalisë së nënrenditur me ndërtimin foljor *s`ka shka u bân* që ka kuptimin mbarëkohor: nuk u bën dot gjë asnjëherë; i japin periudhës më tepër kuptim *kushtor* se sa tregojnë kohën e kryerjes së një veprimi. Kushti i shprehur në fjalinë e nënrenditur është i realizueshëm (*në qoftë se janë lidhur me besë të Zotit*) dhe po ashtu edhe pasoja (*do të jenë të pamposhtur, as flaka e barotit s`ka ç`u bën*) Populli të mbron, por, kur ia *ke me hile, s` të fal.* (D. Agolli, *Dështaku*: 255).

E përgjithësuar në emër të popullit, kjo ka vlerë për këdo që kërkon të përfitojë në kurriz të tjetrit. Ashtu si fjalët e urta, edhe kjo periudhë me bashkëlidhje kohore të së tashmes me vlerë mbarëkohore synon të sjellë mesazhin e një veprimi të mundshëm, të realizueshëm, duke mbajtur parasysh që është një ndodhi reale që është bërë shkas për nxjerrjen e kësaj maksime: *Ironija asht një "forma mentis", asht trajtë, asht stil. Kur nuk asht e shoqnueme me fantazi krijuese, ajo mbetë në planin e fragmenteve të vijosjevet të shpejta, "essai" a përshtypje të rasës.* (Gazeta shqiptare, suplementi *Milosao*, A. Pipa: *Faik Konica-aristokrat edhe kur shau...*, studimi f.VII, e diel 17 gusht 2008).

Këpuja e kallëzuesit emëror në fjalinë e nënrenditur vendos lidhje me foljen në kohën e tashme të mënyrës dëftore në fjalinë drejtuese dhe plotësimi i kushtit të *moshoqërimit të ironisë me fantazinë krijuese*, sjell për pasojë realizimin e veprimit të fjalisë drejtuese që tregon se nuk arrihet të shprehet qartë ajo që ka synuar të shprehë shkrimtari që e përdor ironinë si figurë letrare në stilin e vet të të shkruarit.

1.1.15 Periudhat me fjali të nënrenditur kushtore me përemrin lidhor të pacaktuar kush

Në fjalitë me përemrin lidhor të pacaktuar *kush* shprehen marrëdhënie kushtore me anë bashkëlidhjes së foljeve në rrafshin e së tashmes ose të së ardhmes: në fjalinë e nënrenditur kemi foljen *në kohën e tashme* (të dëftores ose të

lidhores) ose *në të kryerën e thjeshtë*, kurse në fjalinë kryesore folja është *në të tashmen, në të ardhmen* ose në kohën e kryer të dëftores:

Kush të muntnjë shqipëtarët

E Skënderbenë ta zërë

Nga të gjithë ju të parët

Punë të madhe ka bërë. (N. Frashëri, *Vepra IV*: 260).

Këta tipa fjalish që, në të vërtetë, janë fjali të nënrenditura kryefjalore, kuptimin kushtor e realizojnë nëpërmjet përgjithësismit që del jo vetëm nga kuptimi i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i përemrit lidhor *kush*, por edhe nga kuptimi i foljeve të fjalive drejtuese dhe të nënrenditur të cilat janë, përgjithësisht në kohën e tashme mbarëkohore.

Në fjalitë drejtuese të pasvendosura të këtyre ndërtimeve përmbahet pasoja herë e drejtpërdrejtë, herë e tërthortë e ardhur si rezultat i plotësimi të kushtit të vendosur në fjalinë me lidhorin e pacaktuar *kush*. Në periudha të tilla, ashtu siç është trajtuar më parë edhe nga autorë të tjerë (S. Prifti, pj. II, D. II, 1968:258-259; S. Floqi, 1965/4: 19-23; S.Mansaku,1969/3:162) bie në sy shprehja e marrëdhënieve kusht-pasojë ose shkak-pasojë të cilat favorizohen edhe nga brendia e periudhave, edhe nga e tashmja mbarëkohore, kohë në të cilën i gjejmë të përdorura më shpesh foljet e fjalive kryefjalore që shprehin raporte kushtore. Këto përgjithësime teorike vërtetohen, kur foljet vendosen në të kryerën e thjeshtë dhe veprimet që u janë "ngarkuar" nga folësi foljeve të fjalive të periudhës paraqiten si fakte konkrete që kanë ndodhur në një çast të caktuar të së shkuarës dhe jo si ngjarje që supozohen të ndodhin.

1.1.16 Periudhat me fjali të nënrenditura kushtore jolidhëzore të ndërtuara me mënyrën lidhore

Në këto tipe periudhash fjalitë në periudhë bashkohen pa lidhëza. Fjalina e nënrenditur fillon me mënyrën lidhore, e cila, për nga modalitetet që shpreh: të mundësisë, të dëshirës dhe të detyrimit, është e vetëmjaftueshme për të realizuar kuptimin kushtor. Shembujt si në gjuhën

e shkruar, ashtu edhe në atë të folur janë të konsiderueshëm. Përdorimi i lidhëzës nuk është i detyrueshëm, ai është fakultativ dhe mund të shtohet, nëse dëshirojmë, pa prishur as rendin e fjalive, as kuptimin e tyre në periudhë. Këto tipare të veçanta, si edhe ndonjë lidhëz më tepër si lidhëza *në* që shkon me mënyrën dëshirore, (veç *në qoftë se* dhe *po* që mund të përdoren te të ty tipat e periudhave në fjalë), që mund të vendoset ndërmjet fjalisë drejtuese dhe asaj të nënrenditur te periudhat me nënrenditje palidhëzore (asindetike) i dallojnë tipin e periudhave jolidhëzore nga periudhat asindetike. Ashtu si në të gjitha rastet e analizuar për periudhat me fjali të nënrenditura kushtore lidhëzore me lidhëzat e sipërpërmendura, bashkëlidhja është e rrafshëve të ndryshme. Është pikërisht ajo që luan një rol tepër të rëndësishëm në përcaktimin e llojit të kushtit që mund të jetë i mundshëm ose i pamundshëm për t'u realizuar.

*Të isha turk edhe unë,
Ta kisha zëmërën kllirë,
Sot u bënja tjetër punë.*

Nuk u flisja me të mirë. (N. Frashëri, *Vepra IV*: 99).
Bashkëlidhja e rrafshit të së shkruarës: *e pakryer e lidhore* në të nënrenditurën dhe *e pakryer me vlerën e së tashmes së kushtores* në fjalinë kryesore, e paraqet veprimin të pamundshëm për t'u realizuar edhe për faktin që flitet për gjëra joreale, cilësi që nuk zotërohen nga folësi dhe pra nuk mundësojnë realizimin e pasojës në fjalinë kryesore.

(A më sheh ti mua plaknë?)

*Të qënkështa si ti djalë,
Muratit i pinja gjaknë.*

(Sot s'gënjeshta me fjalë) (N. Frashëri, *Vepra IV*: 82).

Fjalja pyetëse me të cilën fillojnë vargjet e mësipërme na jep një fakt real dhe shërben si kontekst për periudhën me fjali të nënrenditur kushtore që vjen pas saj. Supozimi për pasjen e një moshe të njëjtë a të krahasueshme me atë të bashkëbiseduesit, i shprehur me të pakryerën e së ashtuquajturës *mënyrë lidhore-habitore*, është plotësisht i pamundshëm për t'u realizuar, sepse jemi njohur tashmë me moshën e vërtetë. Për

pasojë veprimi në fjalinë kryesore i përfaqësuar nga folja në të pakryerën e mënyrës dëftore që ka vlerën e së tashmes së kushtores, është i përealizueshëm.

PËRFUNDIME

Në punim janë trajtuar vetëm dy çështje nga rubrika e gjerë, ajo e mjeteve dhe formave të shprehjes së raporteve kushtore. 1. Mjetet e shprehjes së raporteve kushtore që janë lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore kushtore dhe 2. 2 nga format jo të zakonshme të shprehjes së raporteve kushtore a. Periudhat me fjali të nënrenditura kushtore jolidhëzore që fillojnë me folje në mënyrën lidhore; b. Rrethanori i kushtit. Shumë shkurtimisht janë numëruar dhe shoqëruar me së paku nga një ose dy shembuj, secili prej mjeteve lidhëse duke i shoqëruar edhe me ndonjë shpjegim të shkurtër të mënyrës se si janë formuar ato. Këto mjete, në punim trajtohen lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, sepse përdorimi i njëres apo tjetres lidhëz kushtëzon edhe bashkëlidhjen kohore e mënyrore të foljeve në fjalitë brenda në periudhë, duke marrë gjithashtu në konsideratë hapësirën e kufizuar që duhet të ketë punimi. Shpjegimet për llojin e lidhëzave dhe të shprehjeve lidhëzore, duke i krahasuar si për nga terminologjia e përdorur nga autorë të ndryshëm, në periudha të ndryshme kohore, ashtu edhe nga evolucionin e tyre nga një gramatikë në tjetrën apo nga një autor në tjetrin janë shoqëruar, në shumicën e rasteve nga shpjegimet e shembujve të dhënë, në lidhje me kontekstin apo në raportin që mjetet lidhëse vendosin me trajtat mënyrore dhe kohore të foljeve kallëzues të fjalive në periudhë. Kurse për rrethanorin e kushtit ne jemi të mendimit që pamundësia e zëvendësimit të ndërtimit të konsideruar si rrethanor nga ndajfolja përkatëse nuk duhet të përbëjë pengesë për pranimin e ekzistencës së rrethanorit të kushtit, ashtu si nuk është vënë ndonjëherë në dyshim ekzistenca e rrethanorit të qëllimit, edhe pse nuk njihen ndajfolje qëllimi.

BIBLIOGRAFIA

- CIPO, Kostaq (1949), Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare, Tiranë;
- CIPO, Kostaq (1951), Sintaksa tekst për Institutin pedagogjik, Tiranë, botim i Ministrisë së Arsimit.
- CIPO, Kostaq (1952), Sintaksa, Tiranë, Instituti i Shkencave.
- DOMI, Mahir (1955), Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare, Tiranë.
- DOMI, Mahir (1969, 1971), Gramatika e gjuhës shqipe” Sintaksa për shkollat e mesme, Prishtinë.
- DOMI, Mahir (1971), Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë 1971
- FLOQI, Spiro (1956), Periudha e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe, BUSHT, 2, Tiranë;
- GUINARD, Emile (1967), Les propositions subordonnées dans l’albanais moderne, Thèse de Doctorat de 3-ème cycle, Directeur de recherche Monsieur le Professeur Henri Boissin, Faculté des Lettres de l’Université de Paris, Ecole Nationale des Langues Orientales Vivantes, Paris.
- LAMBERTZ, Maximilian (1914-15), Die hypothetische Periode im Albanischen, në “Indogermanische Forschungen”, vëll. 34; përkthimi në gjuhën shqipe nga V. Dashi, material i siguruar pranë IGJL.
- MANSAKU, Seit (1969), Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare: “Studime Filologjike”, Tiranë, 3: 153 – 167.
- MIKELI, Gaspër (1916), Gramatika e gjuhës shqipe, Shtypshkronja “Nikaj” Shkodër.
- PRIFTI, Stefan (1959), Sintaksa e gjuhës shqipe, pj I Tiranë.
- PRIFTI, Stefan (1962), Sintaksa e gjuhës shqipe, pj II 1; 2, Tiranë, USHT Fakulteti Histori-Filologji;
- PRIFTI, Stefan (1971), Sintaksa e gjuhës shqipe I, II mars, Rilindja, Prishtinë.
- RROTA, A. Justin (1943), Syntaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes 1942) për klasën II, III, IV të shkollave të mesme, Shkodër, shtypshkronja A. Gj. Fishta.
- RROTA, A. Justin (2006), Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore” ASHSH IGJL Botimi I, Botime Françeskane Shkodër.
- SHEPERI, Ilo Dilo (1927), Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë.
- TOTONI, Minella (1995), Cikël leksionesh të sintaksës, shënime.
- TOTONI, Minella (2000), Fraza me nënrenditje, SHBLU, Tiranë.
- X x x x (1976), FONETIKA dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa e periudhës, Tiranë.
- X x x x (1984), Fjalori i shqipes së sotme, ASHRPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- X x x x (1995), GRAMATIKA e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë.
- X x x x (1997), GRAMATIKA e gjuhës shqipe II, ASHRSH IGJL, Tiranë.
- XANONI, S. J. (1909), Gramatika shqyp qj përdoret n`seminarë e n`mbësuitoire t`sh` Françesk Saverit n`Shkodër, Shtypshkronja e Zojes Papërljeme N`Shkodër.
- XHUVANI, Aleksandër (1922), Njohunit e para të sintaksës shqipe, pjesë e parë për klasët e nalta të fillores, Vlorë.
- XHUVANI, Aleksandër (1938), Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores e për t`ultat e Shkollavet të Mesme, Tiranë.
- XHUVANI, Aleksandër (1942), Libri i gjuhës shqipe pj. II për klasat e nalta të Fillores dhe të parat e Qytetses, Tiranë. .

ECONOMICAL ASPECTS OF ELBASAN CITY AT THE END OF XIXth CENTURY AND THE BEGINNING OF XXth CENTURY

ASPEKTE EKONOMIKE TE QYTETIT TË ELBASANIT NË FUND TË SHEK. XIX E FILLIM TË SHEK. XX

ZHULJETA KADILLI

Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "A.Xhuvani",
Elbasan, ALBANIA
Email: zhkadilli@yahoo.com

AKTET IV, 4: 766 - 772, 2011

PERMBLEDHJE

Ky artikull synon të trajtojë probleme që lidhen me zhvillimin ekonomik të qytetit të Elbasanit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Artikulli shfrytëzon dokumente origjinale osmane (regjistrat e kadiut të qytetit, për vitet 1892-1908) të cilat janë përkthyer e shfrytëzuar për herë të parë për këto probleme. Nga analiza e këtyre dokumentave rezulton se zhvillimi ekonomik i qytetit ishte bazuar mbi funksionimin e esnafëve, të cilët pothuajse përfaqësonin të gjitha degët e zejtarisë. Esnafët, në këtë periudhë, për shkak të konkurrencës kishin filluar të aplikonin metoda të reja në fushën e prodhimit dhe të këmbimit. Qendra e pazarit së bashku me rrugët e tij numëronin afër 900 dyqane të esnafëve. Esnafët merreshin me prodhimin dhe shitjen e produkteve. Gjatë kësaj kohe në Elbasan kishin lindur edhe punishtet e para zejtare të cilat paraprinë ndërtimin e fabrikave të vogla.

Fjalët çelës: Elbasan, esnaf, fabrikë, konkurrencë, punishte.

1. HYRJE

Qyteti i Elbasanit është një qytet sa i lashtë dhe i ri. I lashtë, sepse ai përmendet që në shek.II, si stacion i rrugës Egnatia me emrin Skampis, që varej nga Durrësi (FESH, 1985: 232). Në dy shekujt e mëvonshëm (III-IV), del me emrin Hiskampis, kurse në shek.VI (519) na paraqitet si qendër peshkopate. Qendra ishte e rrethuar me mure, të cilat kishin tri hyrje dhe 28 kulla ndërtuar në shek.IV. Brenda mureve ndodhej katedralja, kurse jashtë saj një bazilikë në kodrat e qytetit (FESH, 1985: 232). Në shek. V (viti 458) nuk përmendet termi vikus por civitas (qytet) (FESH, 1985: 232). Në fillim të shek.VI, si rrjedhojë e pushtimit të Italisë nga perandori Justinian, rigjallërohen lëvizjet nëpër rrugën Egnatia. Gjatë kësaj kohë kalaja e Skampisit kalon në proces rindërtimi dhe qyteti merr jetë (Elbasani, 2003: 150).

Jeta urbane vazhdoi të mbijetojë në shek.VII-VIII. Sipas një dokumenti të kohës që bën fjalë mbi temën e Durrësit, thuhet: "Dyrrahiumi, që dikur quhej Epidamni, ka nën konsilje nëntë qytete si: Skampën, Apolloninë, Bylisin, Aranitanin, Beratin, Vlorën etj. (Elbasani, 2003: 150).

Në shek.IX, Skampa, pushtohet e grabitet nga dyndjet e fiseve bullgare. Pas këtij pushtimi fillon të gjallërohet jeta ekonomike, në kushtet e një ekonomie natyrore, brenda marrëdhënieve feudale. Shpesh herë është nën ndikimin e feudalëve të kohës, si Topiajt, Muzakajt, Arianitet.Gjatë shek.VII-XV, Elbasani paraqitet si një trevë me rëndësi të madhe ekonomike politike dhe kulturore dhe në ngjarjet politike ka luajtur një rol të madh, duke qenë se nëpërmjet tij kalonte Via Egnatia, ose siç quhej gjatë mesjetës, "Udha Mbret" (Demiri, 2006: 26).

Në mesin e shekullit 15 (në vitin 1466) ndodhën ngjarje të tilla politike ushtarake që kushtëzuan rindërtimin e kalasë së Elbasanit. Pas kësaj kohe kalaja do të bëhej qendra nga ku do të niste e zhvillohej me tej qyteti. Sulltani e kishte vlerësuar pozitën strategjike të qytetit të Elbasanit. Ai ishte në mes të rrugëve që lidhnin pjesët bregdetare me vendet në thellësi të Ballkanit, Shqipërinë e veriut me atë të Jugut.

Shekulli XVII shënon për qytetin e Elbasanit një moment të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik gjë që do të vazhdojë edhe më tej ndonëse me oshilacione. Megjithatë pavarësisht nga luhatjet një gjë është e sigurt se Elbasani tashmë kishte hyrë në rrjedhën e zhvillimit.

2. Tiparet e zhvillimit ekonomik

Në fund të shek.XIX e fillim të shek.XX, qyteti i Elbasanit i ruante pothuajse të pandryshuara tiparet e tipit oriental ballkanik të formuara gjatë sundimit osman në aspektet e jetës ekonomike e sociale. Jeta ekonomike ishte e ngjashme me atë të qyteteve të tjera shqiptare. Ishin të njëjtat marrdhënie ekonomike që zotëronin edhe në viset e tjera të banuara nga shqiptarët. Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekXX, për Elbasanin ishin karakteristikë ndërthurja e mardhënieve të vjetra feudale me mardhëniet e reja kapitaliste. Rolin kryesor në jetën ekonomike të qytetit e luante pazari me njësitë e veta të prodhimit dhe të shkëmbimit (Duka, 1997: 11).

Bazën ekonomike të qytetit e përbënte prodhimi i vogël zejtar, ku prodhuesi përgjithësisht merrej edhe me shitjen e produkteve të tij. Mjaft zejtarë të vegjël nuk ishin shkëputur ende nga prodhimi bujqësor. Në Elbasan, zejtaria nga pikëpamja e prodhimit paraqitej e specializuar. Këtu çdo prodhues i vogël ushtronte një zeje të caktuar.

Në regjistrat e kadiut të Elbasanit shohim një numur të madh zejesh të regjistruara bashkë me lokalet e tyre. Zejet i gjejmë të organizuara në esnafë. Më kryesoret janë: zeja e argjendarëve, tabakëve, saçmeve, kazazëve, terzinjve, ekmeqçinjve, mejhaneve, bakenjve, hanxhinjve, kazanxhinjve, bahçevanëve, gëzoftarëve, japakçillerëve, pashmakçinjve, biçakçinjve, dyfekçinjve, duhanxhinjve, çelengjirëve, etj.

Megjithatë ndonse i gjejmë të pasqyruara në këtë formë ato kishin filluar ta ndjenin peshën e konkurrencë së mallrave që vinin nga jashtë. (këtu po japim vetëm një pjesë të zejeve pasi disa janë botuar në periodikun e Universitetit A.Xhuvani).

3. Organizimi i zejeve në Elbasan Esnafi i dyfekçinjve (prodhuesit e armëve)

Një nga zejet që u zhvillua në qytetin e Elbasanit në periudhën fundi i shek.XIX - fillimi i shek.XX ka qenë edhe ajo e prodhimit të armëve. Ky aspekt gjen pasqyrimin e tij edhe në regjistrat e kadiut të qytetit për periudhën (1892-1908). Sipas regjistrave, personat e mëposhtëm kanë qenë pronarë të dyqaneve të prodhimit të armëve. Ibrahim Mehmet Dinçi, Xhemile Veli Shpata, Fatime Islam Zeneli, Hysein Alush Graceni, e tjerë. Të dhënat e këtyre regjistrave, ndonëse shifrat mund të jenë të lëvizëshme tregojnë se në qytet ka pasur 15 dyqane të prodhimit të armëve, të cilat ishin në proces të shitblerjes apo ndarjes mes trashëgimtarëve.

Për të përcaktuar ritmet e zhvillimit të kësaj zeje në shekuj, i referoheni të dhënave të gjysmës së parë të shek.XVII të cilat japin një pasqyrë për zhvillimin e zejtarisë në qytetin e Elbasanit. Tek kjo pasqyrë vemë re se kjo zeje nuk pasqyrohet (Shkodra, 1973: 62). Si shpjegohet kjo? Zeja e dyfekçinjve nuk ka ekzistuar në këtë kohë? Sigurisht që në Elbasan veç zejeve të dhëna në pasqyrë ekzistonin edhe degë të tjera të zejtarisë, të cilat dalin nga burime të tjera dokumentare, midis të cilave përmendim zejtarinë e dyfekçinjve, barutçinjët etj. (Shkodra, 1973: 62). Historia e prodhimit të armëve në Elbasan fillon nga shek.XVII. Sipas njoftimeve të funksionarit të Perandorisë Osmane, E.Çelebi, në Elbasan, si dhe në disa qendra të tjera të vendit tonë, armëtarët i punonin këto mjete "me mjeshtëri shumë të hollë (Çelbi, 2000: 107).

Njoftimet e Çelebiut pajtohen edhe me burimet dokumentare vendase, që dëshmojnë se aty, në gjysmën e dytë të shekullit XVII, ekzistonte edhe organizata esnafore e kondakçinjve (Shkodra, 1973: 121). Pra, këto dy të dhëna konfirmojnë ekzistencën e esnafit të kondakçinjve. Kjo zejtarë vazhdoi të zhvillohet edhe në shekujt e

mëvonshëm. Të dhënat e regjistrave e vërtetojnë edhe njëherë këtë gjë.

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm që del nga regjistrat e kadiut është se zeja e prodhimit të armëve ka qenë në dorë të elementit mysliman (AQSH, D. 6, 8, 9, 17, 19). Gjatë shek. XVIII e XIX, zeja e prodhimit të armëve arriti zhvillim të madh në Elbasan, ajo u bë e njohur brenda e jashtë vendit. Zejtarët e prodhimit të armëve kanë qenë të organizuar në esnafin e tyre, në të cilën detyrat kryeshin me mjaft rigorozitet. Zejtarët punonin me një cilësi të admirueshme. Mjeshtrit më të mëdhenj në prodhimin e armëve kanë qenë nga familjet: Karadaku, Zabzuni, Baxhaku, Guranjaku e Shëngjini (Ame, 13).

Nga duart e Tahir Zabzunit, Beqir Grykshit, Bim Baxhakut, Haxhi Hajrullah Zabzunit, Osman Shingjinit, Hasan Ali Graceni, Xhem Katundjes kanë dalë pajisje luftarake që dalloheshin për elegancën dhe shijen e hollë në zbukurimin e dorezave të pushkëve, të kobureve, të jataganëve, të vezmeve (AIK, Çausi, 16) etj. Me të drejtë studiuesit e huaj shprehën se: luksi i shqiptarëve qëndron në punimin e armëve të tyre, të cilat i bënin me zbukurime argjendi (Cani, 2004: 83). Me interes është fakti se të gjitha pjesët e armëve, me përjashtim të tytave, punoheshin me dorë me ndihmën e limave e veglave të tjera.

Në kuadrin e kësaj mjeshtërie ekzistonte specializimi dhe ndarja territoriale e punës e mbështetur në kooperimin dhe bashkëpunimin krahinor të prodhimit të pjesëve të veçanta të këtyre mjeteve. Elbasani ishte i njohur për prodhimin e çarqeve.

Me të drejtë një vizitor i huaj në shek. XIX shkruante se Elbasani prodhonte çarqe pistoletash dhe armësh të gjata që ishin të çmuara nga turqit. Këto armë gjithashtu, zbukurohen aty me argjend sipas mënyrës shqiptare (Shkodra, 1984: 142).

Në Elbasan çarqet e topanxhave dhe dyfeqeve i bënte me porosi Bim Shabani në një formë të bukur. Llojet e dyfeqeve që përdorshin në pjesën më të madhe punoheshin në Elbasan. Njihen me emrat: Shishane Stambolli, Shishane

me Lule, Shyte Stambolli, Parangon, Karafil Boshnjak, Karafil Prift etj. (Demiri, 2006: 46).

Dyfeqçinjtë e Elbasanit kanë pasur meritën se duke filluar nga viti 1875 deri në 1910 prodhuan me mjete artizanale, por me aftësi teknike të përsosur një nga pushkët më të dëgjua të kohës "Hutën e Elbasanit", e cila u quajt "Huta e Miletit" (Ame, 13).

Zeja e dyfeqçinjve, ka pasur lidhje të ngushta me atë të kujunxhinjve (argjendarëve) pasi në këto punishte armët stoliseshin me dekore e ornamente me argjend e serm.

Po kështu, ka pasur lidhje edhe me saraçët për të përgatitur rrypat, si lahet e brezit, kollanët e fishekëve etj. Dyfeqçinjtë lidheshin me saçmexhinjtë të cilët prodhonin pjesën aq të rëndësishme të armëve. Në fillim të shek. XX kjo zeje për shkak të konkurrencës të mallrave perëndimore filloi të bjerë.

Dyqanet e dyfeqçinjëve ndodheshin në vazhdim të rrugës së argjendarëve (kujunxhinjve) e quhej rruga e dyfeqçinjve (Demiri, 2006: 46). Sot kjo rrugë identifikohet në kryqëzimin e "I Majit" tek busti i "Isuf Myzyrit" e deri tek shatërvani përpara zyrës së Telekomunikacionit (Bashkia, tab. 85).

Esnafi i duhanxhinjve

Një numër qytetarësh si pjestarë të esnafit të duhanxhinjve janë paraqitur yek kadiu i qytetit për të kryer veprimet e shitblerjes apo regjistimit të pasurisë, duke deklaruar edhe esnafin të cilit i përkisnin.

Sipas regjistrat janë katër zejtarë që merreshin me këtë zeje, megjithëse kjo shifër nuk është e plotë. Abdyl Mustafa Curri, Ismail Mehmet Qorri, Ibrahim Kamber Mehmet Huta, Zeqir, Ali, Veli, Salit Sara. Përveç këtyre zejtarëve mund të ketë edhe të tjerë. Këta emra tregojnë se kjo zeje i perkiste elementit mysliman.

Qyteti i Elbasanit ofronte kushte të përshtatshme klimateriko-tokësore për kultivimin e manipulimin e duhanit. Thuhet se duhani në rrethin tonë ka filluar të kultivohet që në shek. XVII. Në fillim në fshatrat Bujaras, Kodër Bujaras, Shirgjan, Shtërmën e më vonë në krahinat e tjera (Ame, 15). Varietetet që mbilleshin ishin kryesisht duhani gjysëm oriental i

tipit Samsun. Megjithëse është bimë me origjinë nga vendet e nxehta e të Amerikës në Elbasan ai u përshtat mjaft mirë (Elbasani, 2003: 139). Në fillim tregtia e duhanit ishte e lirë e bëhej nga prodhuesit e tij.

Hamamet

Pjesë e zejeve të shërbimit në fundin e shek. XIX - fillim i shek. XX ishin dhe hamamet, duke ofruar shërbimin e larjes me ujë ose avull për popullsinë myslimane. Qyteti i Elbasanit, që me ngritjen e tij si pikë e fortë ushtarake, u pajis me objekte të tilla.

Sipas regjistrave të kadiut të qytetit në fund të shek. XIX- fillim i shek. XX në qytetin e Elbasanit, ka pasur 3 banja publike (hamame) (AQSH, D. 3, 4). Këto hamame kanë qenë: Hamami i Vjetër (Hamami i Atik) (AQSH, f. Nr. 113/1), rreth të cilit u ngrit lagjja me të njëjtin emër. Sipas Evlia Çelebiut, ky hamam është qujtur, hamami i Sinan Pashës (Çelbi, 2000: 90). Ky hamam ndodhej në pjesën lindore të lagjes “Kala”. Sot ai ruhet si objekt, madje i shpallur si monument kulture, megjithë ndryshimet në ndërtim e destinacion. Dy hamamet e tjera kanë qenë në lagjen “Xhami Beqire”, ndis lagjeve “Qevan Bej” e “Haznedare.” Hamamet kanë qenë në pronësi të: Nexhibe hanëmit, e bija e Ali Beut, dhe Seit beut, të birit të Abdullaut (AQSH, f. Nr. 113/1, d. 19: 111, 191, 192).

Përveç tyre në këtë periudhë ka qenë edhe Hamami i Shabanajt, i cili ndodhej në pjesën qendrore të tregut (AIK, AIKP, Fondi A. *Çaushi*: 35), e në fillimet e ndërtimit quhej Hamami i Pazarit. Duke i krahasuar të dhënat e kësaj periudhe me ato të gjysmës së parë të shek. XVII, kur kishim dy hamame (Shkodra, 1973: 62) janë shtuar edhe 2 të tjerë. Në Elbasan mendohet që ka pasur edhe 160 hamame private në pallatet e zotërinjve (Çelbi, 2000: 91). Hamamet si banja publike kishin skemën e tyre të ndërtimit, e cila ishte afërsisht e përbërë nga; tre lokale, dhoma e zhveshjes, e izolimit dhe e larjes, të renditura në një bosht të drejtë, duke formuar trajtën simetrike të banjës.

Në këtë mënyrë silueta e banjës dallohej lehtë me kupolën kryesore të dhomës së zhveshjes. Arkitektura e brendshme e dhomave

karakterizohej nga format tipike orientale. Në këto banja kishte personel që shërbente për masazh, për pastrimin e njerëzve të pafuqishëm, për mirëmbajtjen, për mirëmbajtjen, për zjarrin dhe për pastërtinë

Esnafi i Zilexhinjve (Prodhuesit e zileve)

Mjeshtria e prodhimit të zileve është e vjetër dhe e lidhur me zhvillimin e blegtorisë. Në regjistrat e kadiut të qytetit të Elbasanit për periudhën fundi i shek. XIX fillimi i shek. XX, jepen emrat e dy personave që i përkasin zejes së zilexhinjve të cilët kanë kryer veprime pranë tij. 1) Jovan i biri i Vasil Zilexhiut (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi, v. 1900-1901, d. 13: 63) dhe 2) Kostandin Zilexhiu (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi, v. 1900-1908, d. 19: 115).

Këto të dhëna duke i krahasuar me gjysmën e parë të shek. XVII, vëmë re se në atë periudhë nuk e kemi të përfaqësuar këtë zeje, por kjo s’do të thotë se nuk ka ekzistuar. Mendoj se nuk duhet të ketë qenë e organizuar ose mund të ketë qenë e bashkuar mendonjë zeje të përafërt, me atë të përpunimit të metaleve. Zilet punoheshin me material bakri ose bronxi. Teknika e prodhimit ishte e thjeshtë. Materiali i petëzuar në formën e llamarinës, kthehej në kudhër me rrahje derisa i jepej forma e duhur. Më pas i vendosej (varej) pjesa e brendshme në formë sferë ose cilindri që shkaktonte tingullin. Për lloje të ndryshme bagëtish ose kafshësh kishte zile të ndryshme. Tingëllima ishte njoftim për vendondodhjen e tyre (Elbasani, 2003: 666).

Në dyqanin e zilexhiut, të binin në sy këmborat e prijesve të dhenve e të dhive, të bukura dhe elegante ishin këmborët e punuara prej bronxi me shkëlqim që arriheshin nga mjeshtrit nëpërmjet larjes me një lëndë speciale (Ame, 11). Këto në përgjithësi i vareshin kafshëve të bartjes, kuajve e mushkave të karvanëve. Ato kishin tingëllima të ëmbla e melodike. Kjo zeje i përkiste sipas regjistrave elementit ortodoks.

Esnafi i Demirxhinjve (hekurxhinjtë)

Në regjistrat e kadiut të qytetit të Elbasanit, për periudhën fundi i shek. XIX-fillimi i shek. XX, janë dy persona të cilët kanë kryer veprime me pronat e tyre: 1) Hasan Ibrahim Demirxhiu (AQSH, F. nr. 113/1, reg. Jokllama, v. 1899, d. 10: 13, nr.37)

dhe Hasan Arif Evgjiti (AQSH, F. nr. 113/1, reg. Daimi, v. 1902-1904, d. 15: 16).

E veçanta e këtyre regjistrimeve është se aty përcaktohet fakti që personat i përkasin esnafit të farkëtarëve (demirxhinjve) dhe se njëri prej tyre i përket kategorisë shoqërore të evgjitëve (AQSH, F. nr. 113/1, reg. Daimi, v. 1902-1904, d. 15: 16). Në Elbasan ka shumë jevgj të cilët mbahen muhamedanë dhe janë kovaçë (Han, 2007: 115). Të dhënat e këtyre regjistrave ndonëse i marrim me rezervë, pasi vetëm dy persona janë paraqitur tek kadiu i qytetit, duke i ballafaquar me të dhënat e gjysmës së parë të shek.XVII, kur ishin 10 farkëtarë (Shkodra, 1973: 62) janë ulur.

Këto shifra konfirmojnë se kjo zeje në fund të shek.XIX kishte shkuar drejt rënies. Konkurenca prej mallrave më të lira, të importuara nga vendet europiane është një nga shkaqet e rënies. Nën peshën e konkurrencës së tyre vazhdoi rrënimi i zejtarëve të cilët nuk i bënë dot ballë prodhimeve evropiane (Duka, 1997: 25). Pasojat shkatërrimtare të industrisë europiane u dukën sidomos në degën e punimit të metaleve (Shkodra, 1984: 332), hekurishtet vinin nga Austro-Hungaria (Shkodra, 1984: 332). Në zejen e punimit të metaleve, gjatë shek.XIX që kishte një traditë të hershme u zhvillua sidomos përpunimi i hekurit i cili ushtrohej kryesisht nga jevgjit, prodhimi i enëve prej bakri ai i thikave prej çeliku etj.(Shkodra, 1984: 156). Një dëshmitar që vizitoi Shqipërinë në fillim të shek.XIX shkruante se edhe Elbasani kishte punonjës shumë të zotë në punimin e hekurit dhe të bakrit (Shkodra, 1984: 156). Prodhimet kryesore të farkëtarëve ishin: masha, kaci, demiroxhak, kusi, kamje, parmakë, brava, çelsa, gozhdë etj.(Elbasani, 2003: 666). Sipas regjistrave, kjo zeje i përkiste elementit mysliman

Esnafi i saçmexhinjve (Prodhuesit e saçmev

Në regjistrat e kadiut të qytetit për periudhën, fundi ishek.XIX - fillimi i shek.XX(në vitet 1892-1908) figuron i regjistruar edhe esnafi i prodhimit të saçmeve (saçmexhinjtë). Pronarë të dyqaneve të këtij esnafi ishin: Tomorr Musa Çelmusai, Abdulla Tahir Daiu, Ymetullah Haxhi Stringa, Mehmet Haxhi Kotra, Mahmut Ali Doraci, Mehmet Rustem Shkodra, Ali hysen

Mullisi, Seit Bejtulla Kaçuli, Mustafa Seit Luniku, Besim Ismail Kurti, Haxhi Ibrahim Shqerra, Hysein Ymer Mullajonuzi etj.(AQSh, F. Nr. 113/1, regj. Daimi e Jokllama, v. 1892-1908).

Duke vlerësuar regjistrat, shohim se fluksin më të madh të regjistrimeve e kishte periudha e viteve 1897 deri 1899 me 6, 8 dhe 7 dyqane në vit.

Zhvillimi i zejes së prodhimit të saçmeve lidhej me prodhimin e armëve për të cilën Elbasani dallohej në atë kohë. Duke folur për Elbasanin konsulli i Francës në Shkodër në 25 tetor 1865, shkruan: “Ai prodhon armë e mbi të gjitha çarqe pushkësh,” (Shkodra, 1984: 142) për rrjedhojë ai kishte nevojë për zejen e saçmeve. Zejtarët i përgatisnin duke i mbushur saçmet që ju vinin të gatshme nga Venediku me barutin që prodhohej në krahinat e Matit (AIKP, F. *Abedin Çausi...*, D. 66/29: 81).

Duke i krahasuar të dhënat e regjistrave per periudhen e fundit të shek.XIX me gjysmën e parë të shek.XVII shohim se kemi rritje. Kjo zejtarë është rritur me 22 dyqane nga 1 (Shkodra, 1973: 62) që ishte në atë periudhë.Rritja e kësaj zeje kushtëzohet nga rritja e kërkesës për to. Zeja e prodhimit të saçmeve i takonte elementit mysliman, duke ruajtur kështu traditën e shekujve më parë. Në fillim shek.XX, zeja e prodhimit të saçmeve, filloi të ulet për faktin e thjeshtë se ajo nuk e përballonte dot prodhimin industrial që importohet (Shkodra, 1984: 247).

Sipas regjistrave duke filluar nga viti 1900 (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi e Jokllama, v. 1900-1908, D. 11, 12...19) e në vazhdim nuk kemi asnjë dyqan të saçmaxhinjve që të jetë në proces regjistrimi. Ky fakt tregon se kjo zejtarë e prodhimit të saçmeve filloi të bjerë së bashku me atë të prodhimit të armëve në mënyrë artizanale. Saçmat nga fillimi i shek.XX filluan të jenë pjesë e mallrave të importit, pasi prodhimi zejtar nuk përballonte dot prodhimin industrial (Shkodra, 1984: 247). Rruga e saçmaxhinjve ndodhej nga sheshi i “Tabakëve” deri tek “Porta e Kalasë”. Sot identifikohet në anën lindore te bulevardit “Q.Stafa” (Prefektura).

Esnafi i Kasapëve

Një zeje që gjen pasqyrim në regjistrat e kadiut të qytetit të Elbasanit për periudhën fundi i shek

XIX-fillimi i shek XX është edhe ajo e kasapëve. Kjo zeje është pasqyruar nëpërmjet regjistrimit të dyqaneve apo tjetërsimit të pronësisë së tyre. Në këta rregjistra janë të rregjistruar 21 (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi e Jokllama, v. 1892-1908, D. nr. 3, 4, 5...19) dyqane që shërbenin si kasaphane për therjen e bagëtive e shitjen e mishit të tyre. Këto dyqane të kasapëve i përkisnin personave si më poshtë: Tomorr Musa Agai; Ibrahim, Musa, Haxhiymer Shijaku; Jovan Pavli Tanko; Ibrahim Abdulla Qatipi; Santo Gavril Santo; Xhemile Asllan Gjata; Hasan Mustafa Curri; Mustafa Ymer Guranjaku; Sulejman Alush Zyma; Haxhi Nikolla Papakostandini; Hysen Alush Graceni; Dhimitër, Nos Vasil Dashi, etj. (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi e Jokllama, v. 1892-1908, D. nr. 3, 4, 5...19).

Duke studiuar këto rregjistra (1892-1908) e duke i krahasuar me të dhënat e gjysmës së parë të shek.XVII, kur ishin vetëm 7 kasapë (Shkodra, 1973: 62) del se ky esnaf ishte rritur.

Rritja numerike e dyqaneve lidhej me llojin e kësaj zejtarie që hyn në grupin e artikujve ushqimorë. Ato i rezistuan më shumë kohës e konkurrencës, për shkak të kërkesave, pasi plotësonin nevojat për produkte ushqimore të jetës së përditshme, të qytetit e të fshatit (Shkodra, 1984: 25). Duke ndjekur hap pas hapi rregjistrat, shohim se në vitin 1899 ka një rënie të numurit të dyqaneve në procesin e regjistrimit, për të vazhduar me një periudhë pushimi deri në vitin 1904 e për t'u futur në një periudhë kur ky numur është rritur në tre dyqane në vit (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi e Jokllama, v. 1892-1908, D. nr. 3, 4, 5...19).

Nga të dhënat e regjistrave del se nga 21 dyqane, 4 u përkisnin personave të fesë ortodokse. Krahasuar me gjysmën e parë të shek.XVII, kur të gjithë kasapët i përkisnin fesë myslimane, shohim se në fund të shek.XIX në këtë zeje janë përfshirë edhe ortodoksë duke e prishur rregullin e mëparshëm. Esnafi i kasapëve kishte në pronësi të saj të përbashkët një pronë are (çair kasap) (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi, vitet 1904-1905, D. 17, fl.172, nr. 44), të cilën e shfrytëzonte për kullotjen e bagëtive. Dyqanet e kasapëve ndodheshin në rrugën me të njëjtin emër që

shtrihej nga rruga e Mejhanes tek sheshi i Idrajit e ai i Leshnave (Dedej, 50). Sot kjo rrugë identifikohet afërsisht në rrugën "11 Nëntori" dhe lulishtja mbrapa hotel "Skampës" (Bashkia, tab. 85). Në këtë rrugë ishin vendosur 17 dyqane, 3 ndodheshin në lagjen "Sulejmanie" dhe 1 në "Qoshe." (AQSH, F. nr. 113/1, regj. Daimi, v. 1902-1904, D. 15 fl. 72, nr. 3.). Në dyqanet e kasapëve shërbehej mirë në bazë të normave të vendosura shekuj më parë, sipas të cilave: kasapi duhej të shërbente me rregull e të mos e jepte mallin e prishur ose të mangut (shkodra, 1973: 133).

PËRFUNDIME

Trajtesën për problemet ekonomike të qytetit të Elbasanit e kemi bërë duke u mbështetur në zhvillimin dhe llojshmërinë e zejtarisë si një nga degët kryesore të prodhimit në qytetin e Elbasanit. Esnafët ishin baza e organizimit të ekonomisë. Prodhimet e dala ishin të destinuara për trgjet vëndase dhe të huaja, duke shërbyer si një mundësi për vendosjen e lidhjeve ndërkrahinore e më gjerë, megjithëse këto ishin të pakta për shkak të mungesës së rrugëve të transportit. Një dukuri me interes që ne konstatojmë në rregjistrat e kadiut të qytetit të cilat i kemi patur si bazë për studimin është fakti se: në fund të shekullit XIX dhe fillim të shek XX ekonomia ishte në periudhën e tranzicionit, në kalimi nga esnafi tek punishtet dhe fillesat e fabrikave. Duke krahasuar me shekullin e XVII, vemë re se një numër i madh esnfesh të prodhimeve të ndryshme nuk egzistonin më.

Në këtë periudhë ne duhet të pranojmë se, esnafi egzistonte, por sigurisht me një frymëmarje më liberale duke iu përshtatur rregullave të ekonomisë së tregut. Gjatë kësaj periudhe ishte rritur numri i punëtorëve, ishin zbutur rregullat për dhënien e të drejtës së hapjes së dyqanit (vëndi i prodhimit të një malli, punishtja, shërbente edhe si dyqan për shitjen e tij), kishin filluar të hynin makineri të thjeshta, etj. Të gjitha këto ndryshime shënuan një hap të rëndësishëm në ngritjen e punishteve të para dhe manifakturave ku prodhoheshin pëlhura, qepeshin rrobe, etj. Zhvillimi i zejtarisë,

manifaturës dhe tregtisë bënë të mundur lindjen e punishteve dhe fabrikave të para të kooperimit të thjeshtë, në të cilën dukeshin filizat fillestarë të ekonomisë kapitaliste.

BIBLIOGRAFI

AIKP. Fondi Abedin Çausi, dorëshkrimi për zejen e dyfekçinjve

AME E, "Muzeu etnografik",..... mat. i cituar, f.13.

ARKIVI i Muzeut Etnografik Elbasan, Dosja Zejet në Elbasan

ARKIVI Qendror Shqiptar, Fondi nr 113/1 Regjistrat daimi e jokllama vitet 1892-1908

BASHKIA Elbasan, Drejtorja e sherbimeve.. mat i cit. tab.85.

CANI, Xh.(2004), Argjendaria dhe mjeshtrit shkodranë, Sejko.

ÇELEBI, Evlija (2000), Shqipëria 350 vjet më parë, Horizont.

DEDEJ, S. Abedin Çausi,..... vep. e cituar, f.50.

DEMIRI, Sh. (2006), Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Egnatia, Tiranë.

DUKA, Valentina (1997), Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Tiranë.

ELBASANI Enciklopedi, Shtëpia Botuese Sejko, Elbasan, 2003

FESH (1985), Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

GAËRYCH, G (2007), Gjysmëhëna dhe Shqiponja, Bota Shqiptare, Tiranë.

GAZETA "Shkumbini", Elbasan 1921

HAN, J.G.Von (2007), Studime shqiptare, IDK, Tiranë.

MONUMENTET, 1973, nr 5-6

PREFEKTURA Elbasan..rregjistrat....., mat. i cituar

SHKODRA, Zija (1973), Esnafët Shqiptarë, shekulli XV-XX, Botim i Akademisë së Shkencave të R. P. Shqipërisë, Tiranë.

SHKODRA, Zija (1984), Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare, Tiranë..

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE NGA KOSOVA E VISET E TJERA DHE TRAJTIMI I TYRE NGA QEVERITË E SHQIPËRISË NDËRMJET DY LUFTRAVE BOTËRORE (1918-1941)

JANI SOTA

Universiteti "Aleksandër Mosiu", Durrës, SHQIPËRI

Email: jani_sota@yahoo.com

AKTET IV, 4: 773 - 783, 2011

PERMBLEDHJE

Populli shqiptar, gjatë rrugës historike pati reduktime e copëtime të hapësirës dhe shtrirjes së saj gjeografike e demografike, që u përcollën me pasoja të rënda. Format gjenocidiale ndaj popullsisë shqiptare ishin dukuri përcjellëse të pushtetmbajtësve serbe dhe grekë, që vërehej si një formë etnocidi ndaj vetë shtimit të kësaj popullsisë, i cili përcillej me një dozë shqetësimi, duke pasur gjithnjë frikë për ekspansionin demografik në Ballkan. Përpjekjet për mbrojtjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe Greqi, si dhe qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj këtij problemi, kanë pasur veçori dhe probleme specifike në periudha të ndryshme të zhvillimit historik. Ato janë diktuar edhe nga koniunkturaturat politike që kanë qenë vepruese në atë kohë.

Fjalë çelës: Shpërngulje, emigrantë, qeveri, dekretligje, Parlament, Shqipëri, mikpritje, ndihmë, kulturë.

SUMMARY

The Albanian people over the course of history have suffered reductions and partitions of their geographic and demographic area and extension. Genocidal forms against the Albanian population were an accompanying phenomenon of the Greek and Serbian rulers which was seen in the forms of an ethnocide towards the increase of this population which reflected a dosage of worry, being afraid of its demographic expansion in the Balkans. Efforts for the protection of Albanians in Yugoslavia and Greece and the attitude of the Albanian government towards this issue has had specific characteristics and problems in different periods of the historic development.. It has also been subject to the political situations which have been active especially during the period between 1918-1941.

Key words: Displacement, immigrants, government, decreed laws, Parliament, Albania, welcome, help, culture.

HYRJE

Në historinë e popujve të Evropës, veçanërisht në shekullin e kaluar, vështirë se mund të gjendet ndonjë popull që të ketë qenë objekt i shpërnguljeve sikurse populli shqiptar, pjesa që ka jetuar jashtë kufijve të Shqipërisë.

Pastrimi etnik i viseve shqiptare nga Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene, prej vitit 1918 deri në vitin 1929, e më pas në atë Jugosllave, deri në prill 1941, synonte ndërrimin e dukshëm të përbërjes etnike të popullsisë në dëm të shumicës dërrmuese shqiptare. Natyrisht që shpërnguljet me dhunë më 1918 deri më 1941, e kishin zanafillën prej fitimit të autonomisë së

këtyre shteteve. Ato do të intensifikoheshin, sidomos gjatë viteve 1877-1878, ku Serbia pushtoi Sanxhakun e Nishit. 30 mijë shqiptarë myslimanë, sipas Çvijiçit, por në fakt mbi 100 mijë, sipas Brestovcit, u detyruan me dhunë të shpërngulen për t'i shpëtuar gjenocidit shfarosës. Dihet se politikën e spastrimit etnik, Mbretëria Serbe dhe ajo Malazeze e vazhduan edhe gjatë viteve 1912-1913, kur rreth 22.000 km² tokë, me popullsi shqiptare mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë. Ato iu nënshtruan përsëri spastrimit dhe kolonizimit. Mjetet e përdorura nga autoritetet jugosllave për të detyruar popullsinë shqiptare të braktisë vendin, ishin të shumta.

Regjimet e hekurit, të zjarrit dhe plaçkitjes përbënin faktorin kryesor të emigrimit në masë të popullsisë shqiptare, i cili bëhej në kushte të tmerrshme që u kushtonte jetën qindra familjeve shqiptare. Si pasojë e një politike të tillë, gjatë kësaj periudhe u vranë me mijëra shqiptarë dhe u shpërngulën nga vatrat e tyre stërgjyshore përgjithmonë 60.000 të tjerë.

Formimi i shtetit shqiptar në fakt është zanafilla e lindjes së asaj që quhet sot çështja kombëtare. Shqipëria me gjymtyrë të këputura, e dërmuar ekonomikisht dhe politikisht, si shtet i

sapokrijuar, i takoi të luajë rol qendror në zgjidhjen e çështjes kombëtare, të bëhet krah i fuqishëm i shqiptarëve në trojet e veta etnike, të shkëputura nga trungu kombëtar. Asaj i ra barra e rëndë, që të dëshmohej si faktori më me ndikim për pozitën e shqiptarëve në Ballkan.

Duke iu referuar statistikave zyrtare të Turqisë, më 1908-1909, dhe një pjese të statistikës së hartuar nga autoritetet ushtarake të Austrisë, kur këta kishin në pushtimin e tyre Kosovë (1916-1917), rezultonte se popullsia e viseve shqiptare të robëruara ishte 946.929 banorë.

Nënprefektura	Vetëm Popullsia Shqiptare
Ajdonat	13723
Dibër	50113
Ferizovik	21390
Gostivar	23197

Nënprefektura	Vetëm Popullsia Shqiptare
Guci	9905
Gumenicë	10126
Gjakovë	70962
Gjilan	63984
Kaçanik	9151
Kërçovë	16747
Kostur	37118
Kumanovë	18431
Margëllec	15723
Mitrovicë	15227
Monastir	30999
Novi-Pazar	9504
Ohër	20369
Pargë	800
Pejë	62490
Përlepe	18308
Prizrend	72458
Preshovë	20300
Prishtinë	60968
Resnë	6827
Rekë	13469
Rozhaj	15932
Shkup	50258
Tetovë	52076
Tuz	7647
Vuçiterin	56379

SHUMA 946.929

Tabela 1. Popullsia e trojeve shqiptare të robëruara gjatë viteve 1916-1917

Është e kuptueshme, pse në strategjinë shkombëtarizuese të Beogradit ndaj shqiptarëve,

shpërngulja në periudhën pas vitit 1918 mori rëndësi të veçantë. Nëse ajo u realizua ose jo,

tërësisht ose pjesërisht, kjo është një çështje më vete që është trajtuar nga historiografia shqiptare dhe ajo e huaj. Gjithsesi, nën dritën e fakteve të reja shkencore, mendoj se ka vend për hulumtime dhe interpretime të reja shkencore nga të gjithë studiuesit përkatës.

Rruga kryesore e largimit të shqiptarëve nga viset e tyre në Kosovë, gjatë viteve 1918-1941 ishte ajo nëpërmjet territorit të Republikës së sotme të Maqedonisë, kryesisht me anën e vijës hekurudhore Shkup-Selanik dhe prej këtej në Turqi, përsëri me hekurudhë, atë Selanik-Stamboll, ose me anije. Territor i ndërmjetëm me rëndësi për largimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova në Turqi sidomos gjatë viteve 1918-1928, ishte ai i Bullgarisë, vija hekurudhore Nish-Sofje-Stamboll. Sa i përket drejtimeve të tjera të shpërnguljes së shqiptarëve, duhen përmendur ato drejtpërsëdrejti nga Kosova, dhe viset e tjera në territorin e shtetit shqiptar, pastaj nga Shkupi në Selanik e më tej në disa vende të botës arabe, si dhe rishpërnguljet nga Turqia në drejtim të territorit të shtetit shqiptar.

Kalvari i përjetimeve tragjike të shqiptarëve nën sundimin serb (jugosllav) dhe grek, paraqet një nga kapitujt më të rëndësishëm të historisë së shqiptarëve. Fan Noli ngjarjet tragjike në trevat shqiptare të Kosovës dhe Çamërisë në vitet '20 të shekullit të kaluar, i quan një tragjedi në tri akte: shpasurim, shpërngulje, shfarosje.

Gjatë periudhës 1918-1941, për sa i përket ecurisë së shpërnguljeve me forcë të shqiptarëve të Kosovës, mendoj se ajo u zhvillua në dy etapa kryesore, që në disa momente të veçanta kanë tipare të përbashkëta, por që edhe i dallon nga njera-tjetra. *Etapa e parë* është ajo e viteve të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene 1919-1929, e cila përkon me lëvizjen për liri në viset shqiptare ose siç quhet ndryshe në histori lëvizja kaçake. *Etapa e dytë* është ajo e viteve 1929-1941, kur nën formacionin politik të Mbretërisë së Jugosllavisë, Beogradi u përpoq me çdo kusht institucionalizimin ndërshtetëror të procesit të shpërnguljes së shqiptarëve, që u kurorëzua me bisedime dy palëshe gjatë takimit të Aleancës Ballkanike dhe me marrëveshjen qeveritare jugosllave-turke të korrikut 1938.

Në pamundësi që në kufijtë e përcaktuar të një artikulli, të shtjelloj e analizoj etapat, drejtimet, përmasat e pasojat e shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe vise të tjera, në periudhën e viteve 1918-1941, po përqendrohem vetëm në disa çështje të kësaj problematike që lidhet me kohën dhe vendndodhjen e të instaluarve në territorin e shtetit shqiptar, me përpjekjet dhe ndihmën që dhanë qeveritë shqiptare, ndaj bashkëkombësve të vet si në aspektin moral e material, ashtu edhe në atë diplomatik, si dhe me rrjedhimet e bashkëjetesës në viset e reja të Shqipërisë.

Duke u mbështetur në burimet arkivore, rezulton se në periudhën 1919-1923, brenda kufijve shtetëror të Shqipërisë ishin instaluar 538 familje të shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre. Por këto shpërngulje nuk mbetën me kaq, ato vazhduan në intervale kohore më tej: në vitin 1925 u shpërngulën 128 familje: 1926 – 399; 1927 – 316; 1928 – 149, 1928 – 149; 1929 – 216; 1930 – 199; 1931– 624; 1932 – 211; 1933 – 181; 1934 – 328; 1935 – 386; 1936 – 182 familje. Gjithsej deri në vitin 1937, në Shqipëri u shpërngulën 4.046 familje shqiptare. Qeveria shoviniste jugosllave i detyronte të emigronin fillimisht ata që dyshohej se janë përkrahës të çetave çlirimtare ose anëtare të Komitetit të Kosovës.

Çdo ngjarje që përkonte me problemin e shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova dhe nga trevat e tjera, ndiqej me mjaft vëmendje e shqetësim profesional, pse jo edhe kombëtar nga përfaqësuesit diplomatik shqiptarë në Legatat shqiptare në Beograd, kryekonsullatën në Shkup, konsullatën në Manastir, si dhe në ato të Greqisë, Turqisë, Bullgarisë, Rumanisë etj. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Jashtme, Kryeministria, Presidenca e më vonë edhe Oberri Mbretëror, kishin në çdo moment një tablo të qartë të procesit të të larguarve më shumë nga Kosova dhe viset e tjera dhe krahas kësaj, propozime dhe ide konkrete në funksion të zgjidhjes së saj prej tyre, të cilat shpesh herë u realizuan me sukses.

Në shërbim të kësaj çështje madhore, natyrisht u vunë në lëvizje edhe përfaqësuesit e popullit në Parlamentin Shqiptar. Kështu, në mbledhjen e 7

marsit 1923, lexohet shkresa e Kryeministrit, nr. 592 e datës 27 shkurtit, në të cilën paraqitet për aprovim projektligji i Këshillit të Ministrave për përdorimin e një kredie prej 20.000 franga ari për ushqim të 2.000 njerëzve nga ish-Zona Neutrale e Kosovës që ishte pushtuar nga ushtria jugosllave. Ndërkaq në mbledhjen e 17 marsit 1923, Kryeministri, Ahmet Zogu, jepte para deputetëve, shpjegimet qeveritare mbi gjendjen politike të brendshme dhe të jashtme të shtetit. Ai theksonte, se: *“muhaxhirët pa kushte mund ta prishin qetësinë, por qeveria si me ligjin e paraqitur nga ju dhe me masat të tjera është përkujdesur për gjendjen e tyre duke premtuar që në të ardhmen të gjithë shqiptarët do të vendosen në toka shqiptare dhe nuk do të mbetet asnjë pa strehim”*.

Në fund të vitit 1923, qeveria turke refuzoi zbarkimin në Stamboll të 26 familjeve kosovare (mbi 100 frymë) të përzënë nga autoritetet shoviniste jugosllave. Ata u endën për një kohë të gjatë mbi një anije derisa Ahmet Zogu lejoi zbarkimin e tyre në Vlorë dhe i instaloi në Shqipëri.

Lufta për mbrojtjen e bashkëkombësve u bë një nga çështjet më të rëndësishme edhe për shqiptarët e Çamërisë, nga përfaqësuesit e qeverise shqiptare. Ata duke dalë në mbrojtje të rrezikut të popullit çam për shpërngulje në Turqi (shkëmbim me grekët e Turqisë) iu drejtuan disa herë Lidhjes së Kombeve. Krahas përpjekjeve diplomatike Qeveria shqiptare punoi intensivisht që emigrantëve çam, si dhe minoritetit grek në Shqipëri, t'u krijoheshin kushtet e mundshme jetësore.

Me miratimin e Ligjit *“Për vendosjen e emigrantëve”* nga Parlamenti Shqiptar, më 31 Maj 1923, shiheshin qartë përpjekjet e qeverisë së Zogut dhe parlamentarëve për t'i ndihmuar dhe për t'u krijuar kushte materiale e financiare emigrantëve të instaluar në Shqipëri. Në këtë kontekst çështja e vendosjes së emigrantëve shqiptarë në shtetin amë, në Shqipëri, u rregullua me vendim të Ministrisë së Drejtësisë nr. 125/IV, të datës 23 tetor 1923. Në nenin 5 të këtij vendimi theksohej se, *“... familjeve të emigrantëve përveç gjysmë hektari që u falet u*

jepet për punim edhe dy hektar tokë”. Kjo do të thoshte se të gjithë emigrantët që dëshironin të vendoseshin në toka të shtetit do të merrreshin gjithsesi me bujqësi. Kjo përforcohet më tej edhe me nenin 4, në të cilën theksohet se: *“emigrantët kanë të drejtë, përveç dy hektarëve të përmendur në nenin 5, të punojnë pasurinë e shtetit edhe në toka të tjera të nevojshme për bujqësi”*. Gjithashtu, duke iu referuar burimeve zyrtare të shtetit shqiptar, veçanërisht ato të Kuvendit Kushtetues (mbledhja e datës 9 prill 1924), çështja e akomodimit të të ardhurve nga trevat e Kosovës, shihej si domosdoshmëri emergjente për të krijuar sado pak kushte minimale për jetesë, pavarësisht nga gjendja e dobët financiare të prefekturave dhe nënprefekturave ku ata instaloheshin.

Gazeta *“Politika”* e Vlorës, më 23 tetor 1924, në artikullin e saj të titulluar *“Kosovë - Çamëri”* përshkruan qartë kushtet e shqiptarëve që detyrohen të largohen me forcë nga vendbanimet e tyre, odisenë e gjatë e të vështirë drejt Shqipërisë. Është kjo një tjetër dëshmi se problemi kombëtar, veçanërisht problemi i emigrantëve, ishte brengë e thellë si në Jug ashtu edhe në Veri të Shqipërisë.

Në raport me emigrantet, qeveria shqiptare përveç ushqimit dhe strehimit kishte prioritet edhe përkujdesjen për veshmbathje. Kështu në mbledhjen e 64-të të Dhomës së Deputetëve, më 16 nëntor 1925, aprovohet ligji dhe autorizohet qeveria të informojë Zija Begollin për të importuar pa taksë doganore 2.000 petka të papërdorura për emigrantët kosovarë, që ndodheshin të shpërndarë në vise të ndryshme të Shqipërisë. Kurse në mbledhjen e 78-të të mbajtur me 10 dhjetor, aprovohet projektligji për një kredi 20.000 fr. ari për t'i përballuar shpenzimet e emigrantëve dhe ngarkohej për zbatim Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Financave.

Në maj të vitit 1926, Ministri i Punëve të Jashtme, Hysen Vrioni mori një letër nga Legata shqiptare në Greqi, ku rezultoi se, më 23 prill 1926, Ministri i Greqisë ka pasur një takim me homologun e tij turk, Tefik Ruzhdi, ku, ky i fundit i ka thënë Ministrin grek se do t'i sjellin 300.000-

400.000 myslimanë nga Serbia për t'i turqizuar. Këtë lajm e pohojnë edhe gazetatat turke "Milijet" dhe "Hakimijet Milije".

Në këtë kontekst, Ministria e Punëve të Brendshme në mbledhjen e datës 21 mars 1928, parimisht pajtohet me vendosjen e tyre meqë ishin shqiptarë, por duke marrë parasysh shpenzimet e mëdha të udhëtimit dhe fondin e vogël të pronave shtetërore, këtë kërkesë ia dërgon Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

Më 29.3.1928, Këshilli i Ministrave vendosi të autorizohet Ministria e sipërpërmendur që të pranohen për herë të fundit këto dhjetë familje në rast se ata janë racë shqiptare dhe e flasin gjuhën shqipe. Edhe në mbledhjen e datës 23 maj 1928, Kryesia e Këshillit të Ministrave diskutoi edhe për modifikimin e ligjit të emigracionit ndonëse ishte i pranuar nga Këshilli i Ministrave dhe kryesia e Dhomës së Deputeteve. Me dekretin që nxori qeveria e Zogut për ardhësit nga Kosova, bëri që të lehtësoheshin vuajtjet e mijëra muhaxhirëve të përzënë nga tokat e tyre në këtë shtet. Dekreti për dhënie tokash si dhe ndihma në franga ari do të fliste shumë. Qeveria me të gjitha mundësit përkrahu elementin çlirimtar të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare, të cilat kishin në njëfarë mënyrë mburojë atdheun mëmë, Shqipërinë.

Qarqet shoviniste serbe nëpërmjet politikës së tyre përçarëse, ishin të interesuara që këta emigrantë të mos vendoseshin në Shqipëri. Informatorët e tyre përpiqeshin t'i bindnin kosovarët myslimanë se Shqipëria është e krishterë dhe nëse shkonin atje do të merrnin fenë e krishterë. Qeveria e Beogradit përdori të gjitha mjetet, duke filluar që nga propaganda, fanatizmi fetar e deri te forca brutale. Ajo në një masë më të madhe ia arriti qëllimit të saj, sepse shumë familje shqiptare të Kosovës u detyruan t'ua shisnin serbëve pasurinë e tyre për pak të holla dhe të emigronin.

Si kundër peshë, Qeveria e Zogut u angazhua që t'u kundërvijë planeve për largimin e popullsisë shqiptare nga Kosova, mirëpo ajo i frikësohej pranisë së madhe të emigrantëve në Shqipëri, duke dëshiruar t'u shmangej problemeve politike dhe ekonomike. Kështu, nëpërmjet Legatës

Shqiptare në Beograd, filloi propagandën në qarqet shqiptare të Kosovës, duke i këshilluar shqiptarët që të mos linin vatrat e tyre, sepse një gjë e tillë ishte në kundërshtim me interesat kombëtare.

Në këtë drejtim kontribut dha edhe qeveria turke, e cila urdhëroi legatën e saj në Beograd, që të mos vizonte më pasaportat e shqiptarëve që dëshironin të emigronin në Turqi. I ngarkuari me punë i Legatës Shqiptare të Beogradit i premton qeverisë së Tiranës se do të angazhohej për pengimin e emigrimit të shqiptarëve për në Egjipt.

Pra shihet qartë se, qëllimi i politikës zyrtare serbe ishte ndërrimi i strukturës etnike të popullsisë dhe serbizimi i Kosovës, qëllimi i politikës së Shqipërisë ishte që këta shqiptarë me çdo kusht të qëndronin në vatrat e veta. Lidhur me këtë do të kemi qëndrimi zyrtar të Kryeministrit shqiptar ku theksohej se: "interesi i kombit kërkon që kosovarët të mos emigrojnë as në Turqi e as në Mbretërinë tonë"

Qëndrimi i qeverisë shqiptare, për të mos larguar shqiptarët nga trojet e tyre, konfirmohet edhe në promemorien e dt. 5 maj 1930, të paraqitur në Lidhjen e Kombeve nga tre misionarë të Kongresit të Shenjtë "Propoganda Fide"-es, Dom Gjon Bisaku, Dom Shtjefën Kurti dhe Dom Luigj Gashi, ku ndërmjet të tjerash theksohej se: "Në Shqipëri ndodhen afro 10.000 të emigruar fatkeq, në një gjendje të vajtueshme që mund t'i hasësh nga pak kudo. Duket se Qeveria shqiptare ka bërë përpjekje shumë të lavdërueshme për sistemimin e këtyre refugjatëve, por është jashtë çdo dyshimi se vetëm vullneti i mirë nuk mjafton për të pranuar e plotësuar nevojat e të gjithë atyre që duan të shkojnë atje. Si rrjedhojë, ajo u detyrua t'u refuzoj vizën hyrëse pjesës më të madhe të tyre. Kështu ata kërkuan strehim pak më tutje në Turqi".

Bashkëkombësit e shpërngulur nga Kosova, gjatë viteve 1925-1930, autoritetet e shtetit shqiptar i vendosën kryesisht në pjesën perëndimore moçalore, përkatësisht në rrethet e sotme të Fierit, të Lushnjës, të Kavajës, të Beratit, të Elbasanit, të Durrësit, të Krutës etj.

Tabela 2. Emigrantët e instaluar definitivisht në tokat shtetërore deri në vitin 1927

Zona (District)	Emni i Katundit (Nom de Village)	Familje (Fam)	Frymë (Population)
Zona e Durrësit	Shënvlash	54	167
" "	Sukth	22	64
" "	Xhafzotaj	14	45
" "	Rreth	43	123
" "	Arapaj	49	173
" "	Sallmane	3	9
SHUMA		185	581
" Krujës	Hasanaj	22	77
" "	Fushë e Kruejës	5	24
" "	Derven	78	303
" "	Luz	5	21
" "	Mamuras	78	252
" "	Gurzi	134	476
SHUMA		322	1153
" Lushnjës	Lushnja	67	270
" "	Sejmenas	16	51
" "	Biçakaj	14	44
" "	Ferras	14	56
" "	Stanibobos	36	125
" "	Sulzotaj	5	10
" "	Qerret	14	47
" "	Vanar	22	48
" "	Kisha e Libofshës	10	30
" "	Rrethi i "	13	49
" "	Babunja	37	125
" "	Divjakë	4	13
" "	Karavasta	6	17
" "	Xhebbba*	21	134
SHUMA		279	1029
" Kavajës	Maskaresh	5	31
" "	Stan-iri	5	19
" "	Zeleshtik	3	8
" "	Herbert**	51	210
" "	Aganas	6	9
" "	Ballaj	20	73
" "	Gocë-Gogolaj	25	86

* Xhebbba: Ky katund është ngritur prej Misionit Britanik të kryesuar prej Z. Sams.

** Herbert: Ky katund është ngritur prej Zonjës Karnavon në emrin e të birit të saj.

Sota

"	"	Beden	4	9
"	"	Kalush	20	63
SHUMA			139	508
"	Fierit	Urë e Gurtë	31	116
"	"	Lejlek	10	46
"	"	Porteze	17	52
"	"	Dermënas	9	29
"	"	Murlajas	3	15
"	"	Balteza	7	19
"	"	Lalaj	1	2
"	"	Zhavar	10	42
"	"	Pojan	6	30
"	"	Havalejas	5	13
"	"	Mujalli	17	53
"	"	Hamil	6	26
"	"	Pluk	3	10
"	"	Bakere	10	33
"	"	Sheqi i madh	1	2
"	"	Bufas	3	12
"	"	Çipllakë	5	17
"	"	Të pa instaluar	16	68
SHUMA			100	585
"	Delvinës	Gjashtë	45	180
SHUMA			45	180
"	Kolonjës	Në katunde të ndryshme të ardhur nga Stambolli	33	175
SHUMA			33	175
"	Shkodrës	Fusha e Shtojit	30	174
SHUMA			30	174
"	Beratit	Roskovec	8	48
"	"	Berat	8	30
SHUMA			16	78
"	Leskoviqit	Suisse	25	150
SHUMA			25	150
"	Vlorës	Bishan	4	16
SHUMA			4	16

Përveç shifrave të mësipërme kemi edhe emigrantë që u instaluan gjatë vitit 1928 në këto vende:

Në Shkodër imigrantët e Hotit, Grudës e Trepshit	150	800
Në Gurëz	50	280

" Kosovë	40	215
" Gjirokastrë	35	185
SHUMA	275	1480
GJITHSEJ (Total)	1413	6109

Ata u përqendruan veçanërisht në relievin fushor të Myzeqesë, ku dhe u formuan fshatra të reja. Gjithashtu, në vitet 1928-1938, nëpërmjet Reformës Agrare përfituan rreth 1.650 familje të ardhura në Shqipëri. Duhet theksuar fakti se, një pjesë e mirë e tyre, u instaluan në Nënprefekturën e Fierit dhe të Lushnjës, veçanërisht në lokalitetin e Semanit dhe Libofshës. Ata u ndeshën me vështirësi ekonomike, si financiare ashtu edhe të mungesës së tokave prodhimtare. Disa prej tyre ndeshën edhe me kundërshtimin e një pjese të pronarëve në disa komuna, të cilët kërkonin largimin e kosovarëve nga tokat e tyre. Pavarësisht me përballjen e vështirësive, ata ditën të ruanin me fanatizëm traditat e tyre dhe të zhvillonin marrëdhënie të mira me vendasit.

Fakti është se në këto vendbanime, ishin instaluar edhe një numër kosovarësh që kishin emigruar në Turqi, të cilët u kthyen në Shqipëri në vitin 1925. Gjithashtu, aty ishin vendosur edhe grupi i tretë i të ardhurve nga Sanxhaku i Novi Pazarit, me veshje dhe zakone shqiptare që e kishin humbur gjuhën amtare, por me vendosjen e tyre në Myzeqe e rimorën gjuhën e tyre të vjetër. Kishte edhe emigrantë të tjerë të ardhur nga Maqedonia, që u vendosën me banim pranë kosovarëve. Në fushën e Myzeqesë kishte të vendosur edhe emigrantë çamë që i ruanin mjaft besnikërisht traditat e zakonet, të cilat ishin të veçanta nga vendalinjtë.

Dëshmi e qartë e trajtimit të emigrantëve nga shteti shqiptar, është edhe Dekretligji "Mbi vendosjen e emigrantëve", i propozuar nga Kryeministria dhe i aprovuar nga mbreti Zogu, më 2 shtator 1931, i cili lejonte emigrantët shqiptarë që të instaloheshin në Shqipëri sipas dispozitave të këtij ligji. Për nga rëndësia dhe vlerat që mbart ajo, mendoj se duhet të jepet i plotë në këtë studim.

Dekretligje mbi vendosjen e emigrantëve:

Art. 1. Gjithë ata persona të lënë jashta kufijve të Shqipërisë independente, që janë shqiptare prej gjaku dhe gjuhë, pa dryshim feje dhe seksi, që vijnë në Shqipëri të lirë me qëllim vendosje dhe mos kthyerjeje përsëri në vendet e tyre, kanë të drejte m'u instaluar si emigrant në Shqipëri në konformitet me dispozitat e kësaj ligje.

Art. 2. Emigrantat duhet t'u drejtohen organeve konsullore e diplomatike të shtetit shqiptar me paraqitjen e një lutje, ku do të tregohet qëllimi i shpërnguljes. Lutjen do ta shoqërojë një liste e cila do të përmbajë gjithë gjendjen civile të emigrantit dhe të anëtarëve të familjes që kryeson, tue i shtue për çdo person një fotografi të vogël.

Art. 3. Autoritetet kur marrin një kërkesë të tillë dhe konstatojnë se kërkuesi i përmbahet të gjitha dispozitave, lejmërojnë menjëherë Ministrinë nga e cila mvarret e kjo e njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Reformës Agrare. Autoritetet kufitare personat e emigruem kanë me i nisë për kryeqytet ose në vendet e caktuara më parë.

Art. 4. Në rast që emigrantat nuk kanë mjete ushqimi derisa të mbërrinin në vendin e destinuem për instalim autoritetet administrative detyrohen me u paguar shpenzimet e udhëtimit, dhe për ushqim e fjetje t'i jepen fr. ar 1 deri për çdo person.

Art. 5. Në rast që emigrantet, për arsye të pranueshme nuk kanë krye këto formalitete, autoritetet kufitare mundësisht duhet t'ua rregullojnë dokumentat në kufi.

Art. 6. Zyrat e emigrantëve ose nëpunësat që përfaqësojnë këto zyra në Prefektura ose Nënprefektura, që nga data e hyrjes së emigrantëve në Shqipëri, detyrohen me u dhënë për çdo frymë fr. ari 0.40 në ditë. Kjo ndihmë vazhdon një vit, tue paguar në katër këste të njishme.

Art. 7. Organet e Zyrës s'Emigrantave janë të detyruar të kërkojnë dhe tu gjejnë punë emigrantave e të vazhdojnë mirërojtjen e tyre.

Art. 8. Mjekët e Bashkisë të Komunave dhe të shtetit, detyrohen me i mjekue emigrantat e vobektë gratis dhe Zyra e Shëndetësisë obligohet me iu dhënë barna pa shpërblim.

Art. 9. Teshat, mobiljet, enët, veglat mjetet bujqësore ose industriale, shpendët dhe bagëtia që sjellin emigrantat me vete përjashtohen nga tagri doganor i importit.

Art. 10. Gjithë personat emigrues detyrohen me u regjistruar në Zyrën e Gjëndjes Civile ku do të instalohen si shtetas shqiptarë; letërnjoftimet u lëshohen gratis.

Art. 11. Që nga dita e regjistrimit për pesë vjet përjashtohen nga shërbimi ushtarak.

Art. 12. Shteti nga pasunia e vet u ep gratis emigrantave për truall të shtëpisë (që do të goditet simbas planit të pregaditur nga Drejtoria e Ref. Agrare), për dipendencat e për kopshtin 2.500 m² tokë; pas kësaj për çdo frymë të familjes u jepet edhe nga një gjysmë hektari.

Art. 13. Shtëpia dhe tokat e tregueme që nga dita e instalimit për pesë vjet janë të përjashtueme nga e dhjeta dhe kontributet e ndërtesave.

Art. 14. Tokë të papuneshme u falen emigrantave që janë bujq, kurse personave të tjerë që janë marrë me tregti të ndryshme, u falet nga një cop truall mbrenda në qytet në ato vende ku ka pasuni shteti.

Art. 15. Emigratat që janë marrë me zeje tregtare, si peshkatarë ose si marinarë instalohen në brigjet e detit të Shqipnisë

Art.16. Emigratat që kanë punuar mëndafshin ose duhan duhet të instalohen në vende adekuate.

Art. 17. Tokat që akordohen emigrantave janë këto që vijojnë:

a) tokë e punueshme e livadhet që formojnë pasunin e shtetit

b) tokë e shpronsueme prej Zyrës Agrare

Art. 18. Lënda e ndërimit të shpisë u falen gratis nga pyjet shtetërore.

Art. 19. Emigrantat që vendosen në një katund, çiflig ose në qytet përfitojnë nga të drejtat e kullotjes vetëm ndër prona shtetërore.

Art. 20. Në rast se emigrantat formojnë katunde të veçanta, ju akordohet toka gratis për xhami, për kishë, shkolla vorreza, godina pleqnare, dyqane, lulishte, depo.

Art. 21. Kur e lyp nevoja e instalimit dhe e shendetësis s/emigrantave, me hirin e dy palëve mund të blejnë tokë, livadhe ose kullosa që ndodhen nën zotnimin legjitim të privatëve. Tokat për emigrantat të blehen me fonde të posaçme të Zyrës s'emigrantat të blehen me fonde të posaçme të Zyrës s'emigrantave.

Art. 22. Emigrantat që nuk janë shqiptarë nga gjaku e giuha, nuk përfitojnë nga të drejtat e akordueme prej kësaj ligje.

Art. 23. Emigrantat bujqë përveç ushqimit të përmendun do t'u jepen deri një pend qe dhe nje lope me qumësht ose pesë dhëne pjella dhe vegla bujqësore. Gjithashtu do t'u ndihmohet në ngritjen e shtëpisë në formën më ekonomike.

II. Emigranat janë të ndaluem me tjetërsue shpijat e tokët e akordueme prej Mbretnis Shqiptare mbrenda 15 vjetëve prej ditës së dorëzimit të tyre.

III. Shpenzimet e bamuna për instalimin e emigrantave, kan me u rimborsue prej emigrantit detyrues me këste të njinjishme, tue fillue pesë vjet mbas ditës s'instalimit; këto do t'i kthehen arkës së shtetit ose Bankës Agrare që ka avancue fondin.

Art. 24. Ligja mbi vendosjen e emigrantëve me d.14.VI.1923 bashkë me rregulloren përkatëse abrogohen.

Art. 25. Ligja hyn në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art.26. Me ekzekutimin e kësaj ligje ngarkohet Këshilli Ministrues".

Përveç trajtimit vëllazëror që iu bë emigrantëve, për ta informuar kombin shqiptar dhe shtetet evropiane mbi pasojat e shpërnguljes me dhunë nga Kosova dhe viset e tjera, qeveria shqiptare, shoqatat atdhetare dhe personalitete, si Fan Noli, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Hoxhë Kadriu etj., ngritën zërin e tyre në qarqe më të larta shtetërore e ndërkombëtare të kohës, por nuk gjetën përkrahjen dhe mbështetjen që shpresonin.

Gjithsesi, falë luftës vetëmohuese të bërë nga vetë popullsia shqiptare e Kosovës dhe e Çamërisë për mbijetese, nga njëra anë dhe nga përpjekjet qeveritare shqiptare dhe opinionit publik në Shqipëri, nga ana tjetër qeveritë shoviniste jugosllave dhe ato greke nuk arritën të realizojnë përfundimisht projektet e tyre gllabëruese për spastrimin e Kosovës dhe Çamërisë nga popullsia autoktone shqiptare, gjatë viteve 1918-1941.

PËRFUNDIME

Fenomeni i shpërnguljes së shqiptarëve në periudhën midis dy Luftërave Botërore 1918-1941, është nga më tragjikët. Ajo ishte pasojë e interesave të Fuqive të Mëdha, që e lanë këtë popullsi jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, si pasojë e grabitjeve të tokave të tij, si dhe të dëbimeve masive të popullsisë autoktone shqiptare ndër shekuj.

Kjo tragjedi kombëtare me përmasa të mëdha, rrydhje e shpërnguljeve dhunë-gjenocidale, ndodhi si në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, por edhe në Çamëri ku qindra mijëra shqiptarë u larguan nga trojet e tyre me, duke lënë pas tyre familje e pasuri, por dhe hapësirë bosh. Ishte kjo një strategji e përgatitur ndër breza të pushtetarëve serbë, pse jo dhe atij grek që të përzinin sa më shumë shqiptarë nga trojet e tyre etnike e historike, të cilët u orientuan fillimisht në drejtim të Lindjes-Turqisë, e më pas në drejtim të territorit të Shqipërisë.

Ëndrra e afrimit të baraspeshës etnike në mes të popullsisë shqiptare, shumicë gjatë gjithë shekujve, dhe asaj sllave si pakicë, në Kosovë dhe trojet e tjera etnike shqiptare në Jugosllavi, ishte një përpjekje historike e përpunuar në detaje në shumë elaborate të përcjella brez pas brezi nga pushtetarët sllavë. Aleanca greko-sllave, me të cilën ishte rrethuar popullsia shqiptare, gjithnjë shprehte aspirata ekspansioniste territoriale, duke bërë spastrime etnike si në Mal të Zi, po ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni. Kështu, areali shqiptar gjatë historisë tkurrej, reduktohej e zvogëlohej, ndërsa numri i shqiptarëve në mënyrë permanente zvogëlohej.

Përpjekjet për mbrojtjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe Greqi, si dhe qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj këtij problemi, kanë pasur veçori dhe probleme specifike në periudha të ndryshme të zhvillimit historik. Ato u diktuan edhe nga koniukturat politike që kanë qenë vepruese në atë kohë, veçanërisht më të theksuara gjatë viteve '30 të shek. XX.

Megjithëse pasojat e shpërnguljeve të popullsisë shqiptare ishin të paparashikueshme në kohë dhe në hapësirë, ato mbartën mjaft dukuri e vlera ndër shqiptare:

Së pari, këta shqiptarë të shpërngulur me dhunë shfaqën një ndërgjegje të lartë kombëtare, një dashuri të madhe për atdheun. Ata kishin qenë pjesë e pandarë e lëvizjes shqiptare për pavarësi, prandaj nuk mund ta mendonin kurrë veten të shkëputur nga organizmi shtetëror unik i kombit nga mjediset etnike joshqiptare duke u bërë një forcë e madhe për kombin.

Së dyti, pavarësisht nga koha e qëndrimit kjo popullsi e re dha një ndihmesë të fuqishme në zhvillimin shoqëror-kulturor të krahinave të Shqipërisë. Ata dhanë ndihmesë dhe me traditat kulturore krahinore të viseve prej nga erdhën. Krijmtaria e tyre folklorike e në fusha të tjera të jetës shoqërore u ndje e gjallë në tërë viset e atdheut mëmë ku u vendosën.

Së treti, një nga dukuritë ndër shqiptare që mori një kuptim me një theks të veçantë e domethënës ishte edhe mikpritja. Ajo ka të bëjë me virtytet morale, me kodin e nderit të mirëpritjes nga vendasit dhe është e lidhur me traditën dhe me ligjet juridike dokësore, sidomos në mbrojtjen e mikut nga çdo ç'nderim e rrezik.

Etika popullore e popullit shqiptar bëri, që çdo shtëpi shqiptari të ishte e hapur për të gjithë miqtë, i afërt a i largët, njeri fisnik apo lypsar. Më shumë se kurrë, ajo spikati gjatë periudhës së shpërnguljes me dhunë, ku Shqipëri dhe populli shqiptar pritën me ngrohtësi dhe ndihmuan të ardhurit nga Çamëria në vitet 1944-1945, si dhe ata që erdhën nga Kosova gjatë vitet 1998-1999.

BIBLIOGRAFIA**1. Arkivat**

- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondet:

- 143 Koleksione dokumentesh (1484-1944)
- 151 Ministria e Punëve të Jashtme (1912-1917)
- 152 Ministria e Punëve të Brendshme (1918-1944)
- 249 Kuvendi Popullor (1945-1991)
- 490 Këshilli i Ministrave (1945-1947)
- 511 Ministria e Arsimit (1945-1988)
- 588 Rauf Fico (1913-1944)

2. Dokumente të botuara

1. "Bisedimet e Kuvendit Kushtetues (1924-1925)", disa vëllime
2. "Bisedimet e Dhomës së Deputetëve (1925-1928)", disa vëllime
3. "Libri i qarkoreve të Ministrisë së Punëve të Brendshme i viteve (1920-1929)", disa vëllime.

4. "Shqipnija më 1937. Veprim shtetnor gjatë 25 viteve të para të vetëqeverimit. I", Tiranë, 1937;

5. "Shqipnija më 1937. Veprim shtetnor gjatë 25 viteve të para të vetëqeverimit. II", Tiranë, 1938

3. Literatura historiografike

6. Bajrami, Hakif - Shpërgulja e shqiptarëve në Turqi gjatë viteve 1912-1941, Prishtinë, 1995

7. Jakupi, Ali - Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar, QIK, Prishtinë, f. 236

8. Verli, Marenglen - Shqipëria dhe Kosova historia e një aspirote, Vëll. I, Tiranë: Botimpex, 2007

9. Vinca, Agim - Çështja kombëtare dhe vetëdija kritike, Forumi i intelektualëve shqiptarë, Prishtinë, 1998

10. Selenica, Teki – Shqipria në 1927, Tiranë: "Tirana", 1928

11. Shtylla, Zamir - E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990

4. Gazeta:

10. "Shqiptari i Amerikës", Korçë, 12 janar 1924.

11. "Shqipëria e re", Kostancë, 24 tetor 1924.

GJENEZA, PËRPUNIMI DHE PËRKRYERJA E NJË VEPRE (ANALIZË GJENETIKE E MOTËRZIMEVE TË ROMANIT *GJENERALI I USHTRISË SË VEKUR*)

VIOLA ISUFAJ

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë
Email: violaisufaj@hotmail.com

AKTET IV, 4: 784 - 793, 2011

Përmasa e përkohshme e tekstit – objekt i studimeve gjenetike

Përpunimi dhe ripunimi i veprës letrare janë procese të vazhdueshme dhe të përhershme. Këto procese i gjejmë veçanërisht në veprën e shkrimtarit Ismail Kadare. Bukuria dhe përkryerja artistike e një vepre, sipas tij, bëjnë pjesë në lirinë e saj (Kadare, 1999: 73).

“Një vepër lind natyrshëm së bashku me projektin e saj që duhet të jetë origjinal dhe i papërsëritshëm, megjithatë gjatë të shkruarit, e sidomos gjatë lëmimit të veprës, vëmendja e shkrimtarit nuk ruan të njëjtën gjendje të tensionuar. Shumë herë e gjen atë që kërkon, e po aq herë qëllon që nuk e gjen. Ndjenja e humbjes e mundon përherë shkrimtarin. Një kohë të gjatë ai është midis dy mëdyshjeve: ta lërë një pjesë të pasurisë së tij të tretet apo ta sistemojë disi. Një herë i duket se ia vlen të flijojë një pjesë të kohës së tij për të kuptuar e plotësuar më mirë veprën e tij. Po aq herë i duket se s’është e nevojshme (Kadare, 1990)”.

Kërkesa për të ndrequr, plotësuar a përmirësuar diçka mund të jetë shenjë e vetedijes së pakënaqësisë dhe kërkimit të përsosmërisë. Tek Ismail Kadare kjo mënyrë të shkruari përsëritet e ripërsëritet thujse në çdo vepër, duke shënuar kështu një zakon të tij të kthyer në rit.

Në vitin 1962, në gazetën *“Zëri i Rinisë”*, botohet tregimi *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, ndërsa në vitin 1963, botohet romani me të njëjtin titull. Shkrimtari Ismail Kadare i sjell lexuesit një roman

të përmasave botërore, një roman të një cilësie shumë të lartë të të shkruarit. Përpunimi dhe ripunimi i këtij romani do të shënojë variantet e së njëjtës vepër: motërzimin e vitit 1963, motërzimin e vitit 1967, edhe motërzimin e fundit; atë të vitit 2001.

Përcaktimi i gjenezës së tregimit dhe i gjenezës së romanit, përcaktimi i ndryshimeve, përcaktimi i motiveve që çuan në ndryshime, analiza e procesit të përpunimit-këto janë aspektet që ofrojnë motërzimet e këtij romani. Kjo analizë e motërzimeve letrare i përket fushës së studimeve gjenetike.

Analiza gjenetike është një analizë kritike që bazohet në pohimin se teksti përfundimtar i një vepre letrare është rezultat i një përpunimi përmirësues nëpër kohë. Në qendër të këtyre studimeve është vënia në dukje dhe të kuptuarit e origjinalitetit të tekstit letrar nëpërmjet procesit që i dha jetë. Çdo dosje dorëshkrimesh ka një histori të veçantë: historinë që ka kaluar ndërmjet momentit kur autorit i fanitet ideja e parë e “projektit” të tij dhe momentit kur teksti i shkruar merr formën e një libri të shtypur. Objekti i kësaj analize, pra, është përmasa e përkohshme e tekstit. (De Biasi, 1982).

Kjo metodë e analizës kritike analizon dorëshkrimet për të kuptuar lëvizjen e stilit, metodat, konceptet, teknikat e transformimit të tekstit. Studimet gjenetike synojnë të përcaktojnë edhe parapëlqimet ripunuese të shkrimtarit,

parimet e ripunimit të veprës së tij. (De Biasi, 1982).

Gjeneza e tregimit dhe gjeneza e romanit

Kazmat e një gjenerali të huaj që ka ardhur të zhvarrosë një ushtri dhe eshtrat e një prostitute krijuan embrionin e tregimit (Kadare, 1996: 22) Gjeneza e romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, është tregimi *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*.

Një temë e veçantë, tragjike, së cilës Kadareja i shtjellon njëherazi ndërlikime logjike dhe të papritura, kërkon domosdoshmerisht një trajtim të jashtëzakonshëm rrëfimtari, madhështor. Subjekti që të habit me një lloj fuqie magjepëse, prek hapësira të pashkelura; këto janë hapësira letrare ku jeta dhe vdekja kalojnë natyrshëm tek njëra-tjetra. Ky kalim kërkoi skena ku të këmbehen dukuritë më të kundërta: koha e jetës me kohën e vdekjes, hapësira e vdekjes me hapësirën e jetës, ku të bashkëjetojnë të gjallët me të vdekurit të cilët do të gjykojnë e do të dënojnë njëri-tjetrin (Kuçuku, 2000: 16).

Romani përmban mundësinë e shndërrimit në një spektakël të një tabuje psikologjike dhe letrare, siç është zhvarrimi-romani mund t'i heqë velin misterioz një tabuje, duke e paraqitur makabritetin të rëndomtë, ndërsa tregimi është disi i kufizuar për të estetizuar një tabu.

Prirja gjithorizuese, sa është e natyrshme, dhe e vetvetishme, po aq është kthyer në vetëdije dhe qëllim, po aq është edhe e paramenduar. "*Shpesh, -vë në dukje Ismail Kadare, -nuk i jam shmangur dot tundimit për ta përfytyruar veten përballë një auditori kozmik, duke u rrekur të jap një raport për njerëzimin dhe rruzullin tokësor*" (Kuçuku, 2000: 18).

Këto janë shtysat e brendshme që çuan në kalimin nga një lloj i vogël proze në një lloj të madh. (Shtysa e jashtme, u bë Drago Siliqi, i cili e nxiti autorin të bënte këtë kalim (sipas Kadaresë tek *Ftesë në Studio*).

Nga tregimi në romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur": Zhvillimi i figurës së Gjeneralit

Peisazhi shqiptar me të njëjtat ngjyra hap tregimin dhe romanin; i vendosur që në fillim të romanit, përshkrimi i një peisazhi aq të trishtuar,

jo rastësisht jepet në këndvështrimin e gjeneralit, tek i cili do të zgjojë një shqetësim të brendshëm. (Dado, 1997: 127). Gjenerali vjen i trishtuar dhe duket se pritja që i bën natyra është po aq e trishtueshme sa misioni i tij. Në tregim dhe në roman shiu është tregues atmosferik shqetësues, pasi duket se përcakton fillin e mbrapshtë të misionit.

Pikëvështrimi ndaj figurës së Gjeneralit dhe në tregim edhe në roman është i njëjtë: një pikëvështrim i brendshëm nëpërmjet të cilit rrëfimtari zbulon gjendjen psikologjike të personazhit. Në roman është ruajtur nga tregimi teknika e shkrirjes së zërit të rrëfimtari me zërin e personazhit për të zbuluar gjendjen e rënduar që ai përjeton. Rrëfimtari i largohet pak a shumë ligjërit të tij dhe synon të flasë me zërin e personazhit duke ndjekur logjikën e mendimeve të tij. Kjo ndërthurje e zërave zbulon dhe të fshehtat e botës së gjenerali, zbulon dhe ato thellësi që rrëfimtari nuk i kap dot së jashtmi.

Zgjerimi i këndvështrimit mbi "të huajën e zymtë"- rëndimi i ankthit

Në tregim dhe në motëzimin e parë të romanit, gjenerali e sheh këtë tokë të huaj, këtë komb të huaj, si diçka thjesht të panjohur, si çdo gjë tjetër të panjohur. *E huaj* – është përcaktori i parë i përdorur në vepër për të treguar se kjo është një Shqipëri subjektive, jo e Kadaresë, por e gjeneralit.

Relievi, ngjarjet, njerëzit do të shihen e do të përjetojnë nga syri i të huajit. Në roman, ndryshe nga në tregim, e huaja paraqitet si një kaos i vërtetë toponimesh në mendjen e tij, jo vetem nga numri i tyre i madh, por edhe nga tingëllimi i pazakontë. (Emra luginash, grykash, pllajash, lumenjsh, qytetesh i dukeshin gjeneralit të jashtëzakonshme dhe të frikshme).

Në skenën e dasmës zbulohen zakone dhe rite të shqiptarëve. (Në roman shfaqet vajtimi dhe mënyra e vajtimit; rrëfimtari ndalet ngeshëm në përshkrimin e këngës, në mënyrën e të kënduarit; gjeneralin e përshëndesin duke vënë dorën në zemër, e ftojnë në valle.)

E huaja shfaqet mbrojtëse për te pambrojturit, qofshin edhe armiq. Në roman është thelluar

zymtia; përmes zymtësisë, në kronologjinë e rreptë dramatike të rrëfimit, Ismail Kadareja i mohon gjeneralit pranverën, ashtu siç i mohon edhe buzëqeshjen përgjatë gërmimeve endacake. Gjithçka fillon me shiun dhe përfundon me erën.

Në tregim shtrembërimi i kontureve të tokës së huaj, sikur paralajmëron vështiresitë dhe problemet që do t'i dalin gjeneralit gjatë zhvarrimit-në roman, shpeshherë, gjenerali paraqitet i llahtaritur nga e huaja; ai ndihet i bllokuar në këtë vend, i gjendur si nga një mallkim aty dhe i duket se nuk do të dalë kurrë nga ky rrethim. Duket sikur toka nuk ka dëshirë të nxjerrë nga dheu i vet ushtarët e huaj. Natyra e egër paralajmëron vështirësitë që kjo tokë duket se i nxjerr me dashje gjatë zhvarrimit.

Në roman "e huaja" shprehet e plotë; me folklorin, historinë, ritet, zakonet, por shprehet edhe tragjike, e veshtirë, e tmerrshme. Krimet e luftes që zbulon gjenerali, vetëpërbajtja e shqiptarëve (gjenerali e ndjen këte vetepërbajtje), shkaktojnë ankth. Gjenerali, jo vetëm është i huaj, por është edhe ai, nëpërmjet të cilit, pas njëzet vjetësh plagët e luftës lëndohen. Në dasmë një plakë shqiptare e akuzon se ai ka ardhur për të parë sesi i martojnë shqiptarët bijtë që të vijë pastaj për t'ua vrarë.

Nga ideja tek arkeologjia e vdekjes

Romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur, është shestuar mbi një tabu psikologjike dhe letrare siç është zhvarrimi. Lexuesi i romanit hyn në një midis të paqenë, madje të ndaluar, në hapësirën e varrit dhe të përtejjetës.

Në roman (kap II), përshkruhet dita e parë e zhvarrimit konceptuar në dy plane që ndërthuren. Plani i varrosjes ndërthuret me planin e zhvarrosjes.

Struktura e *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* është ndërtuar mbi përftesën shkak-pasojë të një drame me dy akte: vdekje-dështim dhe zhvarrim –ndëshkim, pra nuk niset drejtpërdrejt nga shkaku dhe tragjedia konkrete, por nëpërmjet retrospektivës, niset nga pasoja dhe përmbyllja e tragjedisë. Pas këtyre është rikthyer jeta. Ka një perspektivë historike. E sotmja e jetës së përtërirë është pauza shoqërore dhe

psikologjike, është koha e "gjqyt te ndëshkimit", koha e purgatorit të pendesës dhe e katarsës së njerëzimit të fajshëm. E sotmja, nga pikëvështrimi i së cilës rrëfëhet, është vetëdija e re dhe morali njerëzor mbizotërues që dënon luftën në emër të paqes dhe të drejtësisë.

Kundërshtia midis mbulimit të varrit dhe gërmimit të tij, tregon se ushtria që është gjithmonë dhe vetëm e gjallë,-mishërimi i forcës më të madhe, më të organizuar, që është burim sigurie, lavdie, krenarie, është shndërruar në të kundërtën e vet, në antonimin e të gjitha cilësive të saj. Gërmimi i varrit, tregon në këtë mënyrë, edhe se rrjedhimisht gjenerali është kthyer në mohim të vetvetes, në varrmihës, apo punëtor komunaleje.

Plani i varrosjes ndërthuret me planin e zhvarrosjes edhe për të theksuar kundërshtinë midis dëshirës së ushtarit të vrarë për të mos iu gjendur eshtrat (plani i varrosjes) dhe dëshirës së gjeneralit për t'ia gjetur eshtrat sa më parë (plani i zhvarrosjes).

Skena e hapjes së varrit të parë- skenë që nuk është në tregim, ka edhe një funksion sintetizues: ajo përmbledh, përgjithëson, rrëfen një herë atë që do të ndodhë shumë herë gjatë romanit.

Zgjedhja e kohës gramatikore, (e pakryera), të shpie në idenë e përsëritjes e të pambarimit. (Takimi me gjeneral-majorin nuk është në tregim. Mendimet, batutat ironike që këta gjeneralë këmbëjnë tregojnë se ata janë të trazuar nga fati që koha u ruajti)

Rrëfimi brenda rrëfimit

Rrëfimi i shkallëshkallshëm për Kolonelin Z. Linja e kolonelit Z, intriguere dhe sintetizuese, e endur hollë dhe mjaft tërheqese, bëhet papritmas një linjë kryesore në roman; skena dhe ndodhi të rëndësishme vihen në funksion të saj; ndërthuret kjo linjë me fate njerëzish të huaj dhe vendas, në aspekte ushtarake dhe njerëzore, me fate misionesh dhe lojëra interesash.

Që nëpërmjet një koloneli italian ka një kritikë ndaj të gjithë llojeve të fashizmit, kjo duket fare hapur. Përtej ushtrive musoliniane, apo hitleriane që dogjen a gjakosën, vihen në shenjestër dhe denoncohen të gjitha llojet e ushtrive.

Rrëfimi në trajtën e ditarit Rrëfihet për botën në sytë e ushtarit të huaj (një ushtar pa emër, një dezertor italian, që strehohet nga një millona shqiptar dhe bëhet shërbëtor tek ai, rrëfen me anë të ditarit të tij);-në këtë rrëfim më tepër sesa ngjarje, ka përfjetim të ngjashëm me të ushtarëve të tjerë. Jo më kot, ushtari nuk identifikohet. Atë e thërrasin “ushtar” sepse fati i tij është i ngjashëm me atë të ushtarëve të tjerë. Edhe në takimin e tij me një ushtar tjetër, ata të dy nuk prezantohen me emrat e tyre, por me emrat e regjimenteve (në luftë, njeriu humbet ekzistencën e tij dhe shndërrohet në mjet).

Ndërthurja e rrëfimit me përshkrimin, monologun e dialogun në skenën e dasmës.

Skena e dasmës, e cila mund të qëndrojë si një tregim më vetë— një nga skenat më të habitshme të romanit, është në vetvete një dramë në të cilën luajnë shkaktarë njerëzorë dhe heronj të pafajshëm tragjikë. Skena ndërtohet në bazë të një shkallëzimi dramatik, kulmi i së cilës shënon për gjeneralin edhe ndodhinë më të pakëndshme në Shqipëri, kulmin e tronditjes së tij. Gjenerali bart mbi shpinë gjithë dënimin, ndëshkimin turpërimin dhe përbuzjen.

Rrëfimi restrospektiv i priftit shqiptar. Në roman midis shumë rrefimëve, është dhe rrefimi retrospektiv mbi Nik Martinin, një malesor, që i vetëm zuri pritë dhe qëlloi në katër pika të ndryshme trupat që zbarkonin në atë vend të humbur. Në këtë kapitull historikja bashkohet me legjendën.

Rrëfimtari i dytë rrëfen për shtëpinë publike Në roman, kemi një ndodhi të rrëfyer nga një rrëfimtari i dyfishtë. Rrëfimtari rrëfen rrëfimin e kafexhiut mbi një prostitutë që “ka rënë për atdhe”.

Romani brenda romanit. Mik apo armik i shqiptarëve?

Ndryshimi i dukshëm i figurës së gjeneralit prek anën thelbësore-nga gjenerali i motërzimit të parë që është më tepër për t’u dhimbsur sesa për t’u urreyer, ai është shndërruar në një gjeneral të vrazhdë, cinik, në një armik.

Në ndryshim nga gjenerali i nga gjenerali i romanit të vitit ‘63, ku gjeneralit shiu do t’i dukej

një përkim i, gjenerali i i romanit 1967 është i parapërgatitur për pritjen kërcënuese të tokës dhe natyrës shqiptare-theksohet dukshëm se gjenerali e di se të huajt nuk do ta mirëpresin aspak dhe për këtë, shiu nuk i duket një koicidencë e trishtuar.

Pamja e maleve më tepër se e zyrtë dhe jomikpritëse i duket kërcënuese dhe armiqësore. Vetëm pas kërkimeve të gjata e të vështira, gjeneralit të motërzimit të parë i duket sikur toka s’do të bashkëpunojë, sikur s’do të njerrë nga gjiri i saj ushtarët e huaj, por ende pa nisur gërmimet, madje, pa arritur ende në Shqipëri, gjeneralit të motërzimit të dytë i vijne ndërmend fjalë që i karakterizojnë male tona si të mallkuara e nga kthetrat e tyre zor se mund të shkëpusësh eshtrat e ushtarëve. Ja si ndryshon ngarkesa leksikore e përcaktorëve që karakterizojnë terrenin shqiptar nga një roman tek tjetri: terren *i vështirë-male të nëmura* (duke theksuar ndjenjën armiqësore për tokën shqiptare).

Në skenën e dasmës, gjithashtu, diçka ka ndryshuar në mendimet e gjeneralit. Kur ai kërkon të hyjë në valle, mendon si pengesë të vetme e të papërfillshme vështirësinë e valles.

Këto valle janë të thjeshta, pastaj para kujt do të bëhem qesharak, para këtyre katundarëve?

Ai shpjegon mikpritjen e shqiptarëve si një dukuri që vjen natyrshëm nga prania e tij. Ai nuk ndjen më pasiguri as para priftit, as para të huajve. Dhe kjo “e huaj” nuk do ta ngazëllej gjeneralin dhe nuk do t’i shkaktojë asgjë të ngjashme me mahnitjen dhe hutimin që i shkakton në motërzimin e parë. As gjuha shqipe nuk i duket interesante, përkundrazi: “gjuha shqipe i dukej e rëndë”

Gjenerali i variantit të 1967 është një ushtarak krenar që e nderon ende luftën, ndonëse ajo solli vetëm skatërrim dhe vdekje. Qëndrimin ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve e përcakton që në fillim ndjenja e hamarrjes dhe e urrejtjes që i zgjojnë në shpirt listat e pafund të ushtarëve të vrarë në Shqipëri: *Ç’mund të bëj unë për ta? Si mund t’ua marr hakën?*

Kjo ndjenjë e shtyn gjeneralin e romanit të vitit ‘67 të shohë tek çdo shqiptar një armik e të

mendojë se në çdo hap do t'i kurdiset një provoacion. Këto qëndrime e kanë bazën në mentalitetin racist të këtij militaisti të vjetër dhe zbulojnë në këtë roman një botë paragjykimesh tradicionale. Kështu, qëndrimi i shqiptarëve i ngjall lloj-lloj dyshimesh; çdo gjë i kall në shirt frikë e urrejtje: *Nëse ata në këngë të tyren, bëjnë aluzion për ne, mbani shënim.*

Këto hamendje nxjerrin në pah kotësinë e dyshimeve të gjeneralit, i cili është vendosur disa herë në situata komike e groteske:

Në një luginë, ne gjetëm të përziera me ehtrat e ushtarëve eshtra mushkash - tha gjeneral - lejtanti.

Gjenerali u rrënqeth

- S'ishte provokacion. Vetë tanët i kishin varrosur shpejt e shpejt.

Gjenerali është i gatshëm të pranojë sfida dhe të sfidojë. Kërkon të paguajë për të ulur dinjitetin e shqiptarit dhe për të vënë në dukje varfërinë e tij. Këtu në ndryshim nga motërimi i parë është theksuar epërsia morale e shqiptarëve. Kjo vihet re tek qëndrimi korrekt, dinjitoz i fshatarit shqiptar. Gjeneralin e trondit fundi qesharak e i hidhur i armatave të "të pathyeshme", të udhëhequra prej kolegëve të tij, të cilët, u katandandisën të ruanin pula në fshatra duke "e bërë leckë" prestigjin e vendit dhe ushtrisë së tij. Gjenerali i romanit të vitit 1967 i përbuz ëndërrimet e gjeneral-lejtnantit për vajzën që pret të fejuarin tek stadiumi. Ndonëse gjenerali e kupton se është rinia, vetë shfaqja e jetës ajo që turbullon gjeneral-lejtnantin, (kanë kaq kohë që vërtiten duke nuhatur vdekjen atje ku është strukur dhe duke e ndjellë me gjithfatë mënyrash të dalë jashtë) e vlerëson si diçka shumë të shëmtuar magjepsjen pas vajzës së stadiumit.

Ndryshe nga gjenerali i romanit të vitit 1963, gjenerali i këtij romani duket se nuk ka dashur ta hedhë vërtet thesin me eshtrat e kolonelit Z. Ky veprim ngjan më tepër me një aksident. Jo vetëm kaq, por ai është penduar për këtë dhe është ai vetë që mendon të zëvendësojë eshtrat e Kolonelit Z. Ky gjeneral jo vetëm propozon të zëvendësohet thesi, por dhe, në gjendje të dehur, i lutet priftit për këtë.

Një gjeneral që urren dhe mendon të hakmerret, që degradon, që bie në situata qesharake, që gjen gjuhën e përbashkët me priftin, cinik dhe i vrazhdë, përbuzës dhe përcmues, një ushtarak i huaj armik i vërtetë-ky është gjenerali i romanit të vitit 1967.

Përse janë bërë këto ndryshime? Motërimi i parë shkaktoi tronditje në letërsinë shqipe. *"Kur e shkrova këtë roman, më 1962, pas kthimit nga Moskë e ndjeja veten ende të lirë. Skllavëria është si e ftohta, ajo të pushton shkallë-shkallë. Roberia komuniste kishte prekur disa pjesë të qenies sime, por ato ishin ende në rrethinat e saj. Ajo s'kishte depërtuar ende brenda tempullit, d.m.th. në krijimtarinë time."*²

Vala e ngazëllimit që e madhe, por kritika zyrtare u tregua e rreptë.

Ajo e fajësoi romanin për dy të meta: e para për klimën e zyrtarë që vinte në kundërshtim të plotë me atmosferën festive të letërsisë së realizmit socialist, dhe e dyta, për mungesë urrejtjeje ndaj armikut. Kjo akuzë në termonilogjinë komuniste formulohej si "dobësim i luftës së klasave"(të mos kishe urrejtjeje ndaj një gjenerali perëndimor, pra një gjenerali të NATO-s në një vend si Shqipëria!!!)

Kështu përpunimi për të theksuar tek ky personazh vrazhdësinë, cinizmin, urrejtjen ndaj Shqiptarëve i detyrohet deri diku realizmit (gjenerali nuk ka luftuar në Shqipëri, por ka udhëhequr armatat e tij në Afrikë. Duke qenë se nuk e dënon luftën, ai është po aq fajtor sa gjeneralët e tjerë që udhëhoqën armatat e tyre në Shqipëri dhe ka të njëjtën filozofi si ata: filozofinë e urrejtjes), e, po aq, dhe realizmit socialist.

Në romanin e vitit '67 paraqiten ndryshime të dukshme, theksohen faktet e një realiteti të ri në Shqipëri, por duke nxjerrë në pah idenë se populli shqiptar është një popull me vitalitet të rrallë. Pohimi i kësaj gjen shprehje në disa momente të veprës.

Fabrikë për përpunimin e bakrit

Gërrmojnë, vazhdimisht gërrmojnë

Hapin toka të reja buke

Në një vend pashë që kishin mbyllur edhe dy anët e trasesë së hekurudhës.

Ç'nuk mbjellin. Si duket koha nuk u mjafton.

Le t'i referohemi mendimit kritik të kohës për të arsyetuar edhe më tej se ç'shaqe e shtynë Kadarenë të bëjë këto ndryshime: *"Maksim Gorki ka thënë se hero kryesor për realizmin socialist është puna. Por kjo s'duhet marrë si diçka e përciptë, që të pasqyrosh procesin e punës, makinat dhe njerëzit me to. Duhet kuptuar se heroi i letërsisë është njeriu që punon, njeriu i ri. Për artistin realist esencjalja është e reja... të pasqyrojë në rradhë të parë aktualitetin imediat, ditët që kalojmë. Por pasqyrimi i konflikteve aktuale të ditës është gjithnjë më i vështirë, sepse shkrimtarët shpeshherë, me thellim të dyfishtë dhe guxim duhet të dallojnë të renë që në embrion."* (Siliqi, 1969: 72-76).

Gjenerali i motërzimit të dytë është një ushtarak i zyrtë, por dhe vendasit s'janë më pak të zyrtë. Një ardhmëri që s'i përket askujt. Bie në sy armiqësia, përcmimi, neveria, mllëfi.

Këta dreqër paskan qenë të fortë për luftë

Ç'dreq populli-tha gjenerali

...malet e neveritshme

E kaluara tragjike evokohet përmes përkthimit të dobët e të fjalëpërfjalshëm që i bën prifti këngës së *"Urës së Qabesë"*. Në motërzimin e parë gjenerali turbullohet nga fryma tragjike që mbizotëron në këngët shqiptare. Ai interesohet për këto këngë, mahnitet dhe e pranon se s'mund ta kuptosh folklorin e këtij populli, pasi duhet së pari të zhytesh hellë në shpirtin e tij. Por ja sesi shprehet gjenerali i romanit të vitit '67 për frymën tragjike që mbizotëron në këngët shqiptare: *"Zi edhe më keq"*.

Edhe ushtarët paraqiten të frikësuar e të shqetësuar deri në ankh: *Rrinin shtrirë në tokë dhe me siguri secili mendonte: Ç'është ky qiell kështu, nëna ime?*

Në romanin e vitit 1967 shqiptarët paraqiten dinjitozë dhe kjo gjen shprehje në episodet që tregojnë mbi qëndrimin e shqiptarëve ndaj ushtarëve të mundur që mbetën në fshatra.

Është ripunuar edhe skena e dasmës në disa momente, duke përcjellë kështu idenë se s'duhet ushqyer asnjë iluzion ndaj armikut, ndryshe nga motërzimi i parë:

Do të jetë ndonjë shqiptar që ka ardhur nga Amerika-tha një plak-ka nga ta që e kanë harruar fare gjuhën shqipe.

Ç'duan në dasmat tona?-tha njëri nga djemtë e rinj.

Guxojnë edhe të ngrihen në valle.

Shqiptarët nuk bëjnë lëshime këtë rradhë. Në këtë roman të vitit '67 vihet re një frymë armiqësie e ndërsjelltë, një konflikt aspak i heshtur që sa vjen e thellohet. Mbi këto ndryshime ka ndikuar mendimi kritik i kohës, sipas të cilit një rëndësi të dorës së parë ka aktualiteti i konfliktit. *"Artisti realist duhet të gërshetojë drejt e me kriter artistik kritikën e negatives me mbrojtjen e pozitives, që prgjithësisht është një gërshetim i konflikteve me karakter antagonist dhe joantagonist."* (Siliqi, 1969: 78).

Sipas Drago Siliqit, konflikti i bazuar në luftën e të kundërtave ka qenë dhe mbetet motori i çdo veprë artistike.

Ndërsa Jorgo Bulo për *Gjeneralin* shprehet se ky roman është një polemikë me letërsinë dekadente të kohës që e trajton temën antifashiste nga pozita pacifiste dhe mbi bazën e koncepteve ekzistenciale. Vërejmë ndryshimet e mëposhtme:

Do të nxjerrim dhe ballistët e vrarë e do t'i shpiem prapa diellit, në vend të huaj. Edhe të vdekur të jenë bashkë me hasmin.

Fshati pranë është mbushur me ballistë.

Ka një javë që janë shtruar në fshat si në shtëpi
Gjenerali vështron parrullat nëpër mure. Kuptoheshin vetëm fjalët *"revizionizëm"*, *"plenum"* dhe emri i Enver Hoxhës në një citim të shkurtër.

Subjektin e Gjeneralit e punova disa herë. Kur paraqita më në fund në formën e romanit, redaktori më bëri një vërejtje themelore: ishte i vetmi roman me temë nga lufta antifashiste ku mungonte jo vetëm roli i partistë komuniste, por nuk përmendej as emri i saj. S'po merrem me të tjera-the-po mungesën e partisë nuk ta fal dot. E mora dorëshkrimin dhe pasi e shfletova shpejt e shpejt e shpejt, e kuptova se ishte një kërkesë vrasës për veprën. Megjithatë m'u deshën vetëm tri-katër minuta për të bërë retushin e nevojshëm.

Në kreun e pestë, në mesin e tij, shtova vetëm një frazë afodine, frazë që mund ta shkruante çdo shkrimtar në botë, qoftë perëndomor, fetar, fashist, komunist, apo dekadent. "Gjenerali pinte kafe dhe vështronte parrullat në mure. Kuptoheshin vetëm fjalët "revizionizëm", "plenium" dhe emri i Enver Hoxhës në një citim të shkurtër." U ktheva pas disa ditësh në shtëpinë botuese me dorëshkrimin në duar dhe me pamje triumfatori. I thashë redaktorit që në vend të emrit të partisë, kisha shkuar më larg, kisha vënë emrin e shefit të saj, dhe ai tha "aq më mirë". Ç'është e vërteta ku pa frazën, mbledhi buzët, por s'kishte ç'thoshte. Emri i diktatorit ishte shtypës. Me zemër të thyer pranoi që vepra të shkonte në shtyp.

Rëndimi i ankthit-shformimi psikik i gjeneralit:

ajo çka shënjon ndryshim në këtë variant është se katastrofa morale që pëson gjenerali është jo vetëm rezultat i zhgënjimit në misionin e tij, po dhe fundi logjik i një konflikti me shqiptarët më të thellë se në variantin e parë:

Baltë e mallkuar. K y nuk është kërkim, ky është panik.

Kur shikoj fytyra njerëzish, imagjinoj si do ta kenë kafkën.

Gjenerali ndjeu frikë. E kaluara nuk harrohej kollaj dhe shqiptarët janë hakmarrës.

Dyshimi i llojlojshëm që i ngjall qëndrimi i shqiptarëve, pamja e maleve që e tmerron, frika e hakmarrjes nga shqiptarët.-i kallin në shpirt jo thjesht një tis zymtie, por frikë të përzier me ankth, urrejtje e nervozizëm. E kaluara për të cilën i flasin armatat e tij që dergjen nën dhe, e, nga ana tjetër e tashmja të cilën arrin ta njohë drejtpërdrejt përmes kontakteve me shqiptarët, trondisin thellë në qenien e tij atë lloj krenarie e madhështie me të cilën ka ardhur në tokën shqiptare.

Rrëfimi brenda rrëfimit i pasuruar Udhëtimi i gjeneralit në të dyja motërzimet ka shërbyer për të lidhur episodet, ngjarjet, gjykimet e personazheve të ndryshëm që kanë të bëjnë me të kaluarën dhe të sotmen. Romani i vitit '67 paraqitet edhe më i pasuruar me skena e situata

në formën e kujtimeve të të afërmeve të ushtarëve ose të shokëve që kanë mbetur gjallë. Gjithashtu një pasuruar copëzat e jetës në luftë, të riprodhuara në formën e ditari të ushtarit të panjohur:

S'ka hipokrizi më ta madhe se kërkimi i eshtrave pasi mbaron lufta. Unë për veten time nuk do ta doja këtë favor. Këtë medaljon të poshtër do ta flak ndonjë ditë. Dhe ai e flaku vërtet dhe mbeti pa të.

Ushtarët dënojnë mashtrimet e prijësve të tyre, farsën që luajnë me ushtarët jo vetëm kur janë gjallë, po dhe pas vdekjes, kur mbledhin eshtrat e tyre. Është një kritikë kundër absurditetit të ushtrive pushtuese që përfundojnë në asgjë dhe në turp.

Janë shtuar disa biseda në kujtimet e gjeneralit që përforcojnë kritikën ndaj fashizmit dhe dyfytërsisë e misioneve të tilla:

Misioni juaj është një hipokrizi.

Gjenerali u zverdh në fytyrë.

Kështu flasin të shiturit. Marsh përjashta.

Rrëfimi mbi urën është shtuar për të plotësuar rrëfimet e ushtarëve për shokët e humbur dhe në veçanti, për të dhënë përjetimet plot ankth të ushtarëve fashistë në token e huaj.

Vdekja e varrmihësit të quajtuar Reis është vetëm në romanin e vitit '67. Mikrobi qëndron i fshehur nën tokë dhe pas 20 vjetësh shpërthen. Kufoma hakmerret.

Ndryshim tjetër është heqja e përmbajtjes së telegramit të një grupi veteranësh, të cilët në motërzimin e parë, përgëzonin gjeneralin për flakjen e eshtrave të kolonelit. (Por në këtë motërzim, gjenerali është penduar për flakjen e eshtrave të kolonelit dhe i është lutur priftit për zëvendësimin e tyre. Kështu, do të ishte e pavlerë përmbajtja e një telegrami të tillë.)

Përsheptimi i kohës së zgjatur. *Erdhi pranvera dhe kaloi...* Ndryshe nga motërzimi i parë, koha përsëritet. Kërkimi është zgjatur më shumë se ç'është parashikuar; ka një shtyrje afati për kohën e kërkimeve. Por ajo çka është e rëndësishme në këtë riciklim të kohës është lehtësia me të cilën pranvera dhe vera kalojnë: personazheve (përmes këtij procedimi të elipsës

kohore) u mohohet e drejta për të jetuar nën diell, ata mund të enden vetëm në atmosferë vjeshte me baltë, shi, gjethe të vyshkura.

Grotesku më i shpeshtë. Në të dy motërzimet ka përftesa groteske që janë në themel të kësaj vepre. Ato organizojnë strukturën dhe kompozicionin e saj. Fabula është organizuar mbi një veprim të skajshëm e tmerrues: zhvarrimin dhe mbledhjen e eshtrave të të vdekurve. Grotesku përftohet prej një lloj barazimi shpërpjestimor të figurave, gjendjeve dhe veprimeve të personazheve: *Në një luginë ne gjetëm të përziera me eshtrat e ushtarëve eshtra mushkash-tha general-lietnanti.*

Funksioni i njësimin të eshtrave të ushtarëve me ata të mushkave është theksimi i idesë se në luftë njeriu humbet çdo lloj identiteti: *Të gjithë janë një e tetëdjete e dy. Më duket se edhe unë vetë jam një e tetëdhjetë e dy.*

Në këtë situatë groteske përftohet nëpërmjet njësimin të eshtrave të kolonelit të vdekur me eshtrat e vetë gjeneralit që është i gjallë. Funksioni estetik-shprehja e ndëshkimit të rëndë të gjeneralit. Grotesku e njëson atë me kolonelin e vrarë nga një plakë shqiptare: *Të më qëllonte mua të këndoja një këngë të kësaj natyre për ushtarët që po mbledh, kushedi ç'gjë e llahtarshme do të dilte.* (ndërthurje e një dukurie qesharake me një tmerruese)

Përftesat më të dendura groteske në motërzimin e vitit '67 i japin edhe më dramacitet rrëfimit dhe i përshtaten më së miri natyrës intriguese të fabulës.

Gjenerali dhe prifti më pranë njëri-tjetrit Një ide, një situatë dhe sidomos një personazh i vënë përballë tjetrit, fiton një vlerë të re dhe i jep forcë e mprehtësi idesë qendrore. Mbi bazën e këtij parimi gjenerali dhe prifti janë vendosur në një lidhje të dyfishtë: ata edhe plotësojnë njëri-tjetrin, edhe qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. Me urrejtjen për shqiptarët dhe pikëpamjet e filozofitë e tyre gjenerali dhe prifti në plan shoqëror plotësojnë njëri-tjetrin, kurse në plan individual ata i ndan mënyra sesi i përjetojnë gjërat: gjenerali e përjeton disfatën e vet në

mënyrë më tronditëse; prifti me cinizëm e qetësi. Kjo i ve shpesh përballë njëri-tjetrit. Një zgjidhje e tillë artistike i ka dhënë rrëfimit një karakter më dramatik, e për pasojë dialogu është bërë më psikologjik e më i mprehtë. Këta personazhe, njëri me botën e tronditur nga një disfatë e dyfishtë, tjetri me cinizmin e vet karakteristik dhe me filozofinë e urrejtjes, nxisin mendimin për fatet historike të popullit shqiptar. Marrëdhëniet midis këtyre dy personazheve nuk janë aq të tensionuara sa në motërzimin e parë:

Ju kërkoj ndjesë

Ju dëgjoj me kënaqësi.

Dialogët për Shqipërinë dhe shqiptarët nuk kthehen më në debat, sepse gjenerali e mbështet priftin në botëkuptimin e tij për zakonet e shqiptarëve. Shpesh ata kanë të njëjtin mendim, ose herët a vonë bien dakord për çështje të ndryshme.

Prifti dhe gjenerali gjenden më pranë njëri-tjetri në këtë morëzim: *Prift, -tha, -erdha të pajtohem.* *Kot që u grindëm për thesin.*

Nga motërzimi i dytë në motërzimin e tretë

Përpunime stilistikore në motërzimin e tretë.

Proza në e Kadaresë ka prishur disa kufinj tradicionalë midis shtresave të ndryshme strukturore, midis fjalës së autorit dhe asaj të personazheve, midis dialogut e monologut. Në motërzimin e vitit 2001 Kadareja e ka përpunuar më tej këtë teknikë, duke shmangur disa shenja të pikësimit, gjë që nuk vihet re në romanin e vitit '67. Psh në dialogët që i kujtohen gjeneralit nuk kuptohet se ku mbaron fjala e narratorit dhe ku nis ligjërimi i njërit apo tjetrit personazh. Fjalët e personazheve përzihen e shkrihen me njëra-tjetrën e po ashtu, dhe me fjalën e rrëfimitarit duke i dhënë thellësi rrëfimit. Ditari i ushtarit të panjohur italian nis me gjysmën e një fjalie (duke theksuar përhubjen), jo më një fjali të plotë e të qartë si në variantin e vitit '67. Frazja e ndërtuar në këtë mënyrë vjen natyrshëm tek lexuesi dhe më me vërtetësi. Bëhet fjalë për një ditar çfarëdo të një ushtari çfarëdo e, përveç kësaj, ka kaluar mjaft kohë që kur ushtari italian mbante këtë ditar dhe koha ka lënë gjurmët e saj. Ndonjë fletë e shkëputur, e humbur apo e prishur, ndonjë fjali

e fshirë dhe fraza e këtij ditari vjen e cunguar, e paplotë. Kështu, dhe lexuesi me ndërmjetësinë e kësaj teknike hyn më natyrshëm në kohën e rrëfimit.

Përftesa të tjera të groteskut dhe ironisë.

Përpunimi në këtë motërzim ka prekur dhe anën leksikore. Përpjekja për të zëvendësuar deri në fund fjalët e huaja më fjalë shqipe dëshmon për kërkimin e përsosmërisë.

Ombrellat- hijëzat

Arkivol- arkëmort

Vigjilencë- syçelësi

Oxhak- tymtar

Kapotë- pallto

Tavull duhani- hirnore

Muhabet- kuvendim

Kapuçin e mushamasë- kokoren e mbipetkut

Dentisti- dhëmbtari

Bien në sy disa neologjizma: *thirravajë* apo *vdeknajë* sipas gjedhes *akull-akullnajë*.

Në zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe bie në sy dhe zëvendësimi i emrit *Reis* me *Gjolekë*. Edhe pse romani i është drejtuar një auditori universal me përkthimin e tij në gjuhë të huaja, autori sjell zërin e Shqipërisë në këtë auditor të madh.

PËRFUNDIME

Gjenerali i ushtrisë së vdekur është pa dyshim teksti që ka pësuar më shumë ndryshime që nga lindja e tij. Kalimi nga tregimi në roman ishte një domosdoshmëri artistike. Ndërrimi i zhanreve do të sillte një tekst të gjallë e të larmishëm. Në labirintet ku enden gjenerali dhe ushtria e tij prej kalciumi, lexuesi ndeshet me “xhapa letrarë” që mund të qëndrojnë më vete. Kështu, ditari i një ushtari italian të kthyer në shërbëtor në shtëpinë e një fshatari shqiptar, tregimi për shtrëpinë publike, rrëfimi retrospektiv për Nik Martinin, apo rrëfimi i shkallëshkallshëm për Kolonelin Z., skena e dasmës (ku gjenerali harron se përfaqëson një ish-ushtri pushtuese dhe beson se është i barabartë me të tjetrët, një plakë i hedh eshtrat e një koloneli)-të gjitha këto afirmojnë fuqinë romaneske të këtij shkrimtari.

Romani luhet në dy plane; në të ka tunele që lejojnë të rrëshqitet nga një epokë në tjetrën; fillimi i viteve 60’ dhe akoma më tej: lufta e fundit.

Subjekti dhe arkitektura e romanit kanë pranuar një larmi të pakufizuar elementesh strukturorë, këmbimin e lirë të planeve, kapërcimet dhe kalimet e vazhdueshme, pasurimin e teknikave rrëfimtare.

Ripunimi i romanit të vitit 1963, shënoi botimin e vitit 1967-që është dhe motërzimi kryesor. Ky morëzim ndryshoi figurën e gjeneralit. Nga një gjeneral që është më shumë për t’u dhimbsur sesa për t’u urreyer, ai është shndërruar në një ushtarak me mentalitet fashist racist. Qëndrimi i tij cinik nuk qëndron shumë nga qëndrimi i priftit; ata dhe pse i ndan mënyra sesi e përjetojnë disfatën, i bashkon përçmimi, urrejtja ndaj shqiptarëve. Në këtë motërzim katastrofa morale që pëson gjenerali është jo vetëm rezultat i zhgënjimit të misionit të tij, por edhe fundi logjik i një konflikti me shqiptarët, më të thellë se në motërzimin e parë. Mbi këto ndryshime ka ndikuar nga njëra anë realizmi (një militarist i vjetër që nuk nxjerr mësim nga historia, duke e nderuar luftën, është po aq fajtor sa dhe gjeneralë të tjerë që udhëhoqën armatat e tyre në Shqipëri), e nga ana tjetër, po aq dhe Realizmi Socialist (varianti i vitit 1963 u akuzua, ndër të tjera për mungesë urrejtjeje ndaj armikut, dobësim të luftës së klasave).

Përftesat e reja të groteskut në këtë variant të dytë i përshtaten më së miri natyrës intriguese të fabulës dhe i japin edhe më dramacitet rrëfimit.

Përpunimi që shënon motërzimin e vitit 2001 ka prekur më tepër anën gjuhësore (krijimi i neologjizmave dhe zëvendësimi i fjalëve të huaja) dhe atë stilistikore (është shkrirë jo vetëm fjala e personazhit me fjalën e rrëfimitarit, por edhe frazat e personazheve janë shkrirë me njëri – tjetrin; fraza të ndryshme janë lënë përgjysmë, janë prishur disa prej konvencioneve të pikësimit) Duke kërkuar të ndreqë diçka nga motërzimi në motërzim Kadareja synon përkryerjen e këtij romani. Kërkimi i përsosmërisë, teksti përfundimtar i *Gjeneralit*, përkryerja e tij artistike

janë rezultat i një përpunimi përmirësues nëpër kohë.

BIBLIOGRAFIA

DADO, Floresha (1997), Proza nëpër teknikat poetike, Toena, Tiranë.

DE BIASI (1982), La legende de Saint Julien l'Hospitalier, La critique Genetique.

KADARE, Ismail (1962), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Zëri i Rinisë, Tiranë.

KADARE, Ismail (1963), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Naim Frashëri, Tiranë.

KADARE, Ismail (1967), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Naim Frashëri, Tiranë.

KADARE, Ismail (1990), Ftesë në studio, Tiranë.

KADARE, Ismail (1996), Dialog me Alain Bosquet, Onufri, Tiranë.

KADARE, Ismail (2001), Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Onufri, Tiranë.

KUÇUKU, Bashkim (2000), Kadare në 40 gjuhët e botës, Onufri, Tiranë.

SILIQI, Drago (1989), Në kërkim të së resë, N. Frashëri, Tiranë.

ON SOME FEATURES OF NARRATION ON KADARE'S WORK MBI DISA VEÇORI TË RRËFIMIT NË VEPRËN E KADARESË

LEDIA DEMA
Université Lumière Lyon 2, Lyon, FRANCE
Email: ledia75@yahoo.fr

AKTET IV, 4: 794 - 797, 2011

PERMBLEDHJE

Në kuadrin e këtij artikulli ne propozojmë një lexim semiotik dhe narratologjik të veprës së Kadaresë, duke u përqendruar në disa veçori të mënyrës së tij të rrëfimit. Në të vërtetë, në mjaft romane të këtij autori shfaqet një dukuri e pazakontë për letrat shqipe, e cila e intrigon lexuesin. Bëhet fjalë për disa thyerje tekstuale që shprehen në trajtën e «fragmenteve nga kronikat», në pasazhe me shkronja të pjerrta, nga «thënie njerëzish të panjohur» etj. për të përmendur vetëm disa nga këto forma të veçanta që i gjejmë te Kadareja, sidomos në fillimet e krijimtarisë së tij. Hipoteza jonë është që ky lloj «fragmentarizimi narrativ» që përbën një specifikë të mënyrës së rrëfimit te Kadareja, i përgjigjet një strategjie të shprehuri që ka si efekt një rrëfim ambivalent, duke qenë se «zëri i tekstit» nuk varet nga një instancë e vetme dhe homogjene. Përkundrazi, ai skicohet nëpërmjet një numri të madh dhe heterogjen zërash polifonikë që prishin karakterin unik të fjalës autoritare. Ky karakter heterogjen krijon një efekt palexueshmërie që interferon me mesazhin dhe krijon një problem për lexuesin. Shpesh këto thyerje i duken atij si një errësim, një paqartësi, duke u perceptuar si një lloj hermetizmi. Në kumtesën tonë ne do të shqyrtojmë shkurtimisht disa romane, si *Përbindëshi*, *Kronikë në gur*, *Kështjella*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, dhe *Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*, me qëllim që të ilustrojmë me shembuj konkretë tezën tonë.

Fjalët çelës: ambivalencë, heterogjeneitet, lexues, thyerje tekstuale, rrëfim

Mjaft romane të Kadaresë shfaqin një dukuri të pazakontë për letrat shqipe, e cila tërheq vëmendjen e lexuesit dhe e intrigon atë. Bëhet fjalë për disa thyerje tekstuale, të shprehura në trajtë «fragmentesh nga kronika», në pasazhe me shkronja të pjerrëta, në « thënie njerëzish të panjohur », në kapituj pa emër, etj. Këto përbëjnë disa nga format e veçanta që ndeshen te Kadareja kryesisht në fillimet e krijimtarisë së tij³.

Thyerjet narrative, të cilat përbëjnë një specifikë të këtij autori, i përgjigjen një strategjie të shprehuri, që ka si efekt një rrëfim ambivalent, pasi «zëri i tekstit» nuk varet nga një instancë e vetme dhe homogjene. Përkundrazi, ai skicohet nëpërmjet një numri të madh dhe heterogjen zërash polifonikë që shprishin karakterin unik të fjalës autoritare. Ky karakter heterogjen krijon një efekt palexueshmërie që interferon me mesazhin dhe krijon një lloj problemi për lexuesin. Shpesh këto thyerje, hapësira të bardha, ndryshime tipografie, kolazhe etj. i krijojnë atij përshtypjen se ka të bëjë me një errësim, një paqartësi, me një fjalë, me një lloj hermetizmi. Në fakt, këto fenomene e pezullojnë për një çast

³ Për një studim më të detajuar të këtyre formave narrative shih : DEMA Ledia, Pour une approche sémiotique des formes narratives dans l'œuvre d'I. Kadaré. Le cas de la fragmentation narrative, Tezë Doktorature në Shkencat e Gjuhës, Universiteti Lumière Lyon II, Departamenti i Shkencave të Gjuhës,

proçesin linear të të lexuarit, pasi nga njëra anë pasqyrohen në planin e rrëfimit me ndryshim të narratorit, të perspektivës, të pikëvështrimit dhe fokalizimit, si dhe nga ana tjetër bashkërenditin praktika të ndryshme diskursive (letra, ditare, teza doktorate, etj.).

Ne do të shqyrtojmë shkurtimisht disa romane⁴, si për shembull *Përbindëshi*, *Kronikë në gur*, *Kështjella*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, me qëllim që teza jonë të ilustruhet me shembuj konkretë.

Së pari, te *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, rrëfimi karakterizohet nga një ligjërim heterogjen, i cili shfaqet dukshëm edhe në planin tipografik: rrëfimi kryesor, bërë në vetë të tretë dhe i ndarë në kapituj me numra, ndërpritet në mënyrë të çrregullt nga kapituj të shkurtër të panumërtuar. Duke adoptuar një fokalizim të ndryshëm, këto pasazhe krijojnë efekte të ndryshme për lexuesin, ngadalësojnë ose përshpejtojnë ritmin e tekstit: herë herë ata bëjnë të perceptohet një efekt thellësie për shkak të këndvështrimit 'nga lart' që parapëlqehet nga Kadareja dhe që shpreh aftësinë e tij për t'u shkëputur nga e tashmja, për ta vështruar botën nga një lartësi më e madhe. Por, jo rallë, këto fragmente krijojnë përkundrazi një lloj afërsie me lexuesin.

Nga ana tjetër, këtyre dy formave kryesore u duhen shtuar edhe ditari i mbajtur në vetën e parë njëjës nga një ushtar dezertor gjatë kohës së luftës, si dhe letrat e veteranëve. Ato u bëjnë jehonë zërave të dezertoreve dhe paraqiten me shkronja të pjerrëta në tekst. Duhet theksuar se këto dy praktika të ndryshme diskursive, si letrat edhe ditari, paraqesin një pikëvështrim të ndryshëm nga ai i ushtarakut, domethënë i gjeneralit, duke denoncuar luftën, hipokrizinë dhe përgjegjësinë e atyre që marrin të tilla vendime. Disa pasazhe të tjera me shkronja kursive, paraqesin kujtime të ish luftëtarëve, dëshmi të ndryshme për vendndodhjen e varreve, reminishenca e copëza ditaresh. Në këtë roman, pra, ndeshim një sërë thyerjesh me natyrë të ndryshme, të cilat krijojnë një lloj dialogjizmi, një ndërthurje pikëvështrimesh, të

cilat e ftojnë lexuesin të vetëndërtojë mendimin e tij lidhur me luftën, dhe me metonimi mbi fashizmin, por njëkohësisht edhe mbi misionin e gjeneralit, dhe madje e ftojnë atë që të zbulojë veçanërisht anën humane dhe humanitare të misionit të tij.

Përsa i përket *Përbindëshit*, ai paraqitet si një roman i errët. Rrëfimi, i cili përmban fragmente që shfaqen në mënyrë arbitrare, reflekton një lloj kompleksiteti nga ana e ndërtimit, një mbivënie stratesh dhe pikëvështrimesh që e bëjnë më të vështirë perceptimin e romanit në tërësi. Edhe këtu materiali romanesk është heterogjen: letër dashurie, tezë doktorate, reflektime dhe kujtime. Këto janë forma të ndryshme që e diversifikojnë perceptimin e romanit nga ana e lexuesit. Në këtë libër bie në sy prania e intertekstualitetit, çka bën që figurat e Iliadës të shfaqen si personazhe të plota, të cilat marrin pjesë në intrigë. Nga ana tjetër, edhe statusi i narratorit nuk është homogjen. Në tekst, ai shfaqet i ndarë në dy instanca: narratori kryesor dhe skriptori. Ky i fundit vendos një lidhje të veçantë me lexuesin nëpërmjet fragmenteve të doktoratës së tij, që ai ofron për lexim. Për pasojë, instabiliteti i figurave nga njëra anë dhe dyzimi i narratorit nga ana tjetër, krijojnë një rrëfim të mjegullt, jo fort të qartë.

Duke bërë një përgjithësim, te *Përbindëshi* mund të vërehet një lloj mbivendosje e elementeve të dispozitivit figurativ, siç janë aktorët, koha dhe hapësira. Kështu, përftohen dy linja narrative dhe, siç nënvizon B. Kuçuku (2000:18), pothuajse çdo aktori të kohëve « moderne » i bashkëvihet prototipi i Antikitetit. Për rrjedhojë, krijohen çifte aktorësh që shpesh herë zëvendësojnë njëri tjetrin: Gent Ruvina/Laokont, Lena/Helena, Maks/Menelau etj. Figura të tjera, gjithashtu, funksionojnë në të njëjtën mënyrë: qyteti i Tiranës, që shndërrohet në Trojë, dhe sigurisht, figura kryesore e romanit dhe më interesantja nga pikëpamja e transformimit: përbindëshi. Kjo figurë polisemike merr forma të ndryshme vizuale, duke krijuar në këtë mënyrë problemin e referencializimit dhe stabilitetit figurativ: herë herë ai shfaqet si një furgon i braktisur, herë si kalë prej druri, dhe herë të tjera

⁴ Studimi ynë është bazuar në versionin francez.

si përbindësh. Nga një kapitull në tjetrin, këto variacione figurash bëjnë që në këtë roman të shihen variante të ndryshme të historisë së Kalit të Trojës. Për më tepër, ky rrëfim kompleks krijon një efekt turbullues: « realiteti » i përshkruar duket disi kaotik, i lëvizshëm, në kufi midis reales dhe irrealës.

Kështjella, nga ana e vet, karakterizohet nga një alternim kapitujsh, disa të shkruar në vetë të tretë dhe disa në vetë të parë. Kjo shoqërohet me një ndryshim tipografik, i cili shprehet me shkronja romane vs italice, çka korrespondon edhe me ndryshimin e narratorit. Krijohet në këtë mënyrë një ndarje e rrëfimit në dy pjesë, që mund të konsiderohet si një fakt tipografik, narrativ dhe enonciativ në të njëjtën kohë. Kalimi nga veta e tretë në të parën, me ndryshimin e perspektivës që implikon, shënon dukshëm një ndërprerje të homogjeneitetit të tekstit. Ky alternim i perspektivës në mënyrën e të rrëfyerit krijon një lloj tensioni në aktin e leximit, një kadencë, që i jep një frymëmarrje gjithë romanit dhe e bën leximin më ritmik. Skenat me intensitet të lartë nëpër kapituj, pasohen nga një moment pauze në pasazhet me shkronja të pjerrëta, për të vijuar më pas drejt një pike tjetër.

Ky rrëfim i alternuar luan rolin e vet edhe në kohëzgjatje. Kalimi i njëpasnjëshëm i ditëve, amplifikuar nga loja e kondensimit dhe zgjerimit letrar, e shpalos tërë rrëfimin si një shtrirje pa mbarim. Kjo i jep një përzgjatje edhe gjendjes së ankthit, këtij ankthi të çuditshëm, plot me diell e dritë verbuese deri sa rënia e daulleve lajmëron ardhjen e shumëpritur të pikave të para të shiut.

Një tjetër roman interesant për sa i përket rrëfimit, është edhe *Kronikë në gur*, i cili luan me vetë parimin e narratorit. Prania e tij merr formë të ndryshme, duke filluar nga ai i narratorit të thjeshtë homodiezhetik (shih: G. Genette), deri në mungesën apo zëvendësimin e tij nga narratorë të tjerë. Këtu Kadareja shfrytëzon një formë rrëfimi, e cila shpërndan të dhënat dhe krijon thyerje, ndër të tjera, falë teknikave të montazhit dhe kolazhit të zërave. Për pasojë, historia tregohet në mënyrë të tillë, që instancat narrative plotësojnë njëra tjetrën. Megjithëse këndvështrimi kryesor është ai i një fëmije, jo

rallë janë pikërisht disa nga personazhet, si p. sh. plaka Sose dhe vetë folësi që marrin përsipër rrëfimin: pra, narratori-personazh nuk është i vetmi burim informacioni në roman. Ky funksion kryhet gjithashtu nga një sërë fragmentesh me kronika, dy pasazhe të titulluar « në mungesë të kronikës », si dhe « nga thëniet e të panjohurve ». Siç shihet, efekti i zërave, i shpërndarë në disa narratorë, krijon në këtë mënyrë një jehonë komplekse.

Vlen të theksohet se fenomeni i kolazhit, veçanërisht i pranishëm në këto pasazhe, mbledh dhe bashkangjit copëza thëniesh heterogjene, çka shkakton zhurmëzimin e mesazhit. Si rrjedhim, pasazhet duken inkoherente dhe disi të pakuptueshëm për lexuesin. Duke shtruar problemin e identifikimit të folësit të cilit i atribuohet, kolazhi vë në rrezik monosemine, lexueshmërinë dhe qartësinë e kuptimit. Madje, duke e përgjithësuar, mund të themi se shpesh romanet e Kadaresë funksionojnë si kolazhet që ndeshen tek *Kronikë në gur*. Montazhi i zërave, ndryshimi i pikëvështrimeve dhe narratorëve, futja e praktikave të ndryshme diskursive, krijojnë një efekt heterogjen, i cili perceptohet lehtë nga lexuesi.

Pra, megjithëse disi kaotike në shikim të parë, por me një arkitekture të brendshme rigorozë, struktura e *Kronikës* shkon përtej skemave tradicionale të kohës. Ajo shfaqet si një konstruksion mbi-tekstual, në interseksion të gjithë pikëvështrimeve të pranishme në roman. Ato përfaqësojnë nivele të ndryshme pertinence, duke mos paraqitur të njëjtën shkallë vërtetësie. Romani humb kështu qëndrën e vet, por ruan kuptimin e tij si njësi, duke qenë se çdo fragment merr kuptim në raport me të tërën. Është pikërisht kjo lëvizje që krijon kuptimin e parkurit interpretativ.

Si konkluzion të kësaj pasqyre të shpejtë të romaneve të lartpërmendur, mund të themi se rrëfimi kadarean ka një arkitekturë enonciative origjinale. Duke mos qenë aspak monologale, kjo arkitekture funksionon si një dialektikë e bazuar mbi dialogjizmin dhe polifoninë, gjë që çon në ndërveprimin e pikepamjeve të ndryshme të cilat ndeshen në brendësi të çdo romani. Në vend që

të funksionojë si një përfaqësim homogjen i asaj çka komunikohet nga folësi, kuptimi përftohet si një lloj dialogu abstrakt, metafizik, si një koncert zërash të orkestruar. Në romanet e Kadaresë skicohet një lojë komplekse mendimesh që ndërthuren, kundërvihen dhe plotësojnë njëri tjetrin. Loja e instancave narrative, shembuj të cilave u përmenden më lart, krijon një polifoni komplekse, pothuajse një lloj palexueshmërie, që ka si origjinë alternimin e sekuencave heterogjene. Kjo paqartësi enonciative karakterizon jo vetëm tekstin e romanit, por edhe formën e tij semiotike. Ndërtimi i veprës, që vë në skenë këtë plurivokalitet, merr kështu një vlerë artistike dhe estetike.

Parë në këtë drejtim, mund të themi që estetika e Kadaresë afrohet madje me atë të Bakhtinit. Siç e pamë, mënyra e tij e veçantë e të rrëfyerit karakterizohet nga një natyrë opake, një shprehje e funksioneve narrative dhe aktenciale. Polifonia, shpërndarja e zërave dhe e pikëvështrimeve, mënyra jo autoritare, por bindëse e të raportuarit të fjalëve, shpërndarja e rolit të narratorit që e bën atë të pagjendshëm dhe mesazhin e tij ambivalent, fragmentarizimi, i cili e bën të pamundur dhënien e një përgjigjeje univoke pyetjes « kush flet? », përdorimi i formave moderniste si fragmentet, kolazhet, montazhi, çojnë shpesh në një rrëfim të copëzuar, interpretimi i të cilit kërkon një lexim jo kronologjik. Ai karakterizohet nga efekte të çuditshme dhe ambivalente, të përforcuara nga

përdorimi i tropeve, çka përfundon në një realizëm me ngjyra groteske.

Pamundësia për të shprehur hapur mesazhin e tij, lidhet ndoshta me strategjinë e ndjekur prej autorit, i cili ka gjetur kështu një mënyrë për të maskuar disi përmbajtjen jo konformiste që ai synonte të shprehte, në kushtet konkrete të epokës kur këta libra janë shkruar. Thellësia dhe kompleksiteti i rrëfimit që u përpoqëm të nxirrim në pah në këtë kumtesë, e bëjnë rrëfimin kadarean, origjinal e të veçantë, përtej konfiguracioneve të tij karakteristike e të pazakonta.

BIBLIOGRAFI

- DEMA, Ledia (2011), *Pour une approche sémiotique des formes narratives dans l'œuvre d'Ismail Kadaré. Le cas du morcellement narratif*, Presses universitaires européennes.
- GENETTE, Gerard (1972), *Figures III, Seuil*.
- KADARE, Ismail (1970), *Le Général de l'armée morte*, Albin Michel.
- KADARE, Ismail (1985), *Les tambours de la pluie*, Paris, Fayard.
- KADARE, Ismail (1991), *Le Monstre*, Fayard, Paris.
- KADARE, Ismail (1973), *Chronique de la ville de pierre*, Hachette.
- KUÇUKU, Bashkim (2000), *Kadare në gjuhët e botës*, Tirana, Onufri..

WOULD SUMERIAN LANGUAGE BE A FURTHER POSSIBILITY TO ALBANIAN HISTORICAL LINGUISTICS AND ALBANOLOGY? A DO TË ISHTE GJUHA SUMERE NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR HISTORINË E SHQIPES DHE ALBANOLOGJINË?

ANASTAS S. SHUKE
Blvd. P. N. Luarasi, Vila 49/4, Tiranë
Email: anastas.shuke@gmail.com

AKTET IV, 4: 798 - 803, 2011

PERMBLEDHJE

Studimeve krahasuese në sumerologji mund t'u bashkëngjitej edhe shqipja, me arsyetimin e ndihmesave që mund të jepte ky krahasim dhe duke pretenduar vëmendjen e gjuhësisë historike të shqipes dhe albanologjisë. Argumentet përfshijnë krahasimin tipologjik: Ergativiteti i njëjtë dhe prania e Trajtës së Shkurtër të Shqipes në formën e MP, CP, DP, PA; gjinorja/pronore me -ak/e-; krahasime etimologjiko-semantike nga "Epika e Krijimit" në gjuhët sumere, akade, sanskrite -me shqipen nëpërmjet anglishtes; krahasime për emra zota/planetësh, muajsh, qytetesh; zbërthime aglutinative sumerisht-anglisht-shqip ku përsëriten emra, folje, përemra dëftorë, ndajfolje, që shprehin aglutinativitetin e sumerishtes nëpërmjet shqipes: mundësi për klasifikimin e gjuhës Shumere. Rivlerësimet etimologjike të Shqipes nëpërmjet sumerishtes.

Fjalët çelës: albanologji, sumer, shqip, krahasim, etimologji, ergativ, trajta-shkurtër

SUMMARY

To the comparative studies in Sumerology might also be attached Albanian, arguing the contributions of such comparison and claiming the attention of Albanian historical linguistics and Albanology. Arguments include typological comparison: equal Ergativity and Albanian Short-Form presence in Sumerian in the form of MP, CP, DP, PA affixes, genitive/possessive ãith "-ak, e-", etymological comparisons from Epic of Creation in Sumerian, Akkadian, Sanskrit, through English to Albanian; comparison of names for gods/planets, months, cities; agglutinative division Sumerian-English-Albanian ãith repetition of certain nouns, verbs, çasutive-pronouns, adverbs, shoëing the agglutinativity of Sumerian through Albanian: a possibility for the classification of Sumerian; Etymological reevaluations of Albanian by Sumerian.

Key-words: Albanology, Sumerian, Albanian, comparison, ergative, agglutinative, etymological.

HYRJE

Mundësia e vijimësisë historike sumer-pellasg-ilir-shqiptar, do na sugjeronte studimin krahasues të sumerishtes e shqipes.

Studimi i gjuhës së paklasifikuar sumere, është "në nivel të paplotë, me çështje themelore ende të pazgjidhura" (Hayes, 2000). Arsyet e vështirësive përfshijnë:

1- Nuk janë zbuluar deri më sot lidhje gjenetike me ndonjë gjuhë tjetër të njohur.

2- Shkrimi kuneiform nuk e paraqet në marrëdhënie një për një, leksikon dhe gramatikën e sumerishtes, duke vështirësuar rindërtimin morfologjik.

3- Transliterimi bazohet në leximin Akadisht të shenjave logografike/rrokjore; fjalori është rindërtuar kryesisht mbi bazën e listave leksikore Akadisht/Shumerisht.

4- Mungojnë folësat amëtarë; gjithashtu s'ka një listë standarte të leximit të shenjave Shumerisht.

Ekzistojnë tekste që përshkruajnë fundin e sumerit klasik në rreth 2300pr.k. si ngjarje tepër të rëndë. Një tekst titulluar "Vajtim mbi rrënimin e Shumerit" thotë: "*Mbi Dhe (Shumer) ra një fatkeqsi / e panjohur për njeriun / që s'ish parë kurrë më parë /Një stuhi, një Erë e Ligë vërtitej në qiejt... / Lumenjtë rridhnin me ujë të hidhur / Njerëzit të tmerruar mezi merrnin frymë / Era e Ligë i zuri s'u la më asnjë ditë / gojë të mbytura në gjak / fytyra e zbehtë prej Erës së Ligë.../ Thëntë Anu, mbreti i zotave,/"Eshhtë mjaft"; / Dhëntë Enlili, mbreti i vendeve, / një fat të mbarë!" Për vërtetësinë e ngjarjes dëshmon edhe historiani babilonas Berossus. Ajo që pasoi duhet të ketë qenë një dyndje përfundimtare larg qytetit të Urimit, LARG Shumerit. Këtu gjejmë lidhje dy momente:*

a- Dyndjet IndoEuropiane (ProtoIE) mendohet se ndodhën në rreth 2400-2200pr.k., rreth të njëjtës periudhë me datimin e rrënimin të Shumerit klasik - Urim II. (Sitchin,1976)

b- Straboni përdor për Pellazgët termin "PeLARGos," tërë autorët antikë "quanin PeLARG-ë banorët Europeanë në brigjet e Mesdheut apo në Europën jugore". (R. D'Angely,1998). Sipas Pausanias (VIII,1,2) PeLARGosi (heroi eponim Pellazg) është i pari njeri lindur në Tokë, etnia e të cilit i përket një qytetërimi prehistorik Neolitik....(Sh.M.Ömer,2008).

Dyndjet pas rrënimin të Urim II mund të jenë emërtuar IndoEuropiane nisur nga afërsia e krahasueshme në kohë me gjuhën më të vjetër të njohur të grupit IE- Saskriten. Këto dyndje mund të ketë qenë përbërë vetëm nga popullsia Shumere (Urim-60.000) që kaloi Azinë e Vogël drejt Ballkanit e Europës, të ardhur PeLARG=prej-larg. Etimologjia e drejtpërdrejtë që propozoj, s'është rastësi, por mbështetet në analizat etimologjiko-semantike të Shumerishtes. Edhe personazhet e epikës "Muji e Halili" e

mbështetin këtë. Kultura Shumere nis prej Neolitit, në përputhje me ç'na thotë Pausania.

Gjuha shqipe është klasifikuar si degë më vete e grupit IE, pa nëndegë, nga Franz Bopp-i rreth 160 vjet më parë (1852), kohë kur sumerishtja s'njihej. Shqipja pranohet përgjithësisht se bën pjesë ndër gjuhët e vjetra IE. Problem për krahasimin do ishin ndryshimet fonologjike të Shqipes, dokumentuar prej shek.15. Por ato nuk mund të jenë dhe për fat nuk janë e vetmja rrugë krahasimi. Ato kanë bllokuar përparimin në gjuhësinë historike të Shqipes. Në krahasimin me një gjuhë kaq të vjetër sa Shumerishtja, çdo gjuhë IE do ishte pothuaj në të njëjtat kushte dokumentimi me Shqipen, - gjuha Sanskrite është dokumentuar pas 1500pr.k. Dallimet thelbësore me gjuhët e afërta gjeografikisht, "janë përcaktuar përfundimisht." (Hayes,2000)

Ndryshimet fonologjike në varësi nga kushtet historiko-gjeografike, ndodh të jenë të papërfillshme. Për studiuesin Xhelal Ylli në një projekt të përbashkët në Universitetin "Erlange" në Gjermani, rezulton "konservim i gjuhës sllave për mbi 500 vjet", në disa fshatra të zonës verilindore të Shqipërisë, në kushte jo të favorshme. Përmendim rastin e Islandës me konservim prej mbi 1000 vjet, siç pohon J.A.Halloran, dhe qëndrueshmërinë e vetë Shumerishtes dokumentuar mbi 2000 vjet. Pra, ekziston mundësia që edhe Shqipja ta ketë konservuar gjatë të paprekur fondin bazë, ndoshta që nga periudha Shumere.

Metoda

A - Studimi strukturor i Shumerishtes, ngjashmëritë me Shqipen: krahasimi tipologjik, ergativiteti i Shumerishtes - Trajta e shkurtër e Shqipes. Aglutinativiteti shprehur në zbërthimet etimologjiko-semantike të Shumerishtes nëpërmjet Shqipes.

B - Krahasimi etimologjik tre-gjuhësh Shumerisht-Anglisht-Shqip i fjalëve, shprehjeve dhe fjalive të ngjashme fonetikut mbështetur nga të dhëna historiko-epike, dhe referenca gjuhësore shumerologjike.

Parimi bazë në analizën etimologjike: Terminologjia Shumere, si e tërë lashtësisë, është përsëkruese. Strukturat semantike disa fjalëshe apo fjalitë janë tregues me vlerë të mirëfilltë krahasuese.

Krahasimi Tipologjik

Shumerishtja konsiderohet “gjuhë e izoluar”, e vdekur prej 2000pr.k. Ka patur dy dialekte: *EME.KU*(*EME.KA*) ose *EME.GIR*(*EME.GI/EME.KIR*), si dialekti kryesor, dhe *EME.SAL*(*EME.SHAL*). S’është përcaktuar etimologjia për të parin por quhet “gjuha e Shumerit”; i dyti “gjuha e grave”, pasi shenja kuneiforme për *SAL/SHAL* është përkthyer uterus/vulva dhe ka formën (Halloran/Hayes). Semantikisht shqip: E.Me.Shal. Po kështu mund të kuptohet termi i dialektit bazë.

Ergativiteti, Aglutinativiteti, Tipologjia e Rendit të fjalëve, përbëjnë elementët izolues të Shumerishtes nga gjuhët e grupit IndoEuropian dhe Semitik. Nëpërmjet tyre “Shumerishtja punon ndryshe nga gjuhët e dy grupeve” (J.L.Hayes,2000). Deri sot e vetmja gjuhë ergative në Europë konsiderohet ajo Baske që “ka Ergativitetin më të gjithanshëm në planet” (R.L.Trask,1997)

Gjuhët janë të tipit “emërore-kallzore” ose “ergative”. Në “ergativet” kryefjala (agjenti) për folje kalimtare është në rasën “ergative,” dhe ndiqet nga kallzuesi (S-V-O). Në Shumerisht rasia ergative shënohet me mbaresën –e të kryefjalës/agjentit. Efekti i ergativitetit, është përcaktim dyfish, kuptim më i mirë, më intuitiv i rolit veprues të agjentit. Të analizojmë shembullin e mëposhtëm në Shqip e Anglisht (Hayes,2000):

The boy rolled the ball doën the hill. – Djali rrokullisi topin tatëpjetë kodrës.

Djali=Agjenti; topi=pacienti. Përkthimi i mësipërm është i fjalëpërfjalshëm. Por Shqipja ka mjete të tjera veç lakimit:

Djali e rrokullisi topin tatëpjetë kodrës.

Trajta e shkurtër “e” jep përcaktim dyfish, kuptim më të mirë, më intuitiv të rolit veprues të agjentit, siç e sqaron Hayes ergativitetin e Shumerishtes. Pra, Shqipja mund të jetë ergative,

dhe gjithashtu mund ta ketë krejt të njëjtë atë me Shumerishten, duke përdorur të njëjtën “e” për ta realizuar. Por, këtu s’kemi “rasën” ergative –e, por trajtën e shkurtër. Ndryshimi nga modeli Hayes, mund të vijë nga problemet e shkrimit kunjiform dhe transliterimit me rregullat Akadisht (pika 2;3), që çojnë lehtë në rindërtim morfologjik të gabuar.

Profesori Hayes, duke analizuar më pas “vargun foljor” Shumer, flet për ekzistencën e disa parashtesave dhe prapashtesave (apo mbaresave) të tij, të cilat kanë funksionet që vijnë: MP- parashtesë e mënyrës që ndoshta krijon lidhoren, kushtoren e ndonjë tjetër; CP- Parashtesë e ashtuquajtur e zgjedhimit (rreth 6), një veti misterioze që mund të shprehë afërsinë e folësit me veprimin (mu), marrëdhënie të agjentit me veprimin, apo ndoshta përfshirjen emocionale/mendore të folësit në veprimin që kryhet; DP- Parashtesë që risjell/rregjistron/lidh marrëdhëniet e rasave në fjali, në një marrëdhënie të përcaktuar saktë një për një, dhe thotë se DP mund të jenë të përngjitura 2,3 deri edhe 4 të tilla, por DP e rasës dhanore është gjithnjë e para; PA – Prapashtesë që tregon “mundësi”; Dhe thotë se në Shumerisht mund të ndryshojë edhe rrënja e foljes sipas aspektit, i kryer/i pakryer.

Pothuaj të gjitha këto parashtesa, prapashtesa apo dhe ndryshimi i rrënjës në të kryerën, janë prezente edhe në Shqip.

Rolet e përmendura të MP (nu=nug) dhe CP (mu) në Shqip i kryejnë pjesëza apo nje të ndryshme apo edhe trajta e shkurtër. Rolin e DP, sikurse duket, e kryejnë trajtat e shkurtëra dhe ato të përngjitura. Në rolin e PA mund të jenë prapashtesat e mënyrës dëshirore dhe habitore. Gjithashtu Shqipja ka plot raste kur rrënja e foljes ndryshon sipas aspektit i pakryer/i kryer psh: bie – ra; vij – erdha, shikoj – pashë, rri – ndenja, etj. Në Akadisht e kryer / e pakryer = hamtu/maru, që në Shqip afron me jam.tu/maru (e anasjelltë).

Rendi i fjalëve në fjalinë Shumere mendohet të jetë (në formën e patheksuar): S-O-V, kryefjalë, kundrinor, kallzues (Anu neri a). Edhe në Shqip, pavarësisht rregullit të ngulitur sot, edhe prej ndikimit të gjuhësisë, që është S-V-O, mund të

përdorim renditjen SOV pa ndryshuar asgjë në kuptim (veç theksit): An-i është njeri = An-i njeri është. Fjalitë ergative, siç e pamë më lart, e kanë rendin SVO të detyrueshëm, si edhe në shqip. Pra, edhe tipologjia e rendit të fjalëve nuk përbën për Shqipen, ndryshim ndarës nga Shumerishtja.

- Në Shumerisht, Gjinorja/pronore realizohet kryesisht me prapashtesën –ak, (Hayes,2000) e cila në kunjiform paraqitet nga pjesë të dy shenjave, –a.k– “ma.ki₄/ke₄”, me transkriptimin –a/–ak.

Po kështu edhe në Shqip kemi përdorimin e prapashtesës –ak si psh: durrsak, ushtarak, fshatarak, vezake, etj., të cilat semantikisht shprehin rasën gjinore: i Durrësit, i ushtrisë, i fshatit, (me formën) e vezës, etj. Pra, përputhja është e dukshme.

Gjithashtu Sumerologë të ndryshëm mendojnë se edhe e₂=shtëpi/tempull, paraqet një formë pronore (gjinore), duke pranuar se (ndoshta) Shumerishtja s’e ka fjalën “shtëpi.” Kjo formë e gjinore është krejt e njëjtë në Shqip.

Krahasime Etimologjiko-semantike

Ndër dokumentet më të studiuara është “Epika e Krijimit” (Sitchin,1976). Aty nëpërmjet një gjuhe alegorike jepet zanafilla e Sistemit Diellor₂ secili planet përfaqësohet nga një zot. Veçoritë e zota/planetëve përsëriten në tërë panteonët duke mundësuar krahasimin në gjuhë të ndryshme:

KI–Earth–Toka - tokë ose përem.dëft. Ky=Ki; (Halloran,2006) –“ki” zëvendëson një emër.

Në Sanskrit/Veda përfaqëson “KETU”; Ketu=këtu mund të ketë mbetur në Shqip në formën: këtu/tukë –Tokë. po ashtu vini re se ki=ky=këtu, përem.dëft/ndf.vendi-afërsi.

TIAMAT–Tiamat– Trup qiellor “amë”, që s’është më, pas përplasjes/ndarjes së të cilit u krijua Toka dhe Brezi i Asteroidëve. Sanskrit: Prit-Hivi – ama qiellore (Sitchin,1976) priti 10 fëmijë; ndoshta priti përplasjen t’i vijë. Duket rrënja Shqipe am-amë.

Tiamat= Planeti që mungon: Hebraisht–Tehom ≈ të hum; Greqisht – omorka≈umur.ka= ka.humbur. (Sitchin,1976) Mund të jetë edhe Tiamat = Kiamak=Ki.Am.A.K(i).

SHAR – Shar – Zot/Planeti Nibiru/Nibira; Nibira≈Ni.bir.a, bir/planet i sistemit diellor. Sipas Shar/Nibiru ishte zot/planeti që u ndesh me Tiamat, e prej kësaj përplasjeje, lindi Toka e Asteroidët. Planeti Shar ka katër satelitë që rrotullohen si “erëra” rreth tij, pra i ngjan një sharre rrotulluese, dhe sipas epikës “çau më dysh Tiamatin,” pra termi Shar=sharrë mund t’i përshtatet mirë. Shar përdoret edhe në kuptimin mbret, lidhur me pozitën e epërme të Shar/Nibiru.

AN.SHAR – Saturn Nga pamja e unazave të Saturnit mundet: AN.SHAR=Anë.Sharrë duke i imagjinuar unazat gjatë rrotullimit të planetit; an.sharrë=mitër/bark/mes.sharrë.

KI.SHAR – Jupiter – Të dhënat astronomike japin të dhëna se sipërfaqja e Jupiterit është me kreshta malore tepër të larta, si “sharrë.” KI.SHAR=Tokë.Sharrë i përshtatet.

RAKIA – Asteroidët, brezi/byzlyku i rrahur; Akadisht: Rakkis; Sanskrit: RAHU; Hitite: Kum.mi.a;

Asteroidët u krijuan nga ndarja e Tiamat-it, një pjesë e të cilit krijoi Tokën – KI dhe pjesa tjetër duke u përplasur/rrahur periodikisht me Shar-in e satelitët e tij, U RAH deri sa formoi Brezin e Asteroidëve. Lidhja me Sanskriten është e dukshme – rrah; Asteroidët kishin qenë një trup me Tokën - KI (Tiamat=KI+Rakia).

Pra, ishin copëra që i RANë KI-së ≈ RA.KI.A(sht).

TOPONIME

E.RI.DU – Qyteti më i vjetër Shumer, vendi i ngulimit të parë; mund të kemi: E.Ri.Du(a)=Shtëpia ku dua të rri; A.Ri.Ta=ERDha (Sitchin,1976)

SIPPAR – Qytet kryesor për veprimtaritë e drejtësisë/gjykatave, qendra e Babbar-Utu. Pozicioni në hartë më veriori. Pra, mund ta mbështesë etimologjinë: SIPPAR≈Si.(i)Par ose Sipër.

Sipas Sitchin: Sippar=Land ëhere “Eagles” nest/rest;

Atëhere: Sippar(i)≈Shqipja.ri≈Shqipëri)

Urim – Uri₅ – Qytet kryesor në disa dinasti Shumere, mbi 800vjet (UrimII/III) Urim=Urim (Urim(ma.ki₄)≈ e uruar, e begatë).

Shuruppak – Tell Fara; Qendër me depo të mëdha drithi, dhe qendër mjekësore, Shurup.ak= i Shurupit/Shëru+pi; gjithashtu TellFara ≈ drithë/farë, DelFara (Sitchin,1976)

Shumer-Akad

Ki.en.gi(r)/Ki.Uri – Shumer/Akad (përkatësisht jugu/veriu i Mesopotamisë). Shumeri kish tokë ku bujqësia “bëhej vetë”, pjellore. Pra është e mundshme: Ki.e.ngi(r)= Tokë e nginjur ≈tokë e begatë; E kundërta për Akadin verior: Ki.Uri= Tokë e uritur, mbështetur në “Vajt看 për rrënimin e Shumerit”, del se jugu/Shumeri ishte hambari bujqësor.

Muaj

NISANNU ≈ 15April-15May = Muaji i parë i kalendarit Shumer: Nis.An.a≈Nis.Zot.a;

Zodiak ≈ Zoti.ak(a.ki) = i Zotit ; pra: Nis.An.a=Nis.Zot.a=Nis.Zodiak.asht=Muj i l-rë

SIMANU ≈ 15June-15July = Muaji i tretë i Kalendarit Shumer: ≈ Shi.Man.A= S’ka Shi.

Disa Fjali

^dNI.N.KA.ARNUN.A = Ni na ka arnun asht -PN (H.Radau,63)

LUGALE.UG.ME.LA.MBI.NERGAL=Mbreti/La(rt).Ka .Le(lind). Nuk.Më.La.Mbi.Nergal;

ANU.NERI.A = Anu Neri a = Anu njeri asht (H.Radau,1910)

UG.BI.A= Ug bie a = Nuk bie asht= lart (above) (H.Radau,1910)

EGER.A.MA.RU.BA.UR₃.RA.TA = Egërsia mbaroi, bëj urata -Listat të Mbretërve Shumerë (Sitchin,1976)

HA, GU₇ = food, eat, nurse, sëalloë = ushqim, ha, ushqej, gëlltis ≈ HA Halloran,108

Etimologji - Aglutinativiteti përmes Shqipes

E.NGIZ = engiz (ME.EN.GI) = to Cook = e ngjiz/gatuaj (Halloran,63)

MA₂=Mban (rrokjore: ; Halloran: gish.pesh=kish peshë). Forma sugjeron kuptimin.

MA₂GUR₈ = Ma.Gur = anije minerali, Halloran,167; Ma.Gur.Mah

MA.H (H=many)=to be or to make large=i madh/zmadhoj=Math/Madh Halloran,168

MUR = surround/enclose/guard/preserve = rrethoj/mbyll/mbroj/ruaj ≈ MUR (Halloran,181)

NA.RU.A = Stele = memorial, që na kujton, Na Ru Asht (Halloran,185)

SHEG₃, SHE₇(SHIN₃, SHI₇)=Raining=bie shi≈SHIN, SHI (Halloran,256)

SUL= to hurry, speed up, ëarrior/invader = nxitoj, Sulmoj, sulmues (Halloran,271)

UR=roof/entrance/yoke =çati, hyrje, kular ≈ Urë Halloran,300

Shumerishtja - çelës etimologjik për Shqipen:

BUJK≈BUJ.KI≈BAJ.KI=Bëj Tokën≈Punoj Tokën (BAL≈Baj=dig ë/spade = gërmoj me BEL Halloran,26) E.Çabej: BULK – BULQIT; (S.E. I,356) (K≈Q dhe BUL≈BAL)

QIELL ≈ KI.E.LL ≈ KI.E.LA(rt) (n’qiellt) = Kum.mi.a=Ra.ki.a - Qielli = brezi i asteroidëve, koncepti antik për qiellin. Sitchin,1976

QYTET ≈ KI.T.ET ≈ KI.T.AT ≈ (Cita’, Cite’) ≈ KI të Atit = Tokë e Atit (Zotit) ≈ At.Dhe

Latinisht: Civitatem; Çabej: gjytet/gjitet; qudat/qutat/qytat (S.E. VI,270)

PESHK: HA.A.KI – Fish=Peshk: ha.a.a.ki / HA.U(j).A.Ki ≈ Pi.ësht.ky ≈ P.esh.k = Peshk

HA.(A) (Halloran,82 – Peisk(o) IE – Halloran e pranon këtu lidhjen me IE).

Epika Shqiptare “MUJI dhe HALILI” mund të përbëjë një lidhje tjetër të drejtpërdrejtë të Shqipes me Shumerishten:

M.Uji≈Mb’Uj≈E.U=E.A(e ujit); po kështu mund të

kemi: HALILI ≈ ALIL ≈ ENLIL. Pra dy zotat kryesorë veprues në rrëfenjat Shumere janë të pranishëm në Eposin Shqiptar të Kreshnikëve.

Ndër morfemat më të përsëritura në Shumerisht veçojmë:

Ni = i_3 - përemër dëftor/vetor v.3-të njëjës - Ni(një/dikush)=Ai në Shqip. (Halloran,194)

A- 𐎠 prapashtesë fjalformuese në Shumerisht, formon emra nga foljet. (Halloran/Hayes)

Në Shqip ka kuptimin A=Asht; po këtë kuptim mund të ketë në Shumerisht me të cilin krijohen emrat foljorë të saj, si në etimologjitë e peshk, përmendore/stele, asteroidë, etj.

Shembujt e mësipërm përbëjnë rreth 15% të materialit të mbledhur deri më sot.

PËRFUNDIME E REKOMANDIME

1- Shqipja duket të ketë lidhje gjenetike me Shumerishten. Me studim ndërdisiplinor mund të ndriçohej Zanafilla e Shqipes në segmentet sumer-pellasg-ilir-shqiptar.

2- Ndryshimet fonologjike të fondit bazë të Shqipes mund të jenë të papërfillshme. Shumerologjia mund t'i shërbente shmangjes përfundimtare të problemit të "pakapërcyeshëm" të dokumentimit të ndryshimeve fonologjike të Shqipes dhe pra, dokumentimin zanafillor të gjuhës së lashtë Shqipe. Shumerishtja na jep çelësin më të saktë etimologjik për Shqipen.

3- Zbërthimet etimologjike tregojnë prani sistematike të lidhjeve, në leksik po edhe nga ana gramatikore, e prani të shumë foljeve njërrrokëshe: At, am, bir/bil/gjal, nib, e re, erë, ha, zu(zgju), urt, uri, ur, ik, rri, ru, rrah, bi(e)/ra, ma, var, ul, um, shoh/pa, le(lind), nis, kur/r ku, nug, ni, peshk, a(sht), u(jë), lum, gur, ilu(ill/yll)/i la(rt),

gji, di, bar(dh), kush(kuq), gu(shë), kala, kallam, nam, shal, etj.

4- Afëritë tipologjike janë pothuaj tërësore: Ergativiteti i njëjtë, mund të konsiderohet emërtim i ri për trajtën e shkurtër "e" të Shqipes; Aglutinativiteti na del përmes zbërthimeve të ndryshme etimologjike. Është e dukshme prania e trajtës së shkurtër të përemrit vetor, nëpërmjet Ergativitetit e në përbërjen e vargut foljor. Gjithashtu gjinorja/pronore -ak, duket të jetë gjurmë e pakundërshtueshme e Shumerishtes në Shqipen.

5- Ndhimesa shqiptare do ta ndihmonte përparimin e shkencës së asiriologjisë. Me thellimin e këtij studimi mund të propozohej Klasifikimi i Shumerishtes.

6- Studimi më i plotë kërkon krijimin e një bërthame studimore shqiptare në sumerologji, që mund të realizohet vetëm me mbështetjen e organizmave përkatëse shtetërore.

BIBLIOGRAFI

J.L. Hayes: A Manual of Sumerian Grammar and Texts, Malibu,CA,U.S.A.,2000.

J.A. Halloran: Sumerian Lexicon, Los Angeles, CA, U.S.A.,2006

H. Radau: NIN.IB, Determiner of Fates, Philadelphia,PA,U.S.A.,1910

L.W. King: Seven Tablets of Creation, London, UK,1902/1926.

Z.Sitchin: The Twelfth Planet, NY,U.S.A.,1976-2006

E. Çabej: Studime etimologjike në fushë të shqipes, Tiranë,1976/2002

Sh.M. Ömer: Në gjurmët e Pellazgjishtes, Fier, 2008..